

# **NGA KOLEKSIONI I RISALE-I NURIT**

**5**

**SHENJAT E MREKULLISË  
Paimitueshmëria e thukëtisë së  
Kur'anit**

**AUTOR**

**BEDIUZZAMAN  
SAID NURSI**

ISBN 978-975-432-330-6



*Shqipëroi nga arabishtja:*  
**Jusuf Salkurti**

*Përgatitja kompjuterike:*  
**Muhammed Salkurti**

Të gjitha të drejtat e ribotimit të kësaj vepre i përkasin vetëm përkthyesit. Asnjë pjesë e këtij koleksioni nuk mund të kopjohet dhe as të riprodhohet pa lejen e shqipëruesit.

**Sözler® Nesriyat Tic. ve San. A.Ş.**

- S. Demirel Bulvari Aykosan San. Sit.  
4'lü A Blok Kat: 3 No: 244  
İkitelli / İstanbul / TÜRKİYE  
Tel : +90 212 671 25 47 - 48 pbx  
Faks : +90 212 671 25 49
- Nuruosmaniye Cad. No: 28/2 Sorkun Han Kat: 2  
Çağaloğlu / İstanbul / TÜRKİYE  
Tel : +90 212 527 10 10 - 511 79 80  
Faks : +90 212 520 82 31
- Online Kitap Siparişi: [info@sozernesriyat.com](mailto:info@sozernesriyat.com)

[www.sozler.com.tr](http://www.sozler.com.tr) • [www.sozernesriyat.com](http://www.sozernesriyat.com)

Baskı Tarihi : 2010  
Baskı Yeri : İmak Ofset Basım Yayın  
Yenibosna / İSTANBUL  
+90 212 656 49 97 pbx

© Copyright Her Hakkı Mahfuzdur.

## **PÄRÄTTHËNIE**

### **Kush është**

**Bediuzzaman SAID NURSI**

**dhe ç'është vepra e tij**

**“RISALE-I NUR”?**

Bediuzzaman Said Nursi u lind në Turqinë Lindore më 1876 dhe ndërroi jetë në 1960 në moshën tetëdhjetë e tre vjeçare, pas një jete e një lufte vetmohuese e shembullore për çështjen e Islamit.

Ai qe shkollar i një rangu shumë të lartë, sepse nuk pati studuar vetëm shkencat tradicionale, por edhe ato moderne. Si rezultat i studimit dhe i aftësive të tij të rralla, që në rini pati fituar epititet “**Bediuzzaman**” (*Mrekullia e kohës*), epitet të cilin ia dhanë dijetarët më të shquar.

Jeta individuale e Bediuzzamanit kapi dekadat e fundit të kalifatit dhe të Shtetit Osman, të rrëzimit dhe copëtimit të tij pas Luftës së Parë Botërore dhe, pas formimit të Republikës më 1923, përjetoi tridhjetë e shtatë vjetorin e Republikës, vite këto deri më 1950 të njoitura për shtypjen antiislame të qeverisë dhe për represionin kundër drejtësisë fetare.

Pas Luftës së Parë Botërore, përpjekjet e Bediuzzamanit në rrugën e Islamit qenë shumë të mëdha. Ai, jo vetëm që u jepte mësim studentëve të tij dhe hynte në debate e diskutime me shkollarë e drejtues nga të gjitha anët e botës islame, por edhe komandoi e drejtoi për afro dy vjet

një regiment vullnetarësh kundër pushtimit rus në Turqinë Lindore në vitin 1914 derisa ra në burg. Gjer në atë kohë, ai kishte kërkuar e studiuar në detaje problemet e Islamit, duke marrë pjesë aktivisht në jetën publike. Sidoqoftë, vitet që panë tranzicionin nga Kalifati në Republikë, panë gjithashtu edhe tranzicionin nga "Saidi i Vjetër në Saidin e Ri". Saidi i Ri u karakterizua nga një têrheqje të tij prej jetës publike dhe u përqëndrua në studim, në adhurim e mendim, sepse ajo që kërkohet tani ishte një luftë e një natyre tjetër.

Pas një periudhe afro dyvjeçare, më 1925, Bediuzzaman u detyrua të mërgojet në Anadollin Perëndimor dhe 28 vjet me radhë, deri në prag të dhjetëvjeçarit të fundit të jetës së tij, ai vuajti mërgimin, burgimin, ngacmimin dhe persekutimin prej autoriteteteve.

Gjatë viteve në mërgim e izolim vendosi të shkruante "**Risale-i Nur**" (*Mesazhet e Dritës*) dhe përhapjen e tij anembanë Turqisë.

Vetë Bediuzzmani në ligjératë të drejtë u shpreh: "Tani unë e shoh qartë se pjesa më e madhe e jetës sime është komanduar e drejtuar jashtë aftësisë së perceptimit tim që do të nxirrte këto mesazhe për t'i shërbyer çështjes së Kur'anit. Sikur e gjithëjeta ime si shkollar të kishte kaluar në parapërgatitjen për këto shkrime, të cilat demonstron mrekullinë e Kur'anit".

Bediuzzamani e kuptoi çështjen esenciale të rënies së botës islamike, e cila u dobësua pikërisht në themelin e besimit. Ky dobësim i shoqëruar me sulmet e pashembullta kundër atyre themeleve në shekujt e XIX-të dhe XX-të, të ndërmarrja nga materialistët, ateistët e të tjerët në emër të shkencës e të progresit, e bënë atë që të kuptonte nevojën urgjente dhe themelore, e cila ishte ruajtja dhe forcimi i besimit. Kërkohet të harxhoheshin të gjitha përpjekjet për të rindëruar godinën e Islamit nga themellet e saja, duke filluar nga besimi dhe t'u përgjigjej po me atë gjuhë atyre sulmeve, me një xhihad ma'nevij, ose me "Xhihadin e fjalës".

Kështu, në mërgim, Bediuzzamani shkroi një mori veprash të titulluara "**Risale-i Nur**" ("Mesazhet e dritës"), të cilat do t'i shpjegonin dhe paraqisin njeriut modern parimet bazë të besimit dhe të vërtetat e Kur'anit. Metoda e tij analizon besimin e mosbesimin dhe demontron, përmes argumenteve të qarta logjike, se, duke ndjekur

metodën e Kur'anit, jo vetëm që është e mundur t'i provosh në mënyrë të arsyeshme të gjitha të vërtetat e besimit, si: ekzistencën e Zotit të Lartësuar, Njësinë e Tij, profetësinë dhe ringjalljen e qenieve të gjalla, por gjithashtu se këto të vërteta kanë të vetmin *shpjegim racional për ekzistencën*, për njeriun dhe universin.

Kështu, Bediuzzamani i demonstroi të vërtetat e fesë më së miri, në formën më të lehtë të të kuptuarit, nëpërmjet krahasimeve, shpjegimeve dhe provave të arsyeshme, të cilat janë të papajtueshme me interpretimet materialiste për ato zbulime moderne, duke i cilësuar ato interpretimet materialiste joracionale dhe absurdë.

Në të vërtetë Bediuzzamani, me veprat e tij, provoi se zbulimet mahnitëse të shkencës, lidhur me universin, vërtetojnë e përforcojnë të vërtetat e fesë.

Rëndësia e "**Risale-i Nurit**" nuk mund të çmohet, sepse nëpërmjet kësaj vepre, Bediuzzaman Said Nursi luajti një rol të madh në ruajtjen dhe rigjallërimin e besimit islam në Turqi, pikërisht në ditët shumë të errëta të historisë dhe, në të vërtetë, roli dhe rëndësia e kësaj vepre vazhdon të rritet edhe në ditët e sotme anembane botës. Për më tepër, "**Risale-i Nuri**", veçanërisht, është i përshtatshëm t'u drejtobet jo vetëm muslimanëve, por gjithë njerëzimit për disa arsyet.

Së pari: Sepse është shkruar në harmoni me mentalitetin e njeriut modern, qoftë musliman ose jo, i cili ka qenë mbushur e frymëzuar thellë nga filozofia materialiste.

Së dyti: "**Risale-i Nuri**", në mënyrë specifike, u përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe dyshimeve që shkakton kjo filozofji; u përgjigjet të gjitha "pse-ve" që arrin të ketë mendja e shëndoshë e njeriut modern. Gjithashtu "**Risale-i Nuri**" shpjegon çështjet e thella të besimit, të cilat më parë vetëm shkollarët e përparuar i studiuan në detaje, në atë mënyrë që çdo njeri, madje dhe ai për të cilin subjekti është i ri, mund të kuptojë, të fitojë diçka pa patur ndonjë vështirësi a shqetësim.

Një arsyet tjetër është se duke shpjeguar natyrën e vërtetë të universit dhe qëllimin e njeriut, "**Risale-i Nuri**" tregon se lumturia, në këtë botë dhe në tjetrën, arrihet vetëm nëpërmjet besimit dhe njohjes së Zotit të Lartësuar.

“Risale-i Nuri” gjithashtu tregon dhimbjen e rëndë dhe mjerimin që i shkakton mosbesimi shpirtit dhe ndërgjegjjes së njeriut; dhe se njerëzit të cilët kanë humbur udhën e drejtë përgjithësisht përpiken t'i shmangin të tjerët duke i bërë të shkujdesur dhe duke i shkëputur nga realiteti. Kështu, duke lexuar këtë vepër, çdo njeri mund të kërkojë strehë në besim.

Bediuzzamani, nëpërmjet “Risale-i Nurit” na udhëzon për tek konceptimi i drejtë i Kur'anit dhe i Sunnetit të pastër profetik. Ai na paralajmëron për rrezikun e rënies në bidate, risi, në ekstreme dhe në greminat e çudhëzimit, që rreziqe të tilla janë të shumta në këtë kohë. Ai jep shpjegime të shumta të hollësishme si tek shembulli i trajtesës së “Ikhithadit” e cila është Fjala e Njëzet e Shtatë tek koleksioni i Fjalëve, ku në atë trajtesë theksohet domosdoshmëria e ndjekjes së njërsë nga katër shkollat e sheriatit Islam –**Katër medh'hebët**– të cilat përfaqësojnë mendimet e sakta të dijetarëve të mëdhenj të Ehli Sunnetit vel-Xhemaa.

Gjithashtu në Shkreptimën e Katërt të “Koleksionit të Shkreptimave” dhe në “Shkreptimën e Njëmbëdhjetë,” Bediuzzamani bën një shtjellim të detajuar tek trajtesa “Ruga e Praktikave të Profetit Muhammed A.S.M. dhe Kundërhelmi ndaj sëmundjes së bidatit” duke treguar në të domosdoshmërinë e ndjekjes së Sunnetit Profetik si dhe duke paralajmëruar përrreziqet e rënies në kthetrat e sekteve devijuese, në kurthet e lëvizjeve negative që synojnë të realizojnë qëllime të mbropshtë të kësaj dynjaje duke shfrytëzuar fenë dhe paralajmëron përrreziqun e rënies në grackat e grupeve heretike. Gjithashtu, nëpërmjet dhjetëra trajtesave të ndryshme të “Risale-i Nurit”, Bediuzzamani ndriçon për ne në mënyra të ndryshme botëkuptimin e drejtë të Ehli Sunnetit vel-xhemaa, të cilët janë njerëzit e së vërtetës, duke ua mundësuar kështu besimtarëve të të gjitha niveleve në këtë kohë të trazuar të ecin në rrugën e drejtë të Kur'anit e të Sunnetit me një bindje të plotë e të sigurtë dhe duke i shpëtuar ata përfundimisht nga ekstremet.

Kështu, Fjalët e shkruara rrëth mistereve të Kur'anit janë ilaçi më i efektshëm dhe balsami më i mirë për plagët e kësaj kohe; janë drita më e dobishme përrerësinë e Islamit i cili është zbuluar para sulmeve të errësirës, dhe janë udhëzuesi më i vërtetë për ata që brendin të hutuar e të çoroditur në luginat e çudhëzimit. Koleksioni i Fjalëve në këtë kohë,

të cilat janë shkreptimat e mrekullisë së Kur'anit, janë si një kundërhelm ndaj çudhëzimit ateist. Atëherë nuk do të ishte e perceptueshme të qëndrosh indiferent ndaj kësaj vepre brilante, “Risale-i Nurit”.

### Përfundim:

Kur’ani i Shenjtë i drejtohet inteligencës dhe njeriut të të gjitha niveleve. Ai i kërkon njeriut që ta njohë universin, funksionin e tij, të mësojë për natyrën e vërtetë dhe për qëllimet e krijimit; të mësojë Atributet e Krijuesit të Vetëm dhe detyrat e tij si një kriesë. Kjo është Pikërisht metoda që tregon Bediuzzamani nëpërmjet argumenteve të qarta, se kur kur’ani lexohet në këtë mënyrë, të gjitha bazat e besimit mund të provohen racionalisht.

Kur ndiqet kjo metodë, personi arrin një besim të vërtetë që do të ishte mjaftë i fortë e i qëndrueshëm për t'i bërë ballë çdo dyshimi që buron nga “ftytyra” e sulmeve të holla të materialistëve, natyralistëve dhe ateistëve.

Nevoja kryesore e njeriut është nevoja përfshirë, nevoja për ta njohur e adhuruar Zotin e Plotëfuqishëm me të gjitha Atributet dhe Emrat e Tij të Bukur, është nevoja për t'iu bindur ligjeve të Tij, atyre të manifestuara në univers dhe atyre që u zbuluan nëpërmjet Profetëve të Tij; të pranojë mesazhin e Kur'anit, e librit të fundit të shpallur, i cili u shpjegua nga Profeti i fundit, Muhammedi A.S.M. (*paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të*) dhe të pranojë se Islami është feja e plotësuar e njerëzimit.

Në “Risale-i Nur” Bediuzzamani demonstron se nuk ka kundërthënie apo ndarje ndërmjet shkencës dhe fesë dhe, përparimi i vërtetë e lumturia përfshirë njeriun mund të arrihet vetëm në këtë rrugë, në rrugën e Kur'anit.

### Të dashur lexues!

Vepra “Isharatul i'xhazi”, “Shenjat e Mrekullisë” është një koment rreth sures *El-Fatiha* dhe rreth tridhjetë e tre vërseteve të para të sures *El-Bekare*. Qëllimi i këtij komenti është të shpjegojë natyrën e

mrekullueshme të renditjes së Fjalëve të Kur'anit. Sepse “qëndisjet” e pozicionimit dhe të rendit të Fjalëve të Kur'anit demonstrojnë një aspekt të paimitueshmërisë apo të mrekullisë së tij.

*Paqja qoftë mbi atë që ndjek udhëzimin.*

**JUSUF SALKURTI**

## **PARATHËNIE**

**Doktor Muhsin Abdul-Hamid profesor tefsiri dhe mendimi islam në universitetin e Bagdadit.**

*Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të të gjitha botëve, dhe bekimet dhe paqja qofshim mbi Muhammed Ibn Abdull-lah, të cilit iu shpall Kur'an i gjithurtë, mbi vulën e pejgamberëve dhe të dërguarve, si dhe mbi Ehli Bejtin -familjen e tij-, sahabët, tabiinët -ata të cilët erdhën pas tyre,- deri në Ditën e fundit, Ditën e Gjyqit.*

Pothuajse të gjithë ata të cilët i kanë studiuar rrethanat e muslimanëve në shekujt e fundit bien dakort se ustadh Bediuzzaman Said Nursi ishte një personalitet i madh islam, me besim të fortë dhe me sinqueritet të plotë; ishte një person me një dinjitet të madh, njohës i të vërtetave të Unitetit Hyjnor, ishte një ndër burrat me të shquar të kohës së tij, me njohje shumë të gjërë, me një mendim depërtues, një thirrës i palëkundur e perceptues për tek Ruga e Zotit.

Qysh nga koha e rinisë së tij ai mori mbi vete që të gjente zgjidhje për vuajtjet që u ranë muslimanëve, dhe e kaloi jetën e tij pa u lodhur duke luftuar për të svaruar mësimet e islamit dhe për të shpjeguar akiden, parimet e besimit.

Gjithashtu ai refuzoi e hodhi poshtë mendimet e pavlefshme dhe filozofitë e pabaza që mohuan islamin dhe që kurdisën komplotë kundra tij për shkak të paaftësisë së muslimanëve për t'u bërë ballë sulmeve të rrepta intelektuale para të cilave ai qe zbuluar qysh prej fillimit të shekullit të katërmëdhjetë të Hixhrit; madje edhe më parë asaj kohe.

Në të vërtetë, Nursi ndërmori një detyrë të vështirë dhe shpërblimi i tij është vetëm me Allahun e lartësuar, i Cili i shikon shërbëtorët e Tij të drejtë dhe dijetarët e Tij muxhahidë që përpiken në rrugën e Tij dhe

që janë të vërtetë në besëlidhjen me Zotin dhe nuk i kanë frikë kritikat e akuzuesve të tyre.

Ky libër i tanishëm -të dashur lexues- është një vlerë e lartë, me baza të forta dhe përmban prova të patundura. Kjo demonstron qartë fuqinë e jaftëzakonshme dhe efektshmérinë e Ustadh Said Nursit dhe përmban shembuj të shumtë prej kuptimeve të sakta e të holla që gjenden në të gjitha shkrimet e tij dhe veçanërisht në ato që lidhen me njojjen. Ky gjenialitet dhe ky talent iu dhanë atij nga Allahu xh.sh. me qëllim që ta shohë librin e Zotit xh.sh. nëpërmjet tyre me një kuptim të thellë intuitiv, dhe me një metodë racionale të përshtatshme të mund të depërtonte tek Fjala e Tij dhe të zbulonte të vërtetën, dhe t'i ndihmonte të tjerët për të fituar bindje të plotë dhe sinqeritet lidhur me mrekullinë e Kur'anit; që dijetarët dhe njerëzit e elokuencës të gjejnë në vetet e tyre domosdoshmérinë e besimit dhe të pranojnë se Kur'ani është libri i vërtetë i shpallur nga Gjithënjohësi i së padukshmes mbi profetin e tij më të nderuar Muhammed Ibn Abdil-lah, mbi të qofshin më të mirat e salatit dhe selamit, me qëllim që ta vendosë njerëzimin në rrugën e së vërtetës dhe për të ndriçuar vizionin e njerëzve me dritën e besimit dhe kuptimin dhe sigurinë për të arritur tek robëria e sinqertë ndaj Zotit të gjitha botëve.

Ustadh Said Nursi deshi t'i zhvillojë aftësitë dhe talentin e tij të veçantë duke studiuar shkencat islame dhe filozofinë e lashtë, shkencat humane dhe shkencat moderne, si dhe të mësuarin e letërsisë arabe dhe retorikës nga veprat e profesorëve të tillë si: el-Xha'hiz, el-Zamahshari, el Sekkaki, dhe veçanërisht prej veprave të shquara mbi gramatikën dhe retorikën të imam Abdul Kahir el-Xhurxhani. Sepse Nursi besoi në teorinë e tij të famshme lidhur me renditjen e fjalëve të Kur'anit dhe tregoi admirimin e tij për të në këtë vepër.

Teoria e renditjes së fjalëve nuk ishte e re; Xhurxhani nuk e shpiku atë dhe ajo nuk ishte pa -baza- të mëparshme. Sepse el-Xha'hiz e kishte kthyer vëmendjen e tij tek ajo në veprën e tij "Nazm el-Kur'an" dhe po kështu El-Vasitiu në veprën e tij "I'ëxhaz el-Kur'an fi nadhmihi"; dhe Baklaniu në veprën e tij "I'ëxhaz el-Kur'an"; por ama Xhuxhani e sqaroi atë plotësisht në lidhje me gramatikën dhe me retorikën dhe formuloi një teori të plotë të mbështetur mbi bazën e mosndarjes midis fjalëve dhe kuptimit të tyre dhe midis formës dhe përbajtjes, dhe vendosi se elokuencia në renditjen e fjalëve nuk shtrihet as në fjalët më

vete dhe as në kuptimet e vecanta, por në atë që piktuojnë - pëershruajnë- fjalët dhe frazat. Duke u mbështetur mbi këtë, ai e bëri të njojur dhe përcaktoi renditjen e fjalëve si "disa fjalë duke iu vënë si ndajshtesë të tjerave, dhe disa duke u vendosur për shkak të të tjerave; domethënë, fjalët duke u vendosur siç kërkohet nga shkenca e gramatikës, në përputhje me rregullat e saj, parimet dhe metodat, pa u shmangur prej tyre".

Më duket se Ustadh Said Nursi e studioi këtë teori të renditjes së fjalëve në mënyrë të përkryer dhe pastaj u bë e qartë për të se komentatorët e mëparshëm si Zamahshari dhe Al-Razi dhe Abu Suud nuk qenë orvatur ta zbatonin atë si një sistem të plotë duke përfshirë renditjen e të gjitha sureve, sure pas sure, vërset pas vërsjeti dhe fjalë pas fiale në të gjitha detajet e tyre. Kështu ai deshi të ndiqte shembullin e këtyre komentatorëve të mëdhenj dhe të hartonte një koment në të cilin teoria të aplikohet në mënyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me strukturat dhe kuptimet, në përpilim dhe në shkencat përkatëse, qofshin intelektuale ose intuitive, universale ose të pjesshme. Ai u mbështet mbi të gjitha këto ndërsa zbulonte renditjen sistematike të Kur'anit, nëpërmjet të cilës mrekullia e tij dhe paimitueshmëria bëhen të dukshme. Ai gjithashtu zbuloi e shpjegoi cilësitet e holla të stileve letrare dhe format e Kur'anit, të cilat kur u shfaqën në fillim ishin në kundërshtim me disa veçori të stileve arabe, dhe i çuditit oratorët arabë dhe i heshti profesorët e tyre elokuentë. Ai i konfrontoi ata me sfidën e mrekullisë së tij, dhe kështu do të jetë deri në Ditën e Fundit.

Përpjekjet e Said Nursit nuk u orientuan vetëm për të shpjeguar teorinë e renditjes së fjalëve të tij duke e paraqitur për të provuar mrekullinë e Kur'anit në lidhje me elokuencën, por gjithashtu ato u orientuan tek depërtimi në kuptimet e vërseteve. Sepse ai deshi t'i shpjegonte ato në mënyrë të hollësishme në dritën e arsyes me qëllim që t'i shfaqte parimet e besimit islam dhe për të demonstruar lidhet e tyre me të vërtetat e ekzistencës.

Është shumë e qartë për gjithkënd i cili e studion këtë libër dhe renditjen e tij se Nursi deshi të shkruante një komentim të plotë të këtij lloji. Në qoftë se ai do të kishte qenë caktuar për ta bërë këtë, ai do të kishte prodhuar një koment të plotë duke trajtuar edhe retorikën, edhe elokuencën dhe duke vënë theksin mbi arsyen, dhe kjo do të kishte



njohje dhe me thirrje pér t'u kapur pas Librit të Zotit dhe pas sunnetit të profetit tē tij a.s.m..

Botimi i këtij libri në formë tē re ofron një analizë tē freskët tē retorikës dhe tē elokuencës pér ata që janë tē interesuar pér një studim kritik tē veprave bashkëkohore mbi mrekullinë e Kur'anit, paimitueshmërinë e tij dhe elokuencën dhe veçanërisht nē qarqet e njohjes. Ata do tē gjejnë shpjegime pér akiden islame që vënë nē përdorim arsyetimin logjik, duke i shtuar diskutime tē thella, logjike e shkencore që Ustadh Said Nursi ua bashkangjit analizave tē tij tē pjesës së parë tē sures *El Bekare*.

Profesor Muhsin Abdul-Hamid

Fakulteti i pedagogjisë, Universiteti i Bagdadit.

2 Sha'an 1407/1987

## Përkujtues

Komenti Kur'anor ***"Isharatul Ixhaz"*, "Shenjat e mrekullisë"** u shkrua nē frontin e luftës nē vitin e parë tē luftës së Parë botërore kur as libra dhe as burime referimi nuk ishin tē disponueshëm.

Përveç luftës, kishte katër arsyé pse ai u shkrua nē mënyrë tē përbledhur e konçize.

Sureja ***el-Fa'tiha*** dhe gjysma e parë e komentit janë më tē përbledhura dhe më tē ngjeshura:

**Së pari:** Sepse ajo kohë nuk lejoi shpjegim; Saidi i Vjetër e shprehte atë që synonte nē mënyrë tē ngjeshur e tē thukët.

**Së dyti:** Ai -Saidi- kishte nē mendje nivelin e tē kuptuarit tē studentëve tē tij shumë tē zgjuar; ai nuk mendonte pér tē kuptuarin e tē tjerëve.

**Së treti:** Sepse Saidi i Vjetër po shpjegonte mrekullinë e renditjes së fjalëve tē Kur'anit, që është nē thukëtinë më tē madhe dhe nē hollësinë, që Saidi i Vjetër e shkroi nē mënyrë shumë tē shkurtër dhe tē lartë. Por unë e kam rilexuar atë tani me sytë e Saidit tē Ri: Në tē vërtetë gjeta se ky koment me hollësitë dhe me diskutimet e larta që përmban konsiderohet si kryevepér e shkëlqyer -e Saidit tē Vjetër-pavarësisht fajeve dhe gabimeve tē tij. Meqenëse ai -Saidi i Vjetër- ishte i qëndrueshëm që tē arrinte shkallën e martirizimit gjatë shkrimit, dhe meqenëse qëllimi i tij ishte i pastër dhe ai e shkroi atë nē harmoni me rregullat e retorikës dhe tē shkencave tē arabishtes, unë -tani- kam qenë i pamundur tē refuzoj ndonjë pjesë tē tij. Në dashtë Allahu Ai do ta pranojë veprën si një shlyerje pér gjynahet e Saidit tē Vjetër, dhe do tē ngrejë njerëz tē cilët do ta kuptojnë atë plotësisht...

Po tē mos kishin qenë pengesat e luftës së parë botërore, qëllimi do tē drejtohej që kjo pjesë tē ishte një koment i hollë gjithëpërfshirës, do tē ishte prodhuar pér tē shpjeguar mrekullinë e renditjes së fjalëve tē

Kur'anit -një aspekt të mrekullisë së tij- që është shpjeguar në volumin e parë.

Në qoftë se pjesët e mbeturë do të bashkonin të vërtetët e shpërndara nëpër trajtesa, do të bëhej një koment i shkëlqyer gjithëpërfshirës i Kura'nit të shpjegimit të mrekullueshëm. Ndoshta në të ardhmen, duke marrë këtë pjesë dhe gjashtëdhjetë e gjashtë *Fjalë* dhe *Letra (Sözler, Mektubat)*, madje duke i marrë njëqind e tridhjetë pjesët e Risale-i Nurit si burim, një grup fatlum do të shkruajë një koment të tillë, në dashtë Zotit xh.sh..

*Said Nursi*

## Shënimi i Autorit për botimin turqisht (1955)

Të shpjeguara më poshtë në tre pika janë arsyet e shumë pikave të holla rrëth lidhjeve -ndërmjet fjalëve në dritën e shkencës- së retorikës, të cilat nuk do të janë të kuptueshme për shumë njerëz dhe prej të cilave nuk do të përfitojnë, janë përmendur në këtë komentim të shpërhapur midis shpjegimeve të detajuara të dymbëdhjetë vërseteve rrëth hipokritëve dhe dy vërseteve rrëth jobesimtarëve, ndërsa në vërsetet e tjera natyra e mosbesimit dhe dyshimet e kacavarura nga hipokritët janë prekur vetëm shkurtimisht;

Dhe për këtë arsyë shpjegimi i treguesve të hollë dhe i aluzioneve të fjalëve të Kur'anit është theksuar.

**Pika e parë:** I inspiruar nga mësimet e Kur'anit, Saidi i vjetër perceptoi se diçka do të shfaqej në këtë kohë të vonë që u ngjason mosbesimtarëve kryeneçë analfabetë të viteve të para të islamit dhe anëtarëve hipokritë të feve të mëparshme, dhe ai i shpjegoi vërsetet rrëth hipokritëve në mënyrë sqaruese dhe të detajuara. Por me qëllim që të mos turbullojë mendjet e lexuesve të nderuar, ai i përmendi vetëm shkurtazi duke mos u shpjeguar atyre natyrën e rrugës së tyre dhe bazat e saj.

Prandaj, në kundërshtim me ulematë -dijetarët- e tjerë, rruga e Risale-i Nurit është të mos i përmendë dyshimet e kundërshtarëve me qëllim që ata të mos njollosin mendjet e lexuesve, dhe të japë përgjigje të tillë që të mos mbetet asnjë vend për dyshim apo skepticizëm. Ashtu si Risale-i Nuri, me qëllim që të mos i ngatërrojë mendjet e njerëzve, Saidi i Vjetër vetëm u dha rëndësi në këtë koment treguesve dhe aluzioneve të fjalëve lidhur me elokuencën.

**Pika e dytë:** Meqenëse shkronjat e Kur'anit janë aq të vlefshme saqë leximi i një shkronje të vetme mund të fitojë dhjetë, njëqind, një mijë, ose mijëra merita dhe fruta të përjetshëm ahireti, atëherë sigurisht shpjegimi i Saidit të Vjetër në këtë koment për pikat e holla lidhur me

fjalët e Kur'anit nuk konsiderohen tepricë apo tē parëndësishme, sepse pavarësisht hollësishë së qerifikut dhe vogëlsisë së bebes së syrit, ato tē dyja kanë një rëndësi shumë tē madhe.

Ai duhet ta ketë perceptuar këtë, sepse plumbat e armikut në frontin e luftimit në atë luftë tē tmerrshme nuk e bënë atë konfuz dhe as nuk e bënë tē braktisë shkrimin dhe tē menduarit rrëth pikave tē holla tē Kur'anit pér studentët e tij.<sup>1</sup>

**Pika e tretë:** Përkthimi turqisht i këtij komenti (nga vëllai i autorit, Abdul- Mexhidi) nuk e ka ruajtur rrjedhshmërinë, elokuencën dhe vlerën e jashtëzakonshme tē arabishtes, dhe gjithashtu ai është ndonjëherë i shkurtuar. Prandaj unë nuk pata synuar ta botoja pjesën e një diskutimi tē zgjatur rrëth hipokritëve. Por meqenëse ajo është rrëth Kur'anit, madje edhe sikur sa një atom rrëth Kur'anit ka vlerë tē lartë, ndoshta ajo do tē jetë e dobishme pér disa njerëz.

Në dashtë Zoti, në qoftë se nuk del ndonjë pengesë, komenti arabisht do tē btohet duke ndjekur këtë përkthim dhe tē plotësojë mangësitë e tij. Pér më tepër, ndodhen disa shembuj tē mrekullueshëm ‘koincidencash’ në arabisht, në tē cilat nuk ka ndërhyrë vullneti njerëzor. Kështu që me sa tē jetë e mundur, përpjekja duhet bërë që botimi tē jetë i përputhshëm me origjinalin, me qëllim që ato çudira - keramete- si shenja tē pranueshmërisë së tij tē mos humbasin.

Saidi Nursi

<sup>1</sup> Shënim: A do tē ishte e mundur që një njeri i tillë ta keqpërdortë fenë pér politikën dhe dynjanë? Sa larg drejtësisë janë dhe sa padrejtesi bëjnë ata njerëz që bëjnë një akuzë tē tillë.

Prej studentëve tē Risale-i Nurit,  
Zybejri, Bajrami

## Pohim i Qëllimit

Meqenëse Kur'ani është një Fjalim Hyjnor gjithëpërfshirës dhe një Adresim universal Hyjnor i dhënë nga Froni Sublim që u adresohet të gjitha klasave, kombeve dhe individëve tē njerëzimit në çdo shekull, dhe gjithashtu ai në këtë kohë përfshin shumë shkenca dhe degë tē njobjes që lidhen me aspektet fizike tē botës, njobja e së cilave është përtej kapacitetit tē një individu tē vetëm apo tē një grupei tē vogël, atëherë një komentim që buron nga tē kuptuarit dhe fuqia përfytyruese e një individu tē vetëm, rrezja e kuptimit tē tē cilit është shumë e ngushtë përsa ka tē bëjë me kohën, vendin dhe specializimin, nuk mund ta shpjegojnë me tē vërtetë Kur'anin. Sepse një individ nuk mund tē jetë i informuar dhe nuk mund tē jetë një ekspert në tē gjitha shkencat e sakta dhe në degët e njobjes lidhur me gjendjet shpirtërore dhe materiale tē kombeve dhe tē popujve tē cilëve Kur'ani u adresohet. Ai zor se mund tē shpëtojë nga fanatizmi dhe nuk mund tē jetë i lirë nga tendencioziteti -anëmbajtja- ndaj deklaratave tē tij dhe ndaj rregullit që ai mund t'i shpjegojë tē vërtetat e Kur'anit. Gjithashtu, tē kuptuarit e një personi është e veçantë pér tē dhe ai nuk mund t'u bëjë thirrje tē tjerëve pér ta pranuar -veçse në qoftë se është afirmuar e mbështetur nga një lloj konsensusi; edhe zbulimet e tij -dhe gjykimet- që kanë tē bëjnë me aktet janë tē lidhura -të detyruara- vetëm pér veten e tij dhe pér askënd tjetër, përsëri veçse në qoftë se janë aprovuar nga një konsensus.

Si rrjedhojë, një koment duhet tē shkruhet pas studimeve tē hollësishme dhe pas kërkimeve prej një grupei tē lartë tē dijetarëve autoritarë, kur secili prej tyre është një specialist në një numër shkencash, duke provuar kuptimet e holla tē Kur'anit dhe pikat e tij tē holla që gjenden tē shpërndara nëpër komente tē tjera, dhe tē vërtetat e tij, tē cilat bëhen tē dukshme me kohë në sajë tē zbulimeve tē shkencës.

Ashtu si urdhëresat e tij ligjore që duhet tē sistemohen e rregullohen, jo sipas mendimit tē një individu tē vetëm, por nga një komitet -grup- i tillë dijetarësh, pasi tē janë studiuar e shqyrtaar në mënyrë tē hollësishme prej tij, po ashtu duke fituar besimin dhe

konfidencën e masave të njerëzve, komiteti -grupi- me nënkuptim do të marrë përgjegjësinë për to dhe të jetë një burim autoritar për bashkësinë muslimane.

Në të vërtetë, ai që shpjegon Kur'anin duhet të ketë inteligjencë të lartë, të posedojë një ixhdihad -interpretim- depërtues, dhe një shkallë të lartë shenjtërie.

Por në këto kohë, në mënyrë të veçantë, kushte të tilla mund të përbushen vetëm nga "personaliteti kolektiv" i ndritur i lindur nga bashkëpunimi i një komiteti të lartë e të shqar dhe nga bashkimi i mendjeve të anëtarëve të tij, prej ndihmës për njëri-tjetrin dhe pajtueshmérinë e shpirtrave të tyre, dhe prej lirisë së tyre të mendimit, dhe duke qenë të lirë nga paragjykimet, prej sinqeritetit të tyre të plotë.

Vetëm një personalitet kolektiv i tillë si ky mund ta shpjegojë Kur'anin. Sepse në përputhje me rregullin "Ajo që nuk gjendet në pjesë, eshtë e pranishme në të tërën" kushte të këtilla si këto, të cilat nuk gjenden tek çdo individ, janë të pranishme në grup.

Ndërsa duke pritur, siç kisha bërë për shumë vite, shfaqjen e një komiteti të tillë, unë pata një parandjenjë se ne ishim në prag të një tërmeti të tmerrshëm që ai do të shkatërronte vendin.<sup>2</sup> Dhe kështu sipas rregullit "nuk eshtë e lejueshme ta lësh një gjë krejtësisht edhe në qoftë se ajo nuk kapet plotësisht", pavarësisht pafuqisë sime, mangësive dhe stilit të vështirë të të shkruarit, unë fillova të shënoj vetë disa nga të vërtetat e Kur'anit dhe disa tregues të mrekullisë së renditjes së fjalëve të tij. Pastaj me shpërthimin e luftës së madhe, unë e gjeta vetveten në malet dhe në luginat e Erzurumit dhe të Pasinler. Sa herë që jepej rasti ndërsa unë po kryeja detyrën e xhihadit në mes të atyre rrrethanave të potershme, unë shkruaja atë që më shfaqeji për zemrën time në frazat që jo gjithmonë përputheshin me njëra-tjetrën. Meqenëse ishte e pamundur që të kiske ndonjë libër apo koment për t'i referuar, ajo që unë shkrova përbëhej vetëm nga ajo që u shfaq për zemrën time.

<sup>2</sup> Po, profesori ynë tha ndërsa na jepte mësim tek medreseja Horhor në Van se do të binte një tërmet i tmerrshëm, dhe ekzaktësisht ashtu siç e parashikoi ai, pak kohë më vonë, shpërtheu lufta botërore (ra tërmeti i madh).

Hamza, Mehmed Shefik, Mehmet Mihri (Këta janë prej studentëve të autorit)

Në qoftë se këto inspirimet e mia janë të përshtatshme për një koment, drithë prej dritave; në qoftë se ato përbajnë aspekte kontradiktore, këto mund t'u referohen mangësive të mia.

Sigurisht që ndodhen vende që kanë nevojë për t'u ndrequr, por meqenëse u shkrua me sinqeritet të plotë, në vijën frontale të luftës midis masakrave, ashtu siç nuk është e lejueshme t'i ndryshohen rrobat dhe të hijet me larje gjaku i martirëve, po ashtu unë nuk do të mund të lejoja që frazat e grisura, me të cilat ato u veshën, të ndryshohen; zemra ime nuk do ta pranonit atë. Edhe tani ajo nuk e pranon atë, sepse tani në këtë kohë unë nuk mund ta gjej atë sinqeritet të plotë dhe pastërtinë e zemrës.<sup>3</sup>

Për më tepër, unë nuk e shkrova këtë veprën time të quajtur "**Shenjat e mrekullisë**" "**Isharatul Ixhaz**", me qëllimin e qënies së saj një komentim i vërtetë; por vetëm në qoftë se do të fitonte pranueshmëri të lartë nga dijetarëtverifikues të Islamit.

Unë e përshkrova atë si një model dhe një burim për një koment për t'u shkruar në të ardhmen, për disa aspekte të komentimit. Zelli im më shtyu tek ajo që ishte përtëj fuqisë sime; në qoftë se ajo do të gjendej e pranueshme, do të më jepte kurajo për të vazhduar.<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Saidi i Ri e gjeti përsëri atë sinqeritet nëpërmjet sinqeritetit të vërtetë të Risale-i Nurit. Saidi i Ri e pa me të njëjtin sinqeritet, por nuk gjeti vend për ta korrigjuar. Domethënë, për shkak se kjo ishte inspirim –ilham-prej Kur'anit, mrekullia e Kur'anit e mbroi atë prej gabimeve.

Studentët e Risale-i Nurit.

<sup>4</sup> Shiko shënimin e autorit në fund të veprës.

## Ç'është Kur'ani? Si përkufizohet ai?

### KURANI:

- Është interpretues parapërjetësie i librit të madh të universit...
- Dhe interpretuesi i paspërjetësisë i gjuhëve të ndryshme që recitojnë vërsetet e krijimit...
- Është komentuesi i librit të botëve të dukshme e të padukshme...
- Është zbuluesi i thesareve jolëndorë të Emrave Hyjnorë të fshehura në faqet e tokës e të qiejve...
- Është çelësi i të vërtetave të fshehura poshtë këtyre rreshtave të ngjarjeve...
- Është gjuha e botës së padukshme në botën e dukshme...
- Është thesari i mirësive të Krijuesit Mëshirëplotë dhe i adresimit Hyjnor të parapërjetësisë, i cili vjen nga bota e padukshme matanë perdes së kësaj bote të dukshme...
- Është dielli, themeli dhe plani i botës shpirtërore të Islamit...
- Është harta e shenjtë e botëve të Ahiretit...
- Është komentuesi i shquar, shpjeguesi i qartë, prova përcaktuese dhe interpretuesi i saktë i Esencës Hyjnore, i Atributeve, i Emrave dhe i Veprave...
- Është Edukatori i kësaj bote të humanizmit...
- Dhe uji dhe drita e Islamit i cili është humanizmi më i madh...
- Dhe është urtësia e vërtetë e llojit njerëzor...
- Dhe është udhëzuesi dhe drejtiesi i vërtetë që e çon njerëzimin në lumturi...

• Dhe ai për njeriun është: Një libër urtësie, libër ligji, libër duaje, libër adhurimi, libër urdhëri e thirrjeje, libër përmendjeje dhe libër mendimi...

• Është një libër i vetëm gjithëpërfshirës i shenjtë dhe burim për të gjithë librat që përbushin të gjitha nevojat shpirtërore të njerëzimit.

• Dhe është një libër qiellor, si një bibliotekë e shenjtë, që jep libra të përshtatshëm për metodat e evlijave, të sinqertëve dhe të dijetarëve, rrugët dhe metodat e të cilëve janë të gjitha të ndryshme dhe, është i përshtatshëm të ndriçojë çdo rrugë e metodë.

Meqenëse ka ardhur nga Froni Sublim, nga Emri më i Madh dhe nga shkalla më e lartë e çdo Emri, **Kur'ani** është fjala e All-lahut, me cilësinë e Tij, Krijuesi i të gjitha botëve;

• Është Urdhri i All-lahut. xh.sh., me cilësinë Zoti i të gjitha qënieve;

• Është fjalimi i Tij më cilësinë e Tij, Krijuesi i qiejve e i tokës;

• Është një ligjëratë e lartë nga këndvështrimi i Hyjnisë Absolute;

• Është një fjalim parapërjetësie në Emrin e Sovranitetit universal Hyjnor.

• Ai gjithashtu është një regjistër i mirësive të të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, nga këndvështrimi i Mëshirës së Tij gjithëpërfshirëse e që rrrethon gjithçka.

• Ai është një koleksion i mesazheve Hyjnore që shpjegojnë Madhështinë e Hyjnisë meqë në fillimet e disave ndodhen simbole e shifra.

• Dhe ai është libri i shenjtë plot urtësi dhe duke zbritur nga gjithëpërfshirja e "Emrit më të Madh" shikon e inspekton të gjitha anët e Fronit Sublim.

Për shkak të këtij misteri, me përshtatshmërinë më të plotë, i është dhënë Kur'anit titulli "**Kelamull-llah**" *Fjala e All-lahut*, dhe ky emër i jepet vazhdimisht.

Pas Kur'anit vjen niveli i librave dhe i fletëve të shenjta të profetëve të tjera. Sa pér Fjalët e tjera Hyjnore të cilat janë të pafund, disa prej tyre janë biseda në formë inspirimi, që burojnë e bëhen të dukshme nüpërmjet një nderimi e vlerësimi të veçantë, një titulli të pjesshëm, nüpërmjet një manifestimi të veçantë, të një Emri të veçantë, me një akt të veçantë Hyjnor e një sovraniteti të veçantë Hyjnor dhe përmes një Mëshireje të veçantë. Inspirimet -frymëzimet- e engjëjve, e njerëzve dhe inspirimet e kafshëve ndryshojnë shumë pér sa i përket tërësisë dhe veçantisë.

**Kur'ani i shenjtë**, është një libër qiellor, i cili përfshin në mënyrë të përbledhur librat e të gjithë profetëve, që kohët e të cilëve ishin të gjitha të ndryshme, si dhe veprat e të gjithë Evlijave dhe të dijetarëve të pastër që rrugët dhe metodat e të cilëve janë të gjitha të ndryshme. Gjashtë aspektet e Kur'anit janë të gjitha të shndritshme e të pastruara prej errësirës së dyshimeve dhe të skepticizmit; pika e tij e mbështetjes është shpallje e vërtetë qellore dhe fjalë parapërjetësie; synimi e qëllimi i tij, në mënyrë të vetëkuptueshme, është lumturia e përjetshme; aspekti i tij i brendshëm, në mënyrë të quartë, është udhëzim i pastër; aspekti i tij i sipërm, domosdoshmërisht, janë dritat e besimit; aspekti i poshtëm është dëshmi e pamohueshme dhe provë me shkallën e njohjes së sigurisë; aspekti i tij i djathë, në mënyrë të provuar, është dorëzimi i zemrës dhe i ndërgjegijes; aspekti i tij i majtë, me shkallën e shikimit të sigurisë, është nënshtrimi i arsyes dhe i mendjes me bindje të plotë; fruti i tij, me shkallën e sigurisë absolute, është Mëshira e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, dhe bota e Paraqës; rangu dhe këndshmëria e tij, sigurisht, pranohen nga engjëjt, njerëzit dhe xhindet.

(nga Fjala e Njëzet e Pestë, e shkruar më 1927)



**Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi,  
Mëshirëploti!**

الْحَمْدُ لِلّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ مَا لِلّهِ يُوْمَ الدِّينِ  
إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ اهْدِنَا الصَّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ.  
صَرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ خَيْرَ الْمَخْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا  
الظَّالِمِينَ

Bismil-Lahi el-Rahmani el-Rahim.

El-Hamdu Lil-lahi Rab-bi el-Àlemine. El-Rahman, El-Rahim. Maliki el-jeumi el-din. Ij-jake Naëbudu ve ij-jake nesteine. Ihâna el-sirata el-mustekime. Sirata el-ledhine en'amte alejhim Gajri el-Magħdûbi alejhim vela el-dâlîne.

Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë pér Allahu, Zotin e të gjitha botëve. I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. I Vetmi Zotërues -Mbisundues- i Ditës së Gjyqit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë. Drejtona në Rrugën e drejtë. Në Rrugën e atyre të cilëve Tì u kë dhuruar mirësinë Tënde, jo (në rrugën) e atyre të cilët merituan zemërimin Tënd mbi vete, dhe as në (rrugën) e atyre të cilët u humbën.



الْرَّحْمَنُ \* عَلَمَ الْقُرْآنَ \* خَلَقَ الْأَنْسَانَ \* عَلَمَهُ الْبَيَانَ  
 فَنَحْمَدُهُ مُصَلِّيَنَ عَلَى نَبِيِّهِ مُحَمَّدِ الدُّنْيَا أَرْسَلَهُ رَحْمَةً  
 لِلْعَالَمِينَ وَجَعَلَ مَعْجَزَتَهُ الْكَبْرَى جَامِعَةً بِرْمَوْزَهَا وَ  
 أَشَارَاتَهَا لِحَقَائِقِ الْكَائِنَاتِ بَاقِيَةً عَلَى مَرَادِ الْدُّهُورِ إِلَى يَوْمِ  
 الدِّينِ وَعَلَى إِلَهِ عَامَةٍ وَاصْحَابِهِ كَافِةٍ

*Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.*

*I Gjithëmëshirshmi (Allahu)! Ai juva mësoi Kur'anin. Ai krijoj njeriun. Ai i mësoi atij të folurit e bukur (e të shprehurit).<sup>1</sup>*

*Ne i japim atij lavdërim e falënderime, dhe kërkojmë bekimet e tij për profetin e Tij, të cilin Ai e dërgoi si mëshirë për të gjitha botët, dhe e bëri mrekullinë e Tij më të madhe dhe gjithëpërfshirese nëpërmjet shenjave dhe treguesve të saj për të vërtetat e universit -e bëri- të qëndrojë përjetësisht me kalimin e kohës deri në ditën e gjyqit, dhe (bekimet) qofshin edhe për të gjithë Ehli Bejtin, Familjen e tij dhe për të gjithë sahabët e tij.*

Kështu mësoje së pari se qëllimi ynë prej kësaj vepre të titulluar “*Isharatul I’xhaz*” është një komentim mbi një numër simboleash të renditjes së fjalëve të Kuranit, sepse -njëri aspekt i-mrekullisë së tij manifestohet në renditjen e fjalëve të tij. Në të vërtetë, qëndisja e

renditjes së fjalëve të tij është (forma e) tij më e ndritshme e mrekullisë.<sup>2</sup>

Dhe dije së dyti se qëllimet themelore të Kuranit dhe elementet e tij esencialë janë katër: Uniteti Hyjnor (Et-Tauhid), profetësia (en-nubuvveh); Ringjallja e të vdekurve (El-Hashr) dhe drejtësia (el-adala). Sepse kur njerëzimi, ashtu si një karvan i njëpasnjëshëm dhe si një vargan niset prej luginave të së shkuarës, udhëton në shkretëtirat e ekzistencës dhe të jetës dhe shkon drejt lartësive të së ardhmes, duke u orientuar drejt kopshteve të saj, ngjarjet i trondisin njerëzit dhe universitetin fytyrën e tij drejt tyre. Është sikur qeveria e krijimit dërgoi filozofinë natyrale (ose shkencën) (*fann al-hikma*) që të marrë fjalën e t'u drejtojë pyetjen atyre, duke u thënë: “O njerëz! Prej nga? Për ku jeni duke shkuar? Çfarë bëni? Kush është Sundimtari juaj? Kush është predikuesi -zëdhënësi- juaj?” Një herë gjatë këtij bisedimi, u ngrit në këmbë njëri prej njerëzve -ashtu siç bënë ata si ai prej profetëve me autoritet- prijësi i llojit njerëzor, Muhammed Hashimi a.s.m., dhe tha nëpërmjet gjuhës së Kuranit: “O filozofi! Të gjithë ne qëniet shfaqemi nëpërmjet fuqisë së Sulltanit të Parapërjetshëm prej errësirave të mosekzistencës për tek drita e ekzistencës... dhe të gjithë ne, bijtë e Ademit, u dërguam me cilësinë e nëpunësve të privilegjuar e të dalluar midis vëllezërve tonë krijesa me mbajtjen e Amanetit -besimit; ne jemi në rrugën tonë, duke udhëtar në rrugën e Ringjalljes drejt lumturisë së përjetshme; dhe ne jemi të preokupuar tani në këtë botë për t'u përgatitur për atë lumturi dhe për të zhvilluar potencialet të cilat janë kapitali ynë. Dhe unë jam prijësi i tyre, profesori i tyre dhe zëdhënësi.

Dhe ja, këtu para jush, është shpallja ime, e cila është fjala e Atij Sundimtari të Parapërjetësisë, mbi të cilën shkëndijon stampa e mrekullisë”.

Kështu, përgjigjësi i këtyre pyetjeve, përgjigjja e saktë, nuk është asgjë tjetër përvëç Kuranit, atij libri -përgjigjja është, ato katër parime themelore.

Ashtu siç shihen katër qëllimet në tërësinë e Kuranit, po ashtu ato manifestohen në çdo sure; madje për to hidhet fjala në çdo frazë, dhe për to bëhet aluzion në çdo fjalë; sepse çdo pjesë është si një pasqyrë

<sup>1</sup> Kur'an, 55 : 1-4

<sup>2</sup> Shiko, “isharatul Ixhaz” (I përkthyer turqisht nga Abdul-Mexhid Nursi).

për të tërën duke u ngjitur, ashtu si e tëra shihet në çdo pjesë një pas një, me radhë.

Dhe me këtë pikë -dua të them se me këtë pjesëmarrje të pjesës (*El-Xhuz'e*) në tërësinë (*el-kul'*), Kurani bëhet i njojur si një tërësi (*el-kul'*) me pjesë përbërëse (*el-xhuzijat*).<sup>3</sup>

• *Në qoftë se ti do të thoje: M'i trego mua këto katër qëllime në بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ "Bismil-lah" dhe në أَلْحَمْدُلُلَّهُ "El-Hamdu Lil-lah".*

*Unë do të thoja:* Kur u shpall بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ "Bismil-lah" me qëllim që t'i instruktonte e t'i mësonte shërbëtorët e Zotit, قُلْ "thuaj" ishte e nënkuptuar në të dhe në esencë ajo nënkuptohet nga قُلْ "Thuaj" fjalët e Kuranit.<sup>4</sup> Kështu në përputhje me këtë, ndodhet tek بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ "Bismil-lah" një shenjë –simbol-për Hyjnин; dhe në parashtesën (parafjalën) بِ "bi" të بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ "Bismil-lahit", eshtë një shenjë për Unitetin Hyjnor<sup>5</sup>; dhe në أَلْحَمْدُلُلَّهُ "El-Rahman" ndodhet një aluzion përrugullin (e universit, dhe kështu për) drejtësinë dhe mirëbërësinë; dhe në أَرْحَمُ الْجِنَّاتِ "Er-Rahim" eshtë një aluzion përrugullin e ringjalljen e të vdekurve.

*Gjithashtu* në أَلْحَمْدُلُلَّهُ "El-Hamdu Lil-lah", "Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun" eshtë një tregues për Hyjnин; dhe në لِمِنْ إِلَيْهِ الْمُكَبَّرُ "Li" e لِلَّٰهِ "Lil-lah" eshtë një shenjë për Unitetin Hyjnor; dhe në رَبِّ الْعَالَمِينَ "Rab-bi el-Âleme", "Zotin e të gjitha botëve".

<sup>3</sup> Domethënë çdo pjesë e Kuranit eshtë si një Kur'an i tërë. Shiko Nursi "isharatul Ixhaz"

<sup>4</sup> Domethënë, o Muhammed! Thuaje këtë fjalë dhe mësojua atë njerëzve.

<sup>5</sup> Konstrukt i në rasën gjinore këtu (xhar ve mexhrur) shpreh kufizueshmëri. Shiko Nursi "isharatul Ixhaz"

është një aluzion për drejtësinë, dhe gjithashtu për profetësinë; sepse edukimi i njerëzimit jetep nga profetët.

مَالِكُ يَوْمَ الدِّينِ Dhe në مَالِكُ يَوْمَ الدِّينِ "Maliki el-jeumi el-din", "I Vetmi Zotëruesh - Mbisundues-i Dites së Gjyqit" është një pohim i qartë përringjalljen.

أَنَا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثُرَ "in-na a'etaina kel keuther" "Vërtet që Ne të kemi dhuruar ty (Muhammed a.s.m.) El-Keutherin (burim, lumë në Xhennet)"<sup>6</sup> i përmban këto perla të (katër qëllimeve kryesore të Kuranit). Ky është një shembull, kështu vazhdo në të njëjtën mënyrë.

بِسْمِ اللّٰهِ "Bismil-lah" "Me Emrin e Allahut" eshtë si dielli, i cili ndriçon edhe vetveten po ashtu edhe të tjerët, dhe është i vetëmajtaueshëm.

Kështu, بِ "bi" 'me, në' lidhet me foljen që është e nënkuptuar në kuptimin e saj; domethënë, unë kërkoj ndihmë prej saj", ose me kuptimin e shoqëruar zakonisht me të; domethënë "Unë bëj be me të", ose ajo lidhet me كُلُّ "kul" 'thuaj' të nënkuptuar, e cila bën të domosdoshme një "Recito!" ose أَقْرِأْ "Ikre'ë" "Lexo!" për të nënkuptuar e treguar sinqeritet dhe Unitet Hyjnor<sup>7</sup>.

Sa për emrin "El-ism", dije se Allahu ka Emra që i përkasin Esencës së Tij, dhe Emra që u përkasin llojeve të ndryshme të veprimit, të tillë si: "El-Gaffar, Er-Rez-zak, El-Muhib, El-Mumitu," e të tjerë, Fajfalës, Gjithëfurnizues, Jetëdhënës, Shkaktues i Vdekjes" etj... Ato janë të ndryshëm e të shumtë për shkak të shumësisë së lidhjeve të fuqisë së tij të Parapërjetshme me llojet e ndryshme të qënieve.

<sup>6</sup> Sureja 108, njëra prej sureve më të shkurtëra të Kuranit.

<sup>7</sup> Duke genë e lidhur dhe duke ndjekur konstruktin, këto folje të nënkuptuara shprehin kufizueshmëri, të cilat me rradhë tregojnë sinqeritetin dhe Unitetin Hyjnor. Shiko Nursi "isharatul Ixhaz".

Prandaj, بِسْمِ اللَّهِ "Bismil-Lâh", "Me Emrin e Allâhut" éshtë një lutje, duke kerkuar ndikimin -veprimin- dhe lidhjen e Fuqisë Hyjnore, me qëllim që ajo lidhje të mund të jetë një shpirt për njeriun dhe një ndihmë për të në veprat e tij.

الله "Allâh": Emri i veçantë dhe i mirëfilltë i All-lahut éshtë një përbledhje gjithëpërfshirëse e të gjithë atributave të plotësimit, sepse ai nënkupton Esencën, jo si Emrat e tjerë të përveçëm, tek të cilët nuk ka nënkuptim të domosdoshëm të Atributeve.

**الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ**  
"El-Rahmâni el-Râhim", "I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti".

**Vendosja:** Ashtu si lavdia Hyjnore "xfield" dhe bashkëshoqëruesit e saj që manifestohen në rend -vijimësi- nga Emri i Allahut, po ashtu Bukuria Hyjnore "Xhemal" dhe bashkëshoqëruesit e saj shfaqen në vijimësi prej الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ "el-Rahmâni el-Râhim".

Meqenëse lavdia dhe bukuria janë dy burime, atëherë në vijimësi shfaqen prej tyre -në sajë të qenies së tyre të manifestuar në çdo botë-degë si urdhëresa e ndalesa, shpërblimi e ndëshkimi, nxitja dhe kercënim, lavdërimi dhe falënderimi, frika dhe shpresa, dhe kështu me radhë.

Gjithashtu, ashtu si Emri i All-lahut që tregon atributet që janë identikë -të njëjtë- me Esencën e Tij dhe tregon Qënien e Tij krejtësisht të lirë e pa mangësi (*el-sifat el-ajnijeh vel-tenzihijeh*), po ashtu الرَّحِيمُ "El-Râhim" aludon për atributet që janë të tjera përveç Esencës së Tij dhe i përkasin aktit (*al-sifat el-Gajrijeh el-fi'elijeh*).

الرَّحْمَنُ "El-Rahmâni", ky tregon shtatë atributet të cilët nuk janë as identikë dhe as të tjerë përveç Esencës së Tij (*la ajn ve la Gajr*); meqë "El-Rahmâni", "I Gjithëmëshirshmi" ka kuptimin e "Er-Rezzak"

"Gjithëfurnizuesi" dhe përbëhet nga dhënia e vazhdimësise - qëndrueshmërisë.

Sepse vazhdimësia éshtë përsëritja e ekzistencës; dhe ekzistanca bën të domosdoshëm një atribut dallues, një atribut specifikues dhe një atribut ndikues dhe këto janë Njohja, Dëshira dhe Fuqia. Vazhdimësia - qëndrueshmëria-, që éshtë rezultat i dhënes së Rizkut (furnizimit), kerkon sigurinë e të shikuarit, të dëgjuarit dhe të folurit; sepse Gjithëfurnizuesi "Er-Rezzak" duhet medoemos të ketë shikim me qëllim që të shohë nevojën e marrësit të ushqimit -rëzkut- në qoftë se ai nuk e kerkon; dhe Ai duhet të ketë dëgjim me qëllim që të dëgojë fjalën e marrësit kur ai kerkon; dhe duhet që Ai të ketë ligjërim (të folur), me qëllim që të flasë nëpërmjet ndërmjetësive, kur ndodhen ca. Dhe këto të gjashtë bëjnë të domosdoshëm të Shtatin, që éshtëjeta.

• *Në qoftë se do të thoje:* Bashkëngjitja e الرَّحْمَنُ "El-Rahmâni" që tregon mirësi të mëdhaja me الرَّحِيمُ "El-Râhim" që tregon mirësi të holla, éshtë arti i zbritjes nga e madhja tek e vogla (*san'at el-tadal-li*); ndërsa elokuenca kerkon një ngjitje nga më e ulëta për tek më e larta (*san'atut teraki*)?

*Do të thoja:* E fundit i shtohet të parës me qëllim që ta plotësojë atë, ashtu si vetullat që plotësojnë sytë dhe si kapistra -freri- për kalin. Gjithashtu, kur e madhja varet tek e vogëla, e vogëla fiton epërsi, ashtu si çelësi për drynin dhe si gjuha për shpirtin. Për më tepër, lidhur me këtë kontekst (mekam), i cili duke qenë një stacion që tërheq vëmendjen për tek mirësitë (dhe nuk i numëron ato dhe nuk thérret për mirënjojhe ndaj tyre), ta paralajmërosh, të zgjosh interesin (e lexuesit për këtë fakt meqë ai éshtë) më pak i dukshëm éshtë më e përshtatshmjë për paralajmërim.

Kështu, arti i zbritjes nga më e madhja për tek më e vogëla -në kontekstin e -numërimi- të mirësive dhe të nxitjes së mirënjojhes për to bëhet arti i ngjitjes prej të voglës për tek e madhja kur paralajmëron - mendjen për to- dhe kur i shfaq ato.

• *Në qoftë se do të thoje:* koncepte të tillë si: Dhembshuria, mëshira, zemërbutesia nuk mund të përdoren lidhur me Allahun xh.sh.. Në qoftë

se ajo që synohet prej këtyre janë rezultatet e tyre, e cila këtu do të ishte dhënia e mirësisë, cila është arsyefa për metaforën?

*Do tē thoja:* Arsyefa është ajo e vërseteve alegorike (*Muteshabihat*)<sup>8</sup>; ajo është një zbritje -begeni- Hyjnore tek mendjet e njerëzve, duke e bërë tē njohur diçka pér mendjen dhe duke e bérë atë pér tē kuptuar, ashtu si dikush që i flet një fëmije me ato fjalë me tē cilat ai është mësuar dhe i njeh. Masat e njerëzve i grumbullojnë informacionet e tyre prej shqisave tē tyre dhe i shohin tē vërtetat e pastërtë veçse në pasqyrën e asaj që ata i imagjinojnë ato tē janë dhe prej këndvështrimit tē asaj me tē cilën ata janë mësuar.

Për më tepër, qëllimi i frazës është që tē japë kuptimin, dhe kjo nuk arrihet veçse duke prekur zemrën dhe ndjenjet, dhe duke e veshur tē vërtetën me një stil tē njohur pér atë që i adresohet; në këtë mënyrë zemra përgatitet pér ta pranuar atë.

الْحَمْدُ لِلّٰهِ  
“*El-Hamd*”, “i Gjithë lavdërimi”.

#### vendosja e saj lidhur me atë që e parapriu:

Meqenëse “*El-Rahmàn*” dhe “*El-Rahim*” tregojnë mirësitë Hyjnore dhe favoret, ato bëjnë tē domosdoshme lavdërimin.

Për më tepër, *الْحَمْدُ لِلّٰهِ* “*El-Hamdu Lil-lah*” përsëritet në katër sure të Kur'anit<sup>9</sup>, secila përsëritje i referohet dhe shikon njërin prej atyre mirësive të cilat janë: Krijimi i parë, vazhdimësia -qëndrueshmëria- në tē; dhe krijimi i fundit, dhe vazhdimësia pas saj.

#### Vendosja e saj këtu:

الْحَمْدُ لِلّٰهِ  
“*El-Hamdu Lil-lahi*”, domethënë duke qenë e vendosur në hapjen e Fatihasë së Kur'anit është si vendosja e konceptit të qëllimit përfundimtar të Kur'anit në pamje ballore tē trurit. Sepse lavdërimi –

<sup>8</sup> Kuptime që nuk mund tē përdoren në kuptimin e mirëfilltë pér Zotin e Gjithëfuqishëm, tē tillë si: ‘Dora’ në vërsetin “*Dora e Allahut është mbi duart e tyre*” (Kuran 48:10)

<sup>9</sup> Në suren El-An'am, Al-kahf, Sebeë El-Fatir.

*Hamdi-* është një formë e përbledhur e adhurimit, i cili është rezultati i krijimit dhe i njohjes e cila është urtësia dhe qëllimi i universit.

Kështu, ta përmendësh atë -*Hamdin-* është tē përfytyrosh e tē kuptosh qëllimin përfundimtar tē Kur'anit.

Në tē vërtetë Allahu xh.sh. thotë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْأَنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونَ  
“Dhe Unë nuk i krijova njerëzit dhe xhindët, veçse që ata duhet tē më adhurojnë vetëm Mua.”<sup>10</sup>

الْحَمْدُ لِلّٰهِ  
Për më tepër, kuptimet e mirënjohnur tē lavdërimit *Hamdit-* janë shfaqja e atributeve tē plotësimit.

**Si arrihet kjo:** Allahu xh.sh. e krijoi njeriun dhe e bëri atë një përbledhje gjithëpërfshirëse tē universit dhe një indeks tē librit tē botës, i cili përfshin tetëmbëdhjetë mijë botëra, dhe futi në esencën e tij një model prej çdo bote, në tē cilën manifestohet çdo Emër prej Emrave tē bukur Hyjnоре. Në qoftë se njeriu e shpenzon tē gjithë atë që i është dhuruar atij në rrugën e asaj pér tē cilën ai u krijua, pér qëllimin e dhëni së falënderimeve -që futet nën *Hamd-* dhe duke iu bindur sheriafit, i cili largon ndryshkun (oksidin) e Natyrës, secili prej atyre shembujve -modeleve- behet një hartë -duke ndriçuar- botën e tij, dhe një pasqyrë duke e reflektoar atë dhe atributin e manifestuar në tē dhe emrin që ajo shfaq. Në këtë mënyrë, me shpirtin dhe me trupin, njeriu bëhet një përbledhje e botërave tē dukshme dhe tē padukshme, dhe manifeston atë çfarë manifestohet në ato tē dyja.

Nëpërmjet *Hamdit* -dhëni së falënderimeve- njeriu bëhet një vend demonstrimi dhe një demonstrues i atributeve tē plotësimit.

Kjo nënkuptohet nga ajo që tha Muhjid-din el Arabi<sup>11</sup> në shpjegimin e hadithit: كُنْتُ كَنْزًا مَخْفِيًّا فَخَلَقْتَ الْخَلْقَ لِيَعْرَفُونِي “Unë

<sup>10</sup> Kuran, 51:56

<sup>11</sup> Muhjed-in al-Arabi (1165-1240), u lind në Andaluzi. Ai fitoi titullin “El Shejhul Ekber”. Prej veprave dhe trajtesave tē tij tē shumta më tē famshmet janë “El futuhat el-Mek-kijjah” dhe “Fusuh el-Hikam”.

*isha një thesar i fshehur, kështu Unë e krijova krijimin me qëllim që ata tē mund tē Më njohin Mua.*<sup>12</sup> Domethënë, Unë e krijova krijimin që tē jetë një pasqyrë në tē cilën Unë tē vështroj Bukurinë Time.

الله “*Lil-lah*”, “(qofte) pér Allahun”.

Domethënë, “*Hamd*” “lavdërimi është i posaçëm dhe i përshtatshëm vetëm pér Esencën më tē shenjtë e më tē pastër, i specifikuari i Cili vërehet nga koncepti i Ezkistuesit të Vetëm tē Domosdoshëm. Sepse ndonjëherë diçka specifike mund tē mendohet në terma tē përgjithshme si çështje e përgjithshme. Dhe ky *lam*-shkronja *lam* (ل لِي لِلَّهِ)-këtu varet nga folja e nënkuptuar prej kuptimit tē saj, sikur ajo tē ketë përthihur a tē ketë marrë kuptimin e foljes.<sup>13</sup> Në *lamin* gjithashtu është një shenjë pér sinqueritetin dhe pér Unitetin Hyjnor.

رَبْ “*Rabb*”, “Zoti, Mbështetësi”.

Domethënë, Ai i Cili e ngre dhe e mbështet universin me tē gjithë pjesët e tij përbërëse, ku secila prej tyre është një botë si bota më e madhe, dhe tē gjithë atomet e saj si yjet e saj tē shpërndarë duke lëvizur me rregull.

Dije se Allahu xh.sh. ka përcaktuar pér çdo gjë një pikë plotësimi dhe ka vendosur në tē një prirje drejt saj, sikur e komandon atë nëpërmjet kësaj prirjeje, tē niset pér tek pika e plotësimit. Në udhëtimin e saj çdo gjë qëndron në nevojë tē asaj që do ta ndihmojë dhe pér atë që do t'i shtyjë e zmbrapsë gjërat që e pengojnë atë, dhe kjo është mbështetja e Allahut. Në qoftë se do t'i studioje qëniet e universit, ti do

Pér detaje më tē shumta shiko, Nursi, *Isharatul Ixhaz Fi Medhan'n el-ixhaz* (Tahkiki i Ihsan Kasim el Salihu).

<sup>12</sup> Shiko, al Sujuti, al Durer al-Muntethireh”, 125; ‘Ali el-Qari, El- Athar al Marfua, 273. linja e transmetimit tē këtij hadithi nuk njihet, por sipas Ali el-Qari, kuptimi i atij hadithi është *Sahih* i saktë, i shëndoshë, duke u mbështetur mbi vërsetin “*Dhe Unë nuk i krijova njerëzit dhe xhindët, veçse që ata duhet tē më adhurojnë vetëm Mua,* (51:56) domethënë që ata tē mund tē Më njohin vetëm Mua, ashtu siç shpjegohet nga Ibn Abasi, shiko, El-Ajelun Kashf el-Khafa’ 132.

<sup>13</sup> Domethënë, “lavdërimi është i posaçëm pér Allahun” është bërë “Gjithë lavdërimi është i Allahut”. Shiko Nursi, “*Isharatul Ixhaz*”.

ta shihje se ajo u ngjason grupeve njerëzore dhe kombeve, ku secila në mënyrë individuale dhe kolektive është e vënë në punë në detyrat që ka përcaktuar pér tē Krijuesi i saj, duke u përpjekur me zell, duke iu bindur ligjeve tē Krijuesit tē saj, përvèç njerëzve fatkëqinj. Prandaj, sa e çuditshme pér njeriun, pér qënien e tij një përashtim!

العالَمَينَ “*El-Àlemine*”, “i tē gjitha botëve”.

عَشَرَيْنَ، ثَلَاثَيْنَ ‘*Ja*’ dhe ‘*Nun*’ [domethënë, dy shkronjat e fundit] shënojnë ose nënkuptojnë ose një mbaresë gramatikore si në numrat نَجْزٍ، تَلَاثٍ (ishrin) dhe ثَلَاثَيْنَ tridhjetë (*Thelathine*), ose një shumës tē rregullt -tē shëndoshë.

Sepse pjesët përbërëse tē botërave janë botëra, ose bota nuk është e kufizuar në sistemin diellor. Ashtu siç thotë poeti:

الْحَمْدُ لِلَّهِ كَمَالُهُ مِنْ فَلَكٍ \* تَحْرِي النُّجُومُ بِهِ وَالشَّمْسُ وَالقَمَرُ

*Lavdi Zotit, sa tē shumta janë sferat e Tij qiellore!*

*Midis tyre lëvizin yjet, dielli dhe hëna!*

shumësi i rregullt (i shëndoshë), (i përdorur me vend) pér qëniet e

arsyeshme, ashtu si në vërsetin رَأَيْتُهُمْ لِي سَاجِدِينَ, “...i pashë ato në sexhde pér mua”<sup>14</sup>, tregon se (shkenca e) retorikës e përshkruan çdo pjesë prej pjesëve përbërëse tē botës si tē gjallë dhe tē arsyeshme, duke folur nëpërmjet gjuhës së gjendjes.

Sepse bota (*el a'lem*) është quajtur kështu pér shkak se nëpërmjet saj Krijuesi njihet (*ju'lam*), dhe ajo dëshmon pér Të dhe tregon pér Të. Kështu rritja dhe mbështetja e qënieve dhe bërja e tyre tē njobur Krijuesin e tyre tregojnë, -si sexhdeja, si rënia në sexhde- se ato janë si qëniet e arsyeshme.

<sup>14</sup> Kuran, 12:4

**الْرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ** “El-Rahmân, El-Rahim”, “I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti”.

**Vendosja -pozicionimi- i tyre:** Ato tregojnë dy themelet -bazat- e rritjes, dhe të mbështetjes dhe të furnizimit; sepse **الْرَّحْمَنُ** “El-Rahmân” “I Gjithëmëshirshmi” duke qenë me kuptimin **“Er-Rezzak”** “Gjithëfurnizuesi” dedukton e nënkupton tërheqjen e dobive, ndërsa **الْرَّحِيمُ** “El-Rahim” “Mëshirëploti” duke qenë me kuptimin e **El-Gaffar, Fajfalës** është në përshtatje me shtyrjen -zmbrapsjen- e dëmit, dhe këto janë dy parime bazë për rritjen dhe mbështetjen.

**مَالِكُ يَوْمَ الدِّينِ** “Malîki el-jeumi el-dîn”, “I Vetmi Zotërues - Mbisundues- i Ditës së Gjyqit”.

Domethënë, i Ditës së Ringjalljes dhe i shpërbllimit.

**Vendosja:** Është sikur ajo të ishte rezultati i asaj që e paraprin, sepse mëshira ‘Rahmeh’ është njëra prej provave të Ringjalljes dhe të lumturisë së përjetshme. Sepse mëshira do të mund të ishte mëshirë, dhe mirësia do të mund të ishte mirësi veçse kur të vijë kijameti dhe kur të ndodhë lumturia e përjetshme.

Përndryshe, duke menduar për ndarjen e përjetshme, mendja, e cila është njëra prej mirësive më të mëdhaja, do të ishte një fatkeqësi dhe pë një mjet ogurzi, për njeriun, dhe dashuria e dhembshuria, të cilat janë më të hollat e llojeve të mëshirës, do të transformoheshin në dhimbje të renda.

• *Në qoftë se do të pyesje: Allahu është gjithmonë Pronari - Zotëruesi- i çdo gjëje, atëherë përsë është përcaktuar Dita e shpërbllimit?*<sup>15</sup>

**Unë do të tha:** Ajo është përcaktuar me qëllim që të tregojë se shkaqet e jashtme, të cilat Allahu i ka vendosur në botën e ndryshimit

<sup>15</sup> Tek Zotëruesi i Ditës së Gjyqit

për të demonstruar madhështinë e Tij - që të mos shihet funksioni i drejtpërdrejtë i Dorës së Fuqisë nga syri i mendjes në çështjet që shfaqen të jenë të ulëta në aspektin e tyre të jashtëm (*mulk*), do të ngrihen në atë Ditë, dhe aspektet e tyre të brendshme (*melekutijeh*) do të manifestohen në mënyrë të qartë e transparente -të dukshme. Atëherë të gjitha gjërat do ta shohin dhe do ta njojin Zotin dhe Autorin e tyre pa ndërmjetësi.

Dhe në termin **يَوْمُ دِينِ** “El-Jeum”, ‘Ditë’ është një aluzion për njëren nga shenjat intuitive të Ringjalljes, duke u mbështetur mbi përputhshmërinë -dhe lidhjen e -qartë midis ditës dhe vitit, dhe jetës së njeriut dhe cikëlinë të dynjasë -tokës, ashtu siç është midis akrepave të një ore javore që numërojnë sekondat, minutat, orët dhe ditët.

Kështu, personi i cili sheh se një akrep e ka plotësuar rrotullimin – cikëlin- e tij, do të marrë me mend se edhe akrepat e tjerë gjithashtu do t'i plotësojnë rrotullimet e tyre, edhe sikur me vonesë. Gjithashtu, personi i cili sheh ringjalljet e përsëritura të specieve në shembujt e ditës dhe të vitit do të marrë me mend se pranvera e lumturisë së përjetshme do të lindë në mëngjesin e Ditës së Ringjalljes për njerëzimin, një individ i së cilës është si një specie.

Ajo çfarë synohet me **دِينِ** “El-Din”, “Dita” ose me “Shpërbllimi”, domethënë, dita e shpërbllimit për veprat e mira dhe të këqija, ose për të vërtetat e fesë; domethënë, dita që ato do të lindin dhe që do të shfaqen plotësisht, dhe sfera e besimit do të sundojë mbi sferën e shkaqeve. Sepse duke i lidhur shkaqet me pasojat, Allahu xh.sh. ka vendosur një rregull në univers nëpërmjet Dëshirës së Tij dhe e ka obliguar njeriun nëpërmjet natyrës së tij, iluzioneve dhe imagjinatës që t'i përmbahet atij rregulli dhe të jetë i lidhur me të.

Për më tepër, Ai i orientoi të gjitha gjërat drejt Vetes së tij dhe është lart dhe krejtësisht larg efektit të shkaqeve në sundimet e Tij (*Mulk*). Ai e ngarkoi njeriun me fe e me besim që ai t'i përmbahet kësaj sfere me ndërgjegjjen e tij, me shpirtin dhe të jetë i lidhur me të. Sepse në këtë botë, sfera e shkaqeve mbisundon mbi sferën e besimit, ndërsa në botën tjetër të vërtetat e besimit do të shfaqen mbisunduese mbi sferën e shkaqeve.

Mësoje gjithashtu se secila prej dy sferave ka pozitën e saj të përcaktuar dhe rregullat e veçanta, kështu secilës duhet t'i jepet haku që i takon. Kështu, personi që shikon nga pozita e botës shkakore me natyrën e tij, me iluzionet, me imagjinatën dhe me kriterin e shkaqeve, drejt sferës së besimit detyrohet të jetë Mu'ëtezilit, ndërsa një person i cili shikon prej pozitës së besimit dhe kriterit të saj me shpirtin dhe me ndërgjegjjen drejt sferës së shkaqeve do të përfundojë e rezultojë duke shfaqur një lloj dembelie të mbështetjes -besimit- dhe një kundërvënie kryenece ndaj rregullit të botës. Domethënë nuk i vlerëson shkaqet.<sup>16</sup>

**أَيَّاْكُمْ نَعْبُدُ**  
“Ij-jake Naëbudu”, “vetëm Ty të adhurojmë”.

Dy pika ndodhen lidhur me shkronjën **ك** ‘Kef’ (në përemrin e veçuar të rasës kallzore *ij-jake*):

E para e tyre është se nëpërmjet formës direkte të adresimit (domethënë ndryshimit për tek veta e dytë pas përdorimit të vetës së tretë), prapashtesa përemërore **ك -ke**- ‘Ty’ nënkupton atributet e plotësimit të përmendura më parë. Sepse përmendja e mëparshme -e attributeve- njëri pas tjetrit e nxit trurin, duke e përgatitur atë, dhe duke e mbushur me entuziazëm dhe duke e drejtuar vëmendjen për tek i Vetmi i përshkruar. Kështu, **أَيَّاْكُمْ** “Ij-jake” “vetëm Ty” do të thotë “*O Ti që cilësohesh nga këto attribute!*”

**Pika e dytë:** Përdorimi i vetës së dytë tregon se sipas shkencës së retorikës kuptimet duhet të vërehen e të mbeten, sepse atëherë ajo do të lexohej ashtu siç u shpall, dhe kjo do ta conte njeriun ta bënte adresimin në mënyrë të natyrshme dhe me entuziazëm. Kështu **أَيَّاْكُمْ نَعْبُدُ** “Ij-jake”, “vetëm Ty” nënkupton përputhje me (hadithin): **أَعْبُدُكَ كَانَكَ تَرَاهُ** “Adhuroje Zotin tënd sikur ti ta shihje Atë.”<sup>17</sup>

<sup>16</sup> Kjo u referohet xheberitëve

<sup>17</sup> Forma e plotë e hadithit transmetohet nga Buhariu, Muslimi

نَعْبُدُ Përdorimi i vetës së parë shumës tek “Naëbudu”, “Të adhurojmë” ka tre aspekte duke aluduar për tre grupime:

**Së pari:** Ne adhurojmë, të gjithë ne anëtarët dhe atomet e kësaj bote të vogël -që është vetja ime- duke dhënë falënderimet e shprehura prej të gjithë anëtarëve dhe atomeve duke iu bindur çdo gjëje për të cilën janë të urdhëruara.

**Së dyti:** Të gjithë ne monoteistët të adhurojmë nëpërmjet bindjes ndaj Sheriatit tënd.

**Dhe së treti:** Të gjithë ne qëni, i nënshtrohemi plotësisht sheriatit Tënd më të lartë të krijimit, dhe ne biem në sexhde me habi e me dashuri nën Arshin -Fronin- e Madhështisë dhe të Fuqisë Tënde.

#### Vendi -pozicionimi:

**أَيَّاْكُمْ نَعْبُدُ** “Naëbudu”, “Të adhurojmë” është një shpjegim dhe një koment i **الحمد** “lavdërimi” (domethënë, ajo shpjegon formën që duhet të marrë lavdërimi), dhe është rezultati i **مَالِكُ يَوْمَ الدِّين** “Maliki el-jeumi el-din”, “I Vetmi Zotërues -Mbisundues-i Ditës së Gjyqit” dhe e bën të domosdoshme atë. (Domethënë, “Ne e adhurojmë vetëm Atë për shkak se Ai është Pronari -Zotëruesi- i të gjitha gjërave”.)

Mësoje gjithashtu se vendosja përpara e **أَيَّاْكُمْ** “Ij-jake” “vetëm Ty” dedukton dhe nënkupton sinqueritetin i cili është shpirti -esencia- e adhurimit, ndërsa përdorimi i vetës së dytë tregon arsyen për adhurimin, sepse i Vetmi i cilësuar prej këtyre attributeve, të cilat kërkojnë e bëjnë thirrje për adresim të drejtpërdrejtë, është i denjë për adhurim.

**وَأَيَّاْكُمْ نَسْتَعِينُ** “Ve ij-jake nesteine”, “dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë”.

Në lidhje me tre grupet e lartëpermendura, kjo është e njëjtë si **أَيَّاْكُمْ نَعْبُدُ** “*Ij-jäke Naëbudu*” “vetëm Ty tē adhurojmë”.

Domethënë, të gjithë ne anëtarët e botës së vogël, të gjithë ne monoteistët, dhe të gjithë ne qeniet, kérkojmë ndihmë e mbështetje prej Teje pér tē gjitha nevojat tona dhe qëllimet, më e rendësishmja e të cilave është ibadeti -adhurimi.

**أَيَّاْكُمْ** “*Ij-jäke*”, “*vetëm Ty*” përsëritet pér tē shtuar kënaqësinë e adresimit dhe tē sensit tē prezencës; sepse stacioni -mekami- i takimit ballë pér ballë është më i lartë dhe më i lartësuar se sa stacioni i provës (në mungesë tē personit tē adresuar); dhe sepse prezenca thërret pér tek vërtetësia dhe jo pér tē gënjer; dhe pér shkak se adhurimi dhe tē kérkuarit ndihmë janë dy qëllime të ndryshme tē pavarura.

**Vendorja -pozicioni- i نسْتَعِينُ** “*nesteine*”, “*Tē kérkojmë ndihmë*” me “*Naëbudu*” “*Tē adhurojmë*”.

Ti duhet tē kuptosh se lidhja ndërmjet tyre i ngjason lidhjes së rrogës me shërbimin. Sepse adhurimi është e drejta e Allahut tek robi i Tij (adhurimi është një formë shërbimi), dhe dhënia e ndihmës është mirëbërsia e Zotit xh.sh. ndaj robit tē Tij (ose shpërblimi).

Në ekskluzivitetin e nënkuptuar nga vendorja më parë e **أَيَّاْكُمْ** “*Ij-jäke*”, “*vetëm Ty*” është një tregues pér faktin se nëpërmjet lidhjes fisnikë e cila është adhurimi dhe shërbimi ndaj Allahut, robi ngrihet lart dhe shpëton prej nënshtrimit ndaj shkaqeve dhe ndërmjetësive; madje shkaqet bëhen shërbëtorët e tij, dhe meqenëse ai njeh vetëm tē Vetmin Unik, atëherë (pér tē) sfera e besimit dhe e ndërgjegjjes do tē shfaqet tē dominojë ashtu siç u përmend. Personi që nuk është vërtet shërbëtor i Allahut bëhet një skllav pér shkaqet dhe poshtërohet pér ndërmjetësitë. Megjithatë, ndërsa është në sferën e shkaqeve, robi nuk duhet t'i neglizhojë shkaqet krejtësisht, me qëllim që ai tē mos rebelohet kundra rregullit të vendorus të gjithësi prej Urtësisë Hyjnore dhe prej Dëshireës së Tij xh.sh.. Sepse mbështetja e vendorus gabim në Allahun ndërsa je në sferën e shkaqeve është dembeli, ashtu siç u diskutua. Kjo është si

lidhja e parathënies me qëllimin, sepse ndihma dhe dhënia e suksesit janë parathëniet e adhurimit.

**اهْدَنَا** **“Ihdina”, “Drejtona”.**

**Vendi-pozicionimi:** është përgjigja e robit ndaj pyetjes së Allahut xh.sh. sikur Ai tē pyeste:

“Cili qëllim është më i dashuri dhe më i lidhuri me zemrën tēnde?

Dhe robi do tē përgjigjej: **اهْدَنَا** **“Ihdina”, “Drejtona!”**

Dije se pér shkak tē niveleve tē shumta tē kuptimeve tē saj, është sikur **اهْدَنَا** **“Ihdina”, “Drejtona”** e ka prejardhjen prej katër burimeve [ose emrave foljurë-masdari] tē aktit tē udhëzimit. Sepse përfituesit e saj mund tē ndahen në: *el-ha'dine*, ata tē cilët janë tē drejtar; *el-muhstehdine*, ata tē cilët kérkojnë drejtim, *el-mustezidine*, dhe ata që kérkojnë shtim në udhëzim.

**اهْدَنَا** **“Ihdina”, “Drejtona”** do tē thotë: Na bëj neve tē qëndrueshmëm në udhëzim në qoftë se ne jemi një shoqëri; shtoje mbi ne udhëzimin në qoftë se ne jemi një komunitet; na bëj ne tē suksesshëm në udhëzim në qoftë se ne jemi një fis; na jep neve udhëzim në qoftë se ne jemi një grup. Me fjalë tē tjera, nëse kérkon udhëzim besitmari do tē thotë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi; nëse e kérkon i pasuri, shpreh kuptimin e shtimit, ndërsa nëse e kérkon i varfëri tregon dhënie; nëse e kérkon i dobëti shpreh kuptimin e ndihmës dhe tē suksesit.

**وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ وَهُدَى**

Gjithashtu, sipas vërsetit, “*Zoti ynë është Ai i Cili i dha çdo gjëje formën dhe llojin e vet (me krijim tē përsosur) dhe pastaj e udhëzoi drejt*”,<sup>18</sup> Allahu na udhëzoi duke na dhënë shqise tē jashtme dhe tē brendshme; pastaj Ai na udhëzoi duke vendorus dëshmi në botën e jashtme dhe në veten tonë; pastaj Ai na udhëzoi duke dërguar profetë dhe libra tē shpallur. Dhe pastaj Ai na drejtoi me udhëzimin më tē

<sup>18</sup> Kuran, 20:50

madh, duke hequr perden -mbulesën- prej tē vërtetës, dhe u shfaq e vërteta e vërtetë, dhe gënjeshtra u shfaq gënjeshtë.

اللَّهُمَّ أَرِنَا الْحَقَّ حَقًا وَارْزُقْنَا اتِّبَاعَهُ وَأَرِنَا الْبَاطِلَ بَاطِلًا وَارْزُقْنَا اجْتِنَابَهُ أَمِينٌ

*O Zot! Na e trego atë që eshtë vërtet e vërteta dhe na jep fuqi për ta ndjekur atë, dhe na e trego gënjeshtrën për atë që eshtë e tillë dhe na jep mundësi që t'ishmangemi asaj.*

**الصِّرَاطُ الْمُسْتَقِيمُ**  
*"El-sirata el-mustekime", "Drejtona në Rrugën e drejtë".*

Dije se Rruja e Drejtë eshtë drejtësia që përbëhet nga përzierja dhe përbledhja e urtësisë (*hikma*), dëlirësisë (*if-fa*), dhe guximit (*shexha'at*), tē cilat janë rruga e mesme -e mesmja e artë- e tre shkallëve tē tē trija fuqive tē njeriut.

Le ta shpjegojmë: Kur Allahu xh.sh. futi e strehoi shpirtin nē trupin -e njeriut- i cili eshtë i ndryshueshmë, i nevojshëm dhe i zbuluar para rrezikut, Ai vendosi tre fuqi nē tē për tē siguruuar ekzistencën e vazhdueshme tē tij.

**E para:** Fuqia e orekseve -dëshirave- shtazore për tē tērhequr dobitet.

**E dyta:** Fuqia e zemërimit tē egër për tē larguar e zmbrapsur gjérat e dëmshme dhe shkatërruese.

**E treta:** Fuqia e intelektit engjëllor për tē dalluar midis dobisë dhe dëmit.

Por, meqenëse urtësia e Tij xh.sh. bëri tē domosdoshme që humanizmi duhet ta arrijë plotësimin nëpërmjet misterit tē garës - konkursit-, Allahu nuk vendosi limite tē bashkëlindur mbi këto fuqi, ashtu siç bëri Ai mbi fuqitë e kafshëve tē tjera. Megjithatë, Ai i kufizoi ato nëpërmjet sheriati, sepse sheriati ndalon teprinë (*ifrat*) dhe mangësinë (*tefrīt*) dhe urdhëron rrugën e mesme (*wasat*). Kjo eshtë ajo

që deduktohet e nënkuptohet nga vërseti:

فَاسْتَعْنُ كَانِتَ  
"Qëndro pra  
drejt ashtu siç je i urdhëruar -Ndiqe pra rrugën e drejtë ashtu siç je urdhëruar..."<sup>19</sup>

Në mungesë tē ndonjë kufizimi tē bashkëlindur -tē natyrshëm- shfaqen tre shkallët:

Shkalla e mangësisë, e cila eshtë neglizhenca -pakujdesia; shkalla e bollëkut tē madh, e cila eshtë tepria; dhe rruga e mesme, e cila eshtë drejtësia.

Kështu, mangësia (*tefrīt*) nē fuqinë e intelektit eshtë budallallëku dhe marrëzia; tepria e saj (*ifrat*) eshtë mashtrimi i pabesë dhe meraku - kujdesi- i tepruar nē vogëlima e nē gjérat e rëndomta; dhe rruga e saj e

وَمَنْ يُؤْتَ الْحِكْمَةً فَقَدْ أُوتِيَ خَيْرًا كَثِيرًا  
"Dhe atij tē  
cilit i eshtë dhënë hikmeti, urtësia, vërtet që i eshtë dhuruar mirësi e madhe".<sup>20</sup>

Dije se ashtu siç ndryshon e larmon baza e kësaj fuqie nē këto shkallë, po ashtu secila prej degëve tē saj ndryshon e larmon nē këto tē trija. Për shembull, nē çështjen e krijimit tē veprimeve: Rruja e mesme eshtë ajo e *shkollës sunite* midis *xhebrijes* dhe *mu'tazilës*; dhe nē çështjen e Doktrinës (teorisë) shkolla e Unititetit Hyjnor eshtë rruga e mesme midis mohimit tē atributive Hyjnore (*ta'til*) dhe antropomorfizmit (*teshbih*). Ju mund tē bëni shembuj tē tjerë nē tē njëjtën mënyrë.

Mangësia (*tefrīt*) nē fuqinë e dëshirave shtazore eshtë apatia dhe mungesa e dëshirës për diçka; ndërsa tepria e saj (*ifrat*) eshtë shthurja dhe prishja, e cila eshtë tē dëshirosh çfarëdo që tē haset, sido që tē jetë e ligjshme apo e paligjshme; Rruja e saj e mesme eshtë ndershëmëria (dëlirësia), e cila eshtë tē dëshirosh atë që eshtë e lejuar (*hallall*), dhe t'ishmangesh asaj që eshtë e paligjshme (*Haram*).

Ju mund tē përdorni parimin e aplikuar për këtë fuqi për secilën prej degëve tē saj, tē tillë si e ngrëna, e pira, veshja, dhe kështu me radhë.

<sup>19</sup> Kuran. 11:112

<sup>20</sup> Kuran, 2:269

Mangësia (*tefrit*) në fuqinë e zemërimit është burracakëria -frika-, domethënë, frika prej asaj që nuk duhet të kihet frikë dhe imaginata vegullimtare (e rrëme, mashtruese); tepria e saj (*ifrat*) është zemërimi i pakontrolluar, i cili është prodhuesi -paraardhësi- i despotizmit, i dominimit dhe i tiranisë; dhe rruga e saj e mesme është guximi (trimëria), domethënë, të japësh shpirtin -vetveten- me dashuri e me zell për mbrojtjen e ligjeve të islamit dhe për ngritjen lart të fjalës së Unititet Hyjnor. Përdore këtë të njëjtin parim për secilën nga degët e saj.

Atëherë, prej nëntë shkallëve, gjashtë ekstremet janë kështu tirani, dhe tre rrugët e mesme janë drejtësia e cila është Rruga e drejtë “*el-sirata el-mustekime*” “Drejtona në Rrugën e drejtë”, domethënë, të veprosh në përputhje me “Qëndro pra drejt ashtu siç je i urdhëruar”.<sup>21</sup>

Kushdo që kalon në këtë rrugë, do ta kalojë Urën e varur pezull mbi Ferr.

**صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ** “Sirata el-ledhine en'amte alejhim” “Në Rrugën e atyre të cilëve Tì u kë dhuruar mirësinë Tënde”.

Shikoje këtë: Vendosja e fjalëve të Kur'anit si perlat nuk është në një fije -spango- të vetme, por në një shumësi qëndisjesh që rezultojnë nga ndërthurja e vijave të lidhjeve të ndryshme, të afërtë e të largëta, të dukshme dhe të fshehta. Sepse baza e mrekullisë pas thukëtisë -së stilit- është kjo qëndisje.

**صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ** “Sirata el-ledhine en'amte alejhim” ka një lidhje me **الْحَمْدُ لِلَّهِ** “El-Hamdu Lil-lahi”, “Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun”, sepse mirësia (*El-ni'meh*) është korolar -rrjedhim logjik- i ‘*Hamdit*’, “lavdërimit”.

<sup>21</sup> Kuran 11:112

**رَبُّ الْعَالَمِينَ** • Dhe me “Rab-bi el-Ālemine”, “Zotin e të gjitha botëve”, sepse mbështetja e plotë dhe rritja janë nëpërmjet dhurimit të vazhdueshëm të mirësive (*el-ni'am*);

**الْرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ** • Dhe me “El-Rahmàn, El-Rahim”, “I Gjithëmëshirshimi, Mëshirëploti”, sepse marrësit -përfituesit- e mirësisë - dua të them profetët, martirët të cilët dëshmojnë për të vërtetën, dhe të drejtët dhe dijetarët- janë një mëshirë për botërat dhe ekzemplarë të mëshirës;

**مَالِكُ يَوْمَ الدِّينِ** • dhe me “Malik el-jeumi el-din”, “I Vetmi Zotërues - Mbisundues- i Ditës së Gjyqit”, sepse feja (*din*) është mirësia e plotë;

**نَبِيٌّ** • dhe me “Naëbudu”, “Vetëm Ty të adhurojmë”, sepse ata janë imamët (kryesorët, të parët) në adhurim;

**نَصِيبٌ** • dhe me “Nesteine”, “dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë”, sepse ata janë nderuar me sukses si përgjigje ndaj kërkimit ndihmë nga ana e tyre;

**أَهْدَنَا** • dhe me “Ihdina” “Drejtona”, sepse ata janë modelet më të mirë në përputhje me kuptimin, “Kështu që ndiqni udhëzimin e tyre”<sup>22</sup>

**صِرَاطُ الْمُسْتَقِيمِ** • dhe me “el-sirata el-mustekime”, “në Rrugën e drejtë” sepse në mënyrë të qartë Rruga e drejtë kufizohet në rrugën e tyre.

Ky është një shembull, kështu zbatoje në të njëjtën mënyrë.

Në fjalën **صِرَاطٍ** “Sirat” Rrugë është një tregues se rruga e tyre është e kalueshme, dhe i ka kufizuar anët -ka vendosur kufizime me qëllim që ata të cilët të ecin në të, të mos dalin nga ajo (nga rruga e

<sup>22</sup> Kuran, 6:90)

Drejtë). Pér këtë arsyé ka zzgjedhur “Sirat” nē vend tē sinonimeve tē saj “tarik” dhe “sebil”.

Në fjalën **آلذين El-ledhine**, “e atyre tē cilëve” -meqenëse ajo eshtë një përemër lidhor dhe funksioni i përemrit lidhor eshtë tē përshkruajë gjérat e njohura pér dégjesin- ajo eshtë një tregues pér lartësinë e rangut tē tyre dhe pér shkëlqimin e tyre tē shndritur nē errësirat e njerëzve, sikur ata janë tē dukshëm pér tē gjithë dégjesit edhe nē qoftë se ata nuk kërkojnë apo pyesin. Ndërsa qënia e saj nē shumës tregon mundësinë e ndjekjes së rrugës së tyre, dhe tē mbështetur nga konsensusi i qëndrueshëm lidhur me tē, drejtësinë e saj, meqë “Dora - Fuqia- e Allahut eshtë me xhematin -komunitetin”<sup>23</sup>.

Në përdorimin e kohës së kryer pér **انعمت En'amte**, “Ti u ke dhuruar mirësinë Tënde” eshtë një aluzion pér mjetin e kërkimit të mirësisë.

Dhe përdorimi i saj nē vetën e dytë, duke iu adresuar drejtpërdrejtë Allahut xh.sh., tregon se ajo eshtë një ndërmjetësuese dhe ndihmëse pér tē, sikur njeriu tē thonte: “O Zoti im! Ti je Dhuruesi i mirësisë dhe me mirësinë Tënde e dhurove mirësinë më parë; atëherë dhuroje atë përsëri tek unë pasi ajo i përket Dinjitetit Tënd, dhe nē qoftë se nuk e meritoj”.

Dhe nē **عليهم Alejhim** “mbi ta, mbi tē cilët” eshtë një tregues pér peshën e rëndë që eshtë profetësia Hyjnore dhe mbajtja e amanetit, dhe një shenjë se pejgamberët janë si male tē lartë mbi tē cilët derdhen rrëketë e shiut pér tē përmbytur fushat. Meqë një pjesë e Kuranit shpjegon një tjetër, sa bukur që **انعمت عليهم En'amte Alejhim**

“Ti u ke dhuruar mirësinë Tënde mbi ta” shpjegohet nga

**فَأُولئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِّنَ النَّبِيِّينَ وَالصِّدِّيقِينَ وَالشَّهِيدَاتِ وَالصَّالِحِينَ**  
“atëherë ata do tē jenë nē shoqérinë e atyre mbi tē cilët ka derdhur mëshirën e Tij;

<sup>23</sup> Ky eshtë një hadith, originali i tē cilit jepet nga Tirmidhi si: “Dora e Allahut eshtë mbi xhematin”. Pér më shumë hollësi shiko Nursi, “Isharatul Ixhaz”.

(nē shoqérinë) e pejgamberëve, tē siddikunëve (tē tē besuarve, ndjekësve më tē afërt tē pejgamberit a.s.m.), tē martirëve, tē tē Drejtëve...”<sup>24</sup>

• **Në qoftë se ti do tē thoje:** Pikëpamjet e profetëve janë tē gjitha tē ndryshme dhe mënyrat e tyre tē adhurimit janë tē ndryshme; cila eshtë arsyaja pér këtë?

**Ty do tē tē thuhej:** Të gjithë profetët janë ndjekur nē parimet e besimit dhe nē rregullat themelore, sepse këto janë tē qëndrueshme dhe tē pandryshueshme; ndryshe nga çështjet dytësore, natyra e tē cilave eshtë tē ndryshojnë me kalimin e me ndryshimin e kohës. Ashtu si katër stinët dhe fazat nē jetën e njeriut që ndikojnë nē ndryshimin e ilaçeve dhe tē mënyrës së veshjes –ajo që eshtë ilaç nē një kohë mund tē shkaktojë sëmundje nē një kohë tjetër- po ashtu fazat e jetës së humanizmit bëjnë tē domosdoshme dhe ndikojnë nē ndryshimin e gjërvave dytësore tē rregullave tē cilat janë ilaçi i shpirtërave dhe ushqimi i zemrave.

### غير المغضوب عليهم

**“Gajri el-Magdubi alejhim”,** “jo (nē rrugën) e atyre tē cilët merituan zemërimin Tënd mbi vete”.

**Vendi, pozicionimi i saj:** Dije se ky stacion, duke qenë një ‘stacion’ i frikës dhe i shpartallimit -ikjes, braktisjes- ka një lidhje me ato që e paraprinë atë. Sepse një person shikon me habi dhe me frikë drejt Stacionit të Hyjnisë i treguar nga lavdia e bukuria; ai shikon duke kërkuar strehim drejt stacionit tē adhurimit nē **“Na’ebudu”**; nē **نسطرين nesteine** e tij ai shikon drejt stacionit tē mbështetjes nē **“nesteine”**, dhe duke kërkuar ngushëllim ai sheh drejt shokut tē tij tē vazhdueshëm, domethënë stacionit tē shpresës dhe tē lehtësimit.

Sepse ajo që shfaqet e para nē zemrën e atij që shikon diçka tē tmerrshme eshtë një sens hutimi, pastaj ai dëshiron tē ikë, pastaj duke pasë kuptuar pafuqinë e tij, i shfaqet atij tē mbështetet nē Allahun dhe pastaj ai kërkon rrugën e ngushëllimit.

<sup>24</sup> Kuran, 4:69

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Allahu xh.sh. është i Gjithurtë, i Pasuri Absolut dhe i Vetëmaftueshmë, atëherë cila është urtësia në krijimin e së keqes, shëmtisë dhe të çudhëzimit në botë?

*Ty do tē tē thuhej:* Dije se plotësia, e mira dhe bukuria janë thelbësishët ato që synohen në univers, dhe ato janë në shumicë, janë universale.

Dhe e keqja, shëmtia dhe mangësia janë tē pjesshme në krahasim me ato, janë tē pakta, dytësore dhe tē parëndësishme. Krijuesi i tyre i krijoj ato tē shpërhapura e tē përziera midis tē mirës dhe tē plotësisë, jo pér veten e tyre, por që tē jenë parathënie dhe njësi matëse pér shfaqjen -madje pér ekzistencën- e tē vërtetave relative tē tē mirës dhe plotësisë.

• *Në qoftë se ti do tē thoje:* Atëherë cila është rëndësia e tē vërtetave relative pér hir tē tē cilave e keqja e pjesshme u aprovua?

*Ty do tē tē thuhej:* Tē vërtetat relative janë lidhjet midis qënieve dhe fijet me tē cilat thurret rregulli -sistemi- i tyre.

Ato janë rrezet prej tē cilave reflektohet ekzistanca e çdo qenieje tē veçantë prej specieve në univers. Tē vërtetat relative janë me mijëra herë më tē shumta se sa tē vërtetat reale, sepse në qoftë se atributet reale tē një personi do tē ishin shtatëfish, tē vërtetat relative do tē ishin shtatëqind. Prandaj një e keqe më e vogël mund tē falet, madje aprovohet, pér hir tē një tē mire më tē madhe. Sepse tē braktisësh një tē mirë më tē madhe -pér shkak se ajo përmban ndonjë tē keqe më tē vogël- do tē ishte një e keqe më e madhe. Dhe në shikimin e urtësisë, në qoftë se e keqja më e vogël has tē keqen më tē madhe, e keqja më e vogël bëhet një e mirë relative, ashtu siç është vërtetuar pér shembull tek parimet në zeqat dhe në xhilad. Siç është e mirënjohnur se **انما تعرفُ الأشياءَ باضدِ أدَهَا**, “*gjërat njihen nëpërmjet tē kundërtave tē tyre*”, që do tē thotë se ekzistanca e tē kundërtës së një gjëje shkakton shfaqjen dhe ekzistencën e tē vërtetave tē saj relative.

Pér shembull, në qoftë se nuk do tē kishte shëmti dhe ajo nuk do tē depërtonte midis bukurisë, ekzistanca e bukurisë me shkallët e saja të pafundme nuk do tē shfaqeshin.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Cila është arsyja pér format e ndryshme tē këtyre tri fjalëve: **انعمت** “en'amte”, **u ke dhuruar mirësinë**

**مغضوب** “Magdub” “tē cilët merituan zemërimin Tënd (Ti je i zemëruar prej tyre)” duke qenë një pjesore

**ضالين** pasive; dhe “ed-dal-lin” “tē cilët u humbën, (tē cilët janë humbësit)” duke qenë një pjesore aktive? Gjithashtu cila është arsyja pér ndryshimet vijuese në përmendjen e: Atributit tē grupit tē tretë, përfundimin e tē dytit, i cili është rezultati i atributeve tē tij, dhe tē termave ekzakte tē tē parit?

*Ty do tē tē thuhej:* Termi **niemehi**, **mirësi** (ose bekime) është zgjedhur pér arsyen se mirësia është një kënaqësi drejt së cilës prijet nefsi, shpirti, dhe është në kohë e shkuar pér tē treguar se është shenja e Gjithëbujarit Absolut që tē mos e marrë prapë atë që Ai e jep. Duke têrhequr vëmendjen pér tek kjo praktikë e Dhuruesit tē mirësive, ajo gjithashtu sugeron një mjet pér tē arritur atë që kërkohet, sikur ai tē thonte: “Meqenëse praktika jote është tē dhurosh mirësi dhe Ti i ke dhuruar ato më parë, atëherë dhuroji ato edhe mbi mua gjithashtu”.

Sa pér **Gajri el-Magdubi**, “*jo (në rrugën) e atyre tē cilët merituan zemërimin Tënd, (prej tē cilëve Ti je i zemëruar)*”, me këtë synohen ata tē cilët kalojnë caqet e fuqisë së zemërimit, dhe që kanë bërë padrejtësi dhe shthurje duke braktisur rregullat, ashtu si kryeneçsia e jahudive. Meqenëse ndodhet në esencën e shthurjes dhe tē padrejtësisë një kënaqësi e keqe dhe një krenari e lig prej tē cilave nuk neveritet nefsi, Kur’ani përmend një pasojë që neverit çdo nefi, dhe ajo është zbritja e zemërimit Hyjnor.

Fakti që është zgjedhur një pjesore pasive nënkuption vazhdimësi dhe ky është një tregues se rebelimi dhe e keqja bëhen veçori tē rrënjosura thellë në qoftë se ato nuk ndalojnë e fshihen me *teube -pendesë* dhe me falje-ndjesë.

**vela el-daline**, “*dhe as në (rrugën) e atyre tē cilët u humbën, tē cilët janë humbësit*”.

Kjo u referohet atyre tē cilēt janēshmangur nga rruga, qē kanē humbur rrugen pēr shkak se mashtimi, iluzioni dhe pasioni kanē shkelur mendjen dhe ndērgjegijen, dhe ata kanē rēnē nē hipokrizi nēpermjet besimit tē rremē. Kur'ani ka zgjedhur ta pērshkruajē atē kēshu pēr shkak se vetē çudhēzimi eshtē dhimbje; nefsi sēmuret e neveritet prej tij; shpirti i shmanget edhe nē qoftē se nuk e ka parē rezultatin. Dhe pjesorja aktive eshtē zgjedhur pēr arsy se çudhēzimi do tē jetē çudhēzim nē qoftē se nuk ndalohet nēse vazhdon; por nē qoftēse ndērprit, ky eshtē njē tregues pēr tē pērfituar faljen.

Dije gjithashtu se e gjithē dhimbja qēndron nē çudhēzim dhe e gjithē kēnaqēsia gjendet nē besim.

Nēse dēshiron, shqyrtoje gjendjen e njē personi tē cilin Dora e Fuqisē e ka nxjerrē nga errēsirat e mosekzistencēs dhe e lēshoi nē dynja -nē atē shkretētirē tē tmerrshme. Kur ai hap sytē e tij duke kērkuar mēshirē, ai sheh goditjet, sēmundjet dhe fatkeqēsitet duke i rēnē e duke e sulmuar si armiqtē. Duke kērkuar mēshirē, ai shikon tek elementet dhe tek shkaqet natyrale, dhe i gjen ato zemērgurē dhe tē pamēshirshēm, duke e kērcēnuar. Duke kērkuar ndihmē, ai ngre kokēn -shikimin- e tij lart pēr tek trupat qiellorē dhe i sheh ato tē tmerrshme e tē çuditshme, duke e kērcēnuar atē sikur ato tē ishin predha zjarri - bomba atomike- duke u lēshuar prej grykave tē mēdhaja duke u sjellur rreth tij. Nē habi e çoroditje ai ul kokēn e tij dhe duke e mbuluar atē, duke mbyllur sytē, fillon tē shqyrtojē. Pastaj ai dēgjon mijēra britma tē nevojave tē tij dhe ofshamēn e mungesave tē tij dhe frikēsohet krejtēsish dhe mbyll veshēt. Me frikē, ai shikon tek ndērgjegija e tij duke kērkuar strehim e ngushēllim, dhe sheh nē tē mijēra shpresa tē mēdhaja dhe tē papērbajtura tē cilat nuk mund t'i ngopē e t'i kēnaqē dynjaja dhe bie nē njē gjendje çmendurie. Pēr hir tē Zotit, cila do tē ishte gjendja e kētij personi, nē qoftē se ai nuk beson nē krijimin e parē dhe nē Ringjalljen e tē vdekurve, dhe nē Krijuesin dhe nē Gjyqin e Fundit?

A nuk do tē ishte Xhehennemi mē i flladshēm dhe mē i lehtē pēr tē se sa kjo gjendja e tij duke ia regjur shpirtin nē mēnyrēn mē tē tmerrshme? Sepse ai i mjeri ka njē gjendje tē pērbērē prej frikēs, ankthit, pafuqisē, dridhjes, druajtjes, bonjakērisē dhe dēshpērimit.

Nē qoftē se do ta vēshtronc fuqinē e tij, ai do ta shihte veten se ēshtē i pafuqishēm dhe i dobēt. Nē qoftē se do tē pērpiqej tē qetēsonte nevojat e tij, ai do tē kuptonte se ato nuk mund tē qetēsohen. Nē qoftē se bērtet e bēn thirrje pēr ndihmē, ai nuk do tē drejtohej dhe nuk do tē ndihmohej. Ai e supozon çdo gjē tē jetē armiqēsore. Ai e imaginon çdo gjē tē jetē e huaj, kēshu ai nuk ndjen familjaritet e qetēsi. Ai nuk i sheh rrotullimet e trupave qiellorē veçse me frikē, habi dhe me drujtje, tē cilat shqetēsojnē ndērgjegijen e tij; dhe bēhet njē mijē herē pishman pse ka ardhur nē dyna dhe e bēn lanet.

Tani shikoje gjendjen e kētij personi nē qoftē se do tē ishte nē Rrugēn e Drejtē dhe qē ndērgjegija dhe shpirti i tē cilit janē ndriçuar me dritēn e besimit:

Ti do tē shohēsh se kur hyn nē kētē botē, ai i hap sytē e tij, sheh sulmet e tē gjitha gjērave pērreth tij, atēherē shikon njē pikē mbēshtetjeje tek e cila tē mbēshtetet pērballē atyre sulmeve tē mēparshme, dhe ajo eshtē njohja e Krijuesit, dhe kēshu ai do tē gjejē pushim e qetēsi; dhe ajo gjendje e errēsuar transformohet nē njē gjendje tē ndritshme.

Pastaj nē qoftē se ai i kontrollon aftēsitē e tij tē brendaqenēsishme, potencialet dhe shpresat qē shtrihen pēr nē pērjetēsi, do tē shihte njē pikē mbēshtetjeje, duke pērfytyuar jetēn e amshuar.

Ai kērkon ndihmē prej saj pēr shpresat e tij, sepse prej saj nxirret uji i jetēs dhe shijon prej tij, qē eshtē njohja e lumturisē sē pērjetshme. Dhe nē qoftē se ai e ngre kokēn e tij dhe shikon universin, ai do tē ndjejē njē familjaritet tek çdo gjē; ai do tē ndjejē njē familjaritet dhe dashuri duke ardhur nga çdo lule, dhe kēshu qetēson kērkesat e zemrēs.

Ai do tē shohē nē lēvizjet e trupave qiellorē urtēsinē e Krijuesit tē tyre, dhe do tē marrē kēnaqēsi prej lēvizjeve tē tyre, nē vend tē tmerrit. Duke i vēshtruar me habi ato lēvizje, ai person do tē marrē mēsim dhe reflektim. Sikur dielli i thērret atij duke i thēnē: vällai im! Mos u frikēso prej meje, unē mirēpres ardhjen tēnde. Tē dy ne jemi sherbētoret e njē Krijuesi tē Vetēm duke iu bindur urdhērit tē Tij. Hēna, yjet, deti dhe motrat e tyre, secila do t'i thērrasin atij me gjuhēn e saj tē veçantē. Duke ia bērē me shenjē, ato i thonē: Mirē se erdhe! A nuk na njeh neve? Tē gjithē neve jemi tē preokupuar me sherbimin ndaj

Pronarit Tënd. Mos u tmerro dhe mos u frikëso, as mos u shqetëso prej kërcënimit të fatkeqësive me foljen e tyre me hundë, sepse frerët e të gjitha gjërave janë në Dorën e Krijuesit Tënd.

Kështu, në situatën e parë personi ndjen një dëshpërim të tmerrshëm në thellësirat e ndërgjegjjes së tij. Ai do të detyrohet ta shpëtojë vetveten prej saj dhe t'i zbusë e t'i mpijë ndjenjat e tij nëpërmjet argëtimeve, duke u shtirur e duke pretenduar padije dhe duke e preokupuar veten me vogëlima, me qëllim që të mashtrojë ndërgjegjjen e tij dhe të mpijë shpirtin e tij. Përndryshe ai do të ndjente një dhimbje të madhe në thellësirat e ndërgjegjjes së tij, dhe efektet e saj do të ishin të dukshme në raport me shkallën e largimit të tij prej rrugës së vërtetë. Sa për situatën e dytë, atje njeriu ndjen në thellësirat e shpirtit të tij një kënaqësi të madhe dhe një lumturi të menjëherëshme. Sa herë që ai e zgjon zemrën e tij, lëviz ndërgjegjjen e tij dhe e bën të ndjejë shpirti i tij, lumturia e tij do të shtohet dhe ai do të marrë sihariqe se dyert e një parajse shpirtërore janë duke u hapur për të.

اللهم بسْرُورْهَ هَذِهِ السُّورَةِ اجْعُلْنَا مِنْ أَصْحَابِ الْصَّرَاطِ الْمُسْتَقِيمِ أَمِينٌ

*O Zot për nderim të kësaj sureje na bëj ne prej njerëzve të Rrugës së drejtë!*

\* \* \*

## Sureja El-Bekare

[E para e dy sureve vezulluese<sup>25]</sup>]

• Në qoftë se ti do të thoje: Kur'ani është edhe i mrekullueshëm, edhe i thukët (i ngjeshur në stil), megjithatë disa vërsete në të përsëriten në dukje shumë shpesh, të tilla si  
**بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ نَبَيُ الْأَئِمَّةِ رَبُّكَمَا تَكَدِّبَانِ \* وَيَلِ يَوْمَيْدِيْنِ ...**

*Bismil-lah* dhe vërsitet: "Atëherë pra, cilën nga Mirësitë e Zotit tuaj ju (njerëz dhe xhinde) e mohoni?"<sup>26</sup> dhe "*Mjerë ajo Dité pér mohuesit (e Dítës së Ringjalljes)!*"<sup>27</sup> dhe tregimi i Musait a.s..

A nuk janë përsëritye të tilla, të mërzitshme dhe në kundërshtim me elokuencën?<sup>28</sup>

*Ty do të të thuhej:* "çdo gjë që shkëlqen nuk djeg". Po, përsëritjet ndonjëherë janë të mërzitshme, por jo gjithmonë. Ndonjëherë ato janë të mërzitshme, dhe ndonjëherë janë të vlerësuara dhe të admiruara. Por nuk është përgjithshme pér çdo vend e pér çdo libër. Ushqimi të cilin njeriu e ha, përfshin edhe ushqimin bazë edhe frutin. Sa më shumë të përsëritet i pari aq më të madhe e jep ai kënaqësinë; ai jep fuqi dhe trupi bëhet i mësuar me të. Ndërsa i dyti i jep shkas mërisë kur përsëritet dhe jep kënaqësi kur zëvëndësohet me diçka të re.

<sup>25</sup> Transmetohet nga Ebu Umama el-Bahili:

"Unë kam dëgjuar të dërguarin e Allahut të thotë: 'Lexojeni Kur'anin, sepse në ditën e fundit (të Ringjalljes së të vdekurve), ai (Kur'an) do të jetë një ndërmjetësues pér pasuesit -përkrahësit e tij. Lexojini dy suret vezulluese (el-zahravejn) El-Bekara dhe suren Ali-Imran... transmetoi Muslimi.'

<sup>26</sup> Kur'an, 55:13,16,18 etj.

<sup>27</sup> Kur'an, 77:15, 19, 24.

<sup>28</sup> Për një diskutim mbi përsëritjen në Kur'an, shiko çështjen e Dhjetë të Rrezes së Njëmbëdhjetë. Shiko koleksionin e Rrezeve.

Në të njëjtën mënyrë, disa fjalë dhe ligjérata janë realitetet (*hakikah*) dhe ushqimi bazë; ato forcojnë mendjen dhe ushqejnë shpirtin. Sa më shumë të përsëriten ato, aq më të mira duken dhe bëhen më familjare, të njobura, ashtu si drita e diellit. Në të ndodhen të tjera që janë si frutat dhe si stolisja, ato japin kënaqësi duke u ndryshuar lidhur me llojin dhe dukjen -pamjen e jashtme.

Duke e pasë kuptuar këtë, ju duhet ta dini se, si një tërësi, Kurani është ushqim dhe fuqi për zemrat dhe përsëritja e tij nuk shkakton mërgji, përkundrazi gjendet kënaqësi e gëzim duke e përsëritur shumë atë. Gjithashtu, në Kuran ndodhen pjesë që janë shpirti i atij ushqimi e forcë; sa më shumë të përsëriten ato, aq më shumë ato ndriçojnë në mënyrë vezulluese, duke përhapur dritat e së vërtetës dhe të realitetit.

**بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ**

Midis këtyre të fundit janë disa si “*Bismil-lah*” që janë parime esenciale, burimet e jetës, dhe dritat e mishëruara të përjetshme. Kur ato përsëriten, hapin orekset, ashtu si myshku që kundermon aromë kur e përzien. Ajo që mendohet se është përsëritje, në realitet nuk është përsëritje. Me përashtim të disa ajeteve si ky: “*e atyre do tu jepen gjëra të njashme...*”, që kanë shprehje dhe fjali të njashme me njëra-tjetrën, veçse ama këto tregojnë urtësi, pika të holla dhe qëllime të ndryshme. Për këtë shkak ato mendohen se janë të përsëritura. Por kjo varet nga parimi i përsëritjeve. Tregimi i Musait a.s. mund të merret si një shembull: në çdo vend -mekam që ai gjendet, që përsëritet- për njërin prej aspekteve që ai përban, ai është më i dobishëm se sa pjesët e Shkopit të tij; Kurani e merr atë me dorën e tij të bardhë e të ndritshme si argjend dhe e bëri flori, saqë magjistarët e retorikës ranë në sexhde -u përkulen- përparrë elokuencës së tij.

Gjithashtu, në “*Bismil-lah*” ndodhen faqe të ndryshme, disa duke shprehur kërkimin e ndihmës dhe bekimet; disa duke shikuar subjektin (e sures në çështje), madje qëllimin e saj; të tjerat duke treguar se ajo është një indeks i pikave themelore të Kuranit.

Gjithashtu të përfshira në “*Bismil-lah*” janë nivelet e ndryshëm (të kuptimit), ato të Unitetit Hyjnor (*Teuhid*), dhe duke e shpalluar Allahun krejtësisht të lirë prej attributeve njerëzore -(*tanzih*), duke shpallur lavdërimin, lavdinë Hyjnore (*Xhelal*) dhe bukurinë (*Xhemal*), dhe atë të vepruarit drejtësi (*ihsan*), dhe kështu me radhë.

“*Bismil-lah*” gjithashtu dedukton e nënkupton urdhëresa e dekrete të ndryshme: për shembull, ajo tregon Unitetin Hyjnor, profetësinë, ringjalljen e të vdekurve, dhe drejtësinë; domethënë katër qëllimet (kryesore) të mirënjobura të Kuranit. Shumica e sureve kanë vetëm njëren prej tyre si qëllimin e saj parësor, ndërsa pjesa tjeter janë dytësore.

Atëherë, përsë nuk duhet të ketë njëra nga faqet e “*Bismil-lah*” ose nga dekreteret ose nga nivelet e kuptimit një lidhje të veçantë me shpirtin e sures -në çështje-, dhe të jetë një subjekt i atij konteksti, madje një indeks i përbledhur i të gjithë atyre aspekteve dhe niveleve?

\* \* \*

## VËRSETI 1

### (Shkronjat e shkëputura)



*"Elif. Läm. Mim".*

Ndodhen katër çështje të lidhura me këto.

#### Çështja e parë

Mrekullia dhe paimitueshmëria e Kur'anit agon -lind- prej horizontit të shkronjave të shkëputura, në këtë rast nga *Elif. Läm. Mim*, sepse mrekullia është një dritë që shfaqet prej kombinimit -përzierjes- së shkreptimave të hollësive të elokuencës (ose të retorikës *-el-belâgah*). Kjo çështje përmban shumë pika të holla, por çfarëdo të jetë hollësia e tyre, një agim i vërtetë del nga tërësia e tyre.

**Së pari:** “*Elif. Läm. Mim*”, së bashku me shkronjat e shkëputura në fillimin e disa sureve, me motrat e tyre, përbëhen nga gjysma e disa shkronjave të alfabetit, të cilat janë elementet bazë të të gjitha fjalëve.

Domethënë, Kur'ani përdor gjysmën e njëzet e tetë shkronjave dhe lë mënjanë gjysmën.

Mendo mbi këtë!

**Së dyti:** Gjysma që ai merr janë më shumë të përdorshme se sa gjysma që ai lë.

**Së treti:** Prej shkronjave që merr tek fillimi i sureve, Kur'ani i përsërit ato më të lehtat për gjuhët, si ‘*Elif*’ dhe ‘*Läm*’.

**Së katërti:** Ai i përmend shkronjat e shkëputura në fillimin e njëzet e nëntë sureve, të cilat i korrespondojnë numrit të shkronjave të alfabetit.<sup>1</sup>

**Së pesti:** Ai merr gjysmën e atyre shkronjave që kanë palë -çift- si të mbuluara (*mehmuseh*), emfatiket (*mexhureh*), të theksuarat (*shedideh*), të butat, të dobëtat (*rakhve*) dhe shkronjat ‘*mustalijah*, *munhofida*, *muntabika* dhe *munfatiha*, dhe pjesën e mbetur të tyre. Prej atyre që nuk kanë palë (*Ewtar*), ai merr më pak prej të ‘rëndave’ si tremolo -dridhje e tingullit (*kal kale*) dhe më shumë prej të ‘lehtave’, si buzorëzim i tingullit (*Dhel-laka*).

**Së gjashti:** Ato që ai i përdor prej këtyre janë më të hollat në veçori.

**Së shtati:** Mënyra që ka zgjedhur Kurani për -përgjedhjen- e shkronjave të shkëputura është njëra prej katërqind apo pesëqind mundësive, dhe kjo është mënyra e vetme e mundshme e përgjysmimit të shkronjave -të alfabetit- me karakteristikat e tyre të veçanta. Sepse ndarjet -në grupe të ndryshme të shkronjave- janë të ndërthurura dhe njëra brenda tjetrës, si dhe duke qenë të pangashme -të ndryshme. Secila nga këto ndarje është vërtet e jashtëzakonshme dhe e veçantë. Kështu, në qoftë se një person dështon për ta vlerësuar drithën e mrekullisë e lindur prej përzierjes dhe kombinimit të këtyre rrezeve, ai të mos qortojë veçse shijen e tij -mungesën e mendjemprehtësisë së tij.

#### Çështja e dytë ka disa hollësira:

**Së pari:** “*Elif. Läm. Mim*.” secila prej tyre është si goditja e një çekani, ato e zgjojnë dëgjuesin, duke dhënë alarmin e duke zgjuar interesin e tij nëpërmjet veçantisë së tyre se ato janë lajmëtarët dhe zbulueset e diçkaje të çuditshme dhe të jashtëzakonshme. Kjo çështje gjithashtu përmban një numër hollësish.

<sup>1</sup> Në qoftë se *Hamza* numërohet, ndodhen Njëzet e nëntë shkronja në alfabetin arab;

**Së dyti:** Shkëputja e shkronjave dhe qenia e tyre të shqiptuara shkronjë për shkronjë nga emri tregon se ajo që ato shprehin është i të njëjtit lloj si vetja e tyre.

**Së treti:** Këtu shkronja duke u shkëputur tregon se ajo që ato shprehin merret me mend se është një dhe jo e përbërë -kompleks.

**Së katerti:** Shqiptimi -gërmëzimi- i shkronjave duke i shkëputur ato, është një tregues se ajo aludon për materialin dhe burimin e artit, sikur t'i jepje penën dhe letrën atij që të kundërshton në të shkruar (që dëshirojnë t'i kundërshtojnë ato nëpërmjet të shkruarit). Kurani sikur është duke thënë: “Hej ju rivalë kryeneçë, jujeni profesorët dhe të parët e të folurit bukur! Ju keni në dispozicionin tuaj materialet që i kam unë kur unë i hartova -i shpika këto, bëjeni ju përngjasimin e tij në qoftë se mundeni!”

**Së pesti:** Shkëputja e shkronjave që simbolizon lënien jashtë të kuptimit, tregon se kundërshtarët e -Kuranit- kanë mbetur pa prova. Sepse ata thonë: “Ne nuk i njohim faktet, tregimet dhe dekreteret që të mund t’ju kundërshtojmë ju”. Kurani sikur thotë me gjuhën e gjendjes së këtyre shkronjave të skalitura të pakuptueshme: Unë nuk kërkoj nga ju veçse të prodhoni -diçka të ngjashme- me renditjen elokuente (*nadhmu el-belagah*) “të shkronjave, madje edhe sikur të jenë të trilluara”.

**Së gjashti:** Rrokjezimi i shkronjave rrokje pas rrokje është e veçantë për nxënësit e leximit dhe të shkrimit. Atëherë nga kjo kuptohet e deduktohet se Kurani është themeluesi i një rruge të re dhe është mësuesi i njerëzve analfabetë.

**Së shtati:** Shkronjat si **إِلْيٰفْ لَامْ دَالْ**, quajtja dhe përmendja e shkronjave me emrat e tyre është zakoni i dijetarëve dhe i shkrimitarëve. Por si ai që e shpreh këtë mënyrë të foluri, po ashtu edhe ata të cilët e dëgjojnë atë, ishin analfabetë. Prandaj, duke shqyrtaur e parë veçorinë e saj, shkronjat duke qenë në këtë formë të paparashikuar nënkupton se “kjo mënyrë ligjërimi nuk është e tij, por iu zbulua atij”.

Ata të cilët nuk mund ta shohin artin e lartësuar në ndërthurjen e këtyre reshtave -megjithëse siç pranohet disa janë shumë të hollë- janë

rishtarë (fillestare) për artin e elokuencës, duhet t'u drejtohen mjeshtërave të tij, le të imitojnë vendimet e ekspertëve të atij arti!

### Çështja e tretë

**إِلْيٰفْ لَامْ مِمْ** “*Elif. Lam. Mim.*” tregojnë thukëtinë përfundimtare, e cila është e dyta e dy parimeve të mrekullisë (së Kuranit). Kjo çështje përmban një numër prej pikave të holla.

**Së pari:** **إِلْيٰفْ لَامْ مِمْ** “*Elif. Lam. Mim.*” tregojnë, aludojnë, simbolizojnë, nënkuptojnë, shprehin dhe sugjerojnë krahasimin e njëpasnjëshëm -vijues- alegorik (*el-kijas el-temthili el muteselsil*): **هَذَا كَلَامُ اللَّهِ الْأَزِلِّي**

**نَزَّلَ بِهِ جِبْرِيلُ** **تَهْجِيْرِيْلُ** të cilën **عَلَى مُحَمَّدٍ عَلَيْهِ السَّلَامُ** **مُهَمَّادِيْلُ** **عَلَيْهِ السَّلَامُ** **mbi Muhammedin, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të dy.** Sepse ndonjëherë dekretet e përcaktuara në tërësinë e Kuranit mund të manifestohen, të shfaqen në një sure të gjatë në mënyrë të përbledhur; një sure e gjatë shfaqet në një sure të shkurtër; dhe ndonjëherë një sure e shkurtër përfshihet simbolikisht në një vërsët të vetëm; dhe ndonjëherë një vërsët tregohet në një fjali të vetme; dhe ndonjëherë për një fjali aludohet në një fjalë të vetme; dhe ndonjëherë gjithashtu një fjalë e tillë gjithëpërfshirëse mund të dallohet, të shfaqet, në shkronjat e shkëputura, si në “*Sin. Lam. Mim.*” Gjithashtu i gjithë Kurani mund të dallohet në suren *el Bekareh*; dhe *el-Bekareh* në suren *el-Fatiha*; dhe *el-Fatiha* në “*Bismil-lâhî el-Rahmân el-Rahîm*”, dhe *Bismil-lâhî el-Rahmâni el-Rahîm* në një *Bismil-lâh* të skalitur ose të gdhendur.

E njëjita shkon edhe për **إِلْيٰفْ لَامْ مِمْ** “*Elif. Lam. Mim.*”

Duke u mbështetur tek ky krahasim i njëpasnjëshëm -vijues- alegorik, dhe siç tregohet nga “*Ai është libri (Kurani)*”, i manifestuar nga “*Elif. Lam. Mim.*” (është kuptimi): “kjo është Fjala e parapërjetshme e Allahut, të cilën Xhebraili e zbriti mbi Muhammedin, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dy ata.

**Së dyti:** Shkronjat e shkëputura janë shifra Hyjnore të komunikuar nga (më i larti) për të dërguarin e Tij, me të cilin është çelësi, për të cilit mendja njerëzore nuk ka arritur akoma.

**Së treti:** Skronjat e shkëputura tregojnë mendjen e mprehtë të Hazreti Muhammedit a.s.m., sepse ai a.s.m. e kuptoi atë që ishte aluduese, simbolike dhe e paqartë sikur ajo të ishte e qartë, e shkoqur dhe e shtjelluar.

**Së katerti:** Shkëputja e këtyre shkronjave tregon se vlera e shkronjave nuk qëndron në kuptimet e tyre, por në lidhjet e tyre të natyrshme të ndërsjella, ashtu si lidhjet ndërmjet numrave. Shkenca e veçorive të fshehta të shkronjave (*'ilm asrar al-huruf'*) i ka zbuluar këto lidhje.<sup>2</sup>

**Së pesti:** Në mënyrë të veçantë, “*إِلْفَ لَامَ مِيمٌ*” tregojnë, nëpërmjet qënies së tyre të shkëputura, tre vendet kryesore të tingujve të të gjitha shkronjave të nyjetuara: gryka, goja dhe buzët.

Dhe kjo me rradhë nënkuption se vëmendja duhet të ngulitet dhe perdja e familjaritetit -të zakonshmes- të griset, duke e nxitur njeriun të studiojë ngjyrat e çuditshme e të mrekullueshme të qëndisjes së krijimit të shkronjave, të cilat dalin prej atyre vendeve të vogla.

O Ti që të është lyer dora me ngjyrat e artit të elokuencës! Mblidhi pjesët e ndryshme të këtyre pikave të holla dhe shikoji ato si një tërësi, pastaj dëgjoje recitim e tyre për ty: **هَذَا كَلَامُ اللهِ** “Kjo është Fjalë e Zotit xh.sh.”

### Çështja e katërt.

﴿ إِلْفَ لَامَ مِيمٌ” dhe motrat e tyre kur shfaqen në këtë formë, është sikur ato thërrasin: “Ne jemi imamët -liderit; ne nuk imitojmë asnjë dhe nuk ndjekim askënd. Stili ynë është original dhe mënyra

<sup>2</sup> Shënim: Pas dyzet viteve Risale-I Nuri ua ka treguar edhe të verbërve këtë shkëreptimë mrekullie.

jonë është e veçantë”. Kjo çështje gjithashtu përmban një numër hollësish.

**Së pari:** Është zakoni i oratorëve dhe i ligjëruesve elokuentë që gjithmonë të kafen pas modeleve dhe shembujve të qëndisur dhe të ndjekin rrugë të rrahura. Por këto shkronja janë të virgjera -të përdorura për herë të parë- dhe të paprekura nga njeriu dhe xhindi.

**Së dyti:** Nga fillimi gjer në fund, Kurani ka mbetur akoma ashtu siç ishte në fillim. Megjithëse nga përmallimi i tyre, miqtë e tij kanë dashur ta imitojnë, dhe po ashtu armiqtë e tij nga dëshira e tyre për ta sfiduar, Kurani kurrë nuk është imituar dhe as ndonjë gjë e ngashme me të nuk është arritur. Nëse dëshironi provë për këtë, hidhe vështrimin tek miliona librat në arabisht! A ka ndonjë prej tyre të barabartë me Kuranin, apo madje të afërm me të? Jo, kurrë! Madje edhe një injoranti analafabet do t'i thërriste shikimi i tij, në qoftë se do t'i krahasonte ato me të: “Kurani nuk është i nivelit të tyre! Kurani ose është më inferior se ato të gjithë, dhe kjo është e pamundur, ose ai është superior mbi të gjithë, dhe kjo është siç duhet të jetë”. Atëherë, sigurisht kjo është fjala e Allahut.

**Së treti:** Është shenja e artit njerëzor që në fillim ai të shfaqet i papërpunuar dhe i mangët në shumë aspekte, i thatë dhe në mungesë të këndshmërisë; pastaj ai gradualisht plotësohet dhe bëhet i këndshëm dhe i ëmbël.

Megjithatë stili i Kuranit, kur u shfaq në fillim, u shfaq i këndshëm, i freskët dhe i ri, dhe ai akoma e sfidon mendjen njerëzore, e cila është vjetëruar nëpërmjet kombinimit të ideve dhe duke vjedhur disa prej disave. Kurani ka triumfuar mbi të gjitha ato, duke shpallur me anë të fitores së tij se ai është arti i Krijuesit të të gjitha fuqive dhe të kaderit.

O Ti që thith filadin e elokuencës! A nuk e mbledh bleta e mendjes tënde prej luleve të këtyre katër çështjeve mjaltin e اشْهَدُ أَنَّ هَذَا كَلَامُ اللهِ “Unë dëshmoj se Kjo është Fjalë e Allahut!”?

\* \* \*

## VËRSETI 2

ذَلِكَ الْكِتَابُ لَارِيبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

Dhàlikë el-kitabu là rejbe fi-hi huden lì(e)l mut-tekiñe.

"Ai èshtë libri (Kur'ani), mbi të cilin nuk ka asnje dyshim, udhëzim pér el-muttekine (besimtarët e drejtë, të përkushtuarit)."

### Parathënie

**Shikoje këtë:** Njëri nga parimet e elokuencës që e zbukuron Fjalën duke e bërë atë të shkëndijojë më shumë èshtë se të gjitha fjalitë dhe fjalët i përgjigjen njëra-tjetrës, thërrasin njëra-tjetrën derisa shohin tek qëllimi bazë. Kështu, sipas fuqisë së saj secila e forcon qëllimin i cili èshtë si bashkëderdhje lumenjsh ose si një pellg i furnizuar nga të gjitha anët, duke konfirmuar e ilustruar thënien:

"Shprehjet tonë janë të ndryshme por bukuria jote èshtë një

Dhe secili prej nesh tregon atë bukuri.

**Shembulli i parë:**

Shqyrto, pér shembull, vërseti:

وَلَئِنْ مَسْتَهُمْ نَفْحَةٌ مِّنْ عَذَابٍ رَّبَّكَ <sup>رَبَّكَ</sup> "Dhe në qoftë se vetëm një frysë e ndëshkimit të Mbështetës (Zotit) tënd do t'i prekë ata..."<sup>1</sup>

Ai frikëson nëpërmjet aludimit pér një sasi të vogël të dënimit. Ai tregon tmerrin e dënimit nëpërmjet shfaqjes së rreptësisë në sasi më të vogël.

<sup>1</sup> Kuran 21:46

A nuk e sheh se si fjala ان "Dhe në qoftë se (we le'in)" tregon dyshim dhe dyshimi shikon pakicën e dënimit; dhe fjala مَسْتَهُمْ "mes-se" (do t'i prekë) do të thotë me prek lehtë me të lehtë, dhe shpreh një sasi të vogël; dhe fjala نَفْحَةٌ "Nefhat" (një frysë) èshtë thjesht një frysë dhe èshtë në formën e njëjësit, që shpreh pakicë ose zvogëlim, ashtu siç bën tenvini duke treguar trajtë të pashquar; dhe pjesëtorja "prej dënimit" من "min" që tregon ndarje ose pjesë; ajo do të thotë pak, një thërime, gjë që tregon pakicë; dhe fjala عَذَابٍ "Adhab" "dënim" tregon një lloj të lehtë dënimini në lidhje me ndëshkimin نَكَالٌ "nekal" dhe sugjeron një sasi të vogël; dhe duke aluduar pér mëshirën, fjala رب "Rabb" "Zoti, Mbështetësi" tregon gjithashtu pakicë?

Tani krahasoji të tjerat me këtë dhe shiko se si secila në mënyrën e saj të veçantë ndihmon qëllimin kryesor. Bëj analogji me këtë vërsët pér vëllezërit e saj.

**Shembulli i dytë:**

الْمَ، ذَلِكَ الْكِتَابُ لَارِيبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ <sup>رَبَّكَ</sup> Në mënyrë të veçantë "Elif. Lam. Mim". Ai èshtë libri (Kur'ani), mbi të cilin nuk ka asnje dyshim, udhëheqje pér ata që e kanë frikë Allahun". Qëllimi kryesor i këtij èshtë pér të lavdëruar Kuranin dhe pér të provuar plotësitetë e tij. Të gjitha pjesët e vërsetit tregojnë në harmoni këtë qëllim: në një aspekt, betimi (i shprehur nga) "Elif. Lam. Mim; dhe "Dhàlikë" "Ai" duke qenë një përemër dëftor dhe duke shprehur e nënkuqtaur gjëra konkrete dhe distancë; nyja shquese "el" tek "el-kitab" "libri" dhe prova (e treguar nga) "mbi të cilin nuk ka asnje dyshim", "là rejbe fi-hi"; secila prej këtyre frazave ndihmon qëllimin kryesor, duke i shtuar pjesën e vet, duke zbuluar prej poshtë dëshmitë që mbështeten tek ajo, edhe në qoftë se ato janë të holla e të fshehta:

Në qoftë se dëshiron shqyrtoje ﴿“Elif. Lām. Mīm”﴾, meqë ajo është një betim, ajo është edhe mbështetëse -vërtetuese, si dhe jep idenë e madhështisë -së Kur'anit. Kështu, si provë e asaj për të cilën aludon, ajo tërheq vëmendjen pér tek hollësitë që janë nën -shkronjatë përmendura në katër çështjet lart.

Tani shikoje përemrin dëftor ﴿ذلك﴾ “Dhälîk”, “Ai”. Ai përdoret pér t'u referuar esencës dhe atributeve -të gjërave konkrete, dhe kështu ajo tregon madhështinë -e Kur'anit- sepse ajo tregon ose atë pér të cilën aludojnë ﴿“Elif. Lām. Mīm”﴾, ose atë që është parathënë e njoftuar në Teurat dhe në Inxhil -dhe ajo tregon dëshmitë që janë nën të. Atëherë sa e madhe, dhe sa e përkryer është gjëja e bekuar nga (domethënë, Kur'ani), që është paranjoftuar e sihariquar në Teurat dhe në Inxhil-ungjill!

Pastaj, shqyrtoje me kujdes këtë përemrë dëftor, i cili megjithëse i përdorur siç duhet pér gjëra të prekshme, konkrete, këtu aludon pér diçka mendore (*el-emr el-makul*), dhe ju do të shihni se ashtu siç nënkuption ai madhështi e rëndësi, po ashtu tregon se Kur'ani i tërheq mendjet si magnet, duke tërhequr shikimin e gjithkujt pér tek vetvetja dhe duke preokupuar imaginatat e tyre. Prandaj (Kur'ani 'mendor') shfaqet të jetë tek një nivel i tillë -që do ta shikonin sytë nga prapa në qoftë se do të konsultoheshin me imaginatën- kështu nga pikërisht natyra e tij (ky përemrë dëftor) nënkuption se -Kur'ani- është i vërtetë, i saktë dhe i besueshëm dhe krejtësisht i lirë dhe larg dobësisë dhe mashtrimit, meqë këto duhet të mbulohen -të fshihen.

Pastaj, shqyrtoje distancën e sugjeruar prej ﴿ذلك﴾ “Dhälîk”, “Ai”. Kjo tregon edhe rangun e lartë të Kur'anit, i cili tregon plotësimin e tij, edhe se ai është krejtësisht larg dhe lart çdo përpjekjeje pér ta imituar.

Pastaj studioje nyjen shquese ﴿el﴾ të ﴿el-kitâb﴾: meqenëse shpreh përkufizim, ajo tregon lartësinë e Kur'anit dhe e hap derën pér krahasim, dhe aludon se Kurani ashtu siç grumbullon në vetvete bukuritë dhe virtutet e të gjithë librave të tjera të shpallur, po ashtu u shtohet atyre, dhe prandaj është më i plotësuari i tyre.

**كتاب** Pastaj qëndro tek shprehja “El-kitâb” “Libri” dhe shiko se si aludon se ai nuk do të mund të ishte shpikja e një analfabeti i cili nuk njihte as lexim dhe as shkrim.

لَرِيْبِ فِيهِ “lā rejbe fi-hi”, “Mbi tē cilin nuk ka asnje dyshim”.

Ndodhen dy aspekte pér لَرِيْبِ فِيهِ “la rejbe fi-hi”. (prapashtesa përemërore -hi) i referohet ose (këtij pohimi ose “Librit”. Sipas tē parit (siç afirmohet nga) el miftah,<sup>2</sup> ajo do të thotë “sigurisht dhe padyshim”, kështu është një provë tjetër indirekte e plotësisë (së Kur'anit).

Sipas tē dytit, siç pohohet nga el-Kash-shaf<sup>3</sup>, ajo konfirmon ekzistencën e plotësive të Kur'anit. Dhe që tē dy thonë se nga poshtë “lā rejbe fi-hi” pëshpërit vërseti “Dhe nëse ju dyshoni pér atë (Kuranin) që ne i këmi zbritur robit tonë, atëherë bëni edhe ju një sure tē ngjashme si ajo...”<sup>4</sup> duke treguar dëshminë e saj tē veçantë. Dhe pér shkak se (pjesëza mohore) لَ “lā” e “lā rejbe fi-hi” është absolute, ajo i largon tē gjitha dyshimet e mundshme dhe gjithashtu reciton reshtat:

وَكُمْ مِنْ عَابِرٍ قُلُّا صَحِيحًا وَاقِهٌ مِنَ الْفَهْمِ السَّقِيمِ

*Sa shumë fjalë tē sakta*

*Janë menduar tē janë tē mangëta,*

*Ndërsa gabimi i vetëm i tyre*

*Qëndron në kuptimin -konceptimin- e dëgjuesit.<sup>5</sup>*

Ajo gjithashtu tregon se Kurani nuk mund t'u japë shkas dyshimeve, sepse brenda tij janë shenja tē tilla dhe tregues e të vërteta

<sup>2</sup> Miftah el-Ulum' nga Siraxh-ed-din el Sek-kaki, rrëth gjuhës, letërsisë dhe poezisë. Ajo ishte vepra më gjithëpërfshirëse e kohës së tij mbi “ilm al bajjan”. Shiko *kashf el-dhunun’*... (d.626)

<sup>3</sup> *El-kash-shaf an Haka'ik el-tanzil'* nga Mahmud Ibn Umar al Zamahsheri (538 H):

<sup>4</sup> Kuran, 2:23

<sup>5</sup> El-Muteneb-bi në *divanin* e tij 4/246.

që nga të gjitha anët ato grumbullohen së bashku dhe i shtyjnë dhe i zmbrapsin dyshimet sulmuese.

Dhe tek shprehja ndajfoljore (ose që përmban *-Dharfijje*) “*Fi-hi*” dhe zgjedhja e *fi* “*fi*” “*në*” në vend të parafjalëve të tjera është një shenjë se shikimi i njeriut duhet të depërtojë në brendësi të Kuranit dhe se të vërtetat e tij do t'i shporrin dyshimet e pabaza që ulen në sipërfaqen e tij për shkak të një shikimi sipërfaqësor.

O mik! Tani që ti e ke dalluar vlerën e -kësaj fjalie- të përbërë nëpërmjet analizës së saj dhe e ke kapur ndryshimin midis të tërës dhe pjesëve të saj, hidhe një vështrim tek fjalët dhe frazat e saj dhe shiko se si secila e jep kontribut pjesën e saj për qëllimin e përbashkët me dëshminë e saj të veçantë, dhe si drita e elokuencës flakëron e ndizet menjëherë në çdo anë.

Shqyrtoje këtë: Arsyjea pse frazat

**الْهُدَى لِلْمُتَّقِينَ** “*Elif. Läm. Mim.*

*Dhàliké el-kitâbu lâ rejbe fi-hi huđen li(e)l mut-tekîne*, “*Elif. Läm. Mim. Ai* është Libri (*Kur'anî*), mbi tê cilin nuk ka asnje dyshim, udhëzim për el-muttekîne (*besimtarët e drejtë, tê përkushtuarit*)” nuk janë lidhur me pjesëzat lidhëse është bashkimi -lidhja- e tyre e fortë dhe pëqafimi i ndërsjellë; secila fjalë kap dorën e asaj që e parapriu dhe bishtin e asaj që e ndjek nga pas. Sepse në një mënyrë secila është provë e të gjitha atyre, dhe në një mënyrë tjetër është rezultati i tyre.

Mrekullia -e Kuranit- është skalitur mbi këtë vërset (sikur ai të ishte) një qëndisje e thurur prej vijave të ndërfutura me ndërlirim të lidhjeve. Në qoftë se do të donit ta shihnit atë në mënyrë të detajuar, (së pari) studioji **الْهُدَى** “*Elif. Läm. Mim.*”, sepse ato nënkuptojnë këtë kuptim: “Këto (shkronja) janë nxjerrë si një sfidë; atëherë a ka ndonjë që t'i përgjigjet, që të dalë në shesh?

Pastaj shqyrtoje **الْكَتَابُ** **ذَلِكَ الْكَتَابُ** “*Dhàliké el-kitâbu*”, “*Ai* është Libri (*Kur'anî*)”, sepse ajo deklaron qartë se i tejkalon të gjithë vëllezerit – librat- e saj dhe i ka kapërcyer, kështu duke deduktuar e nënkuptuar se ai është i jashtëzakonshëm dhe i pashok.

**لَرِبِّ فِيهِ** **الْهُدَى لِلْمُتَّقِينَ** “*lâ rejbe fi-hi*”, “në tê cilin nuk ka asnje dyshim”, sepse ajo deklaron në mënyrë të qartë se nuk ka vend për dyshim, duke shpallur kështu se (Kurani) është i ndriçuar me drithë e sigurisë.

Pastaj shiko tek **هُدَى لِلْمُتَّقِينَ** “*huđen li(e)l mut-tekîne*”, “udhëzim për el-muttekîne (*besimtarët e drejtë, tê përkushtuarit*)”; sepse ju informon se ajo tregon Rrugën e drejtë dhe është mishëruar prej drithës së udhëzimit.

Kështu, në lidhje me kuptimin e parë secila frazë është një provë e shoqeve të saj, dhe përsa ka të bëjë me kuptimin e dytë, të gjitha janë rezultati i secilës prej tyre.

Tani nëpërmjet shembullit, ne do të përmendim tre prej dymbëdhjetë lidhjeve, dhe ju mund të bëni analogji me to për pjesën e mbetur.

**الْهُدَى لِلْمُتَّقِينَ** “*Elif. Läm. Mim.*; ”

Domethënë, ky libër i sfidon të gjithë ata të cilët e kundërshtojnë; prandaj ai duhet të jetë më i miri i librave; prandaj ai shpreh siguri, sepse libri më i mirë është ai që është i sigurt; kështu ai duhet të jetë një udhëzim i mishëruar për njerëzimin.

Pastaj **ذَلِكَ الْكَتَابُ** “*Dhàliké el-kitâbu*”, “*Ai* është Libri (*Kur'anî*)”,

Domethënë, ky libër është më superior ndaj çdo gjëje që i ngjason atij. Kështu ai duhet të jetë i mrekullueshëm. Ose ai është i jashtëzakonshëm dhe i shquar; sepse nuk ka dyshim në të; sepse ai tregon rrugën e niveluar -e drejtë- për ata që e kanë frikë Allahun.

Pastaj, **هُدَى لِلْمُتَّقِينَ** “*huđen li(e)l mut-tekîne*”, “udhëzim për el-muttekîne (*besimtarët e drejtë, tê përkushtuarit*)”. Domethënë ai udhëzon për tek rruga e drejtë; kështu ai duhet të jetë i sigurt; kështu ai është i jashtëzakonshëm; kështu ai është i mrekullueshëm.

Ju tani mund të deduktoni pjesën tjetër për veten tuaj.

**هَدْيٌ لِلْمُتَّقِينَ** “*Huden li(e)s mut-tekine*”, “*udħeżim pēr el-muttekine besimtarət e drejtē, tē pērkushtuarit*”.

Ti duhet ta dish se burimi i bukurisë sē kēsaj fraze dhe drita e elokuencës eshtë shfaqur nē katér pika.

**E para:** heqja e kryefjalës, qē tregon se kryefjala dhe kallzuesi janē bashkuar dhe se deklarimi -i shprehur- eshtë i pranuveshém. Sikur nē esencë kryefjala eshtë brenda kallzuesit, dhe ato nuk dallohen midis tyre as edhe nē mendje.

**E dyta:** Zēvendësimi i pjesores aktive me një emér foljor, nē tē cilin eshtë një aluzion pēr faktin se drita e udħeżimit eshtë mishēruar dhe eshtë bérē pikērisht substanca e Kurānit, ashtu siç mishērohet ngjyra e kuqe dhe bēhet karmine.<sup>6</sup>

**E treta:** Pērdorimi i trajtēs sē pashquar pēr **هَادِي** “*Udħeżim*”, e cila aludon pēr fundin e hollësisë sē udħeżimit tē Kurānit, esenca e sē cilës eshtë e pamatshme, dhe pēr gjērēsinē e saj tē skajshme, e cila nuk mund tē pērfshihet a ngērthehet nga njohja. Sepse trajta e pashquar nēnkupton ose hollësi dhe fshehje ose gjērēsi qē nuk rrethohet e ngērthehet.

Pēr shkak tē kēsaj, ajo ndonjéherē pērdoret pēr tē pērçmuar dhe disa herē pēr tē lartēsuar.

**E katērta:** Thukëtia e **مُتَّقِينَ** “*pēr el-muttekine (besimtarət e drejtē, tē pērkushtuarit)*” e cila pērdoret nē vend tē një fraze mē tē gjatē si, “*Njerēzit janē bérē tē devotshém nēpērmjet Kurānit*” tregon rezultatin lidhur me atē qē e parapriu, (*el-mexhaz el-ev-vel*), dhe tregon frutat e udħeżimit dhe efektet e tij. Kjo nēnkupton argumentin nga pasoja tek shkaku (*el burhan el-inni*) pēr ekzistencēn e udħeżimit.

Kēshtu dēgjuesi nē njérin shekull ka dēshminē e shekujve paraardhës, ashtu siç ai do tē jetē dēshmi pēr ata qē do tē vijnē pas tij.

<sup>6</sup> Karmine ishte ngjyra e pērshtatur dhe simbolike e Armenëve. Ajo sigurohej nga trupat e shtrydhur e tē tharē tē insekteve, krimbave.

• *Nē qoftē se do tē pyesje:* Si mundet elokuenga qē eshtë pērtej fuqisë njerëzore tē lindet nga kēto pika tē pakēta tē numēruara?

*Ty do tē tē thuhej:* Një forcë e madhe qëndron nē ndihmën e ndërsjellë dhe nē bashkuar tek çdo gjë materiale dhe shpirtërore. Sepse nē sajē tē misterit tē reflektimit, kur mbidhet bukuria e tre gjérave, bēhet si pesë, pesa bēhet dhjetë, dhe dhjeta bēhet dzyet.

Sepse nē secilën eshtë një lloj reflektimi dhe ajo e pērfaqëson - bukurinë- deri nē një shkallë.

Ashtu siç shFAQEN tē janē shumë pasqyra kur dy pasqyra janē vēnē ballē pēr ballē; ose nē qoftē se ti i ndriçon ato tē dyja me një llampë shtohet drita e secilës nēpērmjet reflektimit tē rrezeve tē saj. E ngjashme me kētē eshtë edhe kombinimi -bashkimi- i një numri pikash. Gjithashtu pēr shkak tē kētij misteri ju do tē shihni se çdo posedues plotësie dhe posedues bukurie, shikon nga vetvetja një prirje tē natyrshme pēr t'u bashkuar me tē tjerēt qē janē tē ngjashëm me tē me qëllim qē tē shtohet bukuria e tyre. Madje edhe gurēt, pavarësish qēnies sē tyre vetēm gurē, priren drejt vēllezërvē tē tyre duke lēnē dorën e ndërtuesit pēr tek vendet e tyre nē një çati me kube, dhe i ulin kokat e tyre pēr tē prekur atē tē vēllezërvē tē tyre dhe duke u mbajtur sē bashku, ato nuk bien. Atéherē sa keq! Qenia njerëzore qē dështon pēr ta perceptuar kētē mister tē ndihmës sē ndërsjellë eshtë mē e pajetë se sa një gurē; sepse disa gurē janē tē tillë saqē pērkulen e shtrembërohen pēr tē bashkëpunuar me vēllezërit e tyre! Atéherē kēta njerëz, tek e pakta, le tē marrin mësim prej gurëve!

• *Nē qoftē se ti do tē pyesje:* Eshtë shenja e udħeżimit dhe e elokuencës tē shpjegosh, tē sqaresh dhe tē ruash mendjet nga konfuzioni -ngatérresa, atéherē pērse komentatorët e Kurānit kanë qenë nē mospajtim, nē mospērputhshmëri mbi vērsetet si ky dhe kanë sugjeruar mundësi tē ndryshme, dhe kanë shpjeguar aspektet kundërshtuese e mospajtuese tē frazave? Atéherē si mund tē njihet e vērteta midis tē gjitha kētyre?

*Ty do tē tē thuhej:* Tē gjitha janē tē drejta, sepse dēgjuesit ndryshojnë shumë. Sepse Kurāni nuk u shpall pēr njerēzit e vetēm një shekulli, por pēr njerēzit e tē gjithë shekujve; jo vetēm pēr një klasë, por pēr tē gjitha klasat e njerēzimit, dhe secila prej kētyre ka pjesën e vet nē tē kuptuarit e Kurānit.

Atéherë gjithësecili, çdo grup, çdo klasë dhe çdo kohë ka një ndryshim të madh lidhur me të kuptuarin, dhe shijet e tyre ndryshojnë shumë, dhe ato piren drejt anëve të ndryshme të Kur'anit, dhe vlerësojnë aspektet e ndryshme të tij, dhe kënaqësitë e tyre janë të ndryshme, dhe temperamentet e tyre janë të gjitha të ndryshme.

Sa shumë gjëra ngodhen që një komb i vlerëson ato si të bukura, gjëra të cilat një komb tjeter madje as nuk i vëren, dhe për të cilat njëri gjëzohet shumë, ndërsa një tjeter madje nuk njeh as ekzistencën e tyre. Ju mund të bëni analogji të mëtejshme në të njëjtën mënyrë.

Për shkak të këtij misteri dhe shembullit të urtësisë, në shumicën e vendeve Kurani nuk është i përcaktuar, i specifikuar, dhe i bën pohimet e tij në mënyrë të përgjithshme me qëllim që gjithësecili të mund t'i vlerësojë ato sipas shijes dhe vlerësimit të vet.

Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm i ka renditur fjalitë dhe vërsetet e tij dhe i ka vendosur ato në një mënyrë të tillë me qëllim që të zbulohen mundësi të shumta të ndryshme prej aspekteve të tij të ndryshëm, dhe -njerezit e ndryshëm me- konceptimet dhe kuptimet e tyre të ndryshme të mund të reflektojnë mbi to dhe secili të mund të marrë pjesën e tij.

Ju mund të bëni analogji të mëtejshme. Domethënë, të gjithë këto aspekte të ndryshëm janë të lejueshme me kusht që ato të mos kundërshtojnë shkencat e arabishtes, të jenë aprovuar nga shkenca e retorikës -elokuencës-, dhe të jenë të pranueshme për shkencën e parimeve dhe qëllimeve të sheriafit. Kështu, ajo shfaqet nga kjo pikë se, njëri prej aspekteve të mrekullisë së Kur'anit është renditja e fjalëve të tij dhe vendosja e tij në një stil që u përshtatet konceptimeve dhe kuptimeve të njerëzve të të gjithë shekujve dhe të të gjitha klasave.

\* \* \*

## VËRSETI 3

وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَمَارِزُ قَنَاهُمْ يَنْفِقُونَ  
الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالغَيْبِ

*"El-ledhine juëminune bi(e)s gajbi ve jukjmune el-salate ve mim-ma Rezaknahum junfikune."*

*Të cilët besojnë në Gajb (Të Padukshmen), kryejnë edhe faljen, dhe shpenzojnë nga gjithçka me të cilat Ne i kemi furnizuar".*

الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالغَيْبِ  
*"El-ledhine juëminune bi(e)s gajbi", "Të cilët besojnë në Gajb (Të Padukshmen)."*

**Shqyrtoje këtë:** Vendosja -pozicionimi- i këtij vërseti dhe i atij të mëparshmit lidhur me kuptimet e tyre esenciale është ky, që lavdërimi i Kur'anit në vërsetin e mëparshëm ka një lidhje me lavdërimin e besimtarëve në këtë vërset, dhe njëri rrjedh e derdhet në tjetrin.

Sepse lavdërimi i besimtarëve është një rezultat i të mëparshmes; është një provë nga pasoja tek shkaku (*el burhani el-inni*); një frut i udhëzimit të Kur'anit dhe një dëshmi për të; dhe -lavdërimi në këtë vërset- duke u nxitur shfaq se ky vërset ka një pjesë prej atij udhëzimi dhe është një shembull i tij.

الَّذِينَ مُتَقِينَ  
*"El-ledhine" "Të cilët" me "el-muttekine" "të perkushtuarit (në besim)" -dhe lidhjen midis tyre-, ajo -shpreh e nënkupton- zbraze ose pastrim (takhilijeh) me zburim (tahlijeh), që është shoqëruesi i përjetshëm i të mëparshmes. Domethënë, zburimi pas pastrimit. A nuk e sheh se takwaja është heqja dorë prej të këqijave dhe që Kurani e përmend atë*

me tre shkallët e saj, të cilat janë: Braktisja e shirkut -e të përshkruarit ortakë me Allahun-pastaj braktisja e mëkateve, dhe pastaj braktisja e të gjitha gjérave përvëç Allahut. Ndërsa zburimi eshtë të kryesh akte të mira ose në brendësi me zemrën, ose fizikisht, ose me pasuri. Tani, dielli i akteve të brendshme -të zemrës- eshtë *imani* ‘besimi’, dhe indeksi i akteve fizike eshtë ‘salati’ ose faljet rituale, të cilat janë ‘shtylla e fesë’, dhe boshti i akteve që lidhen me pasurinë eshtë taksa pastruese (*zekat*), i cili eshtë ‘Ura e Islamit’.

Shqyrtoje këtë: në qoftë se ti do ta vështroje (Frazën) **الذين يؤمنون بالغيب** “*El-ledhine juëminune bi(e)l gajbi*” “*Të cilët besojnë në Gajb (Të Padukshmen)*” në lidhje me pozicionimin e saj, ti do ta shihje se ajo duhet të jetë e thukët, e përbledhur, por në qoftë se do ta vështroje me sinonimin e saj **المؤمنون** “*El muëminune*”, “*Besimtarët*”, ajo do të të dukej ty fjalëshumë, e zgjatur. Sepse nyja shquese **إِلٰ** “*El*” eshtë shkëmbyer për **el ledhine** -“*të cilët*”, funksioni i të cilët si një përemër lidhor eshtë të cilësojë nëpërmjet fjalisë lidhore emrin që ai përcakton. (atëherë eshtë një fjali lidhore -dhe jo një përemër lidhor- që ka rëndësi meqë ajo cilëson kryefjalën. Atëherë struktura këtu tërheq vëmendjen) tek besimi duke e nxitur atë dhe duke e lartësuar dhe madhëruar atë. Kjo gjithashtu eshtë një shenjë se besimi e ndriçon atë që e shpreh (atë) si një -kullë fari-, fanar, me qëllim që cilësitë e tjera nën të, të veniten e të shuhën. Dhe forma follore **‘juëminune’** ‘besojnë’

eshtë preferuar në vend të **‘muëminune’**, ‘**besimtarët**’, me qëllim që të pikturojë e paraqesë këtë situatë të lavdërueshme për imagjinatën. Ajo gjithashtu eshtë një shenjë se besimi ripërtërihet nëpërmjet ekzistencës së tij të vazhdueshme dhe manifestohet nëpërmjet njëpasnjëshmërisë së dëshmive, qofshin të jashtme ose të brendshme. Po, sa më të qarta të janë dëshmitë, aq më i fortë e i qëndrueshëm eshtë besimi.

**بالنیب** Me **‘bi(e)l gajbi’**, “*në Gajb (Të Padukshmen)*” synohet se ata besojnë me zemër, domethënë me sinqueritet dhe pa hipokrizi a gjenjeshtër, madje edhe kur janë vetëm, kur janë të padukshëm.

Kështu, dije se besimi eshtë një dritë e prodhuar nga afirmimi e vërtetuar në detaje i të gjitha esencave të fesë të sjellura prej profetit Muhammed a.s.m., dhe të tjerat në mënyrë të përgjithshme.

• *Në qoftë se do të pyesje:* Vetëm një njeqind prej njerëzve të zakonshëm eshtë në gjendje t'i shprehë qartë të vërtetat e besimit?

*Ty do të tē thuhej:* Paaftësia për të shprehur diçka në mënyrë të qartë nuk tregon mosekzistencën e saj. Ashtu si gjuha që shumëherë eshtë e paaftë për të interpretuar hollësitë e përfytyrimeve të mendjes, po ashtu mendja të vështrojë sekretet e fshehura të ndërgjegjjes, atëherë si do të mundej ajo t'i interpretonte të gjitha ato? A nuk e sheh ti mendjemprehtësinë e Sekkakut, gjeniut dhe masterit të retorikës, që dështoi të mblidhët, të korrite pikat e holla të prodhuara spontanisht - vetveti, në mënyrë të natyrshme- nga një nomad si Imri al-Kajs<sup>1</sup> ose nga dikush tjetër i ngjashëm me të. Si rrjedhojë, njeriu mund ta vërtetojë nëse një njeri i zakonshëm beson ose jo duke e pyetur atë dhe duke i kërkuar shpjegim.

Ju mund ta pyesni atë pozitivisht dhe negativisht, duke i thënë:

O ti njeri i zakonshëm! A eshtë e mundur sipas mënyrës tënde të mendimit që Autori, në kapjen e fuqisë së të Cilit janë të gjitha aspektet e botës, të jetë prezent në vetëm një vend të saj apo jo?

Në qoftë se do të thonte jo, duke u përgjigjur negativisht, atëherë fakti se Allahu eshtë përtej kufizimeve të hapësirës eshtë i vërtetuar në mënyrë të pakundërshtueshme në ndërgjegjjen e tij, dhe ajo eshtë e mjaftueshme për të. Ju mund të mendoni për shembuj të mëtejshëm në të njëjtën mënyrë.

Dije gjithashtu se siç e shpjegoi Sa'di<sup>2</sup> në komentin e tij, besimi eshtë një dritë që Allahu xh.sh. e ngulit -shtie- në zemrat e atyre prej shërbëtorëve të Tij që Ai do -domethënë, pasi ata kanë përdorur fuqinë

<sup>1</sup> Imri al-kajs (497-545), më i famshmi i të gjithë poetëve arabë të periudhës së *Xhahilijah* -injorancës. Ai ishte autor i njërit prej shtatë poezive të varura, në Qabe.

<sup>2</sup> Sa'd el-Din el-Taftazani i lindur në Taftazan në Hurasan më 712 dhe vdiq në Semerkant në 793 sipas Hixhretit. Ai ishte një autoritet në shkencat e arabishtes, të logjikës dhe të fikhit. Ai luftoi për të rigjallëruar shkencat islame pas pushtimit mongol. Midis veprave të tij janë: *Tahzib el-Mantik*, *Sharh Mekasid* dhe *Sharh el-Aka'id el-Nasafija*.

e vullnetit tē tyre. Po, besimi ēshtë një dritē pér ndërgjegijjen njerëzore, një rreze prej Diellit tē parapërjetshëm, saqë papritmas lahet nē dritē – ndriçohet plotësisht- fytyra e brendshme e ndërgjegjjes.

Besimi i jep ndërgjegjjes një ndjenjë familjariteti me tē gjithë universin dhe vendos lidhje midis saj dhe tē gjitha gjërave.

Besimi i jep zemrës së njeriut një fuqi tē tillë morale saqë ai mund t'i rezistojë e t'i mposhtë tē gjitha ngjarjet dhe fatkeqësitet që i bien. Ai i jep atij një gjérësi me tē cilën mund tē gëlltisë e tē mbajë tē shkuarën dhe tē ardhmen. Po, ashtu siç ēshtë besimi një dhunti –rreze- prej Diellit tē parapërjetshëm, po ashtu ai ēshtë një shkreptimë e lumturisë së pérjetshme, domethënë e ringjalljes së tē vdekurve.

Me dritën e asaj shkreptime rriten farérat e tē gjitha shpresave, dhe bërthamat e tē gjitha potencialeve tē vendosura nē ndërgjegjje, dhe fillojnë tē rriten e tē shtrihen drejt pérjetësisë, dhe farérat e aftësive tē tij transformohen nē një pemë Tuba; dhe vahdon tē lëvizë drejt botës së pérjetshme.

**وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ** “ve jukjmúne el-salâte”, “dhe kryejnë edhe faljen.”

**Shqyrtoje këtë:** Vendosja -pozicionimi (i kësaj fraze dhe lidhja e saj me frazën e mëparshme) ēshtë më i qartë se dielli nē mes tē ditës. Sepse nē përcaktimin e ‘salatit’ faljes midis veprave tē tjera tē mira tē tjera fizike tregon se namazi ēshtë një indeks i tē gjitha akteve me meritë dhe një model i tyre, dhe se namazi i reflekton ato.

Ashtu si sureja *El-Fatiha* që ēshtë një indeks i Kuranit dhe njeriu ēshtë një indeks pér botën, po ashtu edhe namazi ēshtë një indeks i veprave tē mira sepse nē një sens namazi, ‘salat’ përfshin agjërimin, Haxhin, Zekatin dhe format e tjera tē adhurimit; dhe namazi përfshin adhurimin e tē gjitha krijesave, tē natyrshme dhe tē vullnetshme, prej melekëve që bëjnë ruku, bien nē sexhde dhe qëndrojnë më këmbë dhe prej gurëve që bien nē sexhde, dhe prej pemëve që qëndrojnë nē këmbë, dhe prej kafshëve që bien nē ruku.

Forma foljore **يُقِيمُونَ** “jukjmúne”, “kryejnë” ēshtë përdorur nē vend tē (pjesores aktive) **“El-mukimune”**, “bërésit (e faljes)” me qëllim që tē

shtyhet e tē dalë para syrit tē mendjes së dëgjuesit ky akt i shtrirë jetik, kjo vëmendje e shpirtit, nē botën e islamit, dhe ta zgjojë e gjallërojë imaginatën e tij pér tek kjo situatë e admirueshme dhe e rregullt nē tē gjitha rrëthet e humanizmit, dhe pér tē ngjallë tek ai dëshirën pér tē vepruar ashtu. Sepse nē qoftë se dikush vëzhgon efektin e një borie që i thërrët ushtarët e shpërndarë dhe tē humbur midis njerëzve, duke i ftuar tē grumbullohen dhe tē marrin pozicionet e kënaqshme e tē rregullta, ai vetë do tē ndiente prirjen pér t'i bashkuar atyre. Pikërisht, nē tē njëjtën mënyrë ēshtë thirrja pér falje –ezani- i Muhammedit a.s.m., me zërin e tij tē ëmbël, midis njerëzve nē shkretëtirën e botës. *Dhe Allahut i takon krahasimi më i lartë.*

Përdorimi këtu, vendi pér thukëtinë e stilit, i proliksit -i zgjatur nē fjalë- ēshtë يَقِيمُونَ الصَّلَاةَ ‘jukjmúne el-salâte’, “kryejnë edhe faljen” nē vend tē يَصْلَوُنَ ‘jusal-fin’, “falën”, tregon rëndësinë e përputhshmërisë me kuptimin e ‘kryerjes’ ‘el-ikama’ ‘salat’ namaz tē tillë si kryerja e faljeve me korrektësi, me rregull, me seriozitet, dhe duke e ruajtur vetveten (prej zbavitjeve etj), dhe duke rritur kërkësën pér to nē tregun e botës. Shqyrtoje këtë, dhe kupto gjithashtu se salati -namazi- ēshtë një hallkë e lartësuar, ēshtë një lidhje e lartë midis robit dhe Sulltanit tē parapërjetshëm, dhe ēshtë një akt i nderuar shërbimi. Ēshtë-veçoria e kësaj lidhjeje që ta têrheqë e robërojë shpirtin, që ta dashurojë atë çdo shpir. Shtyllat e namazit përmblajnë mistere tē shumtë tē cilët janë shpjeguar nē vepra tē tilla si “*El-Futuhat El-Mekkijeh*”<sup>3</sup>. Njëri nga ato mistere ēshtë se ndërgjegjja i do ato.

Ato janë një thirrje e Krijuesit tē parapërjetshëm pér tek prezencia e Tij pesë herë nē ditë e natë pér tē biseduar me Të, si një lloj *miraxhi*.

Kjo ēshtë e tillë që zemra e gjithësecilit tē përmallohet pér tē. *Salat*-namazi- pérjetëson nē zemër idenë e madhështisë së Autorit dhe e bën mendjen tē vetëdijshtme pér tē me qëllim që tē nxisë e ngulisë bindjen ndaj ligjeve Hyjnore tē drejtësisë dhe përbajtje ndaj rregullit Hyjnor tē gjërave. Njeriu ka nevojë pér këtë pér shkak se ai nga natyra ēshtë i civilizuar. Kështu, sa keq pér ata që e braktisin namazin -salatin! Çfarë humbje ēshtë pér dembelin -që nuk e kryen nga përtacia! Dhe çfarë

<sup>3</sup> Nga Muhjiddin el-Arabi (1165-1240)

njorance e atyre që nuk e njohin vlerën e tyre! Dhe ata që nuk i vlerësojnë ato tē denja, le tē shkojnë tjeterkund, objekte tē neverisë së përgjithshme. Në fund ata e kuptojnë por është vonë.

**وَمَارِزْ قَنَاهُمْ يَنْفَقُونَ**  
*“Ve mim-ma Rezaknâhum junfikune”, “dhe shpenzojnë nga gjithçka me tē cilat Ne i këmi furnizuar”.*

#### Vendosja -pozicionimi (dhe lidhja me frazën e mëparshme):

**عَمَادُ الدِّينِ** Ashtu siç është namazi ‘shtylla e fesë’ dhe mban fenë, po ashtu zeqati është “ura e islamit” dhe mjeti nëpërmjet tē cilët njerëzit e tij tē ndihmojnë njëri-tjetrin dhe tē ruajnë rendin dhe qetësinë. Domethënë këto dy parime Hyjnore janë: një për tē mbrojtur fenë dhe tjeri për tē ruajtur rendin. Prandaj këto janë tē lidhura me njëra-tjetrën.

Ndodhen disa kushte që e bëjnë *sadekanë* -lëmoshën- të pranueshme dhe jo tē vendosur gabim.

1 • Njeriu nuk duhet tē jetë prishnik (duke e tepruar), gjë e cila është e qortueshme.

2 • Njeriu nuk duhet tē marrë prej popullit dhe t'ia japë një tjetri, por duhet tē japë nga pasuria e vet.

3 • Të mos e prishë lëmoshën duke thyer dinjitetin.

4 • Nuk duhet lërë lëmoshën prej frikës së varfërisë...

5 • lëmosha nuk duhet tē kufizohet vetëm tek pasuria dhe paraja; por edhe njohje, fuqia, idetë dhe veprimet mund tē jepen gjithashtu për nevojtarët.

Marrësi i lëmoshës nuk duhet ta shpenzojë atë për gjëra tē kota, por për gjërat e domosdoshme dhe për nevojat bazë.

**وَمَارِزْ قَنَاهُمْ يَنْفَقُونَ**  
*“ve mim-ma Rezaknâhum junfikune” “dhe shpenzojnë nga gjithçka me tē cilat Ne i këmi furnizuar” mbi*

**يَتَصَدَّقُونَ يَزْكُونَ**  
*‘jetesad-dekune’, ‘ata japid lëmoshë’ose mbi ‘jezz-ek-kune’, ‘ata japid zekat’ me qëllim që t'i bëjë tē kuptueshme për njerëzit dhe që tē nënkuftohen këto kushte dhe këto pika tē holla që u përmendën:*

1- Me **مِنْ** ‘min’, “ngā ajo që, prej asaj që”, ai tregon se harxhimi i tepruar (në dhënen e lëmoshës) duhet tē shmanget;

2- Duke vendosur ‘**mim-ma**’ në fillim, nënkupton se duhet tē jetet nga pasuria e dhënesit.

3- Dhe me **رَزْقًا** ‘**Rezakna**’, “*Ne i këmi furnizuar*”, ai e ndalon atë nga tē qenurit një favor, domethënë, është Allahu Ai i Cili është dhënesi dhe ti je thjesht një mjet –rob- ndërmjetësues”.

4- Dhe me **نَّا** ‘**Na**’, “*Ne*” ai aludon për kuptimin e hadithit:

“*Kurrë mos iu frikëso pakicës -varfërisë- prej Zotit tē Fronit Hyjnor*”. Domethënë ‘**Na**’ nënkupton: Mos u frikëso nga varfëria.

5- Dhe për shkak se *Rizku* (Emri, ushqimi, rizku, vjen nga rrënja follore) këtu është absolute dhe jo e specifikuar, ajo nënkupton se lëmosha *-sadekaja-* përfshin dhënen e njohurisë, idetë, dhe gjërat e tjera.

6- Dhe me **نَفَقَ** ‘**junfikune**’, “*shpenzojnë*” ai nënkupton kushtin që marrësi duhet ta harxhojë *sadekanë* për mjetet e tij tē jetësës dhe për nevojat esenciale dhe jo për shthurrje.

**الرَّحْمَةُ قَنْطَرَةُ الْإِسْلَامِ**  
*“zeqati është ura e islamit”, domethënë zeqati është një urë dhe është një urë për tē ruajtur rendin; muslimani e ndihmon vëllain e tij musliman për tē kaluar sipër saj. Ku njerëzit mund ta ndihmojnë njëri-tjetrin; ai është mjet për bashkëpunim tē urdhëruar (nga feja), madje, zeqati është një rrugë në sistemin e shoqërisë njerëzore, dhe është një lidhje ose një arterie nëpërmjet tē cilës substanca e jetës tē mund tē vërshojë*

nëpërmjet anëtarëve të saj; ai është një antidot për pikërisht helmet reale që pengojnë progresin njerëzor. Po, ndodhet një urtësi e madhe në obligimin e zeqatit dhe në ‘ndalimin e kamatës dhe të interesave’, një dobi e lartë dhe një mëshirë e gjërë.

Sepse në qoftë se ti do të hidhje një shikim historik tek faqja e botës dhe të studioje të këqijat e shoqërisë njerëzore, ti do të shikoje se arsyet bazë për të gjitha revolucionet dhe korruptionin dhe burimi i imoralitetit janë vetëm dy thëniet:

**E para:** Në qoftë se unë jam i ngopur, atëherë çfarë do të më shqetësonë nëse të tjerët vdesin urie?

**E dyta:** Ti puno që të ha unë, dhe ti lodhu që unë të pushoj.”

Sa për thënien e parë mizore, grabitqare e të ligë, ajo e ka tronditur botën e humanizmit dhe e ka sjellë atë në buzë të rrënimit. Është vetëm zeqati ai që e pret atë tek rrënja.

Ndërsa thënia e dytë tiranike, makute dhe e prishur ka vënë në terezik përparimin njerëzor, duke e treguar të përmbyset e të bie në zjarrin e anarkisë.

Dhe e vetmja mënyrë për ta shkulur nga rrënjet atë, ilaçi i vetëm për të është ndalimi i kamatës dhe i interesave. Kështu reflekto mbi këtë!

**Shqyrtoje këtë:** Rregulli i shoqërisë varet mbi mospasjen zbrazëti ndërmjet klasave të njerëzve. Klasat e larta -elita- nuk duhet të largohet nga klasat e ulëta, as të pasurit nga të varfërit deri në shkallën ku këputet fija e lidhjes midis tyre. Por për shkak se dhënia e detyruar e zeqatit dhe e ndalimit të kamatës janë neglizhuar, një hendek -zbrazëtirë- është hapur midis klasave, dhe klasat e larta janë larguar aq shumë prej klasave të ulëta, saqë nuk ka mbetur asnje lidhje midis tyre. Për shkak të kësaj që në vend të respektit, bindjes dhe dashurisë duke u ngjitur prej klasave të ulëta për tek klasat e larta, britmat e revolucionarëve shkaktohen, dhe klithmat e smirës dhe ulërimat e urrejtjes dhe të hakmarrjes.

Gjithashtu, në vend të mirësisë, bujarisë dhe favoreve duke zbritur prej klasave të larta për tek ato të ulëta, zjarri i tiranisë dhe i shtypjes, dhe breshëritë e fyerjeve bien mbi to.

Ah medet! Ndërsa cilësitetë e elitës duhet të jenë shkaku i modestisë dhe i mëshirës, fatkeqësish ato u japid shkas krenarisë dhe arrogancës. Dhe ndërsa pafuqia dhe varfëria e të varfërvë bëjnë të domosdoshme mirësinë, mëshirën dhe mirëdashjen, ato kanë çuar në skllavëri e në poshtërim. Në qoftë se dëshiron një dëshmitar për këtë që them, hidhe vështrimin tek bota e civilizuar; atje do të gjesh aq shumë dëshmitarë aq sa mund të duash. Mjeti i vetëm për pajtim ndërmjet klasave, që do t'i sjellë ato së bashku, është dhënia e zeqatit dhe vogëlushët e tij, si sadekaja dhe kontributi që duhet të dihen si njëra prej shtyllave të islamit, dhe një sistem shumë i lartësuar dhe i shtrirë në administrimin e shoqërisë.

\* \* \*

## VËRSETI 4

وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنْزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنْزِلَ مِنْ قَبْلِكَ  
وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ

*Ve el-ledhine juëmimune bimà unzile ilejke ve mà unzile min kablike ve bil(e)  
A'hireti hum jukjnúne.*

*“Dhe tē cilët besojnë nē atē qē tē eshtë zbritur ty (Muhammed a.s.m.) dhe nē  
çfarë janë zbritur para teje, si edhe qē besojnë me bindje nē Botën e Përtjejme”.*

**Shqyrtoje këtë:** Kurani nuk e ka ndaluar apo kufizuar renditjen e tij të fjalëve. Domethënë, nē shumicën e vërseteve të ngashëm me këtë, ai nuk ka specifikuar asnjë aspekt të frazave dhe të fjalive nëpërmjet vendosjes së ndonjë shenje nē to. Kjo eshtë pér një arsy te hollë, dhe kjo arsy eshtë burimi i thukëtisë së tij (ose tē elipsit -el-ixhaz-), e cila me radhë eshtë burimi i mrekullisë së tij. Arsyja eshtë kjo:

Elokuanca përbëhet nga tē folurit nē përputhje me kërkuesat e çdo situate. Ata tē cilëve u adresohet Kurani u përkasin klasave të ndryshme nē shekuj të ndryshëm. Kështu, duke i marrë nē konsideratë të gjitha këto klasa dhe shekuj, me qëllim qē tē gjithë llojet e njerëzve të mund tē marrin pjesën e tyre, Kurani bën kapërcime -lë jashtë, heq-me qëllim qē ta bëjë tē përgjithshme atë qē ai thotë dhe ta përpjesëtjë, dhe flet me terma absolute me qëllim qē ta bëjë atë gjithëpërfshirëse dhe ta ndajë. Pér më tepër ai e lë tē lirë renditjen e fjalëve nē shumë vende me qëllim qē tē shumojë aspektet e saj dhe qē tē shtoje mundësitë e pëlqyeshme pér elokuencën dhe -të shtoje-pranueshmërinë pér shkencat e arabishtes. Kështu tē gjitha mendjet marrin vështrimin -shkëlqimin- e Kurani deri nē atë shkallë qē ata tē mund t'i vlerësojnë ato.

### Shqyrtoje këtë me vëmendje:

Tani vendi -pozicionimi- i këtij vërseti nē lidhje me vërsetin e mëparshëm:

Këtu ai eshtë i specifikuar pasi ishte i përgjithësuar, me qëllim qē tē shpallë mbi kokat e dëshmitarëve nderin e atyre njerëzve të librit - pasuesve të shkrimeve të shenja- tē cilët besojnë, dhe qē t'i heshtë ata prej atyre tē cilët ngurrojnë dhe e mbulojnë -fshehin tē vërtetën-, dhe pér t'i marrë ata Abdullah Ibn Selam<sup>1</sup> pér dore me qëllim qē t'i nxisin tē tjerët pér ta ndjekur shembullin e tij. Pér më tepër, ai pohon nē mënyrë tē qartë, pa dykuptimshmëri, se ndodhen dy lloje tē

devotshmish متقدّم (al-muttakin) me takwa (ata qē u përmendën nē këtë ajet dhe nē atë qē erdhë më parë).

Kështu, duke dekluaruar hapur se udhëzimi i Kurani i përqafon e i përfshin tē gjithë profetët, dhe duke nënkopruar se Muhammedi a.s.m u dërgua si Pejgamber pér tē gjithë kombet pa përjashtim. Gjithashtu duke shpjeguar shtyllat e besimit qē përfshihen nē guaskën يُؤْمِنُ بِالْغَيْبِ “juëminune bi(e)l gajbi” “Tē cilët besojnë nē Gajb (Tē Padukshmen)” ai jep detaje pas pohimeve tē tij tē ngjeshura tē mëparshme, sepse ai bën përmendje tē qartë pér librat e shpallur dhe pér ringjalljen e tē vdekurve dhe bën një përmendje tē nënkopruar pér profetët dhe engjëjt. Kurani nuk ka zgjedhur pér thukëtinë duke thënë diçka si وَالْمُؤْمِنُونَ بِالْقُرْآنِ “Tē cilët besojnë nē Kur'an” por me qëllim qē ta zbukurojë e ngulisë këtë kuptim me hollësitë dhe qē tē zbukurojë وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنْزِلَ إِلَيْكَ shtojcat e tij me pikë tē holla, ai preferoi “Ve el-ledhine juëmimune bimà unzile ilejke”, “Dhe tē cilët besojnë nē atē qē tē eshtë zbritur ty”. Sepse nē “El-ledhine” “tē cilët” eshtë një shenjë qē atributi i besimit eshtë ai qē synohet, dhe se atributet e tjera tē personit janë tē varura nga ai dhe tē mbuluara poshtë tij. Në përdorimin e kohës

<sup>1</sup> Ebu Jusuf Abdullah Ibn Salam el-Harithi (vdiq 43/663). Ai ishte një hebre i ditur i cili pranoi islamin dhe u bë njëri prej sahabëve tē profetit a.s.m....

sé pakryer pér: يُؤْمِنُونَ “ju'minunē”, “(tē cilēt) besojnē” nē vend tē مُؤْمِنُونَ

*El mu'emine, “besimtarēt” (pjesores aktive) e cila nēnkupton - diċċa- tē fiksuar e tē pandryshuar, ̄eshtē njē tregues se besimi ripertērihet nē mēnyrē tē vazhdueshme nē ardhjen e pērsēritur tē*

shpalljes. Pastaj me paqartēsinē e مَا “Ma”, “nē atē qē”, ajo tregon se besimi nē mēnyrē tē pērbledhur ̄eshtē i mjaftuershēm, dhe se besimi pērfshin shpalljen ekzoterike (tē jashtmen e kuptuershme pér tē gjithē (si Kurani) dhe shpalljen ezoterike (tē fsheħtē) e cila ̄eshtē hadithi. Nē

lidhje me اَنْزَلَ “Unzile” (nē atē qē tē) “̄eshtē zbritur, shpallur” pér sa ka tē bējē me lēndēn e saj (madda), ajo tregon se besimi nē Kurān ̄eshtē besimi nē shpalljen e tij nga Allahu. Gjithashtu besimi nē Allahun ̄eshtē besimi nē ekzistencēn e tij, dhe besimi nē Ahiretin ̄eshtē besimi nē ardhjen e tij (e Ahiretit). Pērdorimi i kohēs sé kryer, megjithēse shpallja nuk ishte plotēsuar akoma, ̄eshtē njē tregues se plotēsimi i saj

ishte aq i sigurt si ai qē qe shpallur. Pér mē tepér, يُؤْمِنُونَ “ju'emine”, “Ata besojnē” duke qenē nē kohēn e pakryer nēnkupton tē ardhmen, kēshtu duke kompensuar e plotēsuar mangēsinē e nēnkuptuar nga pērdorimi i kohēs sé kryer! Pér shkak se Kurāni u shpall nē kētē mēnyrē [domethēnē, shkallē-shkallē], ju shihni nē stilet e tij se e kryera shumē shpesh e gēllit tē ardhmen dhe koha e pakryer<sup>2</sup> veshjen e sé kryerēs. Elokuanca e kēsaj ̄eshtē shumē e hollē. Sepse ai person qē dēgjon diċċa qē i referohet tē shkuarēs, ndonēse ajo gjē nuk ka ndodhur akoma, tronditet mendja e tij dhe ai ̄eshtē i zgħuar pér faktin se ai nuk ̄eshtē i vetēm por kujton se prapa tij ndodhen tē tjerēt radħe-radħe nē distanca tē ndryshme sikur shekujt janē shkallēt dhe brezat, dhe njerēzit e tyre janē tē ulur nēpēr shkallē [prapa tij]. Kjo e bēn atē tē vetēdijshēm

<sup>2</sup> Domethēnē, e kryera اَنْزَلَ “Unzile” u shpall, u zbrit . “Domethēnē”, shpallja e sē cilēs nuk qe plotēsuar, n.q.s.nuk do tē ishte pērfshirē brenda gjithēpērfshirjes sé اَنْزَلَ “Unzile”, “u shpall” ̄eshtē brenda gjithēpērfshirjes sé يُؤْمِنُونَ “ju'minune” “besojnē”

se adresimi dhe thirja tē drejtuara ndaj tij dēgjohen nga tē gjithē gjeneratat sipas vellimit tē tij. Por, ai ̄eshtē njē adresim Hyjnor prej tē cilit tē gjithē irradhēt e njerēzve nē tē gjithē shekujt marrin pjesēn e tyre. Kēshtu e kryera ̄eshtē reale e mirēfilltē pér shumicēn e njerēzye nē shumicēn e kohēs, ndērsa pér njē pakicē nē kohēn mē tē pakēt<sup>3</sup> ajo ̄eshtē metaforike. Kēshtu tē marrēsh nē konsideratē shumicēn u shérben

مَ إِلَيْكَ ̄ilejke’ “pér tek ti (qē tē ̄eshtē zbritur ty)” nē vend tē عَلَيْكَ ‘alejke’ “mbi ty” ̄eshtē njē shenjē se profetēsia Hyjnore ishte njē detyrē nē tē cilēn u ngarkua profeti, qē ai e ndērmori me vullnet tē lirē. Gjithashtu (nga njéra anē) ajo tregon lartēsinē e tij meqē Xhebraili, i shérbeu duke paraqitur (Kuranin) atij, sepse ‘ala’ “mbi” aludon pér shtrēngim, detyrim dhe se mjeti i zbritjes -shpalljes- ishte mē i lartē. Ndērsa (nga ana tjetr)

الْبَلَكَ ̄ilejke’ “pér tek ti” nē vend tē (vetēs sē tretē) “pér Muhammedin”, nēnkupton se Muhammedi a.s.m ishte vetēm njē i adresuar dhe se ligjērata ishte Fjala e Allahut. Pér mē tepér, nē kuptim, adresimi direkt i rasēs thirorre konfirmon dhe ilustron kuptimin e asaj qē ̄eshtē zbritur ose shpallur (*el-nuzul*), dhe kjo ̄eshtē shpallja e “El-vahji” dhe shpallja ̄eshtē Kurāni qē ̄eshtē njē adresim Hyjnor (pér profetin), veċoria e sē cilēs ̄eshtē tē depērtojē tek tē gjitha kētō (pika). Dhe kjo zbulon pjesēn e tij –kjo pjesē heq perden prej pjesēs sē tij -prej asaj veċorie. Kēshtu bēhet e qartē nēpērmjet gjithēpērfshirjes sé saj tē gjitha kētō pika tē holla, se kjo pjesē ̄eshtē prej thukētisē mē tē skajshme.

وَمَا أَنْزَلَ مِنْ قَبْلِكَ “Ve mà unzile min kablike”, “Dhe nē ̄farē janē zbritur para teje”.

Shqyrtoje kētē: Qēllimi i kētyre pērshkrimeve si kētō ̄eshtē tē ngallē dēshirē e entuziazēm, dhe nēnkupton disa dekrete (tē reja): besojeni kētē e kētē dhe mos bēni dallim (midis profetēve).

<sup>3</sup> E kryera ̄eshtē njē e vertetē e qēndrueshme tek shumē njerēz nē shumicēn e kohēvē ,ndērsa ̄eshtē metaforike tek pakica nē tē paktēn e kohēvē .

**Vendi –pozicionimi i frazës dhe lidhjet e saj (me atë që e paraprin) pérmban katër pika të holla:**

**Se pari:** Argumenti nga ajo që paraqitet -nxirret- pér dëshminë. Kjo është sa vijon: “O njerëz! Në qoftë se ju besoni në Kur'an, besoni gjithashtu edhe në librat e mëparshëm, sepse Kurani konfirmon vërtetësinë e tyre dhe dëshmon pér to.” Kjo tregohet nga vërseti “*Një konfirmim pér atë qfarë ka ardhur më parë*”.<sup>4</sup>

**Së dyti:** Argumenti prej dëshmisë pér atë që paraqitet, si kjo :O njerëzit e librit! Në qoftë se ju besoni në profetët e mëparshëm dhe në librat e mëparshëm, ju duhet gjithashtu të besoni në Kur'anin dhe në Muhammedin a.s.m., sepse shkrimet e shenjta dhanë sihariqe pér ardhjen e tij. Pér më tepër, konfirmimi i tyre, shpallja e tyre dhe dëshmitë e profetësive të pejgamberëve gjenden në realitet dhe në shpirt më të plota në Kur'an dhe në mënyrë më të qartë në Muhammedin a.s.m.. Kështu sipas këtij arsyetimi të përkryer, Kurani është Fjala e Allahut dhe Muhammedi a.s.m. është i dërguar i tij.

**Së treti:** Në këtë është një shenjë se përfundimi (*al-ma'ad*) i Kur'anit që është islami i cili shfaqet prej tij në Epokën e lumturisë, është si një pemë, origjina e së cilës është ngulur e mbërthyer në thellësirat e së shkuarës. Rrënjet e saj ushqehen prej burimeve të ujit të asaj kohe duke fituar jetë e fuqi. Dhe me trungun e saj në qiejt e së ardhmes, degët e saj të shpërndara janë të mbushura plot me fruta. Domethënë islami përqafon e përfshin të shkuarën e të ardhmen.

**Së katerti:** Në këtë është një shenjë se ai është duke i nxitur njerëzit e librit -krishterët dhe hebrejtë- të besojnë -në islam-, sepse ai e bën atë të shfaqet familjar i njohur -pér to, dhe i lehtë. Është sikur -Kurani- të thonte: O njerëzit e librit! Ju nuk duhet të përjettoni asnjë vështirësi në hyrjen në këtë rrugë -të re-, sepse ju nuk po dilni krejtësisht prej guaskave tuaja, por ju vetëm po plotësoni besimet tuaja dhe po ndërtoni mbi themele që ju tashmë i keni sepse Kurani nuk sjell ndonjë themel apo parim të ri ,ai modifikon dhe plotëson ato që janë ekzistuese; dhe ai kombinon në vetvete virtytet e të gjithë librave të mëparshëm dhe esencat e të gjitha ligjeve të mëparshme. Ai vetëm vendos rregulla të reja në çështjet dytësore, të cilat i nënshtrohen

<sup>4</sup> Kuran,2:97

ndryshimit pér shkak të diferencës së kohës e të vendit. Sepse ashtu siç ndryshohen ilaçet dhe rrobat në katër stinët, dhe mënyra e edukimit dhe e arsimimit në fazat e jetës së njeriut; po ashtu e kërkon urtësia dhe dobia ndryshimin e dekreteve, rregullave dytësore në shkallat e fazat e jetës së llojit njerëzor.

Sepse sa shumë prej këtyre janë të dobishme në një kohë tjetër, dhe sa ilaçë në kohën e fëmijërisë së njerëzimit ishin të efektshëm, por nuk kanë asnjë dobi në fund dhe pushuan së qenuri ilaçë në rininë e llojit njerëzor. Kjo është arsyja pse Kurani i shfuqizon disa nga gjërat dytësore. Domethënë, ai dekretoi se koha e tyre ka mbaruar, dhe se ka

من قبلك

ardhur rradha pér dekrete të tjera. Fjalët “*min kablik*”, “*para teje*” -gjithashtu tregojnë- një numër prej disa pikave të holla:

**Shqyrtojeni këtë:** Nuk ka ndonjë fjalë prej shpalljes që ta refuzojë vendi i saj apo që të mos jetë i kënaqur me të, apo të mendojë se një vend tjetër do të kishte qenë më i mirë. Jo nuk ka ndonjë fjalë shpalljeje veçse është si një perlë e zbukuruar, e mbajtur fort në vendin e saj nga hallkat e lidhjes midis saj dhe vëllezërve të saj. Në qoftë se

من قبلك

dëshiron, studioje “*min kablik*”, “*para teje*”, ti do të shohësh se hollësitë fluturojnë nga -çdo anë e vërsitet dhe zbresin- ulen mbi këtë

من قبلك

frazë të veçantë. Vërseti, prej të cilit “*min kablik*”, “*para teje*” është një pjesë, trajton çështjen e profetësisë dhe pesë qëllimet që ajo i përbën. Fraza i ka përhithur -marrë- këto qëllime dhe është ngjyrosur prej tyre. Duke shprehur pesë pika të holla, ajo i kullon -i pikon- pesë qëllimet, të cilët reflektohen prej këtyre lidhjeve.

Qëllimet e përfshira -në profetësi- janë këto:

Muhammedi a.s.m. është një profet; ai është më i plotësuari i profetëve; ai është vula e profetëve; ai u dërgua pér të gjithë popujt; sheriati i tij i shfuqizon të gjitha shariatet e mëparshme dhe i përbën virtytet e tyre.

من قبلك

Mënyra se si reflektohet qëllimi i parë në frazë. (fjalët “*min kablik*”, “*para teje*” përdoren, thuhen vetëm kur rrugët bashkohen

dhe rruga ēshtë një, sikur kjo frazë sugjeron se, nēpērmjet kahasimit, tē gjitha provat e profetēve tē mēparshēm dhe tē vērtetēsisë sē librave - shkrimete- tē tyre formojnë një provē vendimtare tē profetēsisë sē Muhammedit a.s.m dhe tē shpalljes -zbritjes- sē librit tē tij. Sepse tē gjitha shkaqet dhe arsyet duke konfirmuar profetēsitē e tyre, e provojnē profetēsinē e tij nē mēnyrë mē tē qartē e mē tē fuqishme. ēshtë sikur tē gjitha mrekullitē e tyre tē formonin një mrekulli tē vetme duke provuar vērtetēsinē e tij a.s.m..

Mēnyra nē tē cilēn reflektobet qēllimi i dytē, plotēsimi i profetēsisē

sē Muhammedit a.s.m., nē frazēn **من قبلكَ** “*min kablikē*”, “*para teje*”: Nē shikimin e fakteve qē ēshtë zakoni pēr mbretin tē shfaqet para njerēzve nē fund tē ceremonisë, dhe nē pērputhje me ligjin e pērparimit njerēzor një mēsues mē i vonshēm ēshtë mē i mirē se një mēsues mē i hershēm, dhe nē pērgjithësi ata tē cilēt erdhēn mē vonē janē mē tē astē, mē mjeshterorë e ekspertë se sa ata qē i paraprinë, qē erdhēn para tyre, Muhammedi a.s.m. ishte sulltani i profetēve, dhe mē i miri dhe mē i plotēsuari i tyre, ashtu si Kurani qē ēshtë mē gjithēpērfshirës dhe mē universal se sa librat e tyre.

**من قبلكَ** مēnyra se si fraza “*min kablikē*”, “*para teje*” pērthith, merr qēllimin e tretē i cili ēshtë qēnia e Muhammedit a.s.m. Vula e profetēve; nē pērputhje me rregullin, “*Nē qof tē se njëshi shumëzohet - shumohet- ai shkon nē pafundësi, duke mos ndaluar kurrkund; por nē qof tē se shumësia e gjérave do tē bashkoheshin, ato fitojnë stabilitet, dhe ndalen -qëndrojnë*”, dhe siç nēnkuptohet nga ideja e kundërt,

**من قبلكَ** “*min kablikē*”, “*para teje*” aludon se “nuk do tē ketē profet tjetër pas teje”, dhe se Muhammedi a.s.m. ēshtë vula e profetēve.

**من قبلكَ** مēnyra se si fraza “*min kablikē*”, “*para teje*” ngjyrosen nga qēllimi i katërt, universaliteti -pērbotshmëria- e misionit tē tij: ajo shpreh këtë kuptim: “Ti je pasardhësi -trashëgimtari- i tyre, dhe ata tē gjithë janē paraardhësit e tu.”

Kështu sipas rregullit, “pasardhësi merr pērsipër detyrën e paraardhësit tē tij dhe merr vendin e tij”, tē gjithë ata ishin paraardhësit

e tu dhe ti je zēvendësi -pērfaqësuesi- i tyre dhe profeti i tē gjithë popujve. Po, nē tē vērtetë, kjo do tē ishte vetēm kështu! Sepse natyra e bashkëlindur e gjérave e kérkon këtë si dhe urtësia e kérkon atë. Para epokës sē lumturisë tē gjithë popujt e botës sē humanizmit ishin shumë larg njëri-tjetrit dhe shumë armiqësorë ndaj njëri-tjetrit, fizikisht dhe me emocione, dhe instinktivisht dhe me edukim.

Një lloj i vetēm edukimi ishte i pamjaftueshëm pēr ta dhe nuk i pērfshinte thirrja -ftesa- e vetme. Më vonë, kur u zgjua bota e humanizmit nē Epokën e lumturisë, dhe njerëzit ndien një dëshirë pēr t'u bashkuar pēr shkak tē shkëmbimit tē ideve, këmbimit tē karakteristikave -tipareve- dhe pērzierjes sē popujve, dhe disa prej tyre duke hetuar e shqyrtaar gjendjet e rrethanat e tē tjerëve, dhe koha u tund, u trazua, nga shumë mjete komunikimi dhe transporti; atëherë globi tokësor u bë si një vend i vetēm, ose si një provincë, ose si një qytet, dhe njerëzit e botës u bashkuan; dhe atëherë një mision i vetēm, një profetësi e vetme ishte e mjaftueshme pēr tē gjithë ata.

**من قبلكَ** مēnyra se si fraza e shpreh qēllimin e pestë: Meqenëse **من** “*min*” e **من قبلكَ** “*min kablikē*”, “*para teje*” nēnkupton një fillim, ajo nēnkupton “*ila*”, “*deri tek, pēr tek*” e cila tregon mbarim, fundin.

Domethënë, “profetësia erdhi nē fund me ardhjen tēnde, sepse sheriati yt ēshtë i mjaftueshëm”. Kjo nēnkupton se sheriati i tij i ka shfuqizuar tē gjithë sheriati e mēparshëm, duke sinjalizuar e njoftuar fundin e tyre, dhe nēpērmjet mjaftueshmërisë sē tij, i pērfshiu tē gjithë ato.

Dëshmia se nga këndvështrimi i elokuencës kjo frazë ka pērthithur -rrëmbyer- këto pika tē holla ēshtë se pesë qēllimet i ngjasojnë një lumi duke rrjedhur poshtë këtyre vērseteve; njëri prej tyre derdhet krejtësisht nē një vērset, pastaj një tjetër vērshon nē një tjetër, dhe një tjetër manifestohet tērësisht nē një rrëke nē një tjetër.

Madje edhe currili mē i vogël nē sipërsfaqe tregon se venat -damarët- e kësaj fraze e prekin atë. Pēr mē tepër, kuptimet e lartëpērmendura mugulluan -dolën- nē shumë vērsete tē ndryshëm.

**وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقَنُونَ** “Ve bil[el] A'hireti hum jukínúne”, “si edhe që besojnë me bindje nē Botën e Përtejme”.

**Shqyrtoje këtë:** kjo frazë i referohet të katërtit prej katër qëllimeve të mirënjohnura të Kuranit: Ringjalljes së të vdekurve. Unë kam deduktuar -nxjerrë si përfundim- dhjetë prova të saj prej renditjes së fjalëve të Kuranit dhe i kam përmendur ato nē një libër tjetër<sup>5</sup>. Do të ishte e dobishme të përmblidheshin ato këtu. Ato janë sa vijon:

Ringjallja e të vdekurve është një realitet, sepse ndodhet një realitet, sepse ndodhet një rregull i përkryer dhe i qëllimshëm në univers. Ndodhet një urtësi e plotë nē krijim. Nuk ka asgjë të kotë nē botë. Nuk ka harxhim të tepruar nē krijim (*el- Fitra*). Kjo dëshmi është vërtetuar nga arsyetimi induktiv i të gjitha shkencave, secila prej tyre është një dëshmitare e vërtetë për rregullin nē fushën e saj të studimit. Gjithashtu, duke qenë ringjallje të përsëritura nē shumicën e gjërvave, të tilla si ditët dhe vitet dhe të tjera veç tyre, (secila duke dëshmuar për ringjalljen e të vdekurve).

Gjithashtu, aftësia e bashkëlindur e njeriut e tregon ringjalljen. Ajo tregohet gjithashtu edhe nga shpresat dhe dëshirat e pafundme të njeriut. Gjithashtu, mëshira e Autorit të Gjithurtë aludon për ringjalljen. Gjithashtu gjuha e vërtetë e të dërguarit të Allahut e shpreh atë në mënyrë të qartë. Dhe Kurani i paimitueshëm dëshmon për të me vërsonte

**وَقَدْ خَلَقْنَاكُمْ أَطْوَارًا # وَمَارِبُكُمْ بِظَلَامِ الْعَبْدِ** “Dhe ndërkohë është Ai që ju ka krijuar nē faza të njëpasnjëshme (të ndryshme)<sup>6</sup>.... dhe “Dhe Zoti yt nuk është aspak i padrejtë ndaj robëve të Tij”<sup>7</sup>.

Këto dhjetë prova të vërteta janë çelësa për lumturinë e përjetshme dhe për dyert e asaj parajse.

<sup>5</sup> Nursi “Muhakemat” (e botuar për herë të parë më 1911). Si Saidi i Ri ai më vonë i përfshiu të njëjtat prova nē Fjalën e Njëzet e Nëntë, tek Sözler.

<sup>6</sup> Kuran, 71:14

<sup>7</sup> Kuran, 41:46

### Një shpjegim i provës së parë:

Në qoftë se universi nuk do të rezultonte -përfundonte- nē lumturi të përjetshme, rregulli nē të, të cilin Autori i tij e ka vendosur me mjeshterinë dhe saktësinë më të madhe, duke i lënë njerëzit nē habi, do të bëhej një formë e brishtë dhe mashtruese, dhe të gjitha gjërat jomateriale, lidhjet dhe hallkat nē rregull do të shkonin për asgjë, për kot. Rregulli është rregull i vetëm për shkak se ai të çon nē lumturi të përjetshme. Domethënë, pikat e holla dhe aspektet jomaterialë të atij rregulli mugullojnë e mbijjnë nē botën e Ahiretit. Përndryshe, të gjitha ato aspekte jomateriale do të shuheshin, të gjitha lidhjet do të këputeshin dhe të gjitha hallkat do të thyheshin, dhe rregulli do të pushonte së qëni i tillë. Por fuqia e natyrshme -e brendaqenësishme- nē rregull thërret me zërin e saj më të lartë se ajo nuk do ta linte atë të thyhet e të shpërbëhet.

**Prova e dytë:** Urtësia e patëmetë -në univers- që është një ilustrim dhe demonstrim i përkujdesjes së parapërjetshme Hyjnore (*el-inaja el-ezelijeh*) dhe përbëhet nga dobitë dhe shembujt vijues të urtësisë nē të gjitha botërat (në çdo lloj ‘neu’) të qënieve, madje nē çdo gjë të pjesshme -ashtu siç dëshmohet nga të gjitha shkencat-, jadin lajme të gëzueshme, sihariqe, për lumturinë e përjetshme. Përndryshe ne do të duhej që t'i mohonim këto qëllime e dobi, siguria e të cilave na detyron që t'i njohim e t'i pranojmë. Sepse atëherë dobia nuk do të ishte dobi, dhe urtësia nuk do të ishte urtësi, përfitimi nuk do të ishte përfitimi; dhe kjo do të ishte vetëm një sofistikë e pastër.

### Prova e tretë, e cila shpjegon të dytën:

Shkenca gjithashtu dëshmon se Autori zgjedh rrugën më të shkurtër nē çdo gjë, dhe anën më të afërt dhe formën më të lehtë e më të bukur. Kjo tregon mundësinë e kotësisë. Dhe kjo sugjeron se Autori është vërtet serioz. Dhe kjo do të mund të ishte veçse me ardhjen e lumturisë së përjetshme. Përndryshe kjo ekzistencë do të zbriste e binte tek niveli i mosekzistencës absolute dhe çdo gjë do të transformohej nē një kotësi të pastër.

**سُبْحَانَكَ مَا خَلَقْتَ هَذَا بِأَطْلَالٍ**  
*Subhanek -lavdia tē takon Ty, o Zot!*  
 Ti nuk e krijove këtë pér kot!

### Prova e katërt, e cila sqaron tē tretën:

Shkencat tregojnë se nuk ka harxhim tē tepërt -prishje pa hesap- në krijim. Në qoftë se mendja juaj është e paafëtë pér tē kapur shembujt e urtësisë në njeriun më tē madh, që është 'Bota', le tē shikojë e shqyrtojë botën e vogël, që është 'njeriu'. Sepse shkenca e anatomisë ka përshkruar e provuar se, në trupin e njeriut janë afërsisht gjashtëqind kocka, secili prej tyre ka një funksion tē veçantë.

Dhe ndodhen gjashtë mijë vena dhe arterie pér qarkullimin e gjakut secila me dobinë e saj. Dhe ndodhen njëzet e katër mijë pore dhe kanalthe në qeliza. Në çdo qelizë funksionojnë pesë fuqitë e têrheqjes, shtytes, mbajtëses (*mumsike*), formueses (*musav-vire*) dhe riprodhimit, secila prej tyre ka qëllimin e saj.

Në qoftë se bota e vogël -njeriu- është kështu, atëherë a do tē mund tē ishte njeriu më i madh -'bota'- më e mangët se sa ai?

Në qoftë se ndodhet kjo mungesë e harxhimit tē tepërt në trup, i cili nuk ka rëndësi duke u krahasuar me esencën e tij, a do tē ishte e perceptueshme që tē neglizhojë shpirti?

Në qoftë se nuk do tē ishte lumturia e përjetshme, tē gjitha çështjet shpirtërore do tē tkurreshin e pakësoheshin, dhe do tē bëheshin harxhim i tepërt.

Pér hir tē Zotit, a do tē ishte e mundur me arsyë që ti tē kiske një xhevahir që vlen sa dynjaja, dhe tē kujdesesh me sedefin -guaskën- dhe me mbulesën -arkën- e tij, madje duke mos e lënë tē bëhet me pluhur, dhe pastaj ta copëtonte në thërmija e tē shkatërronte tē gjitha shenjat e saj? Absolutisht jo!

Ti kujdesesh pér arkën vetëm pér shkak tē asaj që ajo përbani. Pér më tepër, në qoftë se struktura e shëndoshë e një njeriu dhe gjymtyrët e shëndetshme dhe aftësitë e tij tē bëjnë ty tē kuptosh se ai do tē vazhdojë tē jetojë dhe do tē zhvillohet, atëherë a nuk tē bëjnë ty realiteti i qëndrueshëm që vepron në shpirtin e universit, dhe forca totale duke

treguar ekzistencën e vazdueshme tē rregullit tē tij, dhe përsosuria duke shkaktuar zhvillimin (*tekemmul*) e sistemit tē tij tē përgjithshëm - a nuk tē bëjnë ty tē kuptosh se lumturia e përjetshme do tē vijë nëpërmjet derës së ringjalljes trupore?

Sepse është vetëm ringjallja ajo që e shpëton rregullin nga prishja - nga çrregullimi, dhe është mjeti i zhvillimit tē tij dhe pér zbulimin e asaj force tē përjetshme.

### Prova e pestë, dhe përbledhja, e cila tregon qëllimin:

Ekzistenca e ringjalljeve tē përsëritura në shumicën e botërave tē qënieve tregon ringjalljen më tē madhe.

Në qoftë se ti dëshiron, kjo mund tē ilustrohet me një shembull:

Hidhe vështrimin në orën tënde javore. Ajo përban ingranazhe dhe rrata me fletë, tē dhëmbëzuara, që lëvizin e vënë në punë akrepat. Njëri nga ato numëron sekondat; ai është një paraprijës -lajmëtar- duke dhënë njoftime pér lëvizjen e akrepit tē minutave. Ai shtron rrugën dhe njofton lëvizjen e akrepit tē orës, dhe ai përfundon në njoftimin e lëvizjes së një ore që numëron ditët e javës.

Akrepi paraprijës duke plotësuar rrrotullimin e tij tregon se edhe motra e saj që e ndjek, do ta plotësojë rrrotullimin e saj. Gjithashtu, Allahu xh.sh. ka një orë, pajisjet mekanike tē së cilës janë sferat qiellore; akrepat e saj numërojnë ditët, vitet, jetën e njerëzimit dhe kohëzgjatjen -qëndrimin- e dynjasë. Ato janë ekuivalente me sekondat, minutat, orët dhe ditët e orës tënde. Kështu, ardhja e agimit pas çdo nate dhe ardhja e pranverës pas çdo dimri -që rezulton nga lëvizja e asaj ore- tregon një shenjë tē fshehtë dhe aludon pér një aluzion tē hollë se mëngjesi i pranverës së Ringjalljes do tē vijë, duke dalë prej asaj ore tē madhe tē universit.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Gjërat nuk ringjallen tē njëjtat - identike, njëlloj- në ringjalljet e përsëritura në univers, atëherë si shfaqet kjo se personat do tē ringjallen tē njëjtët në Ringjalljen më tē madhe?

*Ty do tē tē thuhej:* Një individ njerëzor është si një specie e krijuar tē tjerë. Sepse drita e mendimit u jep një gjëresi dhe një

shtrirje tē tillē shpresave dhe shpirtit tē tij saqē ato pērfshijnē e rrethojnē tē shkuarēn, tē tashmen dhe tē ardhmen. Nē qoftē se ai do t'i gelltiste tē shkuarēn dhe tē ardhmen sē bashku me tē tashmen, kjo nuk do t'i kēnaqtē e ngopte shpresat e tij. Sepse drita e mendimit i bēn natyrēn e tij tē lartēsuar, vlerēn e tij tē pērgjithshme, shikimin e tij universal, plotēsinē e tij tē pakufizuar, kēnaqēsitē e tij tē castit (tē tanishme) tē pērherershme dhe vuajtjet e tij tē vazhdueshme. Sa pēr anētarēt e specieve tē tjera, natyrat e tyre janē tē pjesshme; vlera e tyre, individuale; shikimi i tyre, i kufizuar; plotēsitē e tyre, tē kufizuara; kēnaqēsitē e tyre, tē castit; dhe vuajtjet -dhibjet- e tyre, kalimtare -tē pērkokohshme. Atēherē pērse ekzistenca e njē lloji ringjalljeje nē speciet (e tjera) tē mos tregojē njē ringjallje tē pērgjithshme tē individit njerēzor?

#### **Prova e gjashtē, e cila ēshtē aluduese:**

Kjo ēshtē natyra e pakufizuar e potencialeve tē njeriut. Po, konceptet dhe mendimet e pakufishme tē njeriut lindin prej shpresave tē tij tē pafundme. Kēto burojnē prej dēshirave tē tij tē pakufizuara, tē cilat me rradhē burojnē nga aftēsitē e tij tē pakufishme. Kēto fshihen nē potencialet e tij tē pakufishme, tē ngulitura nē substancēn e shpirtit tē tij, tē cilin Allahu xh.sh. e ka nderuar.

Tē gjitha kēto tregojnē duke dēshmuar pēr lumturinē e pērjetshme pērtej ringjalljes trupore tē tē vdekurve, duke fiksuar shikimin e tyre mbi tē nga larg. Reflektu mbi kētē!

**Prova e shtatē, duke dhēnē sihariqe** se mēshira e tē Gjithēmēshirshmit Mēshirēplotē tregon ardhjen e mēshirēs mē tē madhe, me tē cilēn dua tē them lumturinē e pērjetshme, sepse me tē bēhet mēshira mēshirē, dhe mirēsia bēhet mirēsi, dhe universi člirohet shpēton nga vajtimet dhe nga zia e pērgjithshme qē burojnē nga ndarja e pērjetshme, e cila e transformon mirēsinē nē hidhērim e zemērim. Nē qoftē se shpirti i mirēsise, domethēnē, lumturia e pērjetshme nuk do tē vinte, tē gjitha mirēsitē do tē transformoheshin nē fatkeqēsi, dhe kjo do tē bēnte tē domosdoshme kokēfortēsinē nē mohimin e mēshirēs sē qēndrueshme qē nē mēnyrē tē vetékuptueshme tē domosdoshme dēshmohet nga i gjithē universi.

O Habib dhe o Shefik<sup>8</sup>, qē tē dy dashurues! Shikojini veprat e holla tē mēshirēs Hyjnore: dashurinē, mēshirēn dhe ashkun. Pastaj shikoni ndērgjegijjet tuaja, por pasi tē supozoni se ato do t'u nēnshtrohen ndarjes sē pērjetshme dhe ndarjes sē pafund; ju do ta shikoni se si ndērgjegija thērret pēr ndihmē! Si bērtasin imaginatat tuaja, dhe shpirtērat tuaj torturohen nga transformimi i asaj dashurie e mēshire -tē cilat janē mē tē bukurat dhe mē tē hollat e llojeve tē mēshirēs dhe tē mirēsisē- nē njē fatkeqēsi tē tmerrshme dhe nē hidhērim.

A do tē ishte e mundur qē njē mēshirē e tillē e domosdoshme tē ndihmonte ndarjen e pērjetshme duke sulmuar dashurinē dhe mirēsinē? Jo, ajo mēshirē eshtē e tillē qē do ta bēnte ndarjen e pērjetshme tē dominojē mbi ndarjen pa mbarim, dhe tē bllokojē ndarjen e pambarim me ndarjen e pērjetshme, dhe t'i asgjēsojē tē dyja ato!

**Prova e tetē, e cila ēshtē e qartē:** Kjo ēshtē gjuha e vērtetē dhe e verifikuar e Muhammedit a.s.m.. Fjala e tij hapi dyert e lumturisē sē pērjetshme. Konsensusi i tē gjithē profetēve nga Ademi a.s. deri tek Vula e tyre a.s.m. lidhur me kētē tē vērtetē, formon njē provē vendimtare pēr kētē pretendim.

Ajo duhet tē jetē njē e vērtetē e tillē, meqē tē gjithē ata kishin pajtueshméri mendimi lidhur me tē.

**Prova e nēntē:** Ky ēshtē njoftimi i mrekullueshēm i Kurānit pēr lumturinē e pērjetshme.

Shtatē aspektet<sup>9</sup> e mrekullisē sē tij janē konfirmuar pēr trembhējjetē shekuj duke dhēnē provēn e asaj qē ai pretendon. Sepse ai zbulon ringjalljen trupore me mesazhin e tij dhe ēshtē celēs pēr tē.

**Prova e dhjetē:** Kjo pērbēhet nga mijēra prova tē paraqitura prej vērseteve tē shumtē.

<sup>8</sup> Emrat e dy studentēve tē Said Nursit, emrat e tē cilēve kanē kuptimin e 'dashurisē' dhe tē 'mēshirēs'. I pari veproi si shkruesi i autorit.

<sup>9</sup> Detajet e kētyre aspektēve ndodhen tek Fjala e Njōzet e Pestē –Mrekullitē e Kurānit.

**وَقَدْ خَلَقْنَاكُمْ أَطْوَارًا**  
Pér shembull, vèrseti “Dhe naðerkofie është Ai që ju ka krijuar ju në faza të njëpasnjëshme (të ndryshme)”<sup>10</sup>, tregon një krahasim alegorik; dhe vèrseti, **وَمَارِيَّكَ بِظَلَامٍ لِلْعَبْدِ** “Dhe Zoti yt nuk është aspak i padrejtë ndaj robëve të Tij”<sup>11</sup> tregon një ‘provë drejtësie’. Në të vërtetë, në shumicën e vèrseteve të tij Kurani ka hapur dritare me pamje nga ringjallja e të vdekurve.

Krahasimi alegorik në vèrsetin e parë lart është sa vijon: Shqyrtoje trupin e njeriut, si kalon ai nga faza në fazë, nga sperma në copë gjaku dhe nga ajo në një embrion, dhe nga ajo në mish e në kockë, dhe nga ajo pér në krijim të ri. Secila nga këto faza ka ligje të tillë të veçanta, një sistem të tillë të përcaktuar dhe një zhvillim të tillë të rregullt saqë kjo në mënyrë të dukshme zbulon një qëllim, dëshirë dhe zgjedhje. Pastaj sudioje ekzistencën e tij të vazdueshme, sepse trupi i ripërtërin rrobat e tij në çdo vit, dhe kjo ndodh nëpërmjet shpërbërjes dhe rimbledhjes -përbërjes. Domethënë, qelizat çrrregullohen, shemben dhe riparohen me një substancë të hollë të përgatitur nga autori i tyre me një ligj të veçantë dhe shpërndahet në sasira të përshtatshme pér të gjitha organet.

Tani studioji fazat e lëndës së hollë që mban ushqimet e gjymtyrëve, si shpërndahet ajo tek të gjitha pjesët e trupit në një mënyrë që çudit mendjen, dhe si ajo ndahet, përpjesëtohet në përputhje me një ligj specifik të ndarjes në mënyrë të përshtatshme pér nevojat e gjymtyrëve. Kjo bëhet pasi ajo të jetë distiluar duke kaluar sipas një sistemi të qëndrueshëm e të fiksuar sipas një rregulli specifik dhe me një proces të jashtëzakonshëm nëpërmjet katër filtrave -kullesave; dhe duke u përpjekur në katër kuzhinat e saj; pasi kishte ndërmarrë katër transformime; dhe ushqimi duke u siguruar në përputhje me një ligj të rregullt, me një sistem të veçantë dhe me një rregull specifik prej substancave të shpërndara nëpër botën e elementeve.

Të gjitha ligjet dhe sistemet në këto faza tregojnë në mënyrë të tejdukshme një forcë shtytëse, një qëllim dhe një urtësi. Si mund të mos ishte kështu? Në qoftë se ti do të studioje një atom, pér shembull,

<sup>10</sup> Kuran, 71:14  
<sup>11</sup> Kuran 41:46

prej një karvani të lëndës së hollë (të njobur si substanca), që është e mbuluar -e fshehur- në elementin e ajrit i cili më në fund bëhet pjesë e syrit të Habibit, ti do ta shihje se rruga e atij atomi ndërsa është në ajër është përcaktuar, sikur ai të ishte ngarkuar e urdhëruar pér të shkuar drejt vendit të përcaktuar pér të.

Dhe në qoftë se do ta shikoje atë me një sy shkencor, ti do të ishe i sigurt se ai nuk është në lëvizjen e tij nëpërmjet rastësisë së verbër dhe koincidencës së paqëllim, sepse ai atom në çfarëdo nivel që hyn, u përshtatet rregullave të tij të veçanta, dhe tek çfarëdo faze që të ngjitet, ai njeh ligjet e saja të veçanta, dhe tek cilido nivel që të udhëtojë, shtyhet me një lëvizje të mrekullueshme e të rregullt. Ai atom kalon nëpër të gjitha këto faza deri sa arrin destinacionin e tij. Dhe ai nuk shmanget kurrë as edhe sa një thërrmijë prej objektivit të tij të synuar.

**Shkurtazi:** Ai që e shqyrton krijimin e parë, nuk do të mbetej tek ai asnjë dyshim a hezitim lidhur me krijimin e dytë. Në të vërtetë profeti a.s.m. tha: “*Sa e çuditshme pér njeriun i cili e shikon krijimin e parë, si e mohon ai të dytin!*”

Po! Ashtu si grumbullimi i ushtarëve të regjimentit të cilët grumbullohen me zërin e borisë pasi ishin shpërndarë pér të pushuar, duke u shfaqur prej çdo qosheje e skute, pér të formuar rreshtat nën flamurin e tyre, që është shumë më i lehtë se sa t'i thërrasësh ata pér t'u organizuar pér herë të parë dhe pér t'u marrë nën armë; po ashtu do të ishte më e lehtë pér grimcat që janë të njobura e të lidhura duke qenë të përziera në një trup të vetëm pér t'u rimbledhur, rigrumbulluar me zërin e Borisë së Israfilit, dhe pér të ardhur të gjitha nga çdo anë duke iu përgjigjur urdhërit të Krijuesit të tyre; kjo është më e lehtë dhe më e mundshme me arsy se sa krijimi i tyre original dhe kompozimi. Sepse në lidhje me fuqinë Hyjnore, gjëja më e madhe është e barabartë me më të voglën.

Pastaj duket se në Ringjallje, pjesët origjinale të trupit do të rikthehen tek ai, po ashtu edhe ato që qenë hedhur.

Për këtë aludohet nga madhësia e trupave të të ringjallurve<sup>12</sup>, dhe fakti që është ‘Mekruh’ ‘e papëlqyeshme’ të presësh thonjtë ose flokët kur je xhunub (i papastër kanonikisht), dhe se është ‘sunnet’ t'i varrosësh -groposësh- ato”.<sup>13</sup> Por sipas hetimeve dhe studimeve “Axhbu edh-dheneb” (pak qeliza prej saj) do të jenë të mjaftueshme si një bërthamë dhe si substancë për riformimin -rindërtimin e trupit.

Tani, sa për provën e treguar nga vërseti, “Dhe Zoti yt nuk është aspak i padrejtë ndaj robërve tē Tij”<sup>14</sup>, ne shohim se shumë njerëz tiranë, mëkatarë dhe mizorë jetojnë në luksin më të madh, në mes të të gjitha të mirave, duke i kaluar jetët e tyre në bollëk e rehati.

Pastaj ne shohim se të varfërit, të shtypurit dhe njerëzit e drejtë e me moral të mirë i jetojnë jetët e tyre me vështirësi të mëdha, në poshtërim dhe të shtypur. Pastaj vdekja vjen dhe i bën ata të barabartë, dhe kjo barazi pa fund shfaqet të jetë një padrejtësi e skajshme.

Ndërsa drejtësia Hyjnore dhe urtësia, të cilat dëshmohen nga i gjithë universi, janë të përjashtuara prej një tiranie të tillë. Prandaj, duhet të jetë një tubim përfundimtar në të cilin i pari do të marrë dënimin e tij dhe i dyti do të marrë shpërblimin e tij, dhe kështu ajo drejtësia të mund të shfaqet plotësisht. Ju mund t'i krahasoni vërsetet e tjerë të Kur'anit me këto të dy.

**وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقَنُونَ**  
“Vendosja -pozicionimi- i pjesëve të frazës: *bil(e)s A'hireti hum jukjnune*”, “*si edhe që besojnë me bindje në Botën e Përtejme*”:

Pikat kryesore (prej të cilave përbëhet kjo frazë):

<sup>12</sup> Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejreja thuhet: “Dhëmballa e qafirit - mohuesit- do të jetë aq (e madhe sa) mal i Uhud, dhe lëkura e tij do të jetë prej një trashësie të një udhëtimi treditor.” Muslimi.

<sup>13</sup> Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejreja thotë: “Të gjithë bijtë e Ademit do të konsumohen nga dheu përvëç (pak qelizave nga) “Axhb Edh-dheneb” “Rrënya e kërbishtit”. Ato u krijuan prej saj (në herën e parë) dhe do të rikrijohen prej saj. Etj (Muslimi dhe të tjerët)

<sup>14</sup> Kuran 41:46

وَ **‘wavi’ “dhe”;** vendosja para e **‘bil(e)s A'hireti’ ‘në Botën e**  
**بِالْآخِرَةِ**

**‘Përtejme’;** përdorimi i nyjes shquese **“el”** për termin Ahiretin **‘bil(e)s A'hireti’ ‘në Botën e Përtejme’;** përdorimi i përemrit vtor **‘Hum’** **“ata”;** dhe përdorimi i **‘jukjnune’**, **“që besojnë me bindje”** në vend të **“juëminune”**, **“(ata) besojnë”**.

Lidhëzja **‘we’ “dhe”**: Pas pohimeve të përgjithshme të frazave të mëparshme, (qëllimi i) kësaj është të shprehë specifikimin -e kësaj- me përmendjen e tij të qartë të kësaj shtylle të besimit. Sepse -kjo shtyllë- është njëra prej dy boshteve mbi të cilat vërtiten -rrotullohen- librat qiellorë.

Venia para e **‘bil(e)s A'hireti’ ‘në Botën e Përtejme’**, shpreh kufizim, dhe kjo sugjeron se për shkak se (disa prej) ihtarëve të librit thonë:  
**لَنْ تَكُنْتَنَا النَّارُ إِلَّا أَيَامًا مَعْدُودَةً** “Zjarri nuk do të na prekë ne veçse për pak ditë”, dhe (të tjerët prej tyre) mohojnë kënaqësitë trupore; ahireti do të jetë metaforik për ta dhe vetëm në emër; ajo çfarë ata përjetojnë nuk do të jetë ahireti i vërtetë.

جَلِيل **‘el’** është për të shprehur natyrën e tij të njobur. Domethënë, ajo tregon se -Ahireti- është i mirënjobur nëpërmjet përmendjes së tij të vazhdueshme nga librat e shpallur qiellorë. Qenia e tij i mirënjobur është gjithashtu një aluzion se ai është i vërtetë, dhe një shenjë se, si rrjedhojë e provave të bazuara mbi natyrën e gjéravë të përmendura lart, ai është një fakt pothuajse i dukshëm për mendjen. Prandaj, qenia e tij i mirënjobur është një shenjë se ai është një realitet. Dhe përdorimi i termit **‘el A'hireti**, domethënë, duke e bërë atë një mbiemër duke cilësuar krijimin (*En-naitetu lil nash'ah*), është për të drejtuar vëmendjen tek ‘krijimi i parë’, me qëllim që mendja ta kapë e ngërthejë mundësinë e krijimit të dytë.

Përemri vtor **‘hum’**, **‘ata’** nënkuption kufizim, dhe kjo sugjeron se besimi i atyre ihtarëve të librit të cilët nuk besojnë Muhammedin a.s.m. nuk është besim i sigurt.

Në të vërtetë, ai është vetëm një supozim të cilin ata e pandehin se është i sigurt.

**يُوقنون** “ju'kjünne”, “që besojnë me bindje” përdoret në vend të ‘Juminune’ (ata) besojnë’, megjithëse besimi është një afirmim i sigurtë, që të tregojë qëllimi me gjith dyshimet.

Sepse Ringjallja e të vdekurve është një turmë -mizëri- dyshimesh dhe -siguria e plotë (jekin), lidhur me të, është më e rëndësishme se sa afirmimi (*tasdik*) i saj.

Gjithashtu ky deklarim i sigurt i përcaktuar bilo kon rrugën e justifikimeve të tillë të ihtarëve të librit si “Ne jemi besimtarë. Kështu le të besojnë ata të cilët nuk besojnë”.

\* \* \*

## VĒRSETI 5

وَأَوْلَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ  
أَوْلَئِكَ عَلَىٰ هُدًىٰ مِّنْ رَبِّهِمْ

*Ulâike alâ huden min Rab-bihim Ve ulâike hum el-muflihûne.*

*Ata janë në udhëzim, (udhëhiqen, janë) në rrugë të vërtetë nga Zoti i tyre dhe ata janë më të suksesshmit (të shpëtuarit).*

**Shqyrtoje këtë:** Vendet e hamendësueshme (*al-madhan*) në të cilat hollësitë shkëndijojnë -në këtë vërset- janë sa vijon: vendosja e fjalëve në lidhje me ato që i paraprinë (që erdhën para tyre); pastaj perceptueshmëria e **أَوْلَئِكَ** “*Ulâike*”, “*ata*” dhe distanca që ajo shpreh; pastaj lartësia e treguar nga **عَلَىٰ** “*alâ*”, “*mbi, në*”; pastaj përdorimi i trajtës së pasquar në **هُدًىٰ** “*huden*”, “*udhëzim*”; pastaj parafjala **مِّنْ** “*min*”, “*prej, nga*”; pastaj rritja, zhvillimi dhe mbështetja e nënkuptuar nga **رَبِّ** “*Rab-bihim*”, “*Zoti i tyre*”.

**Vendosja -pozicionimi:** Ky vërsset është i lidhur me atë që e parapriu me një numër prej fijeve të lidhjeve. Njëra nga këto është kapja -lidhja- e fijeve, domethënë është përgjigjja për tre pyetjet e nënkuptuara.

**E para** është një pyetje duke kërkuar një shembull, sikur dëgjesi pasi i ka vënë veshin Kuranit dhe ka dëgjuar se ai karakterizohet nga

dhënia udhëzim pér njerëzit tē cilët si rezultat i udhëzimit- fitojnë cilësi tē mira, (dëgjesi) do t'i shohë ata tē veshur vërtet me ato cilësi tē mbështetura duke qëndruar mbi fronin e udhëzimit. Kështu ajo i përgjigjet duke i përshkruar e paraqitur dëgjesit, duke i thënë: “*Ata janë nē udhëzim tē vërtetë nga Zoti i tyre*”.

**E dyta** është një pyetje rrëth arsyses pér udhëzim, sikur pyetësi është duke pyetur: “*Si janë ata që e kanë merituar udhëzimin dhe karakterizohen prej tij?*”

Dhe ajo i përgjigjet: “*Ata i posedojnë tē gjitha këto cilësi nē formë tē kombinuar. Në qoftë se ti do t'i studioje ato me vëmendje do tē shikoje se ata janë tē denjë pér dritën e udhëzimit*”.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* A nuk e shpjegon detajimi -përmendja më e detajuar- e cilësive nē vërsetet e mëparshëm arsyen pér udhëzim në mënyrë më tē qartë se sa thukëtia e **‘Ulâike’**, “*ata*”?

*Ty do tē tē thuhej:* Thukëtia përgjithësisht është më e qartë se sa shpjegimi i detajuar, dhe sidomos nē qoftë se përgjigja e kërkuar buron -lind- nga një kombinim i gjërave. Sepse -këtu- natyra e kufizuar e mendjes së dëgjesit, dhe natyra e shtrirë e diskutimit, dhe ndërhyrja e harresës midis tyre, dhe arsyaja pér udhëzim duke u shfaqur nga kombinimi i të gjithë elementëve tē diskutimit -pengojnë- tē kuptuarin

e saj. Kështu pér shkak se **‘Ulâike’**, “*ata*” i kombinon këto gjëra, thukëtia e saj e shpjegon arsyen më qartë.

**E treta** është një pyetje rrëth rezultateve dhe frutave tē udhëzimit dhe mirësia dhe kënaqësia janë nē tē. Sikur dëgjesi pyet: Ç’është kënaqësia dhe ç’është mirësia”. Dhe ajo i përgjigjet duke i thënë se - vetëm- nē udhëzim gjendet lumturia nē tē dyja botët. Domethënë, rezultati i udhëzimit është vetja e tij dhe frutat e tij janë tē njëjtët si vetja, sepse udhëzimi nē vettete është mirësia më e madhe, dhe kënaqësia më e madhe -dalldia- e ndërgjegjës; madje është parajsa e shpirtit; ashtu si çudhëzimi që është ferri i tij. Pastaj më vonë ai - udhëzimi- do tē prodhojë frutat e lumturisë dhe tē shpëtimit nē Ahiret.

أَوْلَئِكُمْ “*Ulâike*”, ‘*ata*’  
Sa pér perceptueshmërinë (*el-mahsusijeh*) tē “*Ulâike*”, ‘*ata*’ ajo është një shenjë se përmendja e cilësive tē shumta -përmendja e shpeshtë e cilësive- është shkak që ato tē jenë tē mishëruara nē trurin e dëgjesit, tē bëhen tē pranishme nē mendjen e tij, dhe tē perceptueshmë pér imaginatën e tij. Kështu nga qenia e tyre tē njoftuara nga -thjesht-përmendja, ato bëhen tē njobura realisht (një derë hapet pér tek ana e jashtme); dhe nga kjo -e jashtme- ai kuption dallimin e ‘besimtarëve’ dhe vështron rrezatimin e tyre tē ndritshëm midis llojit njerëzor, sikur ai që ngre kokën e tij dhe hap sytë e tij që nuk shfaqen pér tē veçse këta.

أَوْلَئِكُمْ “*Ulâike*”, “*ata*”, ndonëse nē tërësi ato janë afér, tregon lartësinë e rangut tē tyre, sepse kur shihen nga larg, vetëm më shtatlartit e tyre janë tē dukshëm.

Megjithëse realiteti i distancës së kohës dhe i vendit është gjykatesi më i mirë pér tē drejtën e elokuencës. Sepse ashiku si Epoka e lumturisë (që mund tē mendohet si) një gjuhë duke recitar këtë vërsë ndërsa ai po shpaljej, po ashtu tē gjithë shekujt e njëpasnjëshëm tē ardëshëm janë gjithashtu gjuhë duke e recitar atë, duke e bërë atë tē ri e tē freskët sikur ai tē shpaljej rishtas, dhe jo -diçka që- ishte shpallur shumë kohë më parë dhe pastaj tē tregohej. Sepse rreshtat e parë tē

أَوْلَئِكُمْ “*Ulâike*”, “*ata*”, shfaqen nga larg. Kështu qenia e tyre tē dukshëm pavarësisht largësisë së tyre shpall shtatlartësinë -madhështinë- e tyre nē rangun e lartë.

عَلَى ‘*alâ*’, ‘*në, mbi*’, shqyrto këtë:

Misteri i lidhjeve -ose bashkëshoqërimet- ndërmjet gjërave i bën shumicën e tyre si pasqyra duke reflektuar njëra-tjetren. Kjo reflekton atë dhe ajo reflekton këtë. Ashtu si një copë xhami që mund tē tē tregojë ty një shkretëtirë tē gjërë; po ashtu ndonjëherë një fjalë e vetme mund tē tē kujtojë e shkaktojë imaginata tē pafundme, dhe një fjalë mund tē ngrejë -zgjojë- një tregim tē çuditshëm përparrë syve tē tu, dhe një frazë mund ta marrë mendjen tēnde nē një shëtitje nëpër Botën e Shëmbëllësës.

Gjithashtu, fjala بارز 'ba'reze', 'tē ndeshesh nē beteje', zbulon pér ty një fushë beteje, dhe fjala فُرْت "Frut" nē vërset hap pér ty Derën e Parajsës.

Ti mund tē bësh analogji nē tē njëjtën mënyrë! Pikërisht nē tē njëjtën mënyrë është edhe parafjala على 'alà', 'nē, mbi'; ajo hap një dritare pér mendjen -duke zbuluar- krahasimin e mëposhtëm:

Udhëzimi i Kur'anit është një Burak Hyjnor që ua ka dhuruar besimtarëve që tē udhëtojnë -duke hipur- mbi tē. Kur hipin mbi tē, ata janë nē rrugën e Drejtë, duke udhëtar pér tek Froni i plotësimeve.

Përdorimi i trajtës së pashquar pér هدى "huden" "udhëzim", tregon se ai është i ndryshëm nga هدى "huden li(e)l mut-tekine", "udhëzim pér el-muttekine (besimtarët e drejtë, tē përkushtuarit).<sup>1</sup> Sepse duke folur nē përgjithësi, përsëritja e tē pashquarës tregon se e dyta nuk është e njëta si e para. Këtu, e para është një masdar ose një emër foljor, ndërsa kjo është 'produkti' i emrit foljor (*ha'sil bil masdar*). Domethënë, është një atribut i 'perceptueshëm' i qëndrueshëm ose një cilësi (*sifa mahsusa qar'ra*) dhe fruti i tē parës.

Fjala من 'Min', 'prej, nga' tregon se -udhëzimi- është edhe i krijuar nga Allahu dhe i dhuruar pér ta nga Ai.

Fjala رب 'Rabb', "Zoti, Mbështetësi", tregon se tē dhënit udhëzim është shenja e Hyjnisë (*Rububijeh*); Atëherë ashtu siç i furnizon Ai me rizk -ushqime, po ashtu Ai i mbështet ata me udhëzim.

وأَنْتَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ "Ve ulâike hum el-muflihûne", "dhe ata janë më tē suksesshmit (tē shpëtuarit)."

<sup>1</sup> Kur'an, 2:2

Mësoje se vendet ku duhet tē kërkohen pikat e holla janë këto: Lidhëzja و 'Ve', "dhe"; pastaj përsëritja e (përemrit dëftor) أوْلَئِكَ 'Ulâike', "ata"; pastaj përemri vëtor i veçuar هُمُ 'hum', "ata"; pastaj nyja shquese آل 'el'; pastaj مُفْلِحُونَ 'muflihûne', "tē suksesshmit (tē shpëtuarit)" duke qenë absolute, dhe forma e suksesit tē tyre ose e fattit tē tyre tē mirë duke qenë e papërcaktuar.

Lidhëzja përdoret pér shkak tē lidhjes midis dy fjalive. Sepse ashtu si أوْلَئِكَ 'Ulâike', "ata" e parë që tregon lumturi nē këtë botë (*el se-adetu el- A'xhileh*) që është fruti i udhëzimit; po ashtu e dyta tregon lumturinë e Ahiretit (*et seadetul-el axhileh*). Megjithëse tē dyja ato janë fruti -ose përbledhja- e asaj që i parapriu, veçse (shikimi) më i mirë është se rrënjet e tē parës أوْلَئِكَ "Ulâike", "ata"; janë tē lidhura tek والذين "el-ledhine", "tē cilët" e parë,<sup>2</sup> dhe ajo duket se u referohet besimtarëve analfabetë tē cilët (nuk janë ithtarët e librit dhe) e marrin fuqinë e tyre prej shtyllave tē islamit (domethënë, ata kryejnë namazin dhe japin zekatin); kjo shikon atë që e parapriu "ve bil(e)l A'hireti hum jukinûne".

وأَنْتَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ "Ulâike" e dyta vështron nē mënyrë tē fshehtë, duke aluduar pér والذين "el-ledhine-n" e dytë (2:4) e cila duket se u referohet besimtarëve tē ithtarëve tē librit. Pika e saj e referimit janë shtyllat e besimit dhe siguria rreth Ahiretit. Tani reflektó mbi këtë!

Sa pér përsëritjen e أوْلَئِكَ "Ulâike", "ata", ajo tregon se pér sa ka tē bëjë me shkakun përfundimtar tē udhëzimit dhe arsyen pér qënien e tyre tē lavdëruar e tē privilegjuar, këto dy fruta -të udhëzimit dhe tē shpëtimit, suksesit- janë tē pavavar dhe tē ndryshëm nga njëri-tjetri.

<sup>2</sup> Kur'an, 2:3

Megjithatë, -interpretimi- më i mirë është se ‘*Ulāike*-ja’ e dytë tregon të parën përveç se (kallzuesi i të cilës të jetë kryefjala) si të thoje: “Ky është i ditur dhe ai ka qenë nderuar”.

Sa për përemrin vtor të veçuar **hum**, “ata”, përveç mbështetjes së kufizimit që aludon për ithtarët e Librit të cilët nuk besojnë në profetin a.s.m., ai përmban një pikë të hollë e cila është kjo:

**Hum**, “ata” duke u vendosur midis kryefjalës dhe kallzuesit, e ndryshuan kryefjalën e kallzuesit të vetëm me shumë kallzues. Njëri përmendet dhe pjesa e mbetur -e tjetrit- i referohet imagjinatës.

Sepse **hum**, “ata” e zgjon imagjinatën përfaktin se kallzuesit nuk janë përkufizuar -përcaktuar- dhe e nxit atë të kërkojë kallzues të përshtatshëm. Ashtu si ti që mund ta vendosje Zejdin përpara dëgjuesit dhe të tjerrje e të tregoje shumë nga cilësitë e tij, duke thënë: Zejdi është i ditur, Zejdi është punëtor, është i zgjuar, ai ëshë ky; ai është ai; po ashtu duke thënë ‘*Ulāike*’, “ata” dhe pastaj duke vendosur

përemrin **hum**, Kurani lëviz e nxit imagjinatën me qëllim që nëpërmjet përemrit ajo të ngrihet, të arrijë e të kapë gjérat në përputhje me atributet e tyre. Për shembull, **muflihūne** ‘*Ata janë në (mbi) udhëzim*’. “*Ata do të kenë sukses*”, “*Ata do t'i shmangen zjarrit të xhehennemit*”, “*Ata do të fitojnë parajsën*”, “*Ata do të kenë sukses përf të arritur shikimin e bukurisë së Allahut xh.sh.*”, e kështu me rradhë.

Nyja shquese **el** përshkruan, paraqet realitetin, sikur të thonte: “Në qoftë se ti dëshiron të shohësh të vërtetën rreth atyre që do të kenë sukses, shiko në pasqyrën e ‘*Ulāike*’, “ata”, dhe ajo do ta paraqes atë përf ty”. Ose -qëllimi i saj- është që t'i specifikojë ata, sikur të thonte: “Ata përf të cilët ti ke dëgjuar se do të janë të shpëtuar, të suksesshëm,

në qoftë se dëshiron që t'i njohësh, shiko tek ‘*Ulāike*’, sepse ajo është (si janë ata)”.

Ose -qëllimi i saj është- përf të qartësuar atë që po deklarohet dhe përf ta bërë të vetëkuptueshme, si “*Validuhu el-abd*” [babai i tij është (një) skllav]; domethënë, fakti se babai i tij është një skllav -rob- është i ditur dhe i dukshëm qartë. (Sepse meqenëse duhet të kishte qenë i pashquar, ai u bë i shquar).

**المُفْلِحُونَ**  
Sa përf **muflihūne**, “*të suksesshmit (të shpëtuarit)*”, ajo është absolute me qëllim që ta bëjë atë të përgjithshme. Sepse Kurani u adresohet të gjitha klasave të njerëzve me aspiratat e tyre të ndryshme: disa prej tyre dëshirojnë të shpëtojnë prej zjarrit të Ferrit; të tjerët aspirojnë vetëm parajsën; të tjerët kërkojnë vetëm kënaqësinë Hyjnore; të tjerët duan vetëm shikimin e bukurisë Hyjnore; dhe kështu me radhë.

Kurani e ka vendosur atë në një formë absolute që ta bëjë të përgjithshme tryezën e mirësive të tij me qëllim që gjithkush të mund të marrë atë çfarë të pëlqejë.

\* \* \*

## VËRSETI 6

أَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا سَوَاءٌ عَلَيْهِمْ عَانِدُرُهُمْ أَمْ لَمْ تُنْذِرُهُمْ

*In-ne (e)l-ledhine keferu sevaún alejhim e endhertehum em lem tundshirkum là juëminúne.*

“Në tē vërtetë, pér ata që nuk besojnë është njësoj nëse ti i këshillon (paralajmëron) apo nuk i këshillon, ata nuk do tē besojnë”.

**Vendosja -pozicionimi- i saj (dhe lidhja me atë që e parapriu):**

Shqyrtoje këtë: Në botën e Atributeve të Tij të parapërjetshme, Qënia e Vetme ka dy manifestime, ato që i përkasin lavdisë së Tij dhe ato që i përkasin bukurisë së Tij. Nëpërmjet manifestimit të tyre në botën e atributeve ato shfaqen si hijeshia dhe zemërimi, dhe si mirësia dhe madhështia.

Pastaj duke u prirur e kthyer drejt botës së akteve, lindin zbukurimi dhe stolisja **تَحْلِيَةٌ** (*tahlija, tazjin*), dhe demonstrojnë se Krijuesi është krejtësisht larg dhe i përjashtuar nga atributet e krijesave **تَحْلِيَةٌ** (*tahlijah, tenzih*). Pastaj, duke u skalitur në botën e Ahiretit e cila është njëra nga botërat e veprave (*a'lem el-Athar*), mirëbërja -hijeshia-manifestohet si parajsa dhe si drita, dhe zemërimi manifestohet si Ferri dhe si zjarri. Pastaj duke u reflektuar në botën e përmendjes, *dhikri* (përmendja) ndahet në ‘*El-Hamda*’ dhe në ‘*tesbih*’ (lavdërim e lartësim). Pastaj duke u përfaqësuar në botën e ligjëratës, ato ndryshohen, bëhen të larmishme, në urdhëresë e ndalesë. Pastaj duke u vizatuar -pikturuar, pëershkuar- në botën e udhëzimit, ato ndahan në nxitje, në frenim (pengim), në qetësim (sihariq) dhe në paralajmërim. Dhe pastaj nëpërmjet manifestimit të tyre në ndërgjegjje, lindin shpresa dhe frika.

Dhe kështu me rradhë. Pér më tepër, është shenja e udhëzimit që tē ruajë balancën -ekuilibrin- midis shpresës dhe frikës, me qëllim që shpresa tē nxisë përpjekjen dhe punën, dhe frika tē pengojë tejkalinim e 108

caqeve, dhe që personi tē mos bie në dëshpërim duke e këputur shpresën nga Mëshira Hyjnore dhe tē zgjedhë mënyrën e qortueshme e tē dënueshme, dhe as tē ndjehet i sigurt se nuk do tē dënohet, dhe kështu pa kujdes, pa çarë kokën, shthurret e merr rrugë tē keqe. Pér shkak tē kësaj urtësie tē njëpasnjëshme, Kurani nuk nxit pa pengim-frenim, dhe nuk i lavdëron tē drejtët veçse e shoqëron këtë me qortimin ndaj mëkatarëve.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Pérse nuk ndodhet ndonjë lidhje këtu, midis këtij dhe vërsetit tē mëparshëm, ashtu si në vërsetin:

أَنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ \* وَأَنَّ الْفُجَارَ لَفِي جَحَّمٍ

“Vërtet që tē drejtët (e përkushtuar) do tē janë në lumi turi (në Xhennet)”.

*Dhe vërtet që mëkatarët (tē ligjtë) do tē janë në zjarrin flakërues (në Xhennennem).*<sup>1</sup>

*Ty do tē tē thuhej:* Një lidhëse është me vend, e saktë, në qoftë se lidhja (midis dy pjesëve të fjalisë që ajo lidh) është e goditur, dhe përshtatshmëria e lidhjes varet nga (të dyja pjesët duke qenë tē pajtueshme dhe) duke ndjekur tē njëtin qëllim.

Por pér shkak se qëllime tē ndryshme janë duke u ndjekur këtu (në këtë vërset dhe në atë tē mëparshmin) lidhëzja nuk u vlerësua e përshtatshme. Sepse lavdërimi i besimtarëve çon dhe është parathënie pér lavdërimin e Kuranit; është rezultati i tij, dhe nxitet e shtyhet pér tē. Ndërsa qortimi ndaj jobesimtarëve është me qëllim që t'i pengojë e t'i frikësojë, dhe nuk është prelud -hyrje- pér lavdërimin e Kuranit, nuk lidhet me lavdërimin e Kuranit.

**Tani shqyrto hollësitë në vendosjen e pjesëve tē këtij vërseti:**

Së pari familjarizohu me (pjesëzën intensive) ‘*in-ne*’, ‘*Në tē vërtetë, sigurisht*’ dhe me (përemrin lidhor) ‘*el-ledhine*’, ‘*të cilët*’, sepse ato janë më endacake e shëtitëse se çfarëdo që ti has në Kurani në stacionet e rrugës së shpalljes. Pér ndonjë arsyé apo tjetër, Kurani i

<sup>1</sup> Kur'an, 82:13-14

përmend ato të dyja shpesh, sepse përveç pikave të holla që ato shprehin veçanërisht përvendet që ato përdoren, ato përbajnjë dy hollësi të përgjithshme nga xhevahiret e elokuencës.

Është veçori e pjesores انِّي *in-ne'*, “Në tē vërtetë, sigurisht” të shpojë - çajë- sipërfaqen, dhe të gërmojë, kërkojë, të vërtetën. Dhe t'i mbërthejë brenditë dhe qëllimet e fjalisë së tij me të, sikur ajo të ishte rrënja e çështjes e lidhur me të vërtetën, -sikur të ishte rrënja dhe mbytet e ngulitet në të vërtetën. Për shembull, “Në tē vërtetë, ajo është kështu”. Domethënë, ajo që po deklarohet nuk është imagjinare, as e sajuar, as subjektive dhe as e porsashpikur; por ajo është një e vërtetë e qëndrueshme.

(Gramatikanët) thonë se -qëllimi i- انِّي *in-ne'*, “Në tē vërtetë, sigurisht” është të vërtetojë apo të konfirmojë faktet (*fîl-tahkîf*), dhe prandaj ajo shpreh e tregon këtë fakt dhe këtë veçori. Pika e veçantë këtu është se

انِّي *in-ne'*, “Në tē vërtetë, sigurisht” zmbraps e largon dyshimin dhe mohimin, megjithëse ato të dyja mungojnë krejtësisht tek profeti a.s.m., i cili ishte i adresuari; prandaj ajo aludon për dëshirën e fortë e të papërbajtur të profetit a.s.m. që (mohuesit) të besonin.

Sa për الَّذِينَ *el-ledhîne*, “të cilët”; dije se është veçori e (përemrit lidhor) الَّذِينَ *el-ledhî* “*i cilî*” të tregojë një të vërtetë të re dhe të çuditshme të cilën e percepton mendja para syrit, e cila nuk është e theksuar por e lindur nga një kombinim gjérash. Për këtë arsyë ju do ta shihni se midis pjesëzave dhe përemrave të demonstrimit, përemri lidhor është më i lehti në gjuhët dhe më e përdorshmjë përvë shprehur e treguar ndryshimin dhe ripërtëritjen e të vërtetave subjektive.

Sepse kur u shfaq ai i cili do t'i vërtetonte të vërtetën dhe realitetin, domethënë Kurani, disa gjëra (*enwa sh. i neuë*) u shfuqizuan dhe u zhdukën, dhe gjëra të tjera u formuan dhe të vërteta të reja lindën.

Shikoje periudhën e injorancës, se si lidhjet sociale (*anwa*) bazoheshin mbi lidhjet nacionale, dhe të vërtetat shoqërore bazoheshin mbi tribalizmin? Pastaj kur erdhi Kurani, i këputi ato lidhje dhe i

shkatërrroi ato gjëra, dhe themeloi lidhje të tjera (*enwaë*) në vend të tyre, lidhjet e fesë. Tani reflekti mbi këtë! Kur lindi Kurani duke shndritur mbi llojin njerëzor, zemrat u lulëzuan dhe u bënë të frutshme nëpërmjet dritës së tij, dhe një e vërtetë e ndritshme u prodhua, e cila ishte klasa (*neue*) e besimtarëve. Pastaj për shkak të mbrapshtisë së tyre, disa shpirtëra u prishën, u kalbëzuan përballë asaj drite dhe një e vërtetë helmuese u lind, karakteristika e veçantë e klasës së mohuesve - الَّذِينَ *El-ledhîne*, “të cilët” në këtë vëerset dhe asaj (në versetin 3) ndodhet gjithashtu një reciprokësi (për shkak se të dyja tregojnë një të vërtetë e cila është e kundërtë e tjetrës).

Dije se ashtu si nyja shquese الَّذِي “*El*”, përemri lidhor përdoret përvë shprehur pesë kuptime, më i njohuri i të cilëve është të shprehurit e tij diçka të njohur (*al-ahd*).

الَّذِينَ *El-ledhîne*, “të cilët” këtu aludon përmohuesit e shquar si Ebu Xhehli, Ebu leheb dhe Umejje Ibn Khalef të cilët vdiqën në një gjendje mosbesimi. Prandaj nga kjo anë, vërseti jep njoftim rrëth botës së padukshme (është një parashikim i së ardhmes).

Shembujt e kësaj janë shkreptima prej të cilave lind një lloj i mrekullisë prej katër llojeve të mrekullisë ose të paimitueshmërisë që u përket kuptimeve të Kuranit (*el-ixhaz el-manevi*).

كُفَّارٌ *keferû*, “*mohojnë, nuk besojnë*”, dije se mosbesimi është errësirë, duke u përbërë nga mohimi i diçkaje të sjellur nga profeti a.s.m., pasi të ketë pasë njohje të sigurt përvë.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Kurani është prej esencave të fesë, meqithatë ka patur kundërshtime rrëth kuptimeve të tij?

*Ty do tē tē thuhej:* Në çdo pjesë të Kuranit ndodhen tre fjali (ose në çdo fjalë të Kuranit ndodhen tre çështje):

*E para:* Kjo është Fjala e Allahut

**E dyta:** Kuptimi i tij i synuar është e vërteta. Është mosbesim t'i mohosh këto të dyja.

**E treta:** Kuptimi i tij i synuar është ky.

Në qoftë se kjo fjalia e fundit është e pakundërshtueshme ose e shpjeguar, është *vaxhib* -e detyrueshme- të besosh në të sapo njeriu të informohet për këtë; dhe ta mohosh atë është mosbesim.

Në qoftë se ajo do të ishte e qartë ose është një vërset që ka një kuptim tjetër të mundshëm, nuk është mohim (*kufri*) ta mohosh atë meqë ai është i hapur për interpretim.

Megjithatë, interpretimi nuk duhet të mbështetet mbi tekat personale. Hadithet e raportuara me unanimitet, janë të njëjtat si vërsetet Kuranore në këtë vështrim, por ama ku ndodhet mohimi i fjalisë (ose i çështjes) së parë me hadithet, këto duhet të shqyrtohen me kujdes e vëmendje. (Domethënë, vërtetësia e hadithit dhe unanimiteti lidhur me të duhet të shqyrtohen me kujdes.)

- **Në qoftë se ti do të pyesje:** Mosbesimi -mohimi- është injorancë, megjithatë në Kuran thuhet:

*"Ithtarët e librit e njohin mjafit mirë atë (Muhammedin a.s.m.) ashtu siç njohin bijtë e tyre,"<sup>2</sup> si mund të pajtohen këto dy pohime?*

*Ty do të tē thuhej:* Ndodhen dy lloje mosbesimi.

*I pari* është për shkak të injorancës; një njeri mohon për shkak se ai nuk njeh. *I dyti* është kryeneç; njeriu e di, e njeh por nuk e pranon; është i sigurt por nuk beson; ai e afirmon, e vërteton, por ndërgjegjja e tij nuk nënshtrohet.

Mendo me vëmendje rreth kësaj.

- **Në qoftë se ti do të pyesje:** A ka në zemrën e shejtanit njohje rreth Allahut?

*Ty do të tē thuhej:* Jo, për shkak të gjendjes së tij të bashkëlindur zemra e tij është vazhdimisht e preokupuar me futjen e njerëzve në

<sup>2</sup> Kuran, 2:146

rrugë të gabuar, dhe mendja e tij vazhdimisht mendon për mosbesimin dhe për ta ngulitur atë tek të tjerët. Ai kurrë nuk pushon së vepruari kështu. Ideja e mosbesimit kurrë nuk e lëshon kokën e tij, që njohja rreth Allahut të mund të vendosej në të.

- **Në qoftë se ti do të pyesje:** Mosbesimi -mohimi- është një atribut i zemrës, atëherë si mund të vishet 'zunnari'<sup>3</sup> dhe kapelja me strehë, e cila është krahasuar me të, të jenë mosbesim?

*Ty do të tē thuhej:* Sheriati njeh e pranon shenjat e jashtme për çështjet e fshehura; ai madje pranon, i njeh shkaqet e jashtme që nuk kanë arsy (il-la) si arsy. Kështu meqenëse brezat e pengojnë për t'u përkultur -për të rënë në ruku- në falje dhe disa kapelle pengojnë sexhden e plotë, atëherë ai e vlerëson veshjen e tyre si një arsy për mosbesim. Sepse të dyja ato nënkuptojnë heqjen dorë nga adhurimi dhe imitim iñ mosbesimtarëve, duke treguar e shprehur vlerësimin e këndvështrimit të tyre dhe të kombësisë. Kështu, përderisa çështja e fshehur nuk kundërshtohet -nuk hidhet poshtë- në mënyrë vendimtare, gjykimi bëhet në përputhje me shenjat e saj të jashtme.

- **Në qoftë se ti do të pyesje:** Në qoftë se nuk kanë paralajmërim, përsë njerëzit duhet të mbajnë përgjegjësi?

*Ty do të tē thuhej:* Për shkak të hedhjes poshtë argumentet e tyre dhe justifikimet. (Sepse ata mund të thonë: Ne nuk na është thënë se do të mbanim përgjegjësi, dhe nuk kishim njohuri rreth saj. Dhe kjo do të mund t'i shpëtonë ata prej dënimit).<sup>4</sup>

- **Në qoftë se ti do të pyesje:** Meqenëse mohimi i tyre kryeneç është parashikuar -parathënë- kjo do të thotë se ata janë të ndaluar nga të besuarit, atëherë a nuk është e pamundur për t'i mbajtur ata përgjegjës?

*Ty do të tē thuhej:* As parashikimi, as njohja Hyjnore dhe as dëshira nuk lidhen me mohimin -mosbesimin- e tyre në mënyrë të pavarrur e të këputur nga shkaku. Përkundrazi, ata janë lidhur me *kufrin* -mohimin- e tyre nëpërmjet dëshirave -vullnetit- të tyre (*ihtjar*).

<sup>3</sup> Al-zunnar- një brezare e veshur nga të krishterët e lindjes, hebrenjtë dhe magusët.

<sup>4</sup> Nursi, Isharatul Ixhaz (Abdul Mexhid) 74

Ndodhet një diskutim i detajuar pér këtë në vijim. Dhe pér këtë arsyé thuhet: Obligimi i (imponuar nga) vullneti (zgiedhja, dëshira) nuk e kundërshton vullnetin”.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* A nuk do tē ishte e mundur me arsyé që ata tē besojnë në vërsetin që deklaron se ata nuk do tē besojnë? Kështu a nuk është kjo një kontradiktë -kundërshti- në shprehje?

*Ty do tē tē thuhej:* Ata nuk po urdhërohen që tē besojnë në çdo detaje tē Kur'anit që ajo tē bëhej e pamundur.

Pastaj, folja **كَفَرُوا** “*keferū*” (“*tē cilēt*) *mohuan*” duke qenë në kohën e kryer nënkuption se ata e zgjodhën mosbesimin -mohimin- pasi e vërteta ishte bërë e qartë, prandaj nuk vlen paralajmërimi.

Sa pér **سَوْأَةٌ** “*sevaun*” “*është njësoj*”, kjo është një metaforë që ka kuptimin dhe shpreh: Paralamërimi yt është si mosparalajmërimi.

Sido që tē jetë, e kotë apo tē ketë rezultatin e dëshiruar, është njëlloj nëse i këshillon ata apo nuk i këshillon. Domethënë, nuk është e domosdoshme pér ty, nuk ka arsyé pér ty që t'i paralajmërosh apo që tē mos i paralajmërosh.

Sa pér **عَلِيُّونَ** “*alejhim*”, “*pér ata, mbi ata*”, në këtë është një shenjë se ata do tē mbeten e qëndrojnë në tokë, por as nuk do t'i ngrejnë kokat e tyre dhe as nuk do t'i vënë vesh fjalës së Urdhëruesit -Udhëheqësit tē tyre. Ajo gjithashtu nënkuption: “Por nuk është njëlloj, e njëjtë pér ty (o Muhammed si t'i këshillosh apo tē mos i këshillosh), sepse ti do tē kesh shpërblime, mirësi pér përcjelljen e mesazhit; vërtet “*Detyra e tē dërguarit është vetëm që tē bëjë tē njohur (mesazhin)*”.<sup>5</sup>

Sa pér **عَانِدَرَتْهُمْ أَمْ لَمْ تَنْذِرْهُمْ** “*e endhertehum em lem tundhirhum*”, “*nëse ti i këshillon (paralajmëron) apo nuk i këshillon*” hemzeja **‘e’** dhe **‘em’** (ose) këtu janë si shkronja duke shprehur ‘*sevaun*’ tē njëjtën, njëlloj, dhe e

<sup>5</sup> Kuran, 5:99

mbështesin **سَوْأَةٌ** ‘*sevaun*’ e parë (në frazën e parë tē vërsetit) ose (qëllimi i tyre) është pér tē drejtuar vëmendjen pér tek dy kuptimet e saj që u përmendën lart.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* pérse është shprehur kjo ‘njëjtësi’ në formën pyetëse (*suret el-istifham*), (domethënë, ‘*E*’ e “*endhertehum*”).

*Ty do tē tē thuhej:* Në qoftë se ti dëshiron ta zgjosh personin tē cilit i adresohesh në mënyrë tē hollë e bindëse pér faktin se ajo çfarë ai po bën është e kotë, ti duhet ta pyesësh atë, që tē tërheqësh vëmendjen e tij pér aktin e tij. (Pastaj) ai mund tē kalojë me mendje nga akti pér tek rezultati i tij dhe ndihet i qetë, i sigurt.

Gjithashtu është një lidhje midis formës pyetëse dhe njëjtësisë, pér shkak se pyetja e përban atë. Sepse pérderisa pyetësi e di, është e njëjtë, njëlloj, nëse gjëja, pér tē cilën ai pyet, ekziston apo nuk ekziston. Pér më tepër, shumë shpesh përgjigjja gjithashtu nënkuption njëjtësi.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* pérse është shprehur paralajmërimi “*endhertehum*”, “*nëse ti i këshillon (paralajmëron), (i këshilluar)*” në kohën e kryer?

*Ty do tē tē thuhej:* që ajo tē mund tē shpallë: “Ti e ke provuar atë përpara, o Muhammed! Prandaj dije atë që do tē ndodhë!”

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Pérse e përmendi **أَمْ لَمْ تَنْذِرْهُمْ** “*em lem tundhirhum*”, “*apo nuk i këshillon*” megjithëse padobishmëria -kotësia- e mosparalajmërimit është e qartë?

*Ty do tē tē thuhej:* Ashtu si paralajmërimi që mund t'i shkaktonte një personi tē shtojë kryeneçsinë e tij, po ashtu qëndrimi i heshtur mund ta nxisë atë tē mendonte drejt, në mënyrë tē paanshme.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Pérse, ndonëse profeti a.s.m. është edhe përgëzues (sihariques)edhe paralajmërues, ky vërset vetëm paralajmëron dhe frikëson?

*Ty do tē tē thuhej:* Pér shkak se frikësimi -kërcënimi- është i përshtatshëm pér mosbesimin; dhe pér shkak se tē zembrapsësh dhe tē

largosh dëmin është më e preferueshme se sa térheqja e dobive dhe më e efektshme; dhe pér shkak se frikësimi këtu i shkakton imagjinatës të dridhet dhe e bën atë të kuptojë se pas fjalëve **لَا يُؤْمِنُونَ** “*lā juēminūne*”, “*ata nuk do tē besojnē*” do të pérballat me “sidoqë, t’i sihariqosh ata, ose të mos i sihariqosh (është njëlloj pér ta)”.

Dije se çdo fjalë ka një kuptim të mirëfilltë dhe një qëllim të fshehur. Kjo fjalë gjithashtu ka qëllime të holla fluturuese, dhe një qëllim që zbulon, i cili është pér të lehtesar vështirësitet e profetit dhe pér t’i pakësuar vuajtjen, dhe pér ta ngushëlluar atë dhe pér ta këshilluar që të ndjekë profetët e mëparshëm. Sepse shumica qenë të adresuar ashtu si ky adresim. Madje Nuhu a.s. tha pasi mori një adresim të tillë: “...*Zoti im! Mos lér asnje prej mosbesimtarëve mbi tokë!*<sup>6</sup>

Pastaj, pér shkak se vërsetet e Kuranit u ngjasojnë pasqyrave reflektyuese ndërsjelltas, reciprokisht, dhe tregimet e profetëve janë si një aureolë rrëth hënës, ato shikojnë gjendjen e profetit a.s.m.; është sikur kjo pjesë të thonte: “ky është një ligj natyror Hyjnor që duhet me iu bindur”.

Duke e pasë bërë këtë analizë, dije se me të gjitha pjesët e tyre ky vërset dhe tjetri deri tek **وَلَمْ يَعْذَبْ عَذَابَ عَذَابِهِ** “*ve lehum adhabun adhim*”, “*Pér ta do tē këtë ndëshkjm tē madh*” janë shprehur kështu që ato të tregojnë e nënkuptojnë neverinë e mosbesimit dhe pérçimin e tij, dhe pér të shkaktuar urrejtje -krupë- ndaj tij dhe pér t’u pérfrikësuar prej tij në mënyrë të nënkuptuar, dhe pér t’i poshtëruar mosbesimtarët, pér t’i shënuar -dalluar- pér t’i trembur të tjerët prej tij, dhe pér t’i kërcënuar ata. Me fjalët e tyre këto vërsete shpallin se mosbesimi është një fatkeqësi e tmerrshme, humbja e mirësive të mëdha, fillimi, shenjat e para të dhimbjeve të forta, dhe zhdukja e kënaqësive të larta.

Ato deklarojnë në mënyrë të qartë se mosbesimi është më e neveritshmja e gjérave dhe më e dëmshmja e tyre, sa vijon:

Nëpërmjet frazës **كَفَرُوا** ‘*keferu*’, **مُهَاجِرُوا** “*mohuan*” në vend të **لَا يُؤْمِنُوا** “*lā juēminūu*”, **نُكْبَسُوا** “*nuk besuan*” tregon se pér shkak të mungesës së besimit të

<sup>6</sup> Kuran, 72:26

tyre ata kanë rënë në errësirën e mosbesimit, i cili është një fatkeqësi që prish pikërisht substancën e shpirtit të njeriut, dhe nënkupton se ai është burimi i vuajtjeve.

Dhe nëpërmjet frazës **لَا يُؤْمِنُونَ** “*lā juēminūne*”, “*nuk besojnē*” në vend të **لَا يَتَرَكُونَ الْكُفَّارَ** “*la jetrukune el-kufti*”, “*nuk e lënë mohimin*” tregon se pér shkak të kësaj humbje ata kanë humbur besimin e tyre, i cili është burimi i të gjitha lumburive.

Me frazën **خَتَمَ اللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ** “*Khateme All-llāhu ala kułubihim*”, “*All-llāhu ƙa vulosur zemrat e tyre*” tregon se duke u bërë mosbesues, zemrat dhe ndërgjegjjet e tyre, të cilat marrin jetë, gëzim, lumburi dhe arrijnë plotësim vetëm se nëpërmjet manifestimit të të vërtetave Hyjnore nëpërmjet dritës së besimit, bëhen si ndërtesa të rrënuara të shkretuara dhe si luzmim, vend i mbushur me parazitë e me gjëra të dëmshme.

Kështu dyert e tyre janë të mbyllura e të vulosura, dhe ata janë të shmangur. Ata janë lënë pér akrepa, gjarpërinj e kuçedra.

Me frazën **وَعَلَىٰ سَمْعِهِمْ** “*ve ala sem’ihiim*” “*dhe dëgjimin e tyre*”, ai tregon se pér shkak të mosbesimit të tyre ata kanë humbur mirësinë e madhe të dëgjimit, sepse kur drita e besimit -ndriçon- vazhdimisht prapa dhe informon veshin e tij, ai preket nga thirrjet e të gjithë botës dhe kupton klithmat e qënieve të saj. Ai dëgjon britmat e universit dhe kupton tesbihatet e tij. Madje, kur veshi dëgjon ligjëratën Hyjnore në rënkin e erës që fryn, krismën e rrufesë gjëmimtare të resë, refrenet -meloditë- e valëve të detit, britmat e kërcitjes së gurëve, kërcitjen e rënies së shiut, dhe këngët e zogjve cicërues, dhe kupton tesbihatet e tyre të larta, universi bëhet një orkestër e madhe pér të. Ajo shkakton në zemrën e tij një brengë të lartësuar dhe zgjon pasionin -mallëngjimin- në shpirtin e tij. Ai ndjehet i dëshpëruar tek kujtimi i shokëve dhe i të dashurve të tij, por ai është një dëshpërim i kënaqshëm tek mungesa e tyre. Nuk është se ai nuk ka shokë, të dashur, kështu ai është i turbulluar. Por kur veshi bllokohet nga mosbesimi, ai bëhet i shurdhët pér këto zëra, tinguj të kënaqshëm dhe ai nuk dëgjon asgjë prej universit pérveç vajtimeve të zisë dhe qarjeve të vdekjes. Kjo shkakton në zemrën e tij brengën prekëse të jetimit; domethënë, mungesën e të

dashurve; dhe vetminë e syrgjynosjes, domethënë, të qenurit pa pronar apo kujdestar. Për këtë arsy sheriati i gjykon si të ligjshme, të lejueshme disa tinguj -zëra që zgjojnë një dashuri- mallëngjim të lartësuar dhe një melankoli dashurie, dhe ai e shpall të paligjshme çdo gjë që prodhon emocione epsharake dhe një brengë të shumëvuajtur jetimi. Dhe atë që sheriati nuk e specifikon për ty, gjykoje vetë sipas efektit që ato kanë në shpirtin dhe në ndërgjegjjen tënde.

**Fraza** “*ve alà ebsàrihim Gishàvetun*” “dhe në sy kanë perde (e nuk shohin)” aludon për humbjen e një mirësie të madhe për shkak të mosbesimit të tyre. Sepse kur syri ndriçohet me dritën e besimit duke banuar prapa bebes së tij, drita e ndihmon dhe e lëviz, e shtyn përpara, dhe i gjithë universi bëhet si një kopsht për të i zbuluar me lule e huri.

Bebja e syrit bëhet një bletë duke flutuar andej këtej duke mbledhur prej atyre luleve lengun -esencën- e reflektimit, mendimit, familjaritetit, shoqërimit, dashurisë, dhe të përgëzimit -urimit.

Ajo e merr peshën e saj; e cila në ndërgjegjje transformohet në mjaltin e plotësimeve.

Por, në qoftë se, ruajna Zot, syri bëhet i zbehtë, i mekët dhe i shuar nëpërmjet mosbesimit, bota bëhet një burg në shikimin e tij, të vërtetat e saj fshihen prej tij, dhe universi bëhet një vend i shkretuar, duke i shkaktuar një dhimbje të thellë zemrës saqë e përmbyt krejtësisht ndërgjegjjen.

Për më tepër, me frazën وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ “*ve lehum adhàbun Adhimun*” “Për ta do të ketë ndëshkjm të madh” tregon një frut të pemës së Zekkumit të *kufrit* -mosbesimit- në botën tjetër, i cili është dënim i Xhehennemit dhe ndëshkimi i tmerrshëm i zemërimit Hyjnor.

Ndërsa لَا يُؤْمِنُونَ “*lā jueminūne*” “nuk besojnë” mbështet سواء “sevaún” ‘është njësoj’ duke shpjeguar mënyrën e njëjtësisë.

\* \* \*

## VËRSETI 7

خَتَمَ اللَّهُ عَلَى قُلُوبِهِمْ وَعَلَى سَمْعِهِمْ وَعَلَىٰ  
أَبْصَارِهِمْ غِشاوةً وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ

*Khateme All-lâhu alà kulsûbihim ve alà sem'ihiim ve alà ebsârihim Gishàvetun ve lehum adhâbun Adhimun.*

*All-lâhu ka vulosur (ka vënë vulën mbi) zemrat dhe dëgjimin e tyre, dhe në sy kanë perde (e nuk shohin). Për ta do të ketë ndëshkjm të madh.*

**Shqyrtoje** këtë: Në këtë pikë ne duhet të qëndrojmë për të dëgjuar se çfarë thonë dijetarët e *kelamit*, sepse një betejë e ashpër është zvilluar rrëth këtij vërseti ndërmjet Muëtezilitëve, Xheberitëve dhe Sunitëve -Ehli Sunneh vel-xhemah. Luftëra si kjo kanë tërhequr vëmendjen e vëzhguesve. Prandaj është e përshtatshme për të përmendur themelat -argumentet- kryesore me qëllim që të mund të përfitohet prej tyre. (Atëherë do të shihet se) shkolla sunite është rruga e drejtë, ndërsa të tjerat veç saj kalojnë ose në tepri ‘*ifrat*’ ose në mangësi ‘*tefrit*’.

**I pari:** Është vërtetuar se “Nuk ka veprues të efektshëm në univers përveç Allahut”. Atëherë nuk ka delegim fuqie -dhënie e pushtetit për të vepruar, përfaqësim.<sup>1</sup>

**I dyti:** “Allahu është i *Gjithurtë*”, kështu që thevabi -shpërblimi- dhe ndëshkimi nuk janë të kota apo pa urtësi. Prandaj nuk ka shtrëngim -detyrim. Ashtu si Uniteti Hyjnor -*teuhid*- që i godet Muëtezilitët në kraharor, po ashtu Allahu xh.sh. duke qenë i lirë prej elementeve antropomorfik (*tenzih*) u jep xheberitëve një goditje në gojë.

<sup>1</sup> Ashtu siç pohojnë muëtezilitët se njeriu i krijon vetë veprat e tij.

**I treti:** Çdo gjë ka dy aspekte: Aspektin e jashtem (*mulkijeh*), i cili ndonjëherë është i mirë dhe ndonjëherë është i keq. Forma të ndryshme ndërhyjnë -futen- në të me radhë, si ana e pasme e pasqyrës.

Aspekti i brendshëm (*melekutij-jeh*) shikon e orientohet tek Krijuesi. Ai është transparent -i tejdukshëm- në çdo gjë, si ana e përparme -fytyra- e pasqyrës.

Kështu krijimi i së keqes -shëmtuarës- nuk është e keqe, sepse krijimi i saj për sa ka të bëjë me anën e brendshme (*melekutijeh*) është e mirë. Krijimi i së keqes është për të plotësuar të mirën, prandaj në mënyrë indirekte ajo është e mirë. Atëherë mos u kushto vëmendje argumenteve të rreme -mashtuese- të Muëtezilitëve.

**I katërti:** *El-Hasil bil masdar*<sup>2</sup> është pasoja e emrit foljor, ashtu si vdekja (*El-hasil bil masdar*) që është pasoja e vrasjes (*katl*- emër foljor) dhe si dhimbja (*el-hasil bil masdar*) që është pasoja e një goditjeje (*darb* -emër foljor). *El-Hasil bil masdar*, pasoja e një emri foljor është diçka e fiksuar, e kriuar, e pajetë (pa gjallëri), dhe atributet nuk mund ta kenë prejardhjen prej tij.<sup>3</sup>

Sa për emrin foljor, ai është i fituar (*meksub*), relativ (*nisbija*) dhe hipotetik (*iitibarij*) dhe atributet mund ta kenë prejardhjen prej tij. Kështu, Krijuesi i vrasjes (*katl*) nuk mund të jetë vrasësi (*ka'til*). Prandaj lëri Muëtezilitët të zhytur në bisedën e tyre të kotë e pa seriozitet.

**I pesti:** Aktet e jashtme -të dukshme- janë përgjithësisht rezultati i radhës -njëpasnjëshmërisë- së akteve që përfundojnë në prirjen e njeriut (*mejelan*), e cila quhet vullnet (*el-xhuz el iħtijari*). Dhe rrëth këtij themeli e kësaj pike vërtiten debatet e diskutimet.

**I gjashti:** Është praktika -zakoni- i Allahut xh.sh. që vullneti - dëshira- e Tij universale të shikojë vullnetin -dëshirën- e pjesshme të robit të Tij. (Domethënë, ajo manifestohet në përputhje me dëshirën e robit), kështu nuk ka shtrëngim, detyrim.

<sup>2</sup> Si dhimbja dhe vdekja që ndodhin -shkaktohen, rezultojnë- nëpërmjet goditjes dhe vrasjes.

<sup>3</sup> Domethënë, pjesorja aktive nuk mund ta ketë prejardhjen nga diçka e pajetë (xhamid), ashtu siç është e mirënjohur në gramatikë (*ilm el sarf*).

**I shtati:** Njohja është e varur nga gjëja e njohur; gjëja e njohur nuk është e varur nga njohja, përndryshe ai do të ishte një argument rrotullor (rrethor). (Nuk e ndjek atë gjëja e njohur që të rrotullohet, kështu njeriu nuk mund të kérkojë shfajësimë lidhur me (ose të mos pranojë përgjegjësi për) aktet e tij duke ua atribuar shkallën dhe masën e tyre Kaderit Hyjnor (duke pretenduar se ato janë paracaktuar).

**I teti:** Krijimi i *El-hasil bil masdar* është i varur nga ‘fitimi’ i emrit foljor -*masdar*- nëpërmjet funksionimit të ligjeve Hyjnore në univers (*a'datull-llahi te'ala*) në përputhje me kushtet që Ai ka vendosur për të. Dhe bërrhama dhe forca jetike në fitimin e emrit foljor është prirja (*mejelan*), dhe kur kjo zgjidhet, thelbi -nyja- e çështjes zgjidhet.

**E nënta:** Preferanca (diçka duke qenë e preferuar) pa një shkak apo atribut që ta shkaktojë atë është e pamundur, por zgjedhja pa një shkak apo atribut që ta shkaktojë atë nuk është e pamundur. Kështu asnje qëllim (*garad*) apo shkak (*i'l-leh*) nuk është i domosdoshëm në aktet e Allahut xh.sh.; vepruesi i vetëm me zgjedhje (*muraxh-xhih*) është vullneti i Tij.

**I dhjeti:** Një çështje ekzistuese domosdoshmërisht duhet të ketë një veprues të efektshëm (*mueth-thir*) (për ta sjellë atë në ekzistencë), përndryshe do të ishte e domosdoshme preferenca pa një shkak apo atribut që ta shkakonte atë, gjë e cila është e pamundur, siç u tregua lart. Megjithatë një çështje teorike (*i'tibari*) (si vullneti njerëzor dhe prirja) mund të specifikohet (*teħas-sus*) pa një specifikues (*muhas-sis*); kjo nuk është domosdoshmërisht e pamundur. (Domethënë, meqenëse prirjet e njeriut nuk kanë një ekzistencë të jashtme, ato nuk kérkojnë një shkak.)

**I njëmbëdhjeti:** Një qenie duhet të jetë e domosdoshme që të vijë në ekzistencë; domethënë, një gjë nuk mund të vijë në ekzistencë në qoftë se ekzistenca e saj nuk është e domosdoshme; ekzistenca e saj bëhet e domosdoshme vetëm mbi lidhjen e dy dëshirave (vullneteve), dëshirës universale dhe dëshirës së pjesshme; dhe atëherë ajo ka ekzistencë menjëherë, në çast. Por gjërat teorike mund të jenë të preferueshme (*terexh-xhuh*) dhe mund të specifikohen pa arritur shkallën e domosdoshmërisë, kështu kjo nuk bën të domosdoshme një qenie të mundshme duke ardhur në ekzistencë pa një veprues të efektshëm (*mueth-thir*).

**I dymbëdhjeti:** Njohja se një gjë ekziston nuk bën tē domosdoshme njohjen e natyrës së saj; dhe mungesa e një njohjeje tē tillë nuk bën tē domosdoshme mosekzistencën e saj. Kështu, paaftësia pér tē përcaktuar natyrën e vërtetë tē vullnetit -dëshirës- nuk e kundërshton ekzistencën e saj tē sigurt.

Në qoftë se ti i ke kapur e kupuar këto parime, dëgjoje tani atë që do tē thuhet: Ne sunitët, *Ehli es-sunneh vel xhemaah*, themi: O müetezilit! Robi (i Allahut) nuk është krijuesi i *hasil bil masdar*; domethënë, nuk është krijuesi i rezultateve të akteve tē tij. Ai është vetëm *masdar* ose burim i akteve tē tij.

(Robi nuk ka në dorë veçse fitimin). Sepse nuk ka veprues efektiv në ekzistencë përveç Allahut”.

Uniteti Hyjnor -*teuhid*- e bën tē domosdoshme këtë. Pastaj ne themi pér xheberitët: Njeriu nuk është i detyruar -nën detyrim- sepse ai ka dëshirë tē pjesshme -vullnet tē lirë- (*xhuz'ë, iħtijarij*), sepse Allahu është i Gjithurtë. Pér më tepër, Qenia e Allahut i përjashtuar nga tē gjitha defektet e mangësitë e bën tē domosdoshme këtë.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Sa herë që tē zbërthehet dëshira e njeriut, (tē analizohet e t'i bëhet autopsia), e vtmja gjë që shfaqet prej saj është paracaktimi (*el-xhebr*)?

*Ty do tē tē thuhej:*

**Së pari:** Ndërgjegjja dhe natyra e brendaqenësishme që tē dyja dëshmojnë pér diçka tē pakapshme që i dallon midis një çështjeje tē vullnetshme dhe një çështjeje tē detyrueshme, dhe ekzistenca e së cilës është e sigurtë. Por ne nuk jemi në gabim në qoftë se nuk mund ta përcaktojmë a përkufizojmë atë.

**Së dyti:** Ne themi se në qoftë se prirja (*mejelan*) është diçka ekzistuese, -ashtu siç pretendojnë Asharitë- atëherë zgjidhja -vendosja- pér tē do tē ishte se ajo është një çështje teorike dhe i përket njeriut. (Domethënë, duke ndryshuar nga njëri akt pér tek një tjetër). Por në qoftë se prirja është një çështje teorike -ashtu siç thonë materialistët- atëherë ekzistenca e saj (*thubut*) dhe qenia e saj e specifikuar (*teħas'sus*) nuk kërkojnë një shkak tē domosdoshëm (*el-il-letul-tammetul muxhibeh*), (meqë nuk mbetet nevoja pér dëshirë universale).

(Domethënë, shumë shpesh asnë veprim nuk ndodh me ndodhjen e prirjes. Kështu, nuk ka detyrim.) Mendo rrëth kësaj me kujdes!

**Shkurtazi:** El *Hasil bil Masdar* është i varur në përputhje me ligjet e praktikës Hyjnore në Univers, tek *Masdari* ose burimi, baza e tē cilit është prirja (*mejelan*). As vetë prirja -apo vendosja nē tē- nuk kanë ekzistencë (tē jashtme) që duke u aplikuar kjo mënyrë apo ajo, ajo duhej tē ishte një qenë e mundshme dhe t'i duhej një veprues efektiv, apo që duhej tē kishte qenë preferenca pa diçka që ta shkaktonte. Gjithashtu, as prirja dhe as vendosja -dispozicioni i saj- nuk janë mosekzistuese që tē mos ishin përgjegjëse pér qenien një kusht pér krijimin e *El-Hasil bil Masdar*, ose një shkak pér shpërblim apo ndëshkim.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* A nuk e shkulin dhe a nuk e zhdukin Njohja e Parapërjetshme dhe Vullneti i Parapërjetshëm vullnetin e lirë?

*Ty do tē tē thuhej:* Njohja e një akti tē vullnetshëm nuk e mohon vullnetin. (Sepse vepruesi efektiv është fuqia dhe jo njohja, që është e varur nga gjëja e njohur.)

Gjithashtu, njohja e parapërjetshme është gjithëpërfshirëse si qelli, ajo nuk është fillimi i një zinxhiri apo pikenisja e kohës së shkuar që efektet -pasojat- t'i atribuoheshin gabimisht asaj duke shpërfillur -duke mos marrë parasysh- shkaqet e tyre.

Gjithashtu, njohja është e varur nga gjëja e njohur -domethënë, (e varur) nga si është gjëja e njohur. Njohja gjithashtu e rrethon -e përfshin atë- kështu masa dhe kriteri i gjësë së njohur nuk bazohen mbi parimet e Kaderit Hyjnor.

Gjithashtu, Vullneti Hyjnor nuk lidhet vetëm me pasojën një herë dhe me shkakun një herë tjetër, duke i bërë vullnetin dhe shkakun tē paafektshëm e tē padobishëm; përkundrazi ai lidhet njëherësh me pasojën dhe shkakun e saj. Si rrjedhojë e kësaj, në qoftë se pér shembull, një person vret një tjetër me një pushkë, dhe pastaj ne do tē supozonim mungesën e shkakut dhe tē gjuajtjes, a do tē kishte vdekur ai person në atë moment apo jo?

**Xheberitët thonë:** Ai do tē kishte vdekur dhe në qoftë se nuk do tē kishte qenë vrarë. Sepse ata pohojnë se vullneti Hyjnor i trajton

shkakun dhe pasojën veç e veç, ndarazi, dhe se ndodhet një ndarje midis tyre.

Muëtezilitët thonë: Ai nuk do tē kishte vdekur. Sepse sipas tyre është e lejueshme që pasoja (ajo që u synua) mund tē mbetet prapa Vullnetit Hyjnor.

Sa pēr sunitët, Ehli es-Sunneh vel-xhemaah, ata thonë: Ne e ndërpresim (diskutimin dhe) rrimë tē heshtur sepse tē supozosh mungesën e ndonjë shkaku bën tē domosdoshëm supozimin se vullneti Hyjnor dhe njohja Hyjnore nuk janë tē lidhura me pasojën. Ndërkohë që Vullneti dhe njohja i shikojnë ato njëherësh së bashku. Ky supozim i rremë bën tē domosdoshme një pamundësi. Mendo rreth kësaj me vëmendje!

\* \* \*

## NJË PARATHËNIE E DYTË

Shqyrtoje këtë: Natyralistët thonë se shkaqet kanë një efekt tē vërtetë. Zoroastrianët thonë se e keqja ka një krijues tjetër, dhe Muëtezilitët pranojnë se qëniet e gjalla i krijojnë vetë aktet e tyre tē vullnetshme. Të trija këto bazohen mbi një ide tē rreme e tē mashtruar, ato janë thjesht një gabim i pastër, janë një tejkalim i limitit, dhe janë analogji tē rreme që i kanë mashtruar -ata njerëz- dhe i kanë çudhëzuar. Sepse duke vazhduar prej këtyre pohimeve ata e kanë dekluaruar Allahu tē lirë prej elementeve antropomorfikë (*tenzih*), ose kështu ata e supozuan, dhe kanë rënë në kurthet e shirkut -të përshkruarit ortakë me Zotin xh.sh..

Në qoftë se dëshiron tē mësosh detajet, dëgjoji çështjet e mëposhtme, të cilat gjithashtu i largojnë mashtimet e tyre.

**E para:** Ashtu si dëgjimi i njeriut, ligjërimi, vështrimi dhe mendimi i tij që tē gjitha janë tē pjesshme, dhe ai mund t'i marrë gjërat vetëm një në një herë me radhë; po ashtu aspirata e tij është e pjesshme dhe ai mund ta preokupojë vetveten me gjërat veçse me radhë (me ndërresa).

**E dyta:** Vlera e njeriut është në përpjesëtim e harmoni me atë që është. Dhe ajo çfarë ai është ka vlerë me shkallën e aspiratës së tij. Dhe aspiratat e tij janë tē vlefshme në lidhje me rëndësinë e qëllimeve të cilave ai ua ka përkushtuar vetveten.

**E treta:** Njeriu e asgjëson vetveten tek cilado gjë që tē orientohet dhe tek e cila drejton vëmendjen dhe burgoset në tē. Pēr shkak tē kësaj, ju e shikon se në jetët e tyre tē përditshme, njerëzit nuk ua atribuojnë gjërat e ulëta dhe çështjet e pjesshme e tē papërfillshme personave tē mëdhenj e tē lartë, por shkaqeve dhe ndërmjetësive. Ata supozojnë se kjo do tē ishte e papërshtatshme pēr dinjitetin e tyre që ata tē preokupoheshin me gjëra tē pjesshme dhe se nuk do ta ulnin veten tek gjëra tē tillë, dhe as nuk do t'i harxonin përpjekjet e tyre mbi gjëra që s'kanë rezultat; vogëlima tē tillë do tē ishin tē pabarabarta me ambicjet e tyre tē gjëra.

**E katërtë:** Është karakteristikë e njeriut se kur ai reflekton mbi diçka me qëllim që ta peshojë atë, ai para së gjithash kërkon kriterin pēr tē dhe lidhjet dhe parimet e saja në veten e tij; pastaj në bijtë e llojit

të tij -në qeniet e tjera humane; dhe në qoftë se ai nuk mund t'i gjejë ato atje, në qeniet e tjera të mundshme përreth tij.

Madje kur ai shqyrton rrith Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, i Cili kurrsesi dhe në asnje mënyrë nuk u ngjason qenieve të mundshme, aftësia e tij hamendësuese (*el-kuvvet el-wahima*) e detyron atë që ta marrë mashtrimin e keq të lartëpërmendur si parimin e tij, dhe ta përdorë atë analogji mashtruese si një teleskop; ndonëse Autori - Krijuesi- xh.sh. nuk mund të vëzhgohet nga kjo pikë, sepse fuqia e Tij nuk mund të përkufizohet.

**E pestë:** Fuqia e Tij, njojha dhe vullneti i Tij xh.sh. janë si drita e Diellit - “*Dhe për Allahun është më i larti krahasi*” . Ato përfshijnë gjithçka dhe i rrrethojnë të gjitha gjërat. Ato nuk mund të përkufizohen dhe as të krahasohen me ndonjë gjë. Ashtu siç shikojnë (*ta'al luk*) ato më të madhen e gjërave, si Fronin Hyjnor, po ashtu ato shikojnë edhe më të voglën e tyre, si atomin. Dhe ato ashtu siç krijojnë diellin dhe hënën, po ashtu ato krijojnë sytë e pleshit e të harrjes. Dhe ashtu siç kanë vendosur ato rregullin e lartë të universit, po ashtu ato vendosin një rregull -sistem- të hollë në zorrët e organizmave mikroskopikë. Dhe ato ashtu siç i kanë lidhur së bashku trupat qiellorë dhe yjet e varura pezull (në hapësirë) me ligjin e Tij të njojur si graviteti, po ashtu ato vendosin në rregull grimcat e vogëla nëpërmjet një ligji të njëpasnjëshëm, si shembuj infinitezimale (pambarimisht të vegjël) të tyre. Nëpërmjet ndërhyrjes së pafuqisë, shkallët e ndryshme ndodhin në fuqi. Kështu të gjitha gjërat janë të barabarta përparrë fuqisë së të Vetmit Unik për të Cilin pafuqia është e pamundur. Sepse pafuqia është e kundërtë e Fuqisë Esenciale.

**E gjashta:** Fuqia Hyjnore shikon së pari (*teal-luk*) tek fytyra e brendshme (*melekutijeh*) e gjërave, dhe kjo në të gjitha gjërat është transparente dhe e bukur, ashtu siç u diskutua. Po, Krijuesi xh.sh. ashtu siç e bëri fytyrën e diellit të shndritshme e të shkëlqyeshme dhe fytyrën e hënës të shkëlqyer, me dritë; po ashtu Ai xh.sh. e bëri fytyrën e brendshme të natës dhe të reve të bukura dhe të ndritshme.

**E shtata:** Mendja njerëzore nuk e ka gjëresinë dhe rrezen për të matur madhështinë e Allahut xh.sh., për të peshuar plotësitet e Tij, apo për të vlerësuar e gjykuar atributet e Tij. Kjo nuk është e mundur veçse

në një drejtim.<sup>4</sup> Ato mund të vlerësohen vetëm nga shuma e përgjithshme e artifakteve të Tij, dhe nga ajo që manifestohet prej të gjitha veprave të Tij, dhe nga ajo që mund të përmblidhet prej të gjitha akteve të Tij. Po, një atom mund të jetë vetëm një pasqyrë, dhe jo masë -njësi matjeje.

Në qoftë se ti i ke kuptuar këto çështje, dije se Ekzistuesi i Vetëm i domosdoshëm xh.sh. nuk mund të krahasohet me qeniet e mundshme, sepse ndryshimi është aq i madh si nga toka për tek plejadat. A nuk i shikon ti Natyralistët, Mu'ëtezilitët dhe zoroastrianët -mexhusët- që për shkak të sundimit të fuqisë të tyre të imaginatës së rreme e mashtruese me këtë krahasim në mendjet e tyre, ata u atribuan një efekt real shkaqeve, dhe krijimin e akteve kriesave të gjalla, dhe krijimin e të keqes dikujt tjetër veç Allahut xh.sh.? Me iluzionet dhe imaginatat e tyre ata pyetën se, si me madhështinë e Tij, me lartësinë dhe me qenien e Tij i lirë prej të gjitha të metave e mangësive (*tenez-zuh*), Allahu xh.sh. do të zbriste e ulej për t'i -krijuar- këto çështje të ulëta e gjëra të shëmtuara. U zhdukshin ata! Si ata e lidhën mendjen e tyre me një iluzion -mashtrim- të tillë të dobët? Por sa keq! Ky iluzion ka sunduar edhe mbi besimtarin gjithashtu nga aspekti i vesveses -pëshpëritjes djallëzore. Prandaj, ji i kujdesshëm për t'iu shmangur!

**Tani, sa për analizimin e fjalëve të këtij vërseti dhe pozicionimin e tyre:**

Dije se, fakti që **خاتمة**, ‘*ka vulosur*’ është e lidhur me **لا يؤمنون**, ‘*la juëminûne*’, ‘*nuk besojnë*’ dhe që vjen -menjëherë- pas kësaj, është si të bërit e ndëshkimit pasojën e veprimit, sikur ajo të thonte, “meqenëse ata i kanë prishur zgjedhjet -vullnetet e lirë- të tyre dhe nuk besuan, ata u ndëshkuan me vulosjen dhe bllokimin e zemrave të tyre.”

Fjalët **خاتمة**, “*ka vulosur*” gjithashtu tregojnë një metaforë të përbërë, e cila aludon për krahasime parabolike (me shembelltyra, alegori) si një figurë -letrare- (*uslub temthili*), e cila -me radhë- shpreh

<sup>4</sup> Domethënë mendja e njeriut mund t'i përfshijë Artibutet Hyjnore veçse në atë shkallë që një person mund të fitojë njojuri për to nëpërmjet vëzhgimit të veprave Hyjnore.

një proverbë duke piktuar e përshkruar çudhëzimin e tyre, sepse ajo çfarë ajo shpreh e tregon është e vërteta duke u penguar nga depërtimi në zemër.

Termi **ختم** “*khatem*” “*Vulos, tē vulosurit*” e portretizon, e përshkruan zemrën si një shtëpi të ndërtuar nga Allahu xh.sh. që ajo të jetë një thesar plotë xhevahirë. Por për shkak të keqpërdorimit të zgjedhjes -vullnetit të lirë- ajo është bërë e prishur dhe e kalbëzuar, dhe çfarë ajo përmban është helmuese; kështu ajo është mbyllur e vulosur, për ta bërë të shmangur.

Sa përfjalë **الله** “*Allah*”, dije se përdorimi i (emrit të përveçëm në vend të përemrit të vetës së parë) do të thotë dhe shpreh një kthim (*iltifat*) nga veta e parë për tek e treta. Kjo përmban një pikë të hollë që i përket lidhjes së synuar -*bin-nijeh-* të fjalës “*Allah*” me **لَا** *juëminu*’, ‘(ata) nuk besojnë’; unë dua të them se e nënkuptuara në Allah tregon kuptimin e hollë vijues: kur drita e njoħħes së Allahut u erdhia atyre, ata nuk e hapën derën e zemrave të tyre për tē, kështu Ai u largua me zemërim prej tyre dhe e mbylli derën mbi ta.

**ختم: على** ‘*alà*’, ‘*mbi*, ‘*në*’ me foljen kalimtare ‘*khatama*’, ‘*vulosi, ka vulosur*’ sugjeron se folja përfshin kuptimin e vulosjes -damkosjes, sikur ajo të thonte: Allahu ka vënë vulosjen mbi zemrat e tyre, duke i damkosur e duke u vënë shenjë atyre që melekët t’i shohin ato. Gjithashtu **على** ‘*alà*’, ‘*mbi*, ‘*në*’ sugjeron se është dera e lartë e zemrës që është bllokuar, dhe jo dera e saj e ulët e cila shikon tek kjo dynja.

Fjala ‘*kuʃubihim*’, *dhe (Allahu ka vënë vulen mbi) zemrat e tyre*’ paraprindëgjinim dhe shikimin për shkak se ajo është vendi i besimit, dhe për shkak se dëshmitë e para të Autorit manifestohen prej konsultimit të zemrës me vvetveten, dhe nga ndërgjegjja duke iu referuar gjendjes së saj të natyrshme. Sepse kur një person konsultohet me vvetveten, ai ndjen një pafuqi të fortë gjë e cila e shtyn atë të kérkojë një pikë mbështetjeje, dhe ai sheh nevojën e tij të bujshme për të përbushur

shpresat e tij dhe detyrohet të gjejë një burim ndihmë. Por nuk gjendet as mbështetje dhe as ndihmë veçse në besim.

Ajo çfarë synohet me zemrën është aftësia e hollë Hyjnore -dhe jo copa e mishit që ka formën si një boçe pishe- emocionet e së cilës manifestohen në ndërgjegjje dhe mendimet e së cilës reflektohen në mendje. Termi ‘*zemër*’ tregon se aftësia e hollë Hyjnore është për dimensionet shpirtërore të njeriut, si copa e mishit në formën e boçës së pishës që është për trupin.

Sepse ashtu si zemra fizike që është një makineri jetike që shpërndan eçon ujin e jetës tek të gjitha pjesët e trupit, dhe në qoftë se ajo do të bllokohej apo do të pushonte nga aktiviteti, (jeta largohet dhe) trupi ngrin, mpighet; po ashtu aftësia e hollë e brendshme shpërndan, jep dritën e jetës së vërtetë tek të gjitha pjesët e trupit të përbërë nga aspektet shpirtërore të njeriut, dhe nga gjendjet e tij (mendore), dhe nga shpresat. Dhe në qoftë se -Ruajna Zot!- drita e besimit do të shuhej, qenia e tij, me të cilën ai lufton me universin, bëhet si një fantazmë e palëvizshme e errët në têrësinë e saj.

**وَعَلَى سَعْدِهِ** **“ve alà sem’ifhim, “dhe (Allahu ka vënë vulen mbi) dëgjimin e tyre”...**

Përsëritja e **على** ‘*alà*’, ‘*mbi*, ‘*në*’ tregon se dëshmitë e secilës -aftësi-janë të pavurura. Sepse zemra (tregon Allahun) me dëshmitë e intelektit dhe të ndërgjegjjes, dhe dëgjimi (e tregon Atë) me dëshmitë nga Kurani dhe hadithi (*naklij*) dhe nga bota e jashtme. Përsëritja e saj gjithashtu aludon se vulosja e dëgjimit nuk është e tē njëjtë lloj si vulosja e zemrës.

Për më tepër, qenia e ‘dëgjimit’ në numrin njëjës pavarësisht pasjes shumësa në të dyja anët e saj (domethënë, zemra dhe sytë) është një shembull i thukëtisë, dhe gjithashtu përmban disa shenja:

Ajo aludon se si një emër foljor, (akti i) dëgjimit (*sem’*) (kryhet me veshin, i cili) nuk ka mbulesë (si një qepallë, kapak i syrit); dhe se ai i cili bën të dëgjojë (*musmi*) është njëjës; dhe se ajo që dëgjohet (*mes’muë*) nga secili person është njëjës; dhe se një person dëgjon një gjë në një kohë. Dhe ajo aludon se pjesëmarrja e tē gjithë atyre që

dëgjojnë, sikur veshët e atyre janë bashkuar duke u bërë një; dhe se unioni -bashkimi- i komunitetit dhe personifikimi i tij, gjë e cila e bën njeriun të imagjinojë se aftësia e tij e dëgjimit është njëjës; dhe se dëgjimi i një personi ndonjë gjë do t'i mjaftonte komunitetit. Për shkak të këtyre pikave, elokuanca e kërkoi 'dëgjimin' të jetë në njëjës. Ndërsa gjérat që u përkasin zemrave dhe syve janë të ndryshme, dhe mënyrat e tyre janë të ndryshme; dhe dëshmitë e tyre ndryshojnë, dhe ato marrin instruktim prej gjëresh të ndryshme, dhe gjérat që i nxisin e i shtyjnë ato janë të ndryshme. Për këto arsyen njëjësi ndërhyn midis dy shumësve. Zemra ndiqet nga dëgjimi për shkak se dëgjimi formon karakterin e zemrës (domethënë, informacioni i arrin zemrës kryesisht nëpërmjet kanalit të veshit), dhe ai është më i afërti me të. Gjithashtu, dëgjimi i ng Jason zemrës në atë që ai merr informacion nga gjashtë drejtime, (nga të gjitha anët, ndërsa sytë shikojnë vetëm para).

### وَعَلَىٰ أَبْصَارِهِمْ غَشَاوَةٌ

Sa për "ve alâ ebsârihim Gishavetun, "dhe në sytë e tyre kanë perde (e nuk shohin)", dije se ndryshimi i stilit, domethënë, zgjedhja e një fjalie emërore, tregon se në dallim (në kundërshtim) me kopshtet e dëgjimit dhe të zemrës, të cilët ripërtërihen vazhdimisht, kopshtet e syve, prej të cilëve ato mbledhin dëshmi, janë të qëndrueshëm e të vazhdueshëm.

Duke ia atribuar vulosjen Allahut xh.sh. dhe jo mbulimit -perdesë syve, kjo sugjeron se vulosja është ndëshkim për atë që ata kanë fituar, ndërsa mbulimi -perdja- është prej aktit të tyre.

Gjithashtu ajo është një shenjë se në fillim lidhur me dëgjinin dhe zemrën ka zgjedhje, ndërsa lidhur me shikimin, në fillim, ndodhet detyrim; domethënë, ka zgjedhje vetëm për zgjatjen e mbylljes së syve të njeriut.

Termi "Gishavet" "mbulim-perde" tregon se sytë shikojnë vetëm në një drejtim. Dhe përdorimi i trajtës së pasquar është për të treguar këtë; domethënë, shkaku i verbimit nuk është i njohur që të mund të shmanget.

وَعَلَىٰ أَبْصَارِهِمْ  
Vendosja përpëra e "ve alâ ebsârihim", 'dhe në sytë e tyre' është për të drejtuar vëmendjen për tek sytë e tyre, sepse sytë janë pasqyrë për sekretet e zemrës.

وَلَئِمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ  
Sa për "ve lehum adhâbun Adhîmun", "Për ta do të ketë ndëshkjm të madh", dije se ashtu siç aludon vërseti me këtë frazë për frutat e hidhur në këtë botë të pemës së mallkuar të mosbesimit; po ashtu ajo tregon frutin e hidhur të asaj ane të saj që shtrihet për në Ahiret, e cila është pema e Zekkumit të Ferrit.

وَلَئِمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ  
Gjithashtu, stili këtu kërkon një frazeologji të tillë si "we alejhîm ikabun shedid" 'mbi ta do të ketë një ndëshkjm të repte'. Sepse në fjalët zëvendësuese të përshtatshme për mirësi, domethënë, 'lehum', "për ta", për 'alejhîm', "mbi ta", dhe 'adhâbun', "ndëshkjm" për 'ikabun', 'dënim', dhe 'adhim', 'i madh' për 'shedid', 'i fortë, i repte' është një shenjë se ajo është një lloj qesëndie, mikluese e dënuese, sikur Kurani është duke thënë: "Dobia e tyre, kënaqësia e tyre dhe mirësia e tyre më e lartë nuk do të jetë veçse dënim". Kjo i ng Jason thënies: "pëershëndetja midis tyre do të jenë një

وَلَئِمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ  
goditje e dhimbshme", dhe vërseti, "Sihariqoji - njoftoi- ata për ndëshkjm e dhimbshëm."<sup>5</sup> Sepse 'le' e 'lehum', "për ta" tregon pasojat e veprimit dhe dobitë e tij, sikur ai reciton për ta (me tallje): "Merni shpërbilimet për çfarë keni bërë!"

وَلَئِمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ  
Në fjalën 'adhâbun', "ndëshkjm" (rrënja e së cilës gjithashtu mban kuptimet e të ëmbëlës, të këndshmes etj) është një aluzion i fshehtë duke u kujtuar atyre se ata kërkuan kënaqësi dhe gëzim në këtë botë nëpërmjet akteve të mëkatshme, sikur lexon dhe i njofton ata: Tani shijoni e provoni (frutat) e hidhur të jetës suaj të ëmbël!"

<sup>5</sup> Kuran, 3:21

Dhe nē fjalēn **عذاب** 'adħim', 'i madħ' ēshtē njē shenjē e fsheħtē duke u kujtuar atyre pér gjendjen e (njerézve tē) parajsēs tē cilēt marrin miresi tē mahnitħme tē stermēdhaja, sikur ai u thotē (me zē tē ulēt) atyre: "Shikojini mirēsitē e mēdhaja qē ju i humbēt pér veten tuaj, dha si ju keni rēnē nē vuajtje tē dhimbshme." **عذاب** 'Adħim', 'i madħ' gjithashtu pérforcon *tenvinin* -pashquarsinē- e **عذاب** "adħabun", "ndēshkimit".

- Nē qoftē se ti do tē pyesje:** Mēkati i mosbesimit vazhdon -zgħat-pēr njē kohē tē shkurtēr, por ndēshkimi i tij ēshtē i pérjetshem dha i pambarim; si pajtohet ky dēnim me drejtēsinē Hyjnore? Dhe nē qoftē se do tē pranohej kjo, si do tē pérputhej me urtēsinē e parapērjetħħme? Dhe nē qoftē se do tē pranohej edhe kjo, si do ta lejonte kētē Mēshira Hyjnore?

**Ty do tē tē thuhej:** Duke pranuar pafundēsinē e dēnimit; ēshtē e vērtetuar se mosbesimi i kryer nē njē kohē tē fundme -tē kufizuar- ēshtē nē għashtu pérjetħ time njē krim i pērmasave tē pafundme:

**Sē pari:** Personi qē vdes jobesimtar do tē mbetej i tillē edhe nē qoftē se do tē jetonte tē gjithē pérjetēsinē, sepse ai ka prishur pikērisit substancēn e shpirtit tē tij. Dhe zemra e tij e prishur ka tendencē -prirje tē natyrħħme- pér tē kryer krim tē pafundme.

**Sē dyti:** Edhe nē qoftē se mosbesimi ndodh nē njē kohē tē fundme, ai ēshtē njē krim i pafundmē dha pērgħenjesħtron pafundēsinē, dua tē them ai mohon tē gjithē universin, i cili dēshmon Unitetin Hyjnор.

**Sē treti:** Mosbesimi ēshtē mosmirēnjohje ndaj mirēsive tē pafundme.

**Sē katertti:** Mosbesimi ēshtē njē krim kundra pafundēsisē; domethenē Esencēs Hyjnore dha Atributēve.

**Sē pesti:** Asħtu siċ (tregħoħet nga) hadithi: "*Qiejt dha toka nuk mē nxenē Mua, por mua mē nxē zemra e robit besimtar*", ndērgħejja njerézore nē lidħje me fytyrēn e saj tē jashtme ēshtē e kufizuar dha e fundme, por nē sajē tē realitetit tē saj, rrēnġiet e fytyrēs sē saj tē

brendħħme pérhapen e shtrihi nē pérjetēsi. Prandaj nē kētē drejtim ajo ēshtē e pafundme. Kurse mosbesimi e njallos, e nxin atē dha ajo shuhet e prishet.

**Sē għashti:** Megħiżi tħażżeġ tē kundērtat me kokēfortēsi kundērshtojnē njéra-tjetren, ato janē tē ngħażżeġ nē shum ħekk. Kësħtu, nga njéra anē besimi fiton frutat e kōnaqṣive tē parajsēs, dha nga ana tjetter mosbesimi prodhon vuajtjan dha dhimbjen e pérhershme.

Prandaj ai qē i bashkon kētō għashtu aspekti arrin nē pérfundimin se ndēshkimi i pafundmē i pērshtatet krimi tē pafundmē dha ēshtē drejtesi e pastēr.

- Nē qoftē se ti do tē pyesje:** Kësħtu ajo ēshtē nē pérputħje me drejtēsinē, (domethenē, ndēshkimi i pérjetshem ndaj mohuesit ēshtē i pérputħħem me drejtēsinē), por ku ēshtē urtēsia, e cila ēshtē e pērjashtuar nga kriji i tē kēqijave qē pērfundojnē e rezultojnē nē dēnim?

**Ty do tē tē thuhej:** Asħtu siċ e ke dēgjuar mē parē, njē e mirē mē e madhe nuk duhet tē lihet pér shħak tē shpērħapjes -pērzierjes- sē njē tē keqjej mē tē vogħel, pasi kjo do tē ishte njē e keqe mē e madhe. Kjo ēshtē pér shħak se Urtēsia Hyjnore bēn tē domosdoshħme ekzistencēn e tē vērtetav relative, tē cilat janē mē tē shumta se sa tē vērtetav reale; dha shfaqja -dukja- e tyre ēshtē e mundshme vetem nēpērmjet ekzistencēs sē tē keqes; dha e keqja mund tē mbahet brenda caqeve tē saja dha mund tē pengohet nga agresioni i saj veċse nēpērmjet frikēsimit, kērcenimit; dha kērcenimi mund ta prekē ndērgħejja veċse nē qoftē se ai -kērcenimi- mund tē verifikohet dha tē aktualizohet nga ekzistenza e torturimit tē jashtem; sepse asħtu si intelekti dha imaginata, ndērgħejja preket vērtet nga kērcenimi, veċse nē qoftē se ajo do ta perceptone prej tregħesve tē ndryshem realitetin e jashtem tē pérjetshem tē torturēs. Prandaj ajo ēshtē thjesht urtēsia e pastēr pasi t'i kesh mbushur njerézit me frikēn e zjarrit tē Ferrit nē kētē botē, sepse pér tē ai ekziston nē Ahiret.

- Nē qoftē se ti do tē pyesje:** Atēherē kjo ēshtē e pérputħħħme edhe me urtēsinē Hyjnore gjithashtu, por si e lejon atē mēshira?

**Ty do tē tē thuhej:** Mosbesimtarēt mund tē mendohen vetem nē shpreħjet e mosekzistencēs ose ekzistencēs sē ndēshkimit. Ekzistenza -

edhe sikur tē jetē nē Xhehennem- éshtë mëshirë dhe mirësi nē krasim me mosekzistencën nē qoftë se do ta shqyrtoje atë -në ndërgjegjjen tende. Në qoftë se ti do ta analizoje me vëmendje (ti do ta shihje se) mosekzistanca éshtë thjesht një e keqe e pastër; madje mosekzistanca éshtë burimi i të gjitha fatkeqësive dhe mëkateve. Ndërsa ekzistanca éshtë thjesht e mirë e pastër, edhe sikur tē ishte nē Ferr. Për më tepër, éshtë nē natyrën e shpirtit të njeriut -në qoftë se do ta dinte se torturimi eleminon krimet dhe mëkatet e tij, do tē ishte i kënaqur me tē për tē lehtësuar peshën e trupit. Atëherë ai do ta pranonte se ndëshkimi éshtë i drejtë dhe se e meritonte. Madje nga dashuria e tij për drejtësinë, ai do tē merrte kënaqësi.

Nododhen shumë njerëz tē ndershëm nē këtë botë që përmallohen për zbatimin e drejtësisë mbi ta me qëllim që tē jenë tē shpëtuar prej turpit tē krimeve tē tyre.

(Mosbesimtarët) shkojnë nē Ferr dhe banojnë atje përjetësish si vendbanimi i tyre i përjetshëm, por pas pak kohe duke paguar dënimin për aktet e tyre ata bëhen tē mësuar me tē nē një mënyrë, edhe nē qoftë se nuk e meritojnë këtë, dhe i përshtaten asaj.

Gjithashtu, dënimet e tyre pakësohen dhe lehtësohen nē shumë mënyra si shpërblim për veprat e tyre tē mira nē këtë botë, ashtu siç tregohet nē disa hadithe. Këto janë shembuj mëshire për ta, megjithëse nuk janë tē denjë për to.

\* \* \*

## VËRSETI 8

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ أَمْنًا بِاللَّهِ وَبِالْيَوْمِ الْآخِرِ  
وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ

*Ve Min el-Nasi men jekulu A'men-nà bil-lahi ve bi el-jeumi el-Âh'iri ve mà hum bimuëminíne.*

*Ndërsa ka edhe njerëz (hipokritë) tē cilët thonë: "Ne besojmë nē Allahu dhe nē ditën e Fundit", ndërsa nē tē vërtetë ata nuk besojnë.*

Pozicionimi i vërsetit nē lidhje me atë që e parapriu.

Ashtu si dy pjesët e një fjalie që lidhen nëpërmjet një lidhëzeje për shkak se ato tē dyja marrin pjesë e bashkëpunojnë për atë që po deklarohet, dhe dy fjali bashkohen -lidhen- nëpërmjet një lidhëzeje meqë ato i shërbijnë tē njëjtë qëllim; po ashtu dy tregime lidhen meqë tē dyja përputhen me tē njëtin qëllim.

Bashkëlidhja e tregimit tē hipokritëve dhe ai i mosbesimtarëve éshtë e këtij llojit tē fundit; domethënë, përbledhja e dymbëdhjetë vërseteve vijues lidhet nga një lidhëse me substancën -thelbin- (*Me'al*) e dy vërseteve tē mëparshëm. Sepse meqenëse shpallja (*al-tenzil*) hapet me lavdërimin (e vetvetes) "*Dhâliké el-kitâbu*", "*Ai éshtë libri*", ajo e shkakton lavdërimin e besimtarëve si frutat e atij libri (lavdërimi); dhe kjo me radhë kërkon përcëmimin e denigrimin e tē kundërtave tē tyre, meqë "gjërat njihen nëpërmjet tē kundërtave tē tyre". Atëherë, për tē përbushur qëllimin e udhëzimit, éshtë e përshtatshme ta ndjekësh këtë me hipokritët, me qëllim që tē gjithë llojet e njerëzve tē mund tē përfshiheshin.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Përse ai i trajtoi nē mënyrë tē përbledhur e tē ngjeshur mosbesimtarët dhe mosbesimin e pastër në dy vërsete, dhe i trajtoi me hollësi, për së gjati, hipokrizinë -shtirjen- në dymbëdhjetë vërsete?

*Ty do tē tē thuhej:* Pér disa arsyé tē holla:

**Sē pari:** Armiku nē qofté se do tē ishte i panjohur, do tē ishte mē i dēmshēm; dhe nē qofté se ai do tē ishte i pakapshēm -dredhues- ai do tē ishte mē i rrezikshēm; dhe nē qofté se do tē ishte gēnjeshtar, ai do tē shkaktonte mē shumē korruption; dhe nē qofté se do tē ishte i brendshēm, ai do tē ishte mē cēnues, lēndues. Sepse një armik i brendshēm dobēson fuqinē e shkatēronn forcat, ndryshe nga armiqtē e jashtēm, tē cilēt bēhen shkak pér tē forcuar vendosmērinē dhe solidaritetin. Por, sa keq! Dēmi qē i ka shkaktuar hipokrizia islamit eshtē vērtet shumē i madh. Ajo -hipokrizia- eshtē shkaku i konfuzionit tē tanishēm. Pér kētē arsyé Kurani e dēnon shpesh atē.

**Sē dyti:** Hipokriti pérzihet me besimtarēt dhe bēhet familjar -i njobur- me ta deri diku, dhe bēhet i mēsuar me besimin pak. Ai fillon tē ndjehet i ftohur e i larguar nga gjendja e tij pér shkak se aktet e tij shahen e pérçmohen. Pak e nga pak pohimi -fjala- e Unitetit Hyjnor pikon nga gjuha e tij tek zemra e tij.

**Sē treti:** Hipokriti ia kalon mosbesimtarit nē krime tē tillē si tallja, mashtrimi, hileja, tinēzia, gēnjeshra dhe shtirja.

**Sē katerti:** Hipokriti zakonisht eshtē njéri prej ithtarēve tē librit dhe njē mashtrues komplotues i zgjuar djallēzisht. Prandaj tē jesh proliks -i zgjatur nē fjalē- rreth hipokrizisē eshtē elokuencē e pērkryer.

Tani, sa pér analizimin e fjalēve tē kētij ajeti, shqyrtoje kētē: nē njē drejtim *“ve Min el-Nāsi”* *“من الناس”* Ndērsa ka edhe njerēz, *ndodhen prej njerēzve”* eshtē njē kallzues i vēnē nē fillim pér *“men, “ata qē (tē cilēt)”*.

• *Nē qofté se ti do tē pyesje:* A nuk eshtē e qartē, e vetēkuptueshme, qē hipokriti eshtē njéri nga njerēzit?

*Ty do tē tē thuhej:* Kur njē pohim eshtē i vetēkuptueshēm, ajo qē synohet eshtē njéra prej pasojave tē saja tē domosdoshme, dhe kētu ajo eshtē pér tē shkaktuar habi. Eshtē sikur ai tē thonte: Eshtē e çuditshme qē hipokriti i pērbuzur tē jetē njē qēnie njerēzore, sepse njeriu eshtē fisnik, i nderuar; nuk eshtē karakteristikē e tij ta ulē veten nē njē poshtērsi tē tillē.

• *Nē qofté se ti do tē pyesje:* Pérse eshtē vēnē nē fillim kallzuesi?

*Ty do tē tē thuhej:* Pérparësia eshtē mē me vend pér tē prodhuar çudi dhe pér tē pērqëndruar vēmendjen mbi kryefjalēn, sepse ajo eshtē vendi ku gjendet qēllimi -i fjalisē-. Pérndryshe njeriu do tē priste e do tē kalonte (nga kryefjala) pér tek kallzuesi -dhe pjesērisht nuk i vē re kryefjalēn dhe qēllimin.

نَاسٌ  
Disa pika tē holla mund tē pikojnē -distilohen- prej shprehjes *“el-Nāsi”*, *“njerēzit”*.

**Sē pari:** Kurani nuk i specifikoi -hipokritēt- dhe nuk i zbuloi ata, madje ai i fshehu, i mbuloi ata nēn termin *“el-Nāsi”*, *“njerēzit”*. Kjo tregon se mbulimi -fshehja e tyre dhe mos’heqja- e maskēs prej fytyrave tē tyre tē neveritshme ishte mē e pērshtatshme pér politikēn e profetit a.s.m.. Sepse nē qofté do t'i kishte zbuluar, atēherē besimtarēt do tē lēkundeshin e ngurronin, sepse askush nuk eshtē i sigurt prej dredhive tē nefsit, dhe dyshimet do t'i kishin çuar nē frikē, dhe frika nē hipokrizi, dhe hipokrizia nē shtirje. Gjithashtu, nē qofté se vēmendja do tē tērhiqej tek shēmtia e tyre, do tē mund tē ishte thēnē se profeti a.s.m. ishte ngurrues dhe nuk pati besim tek ndjekēsit e tij. Dhe ndonjēherē, nē qofté se korruptioni mbetet i fshehur, ai shuhet pak e nga pak dhe ai qē e kryen atē do tē pērpinqej qē ta fshehē. Por nē qofté se ngrihet perdja, si rrjedhojē e thēnies: “Nē qofté se je i pacipē, ti mund tē bēsh çfarē tē duash,<sup>1</sup> ai do ta shpjegonte: “S’ka rēndēsi çfarēdo qē tē ndodhē!” dhe pa çarē kokēn ai pērhap shturjen.

**Sē dyti:** Termi *“الناس”* *“el-Nāsi”*, *“njerēzit”* tregon se duke lēnē krejtēsisht mēnjanē atributet e tjerē qē kundērshtojnē hipokrizinē, mē i pērgjithshmi i attributeve, dua tē them, humanizmi, eshtē nē kundērshtim me tē. Sepse njeriu eshtē fisnik -i nderuar- dhe njē poshtērim i tillē nuk eshtē karakteristikē e tij.

<sup>1</sup> Kjo bazohet mbi njē hadith tē treguar nga Ebu Mes’ud Ukba Ibn Amr el-Ensari dhe tē transmetuar nga Buhariu: “Njē gjē qē njerēzit kanē kuptuar prej fjalēve tē profetēsisē eshtē: “Nē qofté se nuk ndjen turp, ti mund tē bēsh çfarē tē duash”. El-Buhari, Sahih etj.

**Së treti:** Gjithashtu ajo nënkupton se hipokrizia nuk është e veçantë për ndonjë grup apo klasë, por gjendet përgjithësisht në të gjithë njerëzimin, në cilindo popull.

**Së katerti:** Fjala aludon se hipokrizia fyen nderin e çdo qënieje humane dhe në mënyrë të pashmangshme shkakton zemërimin e tyre kundra personit, dhe i nxit ata t'i kufizojnë -aktivitetet e tij- për të penguar përhapjen e atij helmi. Gjithashtu hipokrizia plagos e prek nderin e grupit, dhe turpi i anëtarëve të tij nxit zemërimin -e anëtarëve të grupit- kundra tij.

Sa për **يَقُولُ أَمَّا** “të cilët thonë: “Ne besojmë, kemi besuar”.

• Në *qoftë se ti do tē pyesje*: Përse ndonëse ato i referohen të njëjtë person, **يَقُولُ يَكُلُّ**, “(i cili thotë) të cilët thonë” është në numrin njëjës, ndërsa **أَمَّا** “**أَمَّا**”, “Ne besojmë, kemi besuar” në numrin shumës?

*Ty do tē tē thuhej*: Kjo tregon një pikë të hollë të bukur e cila është se veta e parë shumës është njëjës (për të thënë: “*Ne*” është duke folur si një), dhe **يَقُولُ يَكُلُّ**, “(i cili thotë) të cilët thonë” është njëjës sepse një person është duke folur. Por **أَمَّا** “**أَمَّا**”, “Ne besojmë, kemi besuar” është shumës sepse ai nuk është i vetëm në besimin e tij.

Pastaj është citati i pohimeve të tyre: kjo formë e citimit letrar tregon kundërshtimin në dy drejtime të asaj që u citua, në pikërisht të

njëjtën mënyrë që ajo tregon fuqi në dy drejtime. Sepse **يَقُولُ يَكُلُّ**, “(i cili thotë) të cilët thonë” aludon nëpërmjet formës së saj se ata nuk flasin nga bindja apo (si rrjedhojë e akteve (të tyre), por shprehin me gjuhët e tyre atë çfarë nuk është në zemrat e tyre. Gjithashtu, qënia e saj në kohën e pakryer sugjeron se arsyeva për vazhdimin e tyre për të mbrojtur vetveten dhe për ta bërë këtë pretendim është hipokrizi dhe jo shtytës nga ndërgjegjja.

Ndërsa pohimi i tyre **أَمَّا** “**أَمَّا**”, “Ne besojmë, kemi besuar” duke qenë në kohën e kryer sugjeron: “Të gjithë ne ithtarët e librit kemi

besuar qysh më parë, dhe kështu përse të mos besojmë tanë?” dhe prapashtesa përemërore **بِاللهِ وَبِالْيَوْمِ الْآخِرِ** “*na*, “*ne*” aludon se ata thonë: “Ne jemi një komunitet dhe jemi itharë; ne nuk jemi si një individ i cili mund të gënjejë ose mund të mashtrohet”.

Sa për **بِاللهِ وَبِالْيَوْمِ الْآخِرِ** “*bil-lahi ve bi el-jeumi el-Âh'ir*”, “në *Allahun dhe në ditën e Fundit*”

Shqyrtoje këtë: shpallja ose merr ekzaktësishët atë çfarë kanë thënë të tjerët, ose duke marrë substancën e saj e vendos në një formë tjetër, ose e përbledh shprehjen e saj.

Sipas të parës së këtyre, duke përmendur të parën dhe të fundit të shtyllave të besimit (hipokritët) janë duke demonstruar qëndrueshmërinë e tyre (të besimit). Sepse në shikimin e tyre, këto shtylla janë më të pranueshmet. Dhe duke përsëritur (parafjalën) **‘bi’**, **‘ne’** pavarsësishët afersisë (së të dyja fjalëve), ata aludojnë për shtyllat e tyre. Pastaj: sipas (mundësisë) së dytë, në qoftë se ajo do tē ishte Fjala e Tij xh.sh., duke përmendur vetëm këto dy pole të besimit, është duke treguar se ajo që ata pretendojnë ta besojnë madje në mënyrën më të fuqishme, nuk është besim. Sepse besimi i tyre në to nuk është siç duhet të jetë. Dhe përsëritja e parafjalës **‘bi’**, **‘ne’** tregon ndryshim. Sepse besimi në Allah është besimi në ekzistencën dhe në unititetin e Tij, dhe besimi në Ditën e fundit është besim në realitetin e saj dhe që ajo do tē vijë, ashtu siç u diskutua më lart.

(Domethënë, besimi në të dyja është i shumanshëm) dhe jo vetëm në një drejtim).

Sa për **وَمَا مِنْ عَبْدٍ** “*ve mà hum bimuëminine*”, “ndërsa në të vërtetë ata nuk besojnë, ata nuk janë besimtarë”.

• Në *qoftë se ti do tē pyesje*: Përse vërseti nuk thotë **وَمَا مِنْ عَبْدٍ** “*a'menu*” “ata nuk besuan”, që do tē ishte e ngjashme (në kohë e në formë) me **أَمَّا** “**أَمَّا**”, “ne besuam”?

*Ty do tē tē thuhej:* Që tē mos supozohet se ka ndonjë kontradiktë, sikur vetëm nē formë. Dhe kështu që mohimi tē mos i referohet **أَمْنًا** “*À'men-nà*”, “*ne besuam*”, e cila (pavarësish tē qenurit një folje nē kohën e kryer) është një fjali thirrmore “*Xumleh inshaij-jeh*”. Kështu qartësia ndalon mohimin e saj.

Përkundrazi përgënjeshtrimi dhe mohimi i referohen fjalisë së nënkuptuar (tē paqartë) nē **أَمْنًا** “*À'men-nà*”, “*Ne besojmë, kemi besuar*”, e cila është **نَحْنُ مُؤْمِنُونَ** “*sepse ne jemi besimtarë*”. Për më tepër, për shkak se kjo fjali mohore është fjali emërore, ajo nënkupton se mosbesimi i tyre është i vazhdueshëm.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Përse ajo nuk tregon mosvazhdimësinë e tij, meqë pjesëza mohore **لَا** “*ma*”, “*nuk*” vjen nē fillim tē fjalisë?

*Ty do tē tē thuhej:* Mohimi është ai që shprehet nga shkronja e dendur (e dukshme) (*el-harf el-kethif*), ndërsa vazhdimësia tregohet nga struktura e lehtë (*el-hej'eh el-khafifeh*) (e fjalisë emërore). Kështu mohimi është më i afërt me atë që është duke u shprehur.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Cila është hollësia nē (parafjalën **بِ** “*bi*” e **وَمَاهُمْ بِعُوْمَيْنِ** “*bimuëminné*”) duke u përdorur nē kallzuesin e pjesëzës mohore **لَا** ‘*ma*’?

*Ty do tē tē thuhej:* ajo tregon mungesën e aftësisë së tyre për tē besuar edhe pse ata (shfaqen) tē besojnë nga ana e jashtme. Ndryshimi është midis “*ma zejdun sekhij-jen*” (Zejdi nuk është bujar) dhe ‘*ma Zejdun bi sehij-jin*’: e para i referohet karakterit tē tij tekamadh; kuptimi i saj është Zejdi nuk po shfaq nē tē vërtetë bujari megjithëse ai ka aftësinë dhe është një person bujar. Ndërsa e dyta do tē thotë: Zejdi nuk e ka aftësinë për tē qenë shpirtmadh dhe nuk është një person bujar, ndonjëse ai bën vepra tē mira.

## VËRSETET 9-10

يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدُعُونَ إِنَّهُمْ هُمُ الظَّالِمُونَ  
وَمَا يَشْعُرُونَ \* فِي قُلُوبِهِمْ مَرْضٌ فَزَادُهُمُ اللَّهُ مَرْضًا  
وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ بِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ

*Jukħadju* All-llāhu ve el-LEDHJUNE àmenū ve mā jakħdejne il-là enfusehum ve mā jesh'urūne. Ti kūlubihum meredun feżżédhem All-llāhu meredan velehum adħabun elīm bima kanu jekgħibhūne”.

“Ata mendojnë tē masħtrojnë All-llāhu dfe ata që besojnë, ndërsa nē tē vërtetë ata vetëm se masħtrojnë vetveten dhe nuk e marrin vesh. Nē zemrat e tyre kā sēmundje (dyshimi dhe hipokrizie), ndërkohë që All-llāhu ua kā shtuar edhe më shumë sēmundjen. Për ta do tē ketë ndēshikim tē dhimbhshem, nga ajo që gjithnjë għenjenin.

Vendosja -pozicionimi- i këtij vërseti dhe lidhja e tij me vërsetin paraprijęs:

Shqyrtoje së pari se çfarë tregon fraza: Kritikë ndaj hipokrizisë; pastaj qortim ndaj saj, pastaj denoncim për hipokritet si tē neveritshem; pastaj kċencim ndaj tyre; pastaj frikësim ndaj tyre; pastaj čudi prej tyre; pastaj zbulimi i qëllimeve tē tyre siç u shpreh më lart; pastaj një shpjegim i asaj që i bëri ata tē thonë atë çfarë bënë; pastaj një përshkrim i tē parit tē katér krimeve që burojnë prej hipokrizisë tē cilat janë masħtrimi, korruzioni, thirrja e tyre ‘besimtarët si tē dobët mendërisht’ dhe tallja e tyre me ta. Pastaj portretizimi -përshkrimi- i krimeve tē tyre dhe i hilev tē tyre nēpërmjet një krasimi alegorik (*istia'ra temħilij-jeh*), është sa vijon:

Ajo pikturen e paraqet sjelljen e tyre përballë urdhéravet tē Allahu dhe ndaj profetit a.s.m. dhe besimtarëve- me shfaqjen e tyre tē besimit për qëllimet e kësaj dynjaje pavarësish mosbesimit tē tyre nga ana e brendshme. Pastaj ajo përshkruan dhe paraqet se si Allahu, profeti dhe

besimtarët veprojnë ndaj tyre, duke i promulguar gradualisht rregullat e besimtarëve kundra tyre, ndonëse në shikimet e Allahut ata janë mohuesit -kafirët- më të neveritshëm. Ashtu si dy njerëz duke mashtruar njëri-tjetrin, ose një gjahtar me gjahun e tij: gjahu e ndjen gjahtarin kur del nga strofulla e tij dhe kështu kthehet me vrap në të...

**يَخْادِعُونَ**  
**Vendosja (dhe lidhja) e fjalëve dhe e frazave prej “Jukħadiūne”, “Ata mendojnë tē mashtrojnë” e cila shikon krimin e tyre tē parë deri tek “bima kanu jekdhibūne”, “nga ajo qē gjithnjë gënjenin”. Shqyrtoji pasojat e njëpasnjëshme tē nënkuptuara nga këto shtatë fraza, sa vijon:**

**Sē pari:** Ata shfaqen se janë budallenj pasi përpiken pér diçka tē pamundur si tē mashtruarit Allahu.

**Sē dyti:** Ata vlerësohen si idiotë pér dëmtimin e vetvetes ndërsa kërkojnë e synojnë dobitë e tyre.

**Sē treti:** Ata akuzohen pér injorancë, pér dështimin e tyre pér tē dalluar midis dobisë dhe dëmit.

**Sē katerti:** Ata pérçmohen pér karakteret e tyre tē këqinj, dhe pér sémundjen e tyre, burimin e shëndetit dhe vdekjen e burimit tē jetës.

**Sē pesti:** Ata përbuzen pér shtimin e sémundjes së tyre ndërsa kërkojnë një ilaç.

**Sē gjashti:** Ata kërcënohen me thjesht sémundje tē pastër që nuk shkakton asgjë tjetër veçse dhimbje më tē shumtë.

**Sē shtati:** Ata parakalojnë para njerëzve (si bërés tē) më tē shëmtuarës së veseve; domethënë gënjeshtës.

Sekuenca e këtyre shtatë frazave, dhe si secila mbështetet në tjetrën mund tē ilustrohet si më poshtë vijon:

Në qoftë se ti dëshiron tē pengosh dikë nga bërrja e diçkaje dhe e këshillon atë kundra saj, ti i thua atij së pari: “Hej ti! Në qoftë se ke mend, ti mund ta shohësh se kjo është e pamundur, dhe në qoftë se ti e do veten, atëherë ti mund ta kuptosh se sa e dëmshme është ajo! Pastaj

ti je i ndjeshëm gjithashtu, atëherë pérse nuk mund ta dallosh ndryshimin midis asaj se çfarë është e dëmshme dhe çfarë është e dobishme?

Pastaj, në qoftë se ti nuk ke zgjedhje -dëshirë-, atëherë tē paktën prano se karakteri yt është i korruptuar.

Ai është i sémurë dhe shtrembëron tē vërtetën dhe ta tregon ty tē emblën tē hidhur; tē bën tē mendosh se ajo që është e embël është e hidhur. Pastaj, në qoftë se ti kërkon shërim, por ama kjo vetëm e shton sémundjen tēnde dhe nuk është ilaç. Ajo me tē cilën ti je sprovuar e goditur i ngjason pagjumësisë; ti përpiqesh tē flesh, tē tē zërë gjumi, por ajo vetëm se tē mërzit e tē shqetëson dhe tē largon edhe përgjumësinë -gjumësinë- gjithashtu.

Ose ti i ngjason dikujt zemra e tē cilit është sulmuar nga shqetësimet, dhe ky merak i tepruar vetëm se e shton dhe e dyfishon sémundjen, fatkeqësinë e tij. Pastaj ti kërkon kënaqësi, por ajo tē shkakton dhimbje tē rëndë dhe çon tek një vuajtje akoma më tē tmerrshme, dhe ajo nuk përmban asnjë kënaqësi. Në qoftë se ti nuk vjen në vete menjëherë dhe nuk e braktis tē gjithë këtë, nuk do tē mbetej asgjë veçse ti tē damkosesh në hundë me një shenjë tē shëmtuar! Dhe pastaj gjithkush do tē tē njoħe ty, dhe korruptioni yt nuk do tē pérhapet midis tyre!

Pikërisht në tē njëjtën mënyrë, Allahu xh.sh. pér tē penguar

hipokritët tha, **يَخْادِعُونَ اللَّهَ** “Jukħadiūne All-ħlahe” “Ata mendojnë tē mashtrojnë Allahu” në vend tē “juħadiune el nebij”, “ata mendojnë tē mashtrojnë profetin” pér tē treguar idiotizmin e tyre. Domethënë, si do tē mund ta mashtronin ata profetin a.s.m. duke parë se ai është mesazhier nga Allahu xh.sh.. Kështu dredhia e tyre kthehet tek vetë Allahu, dhe është krejtësisht e pamundur tē mashtrosh Allahu xh.sh.. Tē përpiqesh pér tē pamundurën është budallallék, dhe një budallallék i tillë është vetëm pér tē çuditur.

وَمَا يَخْدِعُونَ إِلَّا أَنفُسُهُمْ  
Kjo ndiqet nga “ve ma jakħideune il-la enfusehum”, “ndërsa në tē vërtetë ata vetëm se mashtrojnë vetveten” pér tē treguar marrëzinë e tyre. Domethënë, nuk ka asnjë dobi në atë çfarë ju

po bëni, por ka veçse dëm; dhe dëmi i saj do të kthehet prapa mbi ju, sikur ju po mashtronit vetveten.

Duke ndjekur këtë është **وَمَا يَشْعُرُونَ** “ve mà jesh'urún”, “dhe nuk e marrin vesh” për të demonstruar injorancën e tyre. Domethënë, o ju njerëz injorant! Ju jeni më të humbur –të çudhëzuar- se sa kafshët, më të ngurtë se sa gurët, sepse ju nuk mund ta shikoni ndryshimin ndërmjet dobisë dhe dëmit!”

Kjo ndiqet nga **فِي قُلُوبِهِمْ مَرْضٌ** “Fi kulsúbihim meredun”, “Në zemrat e tyre ka sémundje (dyshimi dhe hipokrizie),” për të treguar se sa të përbuzur janë ata, sepse natyrat e tyre janë prishur. Domethënë, në qoftë se ju nuk keni zgjedhje -dëshira-, të paktën ju duhet ta njihni sémundjen që është e tillë, dhe se karakteri juaj është prishur.

Në të vërtetë, hipokrizia dhe smira janë sémundjet e shpirtit, shenja e së cilës është të shtrembërojë të vërtetën dhe ta ndryshojë atë me qëllim që ju ta supozoni të emblën të jetë e hidhur dhe hidhësirën të jetë e embël, dhe të zezën të jetë e bardhë dhe të bardhën të jetë e zezë; prandaj mos e ndiqni një rrugë të tillë!

**فَرَادُهُمُ اللَّهُ مَرْضًا** **فرادهم الله مرضًا**  
Pastaj ajo shton **fezâdehum Allâhu meredan**, “ndërkohë që Allâhu ua ka shtuar edhe më shumë sémundjen” për të treguar poshtërimin e tyre. Domethënë, ju dëshironi një ilaq për t'u shëruar prej zemërimit dhe xhelozisë suaj; por ato janë sémundje që vetëm shtojnë sémundjen tuaj. Ju jeni si një njeri që ka thyer njëren nga duart e tij, dhe duke kërkuar të hakmerret mbi dikë e godet atë me atë dorë të thyer, duke i shkaktuar asaj thyerje -frakturna- të shumëfishta.

**وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ** **ولهم عذاباً أليماً**  
Pastaj ajo thotë **velehum adhâbun el'mun**, “Për ta do të ketë ndëshkjm të dhimbshëm” me qëllim që t'i kërcenojë.

Domethënë, në qoftë se ju kërkoni kënaqësi nëpërmjet kësaj hipokrizisë suaj, ajo nuk ju jep asgjë veçse vuajtje të rënda tanë, dhe do të rezultojë në vuajtje më të rënda në Ahiret. Ajo nuk është si mëkatet e tjera, të cilat japid një lloj kënaqësie të ulët të menjëhershme.

**بِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ** **bima kanu jekdhibûne**, “nga ajo që gjithnjë gënjenin” për t'i damkosur ata me stampën më të neveritshme. Domethënë, në qoftë se ju nuk vini në vete, dhe nuk keni ardhur në vete, e vtmja zgjidhje për ju do të jetë që ju do të bëheni të shquar e të mirënjohur me gënjeshtren tuaj, me qëllim që të mos përhapet sémundja juaj.

Tani vendosja -pozicionimi- i pjesëve të frazave në lidhje me njëra-tjetrën:

**يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا** **Jukhadufûne Allâha ve el-ledhîne àmenû**, “Ata mendojnë të mashtrojnë Allahuun dhe ata që besojnë”: përdorimi i termit mashtrim për të përshkruar aktin e tyre, me kohën e pakryer, dhe sidomos me formën e tretë të foljes, dhe veçanërisht duke përdorur emrin e Allahut në vend të profetit, dhe **الْمُؤْمِنُونَ** **el-ledhîne àmenû**, “ata që besojnë” në vend të **Muëmininë**, “besimtarët”, që të gjitha tregojnë në mënyrë të qartë pamundësinë e qëllimit të tyre për të mashtruar. Kjo e hedh këtë pamundësi para syve, duke i bërë njerëzit të neveriten prej saj, të rrëqethen dhe t'u shkojnë mornica. Sepse metafora parabolike -alegorike- (*el-istiare al temhilij-jeh*) e përfshirë në fjalën “mashtrim” (*el-khuda*) ngjall neveri. Edhe zemra gjithashtu largohet me neveri nga karakteri përshkrues i kohës së pakryer dhe nga vazhdimësia që ajo nënkupton.

Ashtu si në vërsetin “*Shpërbëimi për një të keqe është një e keqe e barabartë me të*”<sup>1</sup>, reciprokësia e shprehur nga përdorimi i formës së tretë të foljes sugjeron se mashtimi i tyre do të jetë i pafrytshëm. Sepse në formën e tretë të foljes, akti i “vepruesit” është një shkak për aktin e tij mbi të cilin veprohet dhe këtu i dyti, akti mbi të cilin ra veprimi, u bë shkak për shterpësinë e mashtimit të vepruesit dhe pa efekt; madje ajo e tregon mashtimin e tyre të jetë i dobët dhe pa substancë, sikur të ndërroje rolet me dikë, -të ndërroje portat me kundërshtarin. Për shembull, ti tallesh dhe shpërfill dikë duke e supozuar atë të jetë i

<sup>1</sup> Kuran, 42:40

pavetëdijshëm për të, por në brendësi, në vetvete, ai e di dhe në mënyrë të fshehtë të përqesh e të shpërfillë ty.

Emri **Allah** pohon në mënyrë të qartë pamundësinë e asaj që ata synojnë, sepse të mashtrosh profetin a.s.m. shkakton mashtrim ndaj Allahut xh.sh., dhe aftësia e arsyes nuk mund ta pranojë një mashtrim të tillë.

Në zgjedhjen e **وَالَّذِينَ آمَنُوا** “el-ledhine amanu”, “ata që besojnë” në vend të **“muëminune”**, **“besimtarët”**, domethënë, në zgjedhjen e një fjalie lidhore dhe atributin e besimit, është një shenjë se hipokritët përpinqen të bëjnë për vete besimtarët nëpërmjet atributit të besimit, duke lëvizur damarin e tyre me qëllim që të fitojnë dashurinë e tyre dhe në këtë mënyrë ata të mund të të përbirohen duke u futur tinëzisht midis tyre. Kjo sugjeron gjithashtu se meqenëse mendjet e komunitetit të besimtarëve janë ndriçuar me besim, mashtrimet e hipokritëve nuk janë të fshehura prej tyre, gjë e cila u shkakton atyre mashtrimeve të jenë shterpa e të pafrizhshme.

**Fraza e Dytë:** **وَمَا يَخْدِعُونَ إِلَّا أَنفُسُهُمْ** “ve mà jakħideúne il-lä enfusehum”, “ndërsa në të vërtetë ata vetëm se mashtrojnë vetveten”. Në kufizimin e shprehur nga **“il-lä”**, **“vetëm”** është një shenjë e marrëzisë së tyre të plotë, meqë akti i tyre kthehet mbi ta. Ashtu si një person i cili hedh një gurë tek një mur dhe guri kthehet prapë dhe ia thyen kafkën. Sepse ata i gjuajtën me shigjeta besimtarët por goditën me to vetet e tyre, sikur ata të mashtronin pikërisht vetet e tyre...

Dhe zëvendësimi i **يَضْرُونَ** “Jedur-rune”, “ata dëmtojnë, i bëjnë dëm” me **يَخْدِعُونَ** “jakħideúne”, “ata mashtrojnë” nënkuption marrëzinë e tyre të plotë, sepse midis njerëzve të arsyeshëm mund të gjendet ndonjë që e dëmton vetveten qëllimi, me dashje, por nuk gjendet asnjë që ta mashtrojë qëllimi, veçse në qoftë se do të ishte krejtësisht gomar, në formë njeriu.

**أَنفُسُهُمْ** Dhe në fjalën **“enfuseum”**, **“vetveten, veten e tyre”**, është një shenjë e mbuluar, e fshehur se meqenëse hipokrizia e tyre dhe hilet e tyre janë për të kënaqr nefset e tyre dhe për arsyegoiste, ata përfundojnë në të kundërtën e asaj që synohet.

- **Në qoftë se ti do të pyesje:** Kufizimi -për hipokritët- këtu nënkupton se mashtrimet e tyre nuk i shkaktojnë dëm islamit dhe muslimanëve, por ama islanii nuk ka pësuar dëm nga asgjë më shumë se sa është dëmtuar prej llojeve të ndryshme të hipokrizisë dhe prej filizave të saj, të cilat janë përhapur si helm midis njerëzve të botës islamike?

**Ty do të tē thuhej:** Dëmi agresiv që ti e sheh, dhe helmi infektues janë përhapur si një sëmundje ngjitetë prej karaktereve të tyre tē kalbura, natyrave të tyre tē prishura dhe ndërgjegjive të tyre tē korruptuara; ajo nuk është si rrjedhojë e mashtrimeve dhe e dredhive që ata kanë bërë nëpërmjet zgjedhjeve të tyre. Sepse ata dëshirojnë tē mashtrojnë Allahun, profetin dhe komunitetin e besimtarëve, por Allahu ka njoburi për tē gjitha gjërat dhe profeti është marrësi i shpalljes, dhe nuk është i mundshëm që mashtrimi tē fshihet prej komunitetit të besimtarëve për ndonjë kohë tē gjatë, dhe ata nuk mashtrohen. Kështu është vërtetuar se mashtrojnë vetëm se vetveten e tyre.

**Fraza e Tretë:** **وَمَا يَشْعُرُونَ** “ve mà jesh'urine”, “dhe nuk e marrin vesh, nuk e dinë”. Domethënë, ata nuk e ndjejnë ose ata nuk janë të ndjeshëm për të: kjo frazë e ngjeshur u atribuon injorancë atyre, sepse ajo tē jep tē kuptosh se në qoftë se ata janë qenie tē zgjuar me mend, kjo nuk është karakteristike për mendjen, dhe në qoftë se ata do tē ishin kafshë dhe tē lëviznin e tē vepronin me shtysat e nefsit instinktiv, ata duhej ta ndjenin e tē bëheshin tē vetëdijshëm për këtë dëm tē dukshëm e tē prekshëm. Prandaj, vërtetohet se ata janë bërë si qëniet e pajeta që nuk kanë zgjedhje.

**Fraza e katërt:** **فِي قُلُوبِهِمْ مَرْضٌ** “Fi kusubihim meredun”, “Në zemrat e tyre ka sëmundje (dyshimi dhe hipokrizie)”: kjo frazë duke u vendosur këtu pohon se meqenëse ata nuk veprojnë siç kërkohet nga arsyetimi i

mendjes dhe nga vetëdija e shqisave, është e qartë se ata po vuajnë nga një sëmundje e shpirtit. Sepse të paktën ata duhej ta dinin se ajo është një sëmundje dhe t'i shmangnin problemet bashkëshoqëruese të saj -që vijnë si pasojë e saj- dhe të mos gjykonin sipas tyre. Sepse një sëmundje e tillë ndryshon të vërtetën, shformon e shtrembëron bukurinë, dhe e shfaq atë që është e hidhur të jetë e ëmbël, ashtu siç është përshkruar.

**Parafjala** فی “Fi”, “në” aludon se smira dhe urrejtja e tyre janë sëmundje duke goditur në dimensionet e brendshme të zemrave, e cila - zemra- është një aftesi e hollë Hyjnore, ashtu siç u përmend.

Dhe në termin قلب “kalf”, “zemër” është një tregues se ashtu si një sëmundje e zemrës fizike që prish funksionimin e të gjithë trupit, po ashtu kur ajo çfarë tregon zemra -kuptimi i zemrës- sëmuret me mashtrim e hipokrizi, të gjitha funksionet e shpirtit shmanget nga Ruga e drejtë, sepse zemra në këtë sens -kuptim- është burimi i jetës dhe makineria e saj.

Dhe në فی قلوبهم “Fi kufubhim”, “në zemrat e tyre” duke paraprirë

**مرض** “meredun”, “ka sëmundje (dyshimi dhe hipokrizie)” mban kuptimin e kufizimit në dy drejtime: Nëpërmjet aluzionit ajo tregon se besimi është një dritë e cila u jep shëndet dhe drejtimin e saktë të gjitha akteve dhe veprave të njeriut. Së dyti, ai nënkupton se korrupzioni i tyre është në themel, prandaj është e kotë e padobi të riparosh gjérat e pjesshme.

Fjala مرض “meredun”, “sëmundje (dyshimi dhe hipokrizie)” në mënyrë aluduese hedh poshtë justifikimet e tyre dhe ua rras ato poshtë gurmazëve të tyre. Sepse gjendja e bashkëlindur e njeriut priret natyrshëm ndaj të vërtetës; korrupzioni dhe shkatërrimi janë sëmundje dhe aksidentale (*a'rid*).

Dhe në përdorimin e trajtës së pashquar është një shenjë se sëmundja është aq e rrënjosur thellë saqë është e pamundur as të shihet dhe as të kurohet.

**Fraza e pestë:** فرادهم الله مرضا “fezàdehum All-lahu meredan”, “ndërkohë që Allahu ua ka shtuar edhe më shumë sëmundjen”: kur ata nuk e njohën se ajo është sëmundje që të shmangeshin prej saj, por e ndoqën atë duke e miratuar, Allahu ua shtoi atë, sepse “Kushdo që kërkon, do të gjejë.”

Në ف “fe” (të فزاده “fezàdehum All-lahu), e cila shpreh qëllim, - megjithëse ekzistencë e sëmundjes nuk është një arsy për shtimin e saj- është një shenjë se meqenëse ata nuk e diagnostikan sëmundjen, as nuk kërkuan ndonjë mjet për ta kuruar; madje ndoqën hapa për ta keqësuar atë si dikush që godet një armik superior me dorën e tij të sëmurë të thyer, ata u bënë sikur kërkuan shtim dhe Allahu ua shtoi atyre sëmundjen duke i transformuar shpresat e tyre në dëshpërim shtypës, për shkak të triumfit të besimtarëve, dhe e transformoi armiqësinë e tyre në një urrejtje përvluese në zemrat e tyre, për shkak se besimtarët triumfuan. Kështu lindën nga dy sëmundjet e dëshpërimit dhe të urrejtjes sëmundja e frikës dhe lëngata e dobësisë dhe sëmundja e poshtërimit; të gjitha këto sunduan në zemrat e tyre.

Pastaj, Allahu xh.sh. nuk tha “Fezadall-lahi meredahum”, “ndërkohë Allahu shtoi sëmundjen e tyre” por “Allahu ua ka shtuar atyre sëmundjen.” Dhe

ë bëri prapashtesën përemërore kundrinor dhe سëmundjen “sëmundjen” përcaktor “temjiz” me qëllim që të tregojë se sëmundja e brendshme e zemrës është përhapur jashtë, duke infektuar të gjitha veprat që ata bëjnë.

Sikur kjo sëmundje e keqe ka mbuluar të gjithë trupat e tyre, të cilët janë bërë pikërisht sëmundja, këto mbufatje, fryrje të qelbëzuara të sëmundjes bëhen një trup shtesor për ta. Ashtu si thënia “ishteale el-bejtu naren” e cila nënkupton se zjarri ka mbuluar të gjithë shtëpinë dhe ajo është e gjitha në zjarr, në flakë, ndryshe nga “ishteale narul bejt”, e cila pohon se një pjesë e saj ka marrë flakë.

**Fraza e gjashtë:** وَلَمْ عَذَابَ أَبِيمْ “velehum adhâbun elîmun”, “Për ta do të ketë ndëshikim të dhimbshëm”: ل Lami (i lehum i tyre) i

cili nénkupton dobi, tregon se nē qoftë se ata do tē merrnin dobi, ajo sigurisht do tē ishte -nē formën e- dhimbjes sē rēndë nē këtë botë ose dēnim i dhimbshēm nē ahiret. Tani është e pamundur që këto tē jenë dobi, prandaj është e pamundur pér ta marrja e dobisë. Ndërsa fjala “*adhabun*”, “*dēnim, ndëshkim*” duke u cilësuar nga fjala “*elīmun*”, “*i dhimbshēm, i rēndë*” me kuptimin “*mute'el-lim*”, “*nē dhimbje, nē vuajtje*”, e cila përgjithësisht u referohet njerëzve, aludon se dënim i ka mposhtur e ka kapluar trupat e tyre dhe ka përfshirë personat e tyre dhe ka mbuluar qëniert e tyre tē brendshme; kështu që janë bërë tortura dhe tortura është bërë identike, i njëjtësuar me ta, ashtu siç kthehet qomyri nē thëngjill tē ndezur -nē prush- kur digjet nga zjarri.

Në qoftë se imaginata do tē shikonte formën e dënimit dhe do tē dëgjonte vajtimin e dëshpëruar dhe ofshamën e angështuar nē çdo anë që buron ngajeta e ripërtërirë nën dënim, duket sikur vetë dënim i është ai që angështon e rënkon. Sa paralajmërim i tmerrshëm pér ata që mendojnë!

**Fraza e shtatë;** domethënë, **بِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ**, “*bima kanu jekdhübune*”, “*nga ajo që gjithnjë gënjenin*”:

Duke ia atribuuar dënimin e lartëpërmendur pér krimet e tyre vetëm gënjeshtës, ajo tregon mizorinë e gënjeshtës, shëmtinë dhe neverinë e saj. Ky tregues dëshmon me tē vërtetë efektet e rënda tē helmit tē gënjeshtës, sepse gënjeshta është baza e mosbesimit; nē tē vërtetë, mosbesimi është një gënjeshtë e llojit më tē keq, dhe është shenja kryesore e hipokrizisë. Gënjeshta është tē shpifësh fuqinë Hyjnore dhe është e kundërtë e urtësisë Hyjnore. Gënjeshta shkatërron moralet e larta. Ajo i transformon nismat, iniciativat e larta nē kufoma tē kalbura. Helmi i saj është përhapur gjithandej botës islame. Ajo ka përbysur çështjet e njerëzimit dhe ka mbajtur botën e humanizmit nga arritja e përsosurisë së saj dhe ka penguar përparimin dhe progresin e saj. Ajo i ka lëshuar shembujt si Musejleme Gënjeshtari nē ultësirën më tē ulët. Ajo është një peshë e rëndë mbi shpinën e njeriut duke e penguar atë nga arritja e qëllimeve tē tij. Ajo është paraardhësja e hipokrizisë dhe e artificializmit. Këto janë arsyet që ajo është specifikuar nga ajo që u shpall prej lart Fronit Sublim, dhe përsë ajo është mallkuar dhe është bërë objekt kërcënimesh.

Prandaj, o ju njerëz, dhe sidomos o ju muslimanë! Ky vërset ju bën thirrje ta shqyrtoni atë me vëmendje.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* A nuk është gënjeshta e përligjshme, e falshme nëse do tē ishte pér ndonjë qëllim tē mirë?

*Ty do tē tē thuhej:* -Në qoftë se gënjeshta do tē ishte e përligjshme dhe avantazhet e saj janë tē sigurta. Por ajo që ata e quajnë arsyet tē mirë, është -përgjithësisht- një justifikim i rremë. Sepse është parashikuar e përcaktuar nga shkenca e parimeve tē Sheriatit se “pér shkak se një çështje që nuk është e përcaktueshme është e hapur para shfrytëzimit tē keq, ajo nuk mund tē bëhet baza e rregullave. Pér shembull, meqenëse vështirësia e përfshirë nē kryerjen e namazit ndërsa je nē udhëtim është e papërcaktueshme, ajo nuk është arsyet pér shkurtimin e tyre, por arsyet është udhëtimi. Dhe nē qoftë se ne do tē pranonim se dëmi i një gjëje peshon më shumë se sa dobia e saj, një rregull jetet pér ta shfuqizuar atë dhe dobia e saj qëndron nē mosekzistencën e saj.

Anarkia dhe çrregullimi nē botë dëshmojnë pér dominimin e dëmit me pretekstin e dobisë. Por aluzioni dhe tē folurit me nénkuptim nuk janë gënjeshtë. Rruga është e dyfishtë: ose heshtja, sepse vërtetësia nuk kërkon që dikush tē thotë gjithçka që është e vërtetë; ose ndershëmëria, sepse vërtetësia është baza e islamit dhe një karakteristikë e besimit, madje besimi, vërtetësia dhe lloji i saj kryesor. (Vërtetësia) është lidhja e tē gjitha plotësive; ajo është jeta e moraleve tē larta; është rrënja që i lidh gjérat me realitetin; është manifestimi i tē vërtetës në gjuhë; është boshti i zhvillimit tē njeriut; është rregulli i botës islame; është ajo që e çon me shpejtësi -si vetëtima- llojin njerëzor nē rrugën e përparimit pér tek Qabeja e plotësive; dhe është ajo që e ngre njeriun më tē varfër dhe më tē shushatur më lart se sulltanët; dhe ajo i bëri sahabët e profetit a.s.m. superiorë mbi tē gjithë njerëzit e tjerët; dhe me tē u ngrit Shkëlqesia jonë Muhammed Hashimi a.s.m. tek kulmi më i lartë i humanizmit.

\* \* \*

## VËRSETET 11 – 12

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا تَقْسِدُوا فِي الْأَرْضِ قَالُوا إِنَّا نَحْنُ مُصْلِحُونَ \* إِلَّا إِنَّهُمْ هُمُ الْمُفْسِدُونَ وَلَكِنْ لَا يَشْعُرُونَ

*Ve idhà kîle lehum là tufsidú fi el-erdí kâlu in-nemâ nahnu Muslîhiûne. Ela in-ne hum hum el-mufsidûne ve lâkin là jesh'urûne.*

Dhe kur atyre u thuhet: "Mos bëni djallëzi -mbrapshti- në tokë", ata thonë: "Ne jemi vetëm pajtues". Në të vërtetë janë pikërisht ata të cilët sjellin trazira, por ata nuk e marrin vesh.

Shqyrtoje vendosjen -pozicionimin- e këtyre vërseteve në lidhje me vërsetet e mëparshëm:

Allahu xh.sh. përmend të parën e krimeve që burojnë nga hipokrizia e tyre: Padrejtësia e tyre ndaj vetes së tyre, tejkalimi dhe shkelja nga ana e tyre e të drejtave të Allahut xh.sh. (*hukuk All-llah*), së bashku me pasojat e njëpasnjëshme të lartëpërmendura, dhe pastaj Ai e ndjek këtë me të dytën e krimeve të tyre; shkeljen, nëpërkëmbjen nga ana e tyre e të drejtave të robëve të Allahut xh.sh., dhe përhapjen e korruptionit nga ana e tyre, dhe rezultatet e pasojat e tij.

(Fraza) **وَإِذَا قِيلَ** "ve idhà kîle", "kur atyre u thuhet" ashtu siç është e lidhur, në sajë të tregimit, me **يَقُولُ** "jekulu", "i cili thotë" tek **وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ** "Ve Min el-Nâsi men jekulu", "Ndërsa ka edhe njerëz (hipokritë) të cilët thonë:"<sup>1</sup> dhe nëpërmjet kuptimit të saj **يَخَادِعُونَ**

"Jukhâdiûne", "mashtrojnë"<sup>2</sup>; po ashtu në sajë të vvetes ajo është e lidhur me **يَكْذِبُونَ** "jekdhibûne", "gënjejnë"<sup>3</sup>.

Ndryshimi nga një fjali kategorike -e prerë- për tek një fjali kushtore është një tregues dhe një shenjë e fshehur e fjalisë së nënkopuar midis tyre. Sikur ajo të thonte:

"Për ta është një ndëshkim i rreptë për atë që ata gënjejnë; sepse kur gënjejnë, ata shkaktojnë përçarje e konflikt, dhe kur shkaktojnë përçarje, ata shkaktojnë korruption; dhe në qoftë se janë paralajmëruar, ata nuk e pranuan atë, dhe në qoftë se u është thënë atyre: Mos përhapni korruption... dhe kështu me radhë."

Vendosja e frazave të këtij vërseti, edhe në mënyrë të qartë edhe të nënkopuar:

Është pikërisht e njëjtë si renditja dhe lidhja në shembullin që unë do t'ju jap tani:

Në qoftë se ti sheh një njeri i cili ka marrë një rrugë që të çon në humbje, ti para së gjithash e paralajmëron atë, duke i thënë:

Kjo rrugë -metodë- do të jetë shkatërrim për ty; prandaj mos e ndiq atë! Në qoftë se ai nuk i shmanget duke përdorur mendjen e vet, ti do t'i përtërish përpjekjet e tua për ta penguar atë duke e ndaluar dhe qortuar, dhe ti do ta përforcosh këtë dhe do të ngulisësh në trurin e tij ose duke e frikësuar atë me kërcënimin e dënimit, ose duke e zbutur zemrën e tij duke ngulitur simpatinë, ashtu siç do të shpjegohet për ju më poshtë.

Në qoftë se personi është kryeneç, kokëfortë, i pabindur, këmbëngulës dhe ka hipur mbi injorancën e përbërë, ai nuk do të jetë i heshtur por do të mbrojë vveteten. Sepse është karakteristikë e të korruptuarve ta shohin korruptionin e tyre si të mirë e të dobishëm. Sepse nga natyra, njeriu nuk kryen vepra të mbrapshta duke menduar se ato janë të mbrapshta e të liga. Pastaj ai do të japë dëshmi se rruga e tij është e drejtë, duke pretenduar se kjo është e mirënjohur dhe se ti

<sup>1</sup> Kuran, 2:8

<sup>2</sup> Kuran, 2:9

<sup>3</sup> Kuran, 2:10

nuk ke tē drejtē ta paralajmērosh atē dhe se ai nuk ka nevojē pēr kēshillēn tēnde. Madje ti ke nevojē tē mēsosh rrēth rrugēs sē tij. Sepse e vētmja rrugē e sheshuar ēshtē e tij dhe ti nuk duhet tē sulmosh rrugēn mē tē mirē.

Dhe nē qoftē se ai person kryeneç ēshtē dyfytyrēsh -hipokrit- ai gjithashtu duhet tē ketē njē gjuhē tē bigēzuar (tē ndarē nē dysh, nē dy gjuhē). Nga njēra anē ai do tē pērpiqet ta shpērdorojē e t'i ndērrojē drejtim, duke e paralajmēruar dhe duke e heshtur, dhe nga ana tjetēr ai do tē mbrojē rrugēn e tij duke i thēnē: "Nga ana e jashtme unē i vendos gjērat drejt ashtu siç dēshiron ti, dhe nga ana e brendshme ashtu siç unē besoj". Pastaj pēr tē mbēshtetur atē qē ai pretendon, thotē: "Vendosja drejt e gjērave ēshtē diçka qē unē e kam bérē gjithmonē -kjo ka qenē cilēsia ime e vazhdueshme, jo qē unē kam qenē i drejtē tani, pas pērhapjes sē korruptionit mē parē nga ana ime.

Pastaj nē qoftē se ai person ēshtē kokēfortē e kryeneç si Faraoni, vazhdon me ngulm tē pērhapē rrugēn -medhbehin- e tij dhe e deklaron kēshilluesin e tij si gēnjeshtar dhe bēn insinuata kundra njerēzve tē sē vērtetēs deri nē kētē shkallē, atēherē ēshtē e qartē se ilaçi nuk ka mē efekt mbi tē. Mbetet vetēm njē ilaç dhe ai ēshtē ta myyllēsh nē karantinē. Ky trajtim pērbēhet nga tē paralajmēruarit e njerēzve dhe tē informuarit e tyre se ai ēshtē i korruptuar, nuk ēshtē bérēsi i tē mirēs, sepse ai nuk i pērdor as mendjen e tij dhe as ndjenjat qē ta ndjejē e perceptojē kētē gjē e cila ēshtē kaq e qartē dhe e prekshme.

Nē qoftē se i ke kuptuar lidhjet e renditura nē shembullin e lartēpermendur (domethēnē, progresin e argumentit), ti do t'i kesh kapur lidhjet midis frazave, qofshin tē cituara ose tē aluduara, nē kētē

vērset nga **وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ** "Ve idħà kīle lehum" "Dhe kur atyre u thuhet" deri nē fund.

Sepse renditja e tyre ēshtē aq e natyrshme dhe aq me stil tē ngjeshur saqē mrekullia shkrepētin prej poshtē saj -si thēngjill i ndezur.

#### Renditja dhe vēndojsja e pjesēvē tē frazave:

Shqyrtoje kētē: pērcaktueshmēria e shprehur nga **إِذَا** "idħà" "kur" tek "Ve idħà kīle lehum là tuftidū fi el-erdt" "Dhe kur atyre u thuhet: "Mos

bēni djallēzi -mbrapshti- nē tokē", tregon obligimin e domosdoshēm pēr ndalimin e asaj qē ēshtē e paligjshme.

**قِيلَ** Forma pēsore -diateza pēsore- e **"kīle"** "u thuhet" tregon se njē ndalim i tillē ēshtē farz *kifajet* mbi tē gjithē.

Nē **لَهُمْ** "le-nē" e **لَهُمْ** "lehum" "atyre" ēshtē njē shenjē se ndalimi duhet tē jetē nē formēn e kēshillimit, jo tē detyrimit; dhe nēpērmjet bindjes dhe jo forcēs.

**لَا تَنْسِدُوا** "Lā tuftidū" "Mos bēni djallēzi -mbrapshti" ēshtē njē pērmbledhje nē formēn e njē silogizmi kushtor -arsyetimi deduktiv kushtor; domethēnē, mos e bēni atē sepse ajo do tē ćojē nē anarki.

Lidhjet -qē kērkojnē- bindje do tē kēputen, drejtesia dhe sistemi i saj do tē flaken nē rrēmuje; hallkat e unitetit do tē kēputen, dhe kjo do tē ćojē nē korruption. Prandaj mos e bēni atē qē tē mos shkaktohet korruption".

**فِي الْأَرْضِ** **fi el-erdt**, "nē tokē" mbēshtet dhe pērjetēson ndalimin, sepse ndalimi i kēshilluesit ēshtē i pērkohshēm. Prandaj paralajmērimi duhet tē fiksohet pērjetēsish nē trurin e personit tē cilit i adresohet duke e caktuar ndērgiegjen e tij qē gjithmonē ta ndalojē atē nga poshtē. Kjo bēhet ose duke lēvizur damarin e tij tē simpatisē -frymēs shoqērore- ose duke i shkaktuar dēshirēs sē tij tē ikē nga

**فِي الْأَرْضِ** **fi el-erdt**, "nē tokē" i zgjon kēto dy damarē, sepse fraza u adresohet -hipokritēve- duke u thēnē: "Kjo shthurja juaj pērhapet nēpēr njerēzimin. Pērse ju ndieni njē urejtie dhe njē zemērim tē tillē ndaj tē gjithē njerēzve, disa prej tē cilēve janē tē pafajshēm, ose tē varfēr, dhe disa nuk i njihni? A nuk ndieni keqardhje dhe dhimbje pēr ta? Ne mund tē shohim se ju nuk keni simpati pēr llojin tuaj njerēzor, por tē paktēn ju duhet tē kuptoni se ky veprimi juaj tērheq zemērimin dhe urejten e tyre mbi ju.

• Në qoftë se ti do tē pyesje: Cili nga objektivat -e hipokritëveshikon tek njerëzit në përgjithësi? Si mundet që shthurja e tyre tē përhapet tek gjithësecili?

**Ty do tē tē thuhej:** Ashtu si çdo gjë e cila shfaqet e errët dhe e shëmtuar për një person i cili shikon nëpërmjet një xhami tē errët -tē syzeve-, po ashtu çdo gjë shfaqet e urryer dhe e mërzitshme për personin shikimi -i brendshëm- i tē cilit është mbuluar nga hipokrizia dhe zemra e tē cilit është prishur nga mosbesimi. Zemra e tij është plot ligësi e urrejtje ndaj tē gjithë njerëzve, madje ndaj tē gjitha qënieve, dhe me kryeneçësi ai i kundërshton ata. Për më tepër, ashtu si në qoftë se një dhëmbëz e një rrote me fletë në funksionet e një ore do tē dëmtuhej e thyhej, ora do tē ndikohej e prekej edhe si tërësi edhe në mënyrë tē pjesshme, po ashtu rregulli i trajtës njerëzore do tē ndikohej e prekej nga hipokrizia e një njeriu. Sepse ai është vënë në rregull nëpërmjet drejtësisë, islamit dhe bindjes. Por medet, sa keq! Helmet e përhapura vazhdimisht -tē hipokritëve- janë grumbulluar dhe kanë dhënë si rezultat poshtërsinë e tanishme.: "

**قالوا إنما نحن مصلحون** “*kālu in-nemā naħnu Muslīhūne*”, “ata thonë: “*Ne jemi vetem pajtues*”; në “*kālu*”, “*ata thonë*” në vend tē “*la jakbelune en-nesiha*”, “*ata nuk e pranojnë këshillen*”, e cila do tē kishte qenë e përshtatshme në kontekst, është një tregues se ata janë duke bërë pretendime arrogante dhe u bëjnë thirrje tē tjerëve për tek *medħhebi* -rruga- e tyre.

**أَنَا** “*in-nemā*” (pjesëza kufizuese, që ka kuptimin “*vetem ose veçse kjo apo ajo gjë...*” posedon dy veçori:

**E para:** Fraza në tē cilën ajo është përfshirë medoemos duhet tē tregonjë diçka tē njobur, ose në realitet ose në pretendim. Kështu, ajo nënkuption poshtërim, përcëmin e atij që jep këshillë, si dhe vazhdimin e tyre -hipokritëve- në injorancë e tyre tē përbërë.

**E dyta:** Kufizimi i **أَنَا** “*in-nemā*”, “*vetem ose veçse kjo apo ajo gjë*” tregon se në këndvështrimin e tyre, rregullimi i gjërave është e papërzier me korruption. Dhe kjo është një insinuatë kundra besimtarëve -tē cilët thonë tē kundërtën.

Përdorimi i pjesores aktive nē **مُصلحون** “*Muslīhūne*”, “*pajtues*” nē vend tē emrit foljor **نَصْلَحٌ** “*nuslihu*”, “*ne pajtojmë*” tregon se -ata pretendojnë se ky atribut i tyre është i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm, dhe ajo çfarë ata bëjnë është një rregullim -përmirësim- i plotë. Por ata po shtiren gjithashtu edhe në këtë thënie, sepse ajo që ata shprehin e pranojnë në brendësi është e kundërtë e asaj që tregojnë në anën e jashtme:

Në brendësi ata e pretendojnë korruptionin e tyre tē janë gjëra tē përmirësuara, dhe në anën e jashtme ata me hipokrizi pretendojnë se ajo çfarë ata bëjnë është për rregullimin -përmirësimin- e besimtarëve dhe në interesin e tyre.

**الآنهم هم المفسدون ولكن لا يشعرون** “*Ela in-ne hum hum el-mufsidūne ve lakin la jeshi'urūne.*” “Në tē vërtetë janë pikërisht ata tē cilët sjellin trazira, por ata nuk e marrin vesh.”

**Shqyrtoje këtë:** Verseti i mëparshëm nënkupto i deduktoi një numër gjérash rreth hipokritëve: Për shembull, përhapjen e ideve tē tyre, pretendimin se ata në mënyrë tē vazhdueshme i rregullojnë dhe i vendosin gjérat drejt, dhe se kjo është një atribut i vazhdueshëm i tyre dhe se përmirësimi i gjërave është i paprekur nga korruptioni; se kjo është e quartë dhe e mirënjohur; dhe poshtërimin e tyre ndaj besimtarëve dhe akuzimin për injorancë ndaj atyre që u japid këshillë.

Këtu Kurani u përgjigjet atyre me fjalinë e tanishme, e cila përban elemente që provojnë korruptionin e tyre dhe se ata janë bërë me tē; se korruptioni është i kufizuar tek ata dhe se ky është një fakt i vërtetuar, dhe i paralajmëron njerëzit kundra shëmtisë së tyre dhe i shfaq ata tē janë injorantë duke mohuar ndjeshmërinë e tyre, sikur ata tē ishin qënie tē pajeta. Dhe në qoftë se ti dëshiron, shqyrtoje këtë:

**إِلَى** (Pasthirrma intensifikuese) “*ela*” “*oh, vërtet*” është për tē dhënë alarmin, për tē tē vënë në gatishmëri, ose për paralajmërim; shiko se si me paralajmërimin e saj ajo e deklaron gënjeshtër tē gjithë propagandën e tyre, për tē cilën aludohet me fjalen “*kālu*”, “*ata thonë*”.

(Pjesëza vërtetuese) “*inne*”, “*në të vërtetë, sigurisht*, e cila është për verifikim:

Shiko se si ajo i refuzon, i hedh poshtë të gjitha pretendimet e tyre të mirënjohnura nëpërmjet **انما** “*in-nema*”, “*vetëm, veçse*”. Sikur **inne** është duke thënë se në realitet gjendja e tyre e brendshme është ajo e korrupsionit, prandaj qënia e tyre të drejtë nga ana e jashtme nuk do t'u sjellë dobi atyre.

Kuptimi kufizues i përemrit vетор **hum**, “*ata*” u kunderpërgjigjet insinuatave të nënkuptuara tek **نحن** “*nahnu*”, “*ne*” dhe **انما** “*innema*”, “*vetëm, veçse*”.

Nyja shquese tek **المفسدون** “*el-mufsidûne*”, “*pajtuesit*”, e cila tregon se ti e sheh në personat e tyre thelbin -të vërtetën- e atyre që shkaktojnë korrupsion dhe se ata janë të shthurur në esencë -shiko se si kjo e hedh poshtë, e përgënjeshtron kufizueshmërinë e shprehur nga **انما** “*innema*”, “*vetëm, veçse*”.

**ولكن لا يشعرون** “*ve lakin la jesh'urûne*”, “*por ata nuk e marrin vesh*” si ajo e kundërshton dhe e hedh poshtë përgënjeshtrimin e tyre ndaj atij që u jep këshillë dhe i paralajmëron ata dhe pretendimin e tyre se ata nuk kanë nevojë për këshillë, meqë pohimet, thëniet e tyre -rreth asaj që janë- njihen.

\* \* \*

## VËRSETI 13

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ أَمْنَوْا كَمَا أَمْنَى النَّاسُ قَالُوا آنَّئُمْ مِّنْ كَمَا  
أَمْنَى السُّفَهَاءُ إِلَّا إِنَّهُمْ هُمُ السُّفَهَاءُ وَلَكِنْ لَا يَعْلَمُونَ

*Ve idhà kîle lehum Āminu këmà Āmene el-nâsu kâlú Īnuēminu këmà  
Ā'mene el-sufehâu Ela in-nehum hum el-sufehâu ve lakin là jaēlemûne.*

Dhe kur u thuhet këtyre (hipokritëve): “Besoni siç kanë besuar edhe njerëzit e tjerë, ata thonë: “A të besojmë siç kanë besuar mendjelehtët?” Në të vërtetë, këta vetë janë mendjelehtët, por nuk e dinë.

Vendorja -pozicionimi- i këtij vërseti dhe lidhja e tij me vërsetin e mëparshëm:

**Shqyrtoje këtë:** Për sa ka të bëjë me këto dy vërsete (2:11, 2:13) që përbëhen nga këshillimi dhe udhëzimi; urdhri për atë që është e ligjshme dhe zburimi (*et-tahlijeh*) dhe nxitja -në vërsetin e tanishëm- lidhen me ndalimin e asaj që është e paligjshme -pastrimin (*takhlijeh*), dhe me kërcënimin në ajetin e mëparshëm.

Dhe për sa ka të bëjë me atë që të dy përshkruajnë krimet e -hipokritëve-, përcëmimi i tyre ndaj besimtarëve dhe krenaria -në vërsetin e tanishëm- lidhen me bërjen mbapshti nga ana e tyre (*ifasad*) në vërsetin e mëparshëm. Ashtu siç lidhet bërja e tyre mbapshti me shthurjen e tyre; çdo lloj prej tyre është një degë e pemës Zekum të hipokrizisë.

Lidhjet midis frazave të vërsetit:

**Ve idhà kîle** شُقْرُتُهُمْ أَمْنَوْا كَمَا أَمْنَى النَّاسُ  
Shqyrtoje këtë: Me fjalinë **lehum Āminu këmà Āmene el-nâsu**, “Dhe kur u thuhet këtyre (hipokritëve): “Besoni siç kanë besuar edhe njerëzit e tjerë”, (vërseti së pari sugjeron me

pjeset e tij obligimin e thirrjes -ftesës- pér tek besimi i singertë duke ndjekur -imituar- masat e njerëzve, tē cilët janë -besimtarët- e vërtetë; ndërgjegjja vazhdimisht i nxit ata pér tē vepruar kështu. Pastaj ajo citon

-përgjigjen e hipokritëve:- **قَالُوا أَنَّمُنْ كَمَا أَمِنَ السُّفَهَاءُ** “*kālū*”, “ata thonë” e “*Enuēminu kēmā Ā'mene el-sufehāu*”, “*A tē besojmë siç kanë besuar mendjelehtët?*” duke treguar kryeneçsinë dhe krenarinë e tyre dhe pretendimin se ata janë nē tē drejtën ashtu si tē gjithë gënjeshtarët që e shohin gënjeshtërni si tē vërtetë dhe që e mendojnë injorancën e tyre si njohje. Sepse zemrat -e hipokritëve- janë prishur nga hipokrizia; dhe krenaria dhe tendencia pér tē korruptuar burojnë nga shthurja, dhe pér shkak tē kësaj ata u bënë kryeneçë. Nëpërmjet bërges mbrapshti ata nē mënyrë tē fshehtë bisedojnë dhe bëjnë plane pér t'i çudhëzuar tē tjerët. Dhe nē krenarinë e tyre, ata e konsiderojnë fetarinë e fortë -plot pasion- dhe besimin e plotë, shkakun e pavarësisë dhe tē vetëmjaftueshmërisë, tē jenë poshtëri, marrëzi dhe varfëri.

Pér më tepër, pér shkak tē dyfaqësisë, ata shtiren kur e thonë edhe këtë, gjithashtu. Sepse nga ana e jashtme ata thonë: Si mund tē jemi ne si mendjelehtët, pasi ne nuk jemi tē marrë? Ne jemi aq superiorë aq sa mund tē dëshironi?! Ndërsa nga ana e brendshme ata thonë: “Si mund tē jemi ne si besimtarët, sepse shumica e tyre janë tē vobektë e skamës? Dhe ata nē shikimin tonë janë mendjelehtët dhe fundëria e kombeve tē ndryshëm. Ju tani mund t'i zbatoni pikat e holla pér dy pjeset e fjaliseë kushtore.

Atëherë Kurani kthen mbrapsht mbi ta gurin që ata hodhën mbi besimtarët duke e futur atë poshtë gurmazeve tē tyre: **أَلَا إِنَّمَا هُمُ السُّفَهَاءُ** “*Ela in-nehum hum el-sufehāu*”, “*Nē tē vërtetë, këta vete janë mendjelehtët*”. Sepse kushdo që eshtë kryeneç deri nē këtë shkallë dhe eshtë injorant pa e kuptuar atë, meriton tē shfaqet midis njerëzve dhe tē shpallet si i dobët mendërisht, sepse ky eshtë një fakt i vërtetuar; dhe thirrja që ata i quajnë besimtarët mendjelehtë buron pér shkak tē dobësisë së tyre mendore.

Pastaj me thënien: **وَلَكُنْ لَا يَعْلَمُونَ** “*ve lakin la jaëlemûne*”, “*por ata nuk e dinë*” eshtë duke treguar se injoranca e tyre eshtë e përbërë pér shkak se ata janë tē pavetëdijshëm pér tē. Prandaj do tē ishte e padobishme t'u

japësh atyre këshillë; duhet tē largohesh krejtësisht prej tyre. Sepse vetëm ata që e kuptojnë se janë injorantë mund tē përfitojnë nga këshilla.

**Vendosja (dhe lidhjet midis) pjesëve të frazave:**

**وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ أَمِنُوا كَمَا أَمِنَ النَّاسُ** “*Ve idħha kif lehum Āminu kēmā Āmene el-nāsu*”, “*Dhe kur u thuhet ketyre (hipokritëve: “Besoni siç kanë besuar edhe njerëzit e tjerë”*

Në këtë frazë, siguria e shprehur nga fjala **إِذَا idħha** “*kur*” tregon domosdoshmërinë e dhëniec së udhëzimit (pér njerëzit) nëpërmjet “tē urdhëruarit e asaj që eshtë e ligjshme”.

**قِيلَ** “*kif lehem Āminu*”, “*u thuhet*” diateza pësore nënkupton se dhënia e këshillimit eshtë një obligim që mund tē kryhet nga një numër njerëzish nē emrin e komunitetit (*ala sebil el kifajeh*), ashtu siç eshtë përmendor.

Përdorimi i foljes **أَمِنُوا** “*Āminu*”, “*Besoni*” nē vend tē **أَخْلَصُوا فِي إِيمَانِكُمْ** “*A'hlisu Fi imanikum*” “*jini tē singertë nē besimin tuaj*” tregon se besimi i pasinqertë nuk eshtë besim.

Fraza **كَمَا أَمِنَ ا** “*kēmā Āmene*”, “*siç kanë besuar*” eshtë një aluzion pér shembujt e njerëzve tē admirueshëm e tē shkëlqyer, duke sugjeruar se singjeriteti mund tē fitohet duke i ndjekur ata.

**نَاسٌ** Fjala “*el-nāsu*”, “*njerëzit*” përban dy pika, tē cilat e shtyjnë **كَمَا أَمِنَ النَّاسُ** që gjithmonë tē veprojë pér mirë. Sepse **“kēmā Āmene el-nāsu”** “*siç kanë besuar edhe njerëzit e tjerë*” nënkupton: “ndiqni masat e njerëzve, sepse t'i kundërshtosh ata eshtë një gabim që zemra nuk eshtë aq e pacipë që ta kryejë”.

Së dyti, ajo nënkupton se ata që nuk besojnë, nuk duhet të konsiderohen si njerëz të vërtetë; vetëm besimtarët janë qënie të vërteta humane, sikur të tjerët janë njerëz vetëm në formë. Sepse besimtarët kanë përparuar në plotësinë, dhe humanizmi i vërtetë është i veçantë për ta, ndërsa pjesa tjetër kanë rënë prej nivelit të humanizmit.

Fraza: **قَالُوا آنُّمْ كَمَا مَنِ السُّفَهَاءُ**, “*kālū Enuēminu kēmā A'mene el-sufehāu*”, “ata thonë: “*A tē besojmë siç kanë besuar mendjelehtët?*” ka kuptimin: “Ne nuk presim këshillë. Si do të ishim ne si këta mjeranë të ulët? Si do të mundej që ne njerëzit e pozitës të bëhem baraz me ta? Ne i shohim ata si të dobët mendërisht?”:

Kështu fjala **قَالُوا** “*kālū*”, “*ata thonë*” aludon për vetëjustifikimin e tyre, përhapjen e pikëpamjeve të tyre nga ana e tyre, përbuzjen dhe shpërfilljen e këshillës nga ana e tyre, dhe për arrogancën dhe pretendimin e tyre.

**أَنْتُمْ** **كَمَا مَنِ السُّفَهَاءُ** Pyetja retorike “*Enuēminu*”, “*A tē besojmë*” tregon kapjen fort të tyre me arrogancë pas pikëpamjeve të tyre injorante, pas injorancës së përbërë. Sikur, duke përdorur formën pyetëse, ata janë duke i thënë atij që i këshillon:

O këshillues: “konsultohu me ndërgjegjjen tënde! A e sheh ti drejtësinë ta pranojë kundërshtimin tonë -a mundesh me të gjithë drejtësinë ta pranosh se ne mohojmë (fenë)!”

Për më tepër, **قَالُوا** “*kālū*” “*ata thonë*” përban tre aspekte të njëpasnjëshëm; domethënë: para së gjithash ata u adresohen, u thanë veteve të tyre, pastaj ndjekësve të tyre, pastaj udhëzuesve të tyre, sepse është e zakonshme kur jepet këshilla për një person, këshilluesi së pari konsultohet me veten e tij, pastaj me ndjekësit e tij, pastaj ta kthen ty me rezultatet e arsyetimit të tij. Prandaj, kur atyre iu tha ajo çfarë iu tha, ata shqyrtuan zemrat e tyre të korruptuara dhe ndërgjegjjet e tyre të prishura dhe iu shfaq rruga e mohimit. Ajo çfarë ata thanë, është një interpretim i asaj që është në zemrat e tyre. Pastaj me shikimin e bërjes mbrapshti ata iu referuan vëllezërve të tyre, dhe përsëri u treguan atyre rrugën e mohimit, dhe ata filluan të mbajnë bisedime të fshehta. Pastaj

nëpërmjet bërjes së justifikimeve dhe për t'i çuar në rrugë të gabuar ata u kthyen tek ai që u jepte këshilla dhe thanë në mënyrë provokuese: “Ndryshimi ndërmjet nesh është aq i madh saqë nuk mund të krahasohet me ta. Ata janë të varfér dhe duhet të janë të fortë në fe dhe në sufizëm; ata thjesht duhet të janë ashtu. Ndërsa ne jemi njerëzit e rangut të lartë dhe të pozitës”. Në arrogancën e tyre ata i bëjnë thirrje atij që është duke u dhënë këshillë të drejtë, dhe si një dinakéri dhe dredhi thonë me gënjeshtra:

O këshillues! Mos na mendo neve si mendjelehtë; ti nuk duhet të imagjinosh të jemi si mendjelehtë e atillë! Jo, përkundrazi, ne veprojmë siç veprojnë besimtarët e singertë”. Por në brendësi ata thonë: Ne nuk jemi si ata besimtarë të varfér e të pavlefshëm, gjë e cila është një aluzion i tërthortë për shthurjen e tyre dhe përhapjen e korrupsionit dhe për arrogancën dhe dyfytyrësinë e tyre.

**كَمَا مَنِ السُّفَهَاءُ** Sa për “*kēmā A'mene el-sufehāu*”, “siç kanë besuar mendjelehtë” domethënë, “Ju i supozoni besimtarët të janë njerëzit e plotësimit, por në shikimin tonë ata janë lypës të përbuzur. Ata janë të detyruar të kthehen, orientohen tek feja me numrin e madh të tyre; secili prej tyre është mendjelehti i një kombi”.

Pretendimi i tyre se nuk mund të ketë krahasim midis tyre tregon se islami është strehimi i të nëpërkëmburve, vendstrehimi i fukarenjve, mbrojtësi i të vërtetës, ruajtësi i të drejtës, penguesi i arrogancës, përbajtësi i krenarisë, frenuesi i mendjemadhësisë, dhe islami është kriteri i vetëm i plotësisë dhe i lavdisë.

Pretendimi i hipokritëve duke qenë i ndryshëm tregon shkakun e hipokrizisë, e cila për pjesën më të madhe është egoizëm, krenari dhe arrogancë, ashtu siç është shpjeguar nga vërseti,

“*Ne tē shohim ty vetëm si një njeri ashtu si ne; as nuk shohim kënd të tē vijë pas, por vetëm ata më të parëndësishmit e më të ulëtit nga radhët tona, madje edhe ata tē erdhën pas pa menduar.*”<sup>1</sup>

Kjo gjithashtu është një shenjë e fshehur se islami nuk mund të bëhet një instrument dominimi dhe shtypjeje në duart e njerëzve të

<sup>1</sup> Kur'an, 11:27

dhënë vetëm pas kësaj dynjaje dhe të rangut të lartë; përkundrazi islami është një mjet për të vendosur të drejtën në dispozicion të të varfërve dhe të vobektëve, në kundërshtim me fetë e tjera. Historia e dëshmon këtë realitet.

**الآنهم هم السُّفَهَاءُ**  
Sa përfjalinë “*Ela in-ne hum hum el-sufehau*” “Në tē vërtetë, këta vetë janë mendjelehtët”, shqyrtoje këtë: Arsyja e vetme përsulmet e fuqishme ndaj hipokrizisë dhe dëshmimi i tij ndaj saj është se llojet e ndryshme të saj kanë qenë shkaku i shumicës së fatkeqësisë që i ranë botës islamike.

Pasthirma **أَلْيَا** “*Ela*”, “oh, vërtet” është përtë térhequr vëmendjen dhe përtë shpallur marrëzinë e tyre dhe përt'i bérë thirrje opinionit publik të dëshmojnë përmendjelehtësinë e tyre. Kuptimi i vërtetë i pasthirmës **أَلْيَا** “*Ela*” është, “A nuk e dini se ata janë tē dobët mendërisht? Domethënë, ju duhet ta dini!”

Pjesëza vërtetuese **انْ** “*in-ne*”, “Në tē vërtetë, sigurish” vepron si një pasqyrë përtë vërtetën dhe është një mjet i saj, sikur ajo tē thonte: “Referojuni tē vërtetës dhe kuptioni se sofistikat e tyre tē jashtme janë tē pabaza”.

Përemri **هُمْ** “*hum*”, “ata’ nënkupton kufizueshmëri (përveten e tyre) dhe (qëllimi i tij) është tē refuzojë vetëjustifikimet e tyre dhe përtë zembrapsur akuzimin e dobësisë mendërisht tē bérë nga ana e tyre ndaj besimtarëve, ashtu siç tregohet nga “*kem'a A'mene el-sufehau*”, “siç kanë besuar mendjelehtët”. Domethënë, tē dobët mendërisht janë ata njerëz tē cilët braktisin -punën për- Ahiret me porosi tē krenarisë së tyre, tē egoizmit dhe tē kënaqësisë kalimtare, ndryshe nga ata tē cilët fitojnë jetën e përjetshme nëpërmjet braktisjes së dëshirave tē tyre kalimtare.

Pastaj nyja shquese **أَلْيَا** ‘el’ i **السُّفَهَاءُ**, ‘*el-sufehau*’, “mendjelehtët” tregon se është fakt i njohur se ata janë tē dobët

mendërisht. Gjithashtu ajo tregon plotësi; domethënë, mendjelehtësia e plotë është e tyre.

**ولَكُنْ لَا يَعْلَمُونَ** “*ve lakin la jaëlemüne*”, “por nuk e dinë”.

Kjo përban tre tregues:

**I pari:** Njohja dhe mendjemprehtësia janë tē domosdoshme ndërmjet tē vërtetës dhe gjenjeshtës dhe përtë dalluar ndërmjet rrugës së besimtarëve dhe asaj tē hipokritëve, ndryshe nga korrupzioni dhe konflikti -i hipokritëve-, tē cilët mund tē kuptohen e ndjehen edhe nga ata me zgjuarsi tē pakët. Përkëtë arsy, (ashtu siç mbylllet ky vërset me

frazën) **ولَكُنْ لَا يَعْلَمُونَ** “*ve lakin la jaëlemüne*”, “por nuk e dinë”, edhe vërseti i mëparshëm i bashkangjiti atij frazën **ولَكُنْ لَا يَشْعُرُونَ** “*ve lakin la jesh'urune*”, “por ata nuk e marrin vesh”.

**I dyti:** **لَا يَعْلَمُونَ** “*La jaëlemüne*”, “nuk e dinë”, ashtu si frazat e ngjashme **أَلَا يَعْلَمُونَ** “*Abla yä'lemaun*” **أَلَا يَتَدَبَّرُونَ** “*Abla yätadbarun*” **أَلَا يَتَدَكَّرُونَ** “*Abla yätadkarun*” **لا يَعْلَمُونَ** “*la jaëklune*”, “nuk mendojnë”, **لا يَتَجَهَّزُونَ** “*la jetefek-kerune*”, “nuk reflektojnë” dhe **لا يَتَدَهَّزُونَ** “*la jetedshek-kerune*”, “nuk kujtojnë” tregojnë se islami bazohet mbi arsy, urtësi dhe njohje. Ai karakterizohet nga tē qenit i pranueshëm nga tē gjitha mendjet e shëndosha, ndryshe nga fetë e tjera, tē cilat bazohen mbi imitim e verbër dhe mbi fanatizëm. Ky tregues është sihariq e tregues i mirë -përislamin-, siç është diskutuar në një vend tjetër<sup>2</sup>.

**I treti:** Njeriu duhet t'u shmanget (hipokritëve) dhe tē mos interesohet e preokupohet me ta, sepse asgjë nuk mund t'i u vlejë atyre nga dhënia e këshillës; ata nuk janë tē vetëdijshëm përinjorancën e tyre saqë ata tē mund ta dëbonin e tē çliroheshin prej saj.

\* \* \*

<sup>2</sup> kjo i referohet Predikimit të Damaskut

## VËRSETET 14 -15

وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ آمَنُوا قَالُوا أَمْنَا وَإِذَا خَلَوُا إِلَيْ  
شَيَاطِينِهِمْ قَالُوا آنَا مَعَكُمْ إِنَّا نَحْنُ مُسْتَهْزِئُونَ \* اللَّهُ  
يُسْتَهْزِئُ بِهِمْ وَيَمْدُهُمْ فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَلُونَ

*Ve idhà lekú el-ledhíne àmenú kàlú àmen-na. Ve idhà khaleu ilà shejatníhim kàlú in-na meakum in-nemà nahnu Mustehziúne. All-làhu jehteziu bishim ve jemud-duhum fi tug-jànhim ja àmehune.*

Ndërsa kur takohen me ata që besojnë, u thonë: "Ne besojmë", por kur janë vetëm me shjetanët e tyre, thonë: "Në të vërtetë ne jemi me ju, në të vërtetë ne vetëm talleshim". Allahu i përqesh ata dhe vetëm ua shton më shumë të këqiat që të sorollaten verbërisht.

**Lidhja e kuptimit të këtyre vërseteve me vërsetin e mëparshëm:**

Kjo përbëhet nga lidhja (nëpërmjet lidhëzes "Ve" "dhe") e krimit të katërt të hipokritëve; domethënë, përqeshja dhe përbuzja, me krimet e tyre të mëparshme; domethënë, akuzimi i tyre ndaj besimtarëve si të dobët mendërisht, përhapja e korruptionit nga ana e tyre dhe shthurrja e tyre.

**Vendosja e këtyre frazave që përbëjnë këto vërsete (dhe lidhjet) ndërmjet tyre:**

Besimi, si një pikë mbështetjeje përballë vuajtjeve dhe si burim ndihmeje për realizimin e shpresave të njeriut, posedon tre veçori esenciale:

**E Para:** Sedra -Vetënderimi, që buron nga pasja e një mbështetjeje të tillë, dhe shenja e së cilës është të mos e ulësh veten me servilizëm e me poshtërim.

**E Dytë:** Dhembshuria -mëshira- Shenja e së cilës është të mos i poshtërosh të tjerët dhe as të jesh përbuzës ndaj tyre.

**E Treta:** Respekti për të vërtetën dhe njohja e vlerës së saj. Sepse personi i cili posedon diçka me vlerë të lartë posedon të vërtetën; ai posedon një xhevahir të veçantë dhe nuk do të jetë përcmues e përbuzës, ndaj të vërtetës. Sepse ai gjithashtu është i nderuar, plot dinjitet.

Gjithashtu, e kundërtë e besimit, domethënë, hipokrizia, ka tre veçori, ka të kundërtat e atyre të besimit: servilizmi, dëshira për të korruptuar, dhe arroganca që çon në përcmimin e të tjereve.

Në qoftë se ti i ke kuptuar këto, atëherë mësoje se hipokrizia i shkakton personit të jetë servil, gjë e cila shkakton poshtërimin e tij; në këtë ai është shtiracak që do të thotë se ai është lajkatar, gjë e cila është gjenjeshtër. Kjo tregohet nga "وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ آمَنُوا قَالُوا أَمْنَا" "Ve idhà lekú el-ledhíne àmenú kàlú àmen-na", "Ndërsa kur takohen me ata që besojnë, u thonë: "Ne besojmë".

Për më tepër, hipokrizia korrupton zemrën, dhe kjo e bën shpirtin të ndjehet si jetim; domethënë, qenia e tij pa pronar, pa mbrojtës dhe pa padron; dhe kjo i jep shkas frikës, e cila i bën njerëz të tillë të strehohen tek fshehja e personave të tyre. Kjo tregohet nga "وَإِذَا خَلَوُا" "Ve idhà khaleu", "por kur janë vetëm".

Gjithashtu, hipokrizia i shkakton një njeriu të këpusë lidhjet me të afërmit e tij, dhe kjo shuan dhembshurinë e tij, dhe zhdukja e saj e çon njeriun në bërjen mbrapshti, dhe kjo çon në përçarje, dhe kjo në tradhëti, dhe kjo në dobësi, e cila e detyron atë të kërkojë një mbështetës dhe një ndihmës. Dhe kjo tregohet nga fraza "إِلَى شَيَاطِينِهِمْ" "ilà shejatníhim", "me shjetanët e tyre".

Pastaj për shkak se hipokrizia është një injorancë e dridhur, e lëkundur, ajo u shkakton -hipokritëve- të lëkunden, gjë e cila i çon në paqëndrueshmëri, dhe pastaj në mospasjen e një mënyre pikpamjeje, dhe pastaj tek qenia e tyre të pabesuar, dhe kjo i detyron ata që në mënyrë të vazhdueshme të ripërtërijnë marrëveshjet. Kjo sekuencë ngjarjesh tregohet nga "كَالُوا أَنَّا نَحْنُ" "kàlú in-na meakum", "thonë: "Në të vërtetë ne jemi me ju".

Pastaj, duke ndjerë nevojën pér tē bérë shfajësime, nga paqëndrueshmëria e tyre, ata nuk i japid rëndësi tē vërtetës. Pér shkak tē pavlefshmërisë së tyre, ata zhvlerësojnë vlerën e saj tē lartë. Pér shkak tē poshtërimit tē tyre, ata pérçmojnë gjërat e larta. Dhe nē dobësinë e tyre, ata rrëmbehen nga krenaria. Kurani aludon pér këtë me fjalët: **قالوَ آنَّا نَحْنُ مُسْتَهْزِئُونَ** “in-nemā nahnu Mustehziūne”, “nē tē vërtetë ne vetëm talleshim, jemi tallësa”.

Ndërsa duke pritur prej kësaj linje arsyetimi që besimtarët do t'u përgjigjen -hipokritëve-, dëgjesi sheh se Allahu xh.sh. u përgjigjet atyre nē vend tē besimtarëve duke treguar nderimin e Allahut pér besimtarët dhe nënkupton se përqeshja e tyre ndaj besimtarëve nuk është asgjë e krahasuar me ndëshkimin e Allahut ndaj tyre.

Kjo gjithashtu tregon marrëzinë e tyre dhe se ata meritojnë tē refuzohen e tē dëbohen. Sepse si mundet një person i cili ka si mbrojtës tē Tij Allahuun tē përqeshet? Prandaj Allahu xh.sh. thotë: **اللَّهُ يَسْتَبْزُ إِيمَانَ** “Allahu i përqesh ata”. Domethënë, Ai do t'i ndëshkojë rendë ata pér përqeshjen e tyre duke u shkaktuar tē jenë tē përqeshur e tē përbuzur nē këtë botë dhe nē tjetrën.

Dhe fraza **وَيَكْذِهُمْ فِي طَغْيَانِهِمْ يَعْمَلُونَ** “dhe vetëm ua shton më shumë tē këqiat që tē sorollaten verbërisht” specifikon se çfarë forme (do tē marrë) përqeshja (e Allahut), ndëshkimi pér përqeshjen e tyre.

Vendosja e pjesëve tē frazave (dhe lidhjet midis tyre):

Shqyrtoje këtë: Fraza **وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ أَمْنَوا** “Ndërsa kur takohen me ata që besojnë, u thonë: “Ne besojmë”. tregon servilizmin e tyre.

Siguria e shprehur nga **إِذَا** “idhà”, “kur” nënkupton vendosmëri, paramendim dhe qëllim. Domethënë, ata qëllimisht synuan t'i takojnë besimtarët.

Folja **لَقُوا** “lekú”, “takohen” tregon se ata synuan t'i takonin rastësisht nē rrugët kryesore nē mes tē njerëzve.

Përdorimi i frazës **الَّذِينَ أَمْنَوا** “el-ledhine àmenú”, “me ata që besojnë” nē vend tē **الْمُؤْمِنُونَ** “el-muëminine”, “besimtarët” tregon se (hipokritët) kanë kontakt direkt me ta dhe se janë nē prekje me njëri-tjetrin, dhe se arsyeva pér lidhjet e tyre me ta është nëpërmjet cilësisë së besimit, dhe se besimi është tipari më i dallueshëm i cilësive të besimtarit.

Fjala **قَالُوا** “kálú”, “thoné” aludon se ata thonë me gjuhët e tyre atë që nuk është nē zemrat e tyre, dhe se ajo që ata thonë demonstron artificializmin, dhe se ata e thonë atë pér tē hedhur poshtë akuzat dhe, me lakmi tē tërheqin (pér tek vetvetja) avantazhet e besimtarëve dhe kështu ata tē mund tē zhbirojnë -tē marrin vesh- tē fshehtat e tyre.

Fjala **أَمَّا** “amen-na”, “ne besojmë” duke mos qenë nē formën intensive (apo verifikuese -bila-teekid) megjithëse sensi e kërkon atë, dhe qenia e saj një fjali foljore, tregon se nuk ka pasion apo nxitës nē zemrat e tyre pér t'i shtyrë ata tē jenë tē qëndrueshëm nē atë që thonë. Mospërdorimi i formës intensive gjithashtu tregon kundërshtimet e tyre tē forta ndaj akuzave kundra tyre, sikur ata janë duke thënë: “mohimi juaj -besimin tonë- është i pavend, nē fakt është e kotë, sepse ne nuk jemi lloji i njerëzve që mund tē akuzohemi”. Ajo gjithashtu është një shenjë që një vrull i tillë nuk do tē përhapet pér atë çfarë ata thonë. Ajo gjithashtu aludon se perdja që i mbulon gënjeshtrat dhe hipokrizinë e tyre është aq e hollë dhe e dobët saqë nē qoftë se do tē përdorej forca mbi tē -do tē têrhiqeji- ajo do tē grisej. Gjithashtu, nē qenien e saj një fjali foljore është një shenjë se ata nuk mund tē pretendojnë tē jenë tē qëndrueshëm e tē vazhdueshëm -në besimin e tyre-; qëllimi i tyre është tē shtire, ndërsa pretendimi se ata nē kohët e fundit kanë besuar është pér tē pasë pjesë nē dobitë e besimtarëve dhe pér tē zbuluar sekretet e tyre.

**وَإِذَا خَلَوَ إِلَيْ شَيَاطِينِهِمْ قَالُوا آنَّا مَعَكُمْ** *Ve idhà khaleu ilà shejatnishim kálú in-na meakum*. por kur janë vetëm me shejtanët e tyre, thonë: “Nē tē vërtetë ne jemi me ju”.

‘Vavi’ gjithëpërfshirës në ١٣١ “Ve idħha” “por kur” aludon se këto fjale janë tē vendosura kështu pér tē bérë tē qartë se hipokritët nuk janë lidhur me ndonjë rrugë -metodë- tē veçantë; dhe pér tē përshkruar lëkundjen e tyre, (ashtu siç shtjelohet në detaje në dy fjalitë kushtore - nē këtë frazë dhe nē tē fundit).

Vendosmëria e shprehur nga ١٤١ “idħha”, “kur” tregon se tē shtyrë nga shthurrja e tyre dhe nga pérhapja e korruptionit nga ana e tyre, ata e quajnë si detyrën e tyre tē domosdoshme që t'u drejtohen (tē këqinjve tē tyre).

Folja ١٤٢ “khaleu”, “janē vetēm” nënkupton se pér shkak tē pabesisë së tyre ata janē tē trembur e tē frikësuar, dhe pér shkak tē frikës së tyre ata e fshehin vetveten.

Përdorimi i ١٤٣ “ilā”, “tek pér tek” nē vend tē ١٤٤ “mea”, “me” e cila eshtë e përshtatshme tē përdoret me foljen ١٤٥ “khaleu”, “janē vetēm”, tregon se pér shkak tē dobësisë së tyre dhe tē pafuqisë ata - duhet tē- kérkojnë strehim -tek tē tjerët-, dhe pér shkak tē korruptionit tē tyre dhe tē intrigave, ata i çojnë sekretet e besimtarëve tek jobesimtarët.

Termi ١٤٦ شياطينهم “shejätinihim”, “shejtanët e tyre” tregon se drejtuesit e tyre janë si shejtanë, tē fshehur dhe duke bérë sugjerime djallëzore, dhe se ata shkaktojnë dëm si shejtanët, dhe se ata janë nē rrugën e djallit dhe nuk mund tē përfytyrojnë veçse tē keqen.

Fraza ١٤٧ قالوا أنا معكم “kàlú in-na meakum”, “thonë: “Nē tē vërtetë ne jemi me ju” eshtë pér tē shprehur takimin e tyre, obligimet e tyre, ripërtëritjen e marrëveshjes së tyre dhe vazhdimësinë e tyre nē rrugën e tyre. Sepse këtu ajo eshtë konfirmuese ndonëse asnjë mohim nuk eshtë bérë, ndërsa nē frazën e mëparshme ajo nuk eshtë konfirmuese ndonëse ka mohim, e cila eshtë dëshmi pér mungesën e entuziazmit shtytës nē zemrën e folësit nē frazën e mëparshme, dhe qenia e saj e gjendur nē këtë frazë. Pér më tepër, fakti se kjo frazë eshtë një fjali emërore dhe

frazë e mëparshme eshtë një fjali foljore, tregon se qëllimi këtu eshtë pér tē demonstruar vazhdimësinë e tyre nē hipokrizi dhe luhatshmërinë -paqëndrueshmërinë- e tyre nē besim.

١٤٨ Sa pér ١٤٩ انا نحن مستهزئون “in-nemà nahnu Mustehziúne” “nē tē vërtetë ne vetēm talleshim, jemi tallës”.

Kjo frazë nuk eshtë lidhur me frazën paraprirëse me ndonjë lidhëze, sepse lidhëzat nuk janë përdorur pér tē lidhur fjalitë që janë ose aq tē ngashme sa tē jenë njet me njëra-tjetrën, ose janë krejtësisht tē palidhura, por vetëm -me fjalitë që- janë midis tē dyjave. Kjo frazë nga njëra anë eshtë një zëvëndësuese (*bedel*) pér frazën e mëparshme, dhe nga një aspekt tjeter e mbështet atë; prandaj tē dyja janë tē ndërlidhura ngushtë. Pastaj nē një mënyrë tjeter ajo eshtë përgjigjja pér një pyetje tē nënkuptuar dhe kështu eshtë krejtësisht e palidhur. Sepse përgjithësisht, përgjigjet janë fjali paralajmëruese -ose fjali dëftore “ihbarijeh”- dhe pyetjet shprehin dëshira, kërkesa, ose kushte “insha'ijeh”.

Pér sa ka tē bëjë me këtë fjali duke mbështetur fjalinë e mëparshme, dhe qenia e saj një zëvëndësuese pér tē, e cila eshtë më e afërt me tē, ajo shpreh përbuzje pér tē vërtetën dhe pér njerëzit e së vërtetës; kështu ajo lartëson gënjeshtren dhe ndjekësit e saj; ky eshtë kuptimi i ١٤٩ انا معكم “in-na meakum” (“thonë: “Nē tē vërtetë ne jemi me ju”...

Dhe pér sa ka tē bëjë me qënien e saj përgjigjja pér një pyetje tē nënkuptuar, ajo eshtë sikur shejtanët e tyre t'u thonin atyre: “Nē qoftë se ju jeni me ne dhe nē rrugën tonë, atëherë përse jeni ju nē përputhje me besimtarët? Ju ose pajtoheni me besimet e tyre, ose ju nuk keni

besim”. Duke u shfajësuar ata thonë: ١٤٩ انا نحن مستهزئون “in-nemà nahnu Mustehziúne” “nē tē vërtetë ne vetēm talleshim, jemi tallës”, duke pohuar kështu nē mënyrë tē qartë se ata nuk janë nē asnjë mënyrë muslimanë, nuk janë nē islam.

Duke përdorur kufizuesen ١٤٩ انا نحن مستهزئون “in-nemà”, “vetēm, veçse”, ata gjithashu nënkuptojnë se ata nuk janë ngurrues tē lëkundur pa medhheb -rrugë- tē njobur (pa besim e pa bindje), dhe duke përdorur

pjesoren aktive **مستهزون** "Mustehziúne", "taflësa" ata aludojnë se përqeshja është njëra nga veçoritë e tyre të pérhershme.

Kështu, ata nuk janë seriozë në këtë veprimin e tyre, -besimin e tyre.

Sa pér fjalinë **الله يستهزئ** "All-lâhu jehteziu bîhim" Allahu i pérqesh ata. Kjo fjali nuk është e lidhur me ato që e paraprinë; madje ajo është e shkëputur dhe është ndarë prej tyre. Sepse në qoftë se ajo do të kishte qenë lidhur nëpërmjet një lidhëzeje me "*in-nemâ nahnu Mustehziúne*", "*në tê vërtetë ne vetëm tallësim, jemi tallës*", ajo gjithashtu do të kishte qenë pér të mbështetur **انامعك** "in-na meakum" "(thonë:) "Në tê vërtetë ne jemi me ju". Dhe në qoftë se do të ishte lidhur me **قالوا** "kâlû", "thonë", ajo gjithashtu do të kishte dashur të ishte e kufizuar pér - gjendjen- kur ata të ishin vetëm, ndërsa Allahu i pérqesh ata në mënyrë të vazhdueshme. Dhe në qoftë se ajo do të kishte qenë e lidhur me "*idha khaleu*", "*kur janë vetëm*", ajo duhet të kishte qenë plotësuesi i cilësisë së lëkundjes së tyre. Dhe në qoftë se do të kishte qenë lidhur me **واذا لقوا** "*idha leku*", "*kur takohen*", të dyja fjalitë do të duhej të kishin qenë duke synuar të njëjtën gjë.

Ndërsa e para pérshkruan çfarë ata kanë bërë, e dyta pérshkruan ndëshkimin e tyre. Kështu, meqenëse të gjitha mundësitë duke kérkuar një lidhëze janë të paafta, nuk do të ishte korrekt pér këtë fjali pér t'u lidhur me ato që e paraprinë. Kështu, ajo vetëm do të mund të ishte e palidhur (*musteënifeh*) me fjalitë e mëparshme, dhe një përgjigjje pér një pyetje të nënkuptuar. Kjo aludon dhe nënkupton se ligësia dhe neveria e tyre kanë arritur në një shkallë të tillë saqë i detyrojnë të gjithë shpirtërat e të gjithë atyre që janë të vetëdijshëm pér to, të pyesin: Si do të dënohen njerëzit që sillen në këtë mënyrë?"

Fillimi i fjalisë me fjalën **All-lâhu**, megjithëse dëgjuesi pret t'i shohë besimtarët duke u përballur me ta, tregon se Ai është duke i nderuar besimtarët dhe qënien e Tij i dobishëm pér ta, sepse Ai konfrontohet në vend të tyre. Gjithashtu, ajo është një aluzion duke i

penguar hipokritët, sepse ata të cilët mbështeten nga i Gjithurti i së Padukshmes, nuk mund të përqeshen. Gjithashtu, fakti se kjo fjali është e shkëputur dhe e palidhur me përqeshjen e tyre tregon se përqeshja e tyre nuk është asgjë e krahasuar me ndëshkimin e saj.

Pér më tepër, përdorimi i termit "*përqeshje*" pér të pérshkruar ndëshkimin e Allahut xh.sh. ndaj tyre, -e cila është e papërshtatshme pér lartësinë e Tij- është pér të dhënë idenë e ngjashmërisë ndërmjet mbajtësve të bisedimit, dhe pér të treguar se dënimë është ndëshkim pér përqeshjen e tyre dhe rezultati i saj i pashmangshëm, megjithëse qëllimi i saj është t'i poshtërojë e t'i përcmojë ata. Pér më tepër, ajo aludon se përqeshja e tyre ndaj besimtarëve nuk u sjell asnje dobi atyre, përkundrazi, ajo i dëmoni ata; sikur Allahu xh.sh. është duke i përqeshur ata (pér të). Ashtu si dikush që mendon se tallet me ty, por ti e sheh atë si të marrë, dhe dëshiron që ai të flasë edhe në qoftë se të fyen, me qëllim që të qeshësh prej tij, sepse bërrja e tij humor e tallje ndaj teje është pjesë e bërrës tënde një marrëzi të tij".

Pastaj, "*jehteziu*", "*përqesh*" është një folje në kohën e pakryer, ndonëse në vërsetin e mëparshëm "**Mustehziúne**", "**tallësa, përqeshësa**" është një pjesore aktive, e cila tregon se ndëshkimi i Allahut xh.sh. dhe poshtërimi i Tij ndaj tyre ripërtërihen vazhdimisht kështu që ata e vuajnë dhimbjen dhe preken prej saj. Sepse efektet e diçkaje të vazhdueshme e të rregullt pakësohen ose zhduken krejtësisht. Kjo është arsyesa që është thënë se ndryshimi është i domosdoshëm pér t'i bëre gjërat të ndjehen.

**و يَكْلِهُمْ فِي طَغْيَانِهِمْ بِعَمَّوْنَ** "ve jemud-duhum fi tug'jânihim jeâmehune" "dhe vetëm ua shton më shumë të këqiat që të sorollaten verbërisht" domethënë, ata përdorin mjetet e çudhëzimit dhe i kérkuani ata, prandaj

Allahu xh.sh. ua dha ato atyre. Kështu fjalë **يَمْدُ** "jemud-dû", "ua shton, ndihmon" nënkupton hedhjen poshtë të muëtezilitëve (të cilët pohojnë se njeriu i krijon aktet e tij), dhe meqenëse ajo përfshin kuptimin e "*të kérkuariit ndihmë*" (*istimdad*) nënkupton refuzimin -hedhjen poshtë- të Xheberitëve; domethënë, duke i keqpërdorur vullnetet e tyre, hipokritët e zgjodhën këtë rrugë dhe kérkuani ndihmë pér ta ndjekur atë, kështu Allahu xh.sh. i ndihmoi ata dhe i liroi frerët e tyre.

Shtimi i prapashtesës përemërore **كُم** “hum”, **تِر** “tyre” tek طغيان **تُجَّاجِنْ** “*tug'jan*”, **تِكْعِيْجَاتْ**, **لِجَسِيتْ**”, domethënë, ata e zgjodhën atë me vullnet të lirë, do të thotë se ata nuk u detyruan, që ata të mund të shfajësohen. Ndërsa **تُجَّاجِنْ**, **تِكْعِيْجَاتْ**, **لِجَسِيتْ**” (e cila ka kuptimin e përblytjes dhe të tejkalimit të të gjitha kufijve) tregon se dëmi i tyre ka përblytur gjithçka të mirë si rryma, duke shkatërruar bazën e plotësimeve, dhe se asgjë nuk ka mbetur veçse shkumë e zezë, zgjyrë.

**يَعْمَلُونَ** “jaemehune”, “*sorollaten verbērisht*”, domethënë, ata janë të hutuar e ngurues. Kjo tregon se ata nuk kanë besim dhe nuk kanë qëllim të caktuar.

\* \* \*

## VËRSETI 16

أُولَئِكَ الَّذِينَ اشْتَرَوُ الْضَّلَالَةَ بِالْهُدَىٰ فَمَا رَبَحُتْ  
تِجَارَتُهُمْ وَمَا كَانُوا مُهْتَدِينَ

*Ulâikे el-ledħine Ishterú el-dalālete bi el-hudâ. Femà rebihat tixfiaretuhum  
ve mà kànú muhtedîne.*

*Këta (ata) janë të cilët shkëmbjen udhëzimin me të gabuarën, kështu që  
tregtia e tyre qe pa përfitim dhe nuk u drejtuani.*

**Vendosja e vërsetit në lidhje me atë që e parapriu:**

**Shqyrtoje këtë:** Ky vërset është një përbledhje e përshkrimeve të detajuara të mëparshme, duke i ilustruar ato në mënyrë të lartësuar e efektive. Tregtia është zgjedhur si një -subjekt- i shembelltyrës, sepse njerëzve të parë që ai iu adresua kishin përfjetuar kënaqësitë dhe vështirësitë e tregtisë në udhëtimet e tyre të dimrit dhe të verës.

**Lidhja e drejtpërdrejt e vërsetit është kjo:** Qëni humane nuk u dërguan tek kjo botë pér ta bërë atë atdheun e tyre, por pér tregti duke përdorur kapitalin e aftësive dhe të fuqive të tyre të bashkëlindura; pér t'i kultivuar dhe pastaj veprojnë me vullnet të lirë në produktet e rezultatet e tyre.

**Vendosja e frazave të vërsetit:**

Kjo është një renditje e lirshme e natyrshme, duke reflektuar rendin e shembelltyrës. Është si kjo: ndodhej një tregtar gënjeshtar i dështuar. Atij i ishte dhënë një kapital i pasur por ai e kishte përdorur atë vetëm pér të blerë helm dhe gjëra të dëmshme pér vetveten. Ai e përdori kapitalin e tij, por ai nuk i solli atij asnjë dobi dhe nuk fitoi asgjë; madje ai e lëshoi atë në humbje mbi humbje, kështu ai e humbi kapitalin e tij, dhe humbi rrugën në një mënyrë që nuk mund të kthehet.

### Vendosja e pjesëve të frazave:

Përemri dëftor **أُولَئِكَ** “Ulāike”, “ata” sjell afér atë që është e prekshme dhe e largët. Kjo sugeron se duke dëgjuar krimet e renditura në vërsetet e lartëpermendura, dëgjuesi ndjen në zemrën e tij një zemërim dhe neveri duke u shtuar gradualisht, kështu ai dëshiron t'i shohë hipokritët me qëllim që t'uа zbrazë inatin dhe t'i konfrontojë ata me të gjithë neverinë dhe përbuzjen e tij. Prekshmëria aludon se qenia e tyre të cilësuar nga këto atribute të jashtëzakonshme i mishëron ata në mendjen -e dëgjuesit-, duke i bërë ata -pothuajse- të prekshme për imaginatën (e tij). Ajo gjithashtu tregon arsyen për pohimin, meqenëse mëkat içon tek një mëkat i mëtejshëm.

Sepse sigurisht një arsyе është e domosdoshme në qoftë se dikush e shkëmben çudhëzimin për udhëzimin, dhe kjo është krimet dhe cilësitë e lartëpermendura. Kështu, Kurani aludon për ta me **أُولَئِكَ** “Ulāike”, “ata”, domethënë, ata të cilësuarit nga këto cilësi; kështu dëgjuesi do ta njohë arsyen për dënimin e tyre në këtë vëerset).

Sa për largësinë e treguar nga **أُولَئِكَ** “Ulāike”, “ata”, ajo tregon largësinë e tyre të madhe prej rrugës së drejtë; ata kanë arritur pikën e moskthimit; ata u larguan me dëshirën e tyre, por nuk mund të kthehen.

Përemri lidhor **الذين** “el-ledhine”, “të cilët” tregon se ky lloj tregtie është e çuditshme dhe e dëmshme; vetëm në kohët e fundit ajo është shfaqur dhe është bërë një parim dhe një mënyrë veprimi i adoptuar nga njerëzit.

Sepse ashtu siç u përmend më lart, përemri lidhor tregon fakte të reja që janë vërtetuar.

Folja **اشتروا** “Ishteru”, “bënë, shkëmbyen” aludon për hedhjen poshtë të shfajësimit të tyre (kur thonë) “Është në natyrat tona për ta bërë këtë”. Është sikur Kurani është duke u thënë atyre: “Jo! Allahu xh.sh. ju ka dhënë frymët e jetës suaj si kapital, dhe ka vendosur në shpirtërat tuaj potencialin -mundësinë- për t'u rritur e plotësuar. Dhe ka ngulitur -

mbjellur- në ndërgjegjjet tuaja forcat e të vërtetës, që kanë udhëzimin e natyrshëm që ju të mund të bleni lumturinë; por ju bletë në vend të saj - madje duke e braktisur atë- kënaqësitetë kalimtare, të çastit dhe dobitë e kësaj bote, dhe duke i keqpërdorur vullnetet tuaj të lirë zgjodhët e preferuat çudhëzimin mbi rrugën e udhëzimit, dhe ju prishët udhëzimin e natyrshëm dhe humbët kapitalin.

**الضَّلَالُ بِالْهُدَى** Fraza **“el-dalalete bi el-hudd”**, “udhëzimin me të gabuarën”, aludon se ata pësuan humbje pas humbje, sepse ashtu siç humbasin ata duke fituar çudhëzimin, po ashtu ata humbasin nëpërmjet braktisjes së mirësisë më të madhe të udhëzimit.

**فَمَا رَبَحَ تِجَارَتُهُمْ** “Femà rebihat tixfiaretuhum”, “kështu që tregtia e tyre qe pa përfitim”; përdorimi i mohores -sepse jo vetëm që ata kanë pësuar humbje por kanë humbur të gjithë kapitalin e tyre -sugeron se është veçori e mendjes që të mos i afrohet një tregtie jofitimprurëse; dhe sidomos tregtisë që shkakton humbje, dhe madje humbjen e kapitalit.

Gjithashtu, duke ia atribuar foljen tregtisë së tyre- megjithëse me drejtësi ajo duhej t'u ishte atribuuar veteve të tyre; domethënë, “Femà rebihat tixfiaretuhum”, “kështu që tregtia e tyre qe pa përfitim”- është një shenjë se në asnjë drejtim, në asnjërrën prej pjesëve të saj apo prej kushteve dhe prej mjeteve të saj, tregtia e tyre nuk fiton asnjë dobi as pjesërisht dhe as tërësisht, jo si në disa tregti ku asnjë përfitim nuk bëhet në produkte, por disa dobi mund të ketë në të pjesshmet e tjera apo në shërbimet e tyre. Tregtia e hipokritëve është thjesht e keqe e pastër dhe një dëm i papërzier. Duke ia përshkruar foljen tregtisë këtu, i ngjason thënies: “*name lejluhu*” (*nata e tij fjeti*) në vend të “*name fil-lejl*” (*ai fjeti në natën*). E para do të thotë se përbri vetes së tij duke fjetur, edhe nata e tij gjithashtu ishte e qetë dhe e heshtur sikur të flinte, dhe asgjë nuk e shqetësoi.

**وَمَا كَانُوا مُهْتَدِينَ** “ve mà kànú muhtedíne”, “dhe nuk u drejtuán, nuk ishin të drejtuár”: Domethënë, ashtu siç kanë humbur ata kapitalin e tyre, po ashtu ata kanë humbur rrugën e tyre. Kjo është e lidhur dhe e

shoqëruar me shëmbëlltyrën “*Ishterū*”, “*blenë, shkëmbyen*”, ashtu siç ishte fraza paraprijëse. Ajo gjithashtu aludon tërthorazi për “*hudan lîl-muttekîne*”, “*udhëzim pér el muttekîne (të përkushtuarit)*” në fillimin e sures, sikur ajo të thonte: Kurani u dha atyre udhëzim, por ata nuk e pranuan atë.

\*\*\*

## VËRSETET 17-20

مَثُلُّهُمْ كَمَثَلَ الَّذِي اسْتَوْقَدَ نَارًا فَلَمَّا أَضَاءَتْ مَا حَوْلَهُ ذَهَبَ  
اللَّهُ بِنُورِهِمْ وَتَرَكَهُمْ فِي ظُلُمَاتٍ لَا يُبَصِّرُونَ \* صُمُّ بَعْضُهُمْ عَمِيَّ  
فَهُمْ لَا يَرْجِعُونَ \* أَوْ كَصَبَّ مِنَ السَّدَاءِ فِيهِ ظُلُمَاتٌ وَرَعْدٌ  
وَبَرْقٌ يَجْعَلُونَ أَصَابِعَهُمْ فِي أَذَانِهِمْ مِنَ الصَّوَاعِقِ حَذَرُ الْمَوْتِ  
وَاللَّهُ مُحِيطٌ بِالْكَافِرِينَ \* يَكَادُ الْبَرْقُ يَخْطُفُ أَبْصَارَهُمْ كُلَّمَا  
أَضَاءَ لَهُمْ مَشَوا فِيهِ وَإِذَا أَظْلَمَ عَلَيْهِمْ قَامُوا وَلُوْشَاءُ اللَّهِ لَذَهَبَ  
بِسَمْعِهِمْ وَأَبْصَارِهِمْ إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

*Metheluhum kemetheli el-ledhi isteukade naren fe lem-ma edaet ma haulehu dhehebe All-llahu binurihim ve terekhem fi dhulumatin la jubsirune. Sum-mun bukmun Umjun fehum la jerxhiune. Eu kesaj-jibin min el-semai fi-hi Dhulumatun ve Raedun ve berkun jexhi'alune esabiahum fi adhanihim min el-savaike hadhere el-meuti ve All-llahu Muhiitun bi el-Kafirine. Jekadu el-berkyu Jakiftafu Ebsarehum kulf-lema edae lesum mesheu fi-hi ve idha adhleme alejhim kamu ve leu Shà All-llahu ledhehebe bisem'iham ve Ebsarihim in-ne All-llahe ala kulf-shej'in kadirun.*

Kjo ng Jason (shembulli i tyre eshtë) si me atë që ndezi zjarrin dhe pasi ai ndriçoi gjithandej rrëth tij, Allahu ua mori dritën e tyre dhe i la në errësirë, (keshtu që) ata nuk mund të shihnin. Ata janë tē shurdhiër, memecë e tē verbër, keshtu që ata nuk kthehen (në Rrugën e drejtë). Ose si një shtrëngatë nga qelli me errësirë, vetëtimë e bubullimë; ata i rrasin gishterintë e tyre në veshë pér tē mos dëgjuar ushtimën tmeruese nga frika e vdekjes. Por Allahu gjithnjë i rrethon mosbesimtarët”. Vetëtima pothuajse ua merr sytë; sa herë që u flakeron, ata ecin (në ndriçimin e saj), ndërsa kur i mbulon errësira, mbeten në vend. Dhe po tē donte Allahu, do t'ua kishte marrë dëgjimin dhe shikimin. Vërtet që Allahu eshtë i Gjithëfuqishëm mbi çdo gjë.

**Shqyrtoje këtë:** Mrekullia e Kuranit bazohet mbi elokuencën e renditjes së fjalëve të tij (*nadhm*), dhe elokuena e renditjes është dy llojesh:

*I pari* është si zbukurimi dhe *i dyti* është si manteli.

**Lloji i parë** u ngjason perlave të vëna në varg, një dekorimi të punuar bukur, dhe një qëndisjeje të zbukuruar me xhevahirë. Ajo e ka prejardhjen prej kuptimeve vijuese gramatikore e foljore të ligjératës, si shkrirja e arit midis blloqeve -gurëve- të argjendit. Shpjegimi i pikave të holla që janë frutat e këtij lloji të elokuencës është ndërmarrë nga “*Fen-n(iłm)el-meani*” “*arti -shkenca- e kuptimeve*”.

**Lloji i dytë** është si një mantel i shtrenjtë ose si një veshje nderimi, e prerë në përputhje me shtatin e kuptimeve, e qepur prej copave të ndryshme me qepje të rregullta, dhe kanë veshur plotësisht shtatin e kuptimit, ose tregimin, ose qëllimin.

Mjeshtri i këtij lloji dhe profesori i tij është “*Fenn -iłm- el-bejan*”, “*arti i shpjegimit*”.

Njëra nga çështjet më të rëndësishme të këtij llojit -të fundit- është ajo e krahasimeve alegorike (*temthil*). Kurani përban aq shumë krahasime të tillë sa që arrijnë një mijë, sepse krahasimet alegorike përbajnë një mister të hollë dhe janë një urtësi e lartë. Po, nëpërmjet tyre, iluzioni -mashtimi- mposhtet nga arsyaja, dhe imaginata detyrohet t'i nënshtrohet mendimit, e fshehta bëhet e pranishme, abstraktja bëhet konkrete, dhe kuptimi bëhet i prekshëm, i qartë; e veçuara bëhet e grumbulluar, e ngatërruara bëhet e kombinuar, e ndryshmja bëhet e bashkuar, e shkëputura bëhet e lidhur, dhe e pambrojtura -e çarmatosura- bëhet e armatosur.

Në qoftë se ti dëshiron të dëgjosh një diskutim të detajuar, atëherë dëgjoje së bashku me mua atë që autori i “*Dela'il el-ięxhaz*” e këndon në “*Esrar el-belagah*<sup>1</sup>”, kur ai tha:

<sup>1</sup> Abd el-kahir Xurxhani (471 H). Ai ishte një yll në fushat e gjuhës dhe të retorikës. Për këtë pjesë, shiko Ahmed Mustafa el-Meraghi Kairo, mat baa elistikame, 1948, 128.

## Mbi përdorimin e përshtatshëm dhe efektiv të krahasimeve alegorike.

Të mençurit -*ukala-* pajtohen në mendim se kur krahasimet alegorike vijnë pas kuptimeve, ose kur kuptimet shfaqen duke u përbledhur nga krahasimet dhe ndërķembhen, zhvendosen nga format origjinale për tek ajo e krahasimeve, krahasimi i vesh ato me madhështi, i bën ato të lavdishme, e ngre vlerën e tyre, ndez zjarrin e tyre, shton fuqinë e tyre duke zgjuar e nxitur nefset e tyre, u bëjnë ftesë zemrave për tek ato, lëvizin e zgjojnë kraharorët -zemrat- me dëshirë të zjarrtë e me dashuri, dhe nënshtrojnë natyrat nëpërmjet pasionit të zjarrtë dhe të zellit.

Sepse në qoftë se -ajo që u synua- është lavdërimi, (krahasimi alegorik e bën atë) më të shkëlqyer dhe më madhështor; dhe më sublime dhe më të madhërishme; ajo shkakton më shumë emocione, duke i familjarizuar kuptimet më shpejt; duke shkaktuar më shumë gëzim; (ajo është) më efektive mbi të lavdëruarin, një ndërmjetësues më i fuqishëm për lavdëruesin; më të gjykuara do të janë dhunitë, dhuratat dhe peshqeshet; më të lehta për gjuhën dhe më të këndshme për t'u përmendur; më të efektshme për ta bërë zemrën të lidhur fort me kuptimin dhe më të vlefshme.

Dhe në qoftë se -ajo që u synua- është qortimi, prekja (e krahasimit) është më therrëse, damkosja e tij është më thumbues, trysnia e tij është më e fortë dhe mprehtësia e tij është më e mprehtë.

Dhe në qoftë se është diskutim dhe debat, provat -e krahasimit- janë më të ndritshme, fuqia e tij është më bindëse, shpjegimi i tij është më i shkëlqyer.

Dhe në qoftë se -ajo që u synua- është krenaria dhe mburrësia, aspirata e tij është më ambicioze, nderi i tij është më serioz, gjuha e tij është më e vrullshme.

Dhe në qoftë se -ajo që synohet- është shfajësim ose ndjesë, (krahasimi) është më i afërt për zemrat dhe më i mirë për t'i ledhatuar ato, duke i larguar urrejtjet në mënyrën më të butë e të urtë, duke e

shuar zemërimin në mënyrën më të efektshme, dhe më robëruese në magjepsjet e saj, duke çuar në kthesë më të mirë.

Dhe në qoftë se -ajo që u synua- është paralajmërimi, (krahasimi) është më i mirë për të kuruar zemrat, më përques tek mendimi, më elokuent në paralajmërim, në kujdes e ndalim, më i mirë në zbulimin e qëllimit, më i vlefshëm për t'u shfaqur synimi, duke shëruar sëmundjen dhe duke kuruar mërinë.

Në qoftë se ti i heton llojet dhe varietetet e ligjëratës dhe të studioje kategoritë dhe degët e saj, ti do të shohësh se kështu është çështja.

(këtu mbarojnë fjalët e Xhurxhanit).

Vërsetet vijuese përbajnjë dëshmitë e mrekullisë së Kuranit dhe misteret e elokuencës. Ne do t'i përmendim ato, për shkak të lidhjes së tyre, për çështjet e diskutuara në parathënien e afërt.

Një shembull i një krahasimi alegorik i dhënë nga Kurani në stacionin -mekamin- e lavdërimit është ai që lidhet me atributet e sahabëve (të profetit):

..Dhe shembulli i tyre në inxhil përshtkuhet si një farë (e mbjellë) e cila lëshon llastarin, pastaj e forcon atë dhe pastaj qëndron vetë në trungun e vet duke i mbushur mbjellësit me çudi e gëzim...<sup>2</sup>

Në stacionin e qortimit janë vërsetet, "kështu shembulli i tij i njason atij të qenit: nëse e pérzë, ai var gjuhën, por edhe nëse nuk e ngacmon, ai përsëri e nxjerr gjuhën jashtë."<sup>3</sup>

Shembulli i atyre të cilëve iu besua (barra-obligimet) e Teuratit, por të cilët më pas nuk i mbajtën ato (detyrime) është si shembulli i gomarit i cili është i ngarkuar rëndë me libra (por nuk i kupton).<sup>4</sup>

Sigurisht që ne kemi vënë në qafat e tyre jaka hekuri që u arrijnë deri tek mjekra, kështu që kokat e tyre janë të ngrira (dhe ata nuk mund ta shohin).<sup>5</sup> Dhe kështu me radhë.

<sup>2</sup> Kuran, 48:29

<sup>3</sup> Kuran, 7:176

<sup>4</sup> Kuran, 62:5

<sup>5</sup> Kuran, 36:8

Dhe në stacionin e debatit dhe të deduksionit:

مُثَلْهُمْ كَمَثَلِ الَّذِي اسْتَوْقَدَ نَارًا  
"Shembulli i tyre është si ai i një njeriu që ndezi zjarrin..."<sup>6</sup>

Ose (një shembull tjetër) është ai i një shtrëngate nga qielli; "në të janë zona errësire... (deri në fund të vërsetit)"<sup>7</sup>

Shembulli (i thirrësit të) atyre që nuk besuan është sikurse i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtive që nuk dëgjojnë gjë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë).<sup>8</sup>

"Shembulli i atyre të cilët marrin për mbrojtës të tjerë në vend të Allahut është si shembulli i merimangës, e cila ndërtton (përvete) shtëpinë e saj".<sup>9</sup>

"Ai lëshon ujë nga qielli dhe luginat rrjedhin sipas masës së tyre, por vërvshimi mbart shkumën që del në sipërfaqe si dhe nga ai (ari) të cilin ata (njerezit) e nxehin në zjarr me qëllim që të bëjnë zbururime ose enë, po nga një shkumë e ngjashime..."<sup>10</sup>

"Allahu ju sjell një shembull përngjasues: një rob e kanë në bashkëpronësi disa pronarë së bashku (si ata që adhurojnë shumë zota përkrah e përveç Allahut) që hahen me njëri tjetrin dhe një rob i cili i përkët plotësisht një pronari të vetëm (si ata që adhurojnë Allahun Një të Vetëm). A janë këta të dy të barabartë në krahasim?"<sup>11</sup> Dhe kështu me radhë.

Një shembull krenarie dhe dinjiteti –edhe në qoftë se nuk do të quhej krenari që ilustron lartësinë Hyjnore dhe plotësinë: "Ata nuk i bënë vlerësim të drejtë Allahut siç duhet e siç i takon Atij. Dhe ditën e kijametit gjithë toka do të jetë e mbështjellë në Dorën e Tij të Djathtë. I lavdëruar dhe i plotësuar është Ai mbi gjithçka që ata ia ngjisin Atij si të barabartë!"<sup>12</sup> dhe kështu me radhë.

I vetmi shembull i krahasimeve alegorike në stacionin e shfajësimit dhe të ndjesës ashtu siç janë përmendor për të shprehur mosmiratim:

<sup>6</sup> Kuran, 2:17

<sup>7</sup> Kuran, 2:18

<sup>8</sup> Kuran, 2:171

<sup>9</sup> Kuran, 29:42

<sup>10</sup> Kuran, 13:17

<sup>11</sup> Kuran, 39:29

<sup>12</sup> Kuran, 39:67

*“Ata thonë: Zemrat tona janë tē mbuluara nga ajo nē tē cilën ti na fton dhe veshët tanë janë tē shurdhët dhe mes nesh e teje është një perde”...<sup>13</sup> dhe kështu me radhë.*

Ashtu siç thuhet nē poezinë:

*Mos supozoni se kërcimi (vallëzimi) im midis jush është i gëzueshëm,*

*Sepse shpendi i therrur kërcen nga dhimbja.*

Shembujt nē Kuran pér paralajmërimet rrëth gjérave luksoze tē kësaj jete janë këto: “këtu është një shembull; si bimësia pas shiut kur rritja e saj e kënaq bujkun; më pas ajo thahet dhe e shihni tē zverdhet, pastaj ajo bëhet kashtë”<sup>14</sup>

*“A nuk e shihni se Allahu zbret nga qieslli ujë dhe e bën atë tē përshkojë tokën (nē thellësi dhe pastaj e bën atë tē shpërthejë) si burime, pastaj me anë tē tij prodhon drithëra tē ngjyrave tē ndryshme”<sup>15</sup>*

Nē tē vërtetë Ne ua paraqitëm Amanetin –besimin- qiejve, edhe tokës, edhe maleve, por ata nuk pranuan ta mbajnë atë dhe kishin frikë prej tij (nga ndëshkimi i Allahut). Por njeriu e mori përsipër atë. Vërtet që ai i bëri këq vetvetes dhe qe i paditur (pér pasojet e tij).<sup>16</sup>

*“Sikur ta kishim zbritur këtë Kuran mbi një mal, sigurisht që do ta kishë parë atë tē përusur e tē thierruar nga frika e Allahut. Të tille janë shembujt tē cilët Ne ua sjellim njerëzve, me qëllimin se mbas mund tē mendojnë.”<sup>17</sup>*

*“Ç’është pra me ta (mosbesimtarët) që ata i kthiejnë shpinën këshillës?*

*Sí tē ishin gomerë tē humbur (tē egërsuar).*

*Duke ikur nga bisha (a luani) që e ndjek!”<sup>18</sup>*

<sup>13</sup> Kuran, 41:5

<sup>14</sup> Kuran, 57:20

<sup>15</sup> Kuran, 39:21

<sup>16</sup> Kuran, 33:72

<sup>17</sup> Kuran, 59:21

<sup>18</sup> Kuran, 74: 49-51

*Shembulli i atyre tē cilët e shpenzojnë pasurinë e tyre nē Rrugë tē Allahut është si ngashmëria e kokrrës së grurit, ajo rrit shtatë kallinj dhe çdo kallë ka njëqind kokrra.”<sup>19</sup>*

*“...është shembulli i një kopështi nē kušmin e tij: bie një shi i mirë;”<sup>20</sup>*

*Një shembull duke treguar se si hipokrizia dhe aktet e dëmshime i shfuqizojnë, anullojnë veprat e mira: “A do tē dëshironte ndonjë nga ju tē kishët një kopësht me hurma dhe rrush, me lumenj që rrjedhën poshtë tij dhe me gjithë llojet e frutave pér të, ndërsa atë e kap mosha e thyer, ndërsa ka fëmijë tē dobët (jo nē gjendje tē kujdesen pér veten), pastaj kopështi goditet me një vorbull ere tē zjarrtë dhe kështu ai digjet?”<sup>21</sup>*

*“shembulli i atyre që mohuan Zotin e tyre është se punët e tyre janë si hiri mbi tē cilin fryn era e tèrbuar nē një ditë me furtunë: ata nuk do tē munden tē marrin asnëj thërrmijë nga çfarë punuan. Kjo është humbja dhe largimi, më i fundit (nga udha e Drejtë).”<sup>22</sup>*

Disa shembuj tē kategorisë së tē folurit, (shembuj tē) stacionit tē përshkrimit (*mekam el-vasf*)

*“Pastaj Ai istewa (u ngjit lart) drejt qiesllit, kur ai ishte tym dhe i tha atij dhe tokës: “Ejani tē dy ju me dëshirë e pa dëshirë”. Ata tē dy (toka dhe qieslli thanë): Ne vijmë me dëshirë e tē nënshtruar.”<sup>23</sup>*

*“U tha: “o tokë! Gëlltite ujin tënd! Dhe o qiesll! Përbaje (shiun tënd)! Dhe uji u ul (u bë tē qetësohet) e urdhëri i Allahut u përbush (shkatërrimi i popullit tē Nuhut), ndërsa ajo (barka) pushoi në (malin) Xhudë dhe u tha: larg nga populli qeqbërés!”<sup>24</sup>*

*A nuk e sheh se si Allahu sjell shembull (e krahasim)? Një fjala e mirë si një pemë e mirë, rrënja e së cilës është e ngulitur fort dhe degët e saj ngrihen (lart) nē qiesll.*

<sup>19</sup> Kuran, 2:261

<sup>20</sup> Kuran, 2:265

<sup>21</sup> Kuran, 2:266

<sup>22</sup> Kuran, 14:18

<sup>23</sup> Kuran, 41:11

<sup>24</sup> Kuran, 11:44

*Duke dhënë frutat e saj në çdo kohë me lejen dhe vullnetin e zotit të saj.*<sup>25</sup>

*Dhe shembulli krahases pér një fjalë tē ligë si ai i pemës së keqe e shkultur nga sipërfaqja e tokës duke mos pasur aspak qëndrueshmëri.*<sup>26</sup>

Një varg:

*Dhe nata vërvshon, yjet duke u derdhur në rrugën e Qumështit.*

*Ashtu si një kopësht, lulet e tij tē ndezura befas u shuan në lum.*<sup>27</sup>

**Shqyrtoje këtë:** Të gjithë vërsetet alegorike janë të niveleve, shkallëve, formave dhe stileve të ndryshëm. Secili përmban të vërteta të holla. Ashtu si në qoftë se ti merr një kupë argjendi dhe do ta zbukuroje atë me flori të shkrirë dhe do ta stolisje me xhevahirë, pastaj do ta elektrifikoje atë duke e bërë të shndriste e të shkëndijonte, ti do të shikoje në të shumë nivele të bukurisë dhe larmi të stolisjes, po ashtu, në të gjitha këto vërsete, aluzionet dhe treguesit shtrihen -zgjerohen-(nëpërmjet krahasimeve alegorike nga qëllimet e tyre kryesore pér tek stacionet (e lartëpërmendura), sikur baza e qëllimit të rrokullisej nëpër të gjitha këto nivele duke marrë ngjyra dhe një pjesë prej secilit, duke i bërë fjalët përbledhje gjithëpërfshirëse (të Kuranit), ose madje përbledhja e përbledhjeve.

## Një parathënie

### (Mbi elokuencën -ose retorikën)

**Shqyrtoje këtë:** ai që flet shpreh një kuptim, pastaj duke dhënë dëshmi bind mendjen.

Atëherë gjithashtu, duke përdorur alegoritë, ai lëviz -prek- ndjenjat në ndërgjegjje, kështu duke shkaktuar -ngjallur- ose dëshirë ose antipati -neveri- në zemër dhe duke e përgatitur pér tē pranuar -fjalët e tij.

Kështu, fjala elokuente është ajo fjalë prej tē cilës përfitojnë bashkarisht mendja dhe ndërgjegjja; dhe ajo ashtu siç futet në mendje, pikon gjithashtu edhe në ndërgjegjje. Krahasimi alegorik është garantuesi -siguruesi- i këtyre dy aspektave, sepse ai përmban një lloj analogji, dhe nëpërmjet tij ligji i përfshirë në krahasim reflektohet në pasqyrën e gjësë së përfaqësuar. Sikur ligjëratat tē ishte një fjalë e mbështetur nga dëshmia. Pér shembull, ju mund tē thoni rreth një sundimtari i cili vuan vështirësi pér hir tē subjekteve tē tij: "Mali i lartë mban peshën e akullit dhe tē borës, ndërsa luginat poshtë tij bëhen jeshile e lulëzojnë."

Shëmböllesat formojnë bazat e krahasimeve, dhe funksioni i shëmböllesave është tē zgjojë ndjenjat e neverisë, ose tē dëshirës, ose tē simpatisë, ose tē urrejtjes, ose tē habisë ose tē druatjes -frikës; kështu, qëllimi i krahasimit mund tē jetë pér tē lartësuar ose pér tē poshtëruar ose pér tē ngjallur dëshirë ose pér tē ngjallur neveri, ose pér tē shformuar, ose pér tē zbukuruar, ose pér tē treguar mirësjellje, dhe kështu me radhë...

Ndërgjegjja zgjohet nga forma e krahasimit dhe nxiten ndjenjat e dëshirës dhe tē urrejtjes.

Nevoja e krahasimeve buron nga thellësia dhe hollësia e kuptimeve, krahasimet i bëjnë këto tē dukshme; ose (ajo buron) nga qëllimi (i asaj që u synua nga ligjërimi) duke u veçuar dhe duke u shpërndarë, dhe atëherë krahasimi e lidh me tē. Vërsetet alegorike tē Kuranit (*muteshabihat*) janë lloji i parë, sepse sipas dijetarëve kryesues dhe

<sup>25</sup> Kuran, 14:24-25

<sup>26</sup> Kuran, 14:26

<sup>27</sup> Njazi Ibn el-Nebih el-Misri (619H) në lavdërim tē Ejjubitëve.

autoritarë (*ehl-el-tahkik*) këto janë një lloj i krahasimit të lartësuar dhe një mjet për të shprehur të vërtetat e papérziera -të mirëfillta- dhe idetë abstrakte. Njëra arsyé për këtë është se shumicës së njerëzve të zakonshëm mund t'u mësohen të vërtetat vetëm në formën imagjinare - ata mund t'i kapin idetë abstrakte vetëm nëpërmjet krahasimeve, dhe kjo bën të domosdoshme përdorimin e shprehjeve të tillë alegorike (*muteshabihat*) si “*Pastaj ai istewa (u ngjit lart dhe qëndroi mbi) Arsh...*”<sup>28</sup>. Në këtë mënyrë, duke marrë në konsideratë të kuptuarin e tyre, ide të tillë bëhen familjare -të njoitura- për ta me kalimin e kohës, unë kam deduktuar prej esencave të elokuencës -retorikës- dymbëdhjetë çështje paraprake për shpjegimin e mrekullisë së Kuranit.

Secila prej tyre është fije peri (*khajt*) -për të treguar- shumë të vërteta.<sup>29</sup>

Meqenëse u përmendën më lart vërsetet që përbajnjë krahasime e shembëllesa, tanë është e përshtatshme t'i përbledhim këto - dymbëdhjetë- çështje. Kështu duke thënë “*Suksesi është vetëm nga Allahu*”, ne fillojmë:

### Çështja e parë:

Burimi i qëndisjeve të elokuencës nuk është gjë tjetër veçse renditja, rregullimi i kuptimeve, nuk është renditja e fjalëve e cila ishte sfera e interpretuesve fjalëmëdhenj.

Pasioni i tyre për fjalët e zhvilluara në një sëmundje kronike saqë në fund ‘Abdul Kahir Xhurxhani’ i refuzoi ato në (veprat e tij) ‘*Delail el ieràxhaz*’ dhe ‘*Esrar El-ieràxhaz*’, duke u kushtuar më shumë se njëqind faqe duke debatuar me ato.

Renditja e kuptimeve përbëhet nga kuptimet gramatikore duke u vendosur me sistem midis fjalëve; domethënë kuptimet e fjalëpërfjalshme -të mirëfillta- (*harfijj*) duke u shkrirë midis fjalëve për të fituar qëndisjet e pazakonta -originale. Në qoftë se ti do ta shikoje nga afër, ti do ta shihje se rrjedha e natyrshme për idetë dhe emocionet është renditja e kuptimeve.

<sup>28</sup> Kuran, 7:54

<sup>29</sup> Kjo u referohet dymbëdhjetë “çështjeve” duke përfshirë pjesën e dyte (ikinçi Makale) të veprës së Nursit, “Muhakemat”, 77-102.

Renditja e kuptimeve është ndërtuar me anë të rregullave të logjikës, sepse vetëm nëpërmjet logjikës mendimi përparon drejt të vërtetave. Dhe mendimi i arrin të vërtetat kur ai depërton në thellësitë e natyrave të gjërave dhe tek lidhjet e tyre. Dhe lidhjet nëpërmjet esencave të gjërave janë hallkat e rregullit të përkryer -të universit. Dhe rregulli i përkryer është sedefi -guaska- e bukurisë së papérzier -të plotë e të thjeshtë- e cila është burimi i të gjithë bukurisë. Dhe buuria e papérzier është kopështi i thënieve elegante, të hijshme e të holla që janë lulet e elokuencës.

Ky kopësht i mbushur me lule është aty ku bilbilat, e quajtur si burrat e elokuencës dhe dashuruesit e krijimit, bredhin e shëtisin.

Dhe këngët e émpla e të buta të atyre bilbilave burojnë nga jehonat e melodishme shpirtërore duke u përhapur prej flautave -këngëve- të renditjes së kuptimeve.

**Shkurtazi:** Universi është në elokuencën më të skajshme; Autori i tij e kompozoi atë në mënyrë të përsosur, me elokuencë. Të gjitha format dhe speciet që ai përmban për shkak të rregullit të përfshirë në to, janë mrekullitë e fuqisë. Kështu kur fjalë vjen ballë për ballë me aktualitetin, dhe renditja e saj është në përshtatje e harmoni me rregullin e tij, ajo posedon pastërtinë e stilit në tërësinë e tij. Por në qoftë se ligjërimi kthehet tek renditja e fjalëve, ai zbret në artificializëm dhe në hipokrizi; dhe sikur bie në tokë të thatë ose në një mirazh të rremë.

Arsyeja përsë interpretuesit u shmanqën prej elokuencës së vërtetë ishte se kur joarabët u bënë të arabizuar duke u tërhequr nga sundimi arab, arti i fjalëve për ta u bë me rëndësi të dorës së parë. Ata duke u përzier me arabët, fjalë e Mudariut, e cila formon bazat e elokuencës së Kur'anit, u bë e prishur; ajo pasqyrë e stileve të Kur'anit u bë e nxirë -ndonëse ajo buroi nga emocionet dhe temperamenti i popullit të Mudarit. Kështu një numër i madh i dijetarëve të fundit u rrëmbyen nga dashuria e fjalëve.

Zbukurimi i fjalëve i magjeps ata vetëm në qoftë se do të bëhej e domosdoshme nga natyra e kuptimeve. Dhe hollësia e krahasimeve bëhet elokuencë vetëm kur është e përshtatshme për qëllimin dhe e miratuar nga ajo që synohet. Fuqia dhe bredhja e imagjinatës është elokuencë vetëm në qoftë se nuk dëmton të vërtetën, as nuk peshon më

shumë se ajo, dhe imaginata ilustron -është shembull- pér tē vërtetën, duke buruar prej saj. Në qoftë se do tē dëshiroje shembuj gjithëpërfshirës tē këtyre kushteve, ti duhet tē konsultohesh me ato vërsete alegorike tē lartëpermendura.

### Çështja e dytë

Në qoftë se imaginata retorike (*el-sihr el-bejani*) manifestohet në ligjératë, aksidentalet bëhen substancë, kuptimet mishërohen, qëni e pajeta fitojnë shpirtëra, bimët pajisen me mend. Atëherë fillon bashkëbisedimi midis tyre që ndonjë herë çon në këndvështrim, dhe ndonjëherë në ngacmim. Qëni e pajeta nisin tē vallëzojnë para imaginatës. Në qoftë se dëshiron një shembull, shqyrtoji këto vargje:

*Pabesia më pëshpëriti nga prapa shtyrjes së tij,*

*Dhe shpresat dhe dëshpërimi polemizojnë në kraharorin tim*.<sup>30</sup>

Ose dëgjoje dashurinë midis tokës dhe shiut në varjet:

*Toka u ankua pér shiun dhe ardhjen me vonesë tē tij,*

*Dhe pastaj piu e mybutur prej ujërave tē tij, e rrufiti prej buzëve tē saj.*<sup>31</sup>

Kjo pikturnon e përshkruan kërcitjen dhe sumbullimin e tokës së tharë tē përvëluar me ardhjen e shirave tē vonuar. Prandaj duhet tē jetë një kokërr realiteti në çdo imaginatë, ashtu si në këto shembuj, dhe në llambën e çdo metafore në çdo flakërimë tē së vërtetës. Përndryshe elokuencia e tij imaginare do tē ishte e sajvar, e trilluar; e mirë vetëm pér tē shkaktuar habi.

### Çështja e tretë

Dije se bukuria dhe plotësia e ligjératës, dhe manteli retorik me tē cilin ajo vishet, qëndron në mënyrën e saj tē shprehjes (*uslub*). Dhe mënyra e saj e shprehjes përbëhet nga forma e tē vërtetave dhe nga modeli i kuptimeve tē fituara prej pjesëve tē metaforave alegorike (*el-*

<sup>30</sup> Ibn el-Mutaz; shiko, Dela'il ixhaz f.61: Divan i Ibn el-Mutaz, f.226.

<sup>31</sup> Shiko el-Mutenebbi, Diwan, I, 263

*istiarat*). Sikur ato pjesë tē ishin një kinematografi imaginare, ashtu si fjala ‘frut’ që tregon kopështin e tij, dhe fjala ‘dyluftim’ fushën e betejës.

Pér më tepër, krahasimet alegorike (*el-temthilah*) gjenden në misterin e lidhjeve midis gjérave, dhe në reflektimin e tyre tek rregulli i universit, dhe tek disa gjëra duke tē tē kujtuar tē tjerat. Pér shembull, pér bijtë e hurmës (Arabët), shikimi i hënës së re në yjësinë e plejadave tē sjell ndërmend një vile rrushi duke u varur prej një kërcelli tē tharë e tē harkuar. Ashtu siç thotë shpallja: “...Derisa ajo tē kthet si (tē ishte) një kërcell i vjetër i tharë hurme (hëna e re)”.<sup>32</sup>

Dobia e krahasimeve (*Uslub el-temthili*), ashtu siç tregohet në vërsitet e dhënë më parë, është se nëpërmjet tyre folësi sjell në dritë (i ngrë në sipërfaqe) rrënjet e thella dhe bashkon kuptimet e shpërndara. Kur ai ia dorëzon njérën anë dëgjuesit tē tij, është e mundur pér dëgjuesin ta tërheqë pjesën tjetër -të mbetur- pér tek vetja e tij; meqenëse ato janë lidhur e bashkuar, ai mund tē shkojë tek ato mendërisht. Meqenëse ai i shikon disa, edhe pse ato mund tē ishin në errësirë, ai mund tē përparojë pak e nga pak drejt tē gjitha atyre.

Pér shembull, një bizhuterier e përkufizon fjalën elokuente si “një ide që shpon (një perlë si një turjelë)”. Ndërsa një bujtinar -pronar pjetoreje- do tē thonte se ajo është “çfarë gatuhet në kazanin e njohjes”. Dhe një mehar deveje do tē thonte pér fjalën elokuente, se “është ajo çfarë ti merr me kapistër dhe e bën tē gjunjëzohet duke e mbështetur në gropën e kuptimit”. Duke vëzhguar artin në këto përkufizime, dikush duke i dëgjuar ato, do t'i kuptonte tē gjitha ato që u synuan.

Urtësia në formimin e figurave letrare (*Uslub*) (e krahasimeve) është se në mënyrë tē vullnetshme folësi thërret dhe zgjon kuptimet që janë duke pushuar në qetësi, në cepet dhe në qoshet e zemrës, sikur ato tē ishin tē zhveshura e lakuriq. Ato shfaqen dhe futen në imaginatë, dhe veshin mantelet e çfarëdo lloj forme që ato gjejnë që gjenden atje nëpërmjet artit tē folësit, ose zanatit ose familjaritetit ose tē nevojës. Ose tē paktën ato lidhin një shami tē artit tē tij rrëth kokave tē tyre, ose ngjyrosen me ngjyrat e atij -arti.

<sup>32</sup> Kuran, 36:39

Hyrja që ju gjeni në parathëniet e librave formojnë shembujt më të mirë të kësaj çështje.

Pastaj, stili i ligjératës mund të jetë gjithashtu në përputhje me imagjinatën e të adresuarit, si stilet -e figurave letrare të përdorura në Kur'an. Mos e harro këtë! Për më tepër, shkallët e stileve janë të ndryshme. Disa janë më të buta se sa flladi; kur fryn, ai tregohet nga ligjérata si një tërësi. Dhe disa janë më të fshehura e të maskuara se sa fshehtësirat dhe dredhitë e luftës; ato mund të zbulohen e të nuhaten vetëm nga mjeshtërit e artit të luftës. Ashtu si Zamahsheri i cili i zbuloi dhe i nuhati nga vërseti: “*kush do t'u japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur?*”<sup>33</sup> “A ka ndonjë konkurues, kundërshtar për luftë?”

Në qoftë se ti dëshiron, studioji vërsetet e përmendura më parë; ti do të gjesh në to gjëra, duke i verifikuar e vërtetuar aspektet më të holla të këtyre çështjeve.

Dhe në qoftë se ti dëshiron, vizitoje imam el-Busajri<sup>34</sup>, dhe shiko se si ai e shkruan përshkrimin e tij në stilin e një mjekut të urtë me fjalët e tij:

*Derdh lotë prej syve të mbushura më gjëra të ndaluara;*

*Kapu fort pas dietës së pendimit.*

Për stilin e mjekut aludohet me fjalën ‘dietet’.

Dhe dëgjoje Pupëzën e Sulejmanit; si ajo i referohet inxhinierisë së saj -zbulimit të ujit nën tokë nga ana e saj- me fjalët: “*Kështu që ata nuk e adhurojnë (e nuk i bien në sexhde) Allahut i Cili nxjerr në drithë qfarë fshihet në qiej dhe në tokë...*”<sup>35</sup>

### Çështja e Katërt

Dije se ligjérata posedon forcë e fuqi vetëm në qoftë se ajo mbështet e konfirmon vargjet:

<sup>33</sup> Kuran, 36:78

<sup>34</sup> 608-698H poeti i shqar islam

<sup>35</sup> Kur'an, 27:25

*Shprehjet tona janë të ndryshme por bukuria jote është Një,  
dhe gjithësecili (prej nesh) tregon atë bukuri;*

(ajo duhet t'i konfirmojë ato) me të gjitha fjalët e saj me renditjen dhe me frazat duke iu përgjigjur njëra-tjetrës; dhe secila duke marrë dorën e tjetrës dhe duke e mbështetur atë, dhe përvëç frutave të saj të veçantë secila duke e ndihmuar me fuqinë e shtrirjen e saj qëllimin e përgjithshëm. Ky qëllim i përbashkët i ngjason një pellgu të furnizuar prej të gjitha anëve nga rrëketë e përronjtë. Përgjigjja e ndërsjellë, e përbashkët, bëhet shkas për ndihmës të ndërsjellë, gjë e cila i jep shkas rendit, prej të cilil buron harmonia, prej të cilës lindin hijeshia dhe bukuria esenciale. Ky sekret i elokuencës shkëndijon në çdo pjese të Kur'anit, dhe sidomos në “*Ky është libri -Kur'an- mbi të cilin nuk ka asnjë dyshim, udhëzim për (besimtarët) e devotshëm*”<sup>36</sup> dhe në të tjerët si kjo, ashtu siç e ke parë tek “*Dhe në qoftë se vetëm një frymë e Ndëshkimit të Zotit tënd do t'i prekë ata*”<sup>37</sup>...

### Çështja e Pestë

Dije se pasuria e -çdo pjese të- ligjératës dhe rrezja e saj qëndron në shërbimin e saj ndaj qëllimit kryesor; dhe mënyra e saj dhe forma e përgjithshme dhe kuptimet aluduese, që të gjitha tregojnë dhe shfaqin qëllimin kryesor së bashku me kuptimet e tij ndihmës e dytësorë. Atëherë nivelet e kuptimit shfaqen njëri pas tjetrit, dhe stacionet njëri prapa tjetrit. Në qoftë se dëshiron një shembull të kësaj, studioje “*Dhe kur atyre u thuhet: “Mos bëni djallëzi në tokë...*” (deri në fund të vërsetit, 2:11), dhe “*Ndërsa kur takohen me ata që besojnë...*” (deri në fund të vërsetit, 2:14), siç janë shpjeguar më lart.

### Çështja e Gjashtë

Dije se kuptimet e mbledhura prej hartës së ligjératës merren e skaliten nga kamera e përpilimit në përputhje me llojet e ndryshme dhe me shkallët. Disa janë si ajri; ato mund të ndjehen por jo të shihen. Disa të tjera janë si avulli; ato mund të shihen por jo të mbahen -nuk

<sup>36</sup> Kur'an, 2 : 2

<sup>37</sup> Kur'an, 21:46

mund tē merren. Disa tē tjera si uji; ato mund tē mbahen por nuk mund tē kafen -shtrēngohen. Disa tē tjera janē si lingoti i shkrirē; ato mund tē kafen e shtrēngohen por jo tē pērcaktohen. Disa tē tjera janē si perlat e vēna nē varg ose si ari i rrāhur; atyre mund t'u jepet njē trajtē specifike e formē; pastaj nēn efektin e qëllimit dhe tē stacionit, kuptimi joreal - imagjinar- fiton qëndrueshmëri dhe trup. Tre gjendje modelojnē - formojnē- njē kuptim tē vetēm.

A nuk ke vēzhguar se kur ndonjē çeshtje e jashtme prek ndërgjegijken tēnde, zemra jote trazohet? Emocionet e tua lëvizin e nxiten, dhe kuptimet joreale marrin fluturimin dhe dëshirat linden. Disa nga këto kanē ndodhur, janē arritur.

Pastaj disa prej këtyre marrin formē. Dhe disa prej këtyre tē fundit frenohen e pengohen. Nē se cilin prej këtyre niveleve, disa prej kuptimeve bëhen tē vërtetuara e tē vendosura ndërsa disa lidhen dhe disa tē tjera pezullohen, ashtu si njē pjesë e zërave që mbeten pezull - ndërpriten përkohësisht- kur formohen disa shkronja, dhe ashtu si pjesa e një kalliri gruri kur lëshon erë kallëz, bëhet lëvore kur formohet gruri. Kështu folësi elokuent dallohet nga tē shprehurit e tij qartë ato gjëra që u synuan nga fjala e tij dhe që u kërkuan nga ata që u adresohet.

Nivelet e tjerë tē kuptimit që ia referon -nē lidhje me afërsinë e tyre me qëllimin kryesor- asaj që dedukton shqisa dhe që tregonjë fjalët dhe që rrëfejnë rrëthanat e veçanta dhe që tregon hyrja dhe që nënkupton stilë dhe që sugeron qëndrimi i tij.

Pastaj, ndodhen kuptime tē varura pezull: dhe janē kuptime kalimtare shprehëse (*harfijeh*), jo tē shprehura nga fjalë tē veçanta.

Ato janē udhëtarë endacake pa banim, pa shtëpi -atdhe- tē pērcaktuar. Ndonjëherë ato fshihen nē një fjalë; ndonjëherë ato përthithen nga një frazë, dhe ndonjëherë ato kërkojnë strehim - ndërfuten- nē ndonjë tregim; ti mund t'i distilosh ato nē qoftë se i shtyp -shtrydh- kur ato gjenden. Ashtu si zhgënjimi i shprehur nga nëna e Merjemit nē vërsetin,

*“O Zoti im! Kam lindur vajzë...”<sup>38</sup>*

<sup>38</sup> Kuran, 3:36

Dhe hidhërimi nē rreshtat

*Ah sikur një ditë tē kthehej rinia,*

*Që t'i tregoja se ç'më ka bërë pleqëria.*

Si dhe kuptime tē tilla si, përmallimi, vetëmburrja, adresimi ndaj tē tjerëve, aluzioni, vuajtja, habia, çudia dhe krenaria.

Lidhjet midis tē gjitha këtyre kuptimeve rivalizuese janē tē mira me kusht që kujdesi dhe vëmendja t'u jepen atyre nē mënyrë tē përpjesëtar pér qëllimin e tyre kryesor. Nē qoftë se ju dëshironi shembujt e kësaj çeshtjeje, më tē qartat janē dhënë nga kjo sure, nga fillimi deri këtu, dhe nga mënyra nē tē cilën ajo eshtë shpjeguar.

### Çeshtja e shtatë

Dije se nē qoftë se imagjinata ka një vend nē një stil ose nē një figurë letrare (*uslub*), ajo sigurisht duhet tē mbijë -mugullojë- prej një bërthame tē një tē vërteteje, dhe tē jetë si një pasqyrë duke reflektuar me tē -në çeshtjet jomateriale (*maënevijjate*)- ligjet fizike dhe shkaqet dhe pasojat nē zinxhirët e qënieve tē jashtme. Filozofia e gramatikës (*el-nahv*) veprat e së cilës përbajnjë lidhjet e lartëpërmendura, eshtë gjithashtu e këtij lloji -ashtu siç thuhet se (*rasa*) emërore eshtë e vepruesit, sepse i fuqishmi merr tē fuqishmin- tē fuqishmen. Ju mund tē bëni shembuj tē tjerë nē tē njëjtën mënyrë.

### Çeshtja e tetë

Dije se Sibawah<sup>39</sup> pohoi prerasi se pjesëzat që shprehin kuptime tē shumta si (*min*), (*ila*) dhe (*el-ba*) dhe tē tjerat, nē fakt -në bazën e kuptimit- shprehin vetëm një kuptim tē vetëm tē pandryshuar, por ato përthithin -marrin- një kuptim tē varrur pezull nē lidhje me kontekstin, stacionin (*mekam*) dhe me qëllimin, duke e têrhequr atë pér tek vetvetja, dhe kuptimet e tyre originale bëhen forma e mënyra shprehjeje (*uslub*) pér mysafirët e tyre. Gjithashtu kur dikush që eshtë njoħës nē shkencën e gjuhës i studion dhe i shqyrtan këto nga afér, ai e

<sup>39</sup> Umer Ibn Uthman Sibavajh (796H), një autoritet kryesues nē gramatikën arabe.

di se një fjalë e përbashkët -duke mbajtur disa kuptime- në shumicën e rasteve ka një kuptim të vetëm. Pastaj, për shkak të lidhjeve midis tyre, kuptimet janë bërë shëmbëllesa dhe disa janë bërë metaforike, dhe të tjerat duke u bërë pjesë e një gjuhe të përditshme; të përgjithshme, i kanë humbur kuptimet e tyre origjinale (*hakaik urfij-jeh*). Në këtë mënyrë fjalët e vetme janë bërë me kuptime të shumta.

Fjala ‘el-ajn’ që do të thotë ‘sy’ ose ‘burim’ përdoret edhe për diellin gjithashtu, në mënyrë figurative, sepse nëpërmjet tij bota qellore -e lartë- shikon poshtë botën më të ulët, ose për shkak se uji i jetës që është drita e tij vërshon, rrjedh poshtë prej atij burimi në malin e bardhë, -në majat e larta të bardha. Ju mund të bëni analogji me këtë për pjesën e mbetur.

### Çështja e nëntë

Dije se shkalla më e lartë e elokuencës, e cila e përblyt, e bën të paaftë, aftësinë e dëshirës së pjesshme -vullnetit të lirë- dhe mendimin personal dhe konceptimet, përfytyrimet e thjeshta, është që folësi të ruajë, t'u përbahet dhe t'i shohë njëherësh të gjitha lidhjet e pjesëve të ligjératës së tij si dhe lidhjet e fjalëve dhe balancën e fjalive. Secila prej këtyre së bashku me të tjerat duhet të shfaqin një qëndisje, dhe të ndërlidhura -në tëresinë e tyre formojnë- një endje të madhe dekorative. Është sikur folësi përdor mendje të tjera tek mendja e tij ashtu si ndërtuesi i një pallati që i vendos gurët shumëngjyrësh në një mënyrë të tillë që me të bëheshin skalitje e vizatime të çuditshme prej balancës dhe harmonisë, ose si disa skica të bukurshkruesve duke karakterizuar shkronjën ‘ajn’ të përbashkët nga të gjithë kalifët<sup>40</sup> njëri nga shembujt më të qartë të kësaj çështjeje është vërseti,

“Elif-lam-Mim. 2-Ky është libri (*Kur'an*), mbi të cilin nuk ka asnjë dyshim, udhëzim për el-muttekjine (besimtarët e drejtë, të përkushtuarit).<sup>41</sup>

Një arsyé tjetër për ligjératën duke qenë e lartë është përngjasimi i saj si një pemë familjare, me degët dhe me shkarpat e brezave të saj që të gjitha duke shprehur qëllimet që tregojnë qëllimin kryesor dhe

<sup>40</sup> Emrat e të gjithë kalifëve fillojnë me ‘Ajn’: Umer, Uthman, Ali. Atik ishte titulli i Ebu Bekrit, i kalifit të parë.

<sup>41</sup> Kuran, 2:1-2

stacionin-mekamin. Një arsyé tjetër është ligjérata duke marrë një formë të tillë saqë shumë aspekte dhe degë mund të deduktohen prej saj, ashtu si tregimi i Musait a.s..

### Çështja e Dhjetë

Dije se ligjérata fiton rrjedhshmëri dhe lirshmëri, burimi i hidhësisë dhe i ëmbëlsisë, kur kuptimet dhe ndjenjat që ajo tregon përzihen e kombinohen, ose janë të ndryshme por të sistemuara, sepse atëherë rrëthinan nuk e tërheqin fuqinë e shprehjes së saj dhe të qëllimit, por qendra tërheq fuqi prej rrëthinateve. Gjithashtu ligjérata fiton lirshmëri kur qëllimi është i përcaktuar mirë, dhe kur pikë, tek e cila bashkohen të gjithë qëllimet e synuara, është e qartë.

### Çështja e Njëmbëdhjetë

Dije se integriteti i ligjératës, e cila është arsyaja për saktësinë dhe fuqinë e saj, qëndron sa vijon: Ashtu si ligjérata që duhet të tregojë parimet dhe provat e para, dhe të aludojë për kuptimet parësore dhe dytësore, po ashtu me elementet e kryefjalës dhe të kallzuesit dhe me mënyrat e tyre të shprehjes, ajo duhet të nënkuptoje largim e zmbrapsje të dyshimeve dhe të iluzioneve -sikur secila pjesë e saj të ishte përgjigjja për një pyetje të nënkuptuar. Në qoftë se dëshiron një shembull të rrjedhshëm të saj, studioje suren e parë të Kur'anit!

### Çështja e Dymbëdhjetë

Dije se ndodhen tre lloje stilesh ose mënyrash shprehjeje (uslub):

I Pari është një stil i thjeshtë ose abstrakt (*el-uslub el-muxher-red*); ajo është një ngjyrë e vetme dhe karakterizohet nga thukëtia e saj, natyrshmëria, saktësia dhe integriteti. Ajo është e lëmuar dhe e rrafshët dhe përdoret për biznes, për diskutime dhe për shkenca instrumentale. Në qoftë se dëshiron një shembull të rrjedhshëm të saj, studio veprat e Sej-jid el-Xhurxhanit.

I Dytë është stili i zbukuruar (*el-uslub el-muzejjeneh*); ai karakterizohet nga zbukurimi dhe ndriçimi, dhe duke i shkaktuar e duke i zgjuar zemrës ose dashurinë ose neverinë. Vendet e

përshtatshme pér tē janē adresimet -e synuara pér- lavdërim ose qortim dhe kështu me irradhë, si dhe pér bindje dhe pér gjëra tē ngjashme. Në qoftë se ti kërkon një shembull tē zbuluar, hyr tek "Dela'il el-ié'xhaz" dhe tek "Esrar el-belagah", sepse nē to ti do tē gjesh kopshte tē stolisur.

**I Treti** është stili i lartë (*el-uslub el-Ali*), i cili karakterizohet nga intensiteti i tij, nga fuqia, madhështia dhe nga lartësia shpirtërore. Vendet e përshtatshëm pér tē janē çështjet Hyjnore, parimet e fesë dhe filozofia. Në qoftë se ti dëshiron një shembull tē mprehtë tē qartë dhe tē mrekullueshëm, studioje Kur'anin, sepse nē tē janē tē vërtetat elokuente që nuk janë parë nga asnje sy dhe as nuk i ka ndodhur asnje zemre.

Kjo pjesë përfundon këtu nē formë tē përbledhur.

\*\*\*

**Shqyrtoje këtë:** Pikat e rëndësishme nē këtë verset që ne po i diskutonim: مثلكم كمثل الذي استوقد نارا "Metheluhum Kemetheli el-ledhi isteukade...", "Kjo ngjason (shembulli i tyre është) si me atë që ndezizjarrin" (deri nē fund tē vërsitit, 2:17), janë sa vijon:

**Së Pari:** Pozicionimi i tij nē lidhje me atë që e parapriu.

**Së Dytë:** Vendosja -pozicionimi- (dhe lidhjet ndërmjet) frazave tē tij.

**Së Treti:** Pozicionimi (dhe lidhjet midis) përbërësve tē frazave tē tij.

Duke mbajtur nē mendje diskutimin mbi elokuencën që u përmend lart, dije se duke pas dhënë një përshkrim tē qartë tē gjendjeve tē hipokritëve dhe tē krimeve tē tyre, Kur'ani citon krahasimin vijues (*temthil*) pér tre arsyen:

**E Para e këtyre:** pér ta bërë (tē renë ose tē panjohurën, tē pazakontën) tē shfaqet familjare -e njobur- pér imaginatën (*el-Khajal*), e cila i pranon produktet e imaginatës më me zell -e më shpejtë- se sa

idetë rationale; dhe pér ta bërë aftësinë hamendësuese (*el-vehm*), e cila është e dhënë pas dyshimeve dhe pas tē pyeturit dhe kundërshtimit të arsyes, tē nënshtrohet duke e shfaqur tē huajën -të çuditshmen- nē një formë familjare e tē njobur, dhe duke e piktuar e paraqitur tē fshehtën si tē dukshme.

**E Dyta:** Pér ta zgjuar ndërgjegjjen dhe pér tē shkaktuar neverinë nē tē, kështu që duke përfaqësuar e paraqitur atë që është mendore - abstrakte- si tē prekshme e konkrete, me qëllim që tē bashkojë mendjen dhe emocionet.

**E Treta:** Pér t'i lidhur bashkarisht kuptimet e shpërndara nëpërmjet krahasimit, dhe pér tē treguar lidhjet e vërteta ndërmjet tyre. Gjithashtu pér tē vendosur -faktet e dëshiruara- përparrë syrit tē imaginatës me qëllim që ajo tē mbledhë pikat e holla që gjuha dështon -pér t'i shprehur.

**Shqyrtoje këtë:** Kuptimi i frazës së këtij vërseti i korrespondon edhe kuptimit tē têrësisë së tregimit tē hipokritëve, si dhe tē gjithë vërseteve që (e tregojnë) atë. A nuk e shikon se ata besuan nga ana e jashtme pér avantazhet dhe dobitë e kësaj bote, pastaj nga ana e brendshme ata nuk besuan. Pastaj ata u bënë konfuzë dhe tē ngatëruar. Pastaj ata nuk e kërkuan tē vërtetën saqë qenë tē pamundur që tē ktheheshin -tek ajo- dhe që tē mund ta njihnin. Sa i ngjason kjo situatës së njerëzve tē cilët ndezin një zjarr ose llampë por pastaj nuk e ruajtën atë (nuk e mbajtën atë tē ndezur, me dritë), dhe pastaj ajo u shua. Ata u zhytën nē errësirë. Pastaj ata nuk mund tē shohin asgjë dhe duket pér ta se gjithçka ka pushuar së ekzistuari!

Pér shkak tē heshtjes së natës, është sikur ata janë tē shurdhër; dhe pér shkak se nata duket e verbër dhe dritat e tyre janë shuar, është sikur ata janë tē verbër; dhe pér shkak se nuk ndodhet askush që tē mund t'i kthehen e t'i drejtohen pér ndihmë dhe që nuk marrin ndihmë, është sikur ata janë memecë; dhe pér shkak se ata nuk mund tē kthehen, është sikur ata janë fantazma tē pajetë, pa shpirtëra nē to. Pikat kryesore nē krahasim shikojnë tek tē pjesshmet kryesore tē subjektit tē tyre (gjërave tē krahasuara -*muteshabihat*). Pér shembull, errësira shikon tek mosbesimi (i tyre), dhe konfuzioni i ngatëruar tek lëkundshmëria dhe ngurrimi (i tyre), dhe zjarri tek përcarja e konflikti.

Ti mund tē bësh analogji tē tjera nē tē njëjtën mënyrë.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Drita -përmendet- në kahasim, por si mund tē ketë dritë hipokriti, që tē aplikohet kahasimi pér tē?

*Ty do tē tē thuhej:* Në qoftë se një person nuk ka dritë, ajo mund tē gjendet në rrithinat e tij, prej ku ai mund tē kërkojë dritë. Në qoftë se nuk ndodhet asgjë atje, ajo mund tē gjendet midis popullit tē tij, prej tē cilëve ai mund ta marrë atë. Në qoftë se nuk do tē kishte dritë midis njerëzve tē tij, mund tē ndodhen disa prej racës njerëzore prej tē cilëve ai mund tē përfitojë. Dhe në qoftë se edhe këtu nuk ndodhet, mund tē gjendet -një shkëndijë që- buron e rrezaton prej natyrës së tij tē bashkëlindur, prej tē cilës ai mund tē marrë shkëlqim, ashtu siç është diskutuar. Në qoftë se ju nuk jeni tē bindur nga kjo, mundet në shikimin e tē tjerëve, tē gjendet -dritë- në gjuhën e tij duke shikuar tek shikimi i tjeterit ose duke shikuar tek vetja e tij -sipas vetes- së tij, me qëllim që tē fitojë dobi tē kësaj bote. Në qoftë se ti akoma nuk je bindur, (hipokritët mund tē kenë pasë një dritë) pér shkak se disa prej tyre besuan në fillim, dhe pastaj bënë apostazi -lëshuan fenë, besimin. Në qoftë se kjo mund tē tē bindë ty, kjo mund tē jetë se drita këtu aludon pér atë prej tē cilës ata përfituan, ndërsa zjarri tregon pérçarjen -konfliktin- (që ata shkaktuan).

Dhe në qoftë se ti nuk je i kënaqur edhe me këtë, fakti se udhëzimi ishte i mundshëm nëpërmjet shpalljes -së Kur'anit- (tregonte) se ai ishte ekzistues, ashtu siç tregohet nga vërseti (paraprijës),

**اشتروا الضلالة بالهدي**  
“Këta (ata) janë tē cilët shkëmbyen udhëzimin me tē gabuarën”. Sepse ky është fqinji më i afërt i kahasimit.

**Tani pér vendosjen -pozicionimin (dhe lidhjet ndërmjet) frazave tē vërsetit:**

**Shqyrtoje këtë:** Pozicionimi i frazës

**مثِلْهُمْ كَمَثَلَ الَّذِي اسْتَوْقَدَ نَارًا**  
“*Metheluhum kemetheli el-ledhi isteukade naren*”, “*Kjo ngjason (shembulli i tyre është) si me atë që ndezi zjarrin*” është absolutisht i përshtatshëm. Sepse gjendja e ndezjes së zjarrit në këtë mënyrë është krejtësisht i përputhur me situatën e njerëzve tē parë tē cilëve iu adresua Kur'ani. Ata ishin banorët e gadishullit arabik dhe pa përjashtim e kishin përjetuar një situatë tē tillë, ose kishin dëgjuar rrith

saj, ose kishin vuajtur efektet e saja tronditëse e çrrégulluese. Ata patën kërkuar strehim tek errësira e natës pér shkak tē tiranisë së diellit, duke udhëtarët në errësirë. Shumë shpesh qiejt do t'u mëshonin atyre -do t'i shtypnin- dhe ata do tē ndjenin lodhje e mërzi prej udhëtimit, dhe ndonjëherë rruga e tyre do t'i conte ata në humnerë. Ata gjithashu do tē bredhnin në errësirën e shpellave dhe guvave tē mbushura me kriesa tē dëmshme. Pastaj ata do tē humbisin rrugën e tyre dhe nevojën pér tē ndezur një zjarr ose pér tē ndriçuar një llambë pér tē parë shokët e tyre ose madje pér t'u ndjerë më afër tyre, dhe pér tē parë pronat e gjërat e tyre me qëllim që t'i ruajnë e t'i mbrojnë, dhe që tē njohin rrugën e tyre në tē cilën do tē shkojnë, dhe kështu kafshët e egra dhe rreziqet e tjera do tē ishin tē dukshme pér ta dhe ata do tē mund t'u shmangeshin atyre. Pastaj, kur ata u ndriçuan mirë me dritën e tyre, ajo do tē shuhej befas me goditjen nga qiejt. Dhe ndërsa ata janë tē mbushur me shpresë dhe gati pér tē realizuar objektivat e tyre, ata do tē flakeshın e binin në dëshpërimin më tē thellë.

(Kur'ani) e pohon këtë në mënyrë tē qartë me fjalët:

فَلَمَّا أَضَاءَتْ مَا حَوْلَهُ ذَهَبَ اللَّهُ بِنُورِهِ  
“*Felem-ma eda'et ma haulehu dheheball-llahu binurishim*”, “*dhe pasi ai ndriçoi gjithandej rrith tij, Allahu ua mori dritën e tyre*”.

فـ “*Fe*” në fillimin e frazës tregon se ata e ndezën zjarrin pér dritë dhe ai i ndriçoi (rrith e qark tyre) dhe ata u ndjenë tē qetë e tē sigurt tek kjo. Por ata u mposhtën menjëherë nga shembja dhe nga zhëgnjimi. Sa i fortë është ndikimi i prishjes (së planeve) ndërsa ishte tek pikërisht momenti i suksesit! Drita duke ikur në (pasojën -domethënë, në gjysmën e dytë) tē fjalisë kushtore, bëhet, në dukje e domosdoshme nga ndriçimi, (por domosdoshmëria e kësaj nuk është e qartë). Domosdoshmëria duke qenë e fshehur tregon ekzistencën e (fjalive) tē nënkuptuara, siç vijon:

Kur gjithçka u ndriçua pérreth tyre, ata e preokupuan veten e tyre me dritë... por nuk e ruajtën atë. Ata nuk ia dhanë asaj rëndësinë e duhur dhe nuk qenë tē vetëdijshëm pér vlerën e saj, nuk e njohën vlerën e mirësise në tē. Ata nuk e mbajtën (zjarrin) tē ndezur dhe ai u shua. Sepse duke qenë tē preokupuar me rezultatin, ata neglizhuan mjetin. Ashtu siç nënkuptohet nga vërseti “*in-nel-insane lejatgha en rea'hu's tagħna*”

(Por ja! Me tē vërtetë njeriu i kalon tē gjithë kufijtë. Ngaqë e sheh veten tē vetëmjaftueshëm)<sup>42</sup>. (Prokopia e tyre me dritën) ishte shkaku i mbarimit dhe i mos vazhdimit tē saj dhe i qënies së saj tē shuar, sikur pikërisht ndriçimi i shkaktoi dritës tē ikë.

**وَرَكِيمٌ فِي ظُلْمَاتٍ** *“ve terekhem fī dhulumātin dhe i la nē errēsirē”*, duke treguar se si ata e humbën mirësimë e dritës, (Kur’ani) pëershkuaran zhgënjin min e tyre tek fatkeqësia e qënies së tyre tē zhytur nē errësirë.

**لَا يَصْرُونَ** *la jabsirūne*, “(kështu që) ata nuk mund tē shihnin”: Dije se kur bie errësira dhe një person humbet rrugën e tij, ai mund tē ndalojë e tē ngushëllohet me shikimin e shokëve tē tij dhe tē posedimeve -pronësive- tē tyre. Por nē qoftë se ai nuk i shikon ata, ndalimi mund tē jetë aq i keq pér tē aq sa lëvizja, ose madje edhe më keq.

**فَهُمْ لَا يَرْجِعُونَ** *“Sum-mun bukmun Umjum fehum la jerxhiune”*, “Ata janë tē shurdhër, memecë e tē verbër, kështu që ata nuk këshen (në Rrugën e drejtë)”: kur një person mposhet nga një fatkeqësi e tillë, ai gjen ngushëllim duke shpresuar pér shpëtim dhe duke e kërkuar atë nga katër drejtime tē njëpasnjëshme.

**Së pari** ai shpreson tē dëgjojë lutjet -klithmat- e fshatarëve aty pranë ose tē udhëtarëve tē tjerë dhe (parashikon) se nē qoftë se ai thërrret pér ndihmë ata do ta shpëtojnë atë. Por meqenëse nata është e pazëshme dhe e heshtur, ai nuk është ndryshe nga një njeri i shurdhët, prandaj -Kur’ani- e thërrret atë **سُمْ** *“Sum-mun”*, “tē shurdhër”, dhe ajo shpresë është e humbur.

**Së dyti** ai shpreson se nē qoftë se ai bërtet apo thërrret pér ndihmë ndodhet mundësia që dikush ta dëgjojë dhe do t'i vijë nē ndihmë atij. Por kur nata është e shurdhët dhe memece, atëherë nuk ka ndryshim midis folësit dhe dikujt që është memec, prandaj -Kur’ani- e quan (atë)

<sup>42</sup> Kur’an, 96:6-7

**بُكْمُونْ** *“bukmun”*, “memecë”, duke e heshtur dhe duke e shkatëruar edhe atë shpresë gjithashtu.

**Së Treti** ai shpreson tē jetë i shpëtar nëpërmjet shikimit tē ndonjë shenje ose një zjarri ose një drite që do t'ia tregonte rrugën e destinacionit tē tij. Por kur nata është e përhime, e errët duke kapluar, e zymtë dhe e verbër, shikimi dhe verbërimi janë tē njëjtat, prandaj

**عَمْيٌ** *“Umjun”*, “tē verbër”, duke e shuar edhe atë shpresë gjithashtu.

**Së Katërti:** Asgjë tanë nuk mbetet pér tē veçse tē përpinqet pér t'u kthyer. Por errësira ka rënë mbi tē dhe ai është si dikush që ka hyrë nē një moçal me dëshirën e vet dhe pengohet dalja pér tē, nuk mund tē gjejë rrugë pér tē dalë. Sa shumë gjëra ndodhen tek tē cilat ti përfshihesh me dëshirë -vullnet tē lirë- dhe pastaj plaçkitet prej teje zgjedhja nē kthim, dhe ti nuk mund tē kthehes; ti heq dorë nga ato por

**فَهُمْ لَا يَرْجِعُونَ** *“Fehum la jerxhiune”*, “kështu që ata nuk kthehen (në Rrugën e drejtë)” pér ta mbyllur pér ta edhe këtë derë gjithashtu, duke e këputur edhe këtë litar tē fundit tek i cili ata ishin kapur. Kështu ata ranë nē errësirën e dëshpërimit, tē shkretimit, mjerimit dhe tē frikësimit.

Tani pér **aspektin e tretë**, dua tē them pér pozicionimin (dhe lidhjet midis) pjesëve përbërëse tē frazave:

**مَثَلُهُمْ كَمَثَلِ الَّذِي اسْتَوْقَدَ نَارًا** *Shqyrto Kjo ngjason (shembulli i tyre është) si me atë që ndezi zjarrin* dhe shiko se si shkëndijat e pikave tē holla ikin fluturim prej fjalëve tē saj.

Fjala **“El-methel”** *“shembell, shëmbëlltyrë”* tregon çudinë e gjendjes së hipokritëve dhe se tregimi i tyre është i jashtëzakonshëm. Sepse një shëmbëlltyrë është diçka që është në çdo gjuhë -qarkullon nëpër gjuhë- dhe njerëzit ia rrëfenjë atë njëri-tjetrit sepse ajo është e ndryshme dhe e pazakontë; karakteristika e saj më dalluese është kureshtia e saj. Pér shkak se parimet themelore janë përfshirë në shëmbëlltyra e në

proverba, ato janë quajtur "Urtësia e Përbashkët" dhe "Filozofia popullore".

Ajo çfarë synohet këtu nga shëmbëlltyra është -për të përshkruar këtë çudi karakteristike, dhe këtë tregimin e tyre kureshtar dhe gjendjen e tyre të neveritshmë. Me fjalë të tjera, përdorimi metaforik i termit

**مُثَلٌ** "methel" "shembell, shembelltirë" për të përshkruar gjendjen e tyre, tregon qënien e tyre të pazakontë dhe të ndryshme. Dhe ky tregues e nënkupton atë në mënyrë karakteristike, ky atribut i tyre haset me neveri, dënim e mallkim prej gjithësecilit, si me një proverbë.

Sa për **ك** "Ke", "si" e "**Kemetheli**", "si shembulli i"

• *Në qoftë se ti do të pyesje:* Në qoftë se kjo do të ishte hequr, do të kishte qenë një krasim elegant; a nuk do të kishte qenë më elokuenti?

*Ty do të të thuhej:* Do të kishte qenë me një elokuencë më të madhe në këtë kontekst (*mekam*) për ta përmendur, sepse qartësia e saj zgjon mendjen, e bën atë ta shohë shëmbëlltyrën në vend të dytë dhe për të kaluar nga pikat kryesore (që është duke i bërë shëmbëlltyrat) për tek ajo që ajo aludon. Sepse në qoftë se (mendja e lexuesit) do të përthithej qëllimisht në (vetë shëmbëlltyrën), hollësitë e saj që duhet të aplikohen (për atë që ajo aludon) do të shmangeshin, do t'i dilnin nga mendja. (Shembulli i dytë i fjalës) Shëmbëlltyra e dytë (*el-methel*) tregon se me çudinë e saj dhe me ekzistencën e saj në mendjen e përgjithshme, situata e atij që ndez zjarrin është sikur proverbiale.

**الذى**  
Tani sa për **"el-ledhi"**, "i cilí, që".

• *Në qoftë se ti do të pyesje:* Përse ky (përemër lidhor) është në numrin njëjës kur (hipokritët) janë në numrin shumës?

*Ty do të të thuhej:* Në qoftë se pjesa dhe e tëra, dhe individi dhe kolektivi janë të barabartë dhe anëtarësia (e kolektivit) as nuk i shton dhe as nuk i pakëson atributet e individëve, është e lejueshme (ta përdorësh atë edhe për njëjësin edhe për shumësin në dy drejtime si tek, "shëmbëllimi i tyre është ai (methel) i një gomari". Përdorimi i njëjësit tregon se çdo individ në mënyrë të pavarur përfaqëson tmerrin

dhe neverinë e të gjithë atyre. Ose mund të jetë që **الله** "el-ledhi", "i cilí, që" është një formë e shkurtuar e "el-ledhine" "të cilët" (forma shumës).

**استوقد**  
Sa për **"isteukade"**, "**ndezi**" (Domethënë, folja duke qenë e Formës së x) aludon për kërkimin e tyre dhe për marrjen përsipër (marrjen e mundimit), ndërsa qenia e saj në njëjës megjithëse ndjekësja

**نورهم** "nurihim", "dritën e tyre" ka prapashtesën përemorre shumës është një shenjë e hollë se personi e ndez atë për grupin. Është me të vërtetë e hollë se njëjësi përdoret për ndezjen dhe shumësi përdoret për qenien i ndriçuar".

**نار** "naren" "një zjarr" në vend të "llambës" ose të diçkaje tjetër aludon për vështirësinë -e përfshirë- në dritën e urdhërave të Allahut (dhe sprovave), dhe tregon se ata ndiznin zjarrin e përçarjes, konfliktet, nën maskën e dritës.

**نار** "Naren" "një zjarr" duke qenë e pashquar tregon se nevoja e tyre për zjarr ishte aq e madhe saqë ata do të kënaqeshin me çfarëdo forme që do të merrte ai.

**فَلَمَّا آضَأَتْ مَا حَوْلَهُ ذَهَبَ لِلَّهِ بِنُورِهِمْ**  
Tani hidhe një sy mbi frazën "dhe pasi ai ndriçoi gjithandej rreth tij, Allahu ua mori dritën e tyre", dhe shiko se si fjalët e saj ndriçojnë errësirën e çudisë së tyre, e cila është qëllimi i tyre kryesor. Ti e dëgjove -lexove- në Çështjen e Katërt lart se fuqia e ligjërâtës qëndron në përgjigjen e ndërsjellë të pjesëve të saj.

**فَلَمَّا** "fe" (në "fe-lem-ma") aludon për sulmin e menjëhershëm të dëshpërimit absolut pas të qenurit plot shpresë. **لِمْ** "Lem-ma" përmban një silogizëm kushtor të përpjesëtar, i cili duke demonstruar sigurinë e -fjisë- së parë, nënkupton sigurinë dhe realizimin e fjalisë

vijuese; (domethënë, qenia e tyre tē mposhtur nga errësira) dhe humbja e tyre burimin e ngushëllimit.

**اضاءت** “*Edāet*”, “*ndriçoi*” tregon se ata e ndozën zjarrin pēr dritē dhe jo pēr ngrohje. Dhe kjo aludon pēr tronditjen e tyre tē tmerrshme, sepse ndriçimi i tij sherbente vetäm pēr tē parë rreziqet (duke u rënë atyre) dhe pēr tē mësuar ekzistencën e tyre. Po tē mos kishte qenë (drita), ata do tē kishin mashtruar vetveten dhe do tē kishin qenë tē qetë.

Ndërsa **ماحوله** “*mà haulehu*”, “*gjithandej rreth tij*” tregon se ata u rrethuan nga tmerri në tē gjitha anët, dhe se ata duhej tē mbronin vetveten me dritën prej dëmeve duke i rrethuar ata prej tē gjitha gjashtë drejtimeve.

Sa pēr **ذهب** “*dhehebe*”, “*ua mori*”, ajo eshtë pasoja e kushtit dhe prandaj u bë e domosdoshme nga (pjesa e parë e fjalisë kushtore) **اضاءت** “*edāet*”, “*ndriçoi*”, por ashtu siç eshtë diskutuar më lartë, kjo domosdoshmëri eshtë (jo e qartë, ajo eshtë) e fshehtë dhe i nënkupton (këto fjalë): Ata nuk qenë tē vëmendshëm dhe tē kujdeshëm pēr zjarrin dhe nuk e njohën vlerën e tij si një mirësi, dhe drita i bëri ata tē dalin sipër veteve tē tyre -i bëri t'u rritet mendja- dhe gëzimi i tyre dhe krenaria i bëri ata tē harronin pēr ta ruajtur (pēr ta mbajtur tē ndezur), kështu Allahu e mori atë prej tyre.

Atribuimi i **ذهب** “*dhehebe*”, “*ua mori*” Allahut tregon këputjen e dy shpresave: Shpresën e ndreqjes së (situatës së tyre) dhe shpresën e mëshirës Hyjnore. Sepse ajo nënkupton se shuplaka qiellore nuk lejon që gjendja e tyre tē drejtohet dhe sugeron se ajo eshtë ndëshkim pēr tē metat njerëzore. Kjo eshtë arsyja pse Allahu xh.sh. i ndëshkoi ata. Kështu ajo pas tē cilës ata ishin kapur, u shkëput e u nda prej tyre kur shkaqet u pezulluan, dhe kjo ishte shpresa e mëshirës. Sepse e vërteta nuk mund tē kerkohet nga e vërteta me qëllim që ta shfuqizosh atë (tē vërtetë).

Parafjala بِنُورِهِمْ ( *binúrīhim* , “dritën e tyre”) tregon dëshpërimin -e tyre- lidhur me rikthimin (e dritës), sepse atë që e ka marrë Allahu nuk mund tē kerkohet. Sepse ka një ndryshim tē quartë ndërmjet “*dhehebe bihi*” e cila do tē thotë: *ai e pretendoi atë dhe e mori*

ذهب الله بنورهم **ذهب** **بنورهم** “*edhehebehu*” (Forma e IV), e cila do tē thotë, “*ai e largoi atë, e hoqi ose e dërgoi tutje*”, ndërsa “*dhehebe*” (forma e I) do tē thotë: *ai shkoi në rrugën e tij*”. Në dy tē fundit ndodhet mundësia e rikthimit, por në tē parën nuk ndodhet asnje.

بنور **بنور** Në “*nur*”, “*dritën*” eshtë një aluzion i hollë rreth situatës (së hipokritëve) në Urën e Siratit. Prapashtesa përemërore e rasës gjinore

tē pronësisë - **him**, “*e tyre*” e cila tregon posaçërim e përcaktim nënkupton brengën e tyre tē tmerrshme. Sepse një person vuani dhimbje më tē madhe kur vetäm zjarri i tij shuhet ndërsa zjarret e njerëzve tē tjerë ndizen duke bërë dritë tē fortë. Shiko se sa perla tē holla tē elokuencës janë tē Allahut në Kur'an! A nuk e shikon se si tē gjitha pjesët -e fjalisë- janë kthyer drejt qëllimit tē përgjithshëm dua tē them, shqetësimi -i hipokritëve- dhe dëshpërimi eshtë si një pellg në një bashkëderdhje lumenjsh.

وَتَرَكَهُمْ فِي ظُلْمَاتٍ لَا يَبْصُرُونَ **وَتَرَكَهُمْ** “*dhe i la në errësirë, (kështu që) ata nuk mund tē shihnin*”.

Lidhëzja **ve** “*dhe*” tregon se ata i kombinuan -i bashkuan- dy humbjet: Ata u zhveshën nga drita dhe u veshën me errësirë.

پَرَدَرِيمِي **terekë**, “*i la'* në vend tē *ebka*” “*i bëri tē mbeten*” ose tē diçkaje tē ngashme sugeron se ata janë bërë si kufoma tē pajeta dhe si lëvozhga pa thelb, pa bërthamë. Prandaj eshtë e përshtatshme që ata duhet tē braktisen si tē pavlefshëm e tē flakur, tē hedhur.

**فِي** “Fi”, “në” nënkupton se në shikimin e tyre gjithçka ka pushuar së ekzistuari dhe se asgjë nuk mbetet përveç errësirës, e cila duket të jetë mosekzistuese dhe i mbyll e i mbulon ata si varri.

**لَا يَصْرُونَ** “errësirat” tregon se terri i natës dhe retë e errëta u kanë dhënë shkas errësirës së dëshpërimit dhe të frikës në shpirtërat e tyre, dhe se në vendin ku ata gjenden është errësira e shkretimit dhe e shtangies. Për ata edhe koha gjithashtu është e mbushur me errësirën e heshtjes dhe të palëvizshmërisë.

Ajo sugjeron se ata janë të mbuluar e të rrrethuar krejtësisht me errësira të shumëllojshmë. Përdorimi i të pashquarës do të thotë se errësira është e panjohur për ta duke mos e pasë përjetuar kurrë më parë atë, dhe kjo shton ndikimin e saj mbi ta.

**لَا يَصْرُونَ** “(kështu që) ata nuk mund të shihnin”, kjo deklaron qartë fatkeqësitë me të këqija, bazën e fatkeqësive. Sepse personi, i cili nuk mund të shohë, vuan më shumë fatkeqësi, dhe për shkak se atij i mungon shikimi, ai përjeton (në një shkallë më të madhe) edhe më të lehtët e fatkeqësive. Koha e pakryer është përdorur për të piktuar e pëershkruar gjendjen e tyre (me ngjyra të gjalla) në syrin e imagjinatës me qëllim që dëgjuesi ta shohë shtangien e tyre dhe ndërgjegjja e tij të preket gjithashtu. Sa për lënien e foljes pa kundrinor kjo është për të përgjithësuar (kuptimin); ata nuk mund të shohin asgjë që do të ishte e dobishme për ta që ta ruanin atë, dhe që t'i mbronte; dhe ata nuk mund t'i shohin rreziqet që ata të mund t'u shmangeshin; dhe ata nuk mund t'i shohin shokët e tyre që t'u vlente atyre intimiteti -miqësia e ngushtë e tyre. Është sikur secili është vetë dhe i vëtmuar.

**صَمْ بِكُمْ عَمَىٰ فَهُمْ لَا يَرْجِعُونَ** “Ata janë të shurdhier, memecë e të verbër, kështu që ata nuk kthehen (në Rrugën e drejtë)” dhe dëgoje se si ato rrëfehen në njëra-tjetren. Sepse këto katër (frazë) janë një përkufizim i përbashkët (*had-mushterek*) si nga shëmbelltyra ose krahasimi (*mumeth-thil*), dhe nga gjëja e portretizuar -e pëershkruar (*mumeth-thel*). Ato janë ndërmjetësuese midis tyre dhe orientohen drejt

të dyjave. Ato tregojnë rrethanat e të dyja anëve, dhe janë një pasqyrë për të dyja duke të të treguar ty karakteret e tyre.

Ato rezultojnë nga të dyja dhe të tregojnë ty tregimet e atyre të dyjave.

Aspekti që sheh tek krahasimi: Dije se një person i cili është i goditur nga një fatkeqësi e tillë kapet pas shpresës së të qenurit i shpëtar nga të dëgjuarit nga afër zërin e dikujt i cili do të mund ta shpëtonë atë. Por nata është aq e heshtur dhe e pazëshme saqë e shurdhon atë. Ai akoma shpreson që ta bëjë dikë ta dëgjonte, por shurdhësia e natës e bën atë memec. Pastaj ai shpreson të udhëzohet nga të shikuarit e një zjarri apo të një drite, por nata e verbër (që nuk sheh) e bën atë të verbër. Pastaj (ai shpreson) të rikthehet tek fillimi (i udhëtimit të tij) por dera mbyllët kundra tij si dikush që bie në një moçal -baltinë dhe sa më shumë të lëvizë e të mundohet në të përpjetë aq më shumë zhytet në të.

Aspekti që shikon tek ata të pëshkruarit në krahasim: Dije se kur ranë në errësirat e mosbesimit dhe të hipokrizisë, ata mund të shpëtonin prej saj në katër mënyrat e njëpasnjëshme:

**Së Pari:** Ata mund t'i ngrenin kokat e tyre dhe ta dëgjonin të vërtetën dhe t'i kushtonin vëmendje udhëzimit të Kur'anit, por kur hovi (vala, shtyrja) e dëshirës e pengoi zërin e Kur'anit të hynte në veshët e tyre, dhe furia e tyre i mori ata nga veshët duke i tërhequr prapa prej

kësaj rruge, Kur'ani i qorton ata me epitetin  “*Summun*”, “*të shurdhier*”. Kjo tregon se kjo derë është mbyllur dhe sugjeron se veshët e tyre kanë qenë të bllokuar, të zënë.

**Së Dytë:** Ata duhet t'i ulin kokat e tyre dhe të konsultohen me ndërgjegjjet e tyre, dhe të pyesin rrëth të vërtetës dhe rrugës. Por kur kryeneçësia i rrëmbeu gjuhët e tyre dhe urrejtja i nduku dhe i tërhoqi për tek gropë e gjuhëve të tyre, Kur'ani u jep atyre goditje, me fjalën

**بِكُمْ** “*Bukmun*”, “memecë” Kjo tregon se edhe ajo derë gjithashtu është e mbyllur në fytyrat e tyre dhe aludon për dështimin e tyre për të miratuar e mbështetur të vërtetën.

**Së Treti:** Ata duhej tē bënин pērpjekje pēr tē nxjerrē mēsime prej dēshmive nē botēn pērreth tyre, por shkujdesja vendosi dorēn e saj mbi sytē e tyre dhe verbimi i shtirur i uli poshtē kapakēt e syve tē tyre,

prandaj Kur'ani i thérret ata **عَمِي** "Umjun", "tē verbēr" si njē shenjē se ata janē čudħeżuar e shmangur nga rruga e drejtē gjithashtu. Heqja e pjeszēs "ke", "si" tregon se sytē e tyre -dritat e kokēs- sikur janē shkulur.

**Së Katerti:** Ata duhej ta njihnin poshtērinē e gjendjes sē tyre dhe tē ndjeheshin tē neveritur prej saj, tē shprehnin keqardhje, tē pendoheshin dhe tē ktheħeshin, por pēr shkak tē korruptionit, prishjes sē natyrave tē tyre tē shkaktuara prej insistimit dhe ngulmimit tē tyre nē rrugēn e tyre dhe tē dominimit tē epshit dhe shejtanit, dhe pēr shkak se nefset e tyre i bënē kēto neveri tē duken joshēse e tērheqēse pēr ta, Kur'ani tha:

**فَهُمْ لَا يَرْجِعُونَ** "kështu qē ata nu k. kthehen (nē Rrugēn e drejtē)". Kjo ēshtē njē shenjē se e fundit e rrugēve tē tyre ēshtē e mbyllur gjithashtu dhe tregon se meqenēse ranē me vullnetin e tyre nē kētē situatē, ata nuk kanē zgħedhje tē dalin -tē shpētojnē- dhe llapashiten si njē njeri qē ka ngecur nē njē rērē tē lēvizshme.

\* \* \*

## VĒRSETET 21-22

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ \* الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فَرَاشًا وَالسَّمَاءَ بَنَاءً وَانْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الْثُمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَإِنْتُمْ تَعْلَمُونَ

Jà ej-juhe el-nasu Uebudú Rab-beķum el-ledħi kħalekakum ve el-ledħinej min kablükum leal-leķum tet-tekune. El-ledħi xhealle leķum el-erda firħšen ve el-semäe bināen. Ve enzele min el-semäi ma'en fe Akherexfe bihi min el-themerati Rizkan leķum Fela texh'asú li-lähi endäden ve entum ta'elemūne.

O Njerēz! Adħuroni Allahuun, Zotin tuaj, i Cili ju kriji ju dħie ataq qē qenē para jush, qē tē mund tē bēħeni tē pērkushtuar. I Cili e kā bērē tokēn vend pushimi pēr ju dħie qiegħi me kupē si mbulesē duke dērguar qē andej ujē pēr tē prodhuar fruta si furnizim pēr ju. Atēherē pra, mos i vini shokē Allahuut kur ju e dini. [Djeni se nuk kā tē adħuruar dħe krijuet tjetēr pērveç Allahuut]

## PARATHËNIE

Ti duhet ta dish se është adhurimi ai që ngulit doktrinat e besimit (tek besimtarët) duke i bërë ato një gjendje të karakterit të tyre. Sepse në qoftë se çështjet që i përkasin ndërgjegjjes dhe arsyes nuk do të ushqeheshin dhe nuk do të forcoheshin nga adhurimi, i cili përbëhet nga vënia në zbatim e urdhërave të Allahut dhe duke iu shmangur ndalimeve (gjëra e tē ndaluara prej Tij), ato do të mbeteshin të paefektshme dhe të dobëta.

Gjendja e tanishme e botës islame dëshmon për këtë.

Dije gjithashtu se adhurimi është shkaku i lumturisë në këtë botë dhe në tjetrën, dhe është mjeti për të rregulluar jetën këtu dhe atje, dhe është një shkak për arritje e plotësim, qoftë si individ po ashtu dhe si kolektiv. Ai është një lidhje e lartë dhe e respektuar midis robit dhe Krijuesit të tij.

Ndodhen disa arsyet që adhurimi është shkaku i lumturisë dhe i prosperitetit në këtë botë, e cila është një tokë e kultivuar e Ahiretit.

**Së Pari:** Njeriu është krijuar me një natyrë të çuditshme e të hollë duke e dalluar atë prej të gjitha qënieve të gjalla të tjera dhe duke e bërë atë një përjashtim për to. Për arsyet e kësaj natyre janë zgjuar tek ai dëshira të shumëllojshme, prirja për të zgjedhur, dhe prirja për gjërat më të bukura dhe prirja për stolisje (dekorim të bukur) dhe një dëshirë natyrale për të pasur një jetesë dhe një pozitë që i përshtaten humanizmit.

Pastaj për shkak të atyre prirjeve dhe dëshirave të bashkëlindura, njeriut i nevojitet për të siguruar nevojat e tij, lidhur me ushqimin e tij, veshjen dhe strehimin, -banesën- të përgatitet me mjeshtëri për arte, zanate e profesione të shumta, por ai është i paaftë për t'i ushtruar vetë të gjitha këto. Prandaj atij i duhet të përzihet me shokët e tij dhe të bashkëpunojë me ata; dhe atyre të gjithëve u duhet të ndihmojnë njëritjetrin dhe të shkëmbejnë frutet e punës së tyre dhe në saj të këtij bashkëpunimi, do t'i përbushin nevojat e tyre. Por meqenëse Autori i Gjithurtë nuk vendosi limite të bashkëlindura mbi (tre) fuqitë humane

të dëshirave, të zemërimit dhe të intelektit me qëllim që të siguronte progresin e njerëzve nëpërmjet pulsuesit -sustës shtytëse -zembrekut të zgjedhjes- (dëshirës së pjesshme, vullnetit të lirë) -jo si kafshët fuqitë e bashkëlindura të të cilave janë kufizuar- lindën dhe u shkaktuan tirania dhe agresioni. Dhe meqenëse asnjë limit nuk është vendosur mbi to, fuqitë -priren tek- agresioni dhe bashkësia -njerëzore- ka nevojë për drejtësi kur shkëmbejnë frutet e përpjekjes së tyre. Pastaj, për shkak se mendja e çdonjërit është e paaftë për të kapur drejtësinë, racës njerëzore si një tërësi i nevojitet intelekti i përgjithshëm dhe universal -për të vendosur- drejtësinë prej të cilës të mund të përfitojnë të gjithë. Dhe ai intelekt është ligji universal, dhe ai ligj sigurisht është sheriati. Pastaj me qëllim që të ruhet efektshmëria e atij sheriati dhe zbatimi i tij, një legislator është i domosdoshëm, dikush që ta pretendojë, ta promulgojë e ta shpallë atë, një autoritet; dhe ai sigurisht është Profeti a.s.m.

Pastaj me qëllim që ta përjetësojë dominimin e tij të jashtëm e të brendshëm mbi mendjet dhe zemrat -e njerëzve- profetit i duhet të jetë shumë më i lartë si fizikisht, shpirtërisht dhe moralisht, dhe në sjellje dhe në paraqitje, si dhe nga natyra dhe në karakter. Ai gjithashtu ka nevojë për provën dhe fuqinë e lidhjeve të tij me Zotin e të gjithë sundimit, Pronarin e Botës, dhe një provë e tillë janë mrekullitë e tij. Pastaj me qëllim që të sigurojë bindje ndaj urdhërave -të tij- dhe shmangje prej ndalimeve -të tij-, ai është në nevojë të përjetësimit të idësë së madhështisë së Autorit, pronarit të gjithë sundimit, dhe ajo është -e mundur- nëpërmjet manifestimit të doktrinave të besimit. Pastaj me qëllim që ta përjetësojë këtë ide dhe të fiksojë doktrinat e besimit në mënyrë të qëndrueshme në mendjet e tyre, atij i nevojitet një përkujtues i përsëritur vazhdimisht dhe një akt i përsëritur, dhe ai përkujtues nuk është asgjë tjetër përvëç adhurimit.

**Së Dytë:** Qëllimi i adhurimit është t'i kthesh e t'i orientosh mendjet drejt Autorit të Gjithurtë. Dhe ky orientim shkakton bindje e nënshtrim, dhe kjo përfshin -adhuruesit- nën rregullin e përkryer -në univers- dhe i lidh atë me të. Ta ndjekësh këtë rregull të çon në realizimin e misterit të urtësisë, dhe urtësia dëshmohet nga arti i përsosur në faqet e universit.

**Së Treti:** Njeriu i ngjason një centrali -shtylle- në majë të të cilës janë lidhur kabllot elektrikë e telegrafikë, sepse të lidhura tek koka e tij

janë majet e tē gjitha ligjeve tē krijimit; ligjet natyrore shtrihen tek ai, dhe frezet e ligjeve Hyjnore dhe tē parimeve nē univers reflektohen dhe pērqëndrohen mbi tē. Prandaj, njerëzimi duhet t'i plotësojë ato, t'i lidhë, tē aderojë tek ato dhe tē kapet pas tyre -pas bishtave tē tyre- me qëllim që tē ecë e tē lehtësojë rrjedhën e përgjithshme, që tē mos i rrëshqasë këmba, tē mos bie, tē mos dëbohet dhe tē mos shtypet nën rrotat e makinerisë duke u rrotulluar nē nivelet -e botës. Dhe kjo arrihet nëpërmjet adhurimit, i cili përbëhet prej ibaditet që janë: urdhërat dhe duke iushmangur ndalimeve.

**Së Katerti:** Duke iu bindur urdhëresave dhe duke iushmangur ndalesave formohen disa lidhje për një njeri me shumë nivele tē shoqërisë, dhe individi bëhet si specia, sepse shumë prej urdhëresave, veçanërisht ato që prekin shenjat -e islamit- dhe tē mirën dhe interesat e përgjithshme tē ngashme me fijet tek tē cilat janë lidhur nderi -i njerëzve- dhe nëpërmjet tē cilave vihen nē rregull tē drejtat e tyre; po tē mos ishin ato, tē gjitha ato tē drejta dhe detyra do tē griseshin dhe do tē nëpërkëmbeshin.

**Së Pesti:** Njeriu nē sajë tē islamit ka lidhje tē forta me tē gjithë muslimanët e tjerë dhe ndodhen lidhje tē forta midis tyre.

Nëpërmjet doktrinave tē besimit dhe tipareve islame -tē muslimanëve- këto lidhje u japid shkas vëllazërisë së patundur dhe dashurisë së vërtetë atëherë shkelëza e parë përpunimin dhe interesin e shoqërisë eshtë vëllazëria dhe dashuria. Dhe eshtë adhurimi që i bën tē dukshme doktrinat e besimit dhe i bën ato tē efektshme, dhe i rrënjos ato duke i ngulitur fort.

Si eshtë adhurimi shkaku i arritjes personale dhe i plotësisë?:

**Shqyrtoje këtë:** Së bashku me qënien i vogël fizikisht, i dobët dhe i pafuqishëm, dhe duke qenë njëri prej kafshëve, njeriu mban brenda tij një shpirt tē lartë, dhe ka një mundësi tē gjërë, dëshira tē pakufizuara, shpresa tē pafundme, ide tē panumërtë dhe fuqi tē pakufizuara, dhe ai ka një natyrë aq tē çuditshme saqë ai eshtë sikur një indeks i tē gjitha specieve dhe i tē gjitha botërave. Sa për adhurimin, ai e shtrin shpirtin e tij dhe e ngrë lart vlerën e tij; ai u shkakton aftësive tē tij tē zbulohen, dhe tē zhvillohen, duke i lejuar atij tē bëhet i denjë për lumturinë e përjetshme. Adhurimi gjithashtu eshtë një mjet për tē drejtuar e pastruar prirjet e tij, për tē realizuar shpresat e tij dhe për t'i bërë ato tē

frutshme, dhe për tē renditur idetë e tij dhe për t'i vënë ato nē rregull; gjithashtu për t'i frenuar, kontrolluar dhe për t'i kufizuar -tre- fuqitë e tij (tē dëshirave shtazore, tē zemërimit tē tërbuar dhe tē intelektit engjëllor). Adhurimi gjithashtu largon e heq ndryshkun prej gjymtyrëve tē tij, fizike dhe shpirtëre, secila prej tyre kur eshtë transparente -e tejdukshme- eshtë si një dritare për botën e tij private dhe për atë tē llojit njerëzor. Gjithashtu, kur kryhet me ndërgjegjje, me mendje, me zemër dhe me trup, adhurimi e ngrë njeriu tek dinjiteti i tij i përshtatshëm dhe tek plotësia e tij e caktuar. Ai eshtë një lidhje e lartë dhe e hollë dhe një hallkë e shquar dhe e lartësuar ndërmjet robit dhe tē Adhuruarit tē vetëm. Kjo lidhje përbën shkallën më tē skajme tē plotësisë njerëzore. Shpirti i adhurimit eshtë sinqeriteti.

Sinqeriteti nē adhurim eshtë ky, që tē kryhet vetëm për shkak se ai eshtë i urdhëruar, ndonëse ai përmban shembuj tē shumtë urtësie (dhe dobi). Secila prej tyre mund tē jetë një arsy (il-le) për kryerjen e adhurimit, por sinqeriteti bën tē domosdoshëm që arsyja -e vërtetë- për kryerjen e adhurimit tē jetë urdhri. Në qoftë se urtësia apo dobia do tē bëheshin arsyja, adhurimi do tē ishte i shfuqizuar dhe i paqenë; por në qoftë se ajo thjesht e nxit njeriu ta kryejë adhurimin, ai do tē ishte i lejueshëm.

Kur ata tē adresuarit i dëgjojnë fjalët e Kur'anit Kerim يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ “O Njerëz! Adhuroni...”, ata pyesin me anë tē gjuhës së gjendjes: “Përse dhe për çfarë arsyje? Cila eshtë urtësia nē tē? Përse duhet ta kryejmë? Dhe për çfarë? Ti e mësove Urtësinë nē parathënien lart; ndërsa nē lidhje me arsyen “il-le” Kur’ani përgjigjet me provën e Autorit dhe tē Unitetit tē tij me fjalët e Kur'anit Kerim: ...Zotin tuaj i Cili ju krijoi ju...”

Pastaj me vërsetin: “Dhe nëse ju dyshoni për atë që Në i kemi zbritur...”<sup>1</sup> provon profetësinë.

<sup>1</sup> Kur'an, 2:23

## NJË PARATHËNIE

Duke shpjeguar disa pika (duke buruar nga) ky vërset

**Shqyrtoje këtë:** Një provë (*burhan*) është ose në formën e argumentit prej shkakut material pér tek pasoja materiale (*limmi*), ose argumenti prej pasojës tek shkaku (*inni*). Ashtu si Burhani –argumenti “*limmi*” që është si zjarri që është provë pér tymin, po ashtu Burhani “*inni*” është si tymiqë është provë pér zjarrin. Kjo e fundit –Burhani “*inni*” është më e shëndoshë, dhe ai ose bazohet mbi mundësinë (*imkani*), domethënë, argumenti që, meqenëse qëni e mundshme janë të barabarta në lidhje me qëni e mosqënien, duhet të jetë -një Qënie e Domosdoshme- pér ta zgjedhur këtë (*el-murexh-xhish*); ose ajo do të bazohet mbi krijueshmërinë (*huduthi*); domethënë argumenti se meqenëse ndodhet një ndryshim i vazhdueshëm dhe një ripërtëritje në qëni, duhet të jetë Një pér t'u dhënë atyre ekzistencë (*el-Múxhid*). Secila nga provat e larta është pér sa ka të bëjë ose me esencat e gjërave ose me atributet e tyre, dhe lidhur ose me dhëni e ekzistencës ose me vazhdimin e saj. Dhe të gjitha ato janë ose provë se gjërave u jepet ekzistanca prej asgjësë (*delil iħtirajj*) ose prova e provanisë -urtësisë- Hyjnore (*delilun ina'jetijun*). Vërseti i tanishëm aludon pér këto lloje provash. E përfshirë këtu është -vetëm- një përbledhje e tyre, sepse ne i kemi shpjeguar ato në mënyrë të hollësishme në një libër<sup>2</sup> tjetër.

Prova e provanisë Hyjnore (*delilul inajeti*) është prova e Autorit që tregohet nga ky vërset. Sepse rregulli është një fije -fill- tek i cili janë lidhur të gjitha dobitë dhe shembujt e urtësisë. Të gjitha vërsetet e Kur'anit që numërojnë dobitë e gjërave dhe përmendin qëllimet e tyre janë “*pēlhurendësja*” -tezgjahistja- e kësaj prove dhe janë aty ku ky argument manifestohet.

Sepse ashtu si rregulli, të cilit të gjithë shembujt e urtësisë dhe dobitë i përbahen, provon ekzistencën e Rregulatorit, urdhëruesit; po ashtu ai demonstron qëllimin e Autorit dhe Urtësinë e Tij, dhe largon

<sup>2</sup> Said Nursi, Muhakemat 107.

iluzionet dhe mashtrimet e rastësisë së verbër dhe të koincidencës së verbër.

Tani shiko! Në qoftë se ti nuk mund ta rrëthosh këtë rregull të lartë dhe të stolisur me faqet e latuara të urtësisë, me shikimin tënd, dhe je i paaftë pér ta kuptuar nëpërmjet arsyetimit induktiv, atëherë shiko nëpërmjet syve kureshtarë të shkencave -të cilat janë shqisat e species tënde dhe të cilat janë formuar nëpërmjet takimit të mendjeve dhe lidhjes së ideve, dhe janë si idetë e racës njerëzore -sepse ti do të shohësh një rregull që i trullos mendjet. Ti gjithashtu do të njoħesh se secila nga shkencat fizike zbulon nëpërmjet universalitetit të parimeve të saj, rregullin dhe harmoninë, që nuk mund të mendohen më të plota se ato. Sepse ndodhet një shkencë pér -të studiar- çdo fushë “*neu*” të universit, ose do të jetë (domethënë, secila mund të mbështesë një shkencë. (Sepse çdo lloj prej qënieve të universit ose do të formohet në të një shkencë ose pranon që të formohet).

Shkencat përbëhen nga parime universale, dhe ky universalitet demonstron bukurinë dhe lartësinë e rregullit. Sepse nuk mund të ketë universalitet në ndonjë gjë pa rregull. Pér shembull, a nuk e shikon ti se në qoftë se ne themi: Të gjithë dijetarët fetarë veshin çallma të bardha”, se kjo konfirmon universalitetin, sepse ndodhet rregull midis atij grupei “*neu?*” Nga kjo del me përfundimin se nëpërmjet universalitetit të parimeve të tyre, të gjitha shkencat demonstrojnë nëpërmjet arsyetimit deduktiv një rregull të plotë, të përsosur e gjithëpërfshirës; secila është një provë e ndritshme duke treguar dobitë dhe frutat e varur në tuftët prej hallkave të zinxhirëve të qënieve, duke treguar gjithashtu shembujt e urtësisë dhe avantazhet e fshehur në gjendjet e tyre të ndryshme. Shkencat ngrejnë flamarin e Unitetit Hyjnor dhe dëshmojnë qëllimin dhe urtësinë e Autorit. Secila prej tyre është një yll vezullues duke shpuar errësirën dhe duke dëbuar e zmbrapsur shejtanët e dyshimeve dhe të iluzioneve.

Në qoftë se do të doje, tani mos merr parasysh -rregullin- e përgjithshëm dhe merr në konsideratë shembullin vijues: një organizëm mikroskopik aq i vogël saqë nuk shihet me sy të zhveshur -pa dylbi, pa mjete-, forma e tij e vogël përfshin një makineri të hollë e të mrekullueshme Hyjnore. Në mënyrë të domosdoshme dhe të vetëkuptueshme, kjo makineri, e cila është e mundshme si në esencën e saj po ashtu edhe në atributet dhe në gjendjet, nuk erdhi në ekzistencë

nga vetvetja dhe pa një shkak. Ashtu si pjatat e disa peshoreve, qëniet e mundshme janë tē barabarta lidhur si me ekzistencën e tyre dhe me mosekzistencën; nē qoftë se njëra peshon më shumë, ajo do tē mbetej nē mosekzistencë. Prandaj, ashtu siç pajtohen nē mendim tē gjithë njerëzit e arsyeshëm, duhet tē jetë një shkak pér tē bërë ekzistencën.

Ēshtë e pamundur që ky duhej tē ishte një shkak natyral. Sepse rregulli i hollë dhe i shkëlqyer i -makinerisë- bën tē domosdoshme njojje tē pafundme dhe inteligjencë tē plotë. Dhe ato tē dyja nuk mund tē përfytyrohen nē ato shkaqe natyrore, rreth tē cilave -Natyralistët-mashtrojnë Vetveten. Shkaqet janë tē thjeshta, tē pakta dhe tē pajeta, dhe nuk mund ta specifikojnë rrjedhën e tyre dhe as tē kufizojnë lëvizjet e tyre, dhe janë ngurruese meqë janë midis mijëra mundësive, dhe disa prej tē cilave nuk kanë parësi -epërsi. Atëherë si vallë -një shkak- do tē ndiqte një rrjedhë specifike dhe tē ecte nē një rrugë tē përcaktuar, dhe si ai do tē mund tē zgjidhje disa aspekte tē mundësive që i prodhon kjo makineri e mrekullueshme e mirërregulluar, hollësitë e shembuje tē urtësisë nē tē cilën i lënë mendjet tē habitura? Ti vetëm do tē mund tē bindje veten tēnde dhe do tē ndiheshe i lumtur tek ajo nē qoftë se do t'ia atribuoje çdo grimceje inteligjencën e Platonit<sup>3</sup> dhe urtësinë e Galenit<sup>4</sup> dhe tē besoje se tē gjitha këto grimca komunikuan me njëra-tjetren. Dhe kjo ēshtë një sofistikë dhe kotësi prej tē cilës do tē turpëroheshin edhe vetë sofistët.

Megjithëse forcat e tērheqjes dhe tē shtytjes formojnë bazat e lëndës -çështjes- fizike nē atomet më tē vegjël tē pandashëm, kjo shfaqet tē jetë kombinimi -bashkimi- i tē kundërtave. Po, ligji i tērheqjes dhe i shtytjes dhe tē tjerët janë emrat e ligjeve tē Praktikës Hyjnore dhe tē Sheriatit tē Tij xh.sh., sheriat i cili quhet natyrë (*Esh-sheriatul el-Fitrij-jeh*). Lige tē tilla janë tē pranueshme me kusht që ato tē mos pushojnë së qëni parime dhe tē mos kalojnë e tē bëhen natyrë -tē mos kalojnë nga parimi nē natyrë-; dhe tē ekzistojnë vetëm nē mendje dhe jo t'u përshkruhet ekzistencë e jashtme, dhe tē mos pushojnë së qëni vetëm teorike dhe tē mos bëhen reale -tē mos

<sup>3</sup> Platon (428-348 para krishtit) filozofi i madh athinas dhe nxënësi i Sokratit dhe mësuesi i Aristotelit. Vepra më e famshme e tij ishte "Republika".

123 Galen, mjek grek dhe filozof i shekullit tē dytë para krishtit, i cili pér shekuj ishte autoriteti më i lartë nē mjekësi

transformohen nga teorikja nē reale-, dhe tē mos pushojnë së qëni tē shikuara si mjete, dhe tē mos konsiderohen tē efektshme -tē mos konsiderohen prej tē qënit mjete nē tē qënit tē efektshme.

Tani, nē qoftë se e ke kuptuar këtë shembull -tē organizmit mikroskopik- dhe ti e ke parë shtrirjen e tij pavarësisht masës së tij pambarimisht tē vogël dhe gjërësisë së tij pavarësisht ngushtësisë, ngrije kokën tēnde dhe vështro universin. Ti do tē shohësh qartësinë e provës së provanisë Hyjnore (*delil-el-inajeh*) dhe se ajo ēshtë aq e qartë dhe e dukshme sa universi. Të gjithë vërsetet e Kur'anit që numërojnë mirësitë e gjërave dhe që kujtojnë dobitë e tyre manifestojnë këtë provë. Kur Kur'ani urdhëron mendimin reflektiv, ai përgjithësisht e drejton atë tē cilit i adresohet tek metoda e këtij arsyetimi (deduktiv) "istidlal":

"...Kthe pra shikimin tēnd përsëri: "A mund tē shohësh ndonjë tē çarë?"<sup>5</sup> Dhe ky vërset, sa qartë e tregon këtë provë:

الذى جعل لكم الأرض فراغاً والسماء بناةً وأنزل من السماء ماءً  
فأخرج به من التمرات رزقاً لكم

"i Cili e ka bërë tokën vend pushimi pér ju dhe qießin me këupe si mbulesë duke dërguar që andej ujë pér tē prodhuar fruta si furnizim pér ju"<sup>6</sup>

Provat se gjërave u jepet ekzistenza nga asgjëja (*el-delail el-ihtira'i*), pér tē cilën aludohej nga vërseti *الذى خلقكم والذين من قبلكم el-ledhí khalekakum ve el-ledhíne min kablikum* i Cili ju krijoj ju dhe ata që genë para jush<sup>7</sup>, ēshtë kjo:

Allahu xh.sh. i dha çdo specieje dhe tē gjithë anëtarëve tē secilës një qënie tē veçantë e cila ēshtë burimi i veprave tē saja tē veçanta dhe burimi i plotësimëve tē saj tē përshtatshme. Sepse meqenëse tē gjitha speciet -dhe botërat e qënieve- janë tē mundshme ashtu siç janë zinxhirët që nuk mbarojnë kurrë tē shkaqeve, asnjëra -specie- nuk mund tē kthehet prapa -nuk daton- nē varg tē pandërprerë, -në një zinxhir tē pathyer- deri nē paspërjetësi. Gjithashtu, meqenëse ndodhet

<sup>5</sup> Kur'an, 67: 3

<sup>6</sup> Kur'an, 2 :22

një ndryshim i vazhdueshëm në botë, ajo provon krijueshmërinë -e botës-, ndonjëherë nëpërmjet vëzhgimit dhe ndonjëherë nëpërmjet domosdoshmërisë racionale të arsyesheme.

Gjithashtu është demonstruar nga biologja dhe nga botanika se ndodhen më shumë se dyqind mijë lloje speciesh dhe se secila ka një paraardhës dhe stërgjysh. Prandaj mundësia dhe krijueshmëria provojnë se në mënyrë të domosdoshme këto paraardhës dhe stërgjyshë u shfaqën pa ndërmjetësi prej dorës së fuqisë Hyjnore. Për më tepër -shkaqet- nuk mund të imagjinohen -në krijimin e parë- siç imagjinohen ato në zinxhirët e specieve. Për më tepër, iluzioni - mashtrimi- i ndarjes dhe i copëtimit të disa specieve prej të tjerave është i anuluar, invalid. Sepse -meqenëse ose pasardhësit janë shterpë (joprodhues)- ose linja bëhet e shuar, e zhdukur) një specie ndërmjetësuese në pjesën më të madhe, tek e shumta, nuk bëhet fillimi i një zinxhiri të ri nëpërmjet riprodhimit. Prandaj është më e ngjashmja dhe më e përshtatshmja se meqenëse origjinat dhe fillimet e njerëzisë dhe të botës shtazore janë kështu, domethënë ashtu siç këputet zinxhiri i fillimit tek një baba, po ashtu edhe fundi i zinxhirit do të këputet e pëfundojë tek një fëmi, atëherë edhe pjesët -anëtarët- e njëpasnjëshëm gjithashtu do të jenë kështu. Si do të mund të imagjinohej se shkaqet e thjeshta dhe të pajeta natyrale, të cilat janë pa vetëdije -inteligjencë- dhe pa dëshirë, të ishin të afta për t'i sjellë në ekzistencë këto zinxhirë - të qënieve- të cilat habisin mendjet dhe për t'i krijuar (*ikhtira*) qëniet individuale, çdonjëra prej tyre është një mrekulli e artit dhe mrekullia e fuqisë Hyjnore? Kështu, të gjithë individët -qëni- me zinxhirët e tyre dëshmojnë në mënyrë vendimtare nëpërmjet gjuhëve të krijueshmërisë dhe mundësisë për ekzistencën e domosdoshme të Krijuesit të tyre, qoftë Ai i lartësuar!

• *Në qoftë se ti do të pyesje:* Përse, kur ndodhet kjo dëshmi vendimtare për ekzistencën e domosdoshme të Krijuesit, besojnë njerëzit në -ide- të tillë të gabuara e të çudhëzuara si parapërjetësia e materies dhe lëvizja e saj?

*Ty do të të thuhej:* Në qoftë se një person do ta vështronë diçka në mënyrë indirekte e sipërfaqësore, ai do të mund ta shikonte të pamundurën të jetë e mundur, ashtu si një njeri i moshuar, i cili duke kërkuar hënën e re të festës së Bajramit (*i"d*) e pa qimen e bardhë duke rënë mbi qerpiqun e syrit të tij -dhe e mendoi dhe tha menjëherë: e

pashë hënën. Sepse në sajë të esencës së tij të lartë, natyrës së tij të nderuar, njeriu e ndjek të vërtetën dhe të drejtën. Dhe në qoftë se gënjeshtra dhe çudhëzimi bien në dorën e tij pa zgjedhje, në mënyrë të pavullnetshme ndësa ai vetë përpiqet të gjejtë vërtetën por e shikon atë në mënyrë sipërfaqësore dhe me një shikim indirekt, atëherë ai detyrohet ta pranojë atë gradualisht. Për shkak se kur ai injoron rregullin e universit, i cili është filli (tek i cili janë lidhur) të gjithë shembujt e urtësisë, dhe dështon për të parë kundërshtinë, antagonizmin -e lëvizjes (së grimcave si burimin e materies) dhe të paspërjetësise së materies, do të bëhej e mundur në shikimin e tij indirekt që t'u përshkruante qëndisjet e mrekullueshme dhe artin e mahnitshëm rastësisë së verbër dhe koincidencës që nuk sheh duke rënë kështu në çudhëzim. Ashtu siç tha Xhisri<sup>7</sup>, në qoftë se një person i cili hyn në një pallat të mbushur me vepra të zbukuruara të civilizimit nuk e shikon pronarin e tij -pallatit- dhe do të besonte se ai nuk ka asnjë, atëherë do të detyrohej t'ia atribuonte ndërtimin dhe zbukurimet e tij rastësisë, koincidencës dhe ligjeve të seleksionimit natyror.

Për më tepër, kur ai injoron dëshminë për një dëshirë të plotë, për një njobje gjithëpërfshirëse dhe për një fuqi të plotë të të gjithë shembuje të urtësisë, të dobive dhe përfitimeve në rregullin e botës, dhe është i pavëmendshëm ndaj tyre, do t'i shfaqej e mundshme për të meqë ai i njeh ato me një shikim dytësor, të dorës së dytë ai u detyrua t'uapë efektin real të shkaqeve të pajeta. Tani si është ky? A shpërfill, lë mënjanë hollësitet e artit të të Vetmit xh.sh. dhe studion më të dukshmen e veprave të quajtur "Natyre" e cila është manifestimi i dukshëm dhe i lartë (*irtisam*) dhe reflektimi (i gjërave) -me kusht që të grisësh perden e familjaritetit, të zakonshmes-: si mund ta pranojë arsyja jote se veçoritë e fytyrës së pasqyrës mund të përbëjnë një shkak të efektshëm e të përshtatshëm -përcjellës- për të zbuluar faqen e qiejve dhe për të têrhequr -e reflektuar- në xhamin e saj imazhin e pasqyrës me lartësinë e saj dhe të skalitur me yje? Dhe si mund të bindet arsyja jote që në realitet gjëja imagjinare e quajtur gravitet të jetë një shkak i efektshëm duke i mbajtur tokën dhe yjet me lëvizjet dhe rrrotullimet e tyre në një rregull të qëndrueshëm në zbrastirë? Ruajna Zot! Këto mund të jenë vetëm se shkaqe e kushte por jo shkaku ndikues.

<sup>7</sup> Husejn Ibn Muhammed b. Mustafa el-Xisr.b Trablus (Syria) (1261-1327). Vepra e tij më e famshme u përkthye në turqisht nën titullin "Risale-i Hamidiye"

**Shkurtazi:** Në qoftë se një person e sheh gjënë e kotë të pamundur me një shikim sipërfaqësor dhe dytësor dhe nuk e gjen shkakun e vërtetë, ai do të mund ta gjykonte të jetë e mundshme dhe e vlefshme. Por në qoftë se ai e shikon një gjë të tillë qëllimisht dhe përveteten, dhe e studion vetë atë me cilësinë e kërkuesit, ai nuk mund të pranonte diçka prej atyre çështjeve me të cilat ata gumëzhijnë në filozofinë natyrore, veçse ai është aq idiot saqë i supozon të gjitha grimcat e vockëla të posdonin vetëdijen -inteligjencën- e filozofëve dhe urtësinë e politikanëve!

- *Në qoftë se ti do të pyesje:* Cila është natyra, dhe ligjet dhe forcat rreth të cilave ata pëshpëritin me krenari, dhe me të cilat përpiken të ngushëllojnë vetet e tyre?

*Ty do të tē thuhej:* Natyra është një skicë -model- dhe jo burimi; ajo është presë tipografike dhe jo tipografi; është një kod ligjesh, dhe jo një fuqi pasi forca është vetëm tek fuqia Hyjnore; është sheriati Hyjnor i krijimit që imponon një rregull midis akteve të gjymtyrëve të trupit të Botës së Dukshme. Ashtu si sheriati që është produkti dhe përbledhja e rregullave që sundojnë aktet e vullnetshme, dhe sistemi i qeverisjes është përbledhja e parimeve politike; dhe ashtu si sheriati dhe rregulli i shtetit që janë dy çështje teorike që ekzistojnë vetëm në mendje; po ashtu natyra është një çështje teorike që është përbledhja e praktikave të jashtme të Allahut në krijim. Iluzioni -mashtrimi- i ekzistencës së saj të jashtme është si përfytyrimi i një -njeriu- të egër i cili, kur shikon një divizion ushtarë duke kryer një stërvitje të disiplinuar, (përfytyron) se ushtarët janë lidhur së bashku (me spango që kanë) ekzistencë të jashtme.

Atëherë, janë ata njerëz me vetëdije egërsirash që imagjinojnë se, për shkak të vazhdimësisë së saj natyra ka një ekzistencë të jashtme të efektshme.

**Shkurtazi:** Natyra është arti i Allahut xh.sh. dhe kodi i ligjeve të Tij kreative. Ligjet e saj janë nenet e kodit dhe forcat e saj janë dekretet e atyre neneve.

Tani sa për provën e Unitetit Hyjnor (*delil el-teuhid*), të treguar nga <sup>اعبدوا</sup> *Uëbusdú “Adhuroni”*, Domethënë “shpallni Unitetin e Allahut”. Sipas komentit të Ibn Abasit, është siç vijon:

Kur’ani i shpjegimit të mrekullueshëm nuk ka lënë asgjë prej provave të tij të Unitetit Hyjnor. Dëshmia e mjaftueshme është prova -e quajtur- “*Burhan el-temanu*” e përfshirë në vërsetin

لوَكَانَ فِيهِمَا الْهُدَىٰ إِلَّا لَفَسَدَتَا <sup>١</sup> “Po të kishte pasur në to (në qiej dhe në tokë) perëndi të tjera përvëç Allahut, atëherë padyshim që të dyja (qiejt dhe tokë) do të ishin shkatërruar<sup>8</sup>; ajo është një pishtar -duke provuar- se pavarësia është një esencë e domosdoshme dhe një cilësi e bashkëlindur e Hyjnise. Ky vërset gjithashtu -aludon- për një provë të hollë të unitetit Hyjnor e cila -tregohet nga sa vijon:

Kooperimi i qiejve dhe i tokës dhe lidhjet e tyre në prodhimin e produkteve -për të mbështetur- mjetet e jetesës së njerëzimit dhe të kafshëve; ngashmëria e veprave në botë, dhe të gjitha anët e saj duke përqafuar njëra-tjetër, dhe duke e marrë për dore njëra-tjetër me qëllim që të plotësojnë rregullin; përgjigjja e ndërsjellë e pjesëve të ndryshme të saj ndaj nevojave të njëra-tjetrës; shikimi i të gjithave tek një pikë e vetme; dhe të gjitha duke qenë në lëvizje të rregullatori në boshtin e një rregulli të vetëm. E gjitha kjo nënkupton, madje deklaron qartë se Autori i kësaj makinerie të vetme është *Një*, dhe reciton për të gjithë.

وَفِي كُلِّ شَيْءٍ لَهُ آيَةٌ تَدْلُّ عَلَىٰ إِنَّهُ وَاحِدٌ

*Në çdo gjë është një shenjë duke treguar se Ai është Një<sup>9</sup>*

**Tani shqyrtoje këtë:** Autori Krijues ashtu siç është “Ekzistuesi i Domosdoshëm dhe Një, po ashtu Ai cilësohet nga të gjitha atributet e plotësimit.

Sepse çfarëdo gjurmësh plotësie që gjenden në artifikat, ato kanë ardhur prej hijes së manifestimit të Plotësisë së Autorit të atij artifakti. Kështu domosdoshmërisht, bukuria, plotësia dhe mirësia e Autorit xh.sh. duhet të janë të një shkalle pafundësish të larta se sa e gjithë bukuria, plotësia dhe mirësia të gjendura në univers. Sepse mirëbërësia “*Ihsan*” vjen nga Mirëbërësi “*Muhsin*” dhe është dëshmi për të; dhe dhënia ekzistencë (*i'xhad*) provon ekzistencën (*Vuxhud*) të Dhënësit të

<sup>8</sup> Kur'an, 21:22

<sup>9</sup> Ebu Atahija mbi Divanin e tij ia atribuon këto vargje Imam Aliut.

Ekzistencës (*el Muxhid*), dhe bërja e domosdoshme provon ekzistencën e Njërit i Cili bën të domosdoshëm, dhe të bërit bukur tregon bukurinë e Njërit i Cili bën të bukurën. Për më tepër, Autori i Gjithëlavdishëm është i përjashtuar prej të gjitha defekteve e mangësive, sepse defektet burojnë nga paaftësia esenciale e qënieve natyrale, por i Vetmi më i lartë është i lirë prej lëndësisë -i zhveshur prej lëndës. Gjithashtu Ai Autori i Parapërjetshëm është i lirë prej atributave të cilat domosdoshmërisht burojnë prej esencave të gjëra dhe të qënieve të mundshme të ndryshme.

Lavdia i takon Atij! Ai është Ekzistuesi i Vetëm i domosdoshëm, asgjë nuk i përngjason Atij xh.sh..

Ai aludon për këto dy të vërteta me fjalët e Tij:  
**فَلَا تَجْعَلُوا لِلّهِ أَنْدَادًا**  
*“Fela texhi’alú li-lahi endáden”*, “Atéheré pra, mos i vini shokë Allahu”

Tani sa për provën e mundësisë (*el-dela’il el imkan*), për të cilën aludohet nga vërseti, **وَاللّهُ الْغَنِيُّ وَأَنْتُمُ الْفَقَرَاءُ** “Sepse Allahu është i pasuri (*absolut*), i Vetëmjaftueshi, ndërsa ju (o njerëz) jeni të varfér, keni nevojë (për Të).<sup>10</sup>

Ju e shikoni se përsa ka të bëjë me esencën e atomit, dhe me të gjitha atributet e tij, dhe me secilën prej gjendjeve të tij dhe të gjitha faqet e tij -çdo atom i veçantë- në univers -ekziston- ngurrues dhe në mëdyshje midis mundësive të pafundme. Pastaj papritmas vjen në jetë, ngrihet në këmbë dhe ndjek një rrugë të përcaktuar; ai vishet në atributë të veçantë dhe merr një gjendje të rregullt dhe hipën në një ligj të drejtë, të duhur; pastaj kthehet, orientohet tek një destinacion i fiksuar; pastaj fiton rezultate të urta dhe dobi që do të mund të fitoheshin veçse në atë rrugë të përcaktuar. A nuk shpall ai me gjuhën e tij të veçantë dhe me lëvizjet e tij të veçanta qëllimin e Autorit të tij dhe urtësinë e tij, duke i shprehur ato qartë?

Ashtu si çdo grimcë më vete që është një provë, për ekzistencën e Krijuesit, po ashtu dëshmia e saj shumëfishohet meqë ajo bëhet një pjesë prej pjesëve përbërëse të ndërfutura gjithmon duke u ngjitur brenda njëra-tjetrës. Sepse ajo ka një pozitë në çdo përbërje, dhe ajo ka

<sup>10</sup> Kur'an, 47:38

lidhje në çdo pozitë, dhe ka funksione që rezultojnë prej secilës prej lidhjeve, dhe secila prej funksioneve të saj mban frutin e dobive dhe të përfshireve. Në çdo shkallë ajo reciton me gjuhën e saj provat e ekzistencës së domosdoshme të Autorit të saj. Ajo i ngjason një ushtari, (i cili ka lidhje dhe detyra) në togën -skuadrën- e tij, regjimentin, divizionin dhe kështu me radhë.

...

Tani ne fillojmë me pozicionimin dhe renditjen e fjalëve (*nadhım*) të vërsitit të lartëpërmendur për sa ka të bëjë (*süparı*) me lidhjen (*nadhım*) të vërsitit si një têrësi me atë që e parapriu, (*südyti*) me lidhjet e disa prej frazave të tij, dhe (*sütreti*) me lidhjet midis pjesëve të frazave.

**Vendosja -pozicionimi- i këtij vërseti dhe lidhja e tij me atë që e parapriu:**

Pasi shpjegoi kategoritë e qënieve humane, besimtarët e devotshëm të ngarkuar me adhurim, mosbesimtarët kryeneçë, dhe hipokritët e lëkundur, Kur’ani tani u adresohet të gjithë atyre me fjalët **بِأَيْمَانِ النَّاسِ اعْبُدُوا** “O ju njerëz! Adhuroni...!” Kjo e bën këtë resultatin e asaj që e parapriu, në të njëjtën mënyrë si një ndërtesë që ndjek planin - projektin, dhe si urdhëresat e ndalesat në lidhje me aktet që burojnë nga ligjet (që ekzistojnë si) njohje, dhe dekreti Hyjnor (*el-kada*) që ekzekutohet në përputhje me kaderin Hyjnor (*el-kader*), dhe kompozimi dhe krijimi që vijojnë pas tregimit dhe citimit<sup>11</sup>.

Sepse kur (Kur’ani) i përmend tre -grupet- e ndryshëm dhe pëershkuar karakteristikat dhe rezultatet -pasojat- e tyre, ai shton rrugën për subjektin -kryesor- dhe për të paralajmëruar dëgjuesin. Pastaj ai u adresohet (atyre) drejtpërdrejtë. Ky shikim -dua të them referimi i tij ndaj tyre së pari në vetën e tretë, pastaj këtu duke i adresuar atyre direkt është një -figurë- përgjithësisht e pranueshme për shkencën letrare të “El-bejan”. Ajo është kështu: kur ose virthitet ose veset e një personi përmenden gradualisht, pak e nga pak, ajo i zgjon dhe i nxit -dëgjuesit- dhe shton -tek ata- ndjenjat ose të admirimit ose

<sup>11</sup> Këto të fundit janë terma letrarë, duke iu referuar llojeve të ndryshme të fjalive.

të neverisë. Këto gradualisht bëhen më të forta derisa t'i detyrojnë - dëguesit- të flasin vetë me personin që i intereson. Këtu, ashtu siç kërkohet nga konteksti (*mekam*) dhe për t'i kënaqur -e ngopur- ato dëshira të dëguesve, folësi (*el-mutekel-lim -Kur'an*) e sjell atë person dhe e tërheq për tek prania e tyre dhe i drejtobet atij duke iu adresuar drejtpërdrejtë.

Kjo përmban një pikë të veçantë për këtë kontekst, e cila është për të lehtësuar peshat e obligimit -të adhurimit- me kënaqësinë e të qënët i adresuar drejtpërdrejtë. Për më tepër, ajo tregon se në adhurim nuk ndodhen ndërmjetësues midis robit dhe Krijuesit të Tij.

**يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا مَا أَنْتُمْ بِهِ مُكْرِنُونَ**  
Sa për lidhjet midis frazave: Fraza “O ju njerëz! Adhuroni...” u adresohet të gjithë njerëzve të çdo klase të të tre grupeve, të së shkuarës, të tanishmes dhe të ardhmes, domethënë:

O besimtarë të plotë, adhuroni në mënyrë të sigurtë, të qëndrueshme dhe të vazhdueshme! O -adhurues- të mesëm, përpinquni ta shtonи adhurimin tuaj! O mosbesimtarë, kryejeni adhurimin me kushtin e tij prej besimit dhe vërtetimit të unitetit Hyjnor! Dhe o hipokritë, adhuroni me sinqueritet të vërtetë! Kështu, fjala, “*adhurim*” këtu është si një fjalë e përbashkët duke shprehur shumë kuptime. Prandaj shqyrtoje këtë!

**نَجِيَ الْمُشْرِكُونَ**  
Një shënim i shkurtër: Në “*Rab-bekum*”, “*Zotin tuaj*” është një aluzion i hollë për mundësinë e esencës (së atyre të adresuarve); dhe në

**الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ**  
“*xheale lekum el-erda firashen*”, “*I Cili e ka bëre tokën vend pushimi për ju*” është një shenjë duke treguar mundësinë e atributeve të tyre, dhe në **el-ledhi khalekakum** ve **el-ledhine min kablikum** “*i Cili ju krijoi ju dhe ata që qenë para jush*” aludon për krijueshmërinë e esencave të tyre dhe të atributeve. Gjithashtu vërsetet vijuese japid dëshmi të qarta se esencat e atyre të

adresuarve janë të mundshme: “*Por Allahu është i pasuri absolut -i Vetëmajtueshi, ndërsa ju (njerëz) jeni të varfëri (jeni në nevojë për Të)*<sup>12</sup>;

*Dhe se te Zoti yt (Allahu) është fundi (kthimi i çdo gjëje).*

*Me të vërtetë që (këto zotra fallo) janë armiqëtë e mi, përvèç Zotit të të gjitha botëve.*<sup>13</sup>

“*Thuaj: Allahu (e zbriti atë), pastaj lëri të luajnë në bisedat e cikërrimat e tyre të kota*”.<sup>14</sup>

*“Ikni pra shpejt drejt Allahut”*<sup>15</sup>

“*Nuk ka dyshim se në përkujtimin e Allahut vërtet që zemrat gjajnë prehje, qetësi*”<sup>16</sup>.

Tani mendo për shembuj të mëtejshëm në të njëjtën mënyrë!

**الَّذِي خَلَقَكُمْ**  
Sa për frazën “*el-ledhi khalekakum*”, “*i Cili ju krijoi ju*”: Dije se kur Allahu xh.sh. urdhëron adhurimin i cili bën të domosdoshëm tre gjëra: *së pari*, ekzistencën e të Adhuruarit të Vetëm (*Ma'bud*); *së dyti*, Unitetin e Tij; dhe *së treti*, përshtatshmërinë e Tij për t'u adhuruar, Ai u përgjigjet këtyre tre pyetjeve të nënkuptuara duke treguar tre dëshmi të tyre.

Dëshmitë e ekzistencës së Tij, të cilat janë dy llojesh: ato në botën e jashtme (*afaki*), dhe ato në veten e njeriut (*enfusi*).

*E fundit gjithashtu është dy llojesh: dëshmitë në veten (neffi) dhe ato që u përkasin origjinave (usuli). Domethënë ndodhen tre lloj dëshmish për ekzistencën e Krijuesit xh.sh.: Afakij, nefsjij dhe usulij. Kur'an aludon për dëshmitë në veten (neffi), të cilat janë më të afërtat*

**الَّذِي خَلَقَكُمْ**  
“*el-ledhi khalekakum*”, “*i Cili ju*

<sup>12</sup> Kur'an, 47:38

<sup>13</sup> Kur'an, 26:77

<sup>14</sup> Kur'an, 6:91

<sup>15</sup> Kur'an, 51:50

<sup>16</sup> Kur'an, 13:28

*krijoi ju*”, dhe pér ato që u pérkasin origjinave me **وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ** “...ve el-ledhíne min qablíkum”, “dhe ata që qenë para jush”.

Sa pér pozicionimin **لَعَلَّكُمْ تَفَقَّوْنَ**, “*leal-lekum tet-tekune*”, “që tē mund tē bëheni tē pérkushtuar” dije se meqenëse Kur’ani e lidh adhurimin me krijjimin -e njerëzve- dhe me atë tē paraardhësve tē tyre, ai bën tē domosdoshëm dy pika:

**E Para:** (Qeniet humane) duke u krijuar me një prirje -tē natyrshme- pér adhurim dhe pasja e tyre aftësinë pér tē qenë tē vetëdijshëm dhe pér ta pasë frikë Allahun (*el-takva*), saqë kushdo që e vështron një prirje -aftësi- tē tillë do ta pranonte adhurimin prej tyre. Ashtu si dikush që sheh kthetrat -e një kafshe- që kupton se ato janë pér tē grisur ose pér tē kapur gjëra.

**E Dyta:** Se qëllimi i krijimit tē tyre, dhe funksioni me tē cilin ata janë ngarkuar dhe plotësia drejt tē cilës ata janë orientuar, është frika ndaj Allahut -takvaja. Ky është adhurimi më i plotë dhe më i përkryer.

Domethënë, **لَعَلَّكُمْ تَفَقَّوْنَ** “*leal-lekum tet-tekune*”, “që tē mund tē bëheni tē pérkushtuar”, qëllimi i krijimit tuaj, dhe plotësimi juaj dhe ajo pér tē cilën natyra juaj e bashkëlindur është bërë, është vetëdija pér Allahun dhe frika ndaj Tij. Me fjalë tē tjera, këto aftësi tē futura tek njeriu nënkuptojnë se synimi pér krijjimin e njeriut është që ta nxjerrë devpcionin nga aftësia në vepr.

Sa pér frazën **جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فَرَاشًا** *xheale lekum el-erafa firashen*, “*I Cili e ka bërë tokën vend pushimi pér ju*”; kjo tregon dëshmitë më tē afërtë tē ekzistencës së Tij xh.sh. tē dhëna nga bota e jashtme. Kjo gjithashtu është një kundërshtim aludues ndaj efektshmërisë së vërtetë tē shkaqeve, gjë e cila është burimi i një lloji shirku, ortakërie pér Allahun xh.sh.; domethënë, tē atribuuarit shpërndarjen -shtrimin- e tokës, ose përgatitjen e saj si djepin e njeriut dhe tē kafshëve tē tjera, Allahut xh.sh. dhe jo natyrës.

Fraza “*ve el-semæ binæn*”, “*dhe qiellin me kypë si mbulesë*” tregon nga tē përmendurit e qillit, i cili është i ngjitur me tokën, më tē lartën e provave tē thjeshta në botën e jashtme pér ekzistencën e Krijuesit.

**وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءَ مَاءً** *Ve enzele min el-semâi* “zbriti prej qießit (duke dërguar që andej)” -kjo tregon- dëshminë e ekzistencës së Autorit tē tyre -të dhënë nga- qeniet dhe nga gjërat e përbëra dhe nga gjërat e lindura shtazore, vegjetale dhe minerale. Pér më tepër, tē gjitha frazat e mëparshme veç e veç tregojnë provën e ekzistencës së –Autorit Krijues.

Gjithashtu, si një tërsi ato tregojnë unitetin e Tij. Dhe mënyra se si ato janë vendosur tregon rregullin -e universit- dhe aludon pér burimin e mirësive. Me dëshminë (e dhënë nga) **رَزْقَكُمْ** *Rizkan lekum*, “*si furnizim pér ju*” ajo vërteton e tregon përshtatshmërinë e tē Vetmit xh.sh. pér t'u adhruar, sepse është e detyrueshme ta falënderosh Dhuruesin e mirësive meqë ibadeti është falënderimi. Gjithashtu **رَزْقَكُمْ** *Rizkan lekum* “*si furnizim pér ju*” tregon se ashtu si toka dhe gjërat shtazore, vegjetale dhe minerale që janë bërë pér t'ju shërbyer juve, pô ashtu ju duhet t'i shërbeni tē Vetmit Unik i Cili i nënshtroi ato pér ju.

**فَلَا جُنُونَ اللَّهِ أَنْدَادًا** *Fela texfi' alû li-lahi endâden* “*Atëherë pra, mos i vini shokë Allahut*”.

Dije se duke u shtrirë nga pozita e saj janë rreshtat:

**يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمْ** *Jà ej-juhe el-nasu Vëbusdú Rab-bekum* “*O Njerëz! Adhuroni Allahun, Zotin tuaj*” deri tek “*i Cili ju krijoi ju*” dhe deri tek **وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ** *El-ledhí xheale lekum*, “*I Cili e ka bërë ... pér ju*” dhe deri tek **وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءَ مَاءً** “*dhe zbriti, duke dërguar*”:

Domethënë, kur ju e adhuroni Zotin tuaj, mos i shoqëroni ortakë Atij, sepse është vetëm Ai i Cili është Zoti dhe Mbështetësi, dhe është

Krijuesi juaj dhe Krijuesi i racës njerëzore; dhe mos bëni zotra e pronarë përvëç Allahut; sepse është vetëm Ai i Cili i krijoj qiejt dhe i bëri ato çatinë e vendbanimit tuaj, prandaj mos besoni që shkaqet natyrore të kenë një efekt të vërtetë, gjë e cila është burimi i idhujtarisë; dhe për shkak se është Ai që e zbret shiun për tokën për ushqimin tuaj dhe për mjetet e jetesës. Nuk ka mirësi veçse prej Tij dhe nuk ka falënderim veçse për Të.

#### Pozicionimi dhe lidhja e pjesëve të frazave:

Shqyrtoje këtë: Pasthirrma يَا أَيُّهَا “Ja ej-juhe”, “o ju” në frazën

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمْ “Ja ej-juhe el-nasu Vëbusdú Rab-be-kum” “O Njerëz! Adsuroni Allahun, Zotin tuaj” shfaqet shpesh në Kur'an meqenëse ajo përmban -një numër të- pikave të holla. Këtu adresimi mbështetet

نَّمَاءً نَّمَاءً “Ja” “O” e cila është për të zgjuar; nga اَيْ

“Ejju” (qëllimi i së cilës) është për të dalluar; dhe nga هَا “Ha” (qëllimi i së cilës) është për të paralajmëruar. Sepse adresimi këtu aludon për tre dobi: zëvendësimi i vështirësisë së obligimit -të adhurimit- me kënaqësinë e -të qenurit- i adresuar, dhe duke -njoftuar se- mjeti i vetëm i progresit të njeriut prej thellësirave të mungesës për tek stacioni -i lartë- i prezencës është vetëm adhurimi. Ajo tregon gjithashtu se ata të adresuarit janë ngarkuar në tre drejtime në lidhje me zemrat e tyre, me nënshtrimin dhe bindjen; në lidhje me intelektet e tyre, me besimin dhe afirmimin e unitetit Hyjnор; dhe fizikisht, nëpërmjet veprimit dhe adhurimit. (Adresimi) nënkupton gjithashtu se ata të adresuarit përbëhen nga tre grupe -nga besimtarët, mosbesimtarët, dhe hipokritët. Ajo aludon gjithashtu për tre klasat: klasën e elitës, klasën e mesme dhe masat e njerëzve.

Gjithashtu ajo aludon për mënyrën familjare -të zakonshme- dhe për rregullin e gjërave, gjë e cila është se një person para së gjithash i thërrët një personi për ta ndaluar atë; pastaj ai njeh tiparet -çehren- e tij dhe kthehet drejt tij, pastaj i adresohet atij dhe e bën atë të bëjë diçka duke e vënë në shërbim.

**Shkurtazi:** Plik e holla të lartëpërmendura -në përdorimin e thirrjes- mbështesin dhe përforcojnë adresimin (nga) të vërtetuarit e tre aspekteve të përmendura (dhe të kuptimeve).

Lidhur me pasthirrmën يَا “Ja”, meqenëse u adresohet njerëzve dhe përbëhen nga klasa të ndryshme duke përfshirë të pavëmendshmit, të munguarit; të pranishmit, të zënët me punë, miqtë e armiqtë e kështu me radhë, ajo edhe zgjon të pavëmendshmit, dhe u bën thirrje të munguarve, dhe njofton injorantët, u jep drejtim atyre që largohen, nxit dashuruesit, inkurajon kërkuesit, dhe nxit të plotësuarit për të shtuar -adhurimin e tyre- dhe gjithashtu u jep njerëzve një tundje. Distanca e

nënkuptuar nga يَا “Ja”, megjithëse konteksti (mekam) është njëri nga afersitë (dhe adhurimi), tregon madhështinë dhe lartësinë e obligimit dhe të besimit të tij (emane el-taklif).

Ajo gjithashtu aludon për largësinë e shkallës së adhurueshmërisë prej shkallës së Hyjnisi.

Gjithashtu është një aluzion për largësinë prej kur dhe ku u shfaq adresimi, prej kohëve dhe vendeve të atyre mbi të cilët është vënë obligimi.

Gjithashtu ai është një aluzion për thellësitë e shkujdesjes së njerëzimit.

Sa për اَيْ “ej-ju”, ajo përdoret për të veçuar -një person ose një grup- prej masave dhe nënkupton se të gjithë universit po i bëhet adresimi, dhe njerëzimi specifikohet meqë njerëzit mbajnë amanetin në formën e “Fard Kifajeh” (domethënë, qeniet njerëzore janë ngarkuar me kryerjen e adhurimit).

Prandaj në qoftë se ata janë të shkujdesur (në bërjen e kësaj), ata shkelin e tejkalojnë të drejtat e të gjitha qënieve (të tjera).

Gjithashtu, në اَيْ “ej-ju” është një hollësi elokuente, në të thukëtia e saj ndiqet nga një përcaktor نَاسٌ “el-nas”, “njerëz”. Pastaj “ha” duke

qenë një zéwendësuese pér pjesën e dytë tē rasës gjinore (*mudaf ilejhi*) tregon -se qëllimi i saj- éshtë pér t'i zgjuar e paralajmëruar ata, tē cilëve u bëhet thirrja me pasthirrmën “*Ja*”.

**نَاسٌ** “*El-nas*”, “njerëz” duke qenë një pjesore aktive që e ka prejardhjen prej -emrit foljor- “*nisjan*” që do tē thotë, “*harresë*”, tregon qortim ose mospëlqim. Domethënë, o ju njerëz! Si mund ta harroni besëlidhjen e parapërjetshme “*el-mithak el-ezelijj*”? Ajo gjithashtu tregon një shfajësim, domethënë: O ju njerëz! Pakujdesia -neglizhencë juaj mund tē jetë vetëm pér shkak tē një gabimi ose harrese; ajo nuk mund tē jetë e paramenduar -e bërë me qëllim- apo serioze. Sa pér

**اعبُدُوا** *Vébudú* meqenëse ajo éshtë konkluzion (ose apodozë -fjali kryesore në fjali tē përbërë kushtore) e thirrjeve tē përgjithshme pér tē gjitha klasat -e njerëzve- tē përmendura lart, ajo tregon bindje, dhe tregon sinqeritet, dhe aludon vazhdimësi dhe aludon pér Unitetin Hyjnor. Domethënë, bindjuni! Jini tē singertë e tē vazhdueshëm (në adhurim)! Shtojeni -adhurimin tuaj!- Shpalleni Unitetin Hyjnor!

**ربِّكُمْ** *Rab-beķum* tregon se ashtu si adhurimi që duhet tē dëshirohet e tē kërkohet meqë ai éshtë një lidhje e lartë, një lidhje e shquar; ai gjithashtu duhet tē kërkohet meqë ai éshtë -një rrugë e- shërbimit dhe tē dhënes falënderime pér tē Vetmin Unik i Cili ju ushqen dhe ju ngre në këmbë, dhe pér tē Cilin ju keni nevojë. Tani pér pjesët e frazës:

**الَّذِي خَلَقَكُمْ** *el-ledhí khalekakum ve el-ledhíne min kablikum* “i Cili ju krijoi ju dhe ata që genë para jush”. Si një përemër lidhor, **الَّذِي el-ledhí i Cili** që njihet vetëm me sa ka tē bëjë me atë që cilësohet nga fjalia lidhore. (Pér shembull, e gjitha ajo që dihet rreth “atij që shkoi” éshtë se ai ka shkuar.) Kështu, (këtu *Rabb*) “Zoti dhe Mbështetësi” duke u sunduar -

drejtuar- nga **الَّذِي el-ledhí** “*i Cili*” nënkupton se njohja rreth Allahut xh.sh. mund tē jetë vetëm në lidhje me aktet dhe veprat e Tij, dhe jo me Esencën e Tij.

Pastaj nëpërmjet tē shprehurit tē saj krijim tē përcaktuar e tē rregullt më tepër se sa (thjesht) dhënie ekzistencën (*ixhàd*) apo mëkëmbje

**خَلَقَ** *insha'ë*, **Khaleka** “*krijoi*” tregon se nga natyra qënia njerëzore éshtë kthyer drejt obligimit -të adhurimit. Ajo nënkupton gjithashtu se adhurimi éshtë një detyrë sepse ai éshtë rezultati dhe “*paga*” e krijimit. Por (kjo pagë nuk éshtë shpërblimi pér adhurimin;) Shpërblimi éshtë thjesht një favor i Allahut xh.sh..

Pér shkak tē pasigurisë se (cilët ose çfarë sundohet e drejtohet nga) “*el-ledhine*”, “*të cilët*”, ajo sikur aludon: “Asgjë nuk éshtë e njohur tanë pér ata tē cilët erdhën përpëra jush dhe që kanë vdekur e janë larguar. Ju po rrezikoni tē përbyseni e po ecni pér në buzë tē varrit, prandaj merrni mësim dhe mos u mashtroni nga kjo botë. Jini tē qëndrueshëm në adhurim, i cili éshtë mjeti pér lumturinë e përjetshme”.

**لَعْلَكُمْ تَقُولُونَ** *leal-lekum tet-tekuṇe* “që tē mund tē bëheni tē përkushtuar”, **لَعْلَ** “*leal-le*” shpreh shpresë, dhe kur ajo paraprin diçka tē dëshirueshme përdoret pér tē shtuar zellin, dhe kur ajo paraprin diçka tē neveritshme, funksioni i saj éshtë t'i thotë (dëgjuesit) tē ruhet -mbrohet. Këtu, shpresa nuk mund t'i referohet në mënyrë tē fjalëpërfjalshme -të mirëfilltë- Folësit (domethënë, Allahut), prandaj ajo éshtë ose metaforike, ose i referohet tē adresuarit, ose vëzhguesve ose dëgjuesve.

Në qoftë se i referohet Folësit, ajo éshtë një metaforë alegorike (*istiare temthilije*). Pér shembull, në qoftë se dikush pajis një person me pajime e mjete pér një detyrë, ai shpreson e pret se ai do ta kryejë atë. Në tē njëjtën mënyrë, Allahu xh.sh. e ka pajisur njerëzimin me mundësinë -potentialin- pér t'u plotësuar, dhe me aftësinë -kapacitetin (pér tē kryer) obligimet (fetare) dhe mjetin e dëshirës. Metafora gjithashtu tregon se qëllimi (*hikmeh*) i krijimit tē njeriut éshtë frika ndaj Allahut dhe vetëdija ndaj Tij (*takva*). Gjithashtu ajo nënkupton se adhurimi rezulton në shkallën (*el-mertebe*) tē frikës ndaj Allahut. Po ashtu ajo éshtë një shenjë se frika ndaj Allahut éshtë shkalla më e lartë.

Pér më tepër në stilin e mbretërve, metafora sugjeron inkurajim dhe mbajtje tē shpresës dhe -bërjen- e premtiveve tē sigurta.

Në qoftë se -shpresa e shprehur nga **لَعْلَ** *leal-le*- u referohet atyre tē adresuarve, ajo sikur éshtë duke thënë: “Adhurimi duke kërkuar (të

aspirojë pér) frikën ndaj Allahut, midis frikës dhe shpresës". Kjo nënkuption se njeriu nuk duhet tē ndjehet i sigurt -konfident- rrëth adhurimit tē tij. Ajo sugeron gjithashtu se ai nuk duhet tē mjaftohet me -shkallën e tanishme tē adhurimit- tē tij, por duhet tē konfirmojë thënien "Ti duhet tē veprost pa pushim" dhe tē shikojë pértej shkallës tek e cila ai gjendet (dhe tē aspirojë më shumë).

Dhe nē qoftë se (shpresa e shprehur nga **leaf-le** u referohet shikuesve dhe dëgjuesve, ajo sikur thotë se kushdo që i vëzhgon qeniet humane tē pajisura me aftësi dhe potenciale tē tilla do tē shpresojë e presë adhurim prej tyre -ashtu si një person i cili sheh kthethrat dhe dhëmbët shqyes tē një kafshe grabitqare që do ta presë atë tē jetë grabitqare. Ajo gjithashtu tregon se adhurimi kërkohet nga natyra e bashkëlindur e njeriut.

Meqenëse frika ndaj Allahut rezulton nga adhurimi i tē gjitha

klasave -tē njerëzimit- tē përmendura më parë, fjala **tet-tekune** "tē bëheni", aludon pér tē gjithë -tipet- dhe nivelet e *takvasë*. Domethënë, takvaja -duke penguar- shirkun; takvaja -duke penguar kryerjen- e gjynaheve tē mëdhaja, takvaja -duke e bërë njeriun- tē ruajë zemrën e tij -nga lidhja me- gjérat përvëç Allahut xh.sh, dhe takvaja duke i - shkaktuar njeriut- t'i shmanget (gjérave që çojnë) nē ndëshkim; dhe takvaja -duke i shkaktuar njeriut ta përbajë veten nga zemërimi. Gjithashtu ajo tregon se adhurimi -i vërtetë- është ai që -kryhet- me sinqueritet. Dhe ajo tregon se adhurimi duhet tē jetë qëllimi i vetëm, dhe jo thjesht një mjet, dhe sugeron gjithashtu se adhurimi nuk duhet -tē kryhet me shpresën- e shpërblimit apo -tē shmangies- së ndëshkimit.

**Tani elementet e frazës** **"الذى جعل لكم الأرض فرآشاً والسماء بناءً"** **EL-ledhî xheale lekum el-erda firâshen ve el-semâe binâen"** I Cili e ka bërë tokën vend pushimi pér ju dhe qiejjin me kypë si mbulesë".

**Shqyrtoje këtë:** Duke përshkruar gjérësinë e fuqisë së Autorit, kjo tregon se ajo është duke i nxitur njerëzit pér adhurim, dhe duke përmendur favoret e Tij, i inkurajon -ata. Ai sikur është duke thënë: "O njeri! Ai i Cili i nënshtroi tokën dhe qiejt pér ty meriton adhurimin tënd".

Ajo gjithashtu tregon virtytin e njeriut dhe vlerën e tij tē lartë dhe fisnikërinë e tij nē shikimin e Allahut sikur thotë: "Ti duhet tē shfaqesh nëpërmjet tē adhuruarit Një tē Vetmin i Cili tē ka mundësuar ty duke i bërë trupat qiellorë e tē ulët -në një mënyrë tē tillë- që ti tē mund tē përfitosh prej tyre pavarësisht gjérësisë së tyre, se ti je i denjë pér Favorin e Tij".

Pér më tepër, ajo është një aluzion duke hedhur poshtë rastësinë, koincidencën dhe efektin e -vërtetë- tē natyrës. Domethënë, tē gjitha atributet që ti i sheh -në natyrë ekzistojnë- me anë tē bërges së një Autori, dhe synimin e një Synuesi, specifikimin e një Specifikuesi dhe rregullin e një Rregulluesi. Sa sublime është Urtësia e Tij!

Gjithashtu ajo nënkuption hedhjen poshtë tē shkollës natyraliste dhe atë tē Sabeanëve, tē cilat i dhanë shkas shkollës së idhujtarëve (*el-Vethenijj*).

Pér më tepër, ajo tërheq vëmendjen pér tek fakti se atributet e trupit tregonjë nëpërmjet mundësisë së tyre Autorin. Sepse atomet e tyre janë tē barabarta nē atë që ato mund tē marrin -një numër tē pafundmë- tē gjendjeve tē përgjithshme dhe mënyrave, dhe tē gjitha qeniet e mundshme janë ngurruese midis shumë mundësive. Kështu nē lidhje me atributet dhe gjendjet e tyre, tē gjithë trupat fizikë janë nē nevojë tē synimit, qëllimit ose tē urtësisë dhe tē specifikimit tē Dikujt pér t'i specifikuar -këto.

Sa pér vendosjen përparrë tē **lekum "pér ju"**, ajo tregon se toka është shpërndarë pér njeriun; sikur tē ishte se vetëm njeriu është ai që përfiton prej saj, dhe pjesa tjetër -në këtë aspekt- janë tē tepërt, tē panevojshëm. Shqyrtoje këtë me vëmendje! **firâsha** **"firâshen vendpushimi, shtrojë"** tregon një pikë tē hollë elokuence që është fakti i çuditshëm se megjithëse natyra -pesha- e tokës kërkon që ajo duhej tē ishte e zhystur nē ujë, (ajo nuk qe) dhe kjo nënkuption se ajo u shtri, u shpërndë ndryshe nga natyra e saj. Sepse sipas kësaj, uji duhej tē kishte vërshuar e dalë mbi -tē gjithë- globin. Por me urtësinë dhe mëshirën e Tij, Autori e nxori -tërhoqi- një pjesë tē tij dhe e shpërndau, e shtroi dhe vendosi mbi tē tryezën e mirësive tē Tij pér njerëzimin.

E ngjashme me tē, nē përputhje me rregullin, “nē qoftë se një gjë provohet, ajo provohet së bashku me gjérat që ajo e bën tē

domosdoshme”, fjala فَأَشَا firashen “vendpushimi, shtrojë” (që vjen nga folja “fereshe”, “shpérndaj, shtrij”) tregon se toka është si dysheme e shtruar -me qilim- e një shtëpie, dhe speciet e bimëve dhe tē kafshëve që ajo i përban janë si pajisjet e saj tē vendosura nē tē me synim e paramendum. Ajo gjithashtu sugjeron se me synim e paramendum - gjendja e- tokës është një mesatare; ajo nuk është as shumë e lëngshme që mbi tē cilën tē mos mund tē ecet, as aq e ashpër që tē mos përdoret e tē kultivohet. Sepse nē qoftë se ajo do tē kishte qenë kështu, ajo do tē kishte qenë e padobishme edhe sikur tē ishte bërë prej ari.

Prandaj -gjendja- e saj e mesme tregon se ajo është specifikuar, e bërë dhe e synuar nga Njëri -i Cili vepron- me urtësi e qëllim.

وَالسَّمَاءُ بَنَاءٌ *Ve el-semâe binâen* “dhe qiellin me kypë si mbulesë” tregon këtë se kur i Vetmi Unik xh.sh. i bëri qiejt një -mbulesë- dhe tavan për ju, yjet e tij u bënë llambat tuaja, prandaj mos imagjinoni se rastësia - ka ndonjë pjesë- nē shpérndarjen -përhapjen ashtu siç mund ta imagjinoni se ajo i shpérndan nē qoftë se ju i shpérndani disa xhevahirë nē tokë.

Në këtë vërset është aluzioni, sugjerimi, nënkuptimi i një misteri të hollë tē mrekullueshmë dhe tē çmueshmë, i cili është sa vijon:

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Njeriu është thjesht një atom nē krahasim me tokën, dhe toka është një atom nē krahasim me universin. Gjithashtu, një individ human është një atom nē krahasim me racën njerëzore, dhe raca njerëzore është një atom e krahasuar me partnerët e saj nē përfitimin prej kësaj shtëpie tē lartë. Për më tepër shtrirja për tek e cila njerëzimi i përdor avantazhet -dobitë- e shtëpisë dhe synimet është -vetëm- sa -vlera- e një atomi dhe, qëllimet e tij që mendja njerëzore mund t'i kapë janë thjesht një atom nē krahasim me dobitë - ekzistuese- nē urtësinë e parapërjetshme dhe nē njohjen Hyjnore. Atëherë si -i Vetmi xh.sh.- e kriroi tokën për njerëzimin dhe e bëri dobinë e njeriut nē tē qëllimin e saj përfundimtar?

*Ty do tē tē thuhej:* Po, ashtu është, por pavarësisht tē gjithë asaj, për shkak tē gjërësisë së shpirtit tē njeriut dhe shtrirjes së aftësive tē tij, dhe

shumicës dhe përhapjes së dobive -përfitimeve- tē tij prej Universit; dhe për shkak tē mungesës së mbingarkesës, copëzimit dhe tē rezistencës ndaj dobive tē saj, si Lidhja e tē tërës me pjesët e saj -sepse e tëra është e pranishme nē tërësinë e saj nē tē gjitha pjesët e saj dhe prandaj nuk ka mbingarkesë dhe as copëzim, Kur'an e bëri dobinë e njeriut qëllimin kryesor ndonjë ai është vetëm njëri prej qëllimeve tē panumërt tē qiejve dhe tē tokës, dhe ajo është si ajo shfaqet për njeriun. Domethënë, njeriu përfiton prej tokës sikur ajo tē ishte oborri i shtëpisë së tij dhe qiejt tē ishin tavani i tij. Yjet janë llamba për tē dhe bimët ushqimi i tij, prandaj çdo (person) ka tē drejtë tē thotë: “Dielli im, qiejt e mi, toka ime”. Tani mendo rrëth kësaj së bashku me aftësinë tënde tē arsyetimit!

وَنَزَلَ مِنَ السَّمَاءَ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الشَّرَابَاتِ رِزْقًا لَكُمْ  
*Ve enzele min el-sema'i ma'en fe ahrexhe biki min el-themerati rizkan lekum*  
“duke dërguar që andej (prej qiellit) ujë për tē prodhuar fruta si furnizim për ju”:

**Shqyrtoje këtë:** Përemri -i nënkuptuar- nē “zbriti, duke dërguar” - duke iu referuar Allahut- tregon se pikat e shiut zbresin poshtë me një balancë tē paramenduar, tē bërë me qëllim, dhe me urtësi -me synim. Në fakt çdo pikë është rrethuar nga një rregull i veçantë, siç tregohet me shenjën e mospërplasjes së motrave tē saj nē atë distancë tē largët pavarësisht përlleshjes së ajrit me to. Kjo njofton se pikat e shiut nuk janë lënë nē tekat e tyre, por frerat e së cilit mbahen nga një melek duke përfaqësuar rregullin dhe duke e reflektuar.

مَاءٌ مِنَ السَّمَاءِ *min el-semâe* “prej qiellit” megjithëse një përemër duhet tē kishte qenë nē vend tē tij -meqë ai është përsëritje-, nënkupton se ajo që synohet është drejtimi i qiellit, jo nga

vetë qielli (*xhirmaha*). Përdorimi i fjalës *ma'en ujë* megjithëse ajo çfarë bie është borë, breshër dhe shi tregon se uji është burimi më i afërt dhe më i dobishëm. Në tē vërtetë, “*Dhe Ne kemi bërë çdo gjë tē gjallë, çdo lloj gjallëse prej ujtit<sup>17</sup>*”. Ndërsa qenia e tij e pashquar sugjeron se ai ka veçori tē çuditshme dhe një strukturë tē mahnitshme dhe se përbërja e tij kimike është e panjohur për ju.

<sup>17</sup> Kur'an, 21:30

Lidhëzja فَ “fe” në fe Akherexhe “dhe nxorri, prodhoi” është vendosur e pozicionuar kështu për t’u ndjekur pa ndërprerje, por ndodhet një shtyrje -vonesë- midis rënies së shiut dhe daljes së frutave. Kjo nënkupton fjali të tilla -munguese- si “...toka u lëkund dhe u rrit, pastaj u bë jeshile dhe فَ خَرَجَ fe Akherexhe dhe prodhoi çdo lloj bime në çift”. Sa për përemrin -e nënkuptuar- të فَ خَرَجَ “fe Akherexhe” (i Cili i referohet Allahut) ai tregon se frutat nuk dalin me anë të thjesht riprodhimit apo të substancave të përbëra, por se Autori i Gjithurtë i krijon dhe i ngre ato nëpërmjet atributeve dhe veçorive jo të pranishme në lëndën e tyre fizike.

**ب** بـ “Bi-hi”, meqenëse kuptimi i vërtetë i (kësaj parafjale mjetore duke cilësuar ujin”), domethënë, të ngjisësh ose ta sjellësh afér (ilsak), ka përthithur (kuptimin e) shkakësisë, ajo tregon freskinë -njomësinë- e shijshme të frutave. Sepse uji -në kundërshtim me natyrën e tij- ngjitet tek ato nëpërmjet “el-a’tħar esh-shērijje” dhe i mbush gllugurimat e frutave nga afér duke u ngjitur me to.

منَ الشَّمَرَاتِ Min el-themerati “prej frutave, disa fruta” sipas Sibawjhil” meqenëse -pjesëtores- منَ min “prej” nuk i mungon plotësisht kuptimi i një kryefjale (ajo nuk mund të jetë kundrinori i أخْرَجَ Akherexhe “nxorri, prodhoi” dhe kjo tregon se kundrinori do të ndryshojë në përputhje me konceptimin -të kuptuarin- e dëgjuesve; domethënë, “fruta të tillë të ndryshme si t’i dëshironi”.

رِزْقًا Rizkan, “si furnizim” ajo tregon se shkaqet me të cilat ju e fitoni këtë rizk -furnizim- janë të panjohura për ju, sepse ai vjen për ju nga ku nuk mund të parashikohet.

لَكُمْ Lekum, “për ju”, ajo është një aluzion duke forcuar kuptimin e mirënjoyjes. Ajo gjithashtu nënkupton se rizku, furnizimi” është për ju, por nuk ka dëm në qoftë se të tjerët përfitojnë prej tij pas jush. Gjithashtu ajo nënkupton se Allahu xh.sh. ju ka zgjedhur e veçuar

juve për mirësitë e Tij, kështu edhe ju gjithashtu duhet t’i jepni falënderime vetëm Atij.

Vendosja, pozicionimi -dhe lidhjet- e pjesëve të Andada فَ لَا تَحْمِلُوا اللَّهَ اندادا Fela texhi’alú li-lahi endāden “Atéheré pra, mos i vini shokë Allahut”:

فَ “Fe” (e “Fela”, “atéheré pra mos”) shikon tek katër pjesët (lart): domethënë, Ai është i Adhuruari i Vetëm, prandaj mos i përshkruani asnjë ortak Atij; sepse Ai është i Plotpushtetshmi Absolut dhe qiejt dhe toka janë në kapjen e fuqisë së Tij, prandaj mos besoni që Ai ka ndonjë partner; dhe Ai është Dhuruesi i -të gjitha- mirësive, prandaj mos ia jepni falënderimet tuaja askujt tjetër përveç Tij; dhe Ai është Krijuesi juaj, prandaj mos imaginoni që Ai të ketë ndonjë ortak.

تَعْتَدُوا taetekidu مَجْعُولًا Përdorimi i texhi’alú “(mos) i vini” në vend të besoni” tregon kuptimin e vërsetit, “Ata janë veçse emra që ju i keni ngjitur<sup>18</sup>”. Domethënë, emra të pakuptimitë që ju i imaginoni të ekzistojnë dhe janë nga shpikja juaj.

Vendosja para e اللَّهِ “lil-lahi”, “për Allahun” duke tërhequr menjëherë vëmendjen (për tek Allahu) tregon nga njëra anë domosdoshmërinë e -përmendjes së Tij-; ndërsa nga ana tjetër ajo nënkupton se arsyeva për ndalimin është fakti se ortakë nuk i shoqérohen Atij. Andada “Endad” “Rivalē, ortak”: njëjësi “nidd” ka kuptimin e “i njëllojtë, i barabartë, shok dhe diçka të ngashëm gjëra të cilat janë pikërisht të kundërtat e Tij; ndërmjet tyre ka kundërshti. Në këtë është një aluzion i hollë se -termi- rival ose i barabartë është esencialisht i kotë. Pastaj përdorimi i shumësit tregon injorancën e plotë të atyre që i përshkruajnë ortakë Allahut xh.sh. (el-mushrikine), dhe nënkupton tallje ndaj tyre: “Si mund t’i përshkruani -shokë- Allahut, i Cili është pa të ngashëm në asnjë mënyrë, turmë prej të njëllojtëve dhe të kundërtëve?”

<sup>18</sup> Kur'an, 53:23

Ajo gjithashtu nënkupton hedhjen poshtë të të gjithë llojeve të ortakëve; domethënë nuk ka partner as në Esencën e Tij, as në Atributet dhe as në aktet e Tij. Ajo gjithashtu nënkupton rrëzim të çdo lloji të përshkruari ortakë me Allahun: paganët “el-vethenijjun”, Sabeanët, njerëzit e trinitetit (*el-tethlith*), dhe Natyralistët, të cilët besojnë se shkaqet kanë një efekt të vërtetë.<sup>19</sup>

**وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ** Sa për *Ve entum ta'ëlemune* “*kur ju e dini*”: Ashtu si të ngjashmet duke konkluduar frazat e vërsetit *-fewasil-* kjo tregon se burimi i islamit është njohja (*el-ilm*) dhe baza e tij është arsyaja (*el-akl*), dhe se ai pranon të vërtetën dhe hedh poshtë sofistikën dhe iluzionet -mashtimet.

Për më tepër, nëpërmjet thukëtisë së tij duke mos i bashkangjitur asnjë kundrinor foljes **“تعلمونَ”**, “*njoh*”, (Kur’ani) zgjat ligjératën.

Domethënë, ju e dini tanë se: Nuk ka të Adhuruar të Vërtetë, as Krijues, dhe as të Gjithëpushtetshëm Absolut dhe as Dhurues mirësish përveç Atij, të Vetmit... Gjithashtu ju e dini se zotrat fallco dhe idhujt nuk janë asgjë, dhe ato nuk janë të aftë të bëjnë asgjë. Ato të gjithë janë të krijuar, janë thjesht dhe vetëm shpikje që ju i keni imagjinuar”. Ju duhet t’i kushtoni kësaj vëmendjen e duhur!

\* \* \*

<sup>19</sup> Burimi i paganizmit apo i idhujtarisë është ose hyjnizim i yjeve ose mishërim ose trupëzim i Allahut.

## VËRSETET 23-24

وَإِنْ كَنْتُمْ فِي رَبِّ مَا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَاتَّوْا بِسُورَةِ مِنْ مُّثَلِّهِ وَادْعُوا شَهِداءَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ كَنْتُمْ صَادِقِينَ \* فَإِنْ لَمْ تَفْعِلُوا وَلَنْ تَفْعِلُوا فَاتَّقُوا السَّنَارَ الَّتِي وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحَجَارَةُ أَعْدَتْ لِكُلِّ كَافِرٍ

*Ve in kuntum fi rejbin mim-mà nez-zelnà alà abdînà feëtû bisüretin min mithlîhi veud’ú shuhedâekum min dûni-f-lâhi in kuntum Sâ’dikjine. Fe in lem tef’alú ve len tef’alú fe it-tekú el-nâre el-letí vekudûha el-nâsu ve el-hixħâretu Vid-det li-l-kâfirîne.*

*Dhe nëse ju dyshoni për atë (Kur’anic) që Ne i këmi zbritur robit tonë (Muhammedit a.s.m.), atëherë bëni edhe ju një sure të ngjashme si ajo dhe thirri dëshmtarët tuaj përveç Allahut nëse jeni të drejtë”. Por nëse nuk e bëni dot atë dhe ju kurrë nuk mund ta bëni atë, atëherë kinie frikë zjarrin (xhehennemin), lëndë djugħejse e të cilist janë njerëz dhe gurë, i përgatituri për mosbesimtarët.*

## NJË PARATHËNIE

### Duke verifikuar profetësinë

**Shqyrtoje këtë:** Ashtu si vërseti i mëparshëm që provoi të parin e katër qëllimeve kryesore të Kur'anit, i Cili është Uniteti Hyjnor (*el-teuhid*), po ashtu ky vërset (2:23) provon të dytin e katër qëllimeve, që është profetësia e Muhammedit a.s.m.<sup>1</sup> nëpërmjet më të përsosurës, më të përkryerës, që ishte sfidimi i tij -kundërshtarët- me mrekullinë e Kur'anit dhe me paimitusshmérinë (*i'xhaz*) e tij. Ne i kemi shtjelluar dëshmitë e profetësisë së tij në mënyrë të detajuar në një libër tjetër<sup>2</sup> dhe një pjesë e tyre është përbledhur këtu në gjashtë çështje<sup>3</sup>.

#### Çështja e Parë

Mund të dilet në përfundimin prej rrethanave, gjendjeve të profetëve, nëpërmjet arsyetimit induktiv (*el-istikra et-tam*), dhe analogjisë së njohur si e fshehur (*el-kijas el-khafij*) (të bazuara mbi) rregullin e pathyer, të vazhdueshëm (në gjëra të ngashme), se boshti dhe baza e misioneve të profetëve dhe trajtimet e tyre me komunitetet e tyre u gjendën në mënyrën më të plotë dhe të përsosur tek profeti Muhammed a.s.m. i cili ishte profesori i njerëzimit në moshën e plotësimit të humanizmit. Kjo jep argumentin më të mirë të mundshëm dhe provën se ai ishte gjithashtu i dërguari i Allahut. Sepse nëpërmjet gjuhëve të mrekullive të tyre, të gjithë profetët sikur dëshmuant përvërtetësinë e profetit Muhammed a.s.m., i cili ishte një provë e ndritshme për ekzistencën e Autorit -Krijuesit- dhe unitetin e Tij. Tani reflektu mbi këtë!

<sup>1</sup> Në fakt, qëllimi i dytë i Kur'anit është profetësia në përgjithësi. Por profetësia e Muhammedit a.s.m. mund të thuhet kështu meqenëse ajo ishte Universale dhe përfshiu esencën e mësimeve të

profetëve të mëparshëm. Shiko: *Isharatul I'xhaz Abdul Mexhid*, 177

<sup>2</sup> Nursi Muhamemat 121

<sup>3</sup> Në fakt, ndodhen shtatë “çështje”.

#### Çështja e Dytë:

Dije se secila prej gjendjeve dhe secila prej lëvizjeve të profetit a.s.m. edhe në qoftë se nuk ishin të gjitha të jashtëzakonshme -aludojnë në fillim përvërtetësinë e tij dhe në fund përvërtetësinë dhe ndershmérinë e tij. A nuk e shih ti se ai a.s.m. veproi në situata të ngashme me ngjarjen e shpellës kur nuk kishte shpresë ndihme, ai deklaroi me siguri të plotë, me konfidencë dhe me seriozitet:

لَا تَخْفِ أَنَّ اللَّهَ مَعَنَا “Mos u mërzit. Sigurisht që Allahu është me ne<sup>4</sup>.

Ashtu si sjellja e tij në fillimin e misionit të tij -i pa shqetësuar, pa e çarë kokën përballë kundërshtarëve dhe pa frikë e pa ngurrim dhe me qetësi e konfidencë të plotë- që tregon kapjen e tij pas të vërtetës; po ashtu themelimi i tij në fund të lëvizjeve të tij -rregullat esenciale përvërtetësinë e tij- dëshmi përvërtetë dhe drejtësia e vepprimeve të tij dhe lidhja e tij me të vërtetën, që të gjitha janë dëshmi përvërtetësinë dhe ndershmérinë e Tij. Kjo ishte e vërtetë për secilën prej akteve të tij. Ndërsa në qoftë se do të hidhje vështrimin tek të gjitha sjelljet dhe gjendjet e tij do të shfaqej përvërtetësinë e tij dëshmi përvërtetësinë së tij aq e ndritshme si vetëtima. Prandaj reflekto mbi këtë!

#### Çështja e tretë

Kuptoje se e shkuara dhe e tashmja -domethënë- epoka e lumturisë (koha e profetit) dhe e ardhmja janë të bashkuara në afirmimin e konfirmimin e profetësisë së tij ashtu siç ishte edhe vetja e tij dëshmi përvërtetësinë e tij. Ne tani duhet të studiojmë katër faqet vijuese. Së pari ne do të kërkojmë bekimet duke studiuar personin e tij, dhe para së gjithash duke sjellë ndërmend *katër pika*:

**Së Pari:** Edhe sikur të ishin tek standarti më i lartë, gjërat artificiale e të bëra nga njeriu nuk do të mund të ishin kurrë të barabarta me atë që është natyrale dhe “reale”, dhe as nuk mund ta marrin vendin e tyre. Gafat dhe shkarjet e artificializmit sigurisht që do ta shfaqin mashtrimin.

<sup>4</sup> Kur'an, 9:40

**Së Dyi:** gjëja e vetme e cila i lidh dhe i fikson moralet e larta me terrenin e realitetit është serioziteti; dhe gjëja e vetme që i përjetëson ato në tërësinë e tyre është vërtetësia (*sidk*). Në qoftë se vërtetësia largohet prej mesit të tyre ato bëhen si një kashtë e hedhur nga era.

**Së Treti:** Ashtu si prirja -e ndërsjellë- dhe têrheqja që janë të pranishme në gjërat që janë harmonike e të pajtueshme, po ashtu gjërat kontradiktore dhe të kundërtat u japid shkas shtytjes dhe neverisë së ndërsjellë.

**Së Katërti:** është (rregulli) “*Ndodhet në të tënë ajo që nuk është e pranishme në pjesët*” si forca e një litari megjithëse fijet e tij janë të dobëta.

Në qoftë se ti i ke kapur këto pika, kupto tani se ashtu siç u pranua nga armiqtë e tij, veprat e Muhammedit a.s.m. dhe rrjedha e historia e jetës së tij, që të gjitha dëshmojnë se ai kishte karakterin më të bukur dhe të kombinuara tek ai ishin të gjitha cilësitë më të larta. Një kombinim i tillë karakterizohet nga dinjiteti personal, rëndësia, vetënderimi, sedra dhe këto nuk e lejojnë një njeri ta ulë veten në kotësira e në gjëra bajate. Ashtu si melekët që nuk i lejojnë shejtanët të përzihen me ta, po kështu, të gjitha ato morale të larta nuk lejojnë në asnjë mënyrë që të futen midis tyre dredhia dhe gjenjeshtra.

A nuk e ke vëzhguar se dikush që është i famshëm vetëm për trimëri nuk e ul veten tek gjenjeshtra, veçse në qoftë se detyrohet? Atëherë si do të ishte e mundur për një person te i cili të gjitha (ato cilësi janë të pranishme)? Kështu, është provuar se vetë personi i profetit a.s.m. jep dëshmi për vetveten aq të qartë si dielli.

Për më tepër, në qoftë se ti e studion sjelljen e tij a.s.m. nga mosha katër deri në dyzet, ti do ta shihje se megjithëse kjo është periudha e rinisë kur pasionet natyrale janë të tërbuara e të shfrenuara dhe vetitë e fshehura dhe ndonjë finokëri e fshehtë ose ndonjë dredhi në karakterin e një personi shfaqet, ai (a.s.m.) i jetoi këto vite në drejtësi të plotë, në qëndrueshmëri, në dëlirësi dhe në mënyrë të rregullt e korrekt. Nuk kishte asnjë aluzion dredhie në ndonjëren prej sjelljes së tij; madje as kur përballej me armiqtë e tij më kryeneçë e të zgjuar (ata nuk vëzhguan asnjë dredhi tek ai). Dhe ndërkaq ti e sheh kur ai a.s.m. është dyzet vjeç, kur karakteri bëhet i qëndrueshëm dhe kur zakonet të ngulitura, dhe ai shfaqet si një mrekulli i cili shkakton një revolucion

madhështor të paprecedent në botë. Kjo do të mund të ndodhë veçse nëpërmjet -Vullnetit- të Allahut xh.sh..

### Çështja e Katërt

Dije se faqja e së shkuarës e cila përmban historitë e profetëve, të treguar (nga profeti a.s.m.) në Kur'an, është një provë e profetës së tij. Kjo (faqe përfshin) *katër pika*:

**E Para:** Në qoftë se një person merr parimet bazë të një shkencë dhe njeh dobinë e saj esenciale dhe e përdor mirë e me mjeshtëri atë në vendin e duhur, pastaj ndërtón çështjen e tij mbi të, kjo është dëshmi për aftësinë e tij dhe për ekspertizën në atë shkencë.

**Pika e Dytë:** Në qoftë se je njohës i natyrës njerëzore -do të mësoje se- ti kurrë nuk do të shihje ndonjë person duke qenë kaq guximtar sa të kundërshtonte (shumicën) pa ngurrim, pa shqetësim ose pa shtrëngim -zor- apo të gënjen edhe sikur pa rëndësi, midis një populli edhe sikur ata të ishin pak, për një çështje edhe sikur të ishte e ulët, me një dinjitet edhe sikur të ishte i dobët. Atëherë si do të ishte e mundur që dikush -me dinjitetin më të skajmë- për një çështje të rëndësisë më të skajshme, midis njerëzve të cilët ishin jashtë mase të shumtë përballë kryeneçisë më ekstreme, pavarësisht qënies së tij analfabet që nuk kishte lexuar... saqë foli i vetëm për çështje të pakapshme nga arsyaja dhe i shfaqi ato me seriozitetin më të madh dhe i shpalli ato mbi kokat e dëshmitarëve? A nuk tregon kjo vërtetësinë e Tij dhe se -ajo që ai shpalli- nuk ishte prej tij por prej Allahut?

**E Trete:** Ndodhen shumë shkenca që për të civilizuarit janë aksiomatike -të njoitura- dhe japid mësim zakonet, ngjarjet, situatat dhe aktet, por se ato janë të panjohura dhe teorike për nomadët -primitivë. Prandaj, në qoftë se dikush dëshiron t'i pyesë -ata- dhe të hetojë rrethanat e tyre -nomadëve- sidomos në shekujt e kaluar, ai duhej ta imaginonte -veten- midis tyre në ato shkretëtira.

**E Katërt:** Kjo është se në qoftë se një person debaton me ekspertë në një shkencë, sikur ajo të ishte vetëm gramatika, dhe parashton pikëpamjet e tij lidhur me çështjet që ajo përmban, duke mbështetur atë mbi të cilën ka pajtueshmëri mendimi dhe duke korrigjuar pikat e

kundërshtive, a nuk do të demonstronte kjo pér ty epërsinë e tij dhe se njohja e tij është "Vehbij" -e dhënë nga Zoti xh.sh.?

Në qoftë se ti i ke kuptuar këto pika, kupto tani se pavarësisht qënies së tij analfabet, Muhammedi arab a.s.m. na tregon neve nëpërmjet gjuhës së Kur'anit historitë e të gjithë profetëve dhe kohët e hershme sikur ai të kishte qenë i pranishëm dhe t'i kishte dëshmuar ato. Ai i përshkruan gjendjet e tyre dhe i shpjegoi, i nxori të fshehtat e tyre mbi kokat e botës në mënyrën e një çështjeje madhështore dhe ka tërhequr vëmendjen e njërežve inteligjentë. Ai i tregon këto pa asnjë shqetësim. Sepse ai mori pikat e tyre vitale, jetike parimet themelore si bazat e çështjes së tij duke konfirmuar çështjet e miratuar unanimisht prej shkrimeve të mëparshme, dhe duke korriguar çështjet e kundërshtive. Sikur me një shpirt shëtitës -kalimhi- duke reflektuar shpalljen Hyjnore ai përshkoi kohën dhe hapësirën dhe hyri në thellësirat e së shkuarës, pastaj e shpalli -atë që ishte atje- sikur ai ta kishte dëshmuar atë. Kështu, bërra e tij këtë është një provë e profetësisë së tij dhe njëra prej mrekullive të tij. Të gjitha dëshmitë e profetësive të profetëve të mëparshëm janë në efekt dëshmi pér profetësinë e tij, dhe të gjitha mrekullitë e tyre janë në efekt një mrekulli e tij.

### Çështja e Pestë

Kjo shpjegon faqen e Epokës së Lumturisë, veçanërisht çështjen e gadishullit arabik. Ajo gjithashtu përbëhet nga *katër pika*:

**E Para:** Në qoftë se do ta studioje botën do të shihje se pér të zhdukur zakonet dhe veset është tepër e vështirë edhe në qoftë se ato do të ishin të parëndësishme, ose tipare edhe sikur të ishin të papërfillshme, midis një populli edhe sikur të ishte i vogël, ose në një grup edhe sikur të ishte i mjerë, pér një mbret edhe sikur të ishte i fuqishëm me vendosmëri edhe sikur të ishte e madhe, në një kohë të gjatë dhe duke bërë shumë përpjekje. Atëherë si do të ishte pér një njeri i cili nuk është një sundimtar por megjithatë pati sukses pér një kohë të shkurtër me pak përpjekje e në raport me atë që ai arriti, t'i zhdukte zakonet tërësisht dhe moralet që ishin tërësisht të ngulitura dhe ishin praktikuar që kur s'mbahej mend, dhe në vend të tyre nguliti –rrënjosimorale dhe zakone në zemrat e njërežve që ishin tepër të shumtë dhe

ishin të lidhur plotësisht dhe fanatikë me zakonet e tyre? A nuk do ta shihje ti këtë një ngjarje të jashtëzakonshme dhe një mrekulli?

**Pika e Dytë:** Një shtet ose një qeveri është një trup kolegjal - personalitet kolektiv (*shahs Maënevi*); ai merr formë gradualisht si ritja e fëmijës dhe pushtimi i tij shtetet e mëparshëm -ligjet dhe rregullat e të cilëve u bënë pikërisht si pjesa e natyrave të popujve - do të merrte kohë.

Atëherë a nuk ishte e jashtëzakonshme që Muhammedi a.s.m. themeloi një shtet madhështor -pothuajse- përnjëherësh, i pajisur pér të përparuar pér tek shkalla më e lartë duke përfshirë parimet themeltare të larta e të përjetësme, dhe e përjetësoi sundimin e tij jo vetëm nga ana e jashtme dhe materiale por gjithashtu edhe nga ana e brendshme dhe shpirtërore?

**Pika e Tretë:** Është e mundshme të dominohet nga ana e jashtme dhe sipërfaqësore nëpërmjet detyrimit dhe forcës, por të pushtosh mendjet dhe të prekësh shpirtërat duke ngulitur në to ëmbëlsinë e tij, dhe të sundosh mbi natyrat duke ruajtur dominimin e tij mbi ndërgjegijet e tyre gjithmonë, kjo nuk është tjetër veçse gjë e jashtëzakonshme, kjo mund të jetë veçse një karakteristikë e dalluar e profetësisë.

**Pika e Katërt:** Ta drejtosh e ta udhëzosh opinionin publik nëpërmjet dredhive të frikësimit dhe ngashënjimit, dhe nëpërmjet kanosjes dhe kërcënimit, do të kishte vetëm një efekt të përkohshëm, sipërfaqësor dhe të pjesshëm, dhe pér një kohë bllokoni rrugën pér tek mendimi racional. Kështu në qoftë se një person depërtón tek pikërisht thellësítë e zemrave të njërežve me udhëzimin e tij, lëviz e prek emocionet e tyre më të holla, zbulon potencialet e tyre, zgjoi moralet e tyre më të larta, zbuloi talentet e tyre të fshehura, dhe e bëri esencën e humanizmit të tyre të bruffollonte e shkumëzonte, dhe i bëri të dukshme vlerat e tyre si qënie racionale, të gjitha këto akte të tij mund të jenë vetëm pikërisht rrezet e realitetit, dhe në të vërtetë të jashtëzakonshme. Ti e sheh një person zemërgurë i cili varros vajzën e tij të gjallë pa brejtje të ndërgjegijes ose pa hidhërim, pastaj kur ti e sheh atë përsëri një ditë më vonë, duke qenë bërë musliman, ai -përbahet, ndalohet, nga shtypja- e një mize; ai ndjen dhimbje nga dhimbja e një krijese, i

vjen keq edhe pér tē. A mund t'ia atribuoni një revolucion tē tillë emocionesh ndonjë ligji? Hë, tregoma pér hir tē Zotit!

Në qoftë se ti i ke kuptuar këto pika, reflekt mbi një tjetër. Ajo eshtë kështu:

Historia e botës dëshmon se gjeni i veçantë eshtë ai burrë i cili eshtë i aftë pér zhvillimin e aftësive dhe tē dhuntive të bashkëlindura tē tē gjithë njerëzve, dhe duke zbuluar vitetë e tyre tē veçanta dhe duke zgjuar ndjenjat e tyre, pér tē shkaktuar emocionet e tyre, sepse në qoftë se ai nuk i ngjall ato emocione tē fjetura, përpjekjet e tij do tē ishin tē kota, ose tē përkohshme, edhe në qoftë se ai do tē ishte i shquar në veten e tij.

Gjithashtu historia na tregon neve se më i madhi i njerëzve eshtë ai i cili eshtë i suksesshëm pér tē zgjuar një ose dy ose tre prej këtyre ndjenjave tē përgjithshme: si ndjenjën e patriotizmit, ndjenjën e vëllazërisë, dhe ndjenjën e dashurisë, dhe dëshirën pér liri, dhe kështu me rradhë. Atëherë, a nuk eshtë çudi dhe ngjarje e jashtëzakonshme tē zgjosh mijëra emocione tē tilla, tē fshehura e tē larta dhe t'i bësh ato tē shpërthejnë e tē zbulohen tek një popull nomad i shpërndarë nëpër shkretëtira tē pafundme tē arabisë?

Po, vërtet eshtë ashtu! Ajo eshtë një drithë prej diellit tē realitetit. Cilido që nuk e ka futur këtë pikë në kokën e tij, ne do t'ia ngulim gadishullin arabik në syrin e mendjes së tij! Dhe tan ky ishull eshtë pas trembëdhjetë shekujsh dhe pasi njerëzimi eshtë ngjitur në shkallët e progresit dhe tē civilizimit!

Prandaj, o njeri kokëfortë! Zgjidh njëqind filozofë tē shquar dhe léri ata tē përipien pér njëqind vite dhe shiko në qoftë se ata do tē mund tē bënин një tē qindtën e asaj që bëri profeti Muhammed a.s.m. në kohën e tij. Dhe në qoftë se ata nuk munden, dhe nuk do tē jenë në gjendje, atëherë ruhu prej asaj që i ndodh kryeneçit!

Po, kjo gjendje eshtë e jashtëzakonshme dhe ajo eshtë vetëm se njëra nga mrekullitë e tij a.s.m..

Ti duhet ta dish gjithashtu se një person i cili dëshiron tē ketë sukses duhet tē veprojë- në përputhje me ligjet Hyjnore (*adatull-lah*), tē jetë i vetëdijshëm pér ligjet natyrore dhe t'u përshtatet lidhjeve

shoqërore, përndryshe gjendja e bashkëlindur e gjérave (*el-fitrë*) do t'i përgjigjet atij duke i mohuar suksesin dhe do ta ngatërrojë.

Gjithashtu, një person i cili ndjek një mënyrë -të veçantë- në shoqëri nuk duhet ta kundërshtojë rrjedhën e përgjithshme, përndryshe ajo -rrjedha- do tē veprojë kundra tij dhe jo pér tē.

Prandaj, në qoftë se një person ndihmohet nga suksesi brenda rrjedhës së përgjithshme, ashtu siç ishte Muhammedi a.s.m. provohet se ai eshtë kapur pas tē vërtetës.

Në qoftë se e ke kuptuar këtë, shqyrtoje tē vërtetën e shariatit: ti do tē shohësh se, pavarësish atyre përplasjeve tē mëdhaja dhe revolucioneve tē çuditshme në këto shekuj tē gjatë, ato kanë ruajtur balancën e ligjeve natyrale dhe tē lidhjeve shoqërore, tē cilat pér shkak tē hollësisë së tyre nuk janë tē dukshme pér mendjet e njerëzve (*el-ukul*) megjithëse janë plotësish në përshtatje e në harmoni me to. Sa më shumë tē kalojë koha, aq më e qartë bëhet ndërlidhja e tyre. Nga kjo gjendje bëhet e qartë se islami eshtë feja natyrale pér njerëzimin dhe se ajo eshtë e vërteta (*hakk*). Pér këtë arsy ai -islami- as nuk këputet as nuk hollohet. A nuk e shihni se antidoti kurues ndaj helmeve vrasës në shoqëri eshtë ndalimi i intereseve dhe i kamatës (*riba*) dhe detyrimi i dhënies së zeqatit? Dhe këto janë vetëm dy prej mijëra çështjeve tē shariatit.

Tani në qoftë se ti i ke njobur e kuptuar katër pikat e lartëpërmendura dhe tre pikat që erdhën pas tyre, dije gjithashtu se megjithëse Muhammed Hashimi a.s.m. ishte analfabet dhe as nuk mund tē shkruante dhe as tē lexonte, dhe nuk kishte fuqi tē jashtme dhe as sovranitet, as paraardhësit e tij nuk kishin, dhe megjithëse nuk kishte dëshirë pér dominim dhe pér sundim, qëndroi me ngulm me zemrën e tij, me konfidencën dhe me qetësinë e sigurinë në një pozicion me rrezikun më tē madh dhe me pozitën më tē rëndësishme, ai ndërmori një çështje me rëndësinë më tē lartë dhe pushtoi mendjet dhe u bë i dashuri i shpirtërave dhe sundoi mbi natyrat, dhe i shkulji prej thellësive tē zemrave tē tyre zakonet dhe praktikat e egra tē rrënjosura e tē vazhdueshme me tē cilat ishin mësuar; dhe pastaj mbolli në vend tē tyre me qëndrueshmërinë më tē skajshme, sikur duke i bashkëshkrirë ato me pikërisht mishin dhe gjakun e tyre, moralet e larta dhe zakonet e bukurë. Ai e zëvendësoi ashpërsinë e zemrave tē një populli tē

degjeneruar e të hedhur në qoshet e largëta të barbarisë e mizorisë me ndjeshmëri të holla dhe zbuloi xhevahirin e humanizmit të tyre. Ai i nxori ata nga barbarizmi i tyre dhe i ngriti tek kulmi i civilizimit dhe i bëri ata mësuesit e botës së kohës së tyre. Për ta ai themeloi një shtet që i gëlltiti shtetet -e tjerë- si shkopi i Musait a.s. Ai shtet u shfaq si një drithë flakëruese e shndritshme që dogji lidhjet -shoqërore- të tiranisë dhe të korruptionit, dhe në një kohë të shkurtër vendosi selinë e atij shteti -i cili u shtri në- lindje e në perëndim. A nuk provon kjo situatë se rruga e tij ishte e vërtetë dhe realitet, dhe se ai ishte i vërtetë në atë që pretendonte!

### Çështja e Gjashtë

Kjo është rreth faqes së të ardhmes, dhe veçanërisht rreth çështjes së sheriatit. Katër pika duhet të merren në konsideratë në këtë çështje:

**E Para:** Edhe sikur të ishte i jashtëzakonshëm, një person mund të bëhet ekspert dhe mjeshtër në vetëm katër ose pesë shkenca.

**Pika e Dytë:** E njëjta fjalë -ligjëratë- mund të ndryshojë me daljen e saj prej folësve; Atëherë ashtu siç mund të tregojë ajo cektësinë dhe injorancën e një personi, ajo mund të tregojë aftësinë dhe mjeshtërinë e një tjeteri- ndonëse fjalët janë të njëjta. Sepse njëri prej tyre shikon burimin dhe përfundimin e asaj që ai thotë, dhe kontekstin e saj dhe atë që e paraprin, ai mendon pér të në lidhje me vëllezërit e saj -gjërat e tjera- dhe e vendos atë në mënyrë të përshtatshme. Ai e përdor atë shumë me vend dhe kërkon një tokë pjellore pér ta mbjellur. Nga kjo kuptohet se ai është një -folës- i vetëm dhe ka pronizuar subjektin rreth të cilit ai është duke folur. Të gjitha frazat përbyllëse të lidhura me shkencat dhe me atë që ata kanë mbledhur, janë prej llojit të lartëpermendur.

**Pika e Tretë:** Pér shkak të plotësimit të mënyrave dhe të mjeteve shumë gjëra që tani -janë- të zakonshme dhe madje lojra pér fëmijë, para dy shekuje konsideroheshin mrekulli. Prandaj ajo që e ruan rininë e saj, freskinë dhe veçorinë mbi këto shekuj të gjatë sigurisht duhet të jetë e jashtëzakonshme dhe e veçantë (duhet të jetë prej të jashtëzakonshmeve dhe prej të zakonshmeve të të jashtëzakonshmeve).

**Pika e Katërt:** Udhëzimi do të ishte i dobishëm vetëm në qoftë se i përgjigjet kapacitetit intelektual (të shumicës së njerëzve). Dhe shumica absolute janë njerëz të zakonshëm, dhe njerëzit e zakonshëm nuk janë të aftë ta shohin e ta shqyrtojnë të vërtetën e mirëfilltë, të zhveshur; ata janë mësuar ta shohin atë të veshur vetëm në veshjen e imaginatave të tyre familjare. Pér shkak të kësaj, Kur'an i pikturnon dhe i paraqet të vërteta të atilla në formën alegorike (*muteshabihat*), me metafora (*istiare*) dhe me krahasime (*teshbih*), dhe ai i mbron masat e njerëzve, të cilët nuk kanë përparuar, nga rënia në humnerën e gabimit. Kështu, ajo është e vagëlluar dhe e errët në çështjet të cilat masat domosdoshmërisht i besojnë me shikimin e tyre emocional sipërfaqësor (*bil his-si edh-dhahir*) të janë në kundërshtim me realitetin, megjithatë ai aludon pér to dhe e tregon të vërtetën.

Në qoftë se ti i kap këto pika, tani *shqyrtoje këtë*: feja islame dhe sheriatit janë themeluari mbi provën racionale, dhe janë përbledhja dhe substanca e degëve të njohjes dhe përfshijnë esencën jetike të të gjitha shkencave themelore:

Shkencën e pastrimit të shpirtit, të trajnimit të zemrës, të edukimit të ndërgjegjjes, dhe shkencën e organizimit shtëpiak, shkencën e qeverisjes lokale dhe atë të lidhjeve ndërkombëtare, dhe shkencat ligjore -jurisprudencën, dhe shkencën e lidhjeve humane, atë të etikës shoqërore, dhe kështu me radhë. Pér më tepër, sheriatit shpjegon dhe sqaron aty ku është e domosdoshme ose e nevojshme, dhe është i përbledhur, i thukët aty ku kjo nuk është e domosdoshme ose që mendjet -e njerëzve- nuk janë të gatshme, ose kohët nuk e lejojnë, dhe parashtron parimet që mund të shtjellohen, të deduktohen dhe të shpjegohen nëpërmjet konsultimit dhe ushtrimit të arsyes.

Në kohën e tanishme, të gjitha këto shkenca ose madje një e treta e tyre pas një mijë e tre qind viteve -duke u shtuar nëpërmjet takimit të mendjeve dhe shtrirjes së rezultateve të tyre- nuk mund të gjenden në një person të vetëm madje as në vendet e civilizuara dhe midis njerëzve të zgjuar. Prandaj, Ai që stolis ndërgjegjjen e tij me drejtësi do të konfirmojë se e vërteta e këtij sheriatit është gjithmonë përtej fuqisë humane, dhe ishte veçanërisht kështu në atë kohë.

Dhe ai do të mbështesë pohimin “Ju as nuk keni qenë në gjendje ta bëni atë dhe as nuk do të jeni në gjendje pér ta bërë”.

Virtyti eshtë ajo që njihet e dëshmohet madje edhe nga armiqtë. Sepse filozofi Amerikan Čarli<sup>5</sup> citoi letrarin e Shqar gjerman Göte i cili pasi hodhi vështrimin tek tē vërtetat e Kur'anit Kerim, tha me çudi: "A do tē mund tē ishte bota e civilizuar më e avancuar brenda limiteve tē islamit? Dhe ai u përgjigj me vete: Po, nē tē vërtetë! Sepse nga një aspekt dijetarët tani përfitojnë prej tij", Čarli gjithashtu tha se islami u shfaq si një dritë flakëruese dhe i përpiu fetë e kohës. Dhe ai ka tē drejtë ta bëjë këtë, sepse ai nuk përbante asgjë prej "zhangëllimave tē kota" tē disa sekteve krishtere ose zhurmat... sofizmat e çifutëve.

Ai konfirmoi kuptimin e vërsetit:

فَاتُوا بِسُورَةٍ مِّنْ مُّثُلِهِ \* فَإِنْ لَمْ تَفْعِلُوا وَلَنْ تَفْعِلُوا فَاقْتُلُوا النَّارَ

"... Atéherë bëni edhe ju një sure tē njashme si ajo (e Kur'anit)... Por nëse nuk e bëni dot atë dhe ju kurrë nuk mund ta bëni atë, atéherë k'nie frikë zjarrin - xhehennemin<sup>6</sup>".

• Në qoftë se ti do tē pyesje: Kur'ani Kerim, po ashtu shpjeguesi i tij -dua tē them hadithi- vetëm kanë marrë përbledhjet nga tē gjitha shkencat, por a nuk eshtë e mundur pér një individ tē vetëm që tē përfshijë përbledhje tē shumta?

*Ty do tē tē thuhej:* Nëpërmjet vendosjes së tyre me vend dhe përdorimit tē tyre tē përshtatshëm nē tokë pjellorre, nē çështjet pér tē cilat vetëm aludohet -ashtu siç kemi treguar nē pikën e dytë lartë-përbledhje tē tillë zbulojnë si xhami një njohje tē plotë tē shkencave - nē çështje- dhe një mjeshtëri tē plotë nē tē.

Kështu përbledhja bëhet si shkenca dhe ajo nuk do tē ishte e mundur pér një person tē tillë (siç e përmende ti pér ta përfshirë).

Tani kupto se konkluzioni i argumenteve tē lartëpërmendur eshtë se së pari ju duhet tē mbani nē mendje rregullat vijuese: "Një person nuk mund tē jetë specialist nē një shumicë shkencash; e njëjtë ligjeratë, ose

<sup>5</sup> Historian i famshëm dhe filozofi Thomas Čarli (1795-1881) ishte nē fakt skocez. Ai lindi nē Skoci e vdiq nē Londer. Čarli lavdëronte disiplinën morale dhe drejtimin që islami dhe profeti i tij u jepnin ndjekësve, ndërsa nē tē njëjtën kohë duke mos mohuar gjërat e kënaqshme tē jetës.

<sup>6</sup> Kur'an, 2 :23-24

tē njëjtat fjalë ndryshojnë -kur ato shprehen nga- dy njerëz (tē ndryshëm); (kur shprehen nga) njëri ato do tē jenë flori dhe -kur fliten nga- tjetri ato do tē jenë qymyr; shkencat rezultojnë prej takimit të mendjeve dhe plotësohen me kalimin e kohës; shumë çështje që ishin teorike nē tē shkuarën janë tani tē vetëkuptueshme; tē krahosh tē shkuarën me tē tashmen do tē ishte krahasi i rremë (ndryshimi midis tyre eshtë shumë i madh; pér shkak tē thjeshtësisë së tyre dhe tē çiltërsisë banorët e shkretëtirës nuk mund ta fshehin dredhinë dhe mashtrimin ashtu siç mund tē fshihen këto poshtë perdes së civilizimit; shumë prej shkencave rezultojnë vetëm nga ngulitja e zakoneve nē natyrën njerëzore dhe duke i mësuar asaj ngjarjet dhe rrethanat kur koha dhe mjedisi janë favorizues; drita e vizionit tē njeriu nuk mund tē depértojë tek e ardhmja dhe ai nuk mund t'i perceptojë rrethanat e saj tē veçanta; ashtu si jeta njerëzore që ka një jetëgjatësi tē natyrshme e cila vjen nē një fund, po ashtu, edhe ligjet kanë një jetëgjatësi tē natyrshme që vijnë nē një fund, natyrisht; dhe nē kufijtë e kohës dhe tē vendit mjedisi ka një ndikim shumë tē madh nē gjendjen e njerëzve...

Dhe shumë prej çudirave tē së shkuarës janë bërë gjëra tē zakonshme nëpërmjet plotësimit tē mjeteve, parimeve; dhe zgjuarsia njerëzore edhe sikur tē ishte e jashtëzakonshme, nuk eshtë nē gjendje tē krijojë një shkencë dhe ta plotësojë atë përnjëherësh, por ashtu si fëmija gradualisht; (zhvillimi i shkencës eshtë gradualisht).

Tani që ti i ke vendosur këto çështje nē kokën tēnde dhe mund t'i përfytyrosh ato, çliroje veten nga imaginatat e së tashmes dhe nga iluzionet e mjedisit tē saj, dhe zhytu nē detin e kohës prej bregut tē këtij shekulli. Pastaj kalo nën ujë deri kur ti tē shfaqesh, tē dalësh tek shekulli i lumturisë dhe shiko Gadishullin Arabik. Ngrijë kokën tēnde dhe vishe veten tēnde me idetë që ajo kohë i qepi pér ty, dhe pastaj hidhe vështrimin tek ajo shkretëtirë shumë e gjërë! Ajo çfarë tē shfaqet ty nē fillim eshtë një person i vetëm i cili ndonëse pa ndihmës e pa fuqi -pushtet- eshtë duke sfiduar më vete tē gjithë botën; ai eshtë duke kundërshtuar gjithkënd.

Ai po mban nē shpatullat e tij një tē vërtetë më tē madhe e më tē lavdishme se sa globi tokësor. Ai eshtë duke mbajtur nē dorën e tij një sheriat që garanton lumturinë e tē gjithë njerëzve. Ky sheriat i tij eshtë sikur përbledhja dhe substanca e tē gjitha shkencave Hyjnore dhe e shkencave tē realitetit. Ai sheriat eshtë i gjallë jo si veshja por si lëkura,

dhe zgjerohet e shtrihet me rritjen e potencialeve njerëzore, duke prodhuar frutat e lumburisë nē këtë botë dhe nē tjetrën. Ai i organizon dhe i rregullon gjendjet dhe çështjet e njerëzimit sikur tē gjithë njerëzit tē ishin anëtarët e një tubimi tē vetëm. Në qoftë se ligjet e tij do të pyeteshin se prej ku kanë ardhur dhe pér ku janë drejtuar, ato ligje -tē atij sheriati- do tē përgjigjeshin nëpërmjet gjuhës së mrekullisë së tyre: "Ne vjmë nga ligjëratë e parapërjetshme -Hyjnore- dhe ne do ta shoqërojmë mendimin njerëzor nëpër tē gjithë përfjetësinë. Kur bota mbaron, ne nē dukje do tē ndahemi nga njerëzit lidhur me obligimet fetare, por përgjithmonë do t'i shoqërojmë ata me anë tē misterit tē kuptimeve tona dhe do t'i ushqejmë shpirtërat e tyre dhe do t'i ndihmojmë e do t'i udhëzojmë ata".

Tani, ajo që ti ke parë deri këtu, a nuk reciton pér ty vërsetin me urdhërin e tij përqeshës.

**Tani shqyrtoje këtë:** Vërseti tregon se pér shkak se disa njerëz janë tē pakujdesur e tē pavëmendshëm pér atë që synon "*el-sha'riū*" "*Liqvénesi*" nē udhëzimin e masave tē njerëzve dhe janë injorantë pér domosdoshmërinë e dhënes udhëzim nē përpjesëtim me kapacitetin e tyre mendor, ata bien nē dyshime, burimi i tē cilëve janë tre çështje:

**E Para:** Ata thonë: "Ekzistenza e vërseteve alegorike dhe e pakuptueshmërive -paqartësive- nē Kur'an eshtë nē kundërshtim me mrekullinë, e cila bazohet mbi elokuencën (*el-belagah*), dhe elokuanca bazohet mbi qartësinë e shprehjes.

**E Dytë:** Ata thonë: Kur'ani eshtë i vagëlluar -i paqartë, i errët nē çështje- dhe i përgjithshëm lidhur me tē vërtetat e krijimit dhe me shkencat fizike (*funun el-ka'inat*), por kjo eshtë nē kundërshtim me rrugën dhe metodën e tij (*meslek*), e cila eshtë tē japë mësim dhe tē japë udhëzim.

**E Treta:** Ata thonë: "Disa nga kuptimet e fjalëpërfjalshme, tē jashtme, tē mirëfillta, priren tē jenë nē kundërshtim me provat racionale saqë mund tē jenë nē kundërshtim me realitetin, dhe kjo eshtë nē kundërshtim me vërtetësinë e tij.

**Përgjigja:** Suksesi eshtë vetëm nga Allahu. O ju dyshues, dëgjojeni këtë! Ajo çfarë ju e supozoni tē jenë shkaqet e defektit, nē realitet janë dëshmi tē vërteta pér misterin e mrekullisë së Kur'anit.

**Përgjigjja pér dyshimin e parë**, e cila eshtë ekzistensa e alegorive dhe e pakuptueshmërive, paqartësive.

Udhëzimi i Kur'anit eshtë pér tē gjithë njerëzit, dhe shumica e tyre janë njerëz tē zakonshëm. Në -çështjet- e udhëzimit pakica ndjek shumicën, sepse kur u bëhet adresimi njerëzve tē zakonshëm, klasat e edukuara dhe tē arsimuara përfitojnë prej tij dhe marrin pjesën e tyre.

Por, në qoftë se e kundërtatë eshtë e vërtetë, njerëzit e zakonshëm privohen -nga pjesa e tyre.

Masat e njerëzve nuk mund t'i çlironjnë mendjet e tyre prej asaj që ata janë mësuar dhe prej gjërave imaginare, dhe prandaj janë tē pamundur t'i kapin e t'i kuptojnë tē vërtetat e zhveshura (tē thjeshta tē mirëfillta) dhe idetë abstrakte veçse nëpërmjet teleskopit tē imaginatave tē tyre dhe duke i piktuuar e paraqitur gjërat -në mënyrë-familjare e tē njobura pér ta. Por me kusht që shikimi e vëmenda e tyre tē mos ndalojë e tē fiksohet mbi format e jashtme (tē aytre gjërave që kjo tē mos bëjë tē domosdoshme diçka tē pamundur si trupëzimin e tyre ose pasjen e "anëve"; përkundrazi ata duhet tē shohin përtëj (formës) tek tē vërtetat (prapa tyre).

Pér shembull, masat -e njerëzve tē zakonshëm- vetëm mund ta përfytyrojnë tē vërtetën e autoritetit -veprimit Hyjnor nē univers nē formën e një mbreti tē ulur mbi fronin e fuqisë së Tij duke ushtruar pushtetin mbi sundimet e Tij. Pér këtë aryse (Kur'ani) zgjedh -pér tē përdorur- një metonimi nē vërsetin:

الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَ  
"I Gjithëmëshirshi u ngrit lart dhe qëndroi mbi Arsh 'Isteva'..." Meqenëse ndjenjat e masave tē njerëzve janë kështu, atëherë eshtë e domosdoshme sipas elokuencës dhe udhëzimit që tē kuptuarit e tyre tē merret parasysh, dhe ndjenjat e tyre tē respektohen, dhe mendjet e tyre tē pranohen -të pranohet mendimi i tyre-, dhe tē bëhet lejueshmëria pér idetë e tyre. Ashtu si dikush që flet me një fëmijë që i duhet tē zbresë tek niveli i tij me qëllim që fëmija tē mund tē kuptojë nē një mënyrë familjare, tē njobur. Figurat letrare dhe stilet e Kur'anit (*el-eslib el-Kur'anijeh*) nē vende tē tilla që tregojnë respekt

<sup>7</sup> Kur'an, 20:5

për masat e njerëzve, quhen: “*Begeni –zbritje*”- Hyjnore pér mendjet e njerëzve

**التَّرْلَاتُ الْأَنْبِيَّةُ إِلَى عُقُولِ الْبَشَرِ**  
*(el-tenez-zulat ilahijeh ila ukul el besher)*. Kjo begeni është pér t'i lehtësuar mendjet e njerëzve. Pér këtë aryse ai i vendos format -e paraqitura nga- vërsetet alegorike përparrasyve të njerëzve si teleskopë. A nuk ke parë se si shumica e letrarëve elokuentë i përdorin figurat e ligjëratës (*el-istiarat*) pér të piktuuar e paraqitur kuptimet e holla ose pér të portretizuar e përshkruar ide të ndryshme. Kështu, vërsetet alegorike janë figurat e ligjëratës së një lloji të pakuptueshëm e të errët (*ga'mid*) pasi ato piktuojnë të vërtetat të pakuptueshme, të errëta.

Sa pér ndodhjen e shprehjeve të paqarta, të ngatërruara (*mushkil*), kjo është pér shkak ose të hollësisë dhe të thellësisë së asaj që ato shprehin, dhe të thukëtisë dhe lartësisë së stilit, dhe pakuptueshmëritë e Kur'anit janë të këtij lloji; ose pér paqartësinë – në dykuptueshmërinë- e fjalëve dhe të shprehjeve të ndërlikuara e të ngatërruara, të cilat janë në kundërshtim me elokuencën, dhe Kur'ani është i përjashtuar prej kësaj.

Tani, o ju skeptikë! A nuk është thjesht elokuencë e pastër që në mënyrë të lehtë t'i sjellësh afër pér -shkallën- e të kuptuarit të njerëzve të zakonshëm këto të vërteta të thella të cilat janë shumë të largëta prej mendimeve të tyre (masave)? Sepse elokuanca është të flasësh në përputhje me çdo situatë të dhënë siç e kërkon situata. Shqyrtoje mirë këtë.

Përgjigjja pér dyshimin e dytë, i cili është paqartësia e Kur'anit lidhur me formimin e krijimit, ndonëse shkencat moderne janë të qarta -ndonëse e kanë shpjeguar atë shkencat moderne. Kupto se të përfshira në pemën e botës është prirja -dëshira- pér t'u plotësuar (*mejl el-istikmal*), prej degëve të së cilës prirja pér të përparuar gjendet tek njeriu. Prirja pér të përparuar i ngjason një fare që mbin dhe rritet si një rezultat i eksperimenteve dhe i provave të shumta, dhe merr formë dhe shtrihet nëpërmjet takimeve të mendjeve -dhe shkëmbimit të ideve- dhe prodhon frutat e shkencave të njëpasnjëshme, me radhë, ku e mëvonshmjë -vijuesja- nuk mund të vijë veçse pasi e mëparshmjë të ketë ardhur në ekzistencë, dhe e mëparshmjë mund të jetë veçse paraprake -parathënie- pér atë që është vijuese pasi ajo të jetë pranuar e

të jetë e njohur në përgjithësi. Si rrjedhojë, në qoftë se para dhjetë shekuish një person donte të jepte mësim ndonjë art apo të bënte të kuptueshme ndonjë shkencë -duke kujtar se shkencat lindën vetëm si rezultat i eksperimenteve të shumta- dhe t'u bëjë thirrje njerëzve pér tek ajo, e gjitha që do të kishte bërë do të kishte qenë pér t'i ngatërruar mendjet e tyre dhe do t'i kishte bërë ata të binin në gabime e sofistikë. Pér shembull, në qoftë se Kur'ani do të kishte thënë: “*O njerëz! Shikojeni diellin e palëvizshëm, e qëndrueshëm dhe rrotullimin e tokës dhe luzmimin -tubimin- e miliona qënieve të gjalla në krijim që të përfytyroni madhështinë e Krijuesit*”, kjo do t'i kishte çuar masat -e njerëzve ose në mohim, ose të mashtonin vetveten ose të konkuronin me të. Sepse pér shkak të shikimit të tyre sipërfaqësor -ose të shikimit të tyre të gabuar- ata shohin rrafshësinë e tokës dhe rrotullimin e diellit si të vetëkuptueshme dhe të dukshme.

Kështu vërtet, të ngatërrosh mendjet e njerëzve, dhe sidomos pér një periudhë njëmijëvjeçare vetëm pér të kënaqur disa njerëz të kohëve tona do të kishte qenë në kundërshtim me udhëzimin e urtë dhe në kundërshtim me shpirtin e elokuencës. O shok! Mos pandeh se ti mund të bësh analogji midis çështjeve teorike të së ardhmes dhe kushteve të ahiretit. (Domethënë, mos supozo se çështjet e ahiretit dhe kushtet e tij që janë të panjohura pér ne, të jenë të ngjashme me çështjet teorike që do të zbulohen në të ardhmen). Sepse meqenëse shqiset e jashtme nuk mund të perceptojnë -kapin- asnjë aspekt të (çështjeve të Ahiretit) ato mbeten brenda caqeve të të mundshmes dhe mund të besohen me besim të plotë. Ajo që ato në mënyrë të qartë kërkojnë është që të shpjegohen e sqarohen. Por, kur vjen tek subjekti ynë (zbulimet e shkencës) meqenëse në shikimin -e njerëzve të atyre kohëve- ato ishin jashtë limiteve të mundësisë dhe të probabilitetit, dhe pér shkak të perceptimeve të gabuara të tyre (ajo që atë menduan të jetë e vërtetë) ishte e vetëkuptueshme, ajo çfarë kërkohej në shikimin e elokuencës ishte pér ato zbulime (pér t'u përmendor) në (terma) të paqarta e të përgjithshme nga respekti pér ndjenjat e njerëzve dhe kështu pér të mos i ngatërruar mendjet e tyre. Megjithatë, Kur'ani tregon, aludon, dhe bën aluzione pér të vërtetën, dhe hap derën pér mendjet dhe i fton ato pér të hyrë duke vendosur shenjat dhe kuptimet e shoqëruara (*kara'in*).

O shok! Në qoftë se je i drejtë reflekti mbi rregullin “folu njerëzve në përputhje me nivelin e tyre të të kuptuarit, dhe kupto se meqenëse kohët dhe mjetidi i këtyre njerëzve nuk i kishin pajisur ata mendërisht,

ata duhej tē kishin qenē tē pamundur t'i pērkrahnin apo t'i mbēshtetnin çeshtje tē tilla (si zbulimet e shkencës), tē cilat u lindën mē vonë prej takimit tē mendjeve dhe lidhjes sē ideve, dhe do tē pranoje e njihje se zgjedhja e Kur'anit pēr tē qenē i paqartë dhe i pērgjithshëm eshtë thjesht elokuencë e pastër dhe dëshmi e mrekullisë sē tij.

**Përgjigjja pēr Dyshimin e tretë**, që eshtë disa prej kuptimeve tē fjalëpërfjalëshme tē vërseteve që priren tē jenë nē kundërshtim me dëshmitë racionale dhe me zbulimet e shkencës.

**Shqyrtoje këtë:** Qëllimi kryesor i Kur'anit eshtë tē instruktojë masat e njerëzve (*el-xhumhur*) rrëth katër parimeve tē tij themelorë, tē cilët janë prova e Autorit tē vetëm, profetësia, ringjallja e tē vdekurve dhe drejtësia. Kështu, përmendja e universit nga ana e tij eshtë dytësore dhe e shmangur pēr qëllimet e deduksionit (*el-istidlal*), sepse ai nuk u shpall pēr tē dhënë mësim gjeografinë apo kozmografinë (astronominë). Ai e përmend universin me qëllim që tē deduktojë e tē nxjerrë si përfundim prej artit Hyjnor nē tē dhe prej sistemit tē mrekullueshëm (ekzistencë e) Rregullatorit tē Vërtetë xh.sh., fakti eshtë se gjurmët e artit, tē qëllimit dhe tē rregullit shfaqen nē tē gjitha gjërat, por si ato u formuan nuk ka tē bëjë me ne meqenëse ajo nuk eshtë e lidhur me qëllimin kryesor. Sepse duke parë se Kur'ani flet pēr qënet pēr qëllime deduksioni, dhe duke parë se ekzistanca e tyre duhet tē ngrihet para propozimit -parashtrimit- dhe duke parë se dëshmia duhet tē jetë e qartë, si do tē ishte e mundur që udhëzimi dhe elokuanca tē mos e bënin tē domosdoshme që -Kur'ani- duhej tē prirej e tē anonte me disa prej kuptimeve tē tij tē jashtme ose tē fjalëpërfjalëshme (*dhava'hir el-nusus*) drejt pikëpamjeve tē tyre emocionale dhe njohjes letrare, duke bërë lëshime pēr ta? Kuptime tē tilla nuk janë pēr tē afirmuar dhe as pēr tē treguar njohjen e tyre, por janë aluduese (*min Kabil el-kinajet*) ose shprehje shoqëruese (*mustat beat el terakih*). Prandaj Kur'ani përfshin shenja e tregues pēr hetuesit e sē vërtetës (*ehl- el-tahkik*) që tregojnë tē vërtetën.

**Pēr shembull:** Nē qoftë se Kur'ani Kerim do tē kishte thënë kur paraqet argumentin e tij "*fi mekam el-istidlal*", "*O ju njerëz!*"

Shqyrtoni rrëth qënies sē diellit i palëvizshëm ndonëse nē dukje ai lëviz dhe rrotullimin e përditshëm e vjetor tē tokës megjithëse nē dukje ajo eshtë e palëvizshme, dhe reflektoni mbi gravitetin e

jashtëzakonshëm midis yjeve (duke i mbajtur yjet nē vend). Dhe vështroni mrekullitë e elektricitetit, dhe kombinimet e pafundme tē shtatëdhjetë elementeve, dhe grumbullimin e mijëra mijëra organizmash tē panumërt nē një pikë uji, që ta mësoni se Allahu eshtë i Gjithëfuqishëm pēr tē gjitha gjërat!" Nē qoftë se ai do tē kishte folur kështu, dëshmia duhet tē kishte qenë më e errët dhe shumë më pak e qartë se sa u pretendua, dhe kjo eshtë nē kundërshtim me rregullat e deduksionit.

Pēr më tepér, meqenëse (kuptimet e fjalëpërfjalëshme tē vërseteve që nē dukje priren ta kundërshtojnë shkencën) janë aluduese, kuptimet e tyre nuk janë as tē vërteta as tē rreme (domethënë, kuptimet e tyre nuk duhet tē merren fjalë pēr fjalë, nē kuptimin e mirëfilltë)

A nuk e shikon ti se **لِإِلِيٰ فَالْكَافُ كَافٌ** "Ka'le" tregon lehtesi, kështu nuk ka asnje ndryshim nëse rrënja e tij eshtë **جَ** "ja" apo **وَ** "wav", **كَفٌ** "Kef" apo **كَافٌ** "Kaf"?

**Shkurtazi:** Meqenëse Kur'ani u shpall pēr tē gjithë njerëzit e tē gjitha kohëve, këto tre pika (tē cilat mendohen tē shkaktojnë dyshime) janë dëshmi tē mrekullisë sē tij. Unë betohem (pēr Allahun) i Cili dha mësim Kur'anin e mrekullueshëm, se shikimi i Sihariquesit dhe i paralajmërueshit dhe intuita dhe mendjemprehtësia e tij kritike ishin më tē holla, më tē ndritshme dhe më depërtuese se sa tē përzuhej e tē ngatërhohej tek ai e vërteta me imaginatën; dhe rruga e tij e së Vërtetës ishte më e pastër, më e lartë e më sublime se sa t'i mashtronë apo t'i çudhëzonte njerëzit.

### Çështja e Shtatë

Librat e biografisë së profetit dhe veprat e historisë kanë përshkruar shumë prej mrekullive tē tij tē perceptueshme (*muëxhizat mahsusa*), dhe çudirat e famshme që ai i kreu nē praninë njerëzore, dhe këto janë komentuar nga dijetarët kryesorë e autoritarë. Meqenëse tē japhë mësim diçka që tashmë eshtë e njohur do tē ishte e tepërt dhe e panevojshme, ne ua referojmë diskutimin e detajuar librave tē tyre dhe

këtu ne do të përbledhim -mrekullitë- duke përmendur (vetëm) kategoritë e tyre.



Kjo formë e çuditshme nuk u shfaq rastësisht në mes të këtij diskutimi të gjërave të çuditshme, sepse ndërsa po shkruaja një kopje në *Dijar Bekir* tek shtëpia e Xhevdet Beit me 19 Shubat (3 mars 1916) në natën (para) të premtes, Bitlisi ra dhe autorri (*Bediuzzaman*) u zu rob. Forma e çuditshme (e bojës së derdhur) në këtë faqe në atë natë ishte një shenjë -por Alalhu e di më së miri- prej gjakut të derdhur të atyre studentëve të Bediuzzamanit të cilët ishin dhe të cilët u burgosën atë natë në Bitlis. (Abdul Mexhid).

Për më tepër, (kjo bojë e derdhur) mori formën e një gjarpëri, bishti i të cilit rrëthoi autorin dhe koka e të cilit ishte këputur. Kjo (tregonte) rusët. Ajo gjithashtu pikturonte e përshkruante tubacionin -ujësjellësin- në të cilin u plagos autorri, ku ai mbeti për tridhjet orë duke pritur vdekjen në çdo moment. (Hamzai)

Lidhur me çudirat e dukshme të profetit: megjithëse secila prej tyre është transmetuar nga vetëm një burim (*ehadijen*) dhe nuk ka konsensus në lidhje me to (*gajr mutevet-tir*), por si një lloj dhe duke qenë shumë prej këtyre kategorive ato mund të konsiderohen si të raportuara unanimisht për sa ka të bëjë me kuptimet e tyre (*mute vet-tir bil-maëna*). Ato përbëhen nga *tre kategori*:

**E Para:** Ngjarjet e ndryshme që ndodhën para misionit profetik por që lidhen me të, të quajtura "*Irhasat*". (Këto përfshinë) zjarrin e zoroastrianeve duke u shuajtur, tharjen e likenit të Savës, çarja më dysh e portikut -*hajatit*- të Kisras, dhe parashikimet e zërave të fshehur. Madje një person do të mund të imaginonte se shekulli në të cilin u lind i Dërguari a.s.m. u bë një shekull i lartë i ndjeshëm me keramet dhe sihariqoi e parashikoi me parandjenjë ardhjen e tij.

**Kategoria e Dytë:** Shumë parashikime të së ardhmes, duke përfshirë pushtimin e thesareve të sundimtarëve të Persisë dhe të Bizantit, mposhtjen e Bizantit, pushtimin e Mekës, dhe kështu me radhë. Sikur shpirti i pastër -jolëndor- dhe fluturues -i profetit- i grisi limitet e kohës së caktuar dhe të vendit të fiksuar, dhe shëtitit në viset -anët- e së ardhmes, pastaj na tregoi neve atë që ai pa.

**Kategoria e Tretë:** Çudirat që do të mund të kapeshin nga shqisat fizike dhe u kryen gjatë -periudhës së- sfidimit të tij (rregullin ekzistues) dhe gjatë thirrjes së tij (për tek islami). (Këto përfshinë) gurët duke folur, pemët duke lëvizur, çarjen më dysh të hënës, dhe ujin duke vërvuar (nga gishtërinjtë e tij).

Zamahsheriu pohoi se ndodheshin një mijë (mrekulli) prej kësaj kategorie. Disa prej këtyre janë raportuar unanimisht por jo të fjälëpërfjalëshme (*mutevet-tir bil-maëna*). Në fakt, edhe ata të cilët e

mohuan Kur'anin, nuk mund ta falsifikonin e ta preknin vërsetin “*Dhe hēna u ça mē dysh*<sup>8</sup>

• *Në qoftë se ti do të pyesje:* Diçka si çarja më dysh e hënës duhej të ishte bërë e famshme botërisht dhe të ishte bërë e njohur për gjithëkënd?

*Ty do të tē thuhej:* (Faktorët si) ndryshimet në kohën e Lindjes së saj, dhe ekzistanca e reve, dhe duke pasë vetëm pak vëzhgim ndaj trupave qiellorë në atë kohë, dhe ndodhja e saj në një orë kur (njerezit ishin) të pavëmendshëm, gjatë natës, dhe ndodhja e çarjes më dysh të saj menjëherë, në çast, e gjitha kjo do të thotë se nuk duhej ta kishin parë të gjithë njerezit ose shumica e tyre.

Megjithatë, është vërtetuar në rrëfenja se ajo -çarja më dysh e hënës- u shikua prej shumë karvanëve për të cilët pozicioni i hënës ishte i ngashëm me atë (të Mekës).

Pastaj, kryetari i këtyre mrekullive është Kurani i qartë, mrekullia e provuar e të cilit në shtatë aspekte tregohet nga ky vërset (2 :23).

O shok! Në qoftë se ti i ke kuptuar këto çështje dëgjoje tanë atë që do të tregohet rrëth tre aspekteve të pozicionimit të vërseteve dhe të rendit të fjalëve: pozicionimi i vërsetit në lidhje me atë që e parapriu; pozicionimi (dhe lidhjet) e disa prej frazave të tij; dhe pozicionimi (dhe lidhjet) e pjesëve të frazave.

**Për sa ka të bëjë me të parën: ndodhen dy aspekte për lidhjen e këtij vërseti dhe të vërseteve paraprijës:**

**I Pari:** Sipas komentit të Ibn Abbasit, kur me qëllim që të provohet uniteti Hyjnor (Kur'ani) thotë: *بِأَيْمَانِ النَّاسِ أَعْبُدُوا* *Ja ej-juhen-nas*, “O ju njerez”, ai gjithashtu provon profetësinë e Muhammedit a.s.m., i cili ishte prova më e qartë e unititetit Hyjnor. Tani, profetësia provohet nga mrekullitë. Më e madhja e mrekullive ishte Kur'ani. Dhe faqja më e hollë e mrekullisë së Kur'anit qëndron në elokuencën e renditjes së fjalëve të tij (*nadhmu*).

<sup>8</sup> Kur'an, 54: 1

Muslimanët pajtohen në mendim se Kur'ani është i mrekullueshmë dhe i paimitueshmë. Dijetarët kryesorë e autoritarë ndryshojnë për sa ka të bëjë me mënyrat në të cilat kjo është kështu. Megjithatë, këto mënyra nuk përplasen e nuk kundërshtojnë, sepse disa preferojnë një aspekt (dhe të tjerët një aspekt tjeter). Disa thonë se mrekullia e tij qëndron në parashikimin e tij të ardhmen; sipas të tjerëve, ajo është sjellja e tij bashkë me (të gjitha) të vërtetat dhe shkencat; të tjerët pojojnë se është çlirimi i tij prej kontradiktave dhe mangësive; sipas të tjerëve, ajo është originaliteti i stileve të tij dhe veçantia e fillimeve dhe i fundeve të vërseteve dhe të sureve të tij; të tjerët thonë se ajo është shfaqja e tij prej dikujt analafabet i cili nuk dinte as të shkruante dhe as të lexonte; sipas të tjerëve ajo ishte qënia e tij kaq elokuent në mënyrë të jashtëzakonshme saqë është përtej fuqisë njerezore; dhe kështu me radhë. Njohja e detajuar e këtij llojit -të fundit- të mrekullisë mund të arrihet duke studiuar komentet Kur'anore të tilla si ky komentim; ose ai mund të mësohet në mënyrë të përbledhur në tre mënyrat (vijuese), ashtu siç u vërtetua dhe u konstaua nga Abdul Kahir el-Xhurxhani, Profesori i Elokuencës (*el-Shejh el-belagah*), dhe nga Zamahsheriu, dhe el-Sek-kaki dhe el-Xha'hiz:

### Mënyra e Parë:

Njerezit arabë ishin nomadë analafabetë -të cilët jetuan- në një mjedis të rrallë, të jashtëzakonshëm që iu përshtat atyre. Ata u zgjuan nga revolucionet e mëdhaja -që ndodhën- në botë. Librat -e vetme- të tyre (*divanuhum*) (të krenarisë së tyre të përdorur përbëheshin nga) poezia; dhe shkenca e tyre (e vetme) ishte retorika (*el-belagah*); dhe (burimi) i krenarisë së tyre dhe i mburrësisë ishte ligjërata elokuente (*el-fesaha*) në panaire të tilla si “*Ukaz*”. Ata ishin më të zgjuarit e njerezve dhe prandaj më të nevojshëm për ushtrim mendor dhe aktivitet, dhe mendërisht ata po përjetonin një periudhë të rinisë mugulluese -përjetonin stinën e pranverës.

Pastaj Kur'ani i shenjtë lindi mbi ta elokuencën e tij madhështore dhe ndriçoi elokuencën e tyre, të përfaqësuar nga shtatë poemat e varura (*el-mual-leka es-seb'a*), të shkruara me ar -të varura- në muret e Qabesë. Pavarësisht qënies së tyre oratorë elokuentë -komandantët e retorikës dhe të elokuencës dhe sunduesit e arabishtes korrekte- ata nuk mundën ta kundërshtonin as të shprehnin një fjalë të vetme në debat,

pavarësish përqeshjeve dhe fyerjeve të rënda të tē Dërguarit a.s.m., kritikës së tij dhe qortimeve ndaj tyre, diskretimit të intelektit të tyre dhe duke i provokuar ata pér një periudhë të gjatë, dhe poshtërimi që ai u bëri atyre ndonëse disa prej kokave të oratorëve të tyre prekën qiejt me krenarinë e tyre dhe të tjerët arritën yjet. Kështu, në qoftë se ata nuk do të kishin dashur ta kundërshtonin -Kur'anin- dhe ta vinin vetë në provë dhe në qoftë se ata nuk do të kishin qenë të vetëdijshtëm pér pafuqinë e tyre, ata sigurisht nuk do të kishin mbetur të heshtur. Prandaj paaftësia e tyre e plotë -pér tē kundërshtuar Kur'anin- ishte prova e mrekullisë së tij dhe e paimitueshmërisë.

**Mënyra e Dytë:** Dijetarët e saktë dhe kritikët të cilët i njohin tē gjitha pjesët e ligjëratës dhe veçoritë e tyre dhe pikat e holla, e kanë studuar Kur'anin sure pér sure, pjesë pas pjesë, vërset pas vërseti dhe fjalë pér fjalë; dhe ata kanë dëshmuar se ai i sjell së bashku tē vërtetat, cilësitetë dhe hollësitetë që nuk gjenden të grumbulluara në tē gjithë ligjëratën humane.

Ndodhen me mijëra -dijetarë- tē atillë. Treguesit pér vërtetësinë e dëshmisë së tyre janë ndryshimet madhështore që Kur'ani shkaktoi në botën e humanizmit, dhe feja e përhapur gjërë që ai themeloi, dhe përjetësoi në fytyrën e kohës -gjatë shekujve- shkencat që ajo përmban, dhe ajo bëhet më e re ndërsa koha vjetërohet dhe sa më shumë tē përsëritet aq më i ëmbël bëhet.

*ان هو الا وحى ربنا*  
Atëherë, “është vetëm shpallje që i frymëzohet<sup>9</sup>”.

**Mënyra e Tretë:** Ashtu siç është treguar nga el-Xha'hiz, pavarësish nevojës së madhe tē profesorëve të oratorisë dhe tē retorikës pér ta shfuqizuar dhe pér tē shembur çështjen e tē Dërguarit a.s.m. dhe pavarësish urrejtjes së tyre ndaj tij dhe kokëfortësisë së tyre, ata hoqën dorë nga kundërshtimi i tyre ndaj tij me gojë, e cila ishte rruga më e sigurt, më e lehtë dhe më direkte, dhe morën armët kundra tij, pavarësish qënies së saj rruga më e vështirë e më e gjatë, e rrëthuar me rreziqe dhe me një fund tē pasigurt. Pér më tepër, mendjemprehtësia e tyre politike ishte e tillë saqë ndryshimet ndërmjet këtyre dy rrugëve nuk mund tē fshiheshin tek ta, nuk mund tē mos

<sup>9</sup> Kur'an, 53: 4

viheshin re. Kështu personi që i shmanget rrugës së parë megjithëse ajo ishte e mundur -pér ta provuar- dhe do tē kishte qenë më e efektshme pér tē penguar e prishur çështjen (e tē Dërguarit a.s.m.) dhe mori rrugën që e hodhi pasurinë e tij dhe jetën e tij në rrezik, do tē duhej tē kishte qenë ose idiot -dhe kjo nuk do tē mund t'u atribuohej atyre që sunduan botën pasi u udhëzuan- ose ai u ndje i pafuqishëm pér ta marrë rrugën e parë dhe u detyrua tē marrë tē dytë.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Ishte e mundur ta kundërshtoje (Kur'anin), por ndoshta pér ndonjë arsyé ose tjetër nuk është bërë përpjekja?

*Ty do tē tē thuhej:* Në qoftë se do tē kishte qenë e mundur, disa njerëz do tē ishin përpjekur ta bënin këtë meqenëse provokimet ishin -tē rënda- dhe nevoja ishte e madhe. Dhe në qoftë se ata do ta kishin kundërshtuar, ajo do tē kishte qenë e njohur, sepse ishte shumë e dëshiruar dhe ndodheshin shumë arsyé pér qënien e saj tē njohur. Dhe në qoftë se ajo do tē ishte bërë e njohur do tē kishte pasë shumë që do ta mbështesnin -një përpjekje tē tillë pér ta kundërshtuar-, dhe do tē ishte gjendur ai që do ta mbronte atë, dhe ata do tē kishin thënë se ai ishte kundërshtuar, dhe sidomos në atë kohë. Dhe po tē kishte pasur kundërshtarë e mbrojtës edhe sikur vetëm nga fanatizmi, kjo do tē kishte qenë bërë e famshme, do tē kishte qenë raportuar në kronika, ashtu siç raportuan përcartjet dhe gjepurat e Mujseleme Gënjeshtarit kur tha (duke imituar Kur'anin): “Një elefant, çfarë është një elefant? Si mund ta njihni një elefant? Ai ka një bisht tē shkurtër dhe një feçkë tē gjatë”.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Musejleme ishte një orator elokuent, atëherë si është e mundur që fjalët e tij u përqeshën e u përcmuant nga njerëzit?

*Ty do tē tē thuhej:* Pér shkak se ai -fjalët e tij u- krahasuan me diçka shumë më tē lartë se vetja e tij. A nuk ke vërejtur se në qoftë se dikush krahasohet me Jusufin a.s., ai shfaqet i shëmtuar edhe sikur tē ishte i pashëm? Prandaj është e pamundur tē Kundërshtosh Kur'anin; kështu ai duhet tē jetë i mrekullueshëm.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Skeptikët kanë shfaqur shumë kundërshtime lidhur me gramatikën rrëth frazave tē Kur'anit dhe tē

fjalëve të tilla si: “*in hadhani*” -“*këto tē dy*<sup>10</sup>” “*el'sa'biune-Sabeanët*<sup>11</sup>” dhe “*el-ledhi issteukadë naren*” “*i cilî ndozi një zjarr*”<sup>12</sup>

*Ty do tē tē thuhej:* Ti duhet tē konsultosh konkluzionin e el-Miftah el-Sekkak, sepse ai nē mënyrë tē efektshme i hesht (kundërshtarë tē atillë) duke thënë: “A nuk e kuptojnë ata se ai që e ka përsëritur fjalën e tij nē një kohë tē gjatë, ndonëse ajo është elokuente e pranuar unanimisht si nuk i ndjen, vëren gabimet që shfaqen pér shikimin e këtyre idiotëve?”

**Aspekti i dytë i pozicionimit të vërsetit (dhe lidhja me vërsetet e mëparshme):** Kur vërseti i mëparshëm urdhëron adhurimin, dëgjesi pyet nē mendjen e tij: “Si duhet tē adhurojmë?” dhe ai sikur përgjigjet: “Ashtu siç ju mëson Kur'an!” atëherë, personi pyet: “Si mund ta dimë se ajo është fjala e Alalhut xh.sh.? dhe ai përgjigjet duke thënë: *وَانْ كُنْتُمْ فِي رِبِّ مَا نَزَّلْنَا*” *Dhe nëse ju dyshoni pér atë (Kur'anin) që Ne i kemi zbritur robit tonë (Muhammedit a.s.m.)...*<sup>13</sup>

### Pozicionimi i frazave të vërsetit:

Fjalia *وَانْ كُنْتُمْ فِي رِبِّ* *Dhe nëse ju dyshoni pér atë (Kur'anin) që Ne i kemi zbritur robit tonë...* ka rënë nē vendin më tē përshtatshëm e tē duhur, sepse kur Kur'an i urdhëron adhurimin, është sikur ai pyet: Si mund ta dimë ne se ai është urdhëri i Allahut, që ne duhet t'i përbahemi? Dhe ai përgjigjet me fjalën e tij: “Në qoftë se ti dyshon, atëherë përpiku vetë (të prodhosh diçka tē ngjashme) që tē jesh i sigurt se ai është urdhëri i Allahut”.

Një aspekt tjetër i pozicionimit të vërsetit është ky: Kur'an duke pasë lavdëruar vetveten me fjalinë *لَرِبِّ فِيهِ هُدٌ لِّلْمُتَّقِينَ* “*Dhàlîké el-kitâbù lâ rejbe fi-hi huden li(e)l mut-tekine*”, “*Ky është libri (Kurani) mbi tē cilin nuk ka asnje dyshim, udhëzim pér el-muttekinet(të përkushtuarit ndaj Allahu)*”

<sup>10</sup> Kur'an, 20:62

<sup>11</sup> Kur'an, 5:69

<sup>12</sup> Kur'an, 2: 17

<sup>13</sup> Kur'an, 2:23

<sup>14</sup> dhe e ndoqi këtë lavdërim me lavdërimin e besimtarëve, dhe duke pasë kaluar prej kësaj tek qortimi i mosbesimtarëve dhe i hipokritëve dhe pastaj vazhdoi tē urdhërojë adhurimin dhe afirmimin e unititet Hyjnor, Kur'an i tani kthehet tek fillimi dhe e drejton

*لَرِبِّ فِيهِ هُدٌ لِّلْمُتَّقِينَ* *lâ rejbe fi-hi* “*në tē cilin nuk ka asnje dyshim*”. Domethënë: dyshimet mund tē shemben tek Kur'an; nē qoftë se ju keni dyshime, ato burojnë nga zemrat tuaja tē sëmura dhe nga karakteret shëndetligji.

*Njeriu e mohon dritën e diellit pér shkak tē sëmundjes së syve;*

*Dhe goja e sëmurë refuzon tē pijë ujin e shijshëm.*

### Pozicionimi i frazës:

*فَاتَوا بِسُورَةٍ مِّنْ مَّثَلِهِ* *fejtú bisüretin min mithlîhi* “atëherë bëni edhe ju një sure tē ngjashme si ajo”; kjo është një apodozë (e protazës (fjali e varur e fjalisë kushtore tē “*Nëse ju dyshoni*”), dhe apodoza duhet tē jetë pasoja e foljes kushtore. Dhe meqenëse urdhëri (“atëherë prodhoni një sure...”) është provokues (*ta'xhizi*), kjo bën tē domosdoshme urdhërin e nënkuptuar “bëj përpjekjen pér tē!” (*Teshebbethu*). Dhe meqenëse urdhëri shpreh diçka tē re (*insha'*), dhe kjo nuk mund tē jetë një pasojë, atëherë pasoja e urdhërit duhet tē jetë diçka tjetër prej apodozës. Dhe kjo është domosdoshmëria se është njëra nga kuqimet bazë tē urdhërit. Tani, domosdoshmëria e përpjekjes gjithashtu nuk shfaqet tē jetë pasoja e dyshimit tē tyre, prandaj kjo kërkon fjali tē nënkuptuara poshtë vërsetit. Fjalitë e nënkuptuara janë këto:

Në qoftë se ju dyshoni se kjo është fjala e Allahut, ju duhet tē studioni natyrën e mrekullueshme tē tij, sepse diçka e mrekullueshme nuk mund tē jetë humane dhe Muhammedi a.s.m. është human. Në qoftë se ju e dëshironi shfaqjen e mrekullisë së tij, përpikuni vetë -të prodhoni diçka tē ngjashme- dhe do tē shfaqej paaftësia juaj. “Kjo do tē

<sup>14</sup> Kur'an, 2 : 2

thotë se ju jeni tē detyuar tē pērpiqeni tē prodhoni një sure tē ngjashme me tē”.

Sa e lartē əshtë shpallja e Allahut! Sa e ngjeshur! Sa e mrekullueshme!

Sa pēr pozicionimin e وَادْعُوا شَهِيداً كُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ veud'ú shuhedākum, min dūni-f-lāhi “dhe thirni dēshmitarēt tuaj pērveç Allahut” ajo ka tre aspekte:

**E Para:** Ata thonë se paaftësia jonë (pēr tē prodhuar ngjashmérinë e tij) nuk tregon paaftësinë e tē gjithë njerëzimit... Atéherë ai i shushat, i lë pa gojë ata me fjalët “*veud'ú shuhedākum*”, “*dhe thirni dēshmitarēt tuaj*” domethënë më tē mëdhenjt midis jush dhe kryetarët tuaj.

**E Dytë:** Ata deklarojnë: “Në qoftë se ju e kundërshtonî (Kur'anin), atéherë kush do tē na mbështeste ne dhe do tē na mbronte? Kështu ai i hesht ata duke u thënë: Çfarëdo botëkuptimi tē ketë -çfarëdo lloj metode tē jetë, ajo ka ndjekësit e saj. Në qoftë se ju do ta kundërshtonit atë, mbështetësit do tē shfaqeshin pēr t'ju mbrojtur juve”.

**E Treta:** Əshtë sikur Kur'ani əshtë duke thënë: I Dërguari a.s.m. thérret Allahun xh.sh. si dëshmitar, dhe Allahu dëshmon pēr vërtetësinë e Tij duke vënë vulën e mrekullisë mbi çështjen e tij. Kështu, në qoftë se zotrat tuaj dhe dëshmitarët do tē sjellin ndonjë dobi pēr ju, atéherë i thirri ata!” Në këtë mënyrë (Kur'ani) u lëshon përbuzje e përcimime atyre.

Pozicionimi dhe lidhja e فَإِنْ لَمْ تَفْعِلُوا Fe in lem tef'alú “Por nëse nuk e bëni dot atë” əshtë e qartë. Sepse ajo nënkupton frazat vijuese: kështu provojeni, pērpiquni, por shikoni? (Ju nuk keni mundësi) dhe në qoftë ju do tē ishit tē pamundur, atéherë əshtë e qartë se ju jeni tē paaftë pēr ta bërë këtë!”

Pozicionimi i وَلَنْ تَفْعِلُوا ve len tef'alú “dhe ju kurrë nuk mund ta bëni atë”: Əshtë sikur ai thotë “dhe sigurisht që ju nuk keni mundësi pēr ta

bërë një gjë tē tillë”, njëri prej tyre thotë nē përgjigje: pēr shkak se ne kemi qenë tē pamundur që ta bëjmë atë, kjo nuk do tē thotë se njerëzimi əshtë i paaftë pēr ta bërë atë nē tē ardhmen:

وَلَنْ تَفْعِلُوا ve len tef'alú

Kështu ai përgjigjet: “Sigurisht që nuk do tē mund ta bëjë...” Kjo tregon mrekullinë e tij nē tre aspekte:

**I Pari:** Parashikimi i tij tē ardhmen, dhe ashtu siç u parashikua, ashtu ndodhi. Siç e dini, me miliona libra arabisht janë orvatur ta imitojnë stilin e shpalljes, si dhe shumë -mohues- kryeneç janë përpjekur, por asnjëri prej tyre nuk ka qenë i suksesshém, ashtu siç do ta shihni nē qoftë se ju do t'i shqyrtoni ato. Əshtë sikur lloji i tij əshtë përkufizuar në personin e tij -əshtë sikur tē ishte personi i veçantë i llojit tē tij. Kështu ai əshtë ose më i ulët se tē gjithë ato, dhe kjo əshtë e pamundur siç əshtë pajtueshmëria e mendimit unanim, ose əshtë më superior se ato tē gjithë.

#### Aspekti i Dytë:

Bërrja e tyre tē heshtur prej tij, poshtërimi ndaj tyre, dhe kritika ndaj tyre mosbërjen e një gjëje tē tillë, dhe duke i provokuar ata, ndërsa -i dërguari- ishte nē atë situatë tē pasigurt e tē rrezikshme (duke mbështetur) çështjen e tij. Kjo əshtë një shenjë e sigurt se ai ishte i besuar, i drejti, besniku dhe konfident nē mesazhin e tij.

**Aspekti i Tretë:** Əshtë sikur Kur'ani tē thonte: Ju jeni princët nē foljen elokuente dhe jeni më tē nevojshmit -pēr tē prodhuar përngjasimin e Kur'anit-, megjithatë ju nuk keni qenë tē aftë ta bëni atë, dhe kështu askush tjetër nuk do tē jetë i aftë, nuk do tē jetë nē gjendje!

Pēr më tepër, ajo nënkupton se ashtu si e shkuara që nuk mundi tē prodhonte ndonjë gjë tē ngjashme me islamin, rezultatin e Kur'anit, po ashtu as e ardhmjë nuk do tē jetë nē gjendje tē prodrojë ndonjë gjë tē ngjashme.

## Tani pozicionimi i

**فَاتَّقُوا النَّارَ الَّتِي وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ أُعِدَّتْ لِلْكَافِرِينَ**

“*fet-teku el-nar el-leti vekuduhen-nasu ve el-hixharetu*” “atēherē kinie frikē zjarrin (xhehennemin), lēnda djegëse e tē cilit janē njerēz dhe gurē”:

Shqyrtoje këtë: **انْ لَمْ تَفْعُلُوا in lem tef'afū** “Por nese nuk e bëni dot atē”

duke u ndjekur nga **fet-teku** “atēherē kinie frikē” bën tē domosdoshme sipas shijeve tē elokuencës fjalitë e nënkuptuara vijuese: Meqenëse ju nuk keni qenë tē aftë ta bëni këtë dhe ju nuk do tē jeni tē aftë, shfaqet se ai është i mrekullueshëm, kështu ai (duhet tē jetë) fjalë e Allahut.

Prandaj ju duhet t'i besoni atij dhe t'u përbaheni urdhërave tē Tij. Dhe njëri prej urdhërave tē Tij është:

“*O ju njerēz! Addhuroni!*” që ju tē mund t'i frikësoheni zjarrit tē Ferrit, kështu kinie krikë zjarrin!”

Shikoje se sa e ngjeshur dhe e thukët është, sa e mrekullueshme!

**الَّتِي وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ** “*el-leti vekuduhen-nasu ve el-hixhareh*” “lēnda djegëse e tē cilit janē njerēz dhe gurē”:

Qëllimi i **“fet-teku”** “atēherē kinie frikē” është për tē frikësuar, dhe (këtu, duke u ndjekur nga “zjarri”) ajo ka një kuptim tē përfocuar dhe tē intensifikuar, me qëllim që t'i tmerrojë ata me “*Vekuduhenas*” “lēnda djegëse e tē cilit janē njerēz”. Sepse një zjarr i furnizuar me lëndë djegëse nga qeniet njerëzore është më i lemerishëm dhe më i tmerrshëm. Pastaj ai e intensifikon duke i shtuar gurët. Sepse (zjarri) i cili djeg gurët është edhe më i fortë. Ajo gjithashtu nënkupton se ai është duke i penguar ata nga idhujtaria. Domethënë, në qoftë se ju nuk i përbaheni urdhrit tē Allahut dhe adhuroni gurët -idhujt-, sigurisht që ju do tē hyni në zjarr i cili konsumon edhe adhuruesit edhe objektet e tyre tē adhurimit.

**أَعْدَتْ لِلْكَافِرِينَ** **Pozicionimi i** **Vid-det li-l kufirine** “i përgatitur për mosbesimtarët”.

Kjo shpjegon dhe vërteton pasojën (*luzum*) ndërmjet foljes kushtore **، انْ لَمْ تَفْعُلُوا** “Në qoftë se ju nuk mundeni” (protazë) dhe apodozën e saj **فَاتَّقُوا** “atēherē kinie frikē”. Domethënë, kjo fatkeqësi nuk është si stuhia dhe si shtrëngata dhe si fatkeqësitë e tjera -natyrore- tē cilat nuk godasin vetëm keqbërësit por i rrëthojnë e përfshijnë edhe tē drejtët dhe tē zgjedhurit; kjo është e veçantë për fajtorët -kriminelët- dhe e shkaktuar nga mosbesimi, dhe i vetmi mjet shpëtimi prej saj është t'i përbahesh Kur'anit.

**أَعْدَتْ** **Për më tepër, uid-det është i përgatitur** tregon se zjarri -xhehennemi,- është i krijuar dhe ekzistues në momentin e tanishëm, në kundërshtim me atë që pohuan Muëtezilitët. Kjo sa vijon do t'ju shfaqë juve, dhe do t'ju lejojë tē merrni me mend se: Ferri është i përjetshëm: Në qoftë se ju do ta shqyrtonit botën nga këndvështrimi i Urtësisë (*el-hikmeh*), ju do ta shihnit zjarrin tē jetë një krijesë e madhe, duke sunduar e duke mposhtur, një element fillestar, zanafilës,- i botërave të larta dhe tē ulëta.

Dhe ju do tē kuptoni se ai përbëhet nga një kokë e madhe dhe fruta tē çuditshëm që varen deri në paspërjetësi. A nuk e shikon ti se dikush që dallon, sheh një kërcell -bisht- tē gjatë duke u zvarritur e kacavjerë (nëpër tokë), do tē kuptojë se ndodhet një bostan në fundin e tij; po ashtu kushdo që shikon krijesa zjarri do tē kuptojë se në fundin -skajine- tyre janë frutat më tē hidhur tē zjarrit –Ferrit.

Gjithashtu, kushdo që sheh mirësi dhe gjëra tē mira dhe kënaqësi do tē kuptojë me intuitë se ekstraktet e tyre dhe vendi që ato derdhen dhe kopshti i tyre është parajsa.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Në qoftë se Ferri ekziston, ku është vendosur ai?

*Ty do tē tē thuhej:* Ne sunitët -Ehl-es-sunneh vel-xhemaah- besojmë se ai ekziston, por ne nuk mund ta specifikojmë e përcaktojmë se ku.

• Dhe nē qoftë se ti do tē pyesje: Kuptimet e jashtme -e fjalëpërfjalëshme- tē disa haditheve tregojnë se ai është nën tokë<sup>15</sup>, dhe nē një hadith thuhet se zjarri (i xhehennemit) është dyqind herë më i nxeh të se sa zjarri i kësaj bote, dhe se dielli gjithashtu do tē hyjë nē Ferr?

Ty do tē tē thuhej: Shprehja “nën tokë” do tē thotë nē qendrën e saj, sepse qendra është nën globin. Është vërtetuar nga teoritë shkencore se nxehësia -zjarri- nē qendrën (e tokës) arrin dyqind mijë gradë. Sepse duke gërmuar teposhtë nē çdo tridhjetë e tre metër kub -njësi matëse- “dhira’ e el-tuxhar”, temperatura rritet një gradë, dhe nē qendër tē tokës ajo është afersisht dyqind mijë gradë. Kjo teori është nē përputhje me hadithin që thotë se ai është dyqind herë më i nxeh të se sa zjarri i kësaj bote. Për më tepër, nē një hadith tjetër ai thotë se një pjesë e këtij zjarri (e Ferrit) është ngrirës i akullt - “Zemherir”<sup>16</sup> dhe se ai djeg me tē ftohtin e tij. Kjo i korrespondon teorisë, se zjarri nē qendër -(nga qendra) pér tek sipërfaqja -përban tē gjitha gradat e zjarrit (nxehësisë). Dhe kjo është vërtetuar nga shkenca natyrore (el-hikme et-tabiij-jeh) se ndodhet një shkallë nxehësia -zjarri- që spontanisht, nē mënyrë tē natyrshme, térheq nxehësinë e mjedisit rrethues dhe e djeg atë me ftohtësinë e tij dhe ngrin ujin, e bën ujin akull.

• Në qoftë se ti do tē pyesje: zjarri brenda tokës dhe ajo çfarë përban brendësia është shumë e vogël, atëherë si ajo do ta përfshijë e rrethojë Ferrin, i cili rrethon e nxë qiejt dhe tokën?

Ty do tē tē thuhej: Është nē qoftë se përsa ka tē bëjë me këtë botë tē dukshme (el-mulk) dhe (Ferri) duke qenë i “mbështjellur” (el-matvijeh), përfshihet nga toka, por pér sa ka tē bëjë me Ahiretin, ai do tē bëhet aq i madh dhe i gjërë saqë do tē rrethojë mijëra -globe- tē ngjashëm me tokën.

Po, Bota e dukshme (A'lem el-shehadeh) është si një perde duke penguar kontaktin ndërmjet atij zjarri dhe degëve tē tjera tē tij. Gjithashtu, qënia e tij nën tokë nuk bën tē domosdoshme qënen e tij tē lidhur me tokën, sepse degët e pemës së krijimit kanë prodhuar fruta tē atilla si dielli, hëna, dhe yjet, dhe tokën tonë, dhe toka tē tjera. Kështu ajo çfarë shtrihet nën frut përfshin zonën midis degëve ku ajo gjendet.

(El-Mulk) Dominimet -sundimet- e Allahut xh.sh. janë nē tē vërtetë tē gjëra dhe pema e krijimit është shpërndarë (nëpër to), kështu kudo që - Ferri- udhëton, ajo nuk mund tē zmbrapset. Në një hadith thuhet: “Ferri është i mbështjellë, i mbuluar”. Kjo mund tē tregojë se Ferri është një vezë e zogut tē tokës sonë fluturuese, dhe kur perdja e botës së dukshme tē griset, (toka) do tē bëjë vezën e saj dhe (Ferri) do tē shfaqet, duke kërcënuar -duke kërcitur dhëmbët- ndaj njerëzve tē Rebelimit. Gjithashtu është e mundur se ishte kjo (çështja e Ferrit) duke qenë i “mbështjellë, i mbuluar” që u shkaktoi Muëtezilitëve tē binin nē gabimin (e besimit) se ferri nuk është tani ekzistues, dhe tē këmbëngulnin nē tē.

Tani sa pér pozicionimin (dhe lidhjet e) pjesëve tē frazave:

وَانْ كُنْتُمْ فِي رَبِّ مَا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا وَ “dhe” nē *kuntum fi rejbin mim-mà nez-zelnà alà abdinà*”, “Dhe nëse ju dyshoni pér atë (Kur'anin) që Ne i këmi zbritur robit tonë (Muhammedit a.s.m.),” është (vendosur kështu) pér shkak tē lidhjes ndërmjet (këtij vërseti dhe

بِأَيْهَا النَّاسُ اعْبُدُوا ”O ju njerëz! Adhuroni...”, por asnjë lidhje e tillë nuk është e dukshme. Ajo bëhet e dukshme vetëm nëpërmjet dy pyetjeve tē nënkuptuara dhe përgjigjive tē tyre: Së pari është përgjigjja e nënkuptuar pér pyetjen që buron nga vërseti i parë: “Si duhet tē adhurojmë ne?”, domethënë,) “ashtu siç ju ka mësuar Kur'ani”. (Në përgjigje tē pyetjes së dytë tē nënkuptuar: “Si mund ta dimë se Kur'ani

أَنْ كُنْتُمْ فِي رَبِّ kuntum fi rejbin Dhe nëse ju dyshoni pér atë (Kur'anin) që Ne i këmi zbritur robit tonë (Muhammedit a.s.m.).

Përdorimi i “in”, e cila shpreh hezitim, ngurrim nē vend tē “idha”, e cila nënkupton siguri dhe vendosmëri, (megjithëse është e sigurt se ata janë nē një gjendje dyshimi,) tregon se pér shkak se mjetet - shkaqet- janë shfaqur pér largimin dhe zhdukjen e dyshimeve, pikërisht ekzistanca e tyre duhet tē jetë e dyshimtë ose madje e pamundur; ato do tē mund tē ishin vëtëm hipotetike. Gjithashtu, dyshimi i shprehur nga “in” shikon tek stil (letrar) dhe jo tek Folësi xh.sh..

Zëvendësimi i **وَانْ كُنْتُمْ فِي رَبِّ** “*kuntum fi rejbin*”, “*ishit (jeni) nē dyshim*” pér (formën foljore) **“انْ أَرْتَبْتُمْ** “*Ju dyshuat*”, megjithëse e dyta është më e thukët, tregon se burimi i dyshimit të tyre është natyrat e sëmura të tyre dhe karakteret.

Dhe dyshimi duke i rrethuar (*dharfijje*) ata, ndonëse ai është i përfshirë (*madhruf*) nga zemrat e tyre, aludon se errësira e dyshimit është shpërndarë nga zemrat e tyre dhe i ka mposhtur të gjitha qëniet e tyre fizike, duke i mbuluar në errësirë të gjitha rrugët (e ndriçimit të mundshëm).

Përdorimi i trajtës së pashquar pér **رَبِّ** “*rejb*”, “*dyshim*” është pér ta bërë atë të përgjithshme. Domethënë, cilindo prej llojeve të dyshimit që ju tē ndjeni, përgjigjja është e njëjtë, dhe ajo është: (Kur’ani) është i mrekullueshëm dhe i vërtetë! Kështu,akuza juaj (ndaj Kur'anit) pér gabim pér shkak të shikimit tuaj sipërfaqësor është një gabim, dhe nuk është e domosdoshme që t'i përgjigjesh çdo dyshimi në mënyrë të përcaktuar qartë. Ju sigurisht mund të shihni se një person i cili -has rastësish- një burim dhe e shijon ujin e tij të pastër e të ëmbël nuk ka nevojë t'i shijojë të gjitha rrëketë dhe degët e tij.

(Pjesëtorja) **مِنْ** “*min*”, “*prej*” tek **مَانَزَلَنَا** “*mim-mà nez-zelna*”, “*prej asaj që Ne i kemi zbritur, shpallur*” dedukton fjalët e nënkuptuara “rreth një pjese të asaj që Ne e kemi zbuluar (*fi shej'in mimma*).

Fjalët **nez-zelna**, “*i kemi zbritur, shpallur*” tregonjë se burimi i dyshimit të tyre është shpallja, zbritja e (Kur'anit). Dhe përgjigjja vendimtare provon shpalljen e tij.

Zgjedhja e (formës së II **نَزَلَنَا** “*nez-zelna*” që tregon një shpallje graduale, në vend (të formës së IV) **“enzele”**, e cila sugjeron se ai ishte i menjëhershëm, aludon pér justifikimet që ata paraqitën duke thënë:

“Përse ai nuk iu shpall atij menjëherë? Në tē vërtetë, Kur’ani iu shpall gradualisht siç e kërkonin ngjarjet, sipas rrethanave, vërsët pas vërsëti, sure pas sureje.

Zgjedhja e fjalës **عبدنا** “*abd*”, “*rob*” në vend tē “*profet*” ose “*Muhammed*” tregon lartësim tē profetit dhe aludon pér natyrën e

**أَعْبُدُوا** **عبدوا** **Uëbusdú** “*Adhuroni*”; dhe nënkupton zmbrapsjen e iluzioneve dhe tē dyshimeve, sepse i dërguari a.s.m. kreu më shumë adhurim se sa çdokush tjetër dhe recitoi më shumë nga Kur’ani. Prandaj reflekto mbi këtë!

**فَاتِوا** **feëtū bisüretin min mithlîhi** “*atëherë bëni edhe ju një sure tē ngjashme*”: (“Qëllimi i urdhërit “*Atëherë prodhoni*” është pér tē shfaqur pafuqinë e tyre dhe ai përmban një sfidë dhe kritikë dhe u bën thirrje atyre tē përpiken që ta kundërshtojnë, duke bërë tē qartë paaftësinë e tyre pér ta bërë këtë.

**بِسْوَرَةٍ** **Suretin**, “*një sure*” tregon (Kur'anin) duke i bërë ata tē heshtur krejtësisht, duke i shushatur, duke i lënë pa gojë, sa vijon:

**Niveli i parë i sfidimit:** Ai thotë: Prodhoveni përngjasimin e të gjithë Kur'anit së bashku me tē vërtetat e tij, shkencat, parashikimet dhe renditjen e lartë tē fjalëve, të gjitha këto prej një njeriu analafabet:

**Niveli i Dytë:** Ai thotë: Në qoftë se ju nuk mund ta bëni këtë, shpikni diçka, por me ngjashmërinë e renditjes elokuente tē fjalëve.

**Niveli i Tretë:** Ai thotë: Në qoftë se ju nuk mund ta bëni as atë, prodhoni afërsisht dhjetë sure.

**Niveli i Katërt:** Në qoftë se nuk jeni në gjendje ta bëni as atë, prodhoni vetëm -barasvlerën- e një sureje tē gjatë.

**Niveli i Pestë:** Në qoftë se edhe ajo gjithashtu është shumë e vështirë pér ju, sillni vetëm një sure edhe sikur ajo tē ishte shumë e shkurtër si “*in-na aëtajna*” (108: 1) dhe nga dikush analafabet si ai.

**Niveli i Gjashtë:** Në qoftë se nuk është e mundur pér ju që ajo të prodhohet nga dikush analfabet, atëherë merrni një dijetar të aftë dhe një shkrimtar të talentuar pér ta bërë atë.

**Niveli i Shtatë:** Në qoftë se edhe ajo është shumë e vështirë pér ju gjithashtu, atëherë le të kooperojë një numër prej jush pér ta prodhuar atë.

**Niveli i Tetë:** Dhe në qoftë se ju nuk mund ta bëni atë, kërkoni ndihmën e të gjithë njerëzve dhe xhindëve dhe ndihmesën e të gjitha rezultateve të njohjes së tyre të përbashkët prej kohës së Ademit a.s. deri në fund të botës, si dhe ato ide që gjenden në librat e disponueshmër rrëth gjuhës arabe dhe stileve të saj, të shkruara me dëshirën pér të imituar (Kur'anin) ose me kryeneçesinë prej atyre të cilët donin ta kundërshtonin atë. Të mos themi asgjë pér dijetarët autoritarë, në qoftë se një person me zgjuarsi të pakët ose madje një injorant do t'i studionte ato, ai do të deklaronte se asnjeri prej tyre nuk ishte i ngjashëm me (Kur'anin). Atëherë ai ose është më inferiori i të gjithë atyre, dhe kjo është e pamundur ashtu siç ka pajtueshmëri mendimi me unanimitet, ose ai është më superiori i të gjithë atyre. Dhe kjo është ajo që kërkohet ashtu siç u përmend më lart. Në të vërtetë, ai nuk është kundërshtuar (në mënyrë të suksesshme) pér trembëdhjetë shekuj. Dhe ashtu siç ishte e vërtetë në të shkuarën, po ashtu ajo do të jetë në të ardhmen, deri në fundin e kohës.

**Niveli i Nëntë:** Ai thotë: Mos protestoni duke thënë se nuk keni asnje dëshmitar dhe nuk dëshmojmë as pér ju. Shkonit dhe i thirri dëshmitarët tuaj dhe përkrahësit tuaj dhe lërini ata që t'i konsultojnë ndërgjegjjet e tyre; a do të guxojnë ata të mbështesin pretendimin e tyre duke kundërshtuar (Kur'ani)?

Në qoftë se ti i ke kuptuar këto nivele, shiko tanit se si Kur'ani është i mrekullueshmër në thukëtinë e tij, duke i treguar këto nivele, duke i heshtur ata në mënyrë të efektshme dhe duke i lëshuar frerët e tyre (duke u dhënë atyre rastin pér t'u përgjigjur e pér të reaguar).

Kupto gjithashtu se paaftësia njerëzore pér të kundërshtuar edhe suren më të shkurtër është një argument i qartë prej pasojës tek shkaku (*inijetuhu bedihijeh*). Sa pér qenien e saj të diskutuar nga shkaku tek pasoja (*limmijetuhu*), thuhet se “Allahu xh.sh. i pengoi njerëzit nga diskutimi i saj”. Shkolla më e saktë në çështjen e dytë (diskutimi nga

shkaku tek pasoja) është ajo e ndjekur nga Abdul-Kahir Xhurxhani, el-Zamahsheri dhe el-Sek-kaki. Kjo pohon se “Është përtej fuqisë humane të kompozosh renditjen e lartë të fjalëve (të Kur'anit)”.

Pér më tepër, el-Sekaki preferoi -pikëpamjen- që mrekullia e tij vetëm mund të ndjehet (*Dheuki*) dhe nuk mund të shprehë apo të shpjegohet”. Por autori i “*Dela'il el-ixhaz*” (el-Xhurxhani), preferoi -pikëpamjen- që është e mundshme ta shprehësh atë (me fjalë), dhe ne pajtohemti me shkollën e tij në këtë çështje.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Zgjedhja, preferimi i **“Sures”** mbi një fjalë të tillë si “*Nexhm*”, “*ta ifeh*” ose “*neube*” tregonit (Kur'anin) duke i heshtur ata (duke iu përgjigjur) burimit të dyshimeve të tyre, kryesisht “Përse ai nuk iu shpall atij përnjëherësh?” Domethënë, (Kur'ani u tha atyre) “Ju prodhoni ca, dhe le ta shohim, madje edhe sikur vetëm një pjesë të shkurtër të veçantë!”

Zgjedhja e fjalës “*Sura*” tregon gjithashtu se ndodhen disa dobi në Kur'an duke u ndarë në sure, siç janë shpjeguar tek Zamahsheri, dhe se kjo metodë e pazakontë përmban shumë pika të holla.

مِنْ مِثْلِهِ

Fraza **“min mithlihi”** “të ngjashme si ajo, si shembulli i tij” shpreh dy gjëra (të mundshme):

Domethënë, (përemri prapashtesor “hi”, “i tij” i referohet) ose gjësë së shpallur (*el-munzel*) (Kur'anit -domethënë, “prodhoni një sure si një e Kur'anit”, ose atij të cilit ai iu shpall (*el-munzel alejhi*) (të dërguarit, dikujt analfabet si ai pér ta prodhuar atë”). Në qoftë se do të

مِثْلِ سُورَةٍ مِّثْلِهِ

ishte ajo, do të formulohej **“mithli suretin minhu”**, “si

مِنْ مِثْلِهِ

“*një sure prej tij*”, por ajo është shprehur si **“min mithlihi”**, “*prej shembullit të tij*” duke tregonit se mundësia e dytë është marrë parasysh. Domethënë, “Ju mund ta shfuqizoni e zhvlerësoni çështjen e tij me kundërshtimin tuaj vetëm në qoftë se dikush analfabet si ai - profeti- do ta bënte atë. Kjo tregon gjithashtu se mrekullia (e Kur'anit) do të mund të shfuqizohej vetëm në qoftë se do të kundërshtohej nga

një koleksion (një vepër letrare, *mexhmu'ë* -domethënë, në qoftë se surja e prodhuar do të ishte pjesë e një vepre të plotë) si (Kur'an).

Fraza gjithashtu tregon në mënyrë aluduese, drejton vëmendjen për tek shkrimet e tjera -librat e tjerë- që u shpallën si Kur'an, me qëllim që dëgjesi të mund t'i peshojë në mendjen e tij dhe të kuptojë natyrën e lartë të Kur'anit.

**فjalia** وَادْعُوا شُهَدَاءَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ veud'ú shuhedäekum min dúni-l-

لَّهِ "dhe thirni dëshmitarët tuaj përveç Allahut": Zgjedhja e thirrjes "ud'u" në vend të "istei nu" "Kërkoni ndihmë ose përkrahjen" tregon se ata që do të mund t'u përgjigjeshin atyre dhe t'i mbronin nuk janë mosekzistues por janë atje (me ta) dhe nuk kanë nevojë të thirren.

**Fjala** شُهَدَاءُ "shuhedä", "dëshmitarët" përban tre kuptime: Autoritetet tuaj në gjuhën arabe, ata që vëzhgojnë (dëshmojnë), dhe zotrat tuaj.

Për sa ka të bëjë me të *parën*, ai i hesht ata duke rrëzuar argumentin e tyre se paaftësia e tyre nuk provon se emirëve të tyre letrarë u mungon fuqia (për ta imituar Kur'anin).

Për sa ka të bëjë me të *dytën*, ai i shushat, i lë pa gojë duke i prerë justifikimet e tyre se ata nuk kishin dëshmitarë, sepse çdo pikëpamje dhe metodë ka mbrojtës dhe dëshmitarë.

Lidhur me të tretën, ajo i refuzon dhe i përqesh ata, duke u kërkuar se përsë zotrat e tyre prej të cilëve ata kërkojnë dobi dhe për të larguar dëmin, nuk i ndihmojnë në këtë çështje që është duke i shqetësuar ata.

**Fjala** شُهَدَاءُ "shuhedä", "dëshmitarët" dhe prapashtesa përemërore "Kum", "tuaj" shpreh veçori, përcaktueshmëri dhe përforcon kuptimin e parë (lart): "Të mëdhenjtë tuaj janë të pranishëm me ju dhe ata janë -lidhjet- e veçanta midis jush; në qoftë se ata do të kishin qenë të aftë që t'ju ndihmonin, sigurisht (ata do ta kishin bërë)". Ajo shpreh kuptimin e dytë si kjo: Ne e pranojmë dëshminë e atyre që ju mbështesin juve dhe që janë përkrahësit tuaj, sepse ata nuk kururisin e

nuk do të guxojnë të dëshmojnë për diçka, pavlefshmëria e të cilës është e vetëkuptueshme".

Dhe ajo merr me krahë kuptimin e tretë dhe e përqesh atë duke i thënë: Përse nuk ju ndihmojnë juve zotrat që i adhuroni?

**فërsa** ka të bëjë me të parën, fraza من دون الله "min dúni-l-Lâhi "përveç Allahut" tregon përgjithësim domethënë, i thirni të gjithë profesorët elokuentë të gjuhës në botë përveç Allahut xh.sh.. Ajo tregon gjithashtu se mrekullia e Kur'anit është (mrekulli) vetëm për shkak se është prej Allahut.

Në lidhje me të dytën ajo tregon pafuqinë e tyre dhe konfuzionin kur ata thonë: "Allahu është Dëshmitar, Allahu e di se ne mund ta bëjmë atë". Sepse është zakoni i atyre të mposhtur në argument dhe të rënë në pafuqi të betohen në Allahun dhe ta thërrasin Atë për të dëshmuar për atë që ata janë të paaftë për ta provuar.

Dhe për sa ka të bëjë me të tretën ajo tregon se kundërshtimi të Dërguarin a.s.m. ishte ekzaktësish përgjigjja ndaj shirkut me Unititin Hyjnor dhe ndaj qënieve të pajeta dhe të pavetëdijshme me Krijuesin e tokës dhe të qiejve.

**Fraza** ان كُنْتُمْ صَادِقِينَ "in kūntum Sā'dikīne" "nëse jeni të drejtë" aludon për thënien e tyre: "Në qoftë se ne do të kishim dashur, ne do të kishim thënë diçka të ngjashme". Ajo gjithashtu nënkupton: Ju nuk jeni të vërtetë". Vërtetësia juaj është vetëm hipotetike; në të vërtetë ju vetëm shprehni sofizma. Dhe ju nuk keni rënë në dyshim për shkak se ju po kërkoni të vërtetën, por për shkak se ju po kërkoni të shtrembërën -gënjeshtrën-, dhe ju ratë në të. Për më tepër, pasoja (apodoza) (e foljes kushtore "në qoftë se ajo që e thoni") është përbledhja dhe substanca e frazave të mëparshme; domethënë, bëjeni atë!" Domethënë, Në qoftë se ajo që thoni është e vërtetë, atëherë përpinquni të prodhoni diçka të ngjashme:

**Fjala** فَإِنْ لَمْ تَفْعِلُوا وَلَنْ تَفْعِلُوا فَأَنْتُمُ النَّارُ "Fein lem tef'alu we len tef'alu fet'teku'u el-nar" "Por nëse nuk e bëni dot atë dhe ju kurrë nuk mund ta

bəni atē, atēherē kinie frikē zjarrin (xiehennemin)": Me frazēn "Nē qoftē se ajo qē ju thoni ēshtē e vērtetē, Kur'ani ēshtē duke i hedhur poshtē me njē silogizēm kushtor duke pranuar tē kundertēn....

**Njē pērbledhje e saj:** Nē qoftē se do tē ishit tē vērtetē, ju do ta kishit kundertshtar atē dhe do tē kishit prodhuar njē sure, por ju nuk mundēt ta bēnit dhe nuk do tē jeni nē gjendje ta bēni njē gjē tē tillē).

Njeriu nxjerr si pērfundim nga kjo se ju nuk ishit tē vērtetē, ndērsa armiku juaj, profeti a.s.m. ēshtē i vērtetē dhe se Kur'ani ēshtē i mrekullueshēm. Kēshtu, kjo ju obligon tē besoni nē tē qē tē mund tē frikēsoheni nga ndēshkimi i Ferrit!" Shiko sa e mrekullueshme ēshtē kjo thukēti e shpalljes!

Pastaj, duke thēnē: **فَإِنْ لَمْ تَفْعِلُوا** *in lem tef'alū* "Por nēse nuk e bēni dot atē" nē vend tē "La'kin ma tef'alune", "por ju nuk e keni (bērē atē, nuk do tē jeni nē gjendje ta bēni)", tregon nēpērmjet dyshimit tē treguar nga "in" pērshtatte e konformizēm me dyshimet e tyre (*Dhann*), dhe nēpērmjet tē shprehurit tē saj njē kusht qē ēshtē e kundērta e fjalise vijuese, bēn tē domosdoshme tē kundertēn e fjalise sē mēparshme, dua tē them "Por ju nuk ishit tē vērtetē, ajo pērmend tē tretēn e tre pasojave

tē njēpasnjēshme "Lazim" tē shkakut "il-le", i cili ēshtē **فَاتَّقُوا النَّارَ** *fe it-tekkū el-nārē* "atēherē kinie frikē zjarrin (xiehennemin)" pēr t'i frikēsuar, pēr t'i kērcēnuar e kanosur.

Sa pēr **انْ لَمْ تَفْعِلُوا** *in lem tef'alū* "Por nēse nuk e bēni dot atē", ajo duke shprehur tē shkuarēn nēpērmjet "Lamit" dhe tē ardhmen nēpērmjet "in" ēshtē me qēllim qē tē drejtojē vēmendjen drejt tē shkuarēs sē tyre, sikur ai t'u thonte atyre: "Shikoni tek ligjēratat tuaja tē zrukuruara dhe shtatē poemat e praruara tē varura: a janē ndonjēra prej tyre tē barabarta me (Kur'anin) apo madje tē afērta me tē, ose nē tē njētēn klasē?

Zgjedhja e **تَفْعِلُوا** *tef'alū* "tef'alu", "bēni" mbi "teetu" "sjell, sillni" sugjeron dy pika:

**E Para:** Ajo nēnkupton se burimi i mrekullisë (sē Kur'anit) dhe i paimitueshmērisē "i'xhaz" ēshtē pafuqia e tyre (*axhz*) dhe, burimi i pafuqisē sē tyre ēshtē (e lidhur me) aktin (*fiēl*) dhe jo me veprēn (*athar*). (Domethēnē, burimi i pafuqisē sē tyre ēshtē paaftēsia e tyre pēr "tē bērē" ose pēr tē prodhuar diċka tē ngashme me Kur'anin, dhe jo me vetē veprēn).

**E Dyta:** Ēshtē pēr thukētinē. Sepse ashtu si nē gramatikē, (rrēnja foljore)

**فَعَلٌ** "fe'a'le" pērdoret pēr tē picturuar modelet dhe format e foljes, kēshtu nē stilet letrare ajo pērdoret si pērbledhja e akteve dhe e historive, sikur ajo tē ishte njē pēremēr duke shprehur fjal tē plota dhe duke aluduar pēr to.

**وَلَنْ تَفْعِلُوا** *Ve len tef'alū* "ju kurrē nuk mund ta bēni atē": E ardhmja dhe theksimi i shprehur nga **لَنْ** "len" nēnkupton pēraktueshmēri, dhe kjo tregon se folēsi ēshtē konfident dhe serioz dhe se ai nuk ka dyshime lidhur me atē qē ai ēshtē duke thēnē.

Dhe kjo ēshtē njē shenjē se nuk ka dredhi apo masħtrim (nē atē qē ai thotē dhe bēn).

**فَاتَّقُوا** *fe it-tekkū* "kinie frikē" nē vend tē **تَحْذِنُوا** *texħennebu* "shmangiuni" tē dyja shprehin tē njējtin kuptim, por **فَاتَّقُوا** *fe it-tekkū* "kinie frikē" vijon pas besimit, ndērsa shmangia nuk e ka kētē kuptim tē dytē) nēnkupton si njē zēvendēsue pēr pasojēn (e fjalise sē lartē kushtore) fjalinē: Besoni dhe shmangiuni shirkut -idhujtarisē, qē ēshtē shkaku i hyrjes nē zjarrin e xhehennemit".

**النَّارَ** *el-nārē* "zjarrin (xiehennemin)" pēr shkak se ai ēshtē i mirēnjohnur dhe i fiksuar fort nē mendjet e njerēzve duke pasē dēgjuar rrēth tij prej (tē gjithē) profetēve nga Ademi deri tani. Qēnia e tij i sunduar nga pēremri lidhor **الَّذِي** *el-lett* "i cili, e cila"

megjithēse (pēremra tē tillē) pērgjithēsis i referohen diċkaje tē njobur

më parë, është si rrjedhojë e shpalljes së mëparshme të  
**وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحَجَارَةُ**  
*Vekudūha el-nāsu ve el-hixħaretu* “një zjarri lēnda dżegëse e tē cilit janë njerëzit dhe gurêt”<sup>17</sup>, pérpara këtij vërseti, dhe ata tē adresuarit e kishin dëgjuar. Kështu përemri lidhor është në vendin e tij.

**وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحَجَارَةُ** “lēnda dżegëse e tē cilit janë njerëz dhe gurë”, siç u përmend më lart, qëllimi i kësaj është pér tē frikësuar dhe kërcënuar, dhe frikësimi është bërë më i fortë nga kërcënim. Kështu, ajo kërcënon me fjalën “njerëz” sikur t'i godisje ata dhe e përforcon këtë me  
**حَجَارَةً** “gurët” sikur t'i ndëshkonte ata: “Çfarë përfitimi apo shpëtimi shpresoni ju prej këtyre idhujve që tani janë instrumentet pér torturimin tuaj?

**أَعْدَتْ لِلْكَافِرِينَ** *Uid-det li-l kàfirine* “i përgatitur pér mosbesimtarët”, mëso se pozicioni (i kërkuar këtu) i përgatitur pér ju **لَكُمْ** (*u'id-det lekum*), por përgjithësisht Kur’ani përmend përbledhje dhe irregulla tē përgjithshme tek fundet e vërseteve pér tē treguar dëshmitë më tē fuqishme, pér pohimet (e bëra në vërsetin në çështje). Kështu, ajo që kryesisht (nënkuptohet këtu)

**أَعْدَتْ لَكُمْ لَا يَكُمْ بِنَ الْكَافِرِينَ وَالنَّارُ أَنْ لَمْ تَفْعِلُوا** “i përgatitur pér ju në qoftë se ju nuk besoni, meqë ai është i përgatitur pér mosbesimtarët”. Pér këtë arsy emri është përdorur në vend tē përemrit.

Pastaj “uid-det” “u përgatit” duke qenë në kohën e kryer tregon se Ferri ekziston në kohën e tanishme, ashtu siç u diskutua lart.

\* \* \*

<sup>17</sup> Kur'an, 66: 6

## VËRSETI 25

وَبَشَّرَ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّلَاحَاتِ أَنَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي  
 مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ كُلَّمَا رُزِقُوا مِنْهَا مِنْ ثَمَرَةٍ رِزْقًا قَالُوا هَذَا  
 الَّذِي رُزِقْنَا مِنْ قَبْلٍ وَأَتُوا بِهِ مُتَشَابِهًـا وَلَهُمْ فِيهَا أَزْوَاجٌ  
 مُطْهَرَةٌ وَهُمْ فِيهَا خَالِدُونَ

*Ve besh-shir el-ledħiñne a'menū ve àmislú el-salihati en-ne leħum xħen-nàtin texħri min taħbiha el-enħaru kul-lema Ruzikú minħà min themeretin Rizkan kàlú hàdhia el-ledħi Ruzikna min kablu ve u'tubihí muteshabihen ve leħum fiha eżvàx fun mutah-heretun ve hum fiha kħsalidúnne.*

Dhe përgëzoji ata që besojnë dħe punojnë mirësi e drejtësi, se pér ta do tē këtë kopshte tē begatë (tē xħennetit) nën tē cilët rrjedħin lumenj. Qđo heré që do t'u shérbehet me fruta tē tij, ata do tē thoné: “Këta janë nga ċ'na është shérbyer më parë”, e atyre do t'u jepen gjéra tē ngħajnej; atje do tē kienē bashķeshorte tē pastra, dħe atje do tē qëndrojnë përgjithmonë.

**Shqyrtoje këtë:** Renditja e fjalëve dhe pozicionimi (*nadhm*) i këtij vërseti, ashtu si motrat e saj, ka tre aspekte: pozicionimi i vërsetit si një térësi (dhe lidħjet e tij) me atë që e parapriu; pozicionimi (dhe lidħjet) e frazave tē vërsetit; dhe pozicionimi (dhe lidħjet) e pjesëve përbërëse tē frazave.

### I Pari:

Ndërmjet kuptimit tē këtij vërseti dhe vërseteve tē mëparshem janë lidħje tē ndryshme, dhe vija, fije- tē ndryshem shtrihen prej tij pér tek ato fraza tē vërseteve. Sigurisht ti e sheh se në fillim tē sures Kur’ani lavdëron vetveten dhe besimtarët, pér besimin (e tyre) dhe pér veprat e mira, pastaj me atë vërset tregon rezultatin e besimit dhe frutin e veprave tē mira. Dhe gjithashtu, si ai i kritikon mosbesimtarët dhe dënon hipokritët dhe përshkruan rrugën e tyre e cila çon në humbjen e përjetshme, pastaj aludon me këtë vërset pér drittē e lumturisë së

pérhershme, duke ua treguar atë atyre pér tē shtuar sensin e tyre tē humbjes, që kanë humbur këtë mirësi më tē madhe.

Dhe duke i pasë ngarkuar (njerezit), *يَا إِلَهَ النَّاسُ اعْبُدُوا “O ju njerëz! Adhuroni...”* megjithëse kjo do tē thotë mundim dhe vështirësi dhe braktisje e kënaqësive të menjëershme, tē çastit, ai hap pér ta dyert e (kënaqësive të shtyra) tē së ardhmes. Me këtë, ajo i kënaq dhe siguron nefset e tyre.

Dhe pasi ka provuar Unitetin Hyjnor, që është shtylla e parë prej shtyllave tē besimit dhe obligimin kryesor fetar, me këtë vërsset ajo shpall frutat e Unitetit Hyjnor, titullin e mëshirës dhe parathënien e kënaqësise Hyjnore duke u treguar parajsën dhe lumturinë e pérjetshme.

Dhe duke pasë provuar profetësinë –shtyllën e dytë tē besimit, nëpërmjet mrekullisë së vërsetit *انْ كُنْتُمْ فِي رِبِّ نَعْصَى ju dyshoni pér atë (Kuranin)...*<sup>1</sup>, me këtë vërsset dhe në mënyrë indirekte me vërsetin e mëparshëm, ai aludon pér detyrat dhe obligimet e profetësisë, tē cilat janë pér tē paralajmëruar dhe pér tē dhënë sihariqe, lajme tē gëzueshme, nëpërmjet gjuhës së Kur'anit.

Dhe duke pasë kërcënuar, frikësuar dhe paralajmëruar në vërsetin e mëparshëm, nëpërmjet misterit tē lidhjes së tē kundërtave, në këtë vërsset ai premton, zgjon dëshirën dhe jep lajme tē gëzueshme.

Gjithashtu, në qoftë se një person e bind dhe e nënshtron nefsin dhe vazhdon në bindje dhe e bën ndërgjegjjen t'i bindet diktatat tē arsyes, ai duhet tē nxisë edhe ndjenjën e frikës edhe ndjenjën e dëshirës, përmallimit duke sjellur së bashku -obligimet- e frikësimit (pér t'i larguar nga e keqja, padrejtësia) dhe duke i tërhequr -pér tek e drejta- (*terhib ve tergib*). Sepse diktatat e mendjes janë vetëm pérkohësish -efektive- dhe duhet tē jetë në ndërgjegjje një motivim -forcë shtytëse- dhe një nxitje detyruese.

Pér më tepër, duke pasë treguar një pjesë tē ahiretit me vërsetin e mëparshëm, atëherë me këtë vërsset ai tregon tjetrin i cili është burimi i

<sup>1</sup> Kuran, 2:23

lumturisë së pérjetshme. Gjithashtu, atje ai aludon me zjarrin pér Ferrin, dhe ai në mënyrë tē qartë përmend parajsën.

Tani kupto se Parajsa dhe Ferri janë dy frutat tē cilët shtrihen drejt pérjetësisë nga pema e krijimit; dhe janë dy rezultatet e zinxhirit tē universit. Ato janë dy depo në tē cilat derdhet universi, dhe janë dy pellgjet pér tē -universin- i cili rrjedh drejt pérjetësisë. Po, universi do tē tronditet dhe do tē tundet me një lëvizje tē fuqishme dhe Parajsa dhe Ferri do tē mbushen -me lëndët e përshtatshme.

**Një shpjegim i kësaj:** Kur Allahu xh.sh. deshi krijimin e botës pér provim e testim pér shembuj tē shumtë e tē hollë urtësie, Ai e deshi ndryshimin dhe transformimin e kësaj bote pér (shumë) arsyë. Ai kombinoi tē keqen me tē mirën, përfshiu dëmin në dobinë, dhe futi shëmtinë në bukur. Ai i lidhi tē keqen, dëmin dhe shëmtinë me Ferrin dhe u dërgon atyre ndihmë prej tij. Dhe Ai i dërgoi gjërat e mira dhe virtytet pér t'u manifestuar në Parajse.

Pér më tepër, kur Ai deshi provimin dhe garën në -botën e- qënieve humane dhe -pér tē qenë- diferençat dhe ndryshimi midis tyre, Ai i pérziu njerezit e këqinj me tē mirët. Pastaj kur periudha e testimtimit mbylljet dhe Dëshira Hyjnore -urdhëron- që ata duhet tē jenë tē pérjetshëm, Ai do t'i bëjë njerezit e këqinj tē manifestojnë vërsetin

*وَأَنْتَرَوْالْيَوْمَ أَيْهَا الْجَرْمُونَ* *Ndahuni këtë Dité (nga besimtarët) o kriminelë!*<sup>2</sup>, ndërsa tē mirët do tē nderohen e hijeshohen me adresimin

*فَادْخُلُوهَا خَالِدِينَ* *...Punuat mirë, hyni pra këtu pér tē banuar në tē përgjithmonë!*<sup>3</sup>. Pastaj kur dy kategoritë ndahen, universi do tē pastrohet, dhe gjërat e këqija dhe tē dëmshme do tē tërhiken prej tē mirës, tē dobishmes dhe tē plotës, dhe ato do tē grumbullohen në një anë.

**Shkurtazi:** Në qoftë se ti do ta studioje universin me vëmendje do tē hasësh dy elemente bazë, dy kërcelle -bishta- zvarritës (si bostanë), që kur (frutat e tē cilëve) tē grumbullohen dhe tē bëhen tē pavdekshëm, ato do tē bëhen Ferri dhe Parajsa.

<sup>2</sup> Kuran, 36:59

<sup>3</sup> Kuran, 39:73

## Një Parathënie

Ky vërset dhe vërseni paraprijës flasin pér ringjalljen e tē vdekurve dhe pér tubimin e madh! Ndodhen katër pikat tē vlefshme nē këtë çështje:

**Së Pari:** Mundësia e Shkatërrimit tē botës dhe e vdekjes së saj.

**Së Dytë:** Ndodhja, vdekja -e saj.

**Së Treti:** Rindërtimi i saj dhe ardhja nē jetë.

**Së Katërti:** Ndodhja e tyre.

**Mundësia e Vdekjes së universit:** Në qoftë se një gjë i nënshtrohet ligjit të revolucionit, procesit të plotësimit (*kanun el-tekamul*), ajo ndërmerr rritje dhe zhvillim. Kështu ajo ka jetë tē natyrshme dhe i është dhënë (e caktuar) koha e vdekjes; ajo nuk mund t'i shmanget e t'i ikë thirrjes së vdekjes. Sipas një arsyetimi deduktiv, kjo -kalon përshumicën e anëtarëve tē specieve (*efrad el-enwa*).

Atëherë, ashtu si njeriu që është si një botë e vogël dhe nuk mund tē shpëtojë nga shkatërrimi; po ashtu bota, e cila është një njeri i madh, gjithashtu nuk mund tē shpëtojë nga vdekja. Dhe gjithashtu ashtu si një pemë e gjallë, e cila është një kopje e zvogëluar e universit që nuk mund ta shpëtojë jetën e saj nga shkatërrimi dhe kalbja, po ashtu zinxhiri i kriesave, i cili është degëzuar nga pema e krijimit -është një pjesë e pemës së krijimit- nuk mund ta shpëtojë veten nga shkatërrimi dhe shkrirja. Kështu, në qoftë se ndonjë sëmundje e jashtme ose ngjarje shkatëruuese -stuhi- nuk do t'i binte dynjasë me lejen e Vullnetit tē parapërjetësisë para vdekjes së saj natyrale, dhe Autori i saj i Gjithurtë nuk do ta shkatërronte atë para asaj kohe, sigurisht -nga domosdoshmëria sipas një llogaritjeje shkencore, një ditë do tē vijë kur kuptimet dhe misteret e këtij vërseni

اَذَا الشَّمْسُ كُوَرْتْ وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرْتْ  
Kur diellî tē mbështiliset dhe tē humbë  
dritën dhe tē përmbyset. Dhe kur yjet tē bien”<sup>4</sup>

اَذَا السَّمَاءُ انْشَقَتْ  
kur qiellî tē plasë”<sup>5</sup> do tē bëhen tē dukshme, do tē realizohen.

Atëherë, Dynjaja -e cila është një njeri i madh- do tē fillojë grahmat e fundit dhe agonitë e vdekjes; ajo do ta mbushë hapësirën dhe do ta bëjë atë tē jehonojë me një regëtimë tē fundit, nē mënyrë tē tmerrshme dhe me një zë shkatërrimtar.

**Sa pér ndodhjen e saj,** nëpërmjet konsensusit tē tē gjitha feve tē shpallura, dëshmisë së natyrave tē shëndosha, dhe treguesve tē tē gjitha ndryshimeve, transformimeve dhe tjeterimeve nē univers. Dhe nē qoftë se dëshiron tē imaginosh agonitë e vdekjes së dynjasë dhe ulurimën e saj, mendo se si pjesët e universit janë lidhur me njëra-tjetren me një rregull tē saktë e tē lartë. Ato mbahen me një lidhje tē tillë tē çuditishme saqë një trup i vetëm qiellor nē qoftë se do tē merrte urdhrin “Bëhu” ose “Dil nga orbita”, atëherë e gjithë bota do tē vuante agonitë e vdekjes së saj, yjet do tē përplaseshin, trupat qiellorë do tē ndesheshin e mbështilleshin, dhe një zhurmë e madhe dhe gjëmim do tē fillonte nē hapësirën e pafundme, duke u përplasur e ndeshur me njëra-tjetren, duke lëshuar breshëri shkëndijash me përmasën e globit tonë, madje edhe më tē mëdhaja. A mund ta imaginosh ti zërin e tmerrshëm tē miliona gjyleve tē topave dhe tē artilerive tē mëdhaja, predhat më tē vogëla tē tē cilave janë më tē mëdhaja se sa toka? Sepse ai do tē jetë zëri i vdekjes së saj. Nëpërmjet kësaj vdekjeje, krijimi do tē tronditet, dhe qëniert do tē ndahen; dhe Ferri do tē shfaqet së bashku me banorët e tij dhe me lëndët; dhe Parajsa do tē bëhet e dukshme, duke i sjellë së bashku tē gjitha hollësitë e ardhura prej elementeve tē saj.

• **Në qoftë se ti do tē pyesje:** Përse universi i nënshtrohet ndryshimit dhe kohës dhe -kështu- do tē shkatërrohet, dhe pastaj nē ringjalljen e tē vdekurve do tē bëhet i përjetshëm, i qëndrueshëm dhe i pandryshueshëm?

<sup>4</sup> Kuran, 81:1-2

<sup>5</sup> Kuran, 82:1

*Ty do tē tē thuhej:* Meqenëse urtësia e parapërjetshme dhe mirëbërësia Hyjnore bënë tē domosdoshme provimin dhe testimin dhe zhvillimin e potencialeve dhe zbulimin e aftësive, dhe shfaqjen e tē vërtetave relative (*el-hakaiku el-nisbijjeh*), tē cilat nē ahiret do tē jenë tē vërteta tē plota (*el-hakaiku el-hakikijjeh*), dhe ekzistencën e shkallëve relative dhe tē shumë shembujve tē urtësisë pér tē cilat mendja njerëzore është e pafuqishme pér t'i kapur; Autori xh.sh. i bëri natyrat dhe dispozitat e gjërave tē ndryshme tē përziera, dhe i kombinoi gjërat e dëmshme me ato tē dobishmet; i përziu tē këqiat midis tē mirave; dhe i solli bashkë gjërat e shëmtuara dhe tē bukura. Kështu Dora e fuqisë i gatoi tē kundërtat së bashku si brumë, dhe universi iu nënshtrua ligjt tē ndryshimit, shdërrimit, transformimit dhe tē plotësimit (*el-tekamul*).

Kështu, Autori xh.sh. deshi nëpërmjet mirësisë së Tij që kur arena e provimit tē mbyllt dhe koha e sprovimit tē ketë përfunduar, dhe kur koha e tē korruvare tē ketë ardhur, Ai do t'i pastrojë tē kundërtat e ndryshme pér t'i bërë ato tē përjetshme, dhe do t'i ndajë shkaqet e ndryshimit dhe do t'i dallojë lëndët e diferençës -konfliktit.

Pastaj Ferri do tē formohet me trupin e tij tē ngurtë, duke marrë adresimin e وَأَمْتَازُوا “*Ndahuni*”. Dhe Parajsa do tē shfaqet e manifestohet me trupin e saj tē përjetshëm e tē qëndrueshëm dhe me themelit e saj.

(Kjo do tē jetë) nē përputhje me (rregullin): “Lidhjet janë esenciale pér rregullin”. (Domethënë, nuk ka kundërshti ndërmjet elementeve dhe pjesëve që formojnë Parajsën dhe Ferrin; ndodhen vetëm lidhjet dhe hallkat midis tyre)<sup>6</sup> dhe rregulli është shkaku i vazhdimësisë.

Pér më tepër, nëpërmjet fuqisë së Tij tē plotë, Ai xh.sh. do t'u japë banorëve tē atyre dy banesave tē përjetshme ekzistencë -trupa -të qëndrueshëm që nuk do t'u nënshtrohen shpërbërjes e ndryshimit, sepse ndryshimi këtu, i cili çon nē zhdukje, buron nga diferençat relative (domethënë, zbalancimi, çekuilibri) ndërmjet asaj që formohet dhe asaj që shpërbëhet. Ndërsa qëndrueshmëria relative atje (domethënë, balanca) do ta lejojnë ndryshimin i cili nuk do tē çojë nē shpërbërje.

<sup>6</sup> Shiko Nursi “Isharatul I'xhaz” (Abdul Mexhid)218

Pikat e Trete dhe e Katërtë, dua tē them mundësia e rindërtimit dhe e ringjalljes dhe ndodhja e tyre: “Meqenëse provat e unititetit Hyjnор dhe tē profetësisë që merren vetëm nga Kur'anı dhe hadithet (*el-delil el-naklij*) nuk janë tē vlefshëm aq sa do tē bënин tē domosdoshme një argument rrotullor, Kur'anı aludon pér prova racionale pér ato (gjithashtu). Megjithatë është e lejueshme pér ringjalljen e tē vdekurve që tē provohen edhe nga arsyaja edhe nga Kur'anı dhe hadithet (*bil akli vel nakli*). Pér provat racionale, ju mund tē konsultoni atë që u shpjegua

وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقَنُونَ *Ve bil A'hireti hum Ju'kinune* “si dhe që besojnë me bindje nē botën e përtejme”.<sup>7</sup>

**Shkurtazi:** Rregulli, mëshira, dhe mirësia do tē ishin e bëheshin rregull, mëshirë e mirësi vetëm me ardhjen e ringjalljes.

Dëshmitë e transmetuara (*naklij*) përbëhen nga ajo që gjithësecili ka thënë (nga tē gjithë profetët)<sup>8</sup> dhe nga ajo që pohon Kur'anı i mrekullueshëm rrëth ndodhjes së saj. Pér këto dëshmi si dhe pér treguesit e provave racionale, ju mund t'i referoheni pér këtë subjekt komentit “*Fahr ed-din Razî*”, sepse ai i numëron vërsetet që provojnë ringjalljen e tē vdekurve.

**Shkurtazi:** Një njeri duhet vetëm tē ndjekë modelet, shembujt dhe shëmbëllimet e ringjalljes nē shumë botëra (specie, lloje *el-enwa* tē qënieve) pér tē marrë me mend prej shenjave tē tyre tē ndryshme ekzistencën e ringjalljes trupore dhe tē lumturisë së përjetshme.

### Pozicionimi dhe lidhjet e frazave:

Ti duhet tē jesh nē dijeni se spangoja tek e cila kalojnë perlat e këtij vërseti nē një rregull tē njëpasnjëshëm është ky: Lumturia e përjetshme është dy llojesh:

<sup>7</sup> Kuran, 2:4

<sup>8</sup> Shiko Nursi “Isharatul I'xhaz” (Abdul Mexhid)218

<sup>9</sup> Fahuddin el-Razi (1165-1240 pas krishtit) vleroshet tē ketë shkruar rrëth dyqind veprat nē fusha tē ndryshme tē shkencave islame, duke përfshirë *tefsir* (komenti), *kelam* (teologji) dhe parimet e *fikhat* (jurisprudences). Njëra nga veprat e tij më tē famshme është komenti “*Mefatih el-Gajb*” e njojur si “*Tefsir el-Kebir*”

**I Pari dhe Kryesoria:**

Kēnaqësia e Allahut xh.sh., mirësia e Tij, manifestimi dhe afërsia:

**I Dyi:** Lumturia fizike e cila arrihet nëpërmjet shtëpisë -banesës-, ushqimit, martesës, dhe vazhdimësisë së tyre për të gjithë përjetësinë, e cila i plotëson ato dhe i përsos.

Pastaj, *llojet e para* nuk kanë nevojë për shpjegim të detajuar, ose ndonjë mënyrë e tillë shpjegimi nuk është e mundur.

Sa për *llojet e tē dytit*: më e këndshmja e banesave është ajo e ngritur midis bimëve dhe ujit rrjedhës. Ti sigurisht që e di se ujërat e lumenjve llokoçitës e gurgulluese të lumenjve, duke pëshpëritur poshtë shatorreve, pallateve dhe midis kopshteve, frysmezojnë poezinë dhe gjallërojnë dashurinë në zemra. Sa për ushqimin, ai është *Rizku*, dhe ndërsa më e shijshtë e ushqimit bazë është ai që është familjar, i zakonshëm; frutat janë më të mira nga një aspekt kur ndryshojnë, ripërtërihen. Sepse familjariteti -e lejon- njeriun të njohë shkallën e lartë të mirësisë dhe epërsinë e saj mbi gjërat e ngjashme.

Për më tepër, njëra prej kënaqësive më të larta është njohja se (rizku, ushqimi) është shpërbimi për punën e tij. Një tjetër është burimi i saj dhe magazina e saj duke qenë të pranishme mu përparrave, duke i sjellur kënaqësinë e qetësisë -sigurisë së besuar.

Lidhur me martesën, njëra nga nevojat më të forta të njeriut është që ai të ketë dikë që i përgjigjet atij me dashuri të përzemërt dhe që të ndajë me -partnerin e tij- kënaqësinë dhe intimitetin; madje të bashkëpunojnë për të ndijuar çudinë (tek mirësitë Hyjnore) dhe për të shqyrtau rreth tyre. Ti duhet ta kesh vëzhguar se në qoftë se dikush sheh diçka të pazakontë që e turbullon atë dhe e bën atë të mendojë, ai kërkon dikë, edhe sikur vetëm mendërisht, për të ndarë hutimin dhe çoroditjen e tij. Pastaj më e buta e zemrave dhe më e dhembshura dhe më e ngrohta është zemra e llojit -seksit- të dytë. Pastaj ato shpirtërat e të cilëve përzihen dhe bashkohen plotësisht dhe zemrat e të cilëve do të arrijnë intimitet të plotë, dhe që bashkimi i tyre i jashtëm do të jetë i pastër dhe i dëlirë janë ato të llojit -seksit- të dytë të cilat janë pastëruar e dëlirësuar prej moraleve të këqija dhe nga tiparet e pahijshme.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* (Qëllimi i) ushqimit është për tē përjetësuar -jetën- e një personi, sepse nëpërmjet tij ato pjesë tē trupit që shpërbëhen riformohen, dhe martesa është për tē përjetësuar racën njerëzore, por në ahiret njerëzit do tē janë tē pavdekshëm dhe nuk i nënshtrohen ndryshimit dhe shpërbërjes. Prandaj nuk do tē ketë riprodhim në Ahiret, apo jo?

*Ty do tē tē thuhej:* Dobitë e ushqimit dhe tē martesës nuk përkufizohen tek përpjesëtimi i jetës dhe i riprodhimit; ato janë burimi i një lumturie të madhe në këtë botë të dhimbshme. Atëherë, përsë tē mos jetë kënaqësia e llojit të pastër e tē lartë në botën e lumturisë; si mund tē mos janë tek ato tē dyja në botën e lumturisë dhe tē kënaqësisë, kënaqësi tē larta e tē pastra?

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Kënaqësia këtu (në këtë botë arrihet) nëpërmjet largimit të dhimbjes dhe tē vuajtjes, (por në Ahiret, nuk do tē këtë asnjë)?

*Ty do tē tē thuhej:* Largimi i dhimbjes është vetëm njëri shkak i kënaqësisë. Gjithashtu, nuk është e mundur tē krahasosh botën e përjetshme me këtë botë. Madje, kopshti i Horhor<sup>10</sup> këtu është për kopshtet e lartë të Parajsës. Ky (kopsht) dhe ajo Parajsë e lartë është krahasimi midis kënaqësive të Ahiretit dhe kënaqësive (të përshkruara) tē kësaj bote.

Dhe ashtu siç është superiore ajo Parajsë mbi këtë kopsht në shkallë tē pakufizuara; po ashtu ky... Ibn Abbasi, Zoti qoftë i kënaqur me tē, aludoi për këtë ndryshim tē madh kur tha: *لَيْسَ فِي الْجَنَّةِ إِلَّا أَسْمَائُهَا* “Gjëja e vetme në Parajsë do tē janë emrat e tyre”.<sup>11</sup> Domethënë, frutat e kësaj bote.

Në lidhje me jetën e amshuar dhe me kënaqësinë e përjetshme, shqyrtoje këtë:

Kënaqësia është kënaqësi e vërtetë vetëm në qoftë se është e paprekur nga zhdukja. Sepse ashtu si largimi i dhimbjes që është kënaqësi ose një shkak i saj, po ashtu kalimi -ikja- e kënaqësisë është

<sup>10</sup> Medreseja e Nursit në qytetin e Vanit, rrëzë kështjellës.

<sup>11</sup> Gjëja e vetme në këtë botë nga Parajsa janë emrat (ose diçka të ngjashme). Shiko Ibn Kethir, VI, 63;etj

dhimbje; madje edhe përfytyrimi i zhdukjes së kënaqësisë është gjithash tu dhimbje. Në fakt, poezia e dashuruesve “metaforikë” që të gjitha përbëhen nga vajtime të një dhimbjeje të tillë.

Divanët e këtyre ashikëve të një dashurie që nuk është “vërtetë” nuk janë tjetër veçse qarja e tyre dhe vajtimi prej kësaj dhimbjeje, e cila buron nga kalimi, zhdukja e imagjinuar e të dashurit.

Në të vërtetë, shumica e kënaqësive të përkohshme prodhon dhimbje të vazhdueshme kur ato zhduken, dhe sa herë që njeriu t'i kujtojë ato, hidhërimi shpërthen e zien tek ai dhe ai thërrret me keqardhje: Oh, Medet! Duke e mallkuar këtë dhimbje të shpirtit.

Pastaj shumë prej dhimbjeve kur kalojnë, prodhojnë kënaqësi të vazhdueshme sa herë që njeriu mendon për qënien e tij i shpëtuar prej tyre, ai thotë “*El-hamdu lil-lah*” duke aluduar për këtë mirësi jolëndore.

Po, njeriu u krijuar për përjetësi dhe ai mund ta arijë kënaqësinë e vërtetë vetëm nga gjërat e përjetshme të tilla si njohja rrëth Allahut, dashuria, plotësia, njohuria, dhe kështu me radhë.

**Shkurtazi:** Kënaqësia dhe mirësia janë kënaqësi e mirësi vetëm në qoftë se ato janë të përjetshme.

Tani që ti e ke parë spangon, duke kaluar frazat e vërseteve në të.

Fraza *“Ve besh-shir el-sedħiħne a'menū ve àmilū el-salihati”*, “Dhe përgëzoji ata që besojnë dħie punojnë mirësi e drejtësi”: kur Ai xh.sh.i ngarkoi njerëzit (me adhurim), dhe provoi profetësinë (e të Dërguarit), dhe e ngarkoi të dërguarin me komunikimin e urdhërave të Tij -me qëllim që duke dhënë sihariqet (e Parajsës) ai do të sigurohej se ata do t'u përbaheshin obligimeve të cilat nxjerrin vështirësi dhe për të hequr dorë nga kënaqësitë e kësaj bote- ai u urdhërua edhe për të paralajmëruar edhe për të komunikuar lajmet e gëzueshme të kënaqësisë së Allahut xh.sh., të mirësisë së Tij, të afërsisë dhe të lumturisë së përjetshme.

Dhe fraza *“انْ لَهُمْ جَنَاتٌ تَجْرِيْ en-ne lehum xien-natin texfir”* “se për ta do tē këtë kopshte tē begatë (tē xien-netit) nén tē cilēt rrjedħin (lumenj)”: ashtu siç u përmend lart, nevoja e domosdoshme esenciale dhe e para e njeriut, meqenëse ai ka një trup, është një vend dhe një banesë. Më tē bukurat e vendeve janë ato me bimë dhe pemë, dhe më tē këndshmit janë ato me pellgje midis kopshteve të tyre të blertë, dhe më tē shkëlqyerit janë ato që kanë rrëke -lumenj duke vërvshuar me shumicë përmes pemëve të tyre dhe nén pallatet e shatorret. Prandaj ai thotë *“تَجْرِيْ مِنْ تَحْتَهَا الْأَنْهَارُ texfir min taħbiha el-enħāru* “nén tē cilēt rrjedħin lumenj”. Pastaj më e madhja e nevojave, siç e dëgjove më parë pas vendit (për tē jetuar) dhe më e plota e kënaqësive trupore është e ngrëna dhe e pira; këto tregohen nga (fjalët) kopshte dhe lumenj... Pastaj më i plotti i furnizimeve -rizkut, është familjar, i mësuar me tē, që tē njohë shkallén e epërsisë së tij mbi ushqimet e tjera tē ngashäm

Dhe më tē shijshmit janë frutat për sa kohë që ripertërihen e ndryshohen. Dhe kënaqësia më e pastér është nga -frutat- që janë tē njohura dhe këputen, mblidhen nga afér. Por më e shijshmja e tē gjithave, është që ta dijë se ajo është fruti i punës së tij. Prandaj ai tha:

*“كُلُّمَا رُزِقُوا مِنْهَا مِنْ ثَمَرَةِ رِزْقًا قَالُوا هَذَا الَّذِي رُزِقَنَا مِنْ قِبْلِهِ Çdo herë që do t'u shérbehet me fruta tē tij ata do tē thonë: këta janë nga ç'na është shérbyer më parë”*. Domethënë, në këtë botë ose para tē tashmes, tani.

Fraza *“وَأَتُوا بِهِ مِتَّسِابِهِا ve ú'tubih muteshàbihen* “e atyre do t'u jepen gjéra tē ngashme”.

Dije këtë: thuhet në një hadith “Ato do tē jenë tē ngashäm në formë por tē ndryshäm në shije”:<sup>12</sup> Kështu, vërseti tregon se kënaqësia e frutave qëndron në ndryshimin dhe variacionin e tyre, dhe se kënaqësia e plotë është kur personit i shérbehet dhe (fruti) i jepet atij.

Fraza “atje do tē kënë bashkëshorte tē pastra”:

Ashtu siç e pe më lartë (kur pëershruante) spangon -fillin- (për perlat e vërsetit), njeriu ka nevojë për një bashkëshorte, një shoqe me tē

<sup>12</sup> Shiko El-Mundhiri, *et-Tergib vel Terhib*, vi, 296; al-Għażali *Iħja Ullum el-Din*

cilën tē banojë, nēpermjet syve tē sē cilës ai tē mund tē shohë, dhe ajo tē mund tē shikojë nēpermjet syve tē tij, dhe prej dashurisë sē tē cilës ai mund tē pērfitojë, (dashuri) e cila eshtë më e holla dhe më e buta e rrezeve tē Mëshirës Hyjnore. Gjithashtu intimiteti i plotë eshtë me tē. A nuk e ke parë se intimiteti i plotë këtu eshtë me ato?

**Dhe fraza** وَهُمْ فِيهَا خَالِدُونَ “ve hum fiha khalidune” “dhe atje do tē qendrojnë përgjithmonë”:

Kur një person has rastësishët mirësi ose kënaqësi, gjëja e parë që i ndodh atij nē mendjen e tij eshtë: “A do tē vazhdojë ajo apo do tē prishet nga zhdukja?” Për këtë arsy, (Kur’ani) tregon me fjalët

وَهُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ve hum fiha khalidune “dhe atje do tē qendrojnë përgjithmonë” se plotësimi i mirësisë eshtë me përjetshmërinë e xhennetit dhe vazhdimësinë e tyre dhe tē bashkëshortëve të tyre nē tē dhe me përjetshmërinë e kënaqësive dhe me përfitimin e tij prej tyre përgjithmonë.

Pozicionimi dhe lidhjet e pjesëve të frazave të vërsetit:

**Fraza** وَيَسِّرْ لِلَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ Ve besh-shir el-ledhine a'menü ve amilu el-salihati “Dhe përgëzoji ata që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi”:

Lidhëzja ♀ “ve, “dhe” aludon për “endhir” “paralajmërimin” i cili pikon prej (vërsetit) tē mëparshëm.

بَشِّرْ “përgëzoji” eshtë një shenjë se Parajsa eshtë -thjesht- nēpermjet favorit tē Tij xh.sh. dhe jo një detyrë për Të, dhe për më tepër, se aktet nuk duhet tē janë për llogari tē Parajses (domethënë, me shpresën e saj). Dhe (folja) duke qenë nē urdhërore sugeron: “komunikoje atë sikur tē përcjellje lajme tē gëzueshme!” Sepse -profeti- u ngarkua për tē komunikuar mesazhin.

Pastaj përdorimi i **el-ledhine a'menü** “(që) tē cilët besuan” nē vend tē **الْمُؤْمِنِينَ el-mueminune** “besimtarët”, aludon për **الَّذِينَ el-ledhine** “tē cilët” nē fillimin e sures, kështu që detajet e dhëna atje mund tē shpjegojnë shkurtësinë këtu.

Përdorimi i kohës së kryer këtu nē “**a'menü ve amilu**” “besuan dhe punuan” ndonëse atje (nē fillimin e sures) eshtë përdorur e pakryera për **الَّذِينَ يَوْمَئِنُونَ besojnë**” dhe **“junfikune”**, **“shpenzojnë”** tregon se e pakryera eshtë e përshtatshme (në lidhje me) lavdërimin dhe kurajimin, por se e kryera eshtë e përshtatshme (lidhur me) shpërblimin dhe shpagimin, sepse shpërblimi vijon pas shërbimit.

Sa për **“Vavin”** وَعَمِلُوا و “ve amilu”, “dhe punuan” tregon nēpermjet misterit tē pangashmërisë (ndryshimit), nē kundërshtim me pohimet e muëteziliteve se veprat nuk janë përfshirë nē besim, dhe se besimi pa punë eshtë i pamjaftueshëm.

**عمل Amel** punë tē cilës jepen sihariqet, lajmet e gëzueshme, i ngjason shpërblimit (ndonëse nuk eshtë ai).

Sa për **el-salihati** “drejtësi, punë tē drejta”, ajo eshtë e paqartë e errët dhe e thukët. Sipas Shejh Muhammed Abduh i Egjiptit, ajo ka një kuptim tē përgjithshëm këtu për shkak se njerëzit e dinë në majë tē gishtave, krejtësisht mirë, se cilat janë punët e mira. Por unë them përvëç kësaj se, ajo eshtë kështu meqë ajo shikon tek (detajet e dhëna) nē fillimin e sures.

**Fraza** أَنْ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ en-ne lehum xhen-natin texfirí min tahtiha el-enharu “se për ta do tē ketë kopshte tē begatë (tē xhennetit) nën tē cilët rrjedhjin lumenj”:

Shqyrtoji tē gjitha pjesët e kësaj fraze: Konfirmuesja e vërtetuesja **أَنْ “en-ne”** dhe përcaktuesja **لِـ “lam”**; vendosja para e **لِـ “lehum”**; shumësi **خَلَقَنَّا** “*xhen-nätin*” dhe qenia e pashquar dhe përmendja e ujërave rrjedhës, përmendja e **“min”** dhe **تَحْتَ “tahtihā”**, duke specifikuar -

shumësin- e **لِـ “enhāru”**, dhe qenia e tij e pashquar; -si lagështira - Reshjet- duke çurguar nga tē gjitha anët e tokës së thatë nē një pellg qëndror, tē gjitha këto pjesë ndihmojnë dhe i përgjigjen njëra-tjetërës duke përforcuar qëllimin kryesor, i cili eshtë gëzimi, kënaqësia dhe shpërbimi.

(Për ta shpjeguar:) **أَنْ “en-ne”, “që, se”** tregon se meqenëse mendja mund tē jetë ngurruese rreth tē mahnitshmes së një gjëje rreth tē cilës jepet sihariqi, ajo ka nevojë pér mbështetje, konfirmim. Gjithashtu, eshtë veçori e një konteksti (mekam) (pér tē zgjuar) gëzim që tē largojë frikësimë tē kota e tē pabaza, sepse ankthi më i vogël shkatërron imaginatën dhe dëbon gëzimin. Ajo gjithashtu eshtë një shenjë se kjo nuk eshtë thjesht një premtim por një realitet aktual.

**لِـ “Lami”** i **لِـ “lehum”**, **“pér ta do tē ketē”** tregon veçori - përcaktueshmëri- pronësi dhe e drejtë e ligjshme (që do tē thotë se gjëja rreth tē cilës jepen sihariqet, lajmet e gëzueshme) eshtë ekskluzivisht, dhe vetëm -pér besimtarët-, dhe eshtë e tyre, dhe se ata e meritojnë atë, dhe ajo plotëson kënaqësinë (e tyre) dhe shton gëzimin (e tyre). Pérndryshe ajo do tē ishte si një mbretëri duke pritur -gostituar një lypës.

Vendorja përpëra e **لِـ “lehum”** tregon se midis njerëzve (janë besimtarët) ata tē cilët zgjidhen -veçohen pér Parajsën. (Si rrjedhojë); ata e shikojnë gjendjen e njerëzve tē Ferrit, e cila do ta bëjë tē dukshme vlerën e kënaqësisë së Parajsës.

Shumësi i **خَلَقَنَّا** “*xhen-nätin*”, **كُوْضِتَهُ تَهْبَطُ** “*kopshte tē begatē*” tregon se numri -i madh- i kopshteve ose i parajsave dhe shkallët e tyre tē ndryshme nē përpjesëtim me shkallët e ndryshme -tē shumta- tē akteve. Ajo eshtë

një shenjë gjithashtu se çdo pjesë e parajsës eshtë një parajsë, dhe nënkupton gjithashtu se çfarëdo pjesë që t'i jepet një personi -pér shtrirjen e madhe tē tij do tē duket si gjithë parajsa; (individët) nuk do tē grumbullohen me grupin e tyre (ose me xhematin) tek një vend (i veçantë).

**خَلَقَنَّا** **كُوْضِتَهُ تَهْبَطُ** duke qenë e pashquar reciton pér mendjet e dëgjuesve: “(Kopshtet) përbajnjë atë që asnje sy nuk e ka parë, asnje vesh nuk e ka dëgjuar, dhe nuk i ka ndodhur zemrës së asnje njeriu”<sup>13</sup>. Ajo gjithashtu ia referon atë mendjeve tē dëgjuesve që ata tē mund ta perceptojnë e përfytyrojnë atë nē një mënyrë që ata ta gjejnë tē kënaqshme. Pér më tepër, eshtë një zëvendësuese pér “...Dhe nē tē do tē ketē çfarë t'u dojë shpirti.”

**تَجْرِي** **تَجْرِي** **texfir**, siç dihet, më tē bukurit e kopshteve janë ata tē cilët kanë ujë; dhe më tē bukurit e këtyre janë ato nē tē cilët uji eshtë rrjedhës, dhe më tē bukurit e këtyre janë ato nē tē cilët vërshimi i ujit eshtë i vazhdueshëm, i përhershëm. Kështu fjala **texfiri** “rrjedh, vërshon” zgjon përfytyrimin e vazhdimitës së vërshimit tē ujit.

**مِنْ تَحْتَهَا** **مِنْ تَحْتَهَا** Sa pér **“min tahtihā”**, **“nēn tē cilēt”**, ju e dini se më i bukuri i ujit rrjedhës eshtë ai që rrjedh nëpér bimë e shkurre duke çurguar i pastër dhe i kulluar prej kopshtit, dhe duke vërshuar e gurgulluar nën pallatet dhe shatorret e tij dhe nē shumë rrëke midis pemëve. **مِنْ تَحْتَهَا** **“min tahtihā”**, **“nēn tē cilēt”** i tregon këto tē trija (domethënë, ujërat duke rrjedhur nën kopshte, pallate e pemë).

**الآنَهُارُ** **الآنَهُارُ** **El-enħāru**, **lumenjtē** uji rrjedhës nē kopshte eshtë më i bukur nē qoftë se eshtë me shumicë, dhe eshtë më i këndshmi nē qoftë se eshtë nē formën e rrëkeve që ndjekin njëri-tjetrin; dhe nē qoftë se këto janë simetrikë ato e shtojnë joshjen dhe bukurinë e asaj pjese. Por,

<sup>13</sup> Nga Ebu Hurejra; shiko Buhari, Muslim,2824

më e bukura e tē gjithave éshtë kur uji éshtë i ëmbël, me shije dhe i freskët si nē vërsetin **الأنهار El-enħaru** "...prej uji tē pastér, tē shijsħem..."<sup>14</sup>

Forma e shumësit dhe përdorimi i nyjes shquese tregon atë që u përmend lart.

**كُلَّمَا رُزِقُوا مِنْهَا مِنْ شَمْرَةٍ رِزْقًا قَالُوا هَذَا الَّذِي رُزِقْنَا مِنْ قَبْلٍ**  
**Fjalia**

*kul-lema Ruzikjú minħà min themeretin Rizkan kálú haddha el-ledhí Ruzikja min kablu*" "Çdo herë që do t'u shérbehet me fruta tē tij, ata do tē thonë: "Këta janë nga ç'na éshtë shérbyer më parë"; Ti duhet ta dish se pjesët e -kësaj fjalie- përfshijnë shumë fjali tē nénkuptuara (ose fraza). Meqenëse ajo nuk éshtë lidhur me fjalinë paraprijëse (*istinaf*), ajo éshtë përgjigjja për një pyetje tē nénkuptuar, dhe kjo pyetje éshtë një përzierje e tetë pyetjeve tē njëpasnjëshme. Sepse kur jepen sihariqet e një vendbanimi tē tillë, i ndodh mendjes së dëgjuasit: A do tē ketë ushqim atje apo jo? Dhe nē qoftë se ka ushqim -Rizk-, prej ku do tē vijë ai dhe si do tē sigurohet? Dhe nē qoftë se ai do tē sigurohet nga kopshti, nga se përbëhet ai? Dhe nē qoftë se éshtë nga frutat e tij, a u ngjasojnë ato frutave tē kësaj bote? Dhe nē qoftë se ato fruta u ngjasojnë, a i ngjasojnë ato njëri-tjetrit? Dhe nē qoftë se ato fruta i ngjasojnë njëri-tjetrit, a janë shijet e tyre tē ndryshme? Dhe nē qoftë se ato janë tē ndryshme, a do tē pakësohen ato nē numér kur tē këputen, tē mblidhen, ose a do tē zëvendësohen ato (me fruta tē reja, tē freskëta)? Dhe nē qoftë se ato zëvendësohen nga tē tjerat, a do tē vazhdojnë këto tē jenë ushqim? Dhe nē qoftë se ato do tē vazhdojnë, a do tē ndjejnë kënaqësi ata që do t'i hanë? Dhe nē qoftë se do tē ndjejnë kënaqësi, çfarë do tē thonë ata?

Në qoftë se ti i ke kuptuar këto pyetje, shqyrto tani se si Kur'ani u përgjigjet atyre me pjesët e paragrafit (tē lartpërmendur) tē vërsetit.

Fjala **كُلَّمَا** "kul-lema" "Çdo herë që" tregon vazhdimësi dhe mbështetje.

<sup>14</sup>Kuran, 47:15

**رُزْقًا**

"Ruzikjú" "do t'u shérbehet, iu shérbye" duke qenë nē kohën e kryer tregon realizimin e saj. Gjithashtu, ajo nénkupton qënien e saj tē sjellur ndërmend prej diçkaje tē ngjashme, prej ushqimit tē kësaj bote. Dhe qenia e saj nē diatezën pësore tregon mungesën e çdo vështirësie - për ta siguruar atë- dhe qenia e tyre duke iu shérbyer dhe qenia e saj duke iu dhënë atyre.

**مِنْهَا مِنْ شَمْرَةٍ**  
Zgjedhja e **minħà min themeretin** "me fruta tē tij, prej tij nga frutat" nē vend tē **من شمارتها** **min themeratiha** "prej frutave tē tij", éshtë me qëllim që tē japë përgjigje tē sigurta për dy pyetjet e lartpërmendura.

Pashquarsia e **من شمرة** "themeretin", "fruta" e bën atë tē përgjithshme dhe tregon se çfarëdo lloj fruti që tē jetë, ai éshtë "Rizk", "ushqim".

Dhe **رُزْقا** "Rizkan" duke qenë e pashquar tregon se ai nuk éshtë lloji i ushqimit që ju e njihni për tē shuar, larguar urinë.

Fjala **قالُوا** "kálú" "ata do tē thonë" ka kuptimin e "Jeteka'velune" "ata i flasin njëri-tjetrit". (Domethënë, Forma e VI e foljes), e cila tregon kënaqësinë e tyre, çudinë dhe lumturinë.

**هَذَا الَّذِي رُزِقْنَا مِنْ قَبْلٍ** **haħħà el-ledhí Ruzikja min kablu** "Këta janë nga ç'na éshtë shérbyer më parë":

Kjo duke qenë e përgjithshme (dhe e papërcaktuar) përmban katër kuptime:

**I Pari:** Kjo që ne u ushqryem éshtë prej punëve tē mira që ne i kryem) nē dynja". Lidhja e fortë midis veprave dhe shpérblimit do tē jetë sikur puna (u transformua) nē ahiret, nē shpérblime tē mishëruara. Dhe ata gëzohen tek kjo.

**I Dytì:** Kjo është ajo që na u dha prej ushqimeve në dynja me këtë diferencë të madhe ndërmjet shijeve të tyre". Dhe ata ndjehen të habitur nga kjo.

**I Treti:** Kjo i ngjason asaj që ne hëngrëm më parë, por ndonëse ajo është e ngjashme në formë është e ndryshme në kuptim meqë ajo kombinon kënaqësitë e familjaritetit -nga njëra anë- dhe variaconin dhe ndryshimin -nga ana tjetër". Dhe ata u kënaqën në këtë.

**I Katerti:** "Çfarëdo që ne hëngrëm nga degët e pemës është zëvendësuar menjëherë, në çast, sikur të ishte ajo që patëm ngrënë". Njihet nga kjo se -frutat-nuk do të pakësohen kurrë.

**Tani fraza** وَأَتُوا بِهِ مِتَّشَابِهَا ve ú'túbihí muteshàbíhen "e atyre do t'u jepen gjëra tē ngjashme":

Kjo është një fjali e ndërshtënë duke konfirmuar e shpjeguar fjalinë e mëparshme, dhe është një përbledhje dhe një shtojcë e saj.

أَتُوا Përdorimi i diatezës pësore në ú'tú "atyre do t'u jepen" tregon se atyre u shërbehet -se ata kanë shërbyes.

Ndërsa مِتَّشَابِهَا "muteshàbíhen" "gjëra tē ngjashme" aludon për kombinimin e dy kënaqësive siç e njeh tashmë.

**Fraza** وَلَهُمْ فِيهَا أَزْوَاجٌ مَطْهُرَةٌ lehum fiha ezvàxhun mutah-heretun "atje do tē kenë bashkëshorte tē pastra":

Në sajë tē lidhjes ndërmjet dy fjalive tē lidhura nga një lidhëse, "ve" (këtu) tregon se ashtu siç janë ata në nevojë për banesa për trupat e tyre, po ashtu ata janë në nevojë për mjete rehatie, qetësie për shpirtërat

e tyre. لَهُمْ "Lehum", "do tē kenë" tregon përcaktueshmëri dhe pronëzim, dhe specifikim, dhe nënkupton se përveç bashkëshorteve të tyre tē kësaj bote, ata do tē kenë huri, të krijuara enkas për ta, për hir të tyre.

فِيهَا Dhe "fi-ha" tregon se këto bashkëshorte do të janë të denja për Parajsë dhe se bukuria e tyre do të jetë në përpjesëtim -raport me shkallën e tyre të lartësuar. Për më tepër, në këtë është një shenjë e fshehur, e mbuluar se parajsa është zbukuruar e stolisur me to.

مَطْهُرَةٌ Fjala "tē pastra" tregon se dikush i ka pastruar e dëlirësuar ato, por mos supozo se dikush i pastruar nga Dora e fuqisë (mund të pëershkruehet)! Qenia e saj një folje kalimtare (Forma e II) sugjeron se gratë e kësaj bote pastrohen e dëlirësohen me qëllim që ato të bëhen aq të bucura si huratë, të cilat janë të bucura nga vetvetja.

وَهُمْ فِيهَا خَالِدُونَ Dhe fraza ve hum fiha khalidûne "dhe atje do tē gëndrojnë përgjithmonë" tregon se ata dhe bashkëshortet e tyre dhe kënaqësitë e parajsës, dhe e gjithë parajsa janë të përjetshme.

\* \* \*

## VËRSETET 26 – 27

إِنَّ اللَّهَ لَا يَسْتَحِي أَنْ يُضْرِبَ مثَلًا مَا بِعُوْضَةٍ فَمَا فَوْقَهَا فَامَّا  
الَّذِينَ آمَنُوا فَيَعْلَمُونَ أَنَّ الْحَقَّ مِنْ رَبِّهِمْ وَآمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا  
فَيَقُولُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ بِهَذَا مثَلًا يُضْلِلُ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ كَثِيرًا  
وَمَا يُضْلِلُ بِهِ إِلَّا الْفَاسِقِينَ \* الَّذِينَ يَنْقُضُونَ عَهْدَ اللَّهِ مِنْ بَعْدِ  
مِشَاقِّهِ وَيَقْطَعُونَ مَا أَمْرَ اللَّهُ بِهِ أَنْ يُوَصِّلَ وَيَفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ  
أُولَئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

In-ne Allâhe la jestahjí en jadribe methelen mà beúdaten femà feukaha Feem-mà el-ledhine aménü fejaëleméune en-nehu el-hak-ku min Rab-bihim. Ve em-mà el-ledhine keferú fejeküline màdhia erâde Allâhu bîhâdhâ methelen. Juâl-lubihî kethíren ve jehdi bishî kethíren ve mà judil-lu bishî il-lâ el-fasikîne. El-ledhine jenkuđíne ahde Allâhi min baëdi mithâ'kihi ve jaktaúne mà emere Allâhu bishî en júsale ve jufsidíne fi el-erdi Ula'ike hum el-khâsirúne.

Sigurisht që Allâhut nuk i vjen zor -tûrp-të sjellë shembull qoftë edhe për një mushkonjë, apo aq më tepër kur ajo tregohet, është më e madhe (apo aq më pak kur ajo është më e vogël) se ajo. Sa për ata që besojnë, ata e dinë se ajo është e vërteta nga Zoti i tyre, por sa për ata që nuk besojnë, do të thonë: "Qfarë don të na thotë Allâhu me këtë shembull?" Me këtë Ai humbet shumë, ndërsa shumë të tjerë i udhëzon. Kështu Allâhu i humbet vetëm ata që janë të panënshtruar ndaj Tij e të shthurur". Ata që thyejnë besën e dhënë Allâhut pasi e pranojnë marrëveshjen me Të dhe ndërpresin çfarë Allâhu ka urdhëruar për të bërë, ndërpresin marrëdhëniet me të afërmimit, dhe kryejnë vepra të ulëta e poshtërsi në tokë. Pikërisht këta janë të humburit.

**Shqyrtoje këtë:** Ndodhen tre aspekte edhe për këto vërsete gjithashtu, që shohin tek renditja e fjalëve -dhe tek pozicionimi dhe lidhjet (*nazmijah*); dhe kuptimi i të gjithë atyre shikon edhe tek vërseti paraprijës edhe tek vërsetet e mëpastajmë, dhe tek Kur'an si një tërsësi.

### Pozicionimi i tyre në lidhje me ato që vijnë pas:

Ti duhet ta dish se kur Kur'ani jep shembujt e harrjeve dhe të merimangave dhe kur flet për Mizat dhe hurmat, çifutët, hipokritët dhe idhujtarët e shohin atë si një rast për ta kundërshtuar -atë- dhe pyesin si budallenj: "A zbret Allahu xh.sh. -pavarësish madhështisë së Tij- të flasë për gjëra të tilla të ulëta, të cilat njerëzit e plotësisë i shpërfillin madje edhe për t'i përmendur:

Kështu Kur'ani u jep atyre një goditje në gojë me këtë vëerset.

### Pozicionimi i tyre në lidhje me ato që i paraprinë.

Nëpërmjet mrekullisë dhe paimitueshmërisë së tij, Kur'ani provon profetësinë e (Muhammedit a.s.m.) dhe duke i sfiduar (kundërshtarët e tij) ai provon mrekullinë dhe paimitueshmërinë e tij; dhe ai provon në fillimin e sures se ai posedon cilësi të larta të cilat nuk gjenden të grumbulluara në ndonjë ligjëratë tjetër (kështu ai i shpartalloi kundërshtarët e tij të cilët) mbetën të heshtur përballë sfidimeve të tij, (heshtën në pikën e sfidës) saqë nuk pulsoi, nuk lëvizi tek ata damari i solidaritetit fisnor, por duke përdorë argumente të rremë, të pabazë ata kundërshtuan çdo (aspekt) të plotësisë së Kur'anit, duke thënë se shëmbëlltyra të tilla, si:

كَمَثَلُ الَّذِي اسْتَوْقَدَ نَارًا  
أَوْ كَحِيبٍ مِّنَ السَّمَاءِ

"Kjo ngjason si me atë që ndezi zjarrin"<sup>1</sup>

"Ose si një shtrëngatë nga qielli (me errësirë)"<sup>2</sup> prej çështjeve të zakonshme që janë shkaku i zbritjes së nivilit të gjuhës dhe kjo i ngjason bashkëbisedimit të njerëzve të zakonshëm. Kështu Kur'ani i godet në kokë ata me këtë vëerset, duke i trulloosur.

Një shpjegim i kësaj: Dyshimet e tyre të dobëta burojnë nga një varg iluzionesh, burimi i të cilave janë një numër gabimesh e sofizmash.

### I Pari:

<sup>1</sup> Kuran, 2:17

<sup>2</sup> Kuran, 2:19

Eshtë një analogji e gabuar, burimi i të cilës eshtë se ata shohin çdo gjë me pasqyrën e asaj me të cilën ata janë familjarizuar -janë mësuar. Sepse ata e shohin një person mendja e të cilit eshtë e pjesshme, mendimi i të cilit eshtë i pjesshëm, folja e të cilit eshtë e pjesshme, dëgjimi i të cilit eshtë i pjesshëm, dhe i cili nuk mund të marrë pjesë - me dy gjëra përnjëherësh, dhe ata e dinë se kriteri për aspiratat e tij eshtë gjëja me të cilën ai preokupohet dhe që i jep rëndësi. Ata e shikojnë se vlera dhe madhështia janë në përpjesët im me ambicjen, saqë ata nuk ia atribuojnë një çështje të ulët dhe inferiore një personi të lartë e madhështor; sepse ata pandehin se ai nuk do ta ulte vetveten të merrej me gjëra të tillë dhe ato gjëra të ulëta e të përbuzshme nuk do ta nxënë -zinin- ambicjen e tij të madhe. Me këtë shikim të rremë ata e shohin Ekzistuesin e Vetëm të Domosdoshëm xh.sh. dhe thonë: "Si do të zbriste Ai me lartësinë dhe me madhështinë e Tij që të fliste me njerëzit dhe të bisedonte në mënyrën e tyre dhe të diskutonte për çështje të këtilla të pjesshme, dhe veçanërisht për këto gjëra të përbuzshme?

A nuk e kuptojnë këta njerëz idiotë se Dëshira e Allahut xh.sh., njohja e Tij, dhe fuqia e Tij janë universale të përgjithshme, të gjithanshme dhe gjithëpërfsirëse, dhe se e vëtmja masë e madhështisë së Tij xh.sh. eshtë tërësia e veprave të Tij, dhe se e vëtmja peshore për manifestimet e Tij janë të gjitha fjalët e Tij të cilat, sikur të gjithë detet të ishin bojë për to, ato (fjalë) nuk do të mbaroheshin kurrë. Për shembull, "Dhe për Allahun eshtë më i larti shembull, krahasim"<sup>3</sup> në qoftë se drita e diellit -duke e supozuar atë të ketë dëshirë dhe vetëdideo të binte mbi një atom të ndotur, të pluhurosur, a do t'i thuhej atij se si me madhështinë e tij ai ka zbritur të merret e të shqetësohet me këtë atom të këtillë?

Po, Allahu xh.sh., ashtu siç e krijoi botën dhe e bëri të skajshëm dhe me përsosurinë dhe u preokupua me të; po ashtu Ai krijoi edhe grimcën më të vockël dhe e modeloi atë me preçionin më të madh dhe me artin. Në shikimin e fuqisë -Hyjnore- nuk ka ndryshim ndërmjet grimcës së vogël dhe planeteve, sepse fuqia, njohja, dëshira dhe Folja e Krijuesit xh.sh. janë cilësi të domosdoshme të brendaqenësishme, të natyrshme. Ato janë të pandryshuara -të paripertërira- dhe as nuk shtohen dhe as nuk pakësohen, dhe nuk janë

<sup>3</sup> Kuran, 16:60

të ndryshme sa të ndërhyjnë në to shkallët (ato nuk kanë shkallë -të cilat do t'u shkaktonin atyre të ishin të ndryshueshme). Sepse pafuqia duke qenë e kundërtë -e fuqisë- nuk mund të ndërhyjë në të. Prandaj nuk ka ndryshim -për të- ndërmjet atomit dhe diellit. Sepse qeniet e mundshme janë të barabarta për sa ka të bëjë me ekzistencën ose mosekzistencën si peshorja me dy pjata: Në qoftë se ato kanë dy diej ose dy atomë, ajo nuk merr më shumë fuqi për ta ngritur njëren dhe për ta ulur tjetrën. Në të njëjtën mënyrë, kriesat janë të barabarta përballë fuqisë (Hyjnore), e cila eshtë e domosdoshme dhe esenciale. Kështu, nuk mund të ketë krahasim midis saj dhe fuqisë së qënieve të mundshme, të cilat janë aksidentale dhe ndryshojnë me ndërhyrjen e pafuqisë midis tyre.

**Shkurtazi:** grimcat e vockëla dhe gjërat e ulëta janë kriesat e Allahut xh.sh., dhe të njohura nga Ai nga domosdoshmëria. Atëherë në mënyrë të pakundërshtueshme dhe të vetëkuptueshme Ai do të flasë rreth tyre. Për shkak të këtij misteri, Ai thotë:

**الْأَعْلَمُ مِنْ خَلْقٍ وَهُوَ الظَّيِّفُ الْخَبِيرُ**  
"A nuk e di Ai i Cili ka krijuar? Dhe Ai eshtë më Dashamirësi (ndaj robërve të Tij), i mirënjohnuri për cdo gjë".<sup>4</sup>

Atëherë, si të mos diskutojë dhe të mos flasë për to Ai që i njeh (ato) dhe i Cili eshtë i Gjithëpushtetshmi, i Gjithurti?

### Gabimi -sofizmi- i dytë

Ata pretendojnë se shohin në stilin e Kur'anit një shëmbëllesë të njeriut prapa Folësit, nëpërmjet përmendjes së tij gjëra të papërfillshme dhe çështje të zakonshme në mënyrën e diskutimeve njerëzore. Por a nuk e dinë këta njerëz të cilët i myllin sytë e tyre -ndaj të vërtetës- se fjala shikon tek Folësi -vetëm- në një drejtim, dhe tek ai të cilit i adresohet shikon në disa drejtime siç kërkohet nga elokuanca, e cila eshtë -të flasësh- në përputhje me -të kuptuarin- e atij të cilit i adresohet. Kështu, meqenëse i adresuari eshtë njeri, dhe ajo që diskutohet janë gjendjet e tij, dhe qëllimi eshtë për t'ia bërë të kuptueshme atij, Kur'ani vesh mantelin e stilit njerëzor, të përzier me

<sup>4</sup> Kuran, 67:14

emocionet njerëzore dhe të quajtura “Begeni -zbritje- Hyjnore” tek mendjet e njerëzve, pér të rehatuar e lehtesar mendjen e njeriut. Ti sigurisht e di se kur flet me një fëmijë, ti duhet të flasësh në gjuhë fëmijërore.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* A nuk janë çikërrimet, gjërat e rëndomta dhe ultësira e gjërave në kundërshtim me lartësinë e Fuqisë - Hyjnore- dhe me pastërtinë e Ligjëratës -Hyjnore?

*Ty do tē tē thuhej:* Papërfillshmëria e tyre, ultësia, shëmtia dhe gjëra të ngjashme me to janë vetëm pér sa ka të bëjë me fytyrën e tyre të jashtme (*mulk*) dhe me fytyrën që na sheh ne dhe me shikimin që duket pér shikimin tonë sipërfaqësor. Shkaqet e jashtme janë vendosur pér të vepruar si ndërmjetës në këtë aspekt, pér të çliruar, pér të nxjerrë të larë lartësinë Hyjnore -prej ndonjë mangësie. Ndërsa fytyra e brendshme e gjërave (*melekutij-jeh el-eshjaë*) është krejtësisht e tejndritshme dhe e lartësuar. Ky aspekt është vendndodhja e Fuqisë (Hyjnore), dhe nuk del asgjë jashtë saj. Kështu, nga njëra anë lartësia (Hyjnore) bën të domosdoshme vendosjen e shkaqeve nga ana e jashtme, dhe nga ana tjetër Uniteti Hyjnor dhe dinjiteti kërkojnë që fuqia dhe ligjérata t'i rrrethojnë e t'i përfshijnë të gjitha gjërat. Një Kur'an i shkruar në grimcat e vockëla mbi një atom nuk është më pak elokuent se sa një Kur'an i shkruar mbi faqen e qelliut me bojën e yjeve. Dhe krijimi i një mize nuk është me art më të vogël se sa krijimi i një elefantit. Kështu, Folja -Hyjnore- është e njëjtë si Fuqia -Hyjnore.

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Atëherë cilës gjëje i referohet kjo ultësi e papërfillshmëri i jashtme në këto shëmbëlltyra?

*Ty do tē tē thuhej:* Ajo nuk i referohet atij që tregon shëmbëlltyrat por atij të cilit i portretizohet -i paraqitet, i pikturohet. Dhe sa më të afërtë tē janë shëmbëlltyrat me gjërat e portretizuara, aq më të mira janë ato dhe më të larta pér nivelin e ligjératës dhe më të lartësuarë pér rregullin e elokuencës. Sigurisht ti e di se një mbret në qoftë se i jep bariut tē tij ndonjë veshje të përshtatshme dhe i hedh qenit një kockë ndjellëse, që i hap oreksin, dhe kështu me radhë, nuk mund tē thuhet se ajo që ai ka bërë është një “*bidat*” -risi- (domethënë, prej vendit), por do tē thuhej se ai ka bërë më të mirën -e mundshme- duke i dhënë secilit atë çfarë është më e përshtashme. Kështu sado e papërfillshme të jetë gjëja e portretizuar, përfaqësimi i saj është gjithashtu i

papërfillshëm, dhe sado e madhe të jetë, përfaqësimi i saj është kështu. Meqenëse idhujt janë më të ulëtat e gjërave, Allahu vendosi harjet pér t'i kërdisur e bezdisur ata. Dhe meqenëse adhurimi i tyre është më e pavlefshmjë e gjërave, Allahu e portretizon atë si cergën e merimangës.

### Gabimi –Sofizmi- i tretë

*Ata thonë:* “Çfarë nevoje ndodhet pér shëmbëlltyra të tilla, të cilat nënkuptojnë se (Kur’ani) është i paaftë pér tē shfaqur realitetin?

*Përgjigjja:* Meqenëse qëllimi i shpalljes së Kur'anit është pér tē udhëzuar masat dhe ata janë njerëzit e zakonshëm; dhe njerëzit e zakonshëm nuk mund t'i kuptojnë të vërtetat e zhveshura -e thjeshtë- dhe idetë abstrakte të zhveshura prej imaginatave të tyre, Allahu xh.sh. me mirësinë dhe me bamirësinë e Tij u veshi të vërtetave veshjet e gjërave familjare -të njobura- pér ta, pér t'i bërë ato më të pranueshme. Ti e ke parë këtë në diskutimin rrëth vërseteve alegorike (në vërsetin 23)

### Pozicionimi (dhe lidhjet) e frazave të vërseteve:

اَنَّ اللَّهَ لَا يَسْتَحْيِي اَنْ يُضْرِبْ مَثَلًا مَا بَعْدَةَ فَمَا فَوْقَهَا

*In-ne Allāhe la jestahjî en jadribe methelen mà beūdaten femà feukaha* “Sigurisht që Allahu nuk i vjen zor -turp-të sjellë shembull qoftë edhe pér një mushkonjë, apo aq më tepér kurr ajo tregohet, është më e madhe (apo aq më pak, kurr ajo është më e vogël) se ajo” refuzon e hedh poshtë vargun -e tyre- të kundërshtimeve. Është sikur ata pyesin: “Cila është arsyja -*hikma*- që Alalhu xh.sh. flet me njerëz, dhe i qorton ata dhe ankohet rrëth tyre, sepse kjo është një shenjë se edhe ata gjithashtu kanë fuqi pér tē vepruar në botë? - Sidomos në qoftë se -ligjérata e Tij- u ngjason bisedimeve që njerëzit i mbajnë ato midis tyre, a nuk nënkupton kjo se ajo është ligjératë njerëzore? dhe veçanërisht në qoftë se imazhi i njeriut është i dukshëm prapa ligjératës? Dhe sidomos në qoftë se (Ai që flet në formën e) alegorive dhe të shëmbëlltyrave, pasi kjo nënkupton paaftësi pér tē piktuuar e paraqitur realitetin? Dhe sidomos në qoftë se shëmbëlltyrat janë të zakonshme, sepse kjo është një shenjë që mendja e folësit është e kufizuar? Dhe veçanërisht në qoftë se ata (pikturojnë e paraqesin) gjëra të rëndomta, pasi tregon mendjelehtësinë e folësit? Dhe veçanërisht në qoftë se ato janë gjëra që nuk duhet të përmenden dhe

do tē ishte mē mirē qē tē shmangeshin? Dhe veçanerisht nē qoftë se disa janē gjéra tē cilat njerëzit krenarë -sedermëdhenj- nuk do ta ulnin veten qē t'i flasin. Dhe veçanerisht nē qoftë se folësi është dikush i madh dhe i rëndësishëm? Kështu, Kur'an u përgjigjet dhe e shkallmon këtë zinxhir nga fillimi nē fund me një goditje tē vetme *In-ne Allâhë la jestahj "Sigurish që Allâhut nuk i vjen zor -turp"*;

Sepse fytyra e brendshme -e gjérave- (*melekutijeh*) nuk është nē kundërshtim me madhështinë dhe lavdinë e Tij, dhe Ai nuk neglizhon dhe nuk lë jashtë asgjë. Hyjnia e bën tē domosdoshme këtë. Prandaj Ai portretizon -paraqet- gjëra tē papërfillshme pér -të shprehur- kuptime tē papërfillshme, sepse urtësia dhe e vërteta -misteri- i elokuencës e bëjnë tē domosdoshme këtë. Dhe prandaj Ai parashtron shëmbëlltyra tē zakonshme meqë ato bëjnë tē mundur pér t'u arritur edukimi dhe udhëzimi. Dhe pér këtë Ai i pikturnon, i paraqet tē vërtetatat nëpërmjet shëmbëlltyrave meqë kjo bëhet e domosdoshme nga mirësia dhe nga begenia Hyjnore.

Dhe prandaj Ai zgjedh pér tē foluar nē mënyrën e bisedimit njerëzor meqë kjo bëhet e domosdoshme nga Hyjnia -*Rububijeh-* dhe nga instruksioni. Dhe prandaj Ai flet me njerëzit meqë kërkohet nga urtësia dhe nga rregulli -i gjérave.

**Shkurtazi:** Kur Allahu xh.sh. vendosi aftësinë e vullnetit tē lirë (*Xhuz'i ihtijarij*) nē njeriun dhe e bëri atë burimin (*masdar -emrin* foljor, formën e thjesht) tē botës së akteve, Ai dërgoi fjalën e Tij (*kelam*) me qëllim qē ta vëré atë botë nē rregull.

**Pozicionimi (pér sa ka tē bëjë me frazën paraprirëse) tē frazës**

فَامَّا الَّذِينَ آمَنُوا فَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ الْحَقُّ مِنْ رَبِّهِمْ  
*Feem-mà el-ledhine àmenú fejaëleméne en-nehu el-hak-ku min Rab-bisim* “Sa pér ata qē besojnë, ata e dinë se ajo është e vërteta nga Zoti i tyre”.

Me këtë frazë (Kur'an) tregon rrugën pér tē provuar pohipmin e bërë nga fraza e mëparshme. Ajo aludon gjithashtu pér rrugën pér tē zmbrapsur e larguar iluzionet dhe frikësimet e pabaza. Domethënë, kushdo qē sheh me dritën e besimit, dhe nga këndvështrimi i Allahut xh.sh. dhe nga aspekti i fuqisë së Tij duke mbajtur nē mendje urtësinë e

Tij, mirësinë dhe Hyjninë, do ta njohë se kjo (shëmbëlltyrat janë) tē vërteta dhe nē harmoni me elokuencën.

Por personi i cili shikon prej thellësirave tē nefsit tē tij dhe nga këndvështrimi i qënieve tē mundshme është i prirur tē térheqë iluzionet. Kjo u ngjason dy njerëzve tē cilët u ngjitet lart kodrës dhe zbritën poshtë luginës derisa hasën një numër rrëkesh. Njëri prej atyre tē dyve vazhdoi tē ngjitet lart dhe erdhi tek burimi.

Ai shijoi ujin dhe e gjeti atë tē pastër, tē freskët e tē shijshëm. (Pastaj ai zbriti dhe) sa herë qē takonte rastësish tē një pjesë uji prej degëve tē rrëkeve ai e njihte atë tē jetë i mirë -edhe pse ishte me treguesin më tē dobët, me dëshminë më tē vogël- dhe asnje iluzion nuk mund ta çudhëzonte atë edhe sikur ai (iluzion) tē ishte i fuqishëm. Ndërsa tjetri vazhdoi duke zbritur dhe e pa ujin prej degëve. Ai nuk (u ngjit dhe as nuk) e pa burimin dhe prandaj kishte nevojë pér dëshmi tē fortë me qëllim qē ta njihte se ishte i mirë prej tē gjitha sasive tē vogëla tē ujtit qē ai hasi rastësish, nëse çdo pjesë uji ishte ose jo i ëmbël. Dhe iluzioni më i vogël e hodhi atë nē dyshim.

Ose ajo u ngjason dy njerëzve midis tē cilëve është një pasqyrë: njëra prej tyre shikon tek fytyra e saj e tejdukshme, ndërsa tjetri shikon tek fytyra e saj e ngjyrosur, tek ana e prapme.

**Shkurtazi:** Kur duke vështruar artin e Krijuesit xh.sh. njeriu duhet tē shikojë nga këndvështrimi i Tij xh.sh. (**min Xha'nibihi**) dhe ta vërejë përkujdesjen dhe Hyjninë e Tij. Kjo është tē shohësh me dritën e besimit, kurse iluzionet -edhe më e fuqishmja e tyre- bëhet më e brishtë dhe e dobët se cerga e merimangës. Por nē qoftë se e shikon (artin Hyjnor) nga këndvështrimi i qënieve tē mundshme, me shikimin e ngushtë tē blerësit dhe me mendimin e tij tē pjesshëm, atëherë iluzionet e dobëta do tē fuqizoheshin nē shikimin e tij dhe e vërteta do tē fshihej prej tij, ashtu si krahu i një mize qē mund tē pengojë syrin prej shikimit tē Malit Xhudi.

وَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا ... *Ve em-mà el-ledhine keferú “por sa pér ata qē nuk besojnë, mohuan”*: Duke pas treguar rrugën pér tē kuptuar urtësinë nē shëmbëlltyra, qē është tē shohësh me dritën e besimit nga këndvështrimi i Ekzistuesit tē Vetëm tē Domosdoshëm, ajo shpjegon këtu rrugën e kundërt, e cila është burimi i iluzioneve dhe i

shkaterrimeve. Kjo eshtë pér shkak se ajo shikon nga ana e nefsit, nēpērmjet errēsirēs sē mosbesimit e cila e imaginon çdo gjë tē jetē e errēt, dhe me një sēmundje tē zemrēs qē madje edhe iluzioni mē i vogël i shkakton qē tē bēhet shtypëse e mbytëse. Pastaj -një person i tillē-humbet rrugën e vërtetë, dhe pastaj ai lëkundet, eshtë ndërddyshas dhe pastaj fillon tē bëjë pyetje, dhe pastaj ai mohon. Kështu, nē ményrë tē pērbledhur dhe aluduese, duke treguar tē pyeturin -e mosbesimtarëve- me nuanca mohimi, Kur'ani thotë:

ماذَا ارَادَ اللَّهُ بِهَذَا مُثْلًا *mâdha erâde Allâhu bîhâdhâ methelen* "do tē thonë":

"Qfarë don tē na thotë Allahu me këtë shembull?" nē vend tē "ata nuk e dinë", ndonëse nē ményrë tē qartë kjo do t'i kiske korresponduar (يَعْلَمُونَ "ata e dinë" nē) frazën e mëparshme.

**Posicionimi i frazës** يُضُلُّ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ كَثِيرًا *Judîl-lubihi kethîren ve jehî bîhi kethîren* "Me këtë Ai humbet shumë, ndërsa shumë tē tjerë i udhëzon": Kjo eshtë përgjigjja pér pyetjen -e mosbesimtarëve- (nē frazën e mëparshme). Pér tē qenë tej mase e përbledhur dhe e thukët, ajo e bën rezultatin (e shëmbëlltyrés, domethënë udhëzimin dhe çudhëzimin) arsyen përfundimtare pér tē (*el il-le el-gaijeh*); domethënë udhëzimi dhe çudhëzimi nuk janë arsyaja e nëntëshme pér shëmbëlltyrën; qëllimi i saj eshtë tē paralajmërojë dhe tē japë udhëzim pér njerëzit) dhe ata pyesin:

"Pérse ishte kështu? Dhe pérse mrekullia e tij nuk eshtë e qartë dhe e vetëkuptueshme? Dhe pérse ajo nuk ishte medoemos Fjala e Allahut? Dhe pérse ajo jep rastin pér dyshime dhe iluzione nēpērmjet këtyre shëmbëlltyrave? Kështu Kur'ani (i largon tē gjitha këto pyetje) duke

thënë: يُضُلُّ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ كَثِيرًا *Judîl-lubihi kethîren ve jehî bîhi kethîren* "Me këtë Ai humbet shumë, ndërsa shumë tē tjerë i udhëzon".

Kjo eshtë pér shkak se kushdo qē reflekton mbi shëmbëlltyrat me dritën e besimit shtohet nē dritë, ndërsa kush i shqyrtion ato me errësirën e mosbesimit (me një vështrim pér) t'i kritikuar, shtohet nē errësirë. Dhe kjo eshtë pér shkak se (Kur'ani) eshtë teorik (*nedharij*) dhe jo i dukshëm, i vetëkuptueshëm (*bedihij*). Dhe kjo eshtë kështu e

lartësuar, qē shpirtërat e pastër mund tē dallohen prej shpirtërave tē turbullt e tē ulët. Dhe kjo eshtë pér shkak qē aftësitë -potencialet- e larta tē mund tē dallohen nēpērmjet progresit tē tyre prej aftësive tē ndyra. Dhe kjo eshtë kështu qē natyrat e shëndosha tē mund tē dallohen nēpērmjet zhvillimit tē tyre, përpjekjes dhe ushtrimit prej natyrave tē kalbura e tē prishura. Dhe kjo bën tē domosdoshme provimin e njeriut. Dhe kjo e kërkon qënien e tij tē testohet e tē sprovohet. Dhe kjo kërkon përgjegjshmërinë e tij pér shkak tē obligimeve tē vendosura mbi tē (*eltakif*), pér ta plotësuar njeriun dhe pér lumturinë e tij. Sa nē ményrë tē pērbledhur e tē ngjeshur përgjigjet Kur'ani!

- Në qoftë se ti do tē pyesje: Ti thua se obligimet e vendosura mbi qëniet njerëzore dhe përgjegjshmëria e tyre janë pér tē siguruar lumturinë e tyre, por ama ato janë shkaku qē shumica e tyre tē bien nē mjerim. Në qoftë se nuk do tē kiske qenë kjo përgjegjshmëri, nuk do tē kiske qenë një ndryshim i madh ndërmjet njerëzve?

Ty do tē tē thuhej: Allahu xh.sh. ashtu siç e ngarkoi njeriun me aftësinë e vullnetit tē lirë (*elxhuz'ë el-ihtijarij*) dhe e ngarkoi atë (*el-teklif*) nēpērmjet saj (nēpērmjet fitimit tē saj -*bikesbih*) pér tē formuar botën e akteve tē vullnetshme; po ashtu Ai e bëri këtë obligim mjetin pér tē vadirur farërat e pakufishme tē mbjella nē shpirtin njerëzor dhe pér mugullimin e tyre. Në qoftë se nuk do tē kiske qenë obligimi, ato farëra nuk do tē mbinin. Në qoftë se do ta studioje thellë historinë (*ahval*) e njerëzimit, ti do tē shihje se tē gjitha përparimet e shpirtit (njerëzor), dhe tē gjitha plotësimet Hyjnore tē ndërgjegjjes dhe plotësimi i intelektit, dhe përparimet produktive nē mendim tē cilat janë aq tē mëdhaja sa tē habisin, kanë ndodhur vetëm pér shkak tē përgjegjshmërisë së njeriut, dhe -ato aftësi- duke u zgjuar nga dërgimi i profetëve dhe nga plenimi -fekondimi- i ligjeve fetare, dhe nga inspirimi i feve; po tē mos kishin qenë ato, qëniet njerëzore do tē kishin mbetur si kafshë dhe ato plotësime tē ndërgjegjjes dhe tē virtyteve morale do tē kishin qenë mosekzistuese. Një pakicë mori përgjegjësinë (dhe ndërmori obligimet) me vullnet tē lirë dhe ata fituan edhe lumturinë pér vetveten dhe ishin mjeti pér lumturinë e racës njerëzore. Sa pér shumicën, nē sasi -ata edhe nē qoftë se mohuan me zemrat e tyre dhe nē ato zona nē tē cilat ata ishin tē lirë, meqenëse jo çdo qëndrim dhe çdo cilësi e çdo mosbesimtari buron prej mosbesimit tē tij, pér shkak se profetët i zgjuan ndjeshmëritë e ndërgjegjjes njerëzore dhe zgjuan sensin e saj moral, ligjet e shenjta (qē ata sollën) u dëgjuan dhe

veprat e tyre janë tē njohura, (dhe shumica) i pranoi me hir e me pahir-dashur e pa dashur- disa nga obligimet (me tē cilat është ngarkuar njeriu).

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Si mundet që lumturia pér pakicën dhe mjerimi pér shumicën tē janë lumturi pér racën njerëzore, që sheriajt është mëshirë? Sepse lumturia e racës njerëzore do tē mund tē (arrihej) vetëm nëpërmjet (lumturisë) së tē gjithëve ose (tē paktën) tē shumicës?

*Ty do tē tē thuhej:* Në qoftë se ti ke njëqind vezë dhe ti i vendos ato nën një pulë, dhe njëzet kulloçiten, ngrohen, dhe tetëdhjetë nuk çelin (zogj), a nuk do tē thoje ti se u plotësua ky lloj? Sepse njëzet zogj tē gjallë pule janë tē barabartë me mijëra vezë. Ose në qoftë se ti ke njëqind bërthama hurme dhe i (mbjell dhe) i ujit, dhe njëzet prej tyre do tē bëheshin palma-hurma- kurse tetëdhjetë kalben , a nuk do tē thoje ti se uji është lumturi pér specien? Ose në qoftë se ti do tē kiske ndonjë metal, mineral dhe ti e shkrin atë, dhe një e pesta bëhet flori dhe pjesa e mbetur kthethet në skorie e zgjyrë, atëherë a nuk është zjarri mjeti i plotësimit dhe i shkëlqimit tē tij (Fjalë pér fjalë, i lumturisë së tij)? Ti mund tē bësh shembuj tē tjerë në tē njëjtën mënyrë. Atëherë, si rrjedhojë, vetëm nëpërmjet përpjekjes zbulohen ndjeshmëritë e larta dhe zhvillohen moralet (e larta); dhe vetëm nëpërmjet konfrontimit tē tē kundërtave dhe garës -konkursit- plotësohen e përsosen gjérat. Ti sigurisht e di se në qoftë se një qeveri ose një shtet përpinqet dhe ushtrohet, guximi i saj rritet, ndërsa në qoftë se ajo heq dorë nga përpjekja guximi i saj mbaron, shuhet. (Domethënë, në qoftë se braktis xhihadin, ajo humbet kurajon e saj dhe iniciativën). Reflekti mbi këtë!

**Tani pozicionimi i frazës** ve mà judil-lu bihí il-là el-fasikíné “Kështu Allahu i humbet vetëm ata që janë tē panënshtruar ndaj Tij e tē shthurur”:

بِضُلُّهُ كَثِيرًا  
Pér shkak tē paqartësisë së frazës (së mëparshme), *Judil-lubihi kethiren* “Me këtë Ai humbet shumë”; kjo paralajmëron e zgjon mendjen e dëgjuesit, dhe e turbullon dhe e trazon atë, dhe ai pyet: kush janë këta njerëz që humbasin rrugën, që çudhëzohen? Cila është arsyja? Dhe si mund tē vijë errësira prej dritës së Kur'anit?

Kështu -Kur'ani- përgjigjet: (Ata humbasin rrugën, çudhëzohen) pér shkak se janë tē shthurur dhe janë shmangur nga rruga e drejtë (janë *fasikine*). Çudhëzimi është dënim i pér shthurjen e tyre. Dhe pér shkak tē saj -shthurjes- drita bëhet zjarr pér ta, dhe ndriçimi bëhet errësirë”. Sigurisht ti e di se drita e diellit e kalbëson lëndën e ndyrë.

Aspektet (e ndryshme të mëkatit, shthurjes (*fish*) pérshkruhen në (vërsetinvjues):

الَّذِينَ يَنْقَضُونَ عَهْدَ اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مِيَاثِيقَ وَيَقْطَعُونَ  
مَا أَمْرَ اللَّهُ بِهِ أَنْ يُوَصَّلَ وَيَفْسَدُونَ فِي الْأَرْضِ

*El-sedhîne jenkydûne ahde Allâhi min baëdi mithâ'kisi ve jaktaúne mà emere Allâhu bihí en júsale ve jufsidûne fi el-erdi*

“Ata që thyejnë besën e dhënë Allahut pasi e pranojnë marrëveshjen me Të dhei ndërpresin çfarë Allahu kë urdhëruar pér tē bëre, ndërpresin marrëdhëniet me tē afërmit, dhe kryejnë vepra tē ulëta e poshtërsi në tokë”.

Kjo shpjegon dhe zbulon (se nga se përbëhet) shthurja (*fish*), sepse shthurja është heqje dorë dhe shmangie nga e vërteta dhe tē tejkalosh caqet dhe dalje prej guaskës së fortë (të udhëzimit tē drejtë). Ajo - shthurja- ose është tepri (*ifrat*) ose mangësi (*tefrît*) në tre fuqitë e intelektit tē zemërimit dhe tē dëshirave shtazore. Dhe tepria dhe mangësia çojnë në rebelim përballë dëshmive që janë si konventa – besëlidhje Hyjnore (*el-uhud*) në krijim (*el-fitre*). Ato gjithashtu janë dy mjete që çojnë në sëmundje personale; atributi i parë (në vërsetin lart) e tregon këtë.

Gjithashtu ato nxisin rebelim përballë jetës sociale dhe këpusin e thyejnë -lidhjet dhe ligjet e jetës shoqërore. Atributi i dytë e tregon këtë. Ato gjithashtu shkaktojnë korruption dhe përbysje, gjë tē cilat prishin rendin në tokë, ashtu siç tregohet nga atributi i tretë. Po, kur intelekti i tij tejkalon caqet e moderimit personi i shthurur i theyn, këput hallkat e teorive tē besimit dhe copëton guaskën e tyre tē fortë, domethënë, jetën e përhershme. Dhe kur fuqia e dëshirave shtazore kalon caqet dhe ai ndjek dëshirat e tij, mëshira pér (qëni humane tē) racës së tij zhduket nga zemra e tij dhe ai i korrupton njerëzit dhe

shkakton vështirësi për ta në çfarëdo gjëje që ai përfshihet, dhe i shkakton dëm racës njerëzore dhe prish rendin e tokës.

**Pozicionimi i frazës:** أُولَئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ “Ulā'ike hum el-kħàsirún”, “Pikérishit këta janë tē humburit”.

Duke pas përmendur krimet e tē shthururit dhe duke i pasë frikësuar ata, (Kur'an) përforcon kërcënimin e tij (duke përmendur) fundet e tyre dhe dënimin, me qëllim që t'i frikësojë në mënyrë më tē efektshme. Dhe ai thotë: Ata pësojnë humbje duke shitur Ahiretin për këtë botë dhe duke shkëmbyer udhëzimin për kapriçot e tyre”.

**Tani le tē fillojmë (duke analizuar) pozicionimin (dhe lidhjet) e pjesëve tē frazave:**

**Shqyrtoje këtë:** vërsetet dhe frazat e tyre dhe pjesët u ngjasojnë akrepave tē një ore që tregon sekondat, minutat dhe orët. Në qoftë se provon një gjë, një tjetër e mbështet atë sipas shkallës së saj; dhe tjetra e ndihmon atë aq sa tē ketë mundësi. Gjithashtu, në qoftë se kjo dëshiron diçka, ajo e ndihmon atë, dhe tjetra i vjen në ndihmë asaj në një mënyrë që ajo tē kujton vargjet vijuese:

عَبَارَاتُنَا شَتَىٰ وَحُسْنُكَ وَاحِدٌ وَكُلُّ إِلَى ذَاكَ الْجَمَالِ يُشَيرُ

Frazat tona janë tē ndryshme por bukuria jote është Një,

Dhe tē gjitha ne tregojmë atë bukuri.

Në sajë tē këtij misteri, rrjedhshmëria e Kur'anit dhe niveli i tij i lartë dhe i shquar dhe hollësia dhe hijeshia e qëndisjeve tē tij arrin shkallën e mrekullisë.

إِنَّ اللَّهَ لَا يَسْتَحِي إِنْ يَضْرِبُ مَثَلًا مَا بِعُوْذَةٍ فَمَا فَوْقَهَا

**Pjesët e frazës:** In-ne All-lâhe la jestahjí en jadribe methelen mà beúdaten femà feukaha Sigurisht që Allahu nuk i vjen zor -turp-tē sjellë shembull qoftë edhe për një mushkonjë, apo aq më tepër kur ajo tregohet, është më e madhe (apo aq më pak kur ajo është më e vogël) se ajo.

**Shqyrtoje këtë:** “Pjesëza انَّ “in-ne”, “në tē vërtetë, sigurisht” është mbështetëse dhe (qëllimi i saj është) për tē larguar ngurrimin dhe për tē hedhur poshtë mohimin. Po ashtu ajo tregon vargun e ngurrimeve - dyshimeve- tē përmendura më parë. Fjala اللَّهُ “Allah” është -përdorur- për tē paralajmëruar e zgjuar mendjen e -dëgjuesit- kundra gabimit tē (bërges së) krahasimit tē lartëpërmendorur.

Zgjedhja e لا يَسْتَحِي la jestahjí “nuk i vjen zor -turp” në vend tē لا يَرْكُ “La jetruku”, “nuk e lë”, ndonëse “el-haja'ë”, “turpi” -e cila është një térheqje e vetes- është e pamundur që t'i referohet (Krijuesit) xh.sh. dhe është e kotë tē diskotosh tē pamundurën -tregon se meqenëse gjëra tē tila si urtësia, elokuenca dhe kështu me radhë, bëjnë tē domosdoshme një shëmbëlltyrë tē hollë, nuk ka arsy për ta lënë - braktisur- përvèç turpit (el-hajaë), dhe meqenëse turpi është i pamundur për më tē Lartin xh.sh., atëherë nuk ka asnjë arsy për lénie - braktisje: Kështu, ai i hesht (mosbesimtarët) në mënyrën më tē efektshme dhe tē hollë. Për më tepër, ai aludon nëpërmjet (figurës letrare -me anë tē tē cilës format e ngjashme shprehin kuptime tē ndryshme, tē quajtura) *Mushakale el-suhbe*, për fjalë tē marra -pa mend, që ata thonin: “A nuk ka turp Zoti i Muhammedit nga këto shëmbëlltyra rrëth gjërave tē rëndomta?” (Domethënë, që përdor shprehjen që ata përdornin me qëllim që tē refuzojë atë që ata thonin).

Zgjedhja e إن يَضْرِبَ “en jadribe”, “tē sjellë shembull, tē godasë” në vend tē “shëmbëlltyrave tē ulëta” (*min methelil hakir*) megjithëse kjo e dyta është më e përshtatshme, tregon një hollësi stilistikore që është se një shëmbëlltyrë i ngjason goditjes -vëni së vulës me qëllim që tē afirmojë e tē vërtetojë (diçka), ose (i ngjason) ose prerjes -goditjes- së monedhës për tē vendosur vlerën dhe besueshmërinë (e parasë). Dhe kjo sugjeron se shëmbëlltyrat e holla dhe krahasimet i largojnë dhe i zmbrapsin dyshimet dhe iluzionet. Gjithashtu, ajo tregon se shëmbëlltyrat janë një metodë e mirënjohur, e vlerësuar dhe e aprovuar. Dhe dhënia e shëmbëlltyrave është prej rregullave tē njohura.

Për më tepër, zgjedhja e **أن يضرب** “en jadribé”, “të sjellë shembull, të godasë” (e cila është në kohën e pakryer) në vend të emrit folor **ضرب** **darb**, **goditje** ndonëse kjo është më konçize, e thukët, është për të treguar se burimi i kundërshtimeve -të mosbesimtarëve- është çikerrima -bajatësia (e gjësë së përfaqësuar në shëmbëlltyra, dhe jo vetë shëmbëlltyrat, të cilat janë të dobishme).

Sepse duke qenë një folje, **أن يضرب** “en jadribé”, “të sjellë shembull, të godasë” nuk është e pavarur (e vetëmjaftueshme); ajo duket joreale - imagjinare-, kështu mendja kalon tek kundrinori. Por, për shkak se - emri folor- **ضرب** **darb**, **goditje** është i pavarur, ai është i dendur dhe pengon mendjen.

Fjala **مثلاً** “shembull” aludon për atributin e veçantë të shëmbëlltyrave dhe të alegorive (el-temthil), i cili është për të pikturnuar e përshkruar gjërat abstrakte me ato konkrete; dhe për ta përfaqësuar imagjinaren me realen, dhe për të portretizuar të fshehtën me të dukshmen. Dhe kjo është një shenjë se ato i largojnë dyshimet dhe ngurrimet.

Pashquarsia e **مثلاً** “methelen”, “shembull” tregon se ajo që është e rëndësishme është vetë shëmbëlltyra, dhe jo karakteri -vetia- (që ajo merr nëpërmjet gjësë që ajo portretizon), e cila lidhet me atë që kërkohet nga konteksti (el-mekam) ose nga situata e gjësë që ajo pikturnon.

Përgjithshmëria e **ما** “ma” tregon se rregulli i (shëmbëlltyrës) është i përgjithshëm, kështu që përgjigjja nuk duhet të (konsiderohet) e veçantë për kundërshtimet e tyre; (dhe duhet të kuptohet se) gjëja e pikturnuar -përshkruar- do të marrë çfarëdo llojë forme të domosdoshme e të vlerësuar e përshtatshme nga (shkenca e) retorikës (elokuencës el-belagah).

(Përmendja e) specifikuar **بعوضة beúdaten** “mushkonje” shikon tek përdorimi parabolik -alegorik- i shpeshtë i tyre prej profesorëve të elokuencës (el-bulega’e) në shprehje të tilla si: “Ad’af minel beudah” dhe “ve esheddu inaden minel beudah”; dhe “Kel-lefetni muh-hul beudah”, “eazz min muh-hil beudah”, dhe “Ve kaletil beudah lin-nahleti istimsiki ene etiru” dhe “Ed-dunja la tuzenu indall-lah xhunaha beudah”. Dhe kështu me radhë. Ajo gjithashtu sugjeron dobësinë e dyshimeve të tyre.

**ما فوقة** **mà feukha** “më e madhe (apo aq më pak kur ajo është më e vogël)” është se ajo që është më e vogël në masë, vëllim, ose çfarë është prej një vlere më të lartë sipas elokuencës, ose çka është më e ulët edhe në vlerë edhe në masë -vëllim.

Gjithashtu fraza nënkupton se gjërat e vogëla janë më të jashtëzakonshme, që bien në sy, në shikimin e elokuencës, dhe më e zgjedhur dhe e hollë në krijimin (e tyre).

**Shqyrtojë këtë:** Pjesët e këtyre frazave janë si fijet e mëndafshta të cilat duke u sjellë së bashku shfaqin një qëndisje të hollë.

#### Tani pjesët e fjalisë

فَامَّا الَّذِينَ آمَنُوا فَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ الْحَقُّ مِنْ رَبِّهِمْ  
وَامَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَيَقُولُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ بِهَذَا مِثَالًا

*Fe em-mà el-ledhine àmenú fejaëlemúnë en-nehu el-hak-ky min Rab-bihim.  
Ve em-mà el-ledhíne keferú fejekálúne mādha eràde All-làhu bihàdhà methelen”*  
“Sa për ata që besojnë, ata e dinë se ajo është e vërteta nga Zoti i tyre, por sa për ata që nuk besojnë, do të thonë: “Çfarë don të na thotë Allahu me këtë shembull?”:

**Shqyrtoje këtë:** Lidhëzja **ف** “Fe” (shpreh) degëzimin ose përhapjen (el-tafri) (të kësaj fjalie prej asaj të mëparshmes), dhe kjo tregon një provë të nënkuptuar e cila prodhon këtë fjali me dy *pjesët* e saj. Domethënë, (Allahu) nuk e lë dhënen e shëmbëlltyrave sepse elokuencia i kërkon ato, dhe njerëzit që janë të drejtë e dinë se ato janë

elokuenta dhe tē vērteta dhe fjala e Allahut. Ndērsa ata qē me kryenečesi i kundērshojnē ato dhe nuk e njohin urtēsinē (nē to), dhe kēshtu janē ngurrues dhe pyesin (rreth tyre), dhe pastaj i mohojnē (ato), dhe pastaj i shohin ato si tē rēndomta e bajate. Si rijedhojē, meqenēse besimtari eshtē i drejtē, ai afirmon se shēmbälltyra eshtē fjala e Allahut, ndērsa pēr shkak se mosbesimtari eshtē kryeneç, ai pyet: Cila eshtē dobia e kēsaj?

**أَمَا** Meqenēse **“em-mā”**, **“sa pēr ata”** shpreh kusht dhe domosdoshméri, (kētu) ajo tregon se kallēzuesi (*ata e dinē se ajo eshtē e vērtetē*) eshtē njē pasojē e domosdoshme e kryefjalēs **“ata qē besojnē”**, domethēnē, kallzuesi (pēr tē njohur tē vērtetēn) eshtē karakteristikē e kryefjalēs (ata tē cilēt besojnē).

Pērdorimi i **الذين أمنوا** **el-ledhine amenu** “pēr ata qē besojnē” nē vend tē **المومنون** **el-mueminune** “besimtarēt” eshtē njē tregues i qartē se besimi eshtē arsyea qē ata e dinē se ajo eshtē e vērteta, dhe se njohja qē ajo eshtē e vērtetē eshtē besimi.

Dhe pērdorimi i **انه الحق** **en-nehu el-hak-ku** “se ajo eshtē e vērteta” nē vend tē **انه البليغ** **“se ajo eshtē elokuenta”**, ndonēse kjo do tē kishte qenē mē me vend nē kētē kontekst, aludon pēr konkluzionin (logik) tē kundērshtimeve tē tyre, sepse qēllimi i tyre eshtē tē mohojē qē - Kur’ani- eshtē fjala e Allahut.

Kufizimi i shprehur nga **انه الحق** **en-nehu el-hak-ku** “se ajo eshtē e vērteta” (domethēnē, ajo duke qenē e drejtē eshtē e kufizuar pēr atē shēmbälltyrē), eshtē njē shenjē se nē kundērshtim me atē qē ata pretenduan, eshtē pikērisht kjo (shēmbälltyrē e mushkonjēs, mizēs) qē eshtē e aprovar (nga shkenca e retorikēs) dhe nuk gjendet e papēlqyeshme dhe e pakēndshme. (Nē pērputhje me kētē, njē metaforē tjetēr nuk do tē ishte e pranueshme edhe sikur tē ishte pa defekt), sepse qēnia e lirē nga defektet -qēnia pa mangēsi- nuk provon plotēsimin (e njē gjēje).

من ربهم **min Rab-bihim** Fraza **“nga Zoti i tyre”** tregon se synimi dhe qēllimi i tyre eshtē tē mohojē (se shēmbälltyra) eshtē shpallur (nga Krijuesi i tyre).

وَآمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا **أَمَا** Lidhēzja **“em-mā”**, **“sa pēr, nē”** nē **em-mā el-ledhine keferū** shpreh theksim, mbēshtetje dhe pērcaktim me hollēsi. Ardhja e **الَّذِينَ كَفَرُوا** **“el-ledhine keferū”** **“qē nuk besojnē, tē cilēt mohuan”** nē vend tē **الْكَافَرُونَ** **“mohuesit”**, ndonēse kjo e fundit eshtē mē konçize, e thukēt, nēnkupton se mohimi i tyre buron nga mosbesimi dhe çon tek ai - mosbesimi- ashtu siç eshtē pērmendor.

فَيَقُولُونَ **فيقولون** Dhe **fejekūlūne** “do tē thonē” eshtē pērdorur nē vend tē **فَلَا يَعْلَمُونَ** **fela jaēlemune** “ata nuk e dinē”, megjithēse ashtu siç eshtē pērmendor, e fundit eshtē mē e qartē, pēr shkak se pēr tē bērē aluzion eshtē mē konçiz, mē e ngjeshur; domethēnē, personi qē nuk beson nuk e njeh tē vērtetēn dhe kjo i shkakton atij tē ngurrojē, tē jetē mēdyshas; dhe kjo çon -sē pari- nē mohim dhe pastaj nē bērjen e pyetjeve pērqmuese e nēnvleftesuese.

Pēr mē tepēr, **“Jekulūne”**, **“do tē thonē”** nēnkupton se ashtu siç janē ata tē çudhēzar, po ashtu me fjalēt e tyre ata i çojnē tē tjerēt nē çudhēzim, nē rrugē tē shtrembēr.

Tani (pozicionimi dhe liidhjet e) pjesēve tē frazave,

**يُضْلِلُ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ كَثِيرًا** **Judīl-lubihî kethîren ve jehâdî bihi kethîren** “Me kētē Ai humbet shumē, ndērsa shumē tē tjerē i udhēzon”:

**شَقِيرْتُهُ** kētē: kētu rregullimi, renditja, (*el-terrib*) kērkon qē - fraza- e dytē tē vijē nē fillim (pēr t'i korresponduar tē mēparshmes **الَّذِينَ أَمْنَوْا** **El-ledhine amenu** “qē besojnē” nē vērset), por meqenēse qēllimi eshtē pēr tē hedhur poshtē kundērshtimet ngurruese, pyetēse

dhe tē neveritshme qē kanē shijen e mohimit, يُضْلِلُهُ Judil-lu “Ai humbet” éshtë mē e rëndësishme.

Mospërdorimi i emrave foljorë “*Dalaleh dhe hidajeh*” “*Cudhëzim, udhëzim*” dhe përdorimi i kohës së pakryer tē foljes tregon se errësira e mosbesimit intensifikohet në mënyrë tē përpjesëtar me shpalljen graduale (tē Kur'anit), ashtu si besimi i besimtarëve qē shtohet në mënyrë tē përpjesëtar në dritësi.

Për mē tepér, si përgjigje (për pyetjen e tyre *mâdhfa erâde Allâhu bîhâdhâ methelen*) “*Qfarë don tē na thotë Allahu me këtë shembull?*” forma follore sugjeron se ajo éshtë duke shpjeguar situatat e dy grupeve, dhe duke shpjeguar -zgjedhjen e- arsyeve (për to).

**كَثِيرًا** Sa për “*kethïren*”, “*shumë*”, e para (ata qē kanë humbur rrugën) shpreh sasi dhe numër, ndërsa e dyta, (tē udhëzuar drejt) shpreh cilësi dhe vlerë.

Po, njerëzit bujarë e fisnikë janë shumë (për shkak tē vlerës së tyre tē lartë) edhe sikur tē jenë tē pakët (në numër). I Dytë **كَثِيرًا** “*kethïren*”, “*shumë*” gjithashtu éshtë një aluzion pér misterin e qënies së Kur'anit një mëshirë pér njerëzimin. Tani hulumtoje këtë!

**Fraza** ve mà judil-lu bîhî il-la el-fasikfîne “Kështu Allahu i humbet vetëm ata qē janë tē panënshtruar ndaj Tij e tē shthurur”.

**Shqyrtoje këtë:** Duke shpjeguar këtu se cilët janë tē çudhëzuarit, (Kur'ani) largon dyshimet, frikën dhe ngurrimin (tē shkaktuara nga “*kethïren*” lart “*Judil-lubîhi kethïren*”, “*humbet shumë*”, dhe hedh poshtë akuzën se Kur'ani qenka i mangët.

(Ajo shpjegon) se burimi i çudhëzimit tē tyre éshtë shthurja e tyre, dhe se shkaku i saj éshtë ajo qē ata kanë bërë (*kesbuhum*) dhe se gabimet janë tē tyre, dhe jo tē Kur'anit, dhe se krijimi i çudhëzimit

éshtë ndëshkim pér aktet e tyre. Kupto gjithashtu se secila prej këtyre frazave shpjegon atë qē e parapriu, dhe shpjegohet nga ajo qē vjen pas, sikur secila éshtë provë e paraprijëses dhe pasojë -rezultat- i ndjekëses.

Kjo mund tē qartësohet me dy rreshtat e arsyetimit:

**E Para éshtë kjo:** (Allahu) nuk shpërfill -nuk turpërohet-, sepse Ai nuk heq dorë (prej tē bërit tē kësaj), sepse -shëmbëlltyra- éshtë elokuente, sepse ajo éshtë e vërtetë, sepse ajo éshtë fjala e Allahut, sepse besimtari e di këtë.

**E Dyta éshtë kjo:** (Allahu) nuk shpërfill (nuk turpërohet tē japë shëmbëlltyra), siç thonë mohuesit, sepse ata thonë se Ai duhet t'i lëré ato (shëmbëlltyrat), sepse ata nuk e njohin urtësinë në tē, sepse ata pyesin se cila éshtë dobia nē to, sepse ata i mohojnë ato, sepse ata i gjykojnë shëmbëlltyrat si gjëra tē parëndësishme e tē rëndomta, sepse ata kanë rënë në çudhëzim nëpërmjet tē dëgjuarit tē shëmbëlltyrave, sepse Kur'ani i ka çuar ata nē çudhëzim, sepse nē shthurjen e tyre ata kanë kaluar caqet dhe kanë dalë prej guaskës së tyre, sepse ata kanë thyer besëlidhjen me Allahun, sepse ata kanë këputur e ndarë atë që éshtë e lidhur nëpërmjet urdhërave tē tij edhe nē krijim edhe nē shariat, sepse ata prishin rendin Hyjnor tē tokës, dhe si rrjedhojë ata janë umbësit edhe nē këtë botë nëpërmjet vuajtjeve tē ndërgjegjës së tyre, shqetësimt tē zemrave dhe dëshpërimit tē shpirtërave, dhe nē Ahiret pér shkak tē torturave tē vazhdueshme dhe tē zemërimt Hyjnor qē do t'u bie atyre. Atëherë shqyrto mbi rrjedhshmërinë e këtyre dy sekuençave!

Tani pjesët e fjalisë,

الَّذِينَ يَنْقُضُونَ عَهْدَ اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مِيَانَقَةٍ وَيَقْطَعُونَ مَا أَمْرَ اللَّهُ بِهِ أَنْ يُوْصَلَ وَيَفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ

*El-ledhîne jenkydûne ahde Allâhi min baëdi mithâ'kihi ve jaktaûne mà emere Allâhu bîhî jûsale ve jufsidûne fi el-erdî* Ata qē thyejnë besën e dhënë Allahu pasi e pranojnë marrëveshjen me Të dhe ndërpresin gfarë Allahu ka urdhëruar pér tē bërë, ndërpresin marrëdhëniet me tē afërmít, dhe kryejnë vepra tē ulëta e poshtërsi nē tokë”:

**Shqyrtoje këtë:** Ndodhet një hollësi e lartë në këtë mënyrë të të pëershkuarit të të shthururve këtu, të cilët janë dyshues rrëth mrekullisë së (Kur'anit) dhe renditjes së fjalëve të tij. Është sikur Kur'ani është duke thënë: Nuk është aspak e pagjasë që të shthururit të janë dyshues dhe injorantë rrëth mrekullisë së Kur'anit dhe paimitueshmërisë së Renditjes së fjalëve të tij, sepse ata nuk mund ta shohin mrekullinë e fuqisë Hyjnore në rregullin e universit, i cili është Kur'ani më i madh. Sepse ata e shohin rregullin e universit sikur (është duke ndodhur) nga rastësia, dhe ndryshimet e tij të frutshme si të ishin pa qëllim; kështu shembujt e urtësisë në të janë fshehur prej tyre -meqenëse shpirtërat e tyre janë prishur e korruptuar. Gjithashtu, për shkak të natyrave të tyre të shthurura dhe të marrëzisë së tyre të kalbur, ata e shohin mrekullinë e Kur'anit të jetë një çrregullim i ngatërruar, masat e tij paraprake -parathëniet- të janë shterpa -jopjellore, dhe frutat e tij të janë të hidhur.

**Fraza** يَنْقُضُونَ jenkudûne ahde Allâhi “Ata që thyejnë besën e dhënë Allahut”:

Një stil i lartë është treguar këtu me përdorimin e fjalës “*nakd*” e cila do të thotë shpleks -ndaj- fijet e një litari dhe këputja e tyre, të pleksura e të tjerrura, sikur besëlidhja me Krijuesin xh.sh. të ishte një litar i ndritshëm i pleksur dhe i tjerrur me Urtësinë, me përkujdesjen dhe me Dëshirën (Hyjnore) dhe duke u shtrirë në të gjithë rrugën nga parapërjetësia për tek paspërjetësia. Ai manifestohet në Univers në formën e rregullit (të tij) të përgjithshëm, dhe ka dërguar zinxhirët e tij tek të gjitha speciet dhe botërat (e qënieve) dhe i ka shtrirë majat e tyre tek raca njerëzore. Në shpirtin human ai ka lënë trashëgiminë e farërave të potencialeve dhe të aftësive (të tij) të cilat vaditen, e bëhen të lulëzojnë nëpërmjet aftësisë së dëshirës -vullnetit të lirë-, (kur) rregullohet e drejtohet me urdhërat e sheriati; domethënë, me dëshmitë e Kur'anit dhe të sunnetit (*el-dela'il el-naklij-jeh*). Kështu, besëlidhja përbushet nga vënia në përdorim e atyre aftësive ashtu siç duhet të janë, dhe ajo thyhet duke bërë të kundërtën dhe duke shpleksur (litarin dhe duke prishur rregullin e rendin), ashtu si duke besuar në disa nga profetët dhe duke mohuar të tjerët, dhe duke pranuar disa dekrete dhe duke refuzuar të tjerët, dhe duke aprovuar disa vërsete dhe duke shpëlqyer e mos miratuar të tjerët. Dhe kjo cënon e shkel sistemin, rendin dhe rregullsinë.

وَيَقْطَعُونَ مَا أَمْرَ اللَّهُ بِهِ أَنْ يُوصَلَ ve jaktaíne mà emere Allâhu bihi en jásale “dhe ndérpresin qfarë Allahu ka urdhëruar për të bëre, ndérpresin marrëdhëniet me të aférmit”:

**Shqyrtoje këtë:** Urdhri këtu përfshin edhe urdhëresat legislative (*teshri'i*) edhe urdhërat kreativë (*tekvini*) që të dyja këto përfshihen brenda ligjeve natyrale *el-kavanine el-fitrijeh* dhe brenda ligjeve të Praktikës Hyjnore (*el-A'dat el-ilahij-jeh*). Kështu, duke këputur atë çfarë urdhëron sheriati për të qenë e lidhur do të thotë të këpusësh lidhjet farefisnore -familjare- dhe të këpusësh hallkat midis zemrave të besimtarëve. Ju mund të bëni shembuj të mëtejshëm. Dhe (duke këputur atë që është e lidhur nga urdhërat krijuese (kreative) do të thotë t'i këpusësh aktet prej njohjes, dhe të ndash njohjen prej inteligencës, zgjuarsisë, dhe të këpusësh inteligencën prej aftësive të bashkëlindura, dhe njohjen e Allahut prej arsyes, dhe të këpusësh përpjekjen nga fuqia, dhe xhihadin nga guximi dhe kështu me radhë. Sepse dhënia e fuqisë është një urdhër jomaterial kreativ (*emr maenevi tekvini*) për të punuar, dhe dhënia e zgjuarsisë është një urdhër jomaterial kreativ për të mësuar. Dhe kështu me radhë.

وَيُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ ve jufsidûne fi el-erdî “dhe kryejnë vepra të ulëta e poshtërsi në tokë”:

**Shqyrtoje këtë:** Në përputhje me (thënien) “Sa më të përgjithshme të janë fatkeqësitë aq më të këndshme ato bëhen”, një person që bëhet i shthurur dhe ngatërrohet e ndërlifikohet në batak, dëshiron shokë që janë gjithashtu të ngatërruar, me qëllim që të lehtësojë gjendjen e tmerrshme të tij.

Gjithashtu, në qoftë se -ideja e- rrëmujës dhe e përbysjes ngulitet në zemrën e dikujt, ajo do të conte në shkatërrimin e plotësimeve të tij dhe të arritjeve, dhe ndjesitë e larta gradualisht do të bien, dhe dëshira për të shkatërruar do të lindet në të. Kjo do ta bëjë atë të ndjejë një kënaqësi tek shkatërrimi, dhe ai do të kërkojë kënaqësi duke përhapur korrupsion dhe duke shkaktuar turbullira.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Si mundet që e gjithë toka, e treguar nga fjala “*fil erd*”, “*në tokë*” të ndikohet e preket nga korrupsiioni i një njeriu të shthurur?

*Ty do tē tē thuhej:* Ajo që ka rregull, ka balancë; në fakt rregulli bazohet mbi balancë. Madje edhe sikur tē ishte një gjë e vogël, e papërfillshme, ajo do t'i prishte funksionet e një makinerie, makineria do tē ndikohej e prekej prej saj, edhe sikur tē mos ndjehej. Peshorja që nē pjatat e së cilës ndodhen dy male do tē ndikohej me vendosjen e një kokrre arre mbi njérën nga pjatat e saj.

**Tani fraza** اُلْقَكْ هُمُ الْخَاسِرُونَ *Ulā'ikə hum el-khāsirūn* “Pikërisht këta janë tē humburit”.

**Shqyrtoje këtë:** Kjo frazë duhej tē kishte qenë: Ata janë humbësit meqë ata (nuk e pranuan) udhëzimin e drejtë nëpërmjet (Kur'anit).

Eshtë shprehur mënyra që tē bëhen pikat vujuese, lidhur me: اُلْقَكْ “*Ulā'ikə*” “ata, këta” dhe هُمُ “*hum*”, “*ata*”, dhe nyja shquese (e “el-Hasirune”) dhe përgjithësia e saj:

Qëllimi i اُلْقَكْ “*Ulā'ikə*” eshtë për tē zgjuar idenë e diçkaje tē prekshme ose tē perceptueshme (*ihdar el mahsus*) dhe kjo tregon se kur dëgjuesi dëgjon rrëth situatës së tyre tē ndyrë, kjo i ngjall atij neveri dhe e bën atë tē zemëruar me ta. Kështu ai dëshiron t'i pikturojë, pëershruajë -ata nē imaginatën e tij me qëllim që tē zbrazë inatin e tij dhe tē shprehë neverinë e tij, dhe që t'i shohë ata nē kohën dhe ashtu siç eshtë pëershruar fundi i tyre i tmerrshëm.

Perceptueshmëria tregon se cilësitë e tyre tē turpshme shumohen deri nē atë shkallë saqë ato mishërohen nē mënyrë tē dukshme nē shikimin e personit tē neveritur e tē indinjuar. Kjo gjithashtu aludon për

arsyen për humbjen e tyre. Distanca (e shprehur nga اُلْقَكْ “*Ulā'ikə*”) tregon se ata janë shumë larg prej rrugës së vërtetë për t'u kthyer dhe prandaj meritojnë tē qortohen dhe tē mallkohen, ndryshe nga ata tē cilët pendohen dhe janë brenda arritjes -distancës- së kthimit.

﴿“*Hum*”, “*ata*” tregon se humbja eshtë e kufizuar për ta, dhe se nē qoftë se besimtarët pësojnë humbjen e ndonjërs prej kënaqësive të kësaj bote, ajo nuk eshtë humbje; po kështu edhe humbja e disa njerëzve tē kësaj bote nē tregtitë e tyre nuk eshtë humbje.

Nyja shquese tregon faktet -specifike- dhe klasat e gjërave; domethënë, ai që dëshiron ta shohë tē vërtetën rrëth tē humburve duhet t'i shikojë ata. Gjithashtu ajo eshtë një shenjë se rruga e tyre (rezulton nē) humbje tē pastër, ndryshe nga llojet e tjera tē humbjeve, tē cilat mund tē përmbajnë aspekte fitimi; dëmi eshtë më i madh.

Sepse nyja shquese eshtë -përdorur- për (gjërat që janë) ose plotësie ose tē vetëkuptueshme, ose për tē përfytyruar një fakt -specifik.

Përgjithësia e humbjes (Domethënë, qënia e saj e përcaktuar) tregon (gjithëpërfshirjen e saj); domethënë, ata kanë humbur duke mos i qëndruar besnikë besëlidhjes dhe duke e thyer atë; ata kanë humbur për sa ka tē bëjë me lidhjet, marrëdhëniet familjare duke i këputur ato, dhe nē (lidhje me) reformimin duke përhapur korrupsiion, dhe (nē lidhje me) besimin nëpërmjet mosbesimit, dhe nē mjerimin e tyre ata kanë humbur lumturinë e përjetshme.

\* \* \*

## VËRSETI 28

كَيْفَ تَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَكُنْتُمْ أَمْوَاتًا فَاحْيَاكُمْ ثُمَّ يُمْتَكِّمُ  
 ثُمَّ يُحِيِّكُمْ ثُمَّ إِلَيْهِ تَرْجِعُونَ

*Kejfe tekfurune bil-lahi ve kuntum emvâten fe Ahjâkum thum-me jumîtukum thum-me juhjikum thum-me ilejhi turxheûne.*

*Si e mohoni e nuñ e besoni Allahun? Duke parë se ishi të vdekur dhe Ai ju dha jetë, pastaj Ai do t'ju vdesë dhe Ai përsëri do t'ju sjellë në jetë, dhe atëherë tek Ai ju do të ktheheni.*

Ashtu si në vërsetet e mëparshme, pozicionimi dhe renditja e fjalëve të këtij vërseti ka tre aspekte:

**Pozicionimi i kuptimit të këtij vërseti në lidhje me atë që e parapriu.**

**Shqyrtoje këtë:** Allahu xh.sh. duke u pasë bërë ftesë njerezve për ta adhuruar Atë dhe për të besuar në Të, dhe duke pasë treguar besimet themelore dhe urdhëresat -lidhur me veprimin- dhe duke pasë përmendur dëshmitë e tyre në mënyrë të përbledhur, u kthye në këtë vërset dhe tek tre vërsetet vijues duke renditur e parashtuar dëshmitë për to dhe duke numëruar mirësitë që përbajnë dëshmitë. Më e madhja e këtyre mirësive ështëjeta, e treguar nga ky vërset. Vazhdimësia e jetës (*el-beka*), domethënë, e bërë e përkryer dhe e plotësuar nga vënia në sistem e rregull të qiejve dhe të tokës, tregohet nga vërseti i dytë. Epërsia e njeriut dhe fisnikërimi i tij mbi të gjitha qëniet tregohet nga vërseti i tretë, dhe qenia e tij duke iu mësuar njohja -pohohet- nga i katërti.

Në lidhje me formën e tyre, këto mirësi janë një provë e Provanisë -përkujdesjes- Hyjnore dhe e qëllimit (*delil el-inajeh vel-gajeh*); po ashtu ato janë prova e -obligimit të- adhurimit. Sepse është e detyrueshme të falenderohet Mirëbërësi -Dhuruesi i Mirësive; ndërsa

mosmirënjohnja, në mënyrë të arsyeshme -me mend- është e ndaluar (haram). Në lidhje me realitetin, (këto mirësi) janë një provë se gjërat e jepet ekzistencë nga asgjëja (*delil ihtiraijj*) (dhe kështu) prej krijimit të parë dhe ringalljes së të vdekurve (*el mebdeë vel-mead*).

Për më tepër, ashtu si ky vërset që shikon tek vërsetet e mëparshëm, po ashtu ai i shikon vërsetet më të hershëm që diskutojnë mosbesimtarët dhe hipokritët.

Ai nënkupton me pyetjen e tij të çuditshme retorike që është duke aluduar për to sipër kokës, dhe duke i dënuar ata, duke i kërcënuar e frikësuar.

### Pozicionimi -dhe lidhjet- e frazave të vërsetit:

Dije se këtu, (Kur'an) kthehet nga përdorimi i vetës së tretë (në vërsetet e mëparshëm) tek veta e dytë, sepse më parë ai po citonte (mosbesimtarët), tanë ai u adresohet atyre.

Kjo është për ta bërë një pikë të mirënjohur në elokuencën e cila është: Në qoftë se dikush pëershkuar ligësitë e një personi pak nga pak, një ndjenjë zemërimi shpërthen tek dëgjesi derisa -në qoftë se ai është njeri (i vërtetë)- do të ndjehej i detyruar të flasë me personin ballë për ballë. Gjithashtu, në qoftë se dikush përmend virthytet e dikuit pak e nga pak, dëshira për të folur me të rritet (gradualisht) dhe bëhet më e fortë derisa t'i kthehet atij e t'i adresohet drejtëpërdrejtë.<sup>1</sup>

Kështu, meqenëse Kur'an u shpall në stilet dhe në mënyrat -e ligjëratës- së arabëve, ai u kthehet -mosbesimtarëve- dhe u adresohet (atyre drejtëpërdrejtë) duke u thënë:

Si mund të refuzoni ta njihni Allahun?

كَيْفَ تَكْفُرُونَ “Kejfe tekfurune “Si e mohoni e nuñ e besoni Allahun?”

Gjithashtu dije se meqenëse qëllimi këtu është të parashtrojë provat e çështjeve themeltare të përmendura lart, duke përfshire besimin dhe

<sup>1</sup> Kjo figurë -metodë- e quajtur “*iltifat*” ka përdorim të gjërë në arabisht. Shiko “*isharatul I’exhaz*” (Abdul Mexhid)

adhirimin, dhe pér tē refuzuar mosbesimin dhe pér tē penguar mosmirënlohjen ndaj mirësive; dhe meqenëse më tē qartat e dëshmive janë ato që vijnë nga zinxhiri i gjendjeve dhe i rrethanave të njerëzimit, dhe më tē mëdhajat e mirësive janë ato tē varura në kërcellin -trungun- e atij vargu dhe gjenden në nyjet e saj; ai thotë:

وَكُنْتُمْ أَمْوَاتاً فَاحِيَّا كُمْ ثُمَّ يَحِيِّكُمْ ثُمَّ إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

*ve kuntum emvâten fe Ahjâkum thum-me jumítukum thum-me juhjíkum thum-me ilejhi turxheúne* “Duke parë se ishi tē vdekur dhe Ai ju dha jetë, pastaj Ai do t'ju vdesë dhe Ai përsëri do t'ju sjellë në jetë, dhe atëherë tek Ai ju do tē ktieheni”, kjo tregon vargun e çuditshëm tē ndërlidhur, i cili ka pesë nyje, prej kërcellit tē tē cilit varen degët e mirësive. Ne tani do tē parashtrojmë pesë çështje pér t'i deshifruar e zbërthyer ato nyje.

كُنْتُمْ أَمْوَاتاً

**Çështja e Parë** èshtë rreth *ve kuntum emvâten* “Duke parë se ishi tē vdekur”.

Ndërsa fizikisht njeriu përbëhet prej grimcave tē pajeta tē shpërndara nëpër botë, ti i sheh se ato u futën nëpërmjet një ligji të veçantë dhe një sistemi të përcaktuar nën rregull. Pastaj, ndërsa ato janë tē fshehura e tē qeta në botën e elementeve ti i sheh ato tē zhvendosen pér tek bota e qënieve frymore nëpërmjet një ligji të veçantë dhe rregulli që shpreh qëllim e urtësi. Pastaj, ndërsa janë tē shpërndara nëpër atë botë, ti vëzhgon se ato grupohen së bashku në një mënyrë tē jashtëzakonshme dhe bëhen spermë. Pastaj nëpërmjet një serie revolucionesh ato bëhen (*alekah*) copë gjaku i mpiksur, dhe pastaj copë mish, pastaj mish e kockë, dhe kështu me radhë. Megjithëse në secilën nga këto fazë -grimcat- janë më tē plota se sa në tē mëparshmet; ato janë relativisht tē vdekura e tē pajeta tē krahasuara me atë që vjen pas.

• Në qoftë se ti do tē pyesje: Vdekja èshtë mungesa e jetës dhe zhdukja e saj, dhe (grimcat) nuk kishin jetë që ajo tē zhduket?

*Ty do tē tē thuhej:* Vdekja këtu èshtë metaforike, pér tē përgatitur mendjen që t'i pranojë “nyjet” e tretë dhe tē katërt.

فَاحِيَّا كُمْ fe Ahjâkum “dhe Ai ju dha jetë”.

**Shqyrtoje këtë:** Jeta èshtë mrekullia më e çuditshme e më e hollë e Fuqisë (Hynore). Ajo gjithashtu èshtë më e madhja e të gjitha mirësive dhe më e qarta e të gjitha provave të krijimit të parë dhe e ringjalljes së tē vdekurve (*el-mebdeë vel mead*).

Aspekti i saj më i hollë dhe më i paqartë -i errët- èshtë ky: Forma më e ulët e jetës èshtëjeta e bimëve, dhe niveli i parë i saj èshtë zgjimi i embrionit ose i qelizave jetike (*el-ukdeh el-hajatij-jeh*) në farëra. Pavarësisht qënies së saj kaq e qartë, e përhapur gjërë, dhe familjare -e njohur- ky zgjim ka mbetur një mister pér shkencën njerëzore qysh nga koha e Ademit deri tani.

Aspekti i qënies së saj mirësia më e lartë: Lidhjet e vetme që ka një trup i pajetë janë me vendin që ai èshtë vendosur dhe me gjérat që i bien atij; ai èshtë i vetëm, i vetmuar sikur tē ishte madje një mal. Por ti e sheh se në momentin që hyn jeta në një trup tē vockël si bleta, bleta mund tē formojë lidhje me tē gjithë universin dhe mund tē bëjë tregti me tē gjitha speciet -e qënieve. Veçanërisht në qoftë se ajo ngrihet tek niveli i jetës njerëzore, ti e sheh se ajo udhëton përmes botërave nëpërmjet dritës së intelektit. Ajo ka autoritet e vepron mbi botën trupore, dhe shëtit në botën shpirtërore dhe bredh nëpër botën e shëmbëllësës. Dhe ashtu siç udhëton ajo pér tek ato botëra, po ashtu edhe ato udhëtojnë tek ai duke u reflektuar në pasqyrën e shpirtit të tij. Pastaj ai ka tē drejtë tē thotë: “Bota u krijua pér mua nëpërmjet mirësise dhe përkujdesjes së Allahut xh.sh.”! Kështu, jeta e tij bëhet shumëformështë dhe shtrihet -pér tē përfshirë- jetën fizike, jetën morale, jetën trupore, dhe jetën shpirtërore, secila prej tyre përfshin shumë nivele. Në fakt, do tē mund tē thuhej se ashtu si drita që i bën ngjyrat dhe trupat tē dukshëm, po ashtu jeta zbulon qënie dhe i bën ato tē dukshme. Èshtë jeta që e bën një atom -si një botë. Dhe jeta èshtë mjeti i të gjithë botës duke u dhuruar mbi çdo qënie tē gjallë veç e veç, dhe kjo pa ngatërrësë apo ndarje përveç një minoriteti tē vogël midis qënieve.

*Aspekti i jetës që èshtë prova më e qartë si pér Autorin po ashtu edhe pér ringjalljen e tē vdekurve.*

**Shqyrtoje këtë:** Shpërngulja dhe ndryshimi i vetvetishëm, i menjëherëshëm, i një numri të grimcave të pajeta në një grupim dhe në një situatë që e kundërshton situatën e parë -pa ndërmjetësimin e ndonjë shkaku të arsyeshëm- është një provë vendimtare. Madje, nga natyra e saj jeta është e vërteta më e pastër dhe më sublime. As në aspektin e saj të jashtëm (*el-mulk*) dhe as në aspektin e saj të brendshëm (*el-melekut*) nuk ndodhen në të asnjë ndyrësi dhe as njollosje, sepse të dy (aspektet) e saj janë të hollë. Në fakt, edhe jeta e gjallesës më të ulët është gjithashu e lartë. Për shkak të këtij misteri, asnjë shkak i jashtëm nuk ndërhyr midis jetës dhe dorës së fuqisë, sepse kontakti -i fundit i saj- nuk e kundërshton dinjitetin e fuqisë, megjithëse siç është pohuar më parë, shkaqet e jashtme janë të vendosura për të ruajtur dinjitetin e fuqisë Hyjnore nga kontakti me gjërat, të cilat për shikimin sipërfaqësor janë të ulëta.

Ti tashmë ke dëgjuar rrëth atij aspekti të jetës i cili formon provën më të quartë të krijimit të parë dhe ringjalljen e të vdekurve, kështu këtu ne vetëm do të bëjmë një përbledhje të saj për ju: Ai që e studion jetën dhe ndjek fazat elementare progresive të trupit, do të shohë pjesë të shpërndara nëpër botën e atomeve. Pastaj ai do të vëzhgojë se ato janë veshur në një formë tjetër në botën e elementeve. Pastaj ai do t'i hasë ato në botën e qënieve të gjalla në një situatë tjetër. Pastaj ai do t'i takojë ato në spermë, pastaj në copë gjaku, pastaj në një copë mish. Pastaj ai do të shohë se ato befas kanë marrë një formë në mes të këtyre transformimeve. Ai do të vëzhgojë se gjithandej këtyre revolucioneve (ato ndjekin) lëvizje të rregullta në përputhje me ligje të veçanta, prej të cilave është e dukshme se çdo grimcë ishte programuar tek faza e parë dhe sikur u ngarkua me detyrën e udhëtimit për tek një pozitë e përshtatshme në një trup të gjallë. Personi ngërthen e kap me mendjen e tij se ajo shtyhet me qëllim dhe dërgohet me urtësi. Tani jeta e dytë do të shfaqet për të shumë më e lehtë, më e thjeshtë dhe më e mundshme (se sa e para), dhe ai do të ndjehet i bindur në zemrën e tij.

فَاحْجُّكُمْ  
Kështu, kjo frazë, *fe Ahjākum* “dhe Ai ju dha jetë” është një provë e frazës vijuese شُمْ يُبَيِّنُكُمْ *thum-me jumítukum* “pastaj Ai do t'ju vdesë”, dhe të dyja bashkarisht formojnë një provë përballë mohimit të nënkuptuar nga “kejfe” (në këtë vërset, 2:28).

Çështja e Tretë, lidhur me شُمْ يُبَيِّنُكُمْ *thum-me jumítukum* “pastaj Ai do t'ju vdesë”.

**Shqyrtoje këtë:** Vërseti “i Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën”<sup>2</sup> tregon se vdekja nuk është asgjësim dhe mosekzistencë absolute, përkundrazi, ajo është një akt, një ndryshim banese, dhe çlrimi i shpirtit prej vendit të tij të burgosjes.

Për më tepër, shenja dhe tregues të panumërt që kanë dëshmuar qeniet njerëzore deri tani kanë ngulitur në mendjet e tyre bindjen dhe intuitën se pas vdekjes njeriu është i pavdekshëm në një drejtim, dhe ajo që ka pavdekshmëri është shpirti i tij. Kështu, ekzistanca e kësaj veçorie të bashkëlindur, të brendaqenësishme në një individ është dëshmi e ekzistencës së saj në racën si një tërësi, sepse ajo është esenciale. Si rrjedhojë, supozimi -pohimi- individual bën të domosdoshëm pohimin universal. Kështu, vdekja është një mrekulli e fuqisë -Hyjnore- ashtu siç është jeta; ajo nuk është mosekzistencë e shkaktuar nga mungesa e kushteve të jetës.

- *Në qoftë se ti do të pyesje:* Si mund të jetë vdekja një mirësi, saqë u varguq në spangon e mirësive?

*Ty do të të thuhej:*

**Së Pari:** Për shkak se ajo është parathënia për lumturinë e përjetshme dhe parathënia për diçka është si vetë gjëja, qoftë e mirë apo e keqe. Sepse çfarëdo gjëje, tek e cila varet e detyrueshmja (*vaxhib*), është e detyrueshme, dhe çfarëdo që të çon në haram, është *haram* (e ndaluar).

**Së Dytë:** Meqenëse vdekja sipas dijetarëve hetues e verifikues midis sufive është shpëtim për personin me daljen e tij prej asaj që duket si një burg i mbushur me kafshë të dëmshme për tek një fushë e gjërë...

**Së Treti:** Dhe për shkak se për qeniet njerëzore ajo është mirësia më e madhe, sepse përndryshe ata do të vuanin mjerim të tmerrshëm.

<sup>2</sup> Kur'an, 67:2

**Së Katërti:** Dhe pér shkak se sipas disa njerëzve ajo është një mirësi e kërkuar, sepse pér shkak të dobësisë së tij dhe të pafuqisë, (njeriu) nuk mund t'i mbajë përgjegjësitë e rënda të jetës dhe trysnitë e sprovave të saj dhe mizorinë -pamëshirshmërinë- e elementeve. Vdekja pér njerëz të tillë është një derë -nëpërmjet të cilës ata mund- të shpëtojnë.

**Çështja e Katërtit**, lidhur me *ثُمَّ يُبَيِّنُكُمْ thum-me jumítukum* "pastaj Ai do t'ju vdesë".

**Shqyrtoje këtë:** ashtu siç tregohet nga vërseti "*Ti na ke bërë ne të vdesim dy herë dhe Ti na ke dhënë jetën dy herë*",<sup>3</sup> dhe siç tregohet nga

(fraza lart) *ثُمَّ يُبَيِّنُكُمْ thum-me jumítukum* "pastaj Ai do t'ju vdesë", duke mbajtur në mendje thukëtinë e Kur'anit, (mund të thuhet se këto) tregojnë edhe jetën e varrit edhe jetën -e ringjallur- në ringjalljen e të vdekurve.

• *Në qoftë se ti do të pyesje:* Në qoftë se një person digjet dhe hiri i tij hidhet në erë, si mund të mendohet ta përjetojë jetën e varrit?

**Ty do të tē thuhej:** Sipas Sunitëve, trupi nuk është një kusht pér jetën, kështu shpirti mund tē lidhet me disa grimca.

• *Dhe në qoftë se ti do të pyesje:* Si përfytyrohen torturat e varrit, sepse në qoftë se dikush vendos një vezë mbi arkivolin e një kufome dhe ta linte atë atje pér ca ditë, as lëvizja më e vogël nuk do tē ndihej në tē. Atëherë si mund tē jenëjeta dhe tortura?

**Ty do të tē thuhej:** Bota e shëmbëllësës (*el-alem el-mithalijj*) e ka provuar atë në vendet përkatëse; madje ekzistanca e saj është e sigurt sipas dijetarëve të saktë Hyjnorë. Ajo botë -e shëmbëllësaves-karakterizohet nga kuptimet e saj të mishëruara, duke i transformuar aksidentet në substancë, dhe duke i bërë gjërat e ndryshueshme të qëndrueshme, të pandryshueshme. Sytë që e shohin atë nga kjo botë e dukshme janë èndrrat e vërteta, ndriçimet e vërteta (*keshf*), dhe trupat e tejdukshëm, si hije, sepse këto tē gjitha nënkuptojnë ekzistencën e saj. Bota e ndërmjetme ('a'lem el-berzah) është një realitet më i fortë se sa

<sup>3</sup> Kuran, 40:11

Bota e shëmbëllësës, e cila është imazhi i saj ose ilustrimi i saj. Ndërsa Bota e èndërrave është hija e botës së fundit -së ndërmjetme-, dhe bota e imaginatës është hija e Botës së èndërrave. Këto trupa janë aq transparentë, të tejdukshëm si pasqyrat.

Tani, në qoftë se ti e ke kuptuar këtë, shqyrtoje Botën e èndërrave dhe mendo pér një person i cili është duke fjetur pranë teje. Ai është duke pushuar paqësish e qetësish por në botën e tij ai është duke luftuar e duke u plagosur nga goditjet që ai merr, ose kafshohet nga një gjarpër dhe ai vuau dhimbje prej kësaj. Në qoftë se do tē ishte e mundur pér ty që tē hyje në èndrën e tij, ti do t'i thoje: Hej! Mos u ndiej i paaftë dhe i pashpresë dhe mos u zemëro! Kjo nuk është reale - është një èndërr!

Ti do t'i betoheshe një mijë herë por ai nuk do tē besonte, dhe do tē thonte: A nuk mund ta shohësh që jam plagosur dhe dhimbjen që po vuaj. A nuk mund ta shohësh burrin dhe shpatën e tij dhe gjarprin që po më sulmon?" Sepse u mishëruan kuptimet e dhimbjes së shpatullës ose i tē ftohitit në kokën e tij si një shpatë prerëse; sepse rezultati ishte i njëjtë. Ose ai imaginoi kuptimin e tradhtisë pikëlluese pér zemrën e tij në veshjen e një gjarpëri, sepse dhimbja është e njëjtë. O shok! Tani që ti e ke parë këtë në hijen e botës së shëmbëllësave, (Botën e èndërrave) a nuk do ta pranoje atë në Botën e Ndërmjetme, realiteti i të cilës është shumë më i qëndrueshëm dhe më i largët prej nesh?

**سَأَبْرُخُكُمْ juhjikum** "do t'ju sjellë në jetë" lidhur me jetën e Ahiretit.

Jeta e Ahiretit është rezultati pér çdo botë. Në qoftë se nuk do tē kishte qenë ajo jetë, nuk do tē kishte pasë realitet tē fiksuar e tē vazhdueshëm dhe tē gjitha tē vërtetat –të tilla si mirësitë- do tē transformoheshin në fatkeqësi. Ti mund tē mendosh pér shembuj tē mëtejshëm në tē njëjtën mënyrë. Ne i përmblodhëm provat e saj kur shpjeguam "Ve bil Ahireti hum jukjinûne, "si edhe që besojnë me bindje në botën e përtejme".<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Kuran 2:5

شُمْ إِلَيْهِ تَرْجُونَ  
Cështja e Pestë, lidhur me *thum-me ilejhi turxheúne* “dhe atéherë tek Ai ju do tē kħeħeni”, kjo eshtë nyja e fundit nē këtë sekuencë, varg; kështu shqyrto sa vijon:

Krijuesi e manifestoi fuqinë e Tij, duke kombinuar tē kundërtat nē këtë botë tē ndryshimit (*a'lem el-kaun vel fesad*) pér (shumë) shembuj tē hollë urtessie; dhe Ai vendosi shkaqe tē jashtme dhe ndërmjetësi pér tē shfaqur dinjitetin e Tij, dhe përcaktoi zinxhirët e shkaqeve dhe tē pasojave. Pastaj, nē Ringjalljen e tē vdekurve kur universi pastrohet dhe -tē kundërtat- ndahen dhe forcat bashkohen, shkaqet do tē hiqen, dhe ndërmjetësitë do tē bien dhe perdja do tē ngrihet, dhe çdo person do ta shohë Autorin e Tij xh.sh. dhe do ta njohë pronarin e tij tē vërtetë.

#### Një shtojcë duke përbledhur pozicionimin e frazave.

Shqyrtoje këtë: Duke pasë hedhur poshtë mosbesimin e nënkuptuar nga pyetja retorike **كيف** “kejfe”, “si”, dhe duke pasë ftuar çudinë e njerëzve pér tē, (Allahu) xh.sh. u jep (atyre) provë me rrethanorin që vijon **“Ve”** (*el vav el-halijeh*); domethënë, katér transformimet e mëdhaja, tē gjitha ato dhe secila prej tyre dëshmojnë pér domosdoshmérinë e besimit. Pastaj, çdo transformim përmban faza tē shumta dhe shkallë, dhe secila eshtë parathënia dhe stomaku i asaj që vijon. Nga faza e parë e transformimit tē parë deri tek faza e fundit e transformimit tē fundit baza e trupit tē gjallë ripërtërihet vazhdimisht. Ajo e hedh guaskën dhe vesh më tē plotën, pastaj e zhvesh atë dhe vesh një formë më tē lartë, pastaj e hedh edhe atë gjithashtu dhe vesh një formë më tē mirë, dhe kështu me radhë. Ajo nē mënyrë tē vazhdueshme e ndërron, e këmben formën e saj pér një tjetër më tē plotë derisa arrin tek kulmi i plotësimit dhe vjen pér tē pushuar mbi vendosjen e lumturisë së përjetshme. Dhe e gjitha kjo eshtë nē përputhje me një rregull specifik dhe me ligje tē rregullta.

وَكُنْتَمْ أَمْوَاتًا  
Me *ve kuntum envàten* “Duke parë se ishi tē vdekur” tregon transformimin e parë, i cili përmban faza (tē shumta), e fundit e

فَاحْيَا كُمْ  
tē cilave çon tek *fe Ahjākum* “dhe Ai ju dha jetë”, e cila tregon transformimin e dytë, i cili eshtë më e çuditshmjë e tē vërtetave tē botës. Ajo gjithashtu përmban shumë faza, e fundit e tē cilave përfundon nē transformimin e *ثُمَّ يُحِيِّكُمْ* *thum-me juhjikum* *dhe Ai përséri do t'ju sjellë nē jetë*, i cili gjithashtu ka shumë faza që i përkasin Botës së Ndërmjetme. Kjo përfundon nē transformimin e *ثُمَّ يُبَيِّكُمْ* *thum-me jumitukum* “pastaj Ai do t'ju vdesë”, i cili përmban shumë faza që i përkasin varrit dhe pastaj Ringjalljes së tē vdekurve, dhe mbylljet me -tē vërteten e- *ثُمَّ يُحِيِّكُمْ ثُمَّ إِلَيْهِ تَرْجُونَ* *thum-me juhjikum thum-me ilejhi turxheúne* “dhe atéherë tek Ai ju do tē kħeħeni”. Si mundet dikush që i studion me vëmendje këto transformime tē jetë aq guximtar sa t'i mohojë (ato)?

Tani ne fillojmë me pozicionimin -dhe lidhjet- e pjesëve përbërëse tē frazave:

**كيف تَكْفِرُونَ بِاللهِ** *Kejfe tekkfurune bil-lashi ve kuntum envàten* “Si e mohoni e nuk e besoni Allahun duke parë se ishi tē vdekur?”,

Forma pyetëse eshtë -përdorur- këtu pér tē térhequr vëmendjen pér tek gabimi -i jobesimtarëve- me qëllim që ata tē mund ta shohin vetë atë dhe tē drejtohen e tē njohin -Allahun.

“*Kejfe*”, “*si*” nënkupton nëpërmjet mohimit tē fjalisë rrethanore tē bërë tē domosdoshme nga “*kejfe*”, se mosbesimi i tyre eshtë -në realitet-mosekzistencë.

تَكْفِرُونَ  
Përdorimi i vetës së dytë nē *tekkfurune* “ju e mohoni” tregon siç u diskutua lart, zemërimin e madh -tē Allahut- (pér ta); dhe nuk tha لا يُؤْمِنُونَ  
*la tuëminune* “nuk besoni” duke treguar pér rebelimin e tyre tē fortë; sepse ata e lënë imanin pér tē cilin ndodhen dëshmi, dhe pranojnë mosbesimin pér kotësinë e tē cilit ndodhen prova tē shumëfishta.

(Lidhëzja) rrrethanore **و** “Ve” (el wav el-halijeh) në و کنتم امواتا و “ve kuntum”, “duke parë se ishit” nënkupton një frazë të pashprehur. (Lidhëzja tregon se كنتم امواتا “kuntum envâten” “ishit tē vdekur” éshtë rrrethanor (hal) për foljen تکفرون “tekkfurûne” “ju mohoni”. Fjalia rrrethanore ose fraza duhet të jetë së bashku me faktorin që e sundon, që e drejton atë (amil dhil hal). Ndërkaq ndodhen katër fraza këtu, dy prej të cilave i referohen të shkuarës (janë në kohën e kryer) dhe dy prej të cilave që i referohen të ardhmes janë (në kohën e pakryer). Prandaj ato janë në kundërshtim me rregullin e njëkohësisë, njëkohshmërisë. Prandaj rrrethanori **و** “Ve”, “ndërsa, duke parë se, dhe” nënkupton një fjali ose frazë të pashprehur), e cila éshtë “ve kuntum” “duke parë se, ju e dinit se ju ishit të pajetë -të vdekur. (Në këtë mënyrë, fjalët تعلمون “innekum taëlemune” “Ju e dini” janë rrrethanorë (hal) për bërësin e foljes تکفرون tekkfurûne “ju mohoni”.

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Ata edhe në qoftë se e dinin vdekjen dhe jetën e parë, por nuk e dinë se ato janë prej Allahut. Gjithashtu ata nuk e pranojnë jetën e dytë, nuk pajtohen në mendim se ata do tē kthehen tek Allahu xh.sh.?

*Ty do tē tē thuhej:* Është një rregull elokuence që i jep njeriut injorant statusin e të diturit në qoftë se ndodhen dëshmi të qarta për të larguar injorancën e tij. Meqenëse reflektimi mbi fazat e vdekjes së parë dhe mbi jetën e parë e detyron njeriun të pranojë Autorin dhe njojja e tyre e bind njeriun mendërisht, me arsy, rrëth jetës së dytë, (mosbesimtarët) sikur kanë njojje pér atë sekuençë -ngjarjesh.

Përdorimi i vetës së dytë كنتم “kuntum”, “ju ishit” tregon se ata kishin një ekzistencë specifike edhe në botën e grimcave të vockëla gjithashtu. Grimcat nuk u bashkuan kuturu dhe u bënë rastësisht një trup i veçantë.

Dhe zgjedhja e **امواتا** “envâten” “të vdekur” mbi “xhemadat”, “sende” ose mbi “grimcat” aludon për kuptimin e vërsetit “*A nuk ka qenë mbi njeriun një pjesë kohe, kur ai nuk ishte asgjë pér t'u përmendur?*”<sup>5</sup>

**Tani fraza فاحِيَاكُم** “fe Ahjâkum”, “dhe Ai ju dha jetë”:

• *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Lidhëzja **ف** “fe”, “dhe” shpreh vijueshmëri dhe kontakt (domethënë, nuk duhet të ketë largësi ndërmjet asaj që parapriu dhe asaj që vjen pas), por a nuk i ndërpret ajo fazat dhe a nuk ka një interval të gjatë ndërmjet vdekjes ose qënieve të pajeta dhe jetës?

*Ty do tē tē thuhej:* **ف** “Fe”, “dhe” tregon burimin e provës së autorit, dhe se éshtë transformimi i grimcave në mënyrë spontane, e vetvetishme nga një gjendje e pajetë tek një gjendje me jetë pa ndërhyrjen e shkakut të arsyeshëm, gjë e cila e detyron mendjen të njojë Autorin. Pér më tepër, fazat në kushtet e qënieve të pajeta janë difektoze dhe të paqëndrueshme, dhe karakterizohen nga vijueshmëria -e shpejtë. Dhe zgjedhja e **فاحِيَاكُم** “fe Ahjâkum”, “dhe ai ju dha jetë” në vend të **صَرْتَمْ أَحْيَاء** “Sirtum ahja'ë” “u bëtë tē gjallë” éshtë pér qartësim; domethënë, ju u bëtë të gjallë dhe kjo ishte e mundur vetëm nëpërmjet fuqisë së Autorit. Prandaj duhet të dilet me përfundimin se éshtë Allahu xh.sh. Ai i cili jep jetë.

**شَهِيدُكُمْ** Pastaj fjalia “thum-me jumítukum” “pastaj Ai do t'ju vdesë” në vend të **تَمُوتُنَّ**, “ju do tē vdisni” tregon, siç u përmend, se vdekja éshtë një akt i gjërë në përputhje me masën e Kaderit Hyjnor. Ti sigurisht që ke vërejtur se éshtë vetëm një minoritet i vogël të cilët jetojnë një jetëgjatësi të plotë natyrale. Kjo e bën njeriun të kuptojë se vdekja nuk éshtë një pasojë e natyrshme. Ajo éshtë një shpërbërje e trupit, dhe jo zhdukje -asgjësim- i shpirtit; në të vërtetë ajo éshtë çlirim i shpirtit.

<sup>5</sup> Kuran, 76:1

Në frazën “*thumme juhjikum*” “*dhe Ai përsëri do t'ju sjellë në jetë*”, “*thumme*” tregon ndërhyrjen e Botës së ndërmjetme me çudirat e saj të mahnitshme.

Në frazën شَمَّ إِلَيْهِ تَرْجُونَ “*thum-me ilejhi turxheune*” “*dhe atëherë tek Ai ju do tē ktheheni*”, “*thum-me*” tregon ekzistencën e perdes së madhe, ndërsa ngritura e saj, dhe zembrapsja e shkaqeve dhe shkarkimi i ndërmjetësve tregohen nga تَرْجُونَ “*ilejhi turxheune*” “*tek Ai ju do tē ktheheni*”.

- Në qoftë se ti do tē pyesje: Kthimi tek Allahu bën tē domosdoshme ardhjen prej Tij në fillim, dhe për shkak tē kësaj disa njerëz kanë imagjinuar tē ketë union (me Allahun) dhe disa Sufi kanë rënë në dyshim?

*Ty do tē tē thuhej:* Ashtu si në këtë botë që ndodhen ekzistanca dhe vazhdimësia e saj, po ashtu edhe në ahiret ndodhet ekzistencë dhe vazhdimësia e saj. Ekzistanca në këtë botë shfaqet prej dorës së fuqisë pa ndërmjetësi, ndërsa vazhdimësia -e saj- është e rrethuar nga përbërja e shpërbërja, dhe nga dispozicioni i fuqisë dhe ndryshimi, dhe për shembujt e urtësisë tē përmendura lart ndérhyjnë shkaqet -në tē. Por në Ahiret edhe ekzistanca edhe vazhdimësia -e saj- do tē shfaqen - drejtëpërdrejtë- nga Dora e fuqisë me tē gjitha domosdoshmëritë dhe kompozimet, dhe çdo gjë do ta njohë Pronarin e saj tē Vërtetë. Në qoftë se mendon rreth kësaj, do tē kuptosh kuptimin e “*Ruxhuë*”, *kthimit*.

\* \* \*

## VËRSETI 29

هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُم مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعاً ثُمَّ أَسْتَوَى  
إِلَى السَّمَاءِ فَسَوَّهُنَّ سَبْعَ سَمَوَاتٍ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

*Huve el-ledshit khaleka lekum mà fi el-erdi xhemian thum-me isteva ilà el-semài fesev-vàhunne seb'a semavatìn ve huve bikul-li shej'in Alimun.*

*Ai është i Cili krijoi për ju gjithçka në tokë pastaj Ai (u ngrit lart) istewa drëjt quellit duke i bërë ata shtatë qiej. Dhe Ai është i Gjithëdituri për çdo gjë.*

Ky vërset gjithashtu ka tre faqe të rëndësishme.

**Pozicionimi i vërsetit si një tërësi në lidhje me vërsetin e mëparshëm:**

Në vërsetin e mëparshëm mosbesimi dhe mosmirënjojja u hodhën poshtë nëpërmjet dëshmive që i përkasin nefsit të njeriut (*el-delail el-enfusijeh*) dhe këto ishin fazat e -zhvillimit- njerëzor, dhe tanë ky vërset tregon dëshmi në botën e jashtme (*el-delail el-afakijeh*). Gjithashtu vërseti i mëparshëm tregoi mirësitë e ekzistencës dhe tē jetës, ndërsa ky vërset tregon mirësinë e ekzistencës së qëndrueshme (*el-beka*). Përsëri, në vërsetin e mëparshëm ndodhej prova e Autorit dhe çështjet parapërgatitore për ringjalljen e tē vdekurve, ndërsa ky vërset tregon realizimin e ringjalljes dhe largimin e dyshimeve, sikur - mosbesimtarët- pyesnin: “Nga i vjen njeriut kjo vlerë që ai ka? Përse e ka ai një rëndësi tē tillë? Dhe cila është pozita e tij në shikimin e Allahut saqë Ai tē shkaktojë kijametin dhe ringjalljen për hir tē tij? Kështu Kur’ani përgjigjet nëpërmjet treguesve tē këtij vërseti: “Njeriu ka vlerë tē lartë ashtu siç dëshmohet nga qiejt dhe toka duke iu nënshtuar (atij) për dobinë e tij. Ai gjithashtu ka rëndësi tē madhe siç dëshmohet nga fakti se Allahu nuk e krijoi atë për krijesat, por krijoi krijesat për tē. Ai gjithashtu ka një vend -tē lartë- në shikimin e Allahut siç dëshmohet nga fakti se Allahu nuk i dha ekzistencë botës për veten

e saj, por pér njeriun, dhe Ai i dha njeriut ekzistencë që ai tē mund ta adhurojë Atë. Nga kjo duhet tē dilet me pérfundimin se njeriu është i shquar dhe i veçuar, dhe nuk është si kafshët; dhe si rrjedhojë ai është i

denjë pér tē marrë Xhevahirin e *وَالْيَهُ تَرْجِعُونَ* *thum-me ilejhi turxheúne*  
dhe atéherë tek *Ai ju do tē kfheheni*".

### Pozicionimi i frazave tē vërsetit.

**Shqyrtoje këtë:** Fjala *جَمِيعًا* “*xfiemian*” “*gjithçka*” nē frazën e parë, fjala *سَبِعَ* “*thum-me*” “*pastaj*” nē tē dytën, dhe *سَبَعَ* “*seb'a*” “*shtate*” nē tē tretën, që tē gjitha kërkojnë hetim e verifikim. Ne do t'i diskutojmë ato nē tre çështje:

### Çështja e Parë:

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Ky vërset tregon se gjithçka nē tokë është pér dobinë e njeriut, por si mund tē pérfytyrohet pérfitimi i Zejdit pér shembull prej secilës prej pjesëve tē tokës? Dhe si minden Habibi dhe Aliu tē nxjerrin pérfitim prej një guri nē rrëzë tē një mali nē mezin e një ishulli nē oqeanin paqësor? Dhe si mund ta përdorë Amri pasurinë e Zejdit? Por ky vërset dhe tē tjerët si ai sugjerojnë se pér çdo individ është e gjitha pa u ndarë. Pér më tepër, si do tē ishte e mundur që pavarësisht madhështisë së tyre, dielli dhe hëna dhe tē tjerat veç tyre tē jenë pér Zejin dhe Amrin dhe qëllimi i tyre kryesor tē ishte një dobi e pjesshme pér ata tē dy? Dhe si do tē ishte e mundur që gjérat e dëmshme tē ishin tē dobishme pér qëni njerëzore? Sepse nuk ndodhet asgjë e paqartë, e errët apo e pasaktë nē Kuran dhe ekzagjërimi nuk është nē harmoni me elokuencën e vërtetë.

*Ty do tē tē thuhej:* Shqyrto gjashtë pikat e mëposhtme tē cilat do t'i bëjnë tē fluturojnë dyshime tē tilla:

**E Para:** Ashtu siç është përmendor, është karakteristikë e jetës që ta bëjë pjesën tē téré dhe tē pjesshmen universale, dhe tē veçantën

kolektive dhe tē kufizuarën absolute, dhe individin një botë; kështu çdo anëtar i tē gjitha specieve bëhet si një racë e gjallë ose si njerëzit dhe bota bëhet shtëpia e tij, dhe ajo bëhet tē ketë lidhje me tē gjitha gjërat.

**E Dyta:** Ashtu siç e ke mësuar ndodhen nē botë një sistem i fiksuar, një rregull i qëndrueshëm, dhe parime tē larta, dhe ligje themelore tē vazhdueshme, duke e bërë botën si një orë ose si një makineri tē mirëregulluar. Dhe ashtu si çdo ingranazh -rrotë e dhëmbëzuar-, madje çdo dhëmb i çdo ingranazhi, madje çdo pjesë e çdo dhëmbi, që ka hyrje, që luan një pjesë, edhe sikur tē vogël e tē pjesshme nē rregullin funksionues tē makinerisë, po ashtu nëpërmjet funksioneve dhe sistemit tē makinerisë ajo ka një efekt nē dobinë e makinerisë dhe nē produktin, rezultatin e saj. Në tē njëjtën mënyrë, nëpërmjet ekzistencës së saj -çdo qënie- është nē ndonjë mënyrë e dobishme pér qëni e gjalla, princi dhe kryetari i tē cilave është raca njerëzore.

**E Treta:** Ashtu siç tē ka rënë nē veshët e tu nē diskutimet e mëparshme, asnjë (qënie) nuk i pengon e nuk i bllokon -qëni e tjeranë lidhje me pérfitimin -prej gjërave. Sepse ashtu si dielli nē térësinë e tij është i Zejdit, dhe drita e tij është vendpushimi i tij dhe shëtitorja e tij, po ashtu nē térësinë -plotësinë- e tij ai është pronë e Omerit dhe kopësht pér tē. Në qoftë se pér shembull Zejdi do tē ishte krejt i vetëm nē botë, si do tē ishte pérfitimi i tij? Ai do tē pérfitonte prej tij jo më shumë se (ajo sasi që do tē pérfitohej) nē qoftë se ai do tē ishte së bashku me tē gjithë njerëzit e botës -me përashtim tē asaj pjesë që shikon tek “dy shpellat” (si ushqimi, sepse këto mund tē jenë objekt lëmshi e pengimi).

**E Katërtë:** Universi nuk ka vetëm një faqe tē hollë; përkundrazi, ai ka fityra tē përgjithshme tē ndryshme shtresë mbi shtresë; dhe pérfitimi i tē cilave (gjithashtu) ka faqe tē shumta tē përgjithshme tē ndërfutura dhe rrugët e dobisë dhe tē pérfitimit tē tyre janë tē shumta dhe tē ndryshme. Pér shembull, nē qoftë se ti ke një kopësht, ti pérfiton prej tij nē një mënyrë dhe njerëzit pérfitojnë nē një mënyrë tjetër, duke marrë kënaqësi prej tij nëpërmjet aftësisë së tē shikuarit. Sepse natyrisht njeriu nxjerr pérfitim me anë tē pesë shqiseve tē tij tē jashtme, nëpërmjet aftësive tē tij tē brendshme dhe nëpërmjet trupit e shpirtit,

dhe gjithashtu nëpërmjet mendjes dhe zemrës së tij, si në këtë jetë në këtë botë, po ashtu edhe në Ahiret, dhe gjithashtu nga këndvështrimi i nxjerrjes së mësimeve; ju mund të mendoni për shembuj të mëtejshëm në të njëjtën mënyrë. Nuk ka asgjë që ta pengojë atë prej përfitimit të ndonjërës prej këtyre faqeve, anëve, të çdo gjëje në tokë, ose madje në botë.

#### E Pesta:

- *Në qoftë se ti do tē pyesje:* Vérsetet këtu dhe të tjerët në vendet e tjera tregojnë se kjo botë e gjërrë u krijuar për qëni njerëzore dhe se dobia -përfitimi- i tyre prej saj është qëllimi përfundimtar i krijimit të saj. Por, planeti Saturn, i cili është më i madh se toka, nuk është në mënyrë të përpjesëtar më i dobishëm për njeriun; ai është një lloj stolie dhe një dritë e dobët. Atëherë si mund të jetë kjo një arsy përfundimtare (për krijimin e tij)?

*Ty do tē tē thuhej:* Një peson që përfiton (prej një gjëje) e humbet veten në faqen e asaj që ai përfiton; ai e fokuson mendjen e tij mbi të dhe harron gjithçka tjetër, dhe ai e shikon gjithçka tjetër nga kënvështrimi i tij.

Gjithashtu, (në shikimin e tij) synimet dhe qëllimi i një gjëje janë të përkufizuara tek faqja që shikon tek vetja e tij. Prandaj nuk ka asgjë të ekzagjëruar apo të pasaktë në qoftë se në kontekstin e mirënjoyces - rehatisë- do të thuhej në lidhje me atë person: "Megjithëse Krijuesi i Saturnit e solli atë në ekzistencë. Për mijëra shejmbuj urtësie, secila prej tyre ka mijëra faqe, dhe për çdo faqe mund të përfitohet në mijëra mënyra, Ai e krijoj atë për atë person për të përfituar prej tij".

**E Gjashta:** Ashtu siç e ke vërejtur më parë dhe siç ka pohuar Imam Aliu r.a., sigurisht njeriu është i vogël por (në kuptim) ai është i madh, prandaj për të ndonjë përfitim i vogël dhe i pjesshëm bëhet i madh dhe universal. Kështu, nuk ka asgjë të kotë e të padobishme.

**Çështja e Dytë** ka të bëjë me  "thum-me" "pastaj". Ky vërset tregon se toka u krijuar para qiejve, ndërsa vërseti

وَالْأَرْضُ, بَعْدَ ذَلِكَ دَحِيبًا “Dhe pas kësaj Ai shtroi tokën”,<sup>1</sup> tregon se qiejt u krijuan para tokës. Pastaj vërseti "...se qiejt dha tokë ishin të bashkuar së bashku si një njësi e vetme krijimi, pastaj Ne i ndamë ato,”<sup>2</sup> tregon se ato u krijuan së bashku dhe pastaj u ndanë prej të njëjtës lëndë.

Kupto së dyti se mësimet (*naklijeh*) të sheriati sugjerojnë se Allahu xh.sh. krijoj së pari një substancë, domethënë, lëndën, pastaj Ai manifestoi (fuqinë e Tij) mbi të dhe e bëri një pjesë të saj avull dhe një pjesë lëng. Pastaj nëpërmjet manifestimit të Tij pjesa e lëngët u trash, u dendësua dhe u bë shkumë. Pastaj nga kjo Ai krijoj tokën ose shtatë globet e tokave. Pastaj u formua një quell për secilin nga këto toka prej atmosferës fryrëse, me një fllad të lehtë. Pastaj Ai shtrui lëndën e avullit dhe i rregulloi duke i vënë në sistem prej saj (shtatë) qiejt, duke mbjellur yjet në to. Kështu qiejt morën formën –erdhën në ekzistencë– duke përbajtur e përfshirë bërthamat e yjeve.

Sipas supozimeve dhe teorive të shkencës moderne, sistemi diellor, së bashku me qiejt në të cilët ai noton, ishin një substancë e thjeshtë e cila u transformua në një lloj avulli. Pastaj nga ky avull u formua një gjendje e lëngëzuar e ndezhme dhe pastaj një pjesë e tillë u ngurtësua me të ftohtin. Pastaj për shkak të lëvizjes së tij të fortë, ai lëngëzim i flaktë hodhi (në hapësirë) shkëndijat dhe copat të cilat u ndanë. Këto u bënë të ngjeshura, të shtypura, dhe u bënë planetet njëri prej të cilëve është toka jonë.

Në qoftë se e ke kuptuar këtë, mund t'i bashkëlidhësh këto dy shpjegime sepse është e mundshme, që vërseti "... se qiejt dha tokë ishin të bashkuar së bashku si një njësi e vetme krijimi, pastaj Ne i ndamë ato"<sup>3</sup> tregon se toka dhe sistemi diellor ishin si një lloj brumi i gatuar nga dora e fuqisë prej një substancë të thjeshtë; unë dua të them eterin "lëndën e eterit" e cila e krahasuar me qëni është si uji rrjedhës (si një substancë e lëngët) që kalon përmes tyre. Vërseti

<sup>1</sup> Kur'an, 79:30

<sup>2</sup> Kur'an, 21:30

<sup>3</sup> Kur'an, 21:30

وَكَانَ عَرْشَهُ عَلَى الْمَاءِ ...*Dhe Arshi (Froni) i Tij ishte mbi ujë*<sup>4</sup> aludon pér këtë lëndë, e cila i ng Jason ujti.

Pas krijimit të tij, “eteri” mori manifestimin e parë të Autorit Krijues duke dhënë ekzistencë –Eteri pasi u krijua u bë qendra e parë e manifestimit të Autorit duke dhënë ekzistencë; domethënë, Ai krijoi Eterin, dhe pastaj Ai e bëri atë në atome themelore (*Xhevahir ferdeten*); pastaj disa prej këtyre Ai i bëri të dendura, dhe pastaj prej të dendurave Ai krijoi shtatë globet, prej të cilëve toka jonë eshtë populluar. Pastaj toka u ngurtësua para të gjitha të tjera, duke formuar me shpejtësi një kore, dhe prej një periudhe të gjatë kohe ajo u bë burimi i jetës, ndërsa deri tanë shumica e trupave qiellorë mbetën në një gjendje të lëngëzuar të ndezshme. Atëherë nga ky aspekt krijimi dhe formimi i tokës ishte përparrat atij të qiejve. Dhe meqenëse plotësimi i dobive dhe i përfitimeve të saj dhe i qënies të saj të “shtrirë, të shpërndarë” të përgatitur pér të jetuar lloji njerëzor u bë pas sistemit dhe vënies në rregull- të qiejve, qiejt nga ky aspekt ishin më të hershëm, ndonëse (qiejt dhe toka) ishin të bashkuar së bashku në fillim). Kështu të tre vërsetet shikojnë tre pikë (duke i zgjidhur kontradiktat në anën e jashtme).

#### Një përgjigje e dytë:

Qëllimi i Kur'anit nuk eshtë pér të dhënë mësim historinë e krijimit; ai nuk eshtë mësuesi i historisë dhe i gjeografisë; ai u shpall pér t'u dhënë mësim masave të njerëzve njohjen rreth Madheshtisë të Autorit Krijues duke përmendor sistemin dhe rregullsinë e botës. Ai përbën dy nivele(mekame): Niveli i parë: Kur duke përshkruar mirësitë (Hyjnore), favoret, mëshirën dhe qartësinë e provave, toka vjen e para. Por në nivelin e dytë: duke përmendor nivelin e madhështisë (Hyjnore), lartësisë dhe fuqisë, qiejt paraprijnë.

“*Thum-me*”, “*pastaj*”: Kjo mund t'i referohet një voneseje ose

shtyrjeje (*Tarakhi*). Kjo mund të jetë esenciale (*dhatij*). Kështu *استوى* “*thum-me isteva*” domethënë, pastaj dijeni dhe reflektoni se (si) Ai

<sup>4</sup> Kuran, 11:7

drejtoi vullnetin e Tij drejt qiejve... (Domethënë, krijimi i qiejve ishte i pari në kohë, por lidhur me reflektimin dhe mendimin ai është në vendin e dytë; dhe krijimi i tokës ishte pas atij të qiejve, por në lidhje me mendimin reflektiv ai vjen i pari<sup>5</sup>.

#### Çështja e Tretë lidhur me سبّ “*seb'a*” “*shtate*”.

**Shqyrtoje këtë:** Filozofia e lashtë pohoi se qiejt ishin nëntë, dhe njerëzit e saj i përfytyruan ato në mënyrë të çuditshme. Idetë e tyre dominuan mbi njerëzimin pér shekuj. Në fakt shumë komentatorë të Kur'anit u detyruan të prireshin tek kuptimet e fjalëpërfjalëshme -të jashtme- të vërseteve pér (t'u përshtatur) me medhhebin -shkollën- e tyre. Megjithatë shkenca moderne pohon se yjet qëndrojnë të varur pezull në hapësirë ose në zbrazëtirë, sikur ajo mohon ekzistencën e qiejve. Domethënë, njëra shkoi në një ekstrem dhe tjetra shkoi tek një ekstrem tjetër. Sa pér sheriatin, ai pohon se Autori xh.sh. krijoi shtatë qiej dhe i vendosi yjet në to si peshku duke notuar (në det). Hadithi موج مکفوف “*Qiejt janë valë të përbajtura...*” aludon pér këtë. Kjo shkollë (e vërtetë mendimi) mund të verifikohet në gjashtë nivele:

**I Pari:** Është vërtetuar nga shkenca dhe nga filozofia se hapësira e pafundme është mbushur me eter.

**I Dytë:** Ajo që i lidh ligjet e trupave të mëdhenj dhe që përcjell e shpërndan forca të tillë si dritën dhe nxehësinë eshtë një lëndë që eshtë ekzistuese në hapësirë dhe e mbush atë.

**I Treti:** Megjithëse lënda (e quajtur) “eter” mbetet si eter, ashtu si lëndët e tjera ajo ka gjendje të ndryshueshme, të ndryshme e të shumëllojshme, si formimi i avullit, i ujit dhe i akullit (që formohen nga uji).

**I Katerti:** Në qoftë se trupat qiellorë do të vëzhgoheshin me vëmendje, do të shfaqeshin të jenë në nivele të ndryshme. Ti sigurisht

<sup>5</sup> Isharatul Ixhaz (Abdul Mexhid 265).

që e ke parë lumin e qiejve të njojur si “Rruga e Qumështit”, i cili shfaqet si një njollë (pellg) i madh reje; ajo përbëhet prej miliarda yjesha që janë duke u formuar rishtas dhe duke u grumbulluar së bashku.

Dhe eteri në të cilin ato yje janë grumbulluar, natyrishët është i ndryshëm me nivelin e yjeve të fiksuar, të qëndrueshëm, dhe njeriu do ta kapte me intuitë e saktësi se kjo gjithashtu është e ndryshme me nivelet e sistemit diellor, dhe kështu me radhë deri sa ndodhen shtatë nivele, sisteme.

**I Pesti:** Është vërtetuar nga intuita dhe nga induksioni se kur bien formimi, organizimi dhe rregullimi në lëndë -kur lënda i nënshtrohet formimit, organizimit dhe rregullimit- ajo u jep shkas gjendjeve të ndryshme -niveleve. Nga karboni (minerali -maden) prodhohen hiri, qymyri dhe diamantet, dhe zjarri mund të ndahet në prush, flakë dhe tym; dhe nga kombinimi i oksigjenit dhe hidrogenit formohen uji, akulli dhe avulli.

**I Gjashti:** Të gjithë ato që u përmendën lart janë tregues se qiejt janë të shumëfishtë. Dhe Ligjvënesi i vërtetë (*el-Shariu’el-sadik*) tha se ata ishin shtatë. Dhe ata janë shtatë në sensin, se në gjuhën arabe shtatë, shtatëdhjetë dhe shtatëqind që të gjitha tregojnë shumësi.

**Shkurtazi:** Autori xh.sh. i krijoi nga lënda -e quajtur- eter سمواتْ shtatë qiejt dhe i vuri ata në sistem dhe duke u dhënë një rregullsi të çuditshme të hollë dhe mbolli –vendosi në to yjet, dhe shtresat e tyre janë të ndryshme.

**Tani shqyrtoje këtë:** Në qoftë se do të hulumtoje mbi adresimet e mëdhaja të Kur'anit, dhe mbi kuptimet e tij dhe mbi marrien e tij parasysh -shkallën- e të kuptuarit të të gjitha klasave -të njerëzve- nga më e ulëta e tyre për tek më e larta e elitës, ti do të vëzhgoje një çështje të jashtëzakonshme. Për shembull, midis njerëzve ka nga ata që prej shtatë qiejve” kuptojnë nivelet e atmosferës (*el-hewa el-nasimi*); dhe disa kuptojnë sferat fryrëse të flladir që rrëthojnë këtë tokën tonë dhe motrat e saja që mbështesin qëniet e gjalla; të tjerët kuptojnë prej saj shtatë planetët e dukshëm për gjithkënd; të tjerët kuptojnë prej saj

shtatë shtresat eterike në sistemin diellor; të tjerët kuptojnë shtatë sisteme diellore, i pari i të cilëve është ky sistemi ynë; të tjerët kuptojnë eterin duke i dhënë shkas formimit të shtatë niveleve -ose gjendjeve- ashtu siç u diskutua lart; disa të tjerë shohin se e gjitha ajo që është e dukshme prej llambave zbukuruese të diejve dhe të yjeve të qëndrueshëm është një qelli i dynjasë dhe mbi të janë gjashtë qiejt e tjerë të padukshëm. Dhe disa të tjerë marrin me mend se shtatë qiejt nuk janë përkufizuar vetëm tek bota e dukshme, por i përfytyrojnë ato si nivelet e krijimit në këtë botë, në ahiretin dhe në të padukshmen dhe në botërat e tyre. Të gjitha këto (klasa të njerëzve përfitojnë prej bekimeve të bollshme të Kur'anit në përpunthje me kapacitetet e tyre dhe marrin pjesët e tyre prej tryezës së tij, e cila i rrëthon dhe i përfshin të gjitha këto konceptime.

**Tani shqyrtoji pesë aspektet** e pozicionimit të fjalisë së vërsetit të parë; domethënë, *هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعاً Huve el-ledhi kħaleka lekum mà fi el-erdi xhemian* “Ai është i Cili krijoi për ju gjithçka në tokë”.

**I Pari:** Vërseti i mëparshëm tregoi mirësinë e jetës dhe të ekzistencës, ndërsa ky vërset tregon mirësinë e ekzistencës së qëndrueshme (*el-beka*) dhe shkaqet e saj.

**I Dytë:** Kur vërseti i mëparshëm provon se njeriu është tek shkalla më e lartë, domethënë, ai do të kthehet tek Ai xh.sh., kjo zgjon mendjen e dëgjesit dhe ai pyet: Si është e mundur që ky njeri i ulët të ketë pasë kapacitetin për këtë shkallë të lartë po të mos kishte qenë mirësia e Tij xh.sh. dhe tērhecja e Tij për të drejt saj?” Kështu kjo frazë sikur iu përgjigji pyetjes, duke thënë se njeriu ka një vend vërtet të lartësuar në shikimin e Krijuesit të tij meqenëse Ai ia ka nënshtuar të gjithë botën atij.

**I Treti:** Në vërsetin e mëparshëm duke treguar ndodhjen e Ringjalljes së të vdekurve dhe Tubimin e madh për njerëzimin, dëgjesi fillon të pyesë: cila është rëndësia e njeriut që ringjallja duhet të shkaktohet për të dhe bota të shkatërrrohet për lumturinë e tij?” Dhe kjo frazë sikur përgjigjet: “Duke parë se e gjithë ajo çfarë përmban toka është përgatitur për dobinë dhe përfitimini e tij dhe të gjitha speciet e saj

-tē qenieve- i janē nēshtruar atij, ai duhet tē ketē rēndēsinē mē tē madhe meqē kjo tregon se ai ēshtē fruti i krijimit". Atēherē, sigurisht dhe medoemos do tē bēhet kijameti pēr lumturinē e tij. Kēshu i jepet pērgjigjja dēgjuesit.

**I Katerti:** Me fjalët "Dhe tek Ai ju do tē ktheheni" vērseti i mēparshēm nēnkupton se nē Ditēn e kijametit ndērmjetēsítē do tē hiqen e ngrihen dhe i gjithē referimi dhe autoriteti do tē kufizohen tek i Vetmi xh.sh.. Por nē kētē botē, njeriu ka gjéra tē shumta dhe autoritete tē cilave ai u referohet, u drejtohet, prandaj kjo frazë pohon se prapa shkaqeve dhe ndērmjetēsive shihen rrezet e fuqisē dhe ndikim ēshhtē i Atij; shkaqet janē thjesht perde (nē kētē botē gjithashtu ēshtē Allahu xh.sh) dhe se shkaqet ndērhjynē vetēm pēr disa shembuj urtēsie. Sepse Krijuesi xh.sh. krijon gjithçka qē i nevojitet njeriut.

**I Pesti:** Vērseti paraprijēs duke pasē aluduar pēr lumturinē e pērjetshme, ky vērset tregon mirēsinē e mēparshme dhe favoret qē e bējnē tē domosdoshme atē. Domethënē, Ai tē cilit i ēshtē dhuruar mirēsi me gjithçka qē ēshtē nē tokē duhet tē jetē i denjē pēr t'iu dhēnē lumturia e pērjetshme.

**Fraza:** شُمُّ اسْتَوَى إِلَى السَّمَاءِ *thum-me isteva ilâ el-semâi* "pastaj Ai (u ngrit lart) isteva drejt qiejjit": Pozicionimi i saj ka katēr aspekte:

**I Pari:** Qielli ēshtē shoku -binjaku- i tokēs. Toka nuk mund tē pērfytyrohet si e vetme; pērmendja e saj tē kujton gjithmonē qiellin. Asstu siç u pērmend nē fjalinē e mēparshme toka, po asstu nē kētē fjali pērmendet qielli.

**I Dytı:** Qiejt janē vēnē nē sistem nē njē mēnyrē tē pērsosur (nē njē mēnyrē tē tillē qē) njeriu tē mund tē pērfitojē prej asaj qē ēshtē nē tokē.

**I Treti:** Vērseti paraprijēs tregon dēshmitē e mirēsise dhe tē bamirēsise (Hyjnore), ndērsa ky vērset tregon dēshmitē e madhēshtisē dhe tē fuqisē (Hyjnore).

**I Katerti:** Kjo frazë tregon se pērfitimet e njeriut nuk janē tē kufizuara tek toka por se edhe qiejt gjithashtu i janē nēnshtuar dobisē sē tij.

**Pozicionimi i frazës** *fesev-vahunne seb'a semavatîn "duke i bérre ata shtaté qiej"*. Kjo ka tre (pesē) aspekte:

**I Pari:** Fraza ēshtē lidhur me atē tē mēparshmen asstu si lidhja فِي كُنْ "fejekun" "dhe ajo ēshtē bérre (nē cast)" me كُنْ "kun", "bēhu". Sikur fjalia *kun* me *istewa*.

**I Dytı:** (ajo *-istewa-* ēshtē lidhur me tē parēn) nē mēnyrēn qē funksioni (*teal-luk*) i fuqisē (Hyjnore) dhe ai i Dēshirēs (Hyjnore) tē lidhen.

**I treti:** (ajo lidhet me frazēn e mēparshme) nē mēnyrēn qē konkluzioni (i njē pjese) tē lidhet me parathēnien.

**Pozicionimi i frazës** *وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ve huve bikul-li shej'in Alimun "Dhe Ai ēshtē i Gjithēdituri pēr çdo gjie"* ka dy aspekte:

**Njéri prej tyre:** (kjo frazë) ēshtē njē argument prej shkakut tek pasoja (*delil-limmij*) duke provuar rregullin -sistemin qiellor- (tē pērshkruar nē frazēn e mēparshme), asstu si ai rregull ēshtē njē argument prej pasoja tek shkaku (*delil innij*) duke provuar kētē frazë. Sepse rregulli dhe harmonia provojnē ekzistencēn e njobjes sē plotē, asstu siç tregon njobja rregullin.

**Tjetri:** Fraza e mēparshme tregon fuqinē e plotē, ndērsa kjo frazë tregon njobje tē gjithanshme e gjithēperfshirēse.

**Pozicionimi i pjesēve tē frazave tē vērsetit:**

(Vērseti pērmban kēto pika:) fraza e parē nuk ēshtē lidhur me frazēn e mēparshme; dy pjesēt e para janē tē shquara, siç ēshtē

kallzuesi; parafjala “*le*” e “*lekum*”, “*pér ju*” dhe vendosja para e frazës; parafjala “*fi*”, “*në*” dhe fjala “*xhemian*”, “*gjithçka*”.

Duke qenë e palidhur me atë që e parapriu (*el-istināf*) fraza e parë nënkupton pyetje të pashprehura dhe përgjigje pér tē cilat u vërejtën në pesë ‘aspektet’ e pozicionimit të frazës së parë lartë.

Në frazën **هُوَ الَّذِي هُوَ أَنْدَلُبُ** “*Huve el-ledhi*”, (*Ai i Cili*), **عَلَى الْأَرْضِ** “*Ai*” është kryefjalë, dhe **الَّذِي أَنْدَلُبُ** *“i Cili”* është kallzues, dhe tē dy janë tē shquar, që tregojnë Unitetin Hyjnor dhe kufizueshmërinë: (Domethënë, krijimi i gjithçkaje në tokë është e kufizuar tek Allahu; Allahu është i vetmi Krijues). Dhe ky kufizim aludon pér kufizimin e shprehur nga vendosja para e **اللهِ تَرْجُونَ** *“ilejhi”*, *“tek Ai”* tek **ثُمَّ أَلَّهُ تَرْجُونَ** *“thum-me ilejhi turxheune”* “dhe atëherë tek *Ai ju do tē ktheheni*” në vërsetin e mëparshëm. (Përemri lidhor “*i cili*” dhe fjalia lidhore janë kallzuesi, dhe me tē drejtë duhej tē ishte i pashquar) Qënia e tij i shquar këtu tregon se pohimi është i qartë, i dukshëm. (Domethënë, është e qartë dhe e dukshme se Allahu është Krijuesi i gjithçkaje në tokë).

Parafjala **لَكُمْ** “*le*” e dobisë në **لَكُمْ lekum** (*pér ju*) tregon se në esencë gjérat janë tē lejueshme dhe bëhen tē ndaluara vetëm nën disa rrithana; pér shembull, pasuria e njerëzve tē tjerë është e ndaluar (haram) meqë ajo është e mbrojtur nga Sheriati; mishi njerëzor është i ndaluar nga nderimi, respekti; helmi, pér shkak tē dëmit tē tij; ose coftina pér shkak se është e papastër.

Pér më tepër, ajo sugjeron ekzistencën e dobisë pér njeriu në çdo gjë, edhe sikur ai tē përfitonte vetëm prej një gjëje, ose në vetëm njëren prej shumë mënyrave; (ka dobi pér njeriu) edhe tek më e vogëla e gjérave; ose tē paktën një gjë mund tē përdoret me një shikim pér tē nxjerrë mësim.

Pér më tepër, Mëshirëploti xh.sh. ka shumë thesare tē depozituara në tokë, duke shikuar njerëzit e së ardhmes.

**لَكُمْ** Vandosja para e **لَكُمْ lekum** “*pér ju*” tregon se aspekti i përfitimit të njerëzimit (prej përbajtjeve, brendive të tokës) është i pari i qëllimeve dhe më kryesor i synimeve. **مَا مَا** “*Mā*” është e përgjithshme me qëllim që ta nxisë (njeriu) tē kërkojë dobitë e përfitimet në çdo gjë.

**فِي الْأَرْضِ** Përdorimi i **فِي الْأَرْضِ** “*fi el-erdī*” “*në tokë*” në vend tē **عَلَى الْأَرْضِ** “*alel erdī*” “*mbi tokë*” pér shembull, tregon se shumica e gjérave pér t'u përfituar janë krijuar brenda tokës. Ajo gjithashtu nxit -njeriun- pér tē kërkuar e hetuar atë çfarë gjendet atje. Dhe përfitimi gradual i njerëzimit prej mineraleve dhe substancave tē tjera tē tokës sugjeron se ajo mund tē përbajë materiale dhe elemente tē tilla si artikuj ushqimorë dhe gjëra tē tjera që do tē lehtësojnë peshat e jetës njerëzore tē së ardhmes.

**جَمِيعًا** Dhe **جَمِيعًا** “*xhemian*”, “*gjithçka*” është pér tē hedhur poshtë iluzionet –idetë e rreme- se disa gjëra janë tē kota dhe tē përkohshme.

**ثُمَّ** Në frazën e dytë, **ثُمَّ** “*thum-me*” tregon një zinxhir tē akteve dhe tē veprave tē tē Vetmit xh.sh. pasi krijoj tokën, (kthimin e Tij) pér tē vënë në rregull qiejt. Ajo gjithashtu është një shenjë se në lidhje me dobitë e njerëzimit, sistemimi i tyre është i një shkalle më tē ulët se sa krijimi i tokës. Ajo gjithashtu nënkupton ndodhjen e tij -sistemimit- më vonë (se krijimi i tokës).

**اسْتَوْى** **أَرَادَ أَنْ يُسْتَوِي** **Isteva** “*Isteva*” është një përdorim i thukët, duke pasë kuptimin **erade e jusavvije**, Ai deshi ose dëshiroi ta vendoste në rregull apo në sistem”. Ajo gjithashtu ka një kuptim metaforik, duke treguar dikë i cili synon diçka me përqëndrim e ngultas pa” u shmangur nga e majta apo e djaththa.

**إِلَى السَّمَاءِ** **Ilā el-semāt** “*drejt qießlit*” domethënë, tek lënda -fizike- e qiejve, dhe drejt tyre.

Pjesëza **ف** “fe” e **فسریان** “fe sev-vàħunne”, “dhe Ai i béri ato” éshtë pér kêtë se kjo éshtë pjesëza e ndryshimit ose e degëzimit (*tefri*), (lidhja midis kësaj fraze dhe frazës së mëparshme; domethënë, midis

“isteva” dhe “tesvijjeh” i ngjason **فيكون** “fejekun” “dhe ajo éshtë

**بَرِّ** **bérë** (në *çast*) duke qenë pasojë e (urdhërit krijues) **كُن** “kun”, **بَهُو**, dhe një akt i fuqisë duke qenë rezultati i një akti Dëshire, dhe ekzekutimi i një akti (*el-kada*) duke qenë rezultati i paracaktaimit (*kaderit*). Dhe sa pér atë që shpreh “vijuesja” (*taækib*), **ف** “fe” nënkuption disa fjalë tē pashprehura: “Ai i béri (qiejt) tē ndryshëm dhe i vendosi ato në rregull dhe i rregulloi çështjet midis tyre, dhe pastaj Ai i vuri ato në sistem (duke i bérë shtatë qiej)”.

Kuptimi i **سُوی** “*sev-và*” **بَرِّي** “*béri, formoi*” éshtë se Ai i krijoi ato të mirëregulluara, të mirësistemuar dhe tē ngashëm, duke i dhënë secilit atë që i përshtatet aftësisë tē tij dhe që éshtë e barabartë pér kapacitetin e tij.

(Prapashtesa përemërore) **هُنْ** “*ħunne*” **أَتُو** “*ato*” shpreh ndryshimin e lëndës (fizike) tē qiejve.

Sa pér **سَبَعَ** “*seb'a*” -shtatë- ajo pérmban -kuptimet- edhe tē shumësisë së niveleve tē qiejve, edhe lidhjen me shtatë atributet (Hyjnore), dhe me shtatë periudhat gjeologjike në formimin e tokës.

Dhe me **سَمَوَاتٍ** “*semavatîn*” **قِيَّ** “*qiej*” synon kopshtet e luleve tē shumtë me perla, detet pér peshqit e planeteve, dhe fushat e lërueshme pér farërat e yjeve tē qëndrueshëm.

**Fraza** **وَهُوَ كُلٌّ شَيْءٌ عَلَيْهِ** *ve huve bikul-lî shej'in Alimun, Dhe Ai éshtë i Gjithëdituri pér çdo gjë.*

Lidhësja **وَ** “ve”, “dhe” bën tē domosdoshme një lidhje (megjithëse në dukje nuk éshtë asnjë), e cila nënkuption (fjalinë e pashprehur vijuese). Ai éshtë i Gjithëfuqishëm mbi tē gjitha gjërat, kështu Ai (duhet tē jetë) Krijuesi i këtyre trupave qillorë madhështorë.

**وَهُوَ كُلٌّ شَيْءٌ عَلَيْهِ** *Dhe Ai éshtë i Gjithëdituri i tē gjitha gjërave, sepse éshtë Ai i Cili i vendosi ato në rregull me një art tē tillë tē saktë.*

**بَكْلٌ** **Bî** e cila shpreh fqinjësi -ngjitje, puqje- (në *bikul-lî*, “pér gjithçka”) tregon se njohja nuk ndahet nga ajo që njihet.

**كُلٌّ** **Kul-lî**, “çdo, pér çdo” éshtë e përgjithshme dhe (nga këndvështrimi i njohjes Hyjnore) nuk ka asgjë jashtë saj (sepse Allahu njeh çdo gjë pa pérjashtim). Kështu rregulli, **مَامِنْ عَامَ الْأَوْدَخْصُ مِنْهُ الْبَعْضُ** “tē gjithë rregullat e përgjithshëm kanë pérjashtime”, ka një pérjashtim. Ose pérndryshe ky rregull do tē ishte vetëkundërshtues si një rrënje e pabashkëmatshme (iracionale) (jo nga matematika por) nga fjalia.

Fjala **شَيْءٌ** “*shej'in*”, **جِئْ** “*gje*” përfshin dëshiruesin dhe tē dëshiruarën, edhe gjëra tē tilla përvëç këtyre si tē pamundshmet.

**عَلَيْهِ** **Alimun**, “*i Gjithëdituri*” domethënë, Esenca -Hyjnore- prej tē cilës njohja éshtë një (Atribut) i brendaqenësishëm e i domosdoshëm.

\* \* \*

## VËRSETI 30

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةَ أَنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً قَالُوا إِنَّمَا تَعْلَمُ فِيهَا مَن يَفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدَّمًا وَنَحْنُ نَسْبِحُ بِحَمْدِكَ وَنَقْدِسُ لَكَ قَالَ أَنِّي أَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُونَ

*Ve idh kâle Rab-bukë li el-melaiketi in-nî xfâ'îlun fi el-erdî kfâlifeten. Kâlu etexh'alu fîha men jufsidu fîha ve jesfiku el-dimâ ve nahnu nuseb-bihu bîhamdikë ve nukad-disu leke. Kâle in-nî Aëlemu ma là ta'elemune.*

Dhe (kujto) kur Zoti yt u tha melekëve: "Me tê vërtetë që Unë do tê krijoj - çoj - nê tokë zëvendësues". Ata i thanë: "A do tê vendosësh atje ata tê cilët bëjnë zullume -padrejtësi- e do tê derdhin gjak, ndërsa ne tê madhërojmë Ty me lavdërimë dhe falënderime, dhe tê shenjtërojmë". Ai u tha: "S'ka dyshim se Unë di atë që ju nuk e dini".

## Një parathënie

**Shqyrtoje këtë:** Besimi vërtetues në ekzistencën e melekëve në njërin prej shtyllave të besimit. Ne mund ta provojmë dhe ta shpjegojmë atë këtu në disa stacione (mekamat)<sup>1</sup>:

### Stacioni i parë

Ai që e vëzhgon tokën, (do tê shohë se), pavarësisht ultësisë së saj, ajo është e mbushur me qënie me shpirtëra (*dhevi el-ervah*), dhe në qoftë se ai e studion rregullin e saktë të botës, do tê kapë me intuitë se yjësitë e larta gjithashtu kanë banorë.

Një person që nuk beson në ekzistencën e melekëve i ngjason një njeriu i cili udhëton për tek një qytet i madh dhe atje has rastësisht një shtëpi të vogël e cila është e vjetër, antike dhe e ndotur me plehra e mbeturina, dhe e mbushur me njerëz. Ai vëren se oborri i saj është plot me qënie e shpirtëra, që të gjitha ato kanë kushte e nevoja të veçanta jetike: Disa prej tyre janë barngrënëse dhe disa janë peshkngrënëse.

Pastaj shikoi miliona apartamente dhe pallate të lartë të reja dhe të shpërhapura midis shesheve të gjërë dhe shëtitoreve, por për shkak të mungesës së kushteve për të mbështetur jetën e njerëzve, ai beson se kjo banesë në ato pallate është zbrazur nga banorët-është pa banorë.

Një person që beson në melekët është si dikush i cili kur shikon shtëpinë e vogël e cila është plot me qënie me shpirtëra dhe vëren rregullin e qytetit, është absolutisht i sigurt se edhe ato pallate të stolisur kanë gjithashtu banorë të përshtatshëm për to dhe me kushtet e tyre të veçanta të jetës. Qënia e tyre e padukshme, për shkak ose të distancës ose të lartësisë së pallateve, nuk provon se ato nuk ekzistojnë. Kështu, nëpërmjet një analogji parësore të bazuar mbi një silogizëm të "fshehir" dhe tê bazuar gjithashtu mbi sistemin e rregullt, mund të dilet me konkluzionin prej tokës duke qenë e mbushur plot me qënie të gjalla se hapësira e pafundme me yjësitë e saj, me yjet dhe qiejt është plotë me qënie me shpirtëra, të cilat janë të llojeve të ndryshme, që sheriat i quan melekë! Tani reflekt o mbi këtë!

## Stacioni i dytë

Ti e di -ashtu siç éshtë diskutuar e vërtetuar- sejeta éshtë zbuluesja e qënieve; në të vërtetë, ajo éshtë rezultati i saj. Atëherë, si do të ishte e mundur që kjo hapësirë e pafundme të ishte pa banorë dhe ato qiej të ishin pa banues? Sigurisht të gjithë të urtit, të mençurit, kanë në efekt pajtueshmëri mendimi mbi konceptin e melekëve dhe mbi realitetin e tyre -edhe pse interpretimet e tyre kanë ndryshime. Në fakt, filozofët peripatetikë i quajtën ata esencat shpirtërore të shtrupëzuara të specieve".

Dhe iluministët i quajtën "dhjetë mendjet dhe zotërat e specieve", dhe ndjekësit e feve i kanë quajtur Meleku i Maleve, Meleku i Deteve dhe Meleku i shirave për shembull, madje edhe për materialistët, të cilët besojnë vetëm në atë çfarë shikojnë, dhe që mendjet e të cilëve kanë rënë tek sytë e verbër të tyre, nuk e kanë pasë të lehtë të mohonin konceptin e engjëjve por interpretuan dhe i shikuani ato në forcat rrjedhëse ose i shoqëruan me fuqitë e përhapura (*el-kuvet el-sarija*) në ligjet e krijimit.

- *Në qoftë se ti do të pyesje:* A nuk janë ligjet dhe parimet në fuqi në krijim të mjaftueshme për të mbajtur universin dhe për -të mbështetur- vitalitetin e tij?

*Ty do të tē thuhej:* Ato ligje dhe parime janë vetëm teorike ose subjektive (*i'ëtbarije*) ose madje imagjinare:

Atyre mund t'u jetet ekzistencë e veçantë dhe identitet veçse nëpërmjet asaj që i përfaqëson dhe i reflekton ato dhe që mban frerat e tyre. Dhe kjo nuk éshtë asgjë tjetër përvëç melekëve.

Për më tepër, filozofët (*el-hukema*), arsyaja dhe tekstet fetare të transmetuara janë të bashkuan në -besimin e tyre se- ekzistanca nuk éshtë kufizuar tek bota e dukshme e jashtme, e cila éshtë e pajetë dhe e papërshtatshme për formimin (*teshek-kul*) e shpirtërave. Ndërsa bota e padukshme përmban botëra të shumta të cilat janë të përshtatshme për shpirtërat, siç éshtë uji për peshqit, dhe éshtë plot me melekë dhe ai përhap e shfaq jetë për botën e dukshme.

Kështu, meqenëse shpjegime çështje dëshmojnë për ty ekzistencën e melekëve si një koncept, format më të kënaqshme që u përshkruhen

## Vërseti 30

atyre janë ato të shpjeguara nga sheriati, ashtu siç éshtë rënë dakort nga të gjithë njerëzit me mendje të shëndosha: se ata -melekët- janë shërbëtorë adhurues të nderuar -të Allahut- të cilët nuk e kundërshtojnë kurrë atë për të cilën u urdhëruan. Ata janë trupa të ndritshëm të hollë dhe janë të llojeve të ndryshëm.

## Stacioni i tretë

**Shqyrtoje këtë:** çështja e melekëve éshtë njëra prej atyre çështjeve në të cilën -ekzistanca e- universales mund të verifikohet nga vërtetimi (i ekzistencës së) një pjesë të vetme; dhe specia mund të njihet nëpërmjet shikimit të njërit prej individëve të saj. Sepse në qoftë se do të mohohej njëri, do të mohoheshin të gjithë të tjerët.

Pastaj ashtu siç éshtë e pamundur tek ti -të zgjoftë Zoti- që të pajtohen në mendim mbi ekzistencën e engjëjve ndjekësit e të gjitha feve nëpër shekuj qysh nga koha e Ademit deri tani, dhe mbi ndodhjen e sigurt të bashkëbisedimeve me to dhe mbi shikimin e sigurt të tyre, dhe mbi rrëfenjat rreth tyre dhe mbi atë që kanë raportuar njerëzit rreth llojeve të tyre të ndryshme -në qoftë se një melek i vetëm ose disa, nuk do të ishin parë, dhe në qoftë se ekzistanca e njërit apo e më shumë prej tyre nuk do të ishte e sigurt ose në qoftë se ekzistanca e tyre do të ishte kapur e perceptuar domosdoshmërisht; po ashtu do të ishte e pamundur që një iluzion i tillë të ishte bërë i vërtetuar në besimet e njerëzimit dhe të vazhdonte në këtë mënyrë nëpër të gjitha turbullirat dhe ndryshimet (e kohës) në qoftë se nuk do të kishte pasë asnjë të vërtetë që t'u jepte shkas atyre besimeve të përgjithshme ose parimeve të domosdoshme mbi të cilat ato u bazuan. Prandaj, baza e konsensusit éshtë një intuitë - teori- e lindur prej shembujve të ndryshëm të shumëllojshëm, të shikuara e të dëshmuara, duke buruar nga parime të domosdoshme. Dhe arsyaja për besimin e përgjithshëm janë parimet e domosdoshme që burojnë nga -engjëjt- duke qenë parë e vëzhguar në raste të shumta, duke formuar atë që në efekt éshtë një konsensus lidhur me to. Përndryshe asnjëri nga besimet e sigurta të njerëzimit -lidhur me gjërat e tjera- nuk do të ishte i besueshëm.

Kështu, në qoftë se ekzistanca e ndonjë qënieje shpirtërore (*el-ruhanija*) éshtë verifikuar në ndonjë kohë, edhe ekzistanca e species éshtë verifikuar. Dhe meqenëse ekzistanca e species éshtë verifikuar,

atëherë ajo sigurisht do të jetë ashtu siç shpjegohet nga sheriati dhe siç shpjegohet nga Kurani.

### Pozicionimi i kuptimit të këtij vërseti në lidhje me vërsetin paraprijës.

Ai ka katër aspekte:

**I Pari:** Vërsetet -e mëparshëm- rendisin mirësitë e mëdhaja që iu dhuruan njeriut, ndërsa vërseti paraprijës tregon më të madhen e tyre - qenien e njeriut fruti i krijimit dhe gjithçka mbi tokë duke iu nënshtruar atij, dhe ai vepron mbi të si të dojë. Tani ky vërset tregon se ai njeri është kalifi i Allahut në tokë dhe është sunduesi i saj.

**I Dytë:** Ky vërset shpjegon e sqaron, shtjellon, verifikon, provon e mbështet atë çfarë -pohon- vërseti i mëparshëm, se frerat e zinxhirëve të gjithçkaje në tokë janë në duart e njeriut.

**I Treti:** Vërseti i mëparshëm duke pasë shpjeguar ndërtimin e dy banesave të tokës dhe të qiejve, ky vërset tregon banorët e tyre, njerëzit dhe melekët. Dhe ndërsa i pari aludon për zinxhirin e krijimit, ky vërset aludon për zinxhirin e qënieve me shpirtëra (*dhevi el-ervah*).

**I Katerti:** Në vërsetin e mëparshëm duke bërë të qartë se njerëzimi është qëllimi i krijimit dhe se njeriu ka një vend të lartë në shikimin e Krijuesit të tij, dëgjesi nxitet të pyesë: Si mund të jetë i denjë njeriu kur ai bën kaq shumë të këqija, fesade dhe korruption? A urtësia e bën të domosdoshme ekzistencën e tij për të bërë adhurim dhe për ta shenjtëruar Allahun xh.sh..? Kështu ky vërset nënkupton se për llogari të (përbri) misterit të (Amanetit, besimit) të vendosura tek ai, të këqijat e tij dhe mbrapshtitë i falen; dhe se Allahu nuk ka nevojë për adhurimin e njeriut, sepse disa nga melekët e shenjtërojnë Atë dhe e lavdërojnë me lëvdata të panumërtë. (Prandaj, krijimi i njeriut) është për ndonjë qëllim -urtësi- të njobur vetëm për të Gjithëditurin e të Padukshmes.

### Tani pozicionimi i frazave të vërsetit:

Ky vërset rrjedh butë, pa vështirësi -prej atij të mëparshmit- për shkak të (të dytit të nënkuptuar) **وَأَذْ** **“ve idh”** **“Dhe (kujto)”** i bërë i

domosdoshëm nga i pari, dhe shikimi i tij tek (*atf*) lidhja e **وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ve huve bikul-li shej'in Alimun** “*Dhe Ai është i Gjithëdituri për çdo gjë*” (megjithëse në dukje është e palidhur, kjo nënkupton) fjalinë e pashprehur: “Atëherë، **إذْ** **‘idh’** Ai krijoi atë çfarë krijoi në një rregull kaq sistematik të përkryer. **el-melâiketi**” **“Dhe (kujto) kur Zoti yt u tha melekëve”**... (Kështu **إذْ ‘idh’** e dytë shikon tek e para dhe një lidhje formohet ndërmjet dy fjalive). Dhe kur Ai xh.sh. iu adresua melekëve – për t'i bërë ata të pyesin rreth shkakut për -krijimin e njeriut- dhe për t'ua mësuar atyre konsultimin si një metodë, duke u thënë: **انَّى جَاعِلُ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً** **in-ní xfà'ilun fi el-erdì khalifeten** “*Me të vërtetë që Unë do të krijoj -çoj- në tokë zëvendësues*” ajo e nxit mendjen e dëgjesit të pyesë (tre gjëra):

*E para:* “Çfarë thanë melekët?”, në lidhje me misterin e bashkëbisedimit; dhe *e dyta*: me habi pyetën rreth arsyes për krijimin e njeriut:

**قَالَ لَوْا أَتَجْعَلُ فِيهَا مِنْ يَفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدَّمَاءَ** **“etexhi'alu fiha”** “*A do të vendosësh atje (në tokë)*” dhe *e treta* pyetën për të mësuar urtësinë në caktimin e kalifatit mbi njeriun dhe jo mbi xhindet keqbërës, ndonëse vendosi fuqitë e zemërimit si dhe të dëshirave shtazore mbi ato gjithashtu: **“men jufsidu fiha?”** **“të cilët bëjnë zullume-padrejtësi”** (Ndërsa kjo e fundit është) për shkak të ekseseve të fuqisë së dëshirave, dhe **“ve jesfiku el-dimâe”** **“e do të derdhin gjak”** për shkak të agresionit dhe të tejkalimit të fuqisë së zemërimit. Duke pasë plotësuar pyetjet e saj dhe duke pasë shprehur çudinë e saj, mendja e dëgjesit pret përgjigjen e (Allahut) xh.sh..

Dhe Kurani Kerim dha përgjigje me frazën:

**قَالَ أَنِّي أَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُونَ** **Kâle in-ní Aëlemu ma là ta'ëlemune** “*Ai u tha: S'ka dyshim se Unë di atë që ju nuk e dini*”. Domethënë, gjërat dhe dispozitat nuk janë të kufizuara tek ajo që ju njihni, dhe mosnjohja juaj nuk nënkupton se ndonjë gjë nuk ekziston.”

Unë jam i Gjithurti, Unë kam urtësi pér (krijimin e tyre), dhe Unë do t'i fal korruptionin dhe gjakderdhjen e tyre pér llogari të -përbri-urtësisë në të.

### Tani pozicionimi i pjesëve të frazave:

Sic u tregua lart, nëpërmjet lidhjes së domosdoshme ndërmjet dy fjalive të lidhura nga një lidhëse, lidhësja ‘ve’ (dhe) (në fillimin) e **وَأَذْقَالَ رِبُّكَ** *Ve idh kâle Rab-bukë li el-melâiketi* “Dhe (kujto) kur Zoti yt u tha melekëve: **أَنِي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً** “Me të vërtetë që Unë do të çoj në tokë zëvendësues”, nënkupton një fjali të shprehur: *Ai krijoi atë çfarë krijoi në një rregull kaq të sistemuar dhe të përkryer.*

Kërkohet gjithashtu edhe përpara vërsetit **وَأَذْقَالَ رِبُّكَ** *Ve idh kâle Rab-bukë* “Dhe përkujto kur Zoti yt u tha melekëve: **أَذْخَلَ مَاخْلُقَ مُنْتَظَمًا** “Unë do të krijoi një njeri (Ademin) prej argjili tingëllues, prej balte të zezë e të lëmuar (duke i dhënë formë).”<sup>2</sup>

Gjithashtu meqenëse (nga pikërisht natyra e saj) shpallja të bën thirrje, të tërheq vëmendjen dhe të kujton, lidhëzja **وَ** “ve”, “dhe” nënkupton **وَأَذْقَالَ رِبُّكَ** “Dhe kujtoju atyre se kur Zoti yt...”

Pjesëza **إِذْ** “idh” “Dhe (kujto)” shpreh kohë të shkuar, dhe kështu e çon mendjen e dëgjuesve tek kohët e njëpasnjëshme të së shkuarës, atje ngre -perden- dhe i tërheq pér tek e tashmja ngjarjet e saja me qëllim që ata të mund t'i shikojnë dhe të mbledhin atë çfarë ndodhi në të.

(Fjalët) **رِبُّكَ** “Rab-bukë” “Zoti yt” është një provë pér melekët; domethënë, Ai i Cili të ka ngjitur dhe të ka plotësuar ty (Muhammed a.s.m.) dhe të ka bërë ty udhëzuesin e njerëzimit që ti të zhdukësh korruptionin e tyre: Domethënë, ti je vepra e mirë më e madhja -e

<sup>2</sup>Kuran 15:28

njerëzimit- që ka epërsi e peshë më të madhe dhe i mbulon të gjitha ato ligësi”.

**لِلْمَلَكَةِ** “*li el-melâiketi*” “(u tha) melekëve”. Allahu xh.sh. nëpërmjet bashkëbisedimit me melekët në formën e konsultimit kjo tregon se banorët e qiejve, domethënë melekët, kanë shumë lidhje e marrëdhënie me banorët e tokës, domethënë, me njerëzimin. Sepse disa nga ata janë ngarkuar pér të mbikëqyrur (qëni njerëzore) (*muvekkel*), disa janë melekë ruajtës, disa janë melekë shkrues, kështu ata kanë të bëjnë dhe interesohen me çështjen e tyre. Meqenëse natyra e (pjesëzës intensifikuese) **أَنِي** ‘*inne*’ “sigurisht, me të vërtetë” është pér të imposhtur dyshimet, këtu e shprehur (nga pyetja e melekëve) **أَتَجْعَلُ** “*etexh'alu?*” “*a do të vendosësh*”, ajo tregon rëndësinë e madhe të pyetjes.

Përdorimi i prapashtesës përemërore të vetës së parë **يَ** “*i*” **أَنِي** “*inni*” “*s'ka dyshim se Unë*”, megjithëse veta e parë shumës është përdorur në **وَأَذْقَلَنَا** **كُلَّنَا** “*Ne thamë*” në vërsetet vijuese, tregon se ndodhen ndërmjetësi në krijim dhe në dhënien e ekzistencës ashtu siç ndodhen në foljen e Tij dhe në adresimin. Këto pika të holla ilustrohen gjithashtu në vërsetin,

**أَنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِتَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ** **بِمَا أَرَيْكَ اللَّهُ** **Sigurisht** që *Ne të kemi zbritur ty (o Muhammed a.s.m.) librin (Kuranin) me të vërtetën që të mund të gjykosh mes njerëzve me anë të asaj që Allahu të ka shpallur ty.<sup>3</sup>*

Këtu veta e parë shumës në **Enzelna** “*Ne të kemi zbritur*” tregon ekzistencën e një ndërmjetësie në -zbritjen- e shpalljes -vahjet- dhe nënkupton madhështinë e saj. (Domethënë, ajo tregon melekun e shpalljes i cili manifeston madhështinë e Atij që e dërgoi).

<sup>3</sup>Kuran, 4:105

Ndërsa veta e tretë njëjës tek **بِمَا أَرْيَكَ اللَّهُ** “në përputhje me atë që tē ka mësuar ty Allahu” tregon se nuk ka ndërmjetësi në inspirimin - ilhamin- e kuptimeve.

**خالق جاعل** **xfi'a'il** “vendos, bëj” mbi **“khalik”** “krjoj” tregon se ajo që shkaktoi dyshime dhe pyetje tek melekët eshtë njerëzimi duke u vendosur në tokë dhe duke u caktuar pér ta mbjellë atë, dhe jo pér tē krijuar e pér tē sjellë në ekzistencë. Sepse ekzistanca eshtë thjesht e mirë e pastër dhe krijimi eshtë një akt esencial (*fiël dhatij*) (i Allahut) dhe (si i tillë) nuk mund tē pytet rreth tij. Preferenca -zgjedhja- e **في الأرض** **“fi”** “në” tek fraza **“fi el-erdi”** “në tokë” mbi **“ala”** “sipër”, ndonëse njerëzimi eshtë mbi tokë, sipër tokës, nënkupton se njerëzimi i ng Jason shpirtit tē fryrë në trupin e tokës, dhe kurdo që tē dalë njerëzimi, do tē shkatërritet toka dhe do tē vdesë.

**خليفة** **khalifeten** “zëvendësues, kalif” sugeron se para se tē bëhej gati toka pér kushtet e jetës së njeriut, u gjend një krijesë e vetëdijshme, që periudhat para tokës ndihmuani kushtet e jetës së saj- ishin tē përshtatshme.

Ky -shikim- eshtë në përshtatje me çështjet e shkencës (*kadije el-hikma*). Eshtë e mirënjohur se ajo krijesë e vetëdijshme ishte një lloj prej xhindëve, por ata përhapën korruptionin-në tokë-, kështu ato u zëvëndësuan nga njerëzimi.

**قالوا أتَجعَلُ فِيهَا مَن يُفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدَّمَاءَ**  
**Pjesët e fjalisë:** **etexh'alu fiha men jufsidu fiha ve jesfiku el-dimâe,** “Ata i thanë: “A do tē vendosësh atje ata tē cilët bëjnë zullume-padrejtësi e do tē derdhin gjak”

**Shqyrto këtë:** **“Kàlu”** “Ata i thanë” duke qenë në dukje e palidhur me atë që e parapriu (*istinaf*) sugeron se drejtimi i Allahut xh.sh. dhe adresimi drejt melekëve e shtyn dëgjesin tē pyesë: Cili eshtë qëndrimi -i melekëve- ndaj fqinjëve tē tyre, duke parë se shtëpitë e tyre janë krah pér krah, përbri? A do tē ishin ato tëdhe a do t'i pranonin që t'i kenë

ato si komshi? Cili eshtë opinioni i tyre pér ta? Kështu Kurani Kerim i përgjigjet asaj pyetje: **“Ata i thanë:** **أَتَجَعَلُ** “*A do tē vendosësh atje...?*”

**قالوا أتَجعَلُ** **“Kàlu etexh'alu”** “Ata i thanë: “*A do tē vendosësh*” eshtë pasojë e pjesëzës kushtore “*idh*” (në frazën **“Ve idh kâle”** “Dhe (kjuto) kur Zoti yt u tha”) (por fraza e domosdoshme “*luzum*” eshtë e pasprehur, duke nënkuptuar fjalët:)

Allahu xh.sh. dekretoi që njeriu duhej tē bëhej kalifi i Tij në tokë, që ishte nën mbikëqyrjen e melekëve, megjithëse Ai nuk kishte nevojë pér oficerë e ministra. Kjo do tē thotë se melekët duhej tē deklaronin se si ato do t'i takonin (qëni njerëzore)”.

Ligjérata (në këto dy fraza) **“tha, thanë”** eshtë një bashkëbisedim në formën e konsultimit, (dhe qëllimi i saj eshtë) t'u ja pësë mësim (këto) njerëzve, sepse Allahu xh.sh. eshtë krejtësisht larg (e aspak në nevojë) pér to. (Melekët pyesin): **أَتَجَعَلُ** **“etexh'alu”** “*a do tē vendosësh*” me qëllim që tē dinë arsyen, sepse Allahu xh.sh. i kishte njoftuar ata rreth saj por kishte penguar arsyen. Ky ishte shkaku i çudisë së tyre dhe i çoi ata në pyetje.

Domethënë, pyetja e tyre: “Cila eshtë urtësia në vendosjen -e njerëzve- në tokë? Kështu, ata donin tē mësonin rezultatin ose pasojën e termit ‘*xheale*’ dhe jo shkakun, dhe jo pér ta mohuar apo pér ta kundërshtuar atë, sepse ato -melekët- janë pa mëkate.

Dhe vendosja -e njerëzimit në tokë- aludon se karakteristikat e njeriut, dhe origjinat teorike dhe prejardhja, dhe rrëthanat nuk janë tē domosdoshme nga natyra, (*vela min darurat el-fitren*) por tē gjitha janë vendosur nga Një i Cili vendos.

**Pyetje:** Çfarë nevoje ka pér t'u pyetur dy herë **“fi-ha”** “në tē (në tokë)” pavarësisht afersisë së tyre, distancës së shkurtër?

**Përgjigjja:** **Fi-ha** e parë nënkupton se njerëzimi duke depërtuar si një shpirt i fryrë në trupin e tokës i jep jetë asaj; ndërsa **fi-ha** e dytë nënkupton se mbapshtia e njerëzimit i shkakton vdekjen tokës duke

futur kthetrat e saj nē zemrēn e tokës, duke i pērngjasuar Azrailit. Domethënë, njerëzimi nga një anë është ilaç pēr shërimin e tokës, ndërsa nga ana tjetër është helm që i shkakton vdekjen.

Pērdorimi i -pēremrit lidhor- ﴿men﴾ “ata tē cilēt” tregon se jo karakteri i njerëzimit, por është rebelimi i krije save kundra Allahut xh.sh. ajo që i shqetëson -melekët.

Dhe pērdorimi i يَفْسِدُ “jufsidū” “bējnē zullume-padrejtēsi” nē vend tē “jaësi” “kundërshtojnë, rebelohen” tregon se rebelimi nē fund prish rendin e botës. Dhe pērdorimi i kohës së pakryer tregon se ajo që është e urryeshme është përtëritja e rebelimit dhe vazhdimësia e tij. (Melekët) kishin njohuri pēr këtë ose nēpërmjet (Krijuesit) xh.sh. (duke i njoftuar ata) ose nēpërmjet *pllakës së ruajtur*, ose pēr shkak se ata kishin njohje rrëth natyrës humane dhe fuqive tē pakufizuara tē vendosura nē tē. Korrupsioni shkaktohet nēpërmjet pērdorimit tē shfrenuar tē fuqisë së dëshirave shtazore, duke tejkaluar caqet e kësaj fuqie, ndërsa gjakderdhja rezulton nga agresioni dhe tejkalimi i fuqisë së zemërimit.

**فَيَهَا** “Fī-hā” “nē tē (nē tokë)”: Domethënë, (ata shkaktojnë korruption, luftë dhe vrasje nē tokë) pavarësisht qenies së saj një xhami që u themelua mbi takvanë -vetëdijen pēr Allahun dhe frikën ndaj Tij xh.sh..

Lidhëzja “ve” “dhe” lidh dy akte tē urryera e tē pērbuzshme (pērhapjen e korruptionit dhe gjakderdhjen), sepse korruptioni çon nē derdhjen e gjakut.

Dhe zgjedhja e “jesfiku” “do tē derdhin gjak” mbi “jaktulu” “do tē vrasin” është pēr shkak se gjakderdhja është tē vrasësh padrejtësisht. Dhe vrasja nuk është xhihad nē rrugën e Allahut; por ka vrasje që është xhihad nē rrugë tē Zotit. Gjithashtu vrasja (me tē drejtë) e një personi pēr tē shpëtar komunitetin nuk pērbën fesad.

Pērdorimi i fjalës الْدَّمَاءُ “el-dimāe” “gjak” me يَسْفِكُنَّ “jesfiku” “derdhin” është pēr tē theksuar neverinë e vrasjes.

وَنَحْنُ نُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ وَنُقَدِّسُ لَكَ ve nahnu nuseb-bihu bihamdikē ve nukad-disu leke. , “ndërsa ne tē madhërojmë Ty me lavdërimë dhe falënderime, dhe tē shenjtërojmë”.

(Lidhëzja rrethanore) ♀ “ve” (va vul el-hal) tregon se -melekëtishin tē vetëdijshmë se do t'i kundërshtonin ata me një kundërshtim (tē tillë) si: “A nuk janë adhurimi i njerëzimit dhe shenjtërimi i tyre ndaj Tij një urtësi e mjaftueshme nē shikimin tuaj (pēr qeniet njerëzore duke u vendosur nē tokë)”?

نَحْنُ نُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ Né “ve nahnu” “ndërsa ne”, domethënë i gjithë grupi i engjëeve të panjollosur e tē papërlyer nga mëkatë. Dhe kjo duke qenë një fjali emërore nënkupton se lavdërimi i Allahut është një pjesë e pikërisht natyrave tē tyre, e lindur, thelbësore pēr to dhe e kërkuar medoemos nga natyrat e tyre.

وَنَقَدِّسُ لِأَخْلَقَكَ Nuseb-bihu bihamdikē “tē madhërojmë Ty me lavdërimë dhe falënderime” është një frazë gjithëpërfshirëse: Ne tē shpallim Ty nē univers nēpërmjet tē gjitha shumëllojshmërive tē adhurimit. Ne besojmë se me atributet e Tua tē gjithëlavdishme Ti je i lartësuar dhe krejtësisht larg ndonjë gjëje tē padenjë (pēr Hyjininë Tënde) -(Atributet e Tua tē lavdishme) që janë burimi i mirësive tē Tua tē lavdërueshme.

Ne deklarojmë *subhanallah ve bihamdihil!* Domethënë, ne tē lavdërojmë e tē lartësojmë me Atributet e Tua tē lavdisë dhe tē bukurisë (El-xhelal-vel-xhemal).

وَنَقَدِّسُ لِأَخْلَقَكَ Dhe ve nukad-disu leke “dhe tē shenjtërojmë”, domethënë, ne tē shenjtërojmë Ty, ose “ne i pastrojmë vetet tona dhe aktet tona prej mëkateve dhe zemrat tona prej dëshirës pēr ndonjë gjë përvëç Teje”.

Dhe ndryshe nga lidhëzja e mëposhtme (duke lidhur dy tē këqijat e korruptionit dhe tē gjakderdhjes), (lidhëzja) ♀ “ve” “dhe” këtu lidh dy virtytet e bindjes ndaj urdhërave Hyjnore dhe shmangia e gjérave tē ndaluara.

**Tani pjesët e frazës:** قَالَ أَنِي أَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُونَ *Kale in-ní Aëlemu ma là ta'ëlemune* “Ai u tha: “S'ka dyshim se Unë dì atë që ju nuk e dini””.

Palidhuria e dukshme e kësaj fraze (*el-istinaf*) nënkupton pyetje (të pashprehura): Çfarë tha Allahu në përgjigje ndaj pyetjes së tyre? Dhe si e largoi çudinë e tyre shpjegimi i tij arsyen (rreth krijimit të njeriut)? Cila është urtësia në preferencën e qënieve njerëzore mbi ta?” Kështu ai thotë: “*Kale*” “*Ai u tha:*” duke aluduar për përgjigjen e Tij të shkurtër dhe për shpjegimin e hollësishëm në vërsetin vijues.

“*In-ne*” e “*in-ní Aëlemu*” “s'ka dyshim se Unë dì” është konfirmuese, vërtetuese (*lil tahkik*) dhe hedh poshtë dyshimet dhe hezitim. Ajo përdoret vetëm në çështjet hipotetike e teorike, ndërsa më i Lartësuari xh.sh. në mënyrë të vetëkuptueshme dhe të pakundërshtueshme di atë çfarë nuk e dinë krijesat dhe, ruajna Zot,

melekët nuk kanë dyshime lidhur me këtë. Prandaj, “*in-ne*” “s'ka dyshim, sigurisht” hedh dritë mbi një sekuencë të frazave -të pashprehuratë cilat, duke qenë në përputhje me rrugën e rrahur të retorikës, Kurani e përbledh në mënyrë të thukët e të ngjeshur. Domethënë, ndodhen shumë gjëra të mira dhe shumë avantazhe e dobi në njerëzimin, dhe ndodhet mëkatë por ky është i pjesshëm, është e keqe e pakët. Do të ishte në kundërshtim me urtësinë të braktisësh të parën për shkak të të dytës; domethënë të braktisësh një mirësi të madhe për një të keqe të vogël. Humanizmi gjithashtu mban një mister, dhe kjo e cilëson dhe e kualifikon njeriun për kalifat -melekët ishin të pavëmendshëm për këtë, kurse Krijuesi i njeriut kishte njojuri për këtë. Gjithashtu ndodhet një shembull urtësie në -krijimin- e qënieve njerëzore që i bën ata superiorë (mbi engjëjt); engjëjt nuk e dinin këtë, por i Vetmi që e krijoi atë e dinte.

Gjithashtu, kuptimi (konfirmues) i “*in-ne*” “s'ka dyshim, sigurisht” mund t'i referohet një pohimi të nënkuptuar nga gjithësecili prej fjalëve të fjalisë, dhe jo prej një fjalë të veçantë. Këtu ajo shikon një frazë të nënkuptuar nga لَا تَعْلَمُونَ “ju nuk e dini”, domethënë, ju nuk keni njojje të sigurt për të.

Gjithashtu, أَعْلَمُ “*in-ní Aëlemu ma là ta'ëlemune*” “s'ka dyshim se Unë dì atë që ju nuk e dini” është prej llojit të përmendjes së diçkaje të domosdoshme dhe të dëshirës së pasojës së saj të natyrshme. Domethënë, diçka ekziston për të cilën ju nuk keni njojuri. Sepse njojja e Më të Lartësuarit xh.sh. është e domosdoshme për gjithçka. Dhe mungesa e njojjes -së Tij- tregon mosekzistencën e gjësë së njojur. Ashtu siç tha Ai xh.sh.:

“*A mos është vallë ndonjë gjë që ju ta vini në dijeni Atë për diçka që Ai nuk e di në tokë...?*<sup>4</sup>

Domethënë, është e pamundur -për diçka të panjohur nga Allahu- të ekzistojë. Dhe ekzistenca e njojjes është dëshmi për ekzistencën e gjësë së njojur.

(Në një vend tjeter Kurani) verifikon dhe konfirmon këtë përgjigje të thukët, duke thënë: انَّ اللَّهَ عَلِيمٌ حَكِيمٌ “*Sigurisht Allahu është i Gjithëedituri, i Gjithurtë.*”

Veprave të Tij nuk u mungon asgjë lidhur me urtësinë dhe dobinë. Prandaj qeniet nuk janë të kufizuara në njojjen e krijesave dhe mungesa e njojjes nuk tregon mosekzistencën e tyre.

Dhe kështu kur Allahu xh.sh. i krijoi të mirën e pastër, domethënë melekët, dhe të keqen e pastër, domethënë shejtanët, dhe atë që nuk ishte as e mirë dhe as e keqe, domethënë kafshët, duke qenë Dhuruesi Gjithëbujar i mirësive, urtësia e Tij bëri të domosdoshme ekzistencën e një kategorie të katërt e cila përfshinte edhe të mirën edhe të keqen (domethënë qeniet njerëzore). Kështu në qoftë se fuqitë -njerëzore- të zemërimit dhe të dëshirave shtazore do t'i nënshtroheshin fuqisë së intelektit, nëpërmjet punës dhe përpjekjes njeriu ngrihet më lart se sa engjëjt. Por në qoftë se çështja do të ishte e kundërtë, atëherë ai do të binte më poshtë se sa kafshët, pasi nuk ka justifikim.

\* \* \*

<sup>4</sup> Kuran, 13:33

## VËRSETET 31 - 33

وَعَلِمَ أَدْمَ الْأَسْمَاءَ كُلُّهَا ثُمَّ عَرَضُوهُمْ عَلَى الْمَلَكَةَ فَقَالَ أَنْبُوْنِي  
بِاسْمَهُمْ هُؤُلَاءِ أَنْ كَتَمْ صَادِقِينَ \* قَالُوا سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا  
إِلَّا مَا عَلِمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ \* قَالَ يَا آدُمَ اتَّهِمْ  
بِاسْمَهِمْ فَلَمَّا أَنْبَاهُمْ بِاسْمَهُمْ هُمْ قَالُوا إِنَّمَا أَقْلَ لَكُمْ أَنْتِ  
أَعْلَمُ غَيْبَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَأَعْلَمُ مَا تَبَدُونَ وَمَا كَتَمْ  
تَكْتُمُونَ

*Ve al-leme A'deme el-esmæ kul-leha thumme aredashum ala el melâ'iketi fekale enbiunt bi esmai ha'ulai in kuntum sadikine. Kâlû subhanekë lâ ilme lena il-lâ mà al-lemtena in-neke ente el-Alîmu el-Hakîm. Kâle ja A'demu enbiëhum biesmâ'ihim. Felem-mâ enbeehum biesmâ'ihim kâle elem ekul lekum in-nî aëlemu gajbe el-semâvâti ve el-erdî ve aëlemu mà tubdûne ve mà kuntum tekatumâne.*

*Dhe Ai ia mësoi Ademit emrat e të gjitha gjérave, pastaj ua paraqiti ato melekëve dhe u tha: "Më thoni Mua emrat e tyre nëse jeni të drejtë. Melekët thanë: "Lavdi të qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga çna kë mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti. Ai tha: "O Adem! Tregoju atyre emrat e tyre" dhe kur ai ua tregoi melekëve emëritmet e të gjitha gjérave, Ai tha: A nuk ju thashë Unë juve, se Unë di të fshehtën (gajbin) në qiej dhe në tokë dhe se Unë di qfarë ju shfaqni dhe qfarë ju keni mbajtur të fshehur.*

## NJË PARATHËNIE

**Shqyrtoje këtë:** Kjo mrekulli e Ademit (mësimi i emrave) i sfidoi engjëjt (dhe dyshimet e tyre); madje, ajo ishte një mrekulli e njerëzimit lidhur me çështjen e kalifatit. Ka shumë mësimë për t'u nxjerrë prej tregimit.

Duke mbajtur në mendje vërsetin

“لَأَرْطَبِ وَلَا يَابِسِ الْأَفَى كِتَابٌ مُبِينٌ”<sup>1</sup>, “Nuk ka asgjë të njomë ose të thatë që të mos jetë shkruar në regjistrin e Qartë”,<sup>2</sup> dhe i mbështetur nga faktet se Kurani të jep edhe pohime e dëshmi të qarta, po ashtu të mëson ty nëpërmjet shenjave dhe treguesve<sup>3</sup>, unë kuqtoj nga shenjat mjeshtërore dhe nga treguesit e mrekullisë së Kuranit në historitë e profetëve dhe në mrekullitë e tyre se ai e nxit njerëzimin për të fituar arritje të tillë. Është sikur me këto tregime Kurani është duke drejtuar gishtin tek linjat kryesore dhe tek rezultatet përfundimtare në të ardhmen e përpjekjeve të njerëzimit për progres, sepse e ardhmja ndërtohet mbi themelet e së shkuarës, ndërsa e shkuara është pasqyra e së ardhmes. Dhe është sikur Kurani po e qëllon me pëllëmbë njerëzimin në shpinë duke i nxitur e inkurajuar njerëzit duke thënë: “Orvatuni dhe përipiquni -dhe zbuloni- mjetet për të arritur disa nga këto çudira!” Ti sigurisht që e di se ishte dora e mrekullive në fillim që i dha njerëzimit orën dhe anijen.

Në qoftë se dëshiron, shikoji tani vërsetet,

“Dhe Ai ia mësoi Ademit emrat e të gjitha gjérave”<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Kuran, 6:59

<sup>2</sup> Në qoftë se jeni në dyshim me atë që zbuloi autori rrëth hollësive të renditjes së fjalëve të Kuranit, unë mund t'ju them ju se ne konsultuam librin e poezisë të Ibn el-Farid, duke e hapur atë rastësisht, dhe këto rreshta u hasën:

“Ke enne el-kiram el katibine tenezzelu/ ala kalbihi vahjen bima fi sahifetin-  
Sikur Melekët Shkrues të kishin zbritur/mbi zemrën e tij, duke e inspiruar atë me  
çfarë është në fletë;” Nënshkroi (studenti dhe shkruesi i tij) Habibi.

<sup>3</sup> Kuran, 2:31

"Dhe vërtet që Ne i dhuruam Davudid mirësi prej nesh (duke i thënë): O ju male! Lavdërojeni Allahun bashkë me tē! Edhe ju zogj (gjithashtu)!"<sup>4</sup>

"Edhe Sulejmanit (Ne ia nënshtruam atij) erën, (fluturimi) i paraditës ishte sa (udhëtimi) i një muaji, dhe (fluturimi) i pasditës ishte sa (udhëtimi) i një muaji. Dhe Ne bëmë që të rrjedhë pér tē burim tunxhi..."<sup>5</sup>

"Dhe Ne i thamë: Bjerri gurrit me shkopin tēnd", pastaj që andej u derdhën me vrull dyrbëdhjetë burime. Deri në fund<sup>6</sup>

Dhe ti i shëron edhe tē verbërit e lindur, edhe lebrozët me lejen dhe vußnetin Tim:<sup>7</sup>

Tani hulumto mbi atë që ka prodhuar mendimi njerëzor i kombinuar dhe mijërat e shkencave që ai ka deduktuar: secila prej tyre (është e lidhur me) njëren nga speciet (botërat e qënies) në univers.

Kështu njerëzimi ka ardhur tē manifestojë: *وَعْلَمَ أَدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلُّهَا* ve al-leme Å'deme el-esmæ kul-leha "Dhe Ai ia mësoi Ademit emrat e tē gjitha gjëra".<sup>8</sup>

Tani shqyrto mbi hekurudhat dhe mbi telegrafitë dhe mbi çudirat e tjera tē artit tē deduktuar nga mendimi njerëzor nепërmjet zbutjes së hekurit dhe punimit tē -shkrirjes së- bakrit që njeriu tē vijë tē manifestojë: "Dhe Ne ia bëmë atij edhe hekurin tē butë"<sup>9</sup>, dhe kjo u bë baza e industrisë së tij.

Gjithashtu mendo rrëth aeroplanëve që mendjet njerëzore i kanë thurrur e kurdisur, tē cilët e përshkojnë udhëtimin e një muaji pér një ditë, që njerëzimi tē vijë e tē manifestojë: *غَدُوهَا شَهْرٌ وَرَوَاحُهَا شَهْرٌ* "Edhe Sulejmanit (Ne ia nënshtruam atij) erën, (fluturimi) i paraditës ishte sa (udhëtimi) i një muaji, dhe (fluturimi) i pasditës ishte sa (udhëtimi) i një muaji."<sup>10</sup>

<sup>4</sup> Kur'an, 34:10

<sup>5</sup> Kur'an, 34:12

<sup>6</sup> Kur'an, 2:60

<sup>7</sup> Kur'an, 5:110

<sup>8</sup> Kur'an, 2:31

<sup>9</sup> Kur'an, 34:10

<sup>10</sup> Kur'an, 34:12

Dhe reflekti mbi progresin e arritur në instrumentet e shpikura nепërmjet iniciativës njerëzore, shkopinj -vegla- pér tē goditur shkretëtirat e thata, duke shkaktuar burime tē bollshëm tē gufojnë e vërshojnë dhe duke i transformuar shkretëtirat me rërë në kopshte, saqë

ان اخْرَبَ بِعَصَابَ الْحَجَرِ "Bjerri gurrit me shkopin tēnd".<sup>11</sup>

Tani shqyrto mbi çudirat e mjekësisë tē fituara nga eksperimentet e njeriut që janë fillimi pér t'i shëruar ata tē verbër tē lindur dhe lebrozët dhe me sëmundje kronike, nепërmjet lejes së Allahut ti do tē shohësh se (ndërmjet vërseteve tē lartëpërmendur dhe zbulimeve shkencore tē së ardhmes) është një korrespondencë -bashkëpërgjigjje e plotë dhe ti do tē ishe i drejtë tē thoje se (ato mrekulli) janë kriteri dhe masa (e atyre zbulimeve tē së ardhmes), dhe se mrekullitë i tregojnë ato dhe i nxisin (njerëzit pér tē pranuar që t'i arrijnë) ato.

Gjithashtu, shqyrtoji vërsete tē tillë, si:

يَانَارٌ كُوْنِيْ بِرْدَا وَسَلَامًا "Ne thamë: "O zjarr! Bëhu i ftohtë dhe paqe e siguri pér Ibrahimin"<sup>12</sup>

لَوْلَانٌ رَا بِرْهَانَ رَبِّهِ "...po tē mos kishte parë shenjat e Zotit tē tij"<sup>13</sup> Domethënë sipas një rrëfenje, po tē mos kishte pasë imazhin -formën- e Jakubit a.s. duke goditur gishtin e tij.

أَنِي لَاجِدُ رِيحَ يُوسُفَ "Vërtet që e ndjej erën e Jusufit".<sup>14</sup>

"O ju male! Lavdëroni (Allahun) bashkë me tē."<sup>15</sup>

O ju njerëz!

O njerëz! Na është mësuar gjuha e shpendëve."<sup>16</sup>

<sup>11</sup> Kur'an, 2:60

<sup>12</sup> Kur'an, 21:69

<sup>13</sup> Kur'an, 12:24

<sup>14</sup> Kur'an, 12:94

<sup>15</sup> Kur'an, 34:10

**أَنَا أَتَيْكَ بِهِ قَبْلَ أَنْ يَرْتَدَ إِلَيْكَ طَرْفَكَ** “Unē do ta sjell atē sa tē hapēsh e tē mbyllēsh sytē!<sup>17</sup>

Tani shqyrtoje zbulimin e njerëzimit prej shkallës së zjarrit që nuk djeg dhe prej mjeteve të cilat pengojnë djegien; dhe shpikjen e mjeteve pér tērheqjen e imazheve dhe tē tingujve që nga larg dhe sjelljen e tyre tek ti para se tē hapēsh e tē mbyllēsh sytē; dhe makineritë folëse (tē tilla si radioja), dhe përdorimin e disa specieve të zogjive si pëllumbi etj. Ti mund tē shohësh përputhshmërinë dhe pajtueshmërinë midis këtyre dy llojeve (tē çudirave), dhe me tē drejtë mund tē thuash se (vérsetet) tregojnë e aludojnë (pér zbulimet e së ardhmes).

Gjithashtu, reflekti mbi atributin e veçantë të mrekullisë më tē madhe (Kuranin), mbi foljen dhe mendimin e nyjetuar, veçorinë e njerëzimit, dhe mbi letërsinë dhe mbi elokuencën. Tani mendo rrith mjetit më tē lartë tē edukimit dhe trajnimit të shpirtit njerëzor, dhe pér mjetin më tē hollë tē pastrimit të ndërgjegjjes, dhe rrugën më tē mirë tē zbulurimit tē mendimit njerëzor, dhe më tē mirin pér zgjerimin e zemrës; kjo nuk është gjë tjetër veçse një lloj letërsie. Pér ndonjë arsyë tē panjohur, kjo letërsi është më e shtrira e shkencave, ajo ka rrezen më tē gjërë, është më depërtuesja dhe më efektivja, dhe më e afërtë pér zemrën njerëzore. Në tē vërtetë është sulltani i shkencave. Mendo me kujdes mbi këtë!

(Ashtu si vérsetet e mëparshëm) këto vérsete kanë tre aspekte që lidhen me pozicionimin e tyre dhe me renditjen e fjalëve:

**Pozicionimi i vérsetit (tē parë) në lidhje me vérsetin paraprijës ka katër aspekte:**

**I Pari:** Kur Kurani shpjegon urtësinë me qënien e njeriut kalif në vérsetin e mëparshëm, ajo është pjesa e parë e përgjigjjes, dhe është më e përgjithshme (duke iu adresuar) gjithkujt, dhe është më e lehta dhe më bindësja dhe më e shkurtuara dhe më e ngjeshura. Atëherë, me këtë vërsenai jep një përgjigje shpjeguese tē hollësishme duke i kënaqur edhe njerëzit e zakonshëm, edhe elitën.

<sup>16</sup> Kuran, 27:16

<sup>17</sup> Kuran, 27:40

**I Dytë:** Duke pasë bërë një pohim të qartë rrith qëndresë kalif tē njeriut në vérsetin e mëparshëm, me këtë vërsenai provon atë çështje me mrekullinë e atij lloji -njerëzimit- përballë melekëve.

**I Treti:** Vérseti i mëparshëm duke pasë treguar epërsinë e njerëzimit mbi melekët, ky vérset aludon pér shkakun e epërsisë së tij.

**I katërti:** Duke pasë aluduar me vérsetin e mëparshëm pér marrjen e njerëzimit kalifatin më tē lartë në tokë, me këtë vërsenai në mënyrë aluduese sjell argumente pér ta mbështetur atë. Sepse në sajë tē ndryshimit të aftësive tē njeriut dhe shumësisë së rrugëve në tē cilat ai mund t'i përdorë gjérat dhe anët e shumta tē njohjes së tij, dhe rrithimi i tij universin me pesë shqipat e tij tē jashtme dhe tē brendshme, dhe veçanërisht me ndërgjegjjen e tij tē pakufishme, ai është një kopje gjithëpërfshirëse (e botës) dhe një vend -skenë- e tē gjitha manifestimeve (tē Emrave Hyjnorë). Ju mund tē shihni se ndryshtë nga melekët, ai mund tē shijojë shijen e gjérave si mjalti në dy mënyra ose madje në më shumë! Kështu shqyrto mbi këtë!

**Pozicionimi i frazave tē vérsetit është natyrisht i lëmuar dhe i rrjedhshëm deri në shkallën më tē skajme:**

وَلَمْ أَدْعُ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا  
Dhe Ai ia mësoi Ademit emrat e tē gjitha gjérave” verifikon (tahkik) kuptimin e (frazës së fundit tē vérsetit tē mëparshëm): *in-ni  
أَنِّي أَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُونَ* *Aëlemu ma là ta-ëlemune*” “s'ka dyshim se Unē dì atë që ju nuk e dini”, dhe shtjellon atë që pohoi në mënyrë tē përmbledhur dhe shpjegon paqartësinë e saj.

Pér më tepër, funksioni i kalifit -të Allahut- në tokë është pér tē ekzekutuar urdhërat e dekreteve tij dhe pér tē zbatuar ligjet e tij, dhe kjo varet nga njohja e plotë. Po ashtu, filli dhe rrjedha e vérsetit tē mëparshëm nënkuption këto -fjalë tē pashprehura:

Kështu Ai e krijoi atë dhe e rregulloi qënien e tij, dhe fryu në tē prej shpirtit tē tij dhe e ngriti atë, pastaj Ai i mësoi atij emrat dhe e përgatiti pér tē qenë kalif. Pastaj meqenëse (Krijuesi xh.sh.) e kishte zgjedhur -

Ademin- mbi melekët dhe e dalloi atë (duke i dhënë atij) njohjen e emrave, (dhe e kishte bërë tē quartē) nē këtë çështjen e epërsisë së tij vlerën e tij tē kalifatit, konteksti duke qenë ai i sfidimit, bëri tē domosdoshëm prezantimin e gjérave -tek melekët- duke kërkuar kundërshtimet e tyre. Kështu duke perceptuar pafuqinë e tyre, ata afirmuan urtësinë e Zotit xh.sh. dhe u siguruan e u qetësan. Për këtë arsyé Kurani thotë:

**ثُمَّ عَرَضْتُمْ عَلَى الْمُلْكَةِ قَوْلَ ابْنَوْنِي بِاسْمَاءٍ هُوَ لَأَنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ** *Thumme are dahum alà el melâ'iketi fekâle enbiûni bi esmâi hâ'u'lai in kuntum sâdîkîne*, "pastaj ua paraqiti ato melekëve dhe u tha: "Më thoni Mua emrat e tyre nëse jeni tē drejtë."

"Kâlú" "ata (melekët) thanë": Domethënë, ata e deklaruan vetveten tē pafajshëm nga ajo që në egoizmin e tij Iblisi kishte bërë insinuatë duke u futur tinëz në pyetjen e tyre, duke thënë:

**سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ** *Subhâneke lâ ilme lenâ il-lâ mà al-semtendâ in-neke ente el-Alîmu el-Hakîm*, "Lavdi tê qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga çna ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".

Pastaj, kur sapo pafuqia e tij -e cila buronte nga mungesa e aftësive tē tyre gjithëpërfshirëse- u bë e quartë, konteksti bëri tē domosdoshëm një pohim tē fuqisë së Ademit, me qëllim që tē plotësonte sfidimin. Kështu Ai thotë: "ja A'demu enbiëhum biesma'iîim" "O Adem! Tregoju atyre emrat e tyre".

Pastaj kur arsyaja e nëntëshme dhe urtësia ishin treguar me shembuj konkretë dhe ishin bërë tē dukshme, konteksti (*el-mekam*) bëri tē domosdoshme përgjigjen e thukët tē mëparshme, duke e bërë atë një lloj pasoje tē shpjegimit tē detajuar këtu. Kështu Kurani thotë: *elem ekul lekum in-nî aâlemu gajbe el-semâvatî ve el-erdi ve aâlemu mà tubdûne ve mà kuntum tektumûne.*" "A nuk ju thashë Unë juve, se Unë di tē fshehten (gajbin) në qiej dhe në tokë dhe se Unë di çfarë ju shfaqni dhe çfarë ju keni mbajtur tē fshehur".

Ky përdorim i bashkëbisedimit zbulon dhe nënkupton se egoizmi i iblisit ishte shpërndarë midis engjëve dhe se kundërshtimet e një grupei (shejtanësh) ndërhynë në pyetjen e tyre.

### Pozicionimi i pjesëve të frazave:

Fraza **وَعَلَمَ أَدَمَ الْأَسْمَاءَ** "Dhe Ai ia mësoi Ademit emrat e tē gjitha gjérave". Domethënë, (Krijuesi xh.sh.) e formoi (Ademin) me një natyrë nē tē cilën përfshiheshin parimet themeltare tē tē gjitha llojeve tē arritjeve dhe tē plotësimit, dhe Ai e krijoi atë me një gjendje -aftësi- nē tē cilën u mbollën farërat e tē gjitha cilësive tē lartësuara, dhe Ai e zbukuroi, e pajisi me dhjetë shqise, dhe me një ndërgjegjje që do tē mbante shëmbëlltyrat e tē gjitha qënieve. Ai e përgatiti atë (duke i dhënë atij) këto tre aftësi që Ai tē mund t'ia mësonte atij realitetet e gjérave nē tē gjitha shumëlojshmërinë e tyre. Pastaj Ai ia mësoi atij tē gjithë emrat.

Lidhëzja "**ve**" "**dhe**" nënkupton frazat e larta tē mbështjella poshtë thukëtisë.

**"Al-leme"** "Ai ia mësoi" nē mënyrë aluduese lavdëron njohjen, dhe tregon shkallën e saj tē lartë dhe se ajo -njoha- është boshti i kalifatit. Ajo është një shenjë gjithashtu se emrat -e gjérave- u bënë tē njohura nga Allahu. Kjo mbështetet nga lidhjet e arritura kryesishët midis emrave dhe gjérave që ato shprehin. Ajo sugeron gjithashtu se mrekullitë janë një akt i Allahut pa ndërmjetësi, ndryshe nga - pretendimi- i filozofëve se çudirat janë aktet e shpirtërave tē çuditshëm.

**أَدَمَ** "A'demu" "Ademit" domethënë, personi tokësor, kalifatin e tē cilit e dëshiron Allahu xh.sh. dhe Ai i dha atij emrin Adem. Përmendja e veçantë e emrit është për ta lavdëruar, miratuar e shpallur dhe për ta shoqëruar atë (emrin) me tē.

**الْأَسْمَاءَ** "El-esmâe" "emrat", atributet, karakteristikat dhe emërtimet që tregojnë gjërat ose gjuhët (e shumta) (ose fjalët dhe termat -*el-lugat*) që i përdorin bijtë e Ademit (që i kanë ndarë midis tyre).

Gjithashtu siç tregohet nga **وَعَرَضْتُمْ** "aredahum" "ua paraqiti ato", ajo sugeron se emrat janë identike, tē njëjtë, me çfarë ato shprehin, ashtu siç pretendohet nga sunitet.

**كُلْمَه** *“Kul-leħha”* “e tē gjitha (gjērave)”, eshtë një pohim i qartë i burimit tē dallimit (tē Ademit) (ballē pērballē melekëve) dhe tē mrekullisë (sē emrave).

Domethënë, ndërsa njeriu mund tē fitojë njohje tē plotë tē emrave, njohja e melekëve eshtë e pjesshme).

#### Frazat

**شَرِّعْضُهُمْ عَلَى الْمُلْكَةِ قَالَ إِنْبُوْنِي بِاسْمَاءِ هُؤُلَاءِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ** “*thum-me aredaħum alà el melā'iketi fekale enbiúni bi esmài ha'ulai in kuntum sàdikine*” “pastaj ua paraqiti ato melekëve dhe u tha: “Më thoni Mua emrat e tyre nese jeni tē drejtē”.

**ثُمَّ** *“Thum-me”* “*pastaj*” nēpērmjet intervalit (*el-terahi*) tē treguar kētu, dhe ashtu siç bēhet e domosdoshme nga konteksti (*el-mekam*), kjo nēnkupton (fjalët e pashprehura): “Dhe (Allahu) tha: **هُوَ كَرِمٌ مِّنْكُمْ وَأَحَقُّ بِالْخِلَافَةِ** *Ai eshtë mē i nderuar se sa ju dhe mē i denjē pēr kalifat”.*

**عَرْضُهُمْ** *“Aredahum”*, *“ua paraqiti ato”* domethënë, sikur u ofrua pēr shitje. “Ai vendosi para shikimeve tē tyre gjérat e tē gjitha llojeve, sikur tē prezantonte mallērat pēr klientēt, ose si duke parakaluar trupat para komandantit.

Nē kētē eshtë një tregues se pēr qēniet me mend gjérat janē malléra tē cilat ata mund t'i blejnē nēpērmjet dijes, dhe i pronizon ato nēpērmjet emërtimit tē tyre), dhe i përvetëson nēpērmjet pērfaqësimit tē formave tē tyre.

Prapashtesa pēremërore **هُمْ** *“hum”* *“ato”* eshtë pērdorë pēr qēniet e arsyeshme mashkullore, kështu shpjegon dy gjëra qē i bējnē qēniet superiore mbi tē tjerat (*taglib*). (Domethënë, mashkullorësia dhe arsyaja) dhe metafora e aluduar nga fjala **عَرْض** *areda - Ai ua*

*paraqiti*). Sepse njeriu imagjinon prej (Allahut) duke i dērguar llojet e qēnieve tē cilat parakalojnē trup pas trupi, rresht pas rreshti para shikimeve, se ato janē regjimente -fiset- e qēnieve tē arsyeshme mashkullore duke pērparuar drejt (engjējve).

**عَلَى** *“Alà”* *“mbi”* aludon se ajo qē u paraqit -pēr engjējt- janē format (e gjērave) tē shkruara nē plakēn mē tē lartē.

**سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلِمْنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ**

*Lavdi tē qoftē Ty! Ne nuk dimē asgjē mē tepēr nga ç'na ke mēsuar Ti. Vérsetet qē vetēm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti*<sup>18</sup>.

**وَأَخْرُدْعُوْيِهِمْ أَنَّ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ** *“Ndërsa duaja e fundit do tē jetē El-Hamdu lillahi Rab-bil Aleminē”, Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janē pēr Zotin e gjithë botëve!*<sup>19</sup>

\* \* \*

<sup>18</sup> Kuran, 2:32

<sup>19</sup> Kuran, 10:10

[Në një mënyrë krejtësisht jashtë vullnetit tim, ky vërset më ndodhi mua kur unë vija tek fundi i shumicës së *Fjalëve (Sozler)* dhe i *Letrave "Mektubat"*. Tani unë kuptoj se ky koment u mbyll me të njëjtin vërset, dhe se të gjitha “*Fjalët*” janë një lloj i komentit të vërtetë mbi të dhe një rrymë shkumëzuese prej oqeanit të tij, dhe tek konkluzionet e tyre derdhen (prapë) në të. Gjithashtu është sikur fjalët vërshojnë (dhe fillojnë) nga vërseti këtu tek fundi i këtij komentimi. Prandaj, qysh nga ajo kohë (kur komenti u shkrua) unë nuk kam qenë në gjendje ta mbaroj shpjegimin e vërsetit që unë të mund të filloja volumin e tij të dytë.]

Said Nursi

## PËRMBAJTJA

• Patathënie .....	5 - 10
• Parathënie..	
• Përkujtues.	
• Shënimi i autorit për botimin turqisht.	
• Pohimi i qëllimit.	
• Ç'është Kurani? Si pëkufizohet ai?.....	11 - 27
• <b>Sure el-Fatiha</b> .....	
• Qëllimet e Kuranit.	
• Bismil-lah.	
• Lavdërimi i Allahut....	
• Adhurimi..	
• Ruga e drejtë...	
• E mira dhe e keqja.....	28 - 54
• <b>Sure el-Bekareh</b> .....	55-57
• <i>Vërseti 1:</i> Shkronjat e shkëputura.....	58 - 63
• <i>Vërseti 2:</i> Në lavdërim të Kuranit.....	64 - 72
• <i>Vërseti 3:</i> Karakteristikat e besimtarëve –besimi, namazi, zeqati.....	73 - 81
• <i>Vërseti 4:</i> Besimi në shpalljen e Kuranit dhe në shkrimet e mëparshme qiellore.....	82 - 100

- Provat e Ahiretit.
- *Vërseti 5:* Udhëzimi i drejtë i shpalljes dhe frutat e tij... 101 - 107
- *Vërseti 6:* Mosbesimtarët.
- Rreth mosbesimit..... 108 - 118
- *Vërseti 7:* Vulosja e aftësive të mosbesimtarëve.....
- Vullneti i lirë dhe krijimi i akteve të njeriut..... 119 - 134
- *Vërseti 8:* Hipokritët.....135 - 140
- *Vërsetet 9-10:* Dënim i hipokritëve.....141 - 151
- *Vërsetet 11-12:* Përhapja e korrasjonit nga hipokritët.....152 - 158
- *Vërseti 13:* Përbuzja e hipokritëve për besimtarët.....159 - 165
- *Vërsetet 14-15:* Krimi i katërt i hipokritëve: Përqeshja....
- Dënim i Allahut për hipokritët.....166 - 174
- *Vërseti 16:* Hipokritët duke këmbyer çudhëzimin për udhëzimin.....175 - 178
- *Vërsetet 17-20:* Dy shëmbëlltyra rreth hipokritëve...
- Diskutimi rreth krahasimeve alegorike dhe përdorimi i alegorisë në Kuran.....
- Një parathënie rreth elokuencës (retorikës)....
- Shëmbëlltyra e parë rreth hipokritëve.....
- *Vërsetet 19-20:* Shëmbëlltyra e dytë rreth hipokritëve....
- Përdorimi i metaforës në disa vërsete..... 179 - 210
- *Vërsetet 21-22:* Çështja e adhurimit.....
- Provat e Autorit dhe atributet e Tij.....
- Shpjegimet e renditjes së fjalëve.....211 - 240

- *Vérsetet 23-24:* Rreth profetësisë së Muhammedit a.s.m.....
- Përgjigja për tre pyetje të ngritura rreth Kuranit, lidhur me vérsetet alegorike, paqartësia e tij lidhur me shkencën, dhe disa nga kuptimet e tij të fjalëpërfjalëshme duke kundërshtuar në pamje të jashtme realitetin.....
- Dëshmi të mëtejshme për profetësinë e Muhammedit a.s.m.....
- Paimitureshmëria e Kuranit.....
- Rreth Ferrit.....
- Paimitureshmëria e Kuranit.....241 - 282
- *Vérseti 25:* Rreth Parajsës.....
- Dëshmitë përfundin e Botës dhe për Ringjalljen trupore.....
- Rreth jetës së përjetshme dhe lumturisë së përjetshme.....283-301
- *Vérsetet 26-27:* Sfidimi i Kuranit me paimitureshmërinë e tij.....
- Një shpjegim i përgjegjshmërisë së njeriut rreth mëkatit dhe çudhëzimit.....302 - 325
- *Vérseti 28:* Rreth jetës, vdekjes dhe ringjalljes së të vdekurve.....326 - 338
- *Vérseti 29:* Gjithçka mbi tokë duke qenë e krijuar për njerëzimin.....
- Krijimi i qiejve dhe i tokës.....
- Lidhur me shtatë qiejt.....339 - 353
- *Vérseti 30:* Kalifati i njeriut dhe prova e engjëeve.....354 - 367
- *Vérsetet 31-33:* Mësimi i emrave.....368 - 379
- Përm bajtja ..... 380 - 382

